ENVER HOXHA

DITAR

PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE

(MATERIALE NGA VITET 1977 - 1980)

TIRANË, 1981

SHËNIM

Materialet që botohen në këtë vëllim — për përdorim të brendshëm — përfaqësojnë vetëm një pjesë të shkrimeve të shokut Enver Hoxha që ndodhen në Ditarin e tij Politik të viteve 1977, 1978, 1979 dhe 1980, mbi disa nga ngjarjet më kryesore ndërkombëtare. Në këtë vëllim nuk janë përfshirë materialet e Ditarit Politik që kanë përbërë tezat dhe bazën themelore mbi të cilat shoku Enver ka shkruar veprat e tij «Imperializmi dhe revolucioni», «Eurokomunizmi është antikomunizëm» si dhe ato që janë vendosur në vëllimin e tretë të librit «Shënime për Kinën», (në dy libra — 1978 e 1979), vënë në qarkullim si botim i brendshëm.

Materialet e tjera të shumta, panorama, analiza, komente e teza, rreth ngjarjeve të veçanta e të përgjithshme ndërkombëtare, mbi politikën e vendit tonë, lëvizjen marksiste-leniniste, ngjarjet në Kinë e në gjirin e partive revizioniste e të tjera, do të botohen më vonë, sipas viteve përkatëse, në serinë e librave të Ditarit Politik.

Tiranë, shkurt 1981

1977

KONFERENCA E MOSSIGURIMIT EVROPIAN NË BEOGRAD SHËNOI DISFATËN E «BOTËS SË TRETË» DHE «TË PAANGAZHUAR»

Konferenca e mossigurimit evropian që po mbahet në Beograd i mbylli në bisht peshku sesionet e saj të panumërta. Kjo konferencë vazhdoi tetë javë dhe sipas komunikatës del se atje nuk u mor asnjë vendim, por ajo gjoja do të mblidhet përsëri në shtator, pastaj do të mblidhet prapë nga tetori, do të shtyhet për në janar dhe perspektiva është e zymtë. Është pikërisht ajo perspektivë që Partia jonë ka parashikuar e ka deklaruar para se të mblidhej konferenca e «Sigurimit dhe e Bashkëpunimit në Evropë» që u mbajt në Helsinki.

Kur Napoleon Bonaparti u thye nga ushtritë e koalicionit ruso-austriak e të tjerë, abdikoi në Fontenëblo dhe u çua në ishullin e Elbës, në Vjenë u thirr një kongres ku perandorë, mbretër e kancelarë ditën mblidheshin dhe bënin llogje, kurse në mbrëmje hidhnin valle me princeshat, baroneshat e konteshat. Kështu Kongresi i Vjenës, që, në qoftë se nuk gabohem, u mbajt më 1815, hyri në histori si kongresi që «vallëzonte». Gjatë kësaj kohe *«L'ogre de Corse»*, siç e quanin Napoleonin, përgatiti kthimin nga ishulli i Elbës në Francë. Është i njohur itinerari i tij dhe bashkimi me të në mes të rrugës i mareshalit Neji, i cili ishte dërguar nga Luigji i 18-të që t'i priste rrugën. Napoleoni hyri në Paris dhe qëndroi në

fuqi 100 ditë, pastaj e mbaroi karrierën e tij të përgjakshme me Vaterlonë dhe, më së fundi, vdiq në Shën-Elenë.

Edhe kjo, Konferenca e Beogradit, i përngjet një balloje, ku dy ishin dirigjentët e orkestrës së madhe e të konferencës që zhvillohej në sallonet plot salltanete të një ndërtese kolosale që është ndërtuar apostafat me paratë amerikane në Beograd dhe që ka kushtuar 16 e ca milionë dollarë. Në këto sallone hidhnin valle marionetat e imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik. Çfarë thoshin ato atje? Asgjë të mirë për Evropën. Dukej qartë që ato kishin vajtur në këtë mbledhje për pallavra, pra, për të bërë muhabete. Ishte një komedi e vërtetë, ku sovjetiku ngrinte zërin e kërcënonte, pastaj ndërhynte polaku me propozime për amendamente, kurse amerikani thërriste për «të drejtat e njeriut». Njëri ngrihej dhe përgjigjej, tjetri i bënte replika, një bënte propozime për korrigjime, tjetri nuk ishte dakord t'i bëheshin ndryshime propozimit të të parit. Çaushesku bënte propozime, norvegjezi bënte edhe ai propozime. Të gjithë hanin e pinin, kurse Titoja fitonte dollarë.

Diplomacia titiste u lodh, u rraskapit që të arrihej ndonjë sukses, pse dëshironte të kishte njëfarë rezultati në kryeqytetin e famshëm të «këtij burri kaq të madh», siç është Titoja. Ky i jepte një rëndësi të madhe kësaj konference dhe donte ta mbyllte jetën e tij, si thotë francezi, *«en beauté»*[1], por e mbuloi *«aveuglement»*[2].

Konferenca e Beogradit tregoi me të vërtetë se manipulohej nga dy superfuqitë, ashtu siç ka vënë në dukje Partia e Punës e Shqipërisë. Dhe këtë fakt e njohin të gjitha shtetet. Gjithë të tjerët që merrnin pjesë në Konferencën e Beogradit ishin jallanshahitë. Edhe në të ardhmen do të hidhen valle në konferenca të tilla, që do të

1 Frëngjisht — me lavdi.
2 Frëngjisht — me verbim.

mbarojnë në bisht peshku. Do të vendoset sigurisht që në vazhdim një konferencë e tillë të mbahet, ku ta di unë, në ndonjë qytet të «gjyshes së madhe» të Luksemburgut, ose në ndonjë vend tjetër të vogël, si në Rumani, për shembull, për të treguar që edhe kjo «është një vend asnjanës», që i reziston «heroikisht» presionit sovjetik e pallavra të tjera.

Në këtë konferencë pësuan disfatë të madhe jo vetëm Titoja, jo vetëm «bota e paangazhuar», jo vetëm «bota e tretë», por edhe kinezët. Këta nuk kanë ç'të bëjnë, jashtë dëshirës së mikut të tyre Tito. Janë të detyruar të vënë në dukje **se ekzistojnë antagonizma të thellë në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, se ekzistojnë gjithashtu mosmarrëveshje të thella në mes të gjitha shteteve të Evropës që i futin në «botën e tretë» e në «botën e dytë» dhe për të cilat Kina predikon një aleancë kundër sovjetikëve. «Teoria» kineze nuk pati sukses.** Po kështu nuk do të ketë sukses as deklarata që i bëri Valdhajmit ministri i Jashtëm kinez, Huan Hua kur tha se duhet të marrë fund preeminenca ose dalja më shumë në skenë nga të tjerët e dy superfuqive në OKB. Dhe zhdukja e kësaj influence të superfuqive, sipas të zgjuarit ministër të Jashtëm kinez, do të shkaktohet nga «bota e tretë», të cilën e udhëheq Hua Kuo Feni.

Por «bota e tretë» e kinezëve dhe «bota e paangazhuar» e Titos formohen nga të njëjtat shtete, që janë të angazhuara dhe të lidhura me kapitalin botëror, prandaj demagogjitë e kinezëve dhe të Titos po demaskohen njëra pas tjetrës. **Vetëm nga revolucioni, vetëm nga lufta e vendosur kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik dhe kapitalizmit, që zhvillojnë proletariati botëror dhe popujt që kërkojnë clirim, do të ketë shpëtim njerëzimi. Ky shpëtim i njerëzimit do të arrihet duke u udhëhequr nga teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit.** Kësaj teorie kurrë nuk duhet

t'i shtohet ndonjë bisht, si «teoria» e Mao Ce Dunit (maocedunideja), pse kjo nuk është një teori marksiste-leniniste, por teori oportuniste, revizioniste. Për fat të keq të «teorisë» ose të «ideve» të Mao Ce Dunit, vetë udhëheqja aktuale kineze po e hedh atë në shportë. Ten Hsiao Pini është një revizionist me damkë, që ka qenë në kundërshtim edhe me ideologjinë dhe me politikën eklektike të Mao Ce Dunit. Ai, në kohën kur rronte Liu Shao Çia, ka qenë për një politikë të vendosur në aleancë me Bashkimin Sovjetik, gjoja kundër imperializmit amerikan. Ten Hsiao Pini i sotëm është për një politikë afrimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe përpiqet që mundësisht të përmirësojë punët edhe me Bashkimin Sovjetik.

Kjo është arsyeja që në ekspozitat e sotme të ushtrisë shikohet vetëm një fotografi e Mao Ce Dunit dhe me dhjetëra të Hua Kuo Fenit, i cili ka qenë një hiçgjë në kohën e revolucionit që çliroi Kinën dhe të Revolucionit Kulturor. Me dhjetëra e dhjetëra portrete e tablo të Çu En Lait, si udhëheqës kryesor i çlirimit të Kinës dhe me dhjetëra e dhjetëra fotografi të Ten Hsiao Pinit duken tani në të gjithë Kinën. Kështu dalngadalë po zhduket dhe ajo influencë e Mao Ce Dunit që ka mbetur në Kinë. Emri i Maos atje do të ruhet, por do të zbrazet nga gjithë esenca e tij, duke lënë vetëm ato fraza ëndërruese që mund t'i shërbejnë klikës revizioniste.

E HËNË
19 SHTATOR 1977

TË DEMASKOHEN FORT ARMIQTË E POPUJVE ARABË
(Teza për artikull[1])

Bisedova me Ramizin për vizitën që Anuar el Sadati do të bëjë pas disa kohe në Izrael. Është rasti që t'u bëjmë një demaskim të fortë armiqve të popujve arabë e, në mënyrë të veçantë të popullit palestinez, imperialistëve amerikanë, socialimperialistëve sovjetikë dhe qarqeve reaksionare arabe. Udhëtimi i Sadatit në Izrael është pjesë e komplotit të përbashkët imperialisto-sionist dhe i reaksionit arab kundër interesave dhe të drejtave të popujve arabë. Për këtë çështje i dhashë Ramizit udhëzime të hollësishme dhe teza të zgjeruara për një artikull, në të cilin të demaskohen edhe vepra e politika kapitulluese e Sadatit, por pa e përmendur atë me emër.

Agresorët duhen izoluar, ata duhen demaskuar e duhen luftuar. Një agresor i tillë kundër popujve arabë, kundër lirisë, pavarësisë dhe tërësisë territoriale të tyre është Izraeli. Ky i ka gjakosur popujt vëllezër arabë, ka pushtuar tokat e tyre. Izraeli çdo ditë e vazhdimisht godet, vret e pret një popull të lavdishëm, siç është populli vëlla palestinez, të cilin sionistët, të mbështetur nga imperialistët amerikanë, e kanë lënë pa atdhe. Populli heroik

1 Botuar në gazetën «Zëri i popullit» me titullin «Çështja e drejtë e popujve arabë është e pamposhtur» — 24 nëntor 1977.

palestinez tani është shpërndarë dhe jeton i mjeruar si muhaxhir, si mik në shtëpitë e vëllezërve të tij arabë. Megjithëse i vrarë e i copëtuar, ky popull ka një frymë e një ndërgjegje të lartë luftarake. Ai kurrë ndonjëherë nuk i ka ulur armët për të fituar lirinë, të drejtat dhe atdheun e vet. Populli shqiptar ushqen një dashuri, një respekt e admirim të madh për këtë popull trim e të shumëvuajtur dhe ka besim të patundur në fitoren e tij përfundimtare.

Të bihet në ujdi e të bëhet kompromis me Izraelin, të lihen mënjanë dhe të merren nëpër këmbë interesat e popujve arabë, sidomos interesat e popullit palestinez e të atij sirian, është e dënueshme. Populli shqiptar, si mik i ngushtë e besnik i popujve arabë, e konsideron këtë si një veprimtari të drejtuar kundër interesave të arabëve, si proimperialiste e që nxit agresionin imperialisto-izraelit.

Gjithë opinioni i shëndoshë arab, që nga vetë palestinezët e sirianët, algjerianët, irakianët, libianët e deri tek egjiptianët, është prononcuar kundër ujdisë e kundër kompromisit me Izraelin. Gjithashtu të gjithë ata që janë luftëtarë të vërtetë kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, kundër reaksionit e shtypjes, të gjithë ata që janë për lirinë e popujve dhe luftën e tyre çlirimtare, e kanë dënuar dhe e kanë kritikuar pa ekuivok gjunjëzimin ndaj Izraelit, kanë mbajtur qëndrim të prerë kundër kompromisit me Izraelin.

Por vihet re se nuk po luan fare karta e «të paangazhuarve». Dhe kjo nuk është e rastit. Falsitetin e «teorive» ose të «lëvizjeve» që janë destinuar për mashtrimin e popujve, e nxjerrin në shesh ngjarjet konkrete, zhvillimi i luftës së klasave. Ç'të thonë partizanët e lëvizjes së «të paangazhuarve», kur protagonistët e kompromiseve të tilla, që janë edhe flamurtarë të «mosangazhimit», e tregojnë hapur se janë të angazhuar dhe të varur nga imperializmi, se bëjnë lojën e tij, se politika që ndjekin, formalisht është e pavarur, por në realitet diktohet nga të tjerët, mbron interesa të huaja për popujt arabë.

Nuk po duket, gjithashtu, as veprimtaria e së ashtuquajturës botë e tretë. Përkrahësit e kësaj teorie, që bërtasin me të madhe dhe përpiqen ta provojnë me citate se ndihmojnë luftën e interesat e popujve të botës, nuk po i shohim që të mbrojnë kauzën e drejtë të popujve arabë, nuk po dalin në mbështetje të tyre. Përse vallë? Mos duhen sakrifikuar interesat e arabëve, tokat e tyre, fati dhe jeta e palestinezëve për hir të aleancës me «botën e dytë» dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Apo ndoshta kështu e duan interesat e larta të superfuqive imperialiste, që popujt e vegjël dhe njerëzit e thjeshtë nuk arrijnë t'i kuptojnë dot?

Partia jonë e populli shqiptar i hedhin poshtë me përbuzje të gjitha llogaritë imperialiste. Populli ynë ka qenë dhe është gjithnjë me kauzën e drejtë të popujve arabë dhe do të jetë përkrah tyre në çdo situatë, të mirë e të keqe, në gëzime e në fitore si dhe në hidhërime e në disfata të përkohshme. Populli ynë është një popull i vogël, por për popujt që luftojnë për liri e për të drejtën, si ata arabë e të Afrikës, ai është një vëlla besnik i patundur.

Po konstatojmë se politika e përgjithshme që ndjekin superfuqitë imperialiste është ndërtuar në përputhje me interesat e tyre, kush të vendosë më mirë e më shpejt hegjemoninë e vet mbi popujt, mbi kontinentet. Secila nga superfuqitë imperialiste, si kur i ka futur thellë thonjtë, ashtu edhe kur është duke ngulur piketat e para të ekspansionit, lufton t'u imponojë vendeve e grup-vendeve politikën e vet.

Socialimperialistët sovjetikë punojnë që të gënjejnë udhëheqje të vendeve të ndryshme të Afrikës, duke u shtirë si kampionë të lirisë. Ata u shesin armë këtyre udhëheqjeve dhe fitojnë të drejtën për të krijuar baza ushtarake

për interesat e veta sunduese imperialiste. Kështu ndodhi në Somali. Por, njëkohësisht, një fuqi tjetër imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, manovruan me shpejtësi dhe nëpërmjet agjentëve të tyre, kredive, armëve e dollarëve i luajtën të gjithë gurët për t'ua ngritur këmbët pas një kohe socialimperialistëve sovjetikë.

Viktima të këtyre lojërave të rrezikshme e interesave imperialiste bien popujt. Shohim që popujt e Etiopisë e të Somalisë dy popuj liridashës e paqedashës, me një kulturë të lashtë dhe që kanë vuajtur të zitë e ullirit nga kolonialistët italianë, kanë hyrë në luftë dhe po vriten me njëri-tjetrin. A e duan këta popuj këtë luftë? Aspak. A mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që kanë në mes tyre pa qenë nevoja për luftë? Sigurisht, mund t'i zgjidhin e të gjejnë rrugët e përshtatshme. Atëherë pse luftojnë? Është e qartë se këta i shtyjnë në luftë të tjerët, fuqitë e superfuqitë imperialiste, për interesat e veta grabitqare e hegjemoniste.

Ndërsa derdhet gjaku i popujve të mjeruar dhe rritet urrejtja midis tyre, ka fuqi imperialiste e kapitaliste që herë marrin anën e njërit, herë të tjetrit, herë duartrokasin njërin vend, herë tjetrin, pa bërë as gjestin më të vogël për të ndihmuar këta popuj të shumëvuajtur që të fitojnë paqen dhe mundësinë për të ndërtuar jetën e tyre në liri e në pavarësi të plotë.

Politika e Partisë sonë është e qartë. Ajo mbështet luftën nacionalçlirimtare të popujve, përkrah interesat e tyre. Ne u flasim popujve vëllezër hapur, ashtu siç i gjykojmë e i mendojmë gjërat. Ata duhet të ruhen nga intrigat e superfuqive imperialiste, të cilat zakonisht vijnë si miq, si dashamirës, por qëllimi i tyre i vërtetë është të dominojnë, të hedhin bazat për vendosjen e hegjemonisë së vet. Kjo ngjet në Angola, në Zaire e gjetkë. Kjo po ndodh për një kohë të gjatë në Lindjen e Mesme, ku po luhet një dramë e rëndë me fatet e popujve vëllezër

arabë. Në këtë rajon superfuqitë imperialiste luajnë të gjitha fijet, alternojnë njëra-tjetrën, për të plotësuar ambiciet ekspansioniste e shfrytëzuese.

A mund të konsiderohet politikë joagresive e në tërheqje, politika e imperialistëve amerikanë që mbrojnë dhe mbështetin satelitin e tyre më agresiv, Izraelin? Në kohën e sotme lufta agresive përgatitet shkallë-shkallë, nëpërmjet luftërave të pjesshme, duke nxitur agresione të veçuara, luftëra lokale. Në qoftë se imperialistët amerikanë shpallin se janë për statukuonë, kjo nuk do të thotë se kanë hequr dorë nga synimet agresive e ekspansioniste, por se statukuoja u intereson dhe është në favor të interesave të imperializmit amerikan e aleatit të tij, Izraelit.

Ne jemi kundër dhe e demaskojmë këtë maskim që i bën Karteri politikës së tij agresive. Ne i demaskojmë të gjithë ata që duan ta paraqesin politikën e statukuosë si një politikë joagresive, por mbrojtëse. Imperializmit amerikan akoma s'i kanë rënë dhëmbët dhe as i janë prerë thonjtë.

E SHTUNË
17 DHJETOR 1977

ÇËSHTJA E LINDJES SË MESME NË DRITËN E NGJARJEVE TË FUNDIT

Siç dihet, imperialistët amerikanë kanë hedhur thonjtë në Lindjen e Mesme dhe kanë ndërmarrë rregullimin e një paqeje ala amerikane në këtë rajon, duke përjashtuar Bashkimin Sovjetik, konkurrentin e tyre kryesor. Në këtë gjendje ne shohim një ashpërsim të mëtejshëm të kontradiktave në mes imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Të dy këta kalanderë përpiqen të ndajnë zonat e tyre të influencës në këtë rajon.

Dihet se Lindja e Mesme është një rajon me rëndësi të madhe strategjike në çështjen e lëndëve të para e të pasurive të tjera natyrore, të tregjeve, po kështu edhe nga pikëpamja ushtarake në lidhje me një luftë të madhe eventuale. Flotat detare në Mesdhe, si ajo amerikane, ashtu edhe ajo sovjetike, përpiqen të krijojnë baza të përhershme në këtë pjesë të botës.

Bashkimi Sovjetik, siç e dimë, u përpoq dhe zuri vend për një kohë në Egjipt dhe në Siri, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia ngritën këmbët nga Egjipti me anën e Sadatit, i cili bëri si bëri dhe, pas luftës së Kipurit, i nxori sovjetikët jashtë nga Egjipti. Por, siç dihet, ai i nxori jashtë sovjetikët, për të kallur brenda vendit amerikanët. Sovjetikët kanë mbetur tashti në Siri, së cilës vazhdojnë t'i japin ndihma për të pasur aty një bazë detare të fuqishme. Sovjetikët, pas humbjes së Egjiptit, natyrisht u përpoqën që të kenë baza të tjera në detin Mesdhe dhe ia arritën qëllimit: u lidhën me Kadafin e Libisë, po e armatosin këtë, marrin prej saj naftën dhe njëkohësisht gjetën mundësinë që të krijonin në këtë vend baza ushtarake dhe detare.

Me Algjerinë, po ashtu, sovjetikët po flirtojnë dhe kanë disa fitime, në mos plotësisht strategjike, politike, për arsye se ky vend është në konflikt me Marokun dhe me Mauritaninë. Konflikti është ndezur për çështjen e Saharës Perëndimore. Algjeria mbështet Frontin POLISARIO, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështetin mbretin e Marokut dhe Mauritaninë. Nga ana tjetër, siç e dimë, imperializmi amerikan është lidhur fort edhe me Arabinë Saudite, me shahun e Iranit, me Emiratet e Gjirit Persik, me Izraelin e tash edhe me Egjiptin e me mbretin Husein të Jordanisë.

Shohim, pra, dy blloqe në luftë kundër njëri-tjetrit për të vendosur secili hegjemoninë e vet në këtë rajon në kurriz të popujve arabë. E gjithë politika e superfuqive synon në atë që të përçajë unitetin dhe aleancat e popujve arabë, të pengojë realizimin e aspiratave të tyre dhe secila prej tyre të sundojë sa të jetë e mundur më mirë e më lehtë mbi këta popuj.

Në këtë çështje Egjipti dhe Izraeli janë dy protagonistët kryesorë në ngjarjet ushtarake që zhvillohen në këtë rajon. Partneri tjetër më pak i rëndësishëm është Siria. Sadati i bëri për vete amerikanët dhe, pa pasur aprovimin e vendeve të tjera arabe, me të cilat hiqej se ishte i lidhur ngushtë, ndërmori një veprim «të guximshëm», shkoi në Izrael, u takua me kryeministrin e Izraelit, Begin, e me anëtarët e parlamentit izraelit, knesetit, dhe filloi atje tratativat e paqes. Sadati u prit shumë mirë nga izraelitët. Bisedimet në fasadë, natyrisht, qenë të përzemërta, por të gjitha këto bisedime ishin të sinkronizuara nga «shkopi i dirigjentit», presidenti Karter.

Në vija të përgjithshme Sadati, Begini dhe Karteri ishin marrë vesh qysh më parë jo për të gjitha problemet, por për ato më kryesoret. Aktualisht këto probleme kryesore po shtjellohen në Kajro, në Uashington dhe gjetkë. Në Kajro tash janë grumbulluar e po bisedojnë ekspertët e të dy vendeve, të Egjiptit dhe të Izraelit. Çfarë bisedojnë, ne nuk dimë akoma shumë gjëra, pse agjencitë e huaja të lajmeve nuk pipëtijnë gjëkafshë të rëndësishme.

Ato gjëra të pakta që thonë lënë të kuptohet se miqësia në mes egjiptianëve dhe izraelitëve sa vjen e po trashet. Kjo duket nga fakti se izraelitët flasin me admirim të madh për Egjiptin, për udhëheqjen e tij. Kjo duket, gjithashtu, edhe nga pritja jashtëzakonisht e ngrohtë që po u bëhet izraelitëve në Kajro, ku rruga që çon nga kryeqyteti egjiptian për në piramidat u quajt «Rruga e paqes».

Gjatë gjithë kësaj kohe Begini sillet rreth e rrotull. Ai shkoi në Francë, ku pati bisedime të përzemërta me Zhiskar d'Estënin, i cili e mbështet këtë «vijë paqësore». Begini shkoi gjithashtu në Gjermaninë Perëndimore që gjithashtu e mbron këtë «vijë paqësore». Tash së fundi Begini ka shkuar në Uashington. Sigurisht, ai është thirrur në kryeqytetin amerikan nga Karteri për të precizuar akoma edhe më mirë vullnetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këto tratativa. Dhe siç po duket, Karteri me Beginin kanë rënë në ujdi të mira. Kështu Begini, siç bëjnë të ditur agjencitë e lajmeve, do të shkojë të takohet me Sadatin në Egjipt dhe do të përfundojë me këtë të fundit një marrëveshje. Çfarë marrëveshjeje do të jetë kjo në kushtet e sotme? Mund të jetë, dhe ka shans të jetë, një paqe dypalëshe, domethënë në mes Egjiptit dhe Izraelit, e cila, do të bëhen përpjekje që më vonë të mund të pranohet edhe nga Siria, ndoshta edhe nga vendet e tjera arabe që aktualisht e kanë kundërshtuar. Me këtë rast mund t'i jepet Sadatit shkretë-

tira e Sinait, natyrisht, duke i akorduar Izraelit shumë të drejta të konfirmuara dhe të siguruara edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si kalimin e lirë e pa pengesa të anijeve të saj nëpërmjet kanalit të Suezit për në Detin e Kuq e nëpërmjet ngushticës së Bab-el-Mandabit dhe gjirit të Adenit për në Oqeanin Indian, dhe kanali të mbetet krejt i lirë ose nën drejtimin e të dyja palëve.

Nga ana tjetër, kjo marrëveshje dypalëshe për «paqe» mund të çojë po ashtu në zgjidhjen «në parim» të çështjes palestineze. Kjo zgjidhje «në parim» e çështjes palestineze, natyrisht do të bëhet sipas qejfit të amerikanëve dhe të izraelitëve e do të pranohet edhe nga Sadati. Pra, synimi është të krijohet një «shtet palestinez» ku të përfshihet bregu perëndimor i lumit Jordan, Cisjordania, si dhe rripi i Gazës në brigjet e Mesdheut, ose, më mirë të themi, jo një shtet i pavarur palestinez, por një entitet me anë të të cilit vetëm sa të njihet ekzistenca e palestinezëve, të bashkuar me mbretërinë hashemite të Huseinit.

Ky mund të jetë akordi ose marrëveshja paqësore dypalëshe në mes Egjiptit dhe Izraelit e kurdisur nga imperializmi amerikan. Natyrisht, nga të parët që do të aderojnë dhe do ta pranojnë këtë marrëveshje do të jenë Arabia Saudite, Irani, Maroku dhe Emiratet e Gjirit Persik. Vendet e tjera arabe do ta pranojnë më vonë, pasi çështja e Golanit sirian të gjejë njëfarë zgjidhjeje. Se çfarë zgjidhjeje do t'i japë ky traktat dypalësh çështjes së Golanit sirian, do të shikohet, por amerikanët kanë tendencë që edhe Sirinë ta bëjnë me vete. Me fjalë të tjera, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që Bashkimit Sovjetik t'i ngrihen këmbët edhe nga Siria e, për të arritur këtë objektiv, duhet medoemos t'i japin disa të drejta e disa privilegje edhe Sirisë. Kjo, mendoj unë, do të bëhet më vonë, pas shumë tratativave që do të zhvi-

llojnë për këtë problem Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Sadati dhe mbreti Saud i Arabisë Saudite.

Në qoftë se arrihet që edhe Sirinë ta futin në kllapë, atëherë kush mbetet tjetër atje? Mbetet Iraku. Ky aktualisht nuk e mbështet Sadatin, por edhe me Sirinë nuk është në marrëdhënie të mira, për arsye të ambicieve territoriale nacionaliste. Të dyja partitë Baas, që sundojnë në këto vende, janë në kundërshtim e në luftë me njëra-tjetrën. Mirëpo Iraku neutralizohet lehtë nga ana e imperializmit amerikan. Mbeten kështu Algjeria, Libia dhe Libani. Ky i fundit është një shtet-kozmopolit, i cili është gati të zhveshë brekët dhe zaten i zhvesh këto në çdo minutë. Borgjezia e Libanit është një borgjezi që dëshiron të bëjë tregti, të luajë kumar, të bëjë tratativa dhe spekulime me të gjithë, prandaj Libani është, si me thënë, nën saçin e imperializmit amerikan dhe izraelit. Në këto kushte imperializmi amerikan nuk llogarit shumë rezistencën e Libisë dhe të Algjerisë për të ngatërruar planin e tij në Lindjen e Mesme.

Gurët kryesorë të kësaj loje shahu, Egjiptin, Arabinë Saudite dhe Izraelin, i kanë në dorë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson shumë që Bashkimit Sovjetik të mos i zënë këmbët dhe as në Libi, as në Algjeri dhe natyrisht për këtë ato do të përpiqen.

Karteri kohët e fundit bëri një deklaratë në shtyp dhe tha se do të vijë në Evropë. Ai do të shkojë në Francë, ku do të bisedojë me Zhiskar d'Estënin. «Unë jam shumë i interesuar të bisedoj me Zhiskar d'Estënin, deklaroi ai, pse Franca është një vend që, pavarësisht se nuk është në NATO, e mbështet NATO-n, që është një mbrojtje e sigurt për të cilën të gjithë ne duhet të interesohemi. Por unë, vazhdoi Karteri, do të bisedoj me Zhiskar d'Estënin veçanërisht për Afrikën, se Franca ka një njohje të madhe dhe të vjetër për këtë kontinent dhe neve, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, na intereson shumë çështja afrikane». Një deklaratë e tillë nga ana e imperializmit amerikan s'ka si bëhet më qartë. Imperializmi amerikan dëshiron të forcojë pozitat e tij ekonomike, strategjike dhe politike në kontinentin afrikan. Ai do të luftojë që Bashkimi Sovjetik të mos gjejë vend ku të mbështetet atje dhe kudo ku ka mundur të krijojë baza ose zona influence në Afrikë t'i likuidohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, në këtë veprim imperializmi amerikan do të ruajë interesat e Francës dhe të Anglisë në Afrikë derisa edhe këto t'i mbytë gradualisht nëpërmjet influencës së vet.

Ne shohim që aktualisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës ia ngritën këmbët Bashkimit Sovjetik nga Somalia presidenti i së cilës, që ishte prosovjetik, tash është kthyer në proamerikan dhe ka shkuar në Uashington, ku sigurisht i ujdisi letrat me Karterin dhe në fakt, prej një kohe mjaft të gjatë, në mes Somalisë dhe Etiopisë po zhvillohen luftime. Etiopia që doli nga gjendja e mjeruar mesjetare e Haile Selasiesë, nuk ka gjetur akoma stabilitet. Pikërisht nga kjo mungesë stabiliteti kanë përfituar sovjetikët, të cilët, ku gjejnë një vrimë miu hapur, futen përnjëherë, japin armatime, në radhë të parë, si dhe ndonjë ndihmë të vogël ekonomike e teknike. Ata kanë zbarkuar në Etiopi ushtri kubane, oficerë e instruktorë sovjetikë dhe kubanë, të cilët organizojnë dhe hedhin në luftë etiopianët kundër somalezëve. Ky konflikt, natyrisht, do të përfundojë me fitoren e influencës së amerikanëve dhe me shembjen e influencës së sovjetikëve në këtë pjesë të Afrikës.

Megjithëkëtë situatë të rëndë e të koklavitur që po zhvillohet në kurrizin e popujve arabë e që përbën një rrezik të madh për paqen botërore, Kina e Hua Kuo Fenit, me tërë kuptimin e fjalës rri dhe bën sehir. Ajo bën sehir me ankth në zemër, pse nuk di ç'pozita të mbajë, ngaqë është

e hutuar dhe e turbulluar nga gjendja e saj e brendshme e rëndë dhe nga teoritë e saj të kalbura.

Në këto tratativa të mëdha që po ndërmerr imperializmi amerikan në Afrikë me Sadatin dhe në Etiopi, s'ka asnjë dyshim se Kina është pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe pro paqes bilaterale. Zaten asaj i pëlqen shumë politika bilaterale, por në këtë mes ajo po demaskohet përpara syve të të gjithë botës, pse nuk thotë haptazi as se është pro këtyre ngjarjeve të drejtuara nga «shkopi i dirigjentit» amerikan, as se është kundër. Kemi të dhëna që ambasadorëve kinezë po u bëhen pyetje kudo për këto çështje dhe ata pa pikë turpi përgjigjen se «ne nuk flasim, nuk marrim pjesë, për arsye se këto probleme janë të koklavitura». Të tjerët, që i dëgjojnë këto përgjigje kineze, skandalizohen dhe thonë: «Si është e mundur të mbahet ky qëndrim? Si është katandisur një shtet i tillë i madh që quhet socialist, sa të mbyllë gojën dhe të thotë se nuk përzihem në këto çështje kaq të mëdha, për arsye se janë të koklavitura?». Me fjalë të tjera, të gjithë e kuptojnë se Kina është futur në llumin e një rendi e të një shteti kapitalist, por të një shteti kapitalist kaotik dhe të çorganizuar, që gjendja nuk e lejon të mbajë një qëndrim, të ketë një pikëpamje të saj dhe ta thotë këtë pikëpamje siç bën çdo vend kapitalist, qoftë edhe i vogël.

Ja, deri këtu e ka çuar vija antimarksiste revizioniste e Mao Ce Dunit Kinën e madhe, tek e cila ne kemi pasur besim se do të luftonte me konsekuencë kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik.

1978

SHPREHJE E NDJENJAVE ARMIQËSORE TË UDHËHEQJES REVIZIONISTE KINEZE NDAJ VENDIT TONË

Dje, më 11 Janar, ishte festa e madhe e shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë. Republika Popullore e Shqipërisë u realizua pas një Lufte të madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër armiqve më të egër, fashizmit italian, nazizmit gjerman dhe kundër feudalizmit, bejlerëve e ballistëve. Populli derdhi gjak për këtë ditë të shënuar, vendi u dogj, u bënë sakrifica të mëdha, që i shërbyen jo vetëm çlirimit kombëtar, por edhe atij ndërkombëtar, sepse Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar ishte një ndihmë edhe për popujt e tjerë që luftonin kundër të njëjtëve armiq.

Pra, shpallja e Republikës sonë Popullore është një ditë solemne, një ditë feste, një ditë e madhërishme për popullin shqiptar, e paharrueshme në shekuj!

Vetëm kinezët nuk morën mundimin të thoshin qoftë edhe një fjalë për këtë ditë kaq të shënuar të popullit shqiptar. Pavarësisht nga kontradiktat ideologjike që ne kemi me udhëheqësit e Partisë Komuniste të Kinës dhe të shtetit kinez, miqësia midis popullit kinez dhe popullit shqiptar do të ekzistojë kurdoherë dhe këtë miqësi ne nga ana jonë do ta kultivojmë gjithnjë në rrugë të drejtë e të sinqertë, marksiste-leniniste. Mirëpo këtë gjë udhëheqësit kinezë nuk e bëjnë dhe një gjë e tillë tregon ndjenjat ar-

miqësore të tyre që janë jo vetëm revizionistë të egër, por dhe apolitikë, sepse nuk kanë asnjë fije sensi politik.

Flas në këtë mënyrë se edhe revizionistët sovjetikë, të cilët pavarësisht se jemi të vegjël, ideologjikisht na konsiderojnë armiqtë kryesorë të tyre, nuk harruan ta përmendnin ditën e Republikës sonë, 11 Janarin dhe jo vetëm kaq, por ata kujtojnë vazhdimisht edhe data të tjera të shënuara të historisë së popullit shqiptar. Bile në radiot e tyre ata flasin edhe për përvjetorët e heronjve tanë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ose të luftërave tona kundër otomanëve. Revizionistët sovjetikë flasin bile edhe për materialet tona.

Pse shkruajnë e flasin ata për të gjitha këto? Këtë e bëjnë, jo se na duan, por me këtë tregojnë se nuk janë budallenj, siç janë revizionistët kinezë. Të ligj janë dhe ata, po aq sa edhe kinezët, por dinë të bëjnë politikë. Ata mendojnë se radion e tyre e dëgjon populli shqiptar dhe pikërisht këtu u rreh çekani, këtu i kanë synimet dhe qëllimet e tyre që populli shqiptar të dëgjojë emisionet e tyre dhe të mendojë se Bashkimi Sovjetik revizionist është gjoja mik i popullit shqiptar.

Kurse kinezët, me të cilët ne nuk i kemi prerë urat, që miqësia me popullin kinez, nga ana jonë, vazhdon të forcohet, që ne bëjmë të gjitha përpjekjet që kjo miqësi të mos cenohet, heshtin. Ne, gjithashtu, kemi bërë përpjekje që edhe çështjet ideologjike, që na ndajnë, t'i diskutonim me ta dhe të spastronim rrugën derisa kishte mundësi të pastrohej, ndërsa kinezët këtë gjë jo vetëm nuk e kanë bërë, por bile kanë vepruar dhe veprojnë në të kundërtën.

Kështu pra, kudo në botë folën pak a shumë për ditën e Republikës sonë, dikush mirë e dikush sipas oreksit të tij, por fundi i fundit e përmendën këtë ngjarje të shënuar të popullit shqiptar, kurse Kina nuk bëri zë fare.

Çfarë shkruante «Zhenminzhibaoja» më 11 janar? Kjo

gazetë, organ i KQ të PK të Kinës, shkruante për ullinjtë e Marokut, për prodhimin e zarzavateve që u realizua në Jugosllavinë titiste, shkruante, gjithashtu dhe për heroizmin e popullit rumun. Udhëheqësit kinezë janë me të vërtetë armiq të popullit e të Partisë sonë. Partia jonë nuk u gabua dhe nuk gabon në politikën e saj për ta demaskuar këtë klikë renegatësh revizionistë. Populli kinez do t'i dënojë këta njerëz, sepse do ta shikojë dhe do ta kuptojë që Partia e Punës e Shqipërisë ka pasur të drejtë politikisht, ideologjikisht dhe populli shqiptar ka mbajtur kurdoherë qëndrime korrekte, të drejta, dashamirëse ndaj Kinës.

Ne asnjëherë nuk kemi lënë në harresë jo një ditë të shënuar të popullit kinez, por edhe çështjet e ditës të cilat kanë pasur rëndësi për Kinën. Ne kemi folur në radio dhe kemi shkruar në shtypin tonë për Kinën për arsye se duhet folur, se kështu zhvillohet dhe ruhet miqësia midis dy vendeve, se kështu propagandohet edhe jashtë ajo që është e mirë për Kinën. Kurse atë që është e keqe për Kinën dhe për të tjerët, ne jo vetëm që nuk e reklamojmë, por do të bëjmë gabim të madh ta përmendim ose të shkruajmë për të.

Një qëndrim krejt të kundërt nga yni mbajtën kinezët për festën e Republikës sonë.

E MARTË
28 SHKURT 1978

STRUKTURA E SHOQËRISË ITALIANE ËSHTË E KALBËZUAR

Çdo ditë po ndjek me vëmendje ngjarjet në Itali. Këto ngjarje na interesojnë në mënyrë të veçantë, meqë Italia është afër vendit tonë dhe ka qenë kurdoherë shteti që na ka sulmuar e na ka pushtuar dhe kundër këtij shteti borgjez kapitalist ne kemi luftuar dhe e kemi thyer.

Aktualisht, Italia është në buzë të greminës. Në qoftë se ka në botë një shtet, ku vërtetohet katërcipërisht degjenerimi kapitalist, degjenerimi i shoqërisë, degjenerimi i strukturës dhe i superstrukturës, ky është Italia. Ka 45 ditë që gjendja atje po zien dhe qeveria nuk po formohet dot. Partitë e ndryshme borgjeze, se të gjitha janë të tilla, kanë hyrë në tratativa pa mbarim, për të zgjidhur krizën qeveritare, por ajo vazhdon. Përse? Sepse atje mbretëron inflacioni, ekziston papunësi e madhe, kapitalet po nxirren nga vendi, çmimet ngrihen dita-ditës. Në të katër anët e Italisë mbretëron terrori fashist, ka vrasje nëpër rrugë dhe të plotfuqishme atje janë ushtria, policia, karabinieria e spiunazhi. E tillë është, pra, sot gjendja në Itali.

Struktura e shoqërisë italiane është e kalbëzuar. Italia përfaqëson realitetin tipik të kalbëzimit të kapitalizmit, siç e paraqit Lenini. Grevat e punëtorëve janë të përditshme dhe socialdemokracia, revizionizmi me

sindikatat e tyre, e të tjerë, kanë krijuar një frazeologji të gjerë demagogjike shurdhuese, britma pa bukë, për të gënjyer klasën punëtore që vuan dhe shfrytëzohet në palcë nga kapitalizmi.

Situata brenda në Itali është shumë e acaruar, mjerimi është i madh dhe revolta është e madhe. Por fakt është se atje mungon faktori subjektiv, domethënë nuk ekziston një parti e tillë komuniste marksiste-leniniste që të udhëheqë masat e pakënaqura, revoltën e madhe të popullit kundër regjimit kapitalist të vendit. Partia Komuniste Italiane i ka tradhtuar interesat e proletariatit, që shfrytëzohet egërsisht nga kapitalistët dhe ka hyrë në tratativa me kapitalizmin italian, me demokristianët, me Vatikanin etj. Gjendja aktuale në Itali vërteton teorinë leniniste mbi zhvillimin e shoqërisë kapitaliste.

Një faktor tjetër që influencon negativisht në mungesën e stabilitetit të udhëheqjes kapitaliste në këtë vend është se qeveria demokristiane ose qeveria e koalicionit e demokristianëve me partitë e tjera, është e paqëndrueshme. Që nga çlirimi e deri tani në Itali janë ndërruar një numër i madh qeverish. Në krye të shtatë-tetë muajve bie një qeveri dhe për t'u formuar qeveria tjetër, duhet një periudhë kohe prej 40 ditësh, bile edhe prej 60 ditësh. Aktualisht, kur dëgjon radion italiane ose kur shikon televizorin italian, nuk dëgjon e nuk sheh gjë tjetër veçse fjalime, diskure të pafund e pa shpresa. Perspektiva e një qeverie të re italiane nuk duket në horizont. Ekzistojnë dy faktorë objektivë që bëjnë të mos gjenden dot rrugët e njëfarë stabiliteti në drejtim të shtetit: pakënaqësia në kulm e popullit dhe paqëndrueshmëria e udhëheqjes kapitaliste.

Nga ana tjetër fashizmi në Itali po përparon. Nga të katër anët e vendit janë mobilizuar lumpeni, kriminelët, hajdutët e huliganët që vrasin, presin e hedhin bomba kudo. Degjenerimi është futur jo vetëm në jetën

e shoqërisë, për sa i përket anës morale, por aktualisht ne shohim se banditizmi është bërë i modës deri edhe në shkollat e mesme. Këtu ka filluar aktiviteti banditesk, hedhja e bombave, vrasja e profesorëve, organizimi i grevave, mbyllja e auditoreve, djegia e bibliotekave etj. etj. Në çdo fushë të veprimtarisë shoqërore, shikon degjenerim, anarki, banditizëm, huliganizëm.

Gjendja në Itali është me të vërtetë pasqyrë tipike e kalbëzimit të kapitalizmit. Atje ka një situatë revolucionare. Por kur në këtë situatë revolucionare nuk ekziston një parti marksiste-leniniste e shëndoshë, atëherë përfitojnë fashizmi dhe borgjezia kapitaliste në fuqi, që kërcënojnë vendin, kërcënojnë popullin. Diktatura fashiste ka krijuar brenda në vend një situatë tmerri e frike, ka krijuar psikozën se asnjë pushtet në Itali nuk mund t'u vërë fre këtij degjenerimi, këtyre vrasjeve, grabitjeve, vjedhjeve, falsifikimeve që nga baza e deri lart në krye, te vetë presidenti i republikës. Të gjithë akuzohen se marrin ryshfete të panumërta nga shoqëritë kapitaliste vendase e të huaja.

Prandaj është e nevojshme që situatën në Itali ta vëzhgojmë me kujdesin më të madh.

E ENJTE
9 MARS 1978

TITOJA POHON BOTËRISHT UNITETIN E TIJ ME IMPERIALIZMIN AMERIKAN

Nuk ka njeri në botë, njeri të ndershëm, njeri që të marrë vesh edhe fare pak nga politika që të mos e urrejë e të mos ketë kuptuar qëllimet agresive, grabitqare, kolonialiste të imperializmit amerikan. Duhet të jesh njeri i ulët, renegat e shërbëtor i imperializmit që të mendosh dhe të flasësh ndryshe.

Duke lexuar variantin e gjerë të fjalimit të Titos përpara Karterit, vura re se thotë: «Jugosllavia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke i bazuar marrëdhëniet e tyre në parimet e njohura të barazisë, të mosndërhyrjes dhe të respektit reciprok, kanë arritur rezultate me të cilat kanë vërtetuar plotësisht vitalitetin dhe vlerën e pazëvendësueshme të këtyre parimeve». Pra, ky renegat i thotë botës se Shtetet e Bashkuara të Amerikës i trajtojnë shtetet e tjera, të mëdha ose të vogla si Jugosllavia, në «barazi të plotë». Titoja i deklaron botës se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kurrë «nuk kanë ndërhyrë» e «nuk ndërhyjnë» në punët e të tjerëve. Titoja, pra, merr përsipër dhe deklaron botërisht se imperializmi amerikan i «respekton të tjerët». Kështu flet ky «burrë i madh», siç e cilësoi Karteri. Po përse të mos e vlerësonte ai Titon «të madh», kur ky i thotë që

mbi këto baza «le ta zhvillojmë akoma më shumë bashkëpunimin tonë në planin politik, ekonomik, në fushën e shkencës e të teknologjisë, të teknikës, kulturës, turizmit» etj?

Titoja pohoi botërisht se Jugosllavia është në unitet dhe në bashkëpunim të plotë, në të gjithë sektorët e jetës, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. A duhet gjë tjetër për të vërtetuar varësinë e Jugosllavisë nga imperializmi amerikan? Nuk ka nevojë për më tepër. Dhe Titoja vazhdon të shtojë se «kjo është rruga më e sigurt për forcimin e vazhdueshëm të miqësisë midis dy popujve tanë». «Traditat e miqësisë dhe të lidhjeve të çmueshme në mes të dy vendeve tona», thotë Titoja, kanë bërë që të jepet një «kontribut i jashtëzakonshëm», nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për emigrantët jugosllavë, të cilët s'kishin bukë të hanin në atdheun e tyre (që e zhvat imperializmi amerikan) dhe «kanë gjetur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës atdheun e tyre të dytë».

Titoja, mbasi përcaktoi cilësitë «e mira» të imperializmit amerikan, duke harruar ato që tha pak më parë, thotë se duhet «të zhduken» konfrontimet midis fuqive të mëdha dhe problemet themelore të zhvillimit botëror duhet «të zgjidhen» në çdo fushë me bisedime, të evitohen në marrëdhëniet ndërkombëtare politika e forcës dhe ndërhyrjet në çështjet e brendshme të vendeve të tjera etj., etj. Po kush i bën këto ndërhyrje? Kush e përdor forcën? Janë imperialistët dhe socialimperialistët ata që i bëjnë këto monstruozitete, por që Titoja nuk i thotë dot. Pra definicioni i marrëdhënieve jugosllavo-amerikane që vuri në dukje Titoja në fillim është plotësisht një elozh që ai i bën padronit të vet, kurse të tjerat, që përmend më vonë, i ka për socialimperializmin sovjetik ose për Somalinë që ndërhyn në punët e Etiopisë.

Kjo çështje s'mund të kuptohet ndryshe, ose këtij njeriu i kanë rrjedhur trutë nga pleqëria.

Një çështje tjetër që prek Titoja, se i është ngritur aq mendja saqë mendon se qenka bërë kërthiza e botës dhe është i zoti t'u japë mendje njerëzve e shteteve, është ajo e çarmatimit. Ai thotë se OKB-ja, me një punë «të jashtëzakonshme dhe me përpjekje të përbashkëta të të gjitha vendeve anëtare të organizatës botërore, në emër të sigurimit të tyre sot dhe të brezave të ardhshëm» duhet «të fillojë procesin e çarmatimit të vërtetë». Këtë proces që predikon Titoja e kanë filluar Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke krijuar bombën me neutron e armë të tjera të fuqishme shfarosëse dhe duke shtuar buxhetet luftarake. Por Titos i duhet t'i përmendë këto për t'u gjendur në fjalë dhe arrin t'i thotë presidentit amerikan «se ne kemi shpresa të mëdha se ju personalisht dhe vendi juaj, do të kontribuoni dhe do ta nxitni këtë proces», po ashtu «do të nxitni procesin e dhënies së ndihmave popujve»! Po, Karteri do t'u japë popujve ndihma kur kikirikët të bëhen me bollëk të madh në kontinentin amerikan!

Sidoqoftë Titoja nuk u qan hallin popujve që vuajnë, por i lutet me përulësi presidentit Karter që të vërë dorën në zemër dhe t'i japë diçka Jugosllavisë, sidomos disa kredi, pse çmimet në Jugosllavi po ngrihen dita me ditë e pikërisht në kohën kur ai u nis për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çmimet e mallrave ushqimore dhe të mallrave të tjera u ngritën përsëri atje. Po për ç'arsye ngrihen këto, Titoja nuk e thotë.

Natyrisht Titoja flet edhe për «lëvizjen e mosangazhimit», që ia mburri edhe Karterit, i cili e quajti këtë renegat «babanë» e kësaj lëvizjeje. «Kjo lëvizje, theksoi Titoja, është bërë sot një faktor i pranueshëm në botë në sajë të luftës konsekuente për paqe dhe për sigurim, për barazi, për zhvillim të lirë, për zgjidh-

jen e problemeve kryesore të botës së sotme». Pra të gjitha këto probleme i zgjidhi «lëvizja e mosangazhimit» e Titos, e cila na qenka «shprehja logjike e nevojës objektive të botës». Titoja e siguron Karterin se me këtë «ne, (domethënë revizionistët jugosllavë) do të vazhdojmë të gënjejmë ata që mund të gënjejmë» rreth ekzistencës së kësaj lëvizjeje.

Të gjitha këto gjepura të Titos **i vërtetoi konferenca e Beogradit që mbaroi si bisht peshku me asgjë, me një disfatë të plotë.** Në fund u botua vetëm një komunikatë një faqe e gjysmë a dy, në të cilën thuhet se kjo konferencë do të mblidhet përsëri në vitin 1980 në Madrid. Ky ishte rezultati i saj. Në këtë konferencë ku u fol për «sigurimin evropian», për «uljen e tensionit» e për të gjitha ato çështje që përsëriti Titoja si mulliri pa kokrra, nuk u arrit dhe s'mund të arrihej asnjë sukses përderisa dy kuçedrat dhe imperializmi botëror ndodhen në këmbë për të shtypur, për të shfrytëzuar dhe për të skllavëruar popujt.

Por fjalë të bukura dhe bombastike si të Titos kanë thënë kurdoherë lakenjtë e imperializmit e të kapitalit botëror. Kurdoherë ata e kanë lëvduar me fjalë, haptazi dhe në mënyrë të maskuar, veprimtarinë agresive të kapitalit botëror. Titoja s'mund të bëjë përjashtim nga këta. Ai është i lidhur pas qerres së kapitalizmit, e ka gojën plot me dollarë dhe ia kanë zënë frymën grushti dhe thundra e imperializmit amerikan dhe e kapitalit botëror. Prandaj ky renegat i bie daulles së imperializmit amerikan, por, këtë tellall të çjerrë nga gryka, që ka folur për 40 vjet me radhë në të tillë mënyrë, nuk e dëgjon kush. Vetëm padronët e tij kapitalistë e mburrin, që të mund t'i mbetet kështu njëfarë kredie për të gënjyer popujt sot dhe nesër me teoritë e tij antimarksiste dhe prokapitaliste.

Përse kreu i imperializmit amerikan, Karteri, e

mburr në këtë mënyrë skandaloze këtë renegat, Titon? Arsyeja e parë është se kapitali amerikan i ka shtënë në duar Jugosllavinë dhe pasuritë e saj, të cilat i sjellin atij fitime të mëdha.

Arsyeja e dytë është se Jugosllavia për imperializmin amerikan dhe për NATO-n është një vend strategjik me rëndësi të madhe, mbasi në rast se dobësohet influenca e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e kapitalit perëndimor në Jugosllavi, atëherë vendin e tyre atje do ta zënë kapitali dhe influenca e socialimperialistëve sovjetikë, influencë që rrezikon gjithë mbrojtjen e NATO-s.

Arsyeja e tretë është se sistemi i vetadministrimit jugosllav është një formë e përshtatshme për degjenerimin e vendeve të ashtuquajtura socialiste dhe një shembull në të ardhmen për të përballuar ato momente kur qëndrimi i kapitalizmit mbi kurrizin e popujve në një ose në shumë vende rrezikohet. Në një rast të tillë sistemi i vetadministrimit jugosllav, që është një sistem anarkosindikalist, mund të adaptohet me qëllim që të ruhet sundimi i kapitalit dhe i kapitalistëve.

Në fakt, në Jugosllavi sistemi i vetadministrimit përfaqëson atë formë të kapitalizmit që kanë luftuar Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini dhe që e kanë vlerësuar si një mjet të armikut për të luftuar vendosjen e socializmit, vendosjen e pronës së përbashkët socialiste mbi mjetet e prodhimit dhe administrimin e saj në mënyrë të centralizuar e të racionalizuar nga diktatura e proletariatit për të krijuar bollëkun, për të ecur në socializëm në interesin e klasës punëtore. **Socializmi është kategorikisht në kundërshtim me vetadministrimin jugosllav.**

Vetadministrimi jugosllav është një teori sipas së cilës gjoja u jepet e drejta punëtorëve të administrojnë pronën e grupit, të ndërmarrjes ose të fabrikës, dhe gjoja

u sigurohet punëtorëve një demokraci e vërtetë. Në fakt kjo formë shtetërore administrative ose vetadministruese çon në shthurjen e pronës shtetërore socialiste dhe krijon në ndërmarrje grupet gjoja të punëtorëve, por që në fakt bëjnë të lindë borgjezia e re kapitaliste, sepse në realitet prona e përbashkët në Jugosllavi është copëtuar. Jo vetëm kaq, por, po të shohim ç'është vetadministrimi punëtor, del se në Jugosllavi krahas ligjit për «këshillat punëtorë», në fakt ekziston edhe një ligj tjetër, sipas të cilit mbi çdo gjë vendos drejtori deri edhe në kuadrot, në rrogat e në ndarjen e fitimeve, kurse «këshilli punëtor» i përngjet një klubi ku vetëm mund të diskutohet. Në këtë klub, në këtë «këshill punëtor» bëjnë pjesë ata punëtorë të pasur, të cilët favorizohen nga drejtori dhe nga administrata e tij burokratike. Me fjalë të tjera, me këtë formë qeverisjeje vetadministruese, krijohet një grupim kapitalistësh të rinj dhe një sistem i tillë shoqëror ku siç ka vënë në dukje vetë Titoja ndryshimet e rrogave në mes një punëtori dhe udhëheqjes së administratës janë në raport një me njëzetë, bile nganjëherë vete edhe një me dyzetë.

Titoja, Kardeli dhe shokët e tyre në momente krize të rënda nëpër të cilat ka kaluar ky vetadministrim kanë pranuar se në Jugosllavi është krijuar një gjendje anarkie në prodhim, që në fakt është *apanazhi*[1] i kapitalizmit. Fabrika ose ndërmarrja që «vetadministrohet» s'i jep askujt llogari se çfarë prodhon, se si prodhon, ku i shet mallrat dhe me çfarë çmimesh i shet. Kjo nuk pyet njëri sa investon apo sa nuk investon nga këto fitime, sa ndan e sa nuk ndan dhe si i ndan ato. Pra ky sistem ekonomiko-shoqëror krijon anarki në çmimet e në rrogat, krijon papunësinë, krijon ndarjen dhe luftën në mes republikave të ndryshme jugosllave, si, për shembull, në

1 Frëngjisht — privilegj, monopol.

mes Kroacisë dhe Serbisë, në mes Sllovenisë dhe Serbisë etj.

Dihet se në Jugosllavi Kroacia dhe Sllovenia janë republikat më të përparuarat ekonomikisht, më të industrializuarat dhe pas tyre vjen Serbia, kurse republikat e tjera dhe krahinat, sidomos Kosova, janë më të prapambeturat. Si pasojë e këtyre diferencave ekziston një ndryshim i madh edhe në mënyrën e jetesës, për arsye se ashtu siç ngjet në ndërmarrjet, ashtu ngjet edhe në republikat, sepse prodhimi dhe drejtimi nuk janë të centralizuar, Partia ose Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka asnjë rol drejtues e organizues, përkundrazi ajo ka pasur dhe ka vetëm një rol «edukues», një rol zero me fjalë të tjera. Edhe klasa punëtore nuk është aspak hegjemone, përkundrazi ajo shfrytëzohet në palcë nga borgjezia e re kapitaliste titiste.

Kështu qëndron çështja për sa i përket vetadministrimit në sektorin e industrisë dhe të shërbimeve në qytete, kurse në fshat në asnjë formë nuk ekziston socializmi, qoftë edhe ashtu siç e paraqesin titistët, toka u përket privatëve dhe në radhë të parë kulakëve. Këta kanë të drejtë ta shesin, ta blejnë tokën, të marrin fshatarë në punë, t'i pushojnë ata dhe t'i hedhin në rrugë të madhe. Kulakët disponojnë makineritë, ata ua japin këto me qira fshatarëve të mesëm ose të varfër dhe u blejnë këtyre tokat, u japin para me ozurë. Më në fund kulakët u marrin fshatarëve jo vetëm tokat, por edhe kafshët, edhe shtëpinë. Në këto kushte shohim që rreth 1 milion e gjysmë jugosllavë emigrojnë jashtë, në vende të ndryshme të botës, për të punuar e për të nxjerrë një krodhë bukë. Të gjitha këto janë ato «të mira» që ka sjellë për Jugosllavinë vetadministrimi, ky sistem anarkosindikalist, kapitalist kaotik, që Karteri e do aq shumë dhe e mburr, pse një sistem i tillë e leh-

tëson penetrimin dhe vendosjen me të dyja këmbët të kapitaleve amerikane në tokën jugosllave.

Këto janë pra të vetmet arsye që Karteri e quan Titon «burrë të madh». Ai e quan kështu se Titoja iu kundërvu socializmit shkencor, ndërtimit të vërtetë të shoqërisë së re të dalë nga revolucioni, se ai iu kundërvu dhe e luftoi klasën punëtore që të mos jetë hegjemone, se ai shkatërroi diktaturën e proletariatit dhe krijoi një parti fashiste dhe me anë të ushtrisë, të policisë, të sigurimit mban në këmbë regjimin skllavërues titist. **Titoja e regjimi i tij mbrojnë borgjezinë e re që shtyp klasën punëtore dhe masat punonjëse jugosllave, ashtu sikundër imperializmi amerikan e kapitalizmi botëror me armët që disponojnë dhe me gjithë strukturën e superstrukturën që kanë, shtypin klasën punëtore, fshatarësinë e varfër, fshatarësinë e mesme dhe të varfrit e qyteteve.**

Për këto që ka bërë Titoja për kapitalizmin botëror e meriton lëvdatën që i bëri Karteri, duke e quajtur «burrë të madh shteti». «Burrë të madh shteti» e konsideron Titon edhe Hua Kuo Feni, pse dhe ky po ecën në rrugën kapitaliste titiste në unitet të plotë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror. Do të vijë shpejt dita që Hua Kuo Feni, ta cilësojë Titon akoma më lart. Do të vijë gjithashtu dita që Karteri ose zëvendësi i Karterit do ta cilësojë edhe Hua Kuo Fenin si shpëtimtarin e Kinës, si njeri nga më të mëdhenjtë në botë. **Kapitalistët mbështetin kapitalistët, imperialistët mbështetin shërbëtorët e tyre, prandaj ne duhet t'i luftojmë me vendosmërinë më të madhe të dy këta, padronë e shërbëtorë, për t'i shkatërruar, për t'i likuiduar dhe për t'i futur në varr përgjithmonë.**

VLORË, E SHTUNË
1 PRILL 1978

REVIZIONISTËT SOVJETIKË PËRPIQEN TË FSHEHIN TRADHTINË E TYRE

Kemi të dhëna se, për të fshehur tradhtinë e tyre ose «për të arsyetuar» këtë tradhti, revizionistët sovjetikë nëpër shkollat e kurset e partisë kanë nxjerrë «argumentime» se gjoja Lenini ka gabuar. Ai paska gabuar veçanërisht në çështjen e diktaturës së proletariatit, kur thotë se kjo diktaturë duhet të ekzistojë deri në zhdukjen e klasave, domethënë deri në komunizëm. Sipas tyre, ky qenka një parashikim i gabuar i Leninit. Revizionistët sovjetikë vënë në dukje se teza e tyre është se sot i gjithë pushteti është i popullit dhe kjo vete në kundërshtim me tezën e Leninit, rrjedhimisht pra ky ka gabuar.

Çështja tjetër sipas revizionistëve sovjetikë ku paska gabuar Lenini, është ajo kur thotë se në socializëm duhet të shkohet drejt uljes së rrogave të kuadrove të lartë etj., dhe afrimi i tyre me pagat e punëtorëve të thjeshtë. Është e kuptueshme që revizionistët sovjetikë, të cilët në bazë të çdo pune kanë vendosur fitimin dhe që po e majmin borgjezinë e tyre, ta luftojnë këtë parim socialist të Leninit dhe të vendosin, siç kanë vendosur, diferenca kolosale në mes rrogave të punonjësve. Këto «argumentime» ata kanë filluar t'i përhapin edhe në kurset dhe në shkollat e partisë ku dërgojnë përfaqësues dhe lektorë, të cilët, akuzat kundër Leninit i trajtojnë në kalim e sipër e sikur gjoja nuk është fjala për një

problem të mprehtë. Megjithatë ata përsëri i thonë shpifjet e tyre.

Kjo nuk na çudit aspak. Revizionistët sovjetikë e tradhtuan leninizmin. Ata do të fillojnë t'i rrëzojnë një nga një dhe publikisht tezat lenineste, për të cilat deri tani janë përpjekur ta ruajnë akoma maskën.

E MARTË
18 PRILL 1978

FASHIZMI PO NGRE KRYE KUDO

Kriza e madhe ekonomiko-politike e kapitalizmit botëror, e imperializmit dhe e socialimperializmit, ka shkaktuar varfërimin, mjerimin dhe shtypjen e masave të gjera punonjëse, shtypjen e proletariatit dhe shtimin e papunësisë, të inflacionit, të urisë, por nga ana tjetër edhe të revoltës popullore kundër kësaj gjendjeje katastrofike, në të cilën po e çojnë njerëzimin kapitalizmi botëror, imperializmi dhe revizionizmi modern.

Kësaj revolte të madhe të popujve në vendet kapitaliste dhe revizioniste borgjezia kapitaliste përpiqet t'i gjejë një ilaç. Por ilaçi i tyre është ai i përhershmi, **ngritja në këmbë e diktaturës fashiste, e asaj force brutale, regresive, gjakatare që shtyp masat e punonjësve, që zhduk çdo liri demokratike, çdo formë pseudodemokratike parlamentare dhe zbaton ligjin e kapitalit të madh në kalbëzim.**

Revizionizmi modern, titizmi, hrushovizmi, eurokomunizmi dhe revizionizmi kinez kanë ndihmuar e po ndihmojnë në rimëkëmbjen e fashizmit në botë, jo vetëm në vendet ku sundojnë drejtpërdrejt kapitalistët e imperialistët e vjetër, por edhe në vendet revizioniste ku është zhdukur regjimi socialist e është vendosur regjimi kapitalist dhe ku ka marrë frenat borgjezia e re revizioniste e mbështetur në aparatet e saj shtypëse.

Revizionizmi modern ishte ai variant i socialde-

mokracisë që u erdhi në ndihmë kapitalizmit botëror në kalbëzim dhe imperializmit amerikan pas Luftës së Dytë Botërore. Rrezikshmëria e tij fillestare qëndronte në atë se kjo ideologji ose kjo rrymë e madhe regresive fshihej nën maskën e marksizëm-leninizmit, hiqej sikur regjimet socialiste në ato vende ku sundonte proletariati vazhdonin të ishin në fuqi dhe se gjoja në to risundonte proletariati. Por, në fakt, në këto vende regjimi socialist u rrëzua, pushteti i diktaturës së proletariatit u përmbys dhe u rivendos pushteti i klasave të larta që u krijuan dhe që morën fuqinë në dorë.

Revizionistët modernë me pikëpamjet e tyre demagogjike, pavarësisht se ndërtojnë kapitalizmin, po bëhen konkurrentë të kapitalizmit të vjetër, dëshirojnë dhe luftojnë për rindarjen e botës, rindarjen e tregjeve e të zonave të influencës. Në vendet ku në fuqi është borgjezia kapitaliste, revizionistët modernë, me partitë e tyre pseudomarksiste, nëpërmjet reformave të strukturës, nëpërmjet kompromiseve, dëshirojnë të infiltrohen në pushtetin e kapitalit dhe nëpërmjet kësaj të mund të nxjerrin fitime në dobi të një borgjezie të re, krahas borgjezisë së vjetër, dhe të shtypin kështu më mirë kërkesat e ligjshme politike, demokratike të vërteta dhe ekonomike të proletariatit dhe të masave të popullit. Por si për kapitalizmin e vjetër dhe për kapitalizmin e ri revizionist, për vetë regjimet e tyre aktuale në fuqi, është krijuar një situatë shumë e rrezikshme. Pse? Sepse popujt që sundohen e shtypen nga kapitalistët e vjetër e ata të rinj, revizionistët, shohin se po çohen drejt një mjerimi akoma edhe më të madh ekonomik, politik, moral. Prandaj ata janë ngritur në revolta, në greva, në demonstrata për ta penguar këtë shtypje. Kështu që në të gjitha këto vende borgjezia e vjetër dhe ajo e re po vendosin një diktaturë të fortë.

Në vendet kapitaliste dhe ato imperialiste fashizmi

po gjallërohet, po ashtu po gjallërohet atje edhe një fashizëm i një natyre tjetër, por me të njëjtin qëllim dhe me të njëjtën ideologji, natyrisht të maskuar, për të shtypur revoltën e popujve. Fashizmi shohim se po ngre krye kudo, por veçanërisht këtë ne e konstatojmë më shumë në Itali dhe në Gjermaninë Perëndimore.

Në Itali lëvizja fashiste po merr forma kërcënuese, për arsye të dobësimit të borgjezisë italiane dhe të rrugës pa krye në të cilën është futur vendi. Qeveritë borgjezo-kapitaliste të demokristianëve, të socialdemokracisë dhe të partive të tjera, nuk janë në gjendje të dalin nga kjo rrugë. Fashizmi në Itali jo vetëm përfaqësohet nga disa parti si Lëvizja Shoqërore Italiane, e Djathta Nacionale, që kanë deputetë në parlament dhe që andej propagandojnë marrjen e pushtetit prej tyre, por ka organizuar gjithashtu grupe të mëdha të panumërta ilegale. Këto grupe veprojnë në drejtim të dobësimit të pushtetit pseudodemokratik të borgjezisë italiane, luftojnë për të tmerruar masat punonjëse dhe proletariatin, luftojnë po ashtu çdo përpjekje të borgjezisë revizioniste italiane që të infiltrohet në punët e kapitalit të madh italian. Këto grupime të panumërta bëjnë krime të çdo lloji, sulme me banda, rrëmbejnë persona të ndryshëm, rrëmbejnë personalitete politike si Aldo Moron, u kërkojnë haraç, i vrasin, sulmojnë bankat etj. Në të gjithë Italinë, ata kanë krijuar një situatë shqetësimi dhe frike të madhe të jashtëzakonshme në masat e gjera të popullit. Kjo e keqe po rritet dita me ditë dhe revizionistët e të gjitha partitë e tjera pseudodemokratike italiane nuk kanë ç'bëjnë, nuk veprojnë dhe me siguri ato do ta pësojnë, po ashtu siç e pësuan në kohën e ardhjes së Musolinit në fuqi.

Ne konstatojmë se parti të ndryshme të borgjezisë kapitaliste, përveç Partisë Demokristiane që është në fuqi dhe tregon një pazotësi shembullore, apostafat dobë-

si shembullore, të gjitha të tjerat bëjnë një demagogji shurdhuese e pa emër kundër terrorizmit, nuk flasin aspak për fashizmin që po ngrihet dhe nuk u bëjnë thirrje masave të gjera të popullit që të ngrihen në këmbë dhe ta përballojnë me vendosmëri një situatë të tillë kërcënuese.

Nuk përjashtohet mundësia që fashizmi të vijë në fuqi në Itali në forma mundet pak më ndryshe nga ai i kohërave të Musolinit. Por edhe në mos ndodhtë kaq hapur, prapëseprapë borgjezia e madhe italiane, me demokristianët në krye, me krahun më reaksionar të saj, do të formojë një qeveri të ashpër kundër masave të popullit, të ashpër natyrisht kundër elementëve progresistë dhe gjoja për të mbajtur rregullin e «për të shëndoshur» gjendjen e krimbur në Itali, do të vendosë një regjim të fortë ushtarak, diktatorial, fashist.

Pra në Itali fashizmi aktualisht ecën përpara pa gjetur asnjë ndalesë serioze. Ajo që mund ta pengojë ardhjen në fuqi të fashizmit atje është kryengritja popullore kundër kapitalit italian dhe atij të huaj që sundojnë në këtë vend, ndryshe Italia do të vazhdojë të gjendet në një konfuzion akoma më të madh. Vetëm në një kryengritje popullore, në revolucion punëtorët do të thonë fjalën e tyre, do të thyejnë prangat që u kanë hedhur në duar borgjezia kapitaliste dhe shërbëtorët e saj deri te revizionistët toliatistë dhe berlingueristë dhe do të spastrojnë nga kokat e tyre helmin ideologjik që këta po u futin me shiringa çdo orë e çdo ditë. I vetmi shpëtim i Italisë nga kjo murtajë që i turret është, pra, rezistenca e popullit.

Në rrugën akoma më të hapët drejt fashizmit po ecet në Republikën Federale Gjermane. Atje, përveç partive të kapitalit të madh revanshist që janë në fuqi, janë organizuar dhe zhvillojnë, nën dritën e diellit, pikëpamjet e tyre revanshiste për unifikimin e të dy shteteve gjermane dhe për dominim brenda dhe jashtë Evropës, parti të ndryshme borgjeze e veçanërisht partia socialkristiane e Shtrausit në radhët e të cilës janë grumbulluar e janë organizuar nazistë e fashistë të vjetër e të rinj.

Ky organizim bëhet hapur në Gjermaninë Perëndimore. Atje janë krijuar shoqëri të ndryshme dhe të shumta me fashistë të vjetër dhe me të rinj që bëjnë haptazi propagandë naziste hitleriane. Ato kanë shtypin e tyre, botojnë «Majn Kampfin», të gjitha kujtimet e Gëbelsit, të Gëringut dhe të të gjithë shefave historikë të nazizmit gjerman. Këto shoqërira bëjnë mbledhje çdo muaj, organizojnë darka dhe dreka, ku pihet birrë e këndohen këngë revanshiste përpara syve dhe nën hundën e policisë, nën hundën e ushtrisë dhe të sigurimit të Republikës Federale Gjermane. Domethënë në Gjermaninë Perëndimore çështja e vendosjes së diktaturës fashiste nuk zhvillohet në ato forma siç po veprohet në Itali, por në forma të hapëta. Kështu, një mëngjes të bukur, me këto forma të hapëta organizimi, fashistët do të vijnë në fuqi. Edhe në Gjermaninë Perëndimore nuk mungojnë aktet terroriste, vjedhjet, vrasjet. Edhe atje këto bëhen në shkallë të gjerë, por jo si në Itali, për arsye se forca e kapitalizmit gjerman është akoma në gjendje të dominojë situatën e brendshme të vendit dhe të mos jetë përpara atyre krizave të mëdha ekonomike dhe politike që kanë pllakosur borgjezinë kapitaliste italiane. Në Gjermani pozitat e kapitalit janë më të fuqishme, bile më të fuqishme nga të gjitha vendet e tjera kapitaliste të Tregut të Përbashkët Evropian. Kapitali gjerman dominon mbi Tregun e Përbashkët Evropian, bile rrezaton forcën e tij ekonomike dhe jashtë Evropës.

Në këto kushte gjendja ekonomike në Gjermaninë Federale është shumë më e mirë se ajo e Italisë, prandaj

mundësia e shpërthimit të revoltave të masave punonjëse italiane është më e madhe sesa në Republikën Federale Gjermane. Përveç kushteve të forta ekonomike, borgjezia e madhe kapitaliste gjermanoperëndimore ka një forcë shtypëse më mirë të organizuar nga forca shtypëse e borgjezisë kapitaliste italiane. Kjo i jep asaj mundësi që të lejojë lirisht veprimtarinë e rezervës së saj, diktaturën fashiste, të krijojë shoqëri e grupime të ndryshme legale që të propagandojnë haptazi kohën e hitlerizmit.

Në Francë po ashtu, shohim të ekzistojë akoma një situatë konfuze. Ekziston gjoja një luftë më demokratike në mes partive të ndryshme, por konstatojmë se borgjezia kapitaliste franceze në fuqi në zgjedhjet e fundit fitoi dhe nuk e la «të majtën», bashkimin e partisë komuniste me partinë socialiste, që të merrte fuqinë ose të infiltrohej, siç tenton partia revizioniste italiane të infiltrohet në pushtetin e kapitalit të madh.

Disfata e këtyre dy partive të borgjezisë, e partisë revizioniste franceze dhe e asaj socialiste, në këto zgjedhje bëri që tash ato të përçahen. Kjo është vepër e kapitalit të madh francez, i cili po përgatit dhe ai momentin e përshtatshëm për vendosjen e një diktature fashiste. Kjo do të ndodhë kur ta shikojë rrezikun që do t'i turret në mënyrë më kërcënuese, si dhe kur të shohë se në të gjithë Komunitetin Evropian situata po ndryshon. Në qoftë se situata në Komunitetin Evropian ndërron në favorin e diktaturës fashiste, atëherë borgjezia kapitaliste franceze, natyrisht, do të përpiqet të fitojë dhe të likuidojë edhe ajo kundërshtarët e saj, qofshin këta edhe të dobët. Në të njëjtën kohë ajo do të dominojë, gjoja në format e vjetra demokratike që kurdoherë do të thotë me forma shtypëse, shfrytëzuese ndaj proletariatit dhe masave punonjëse të vendit, në interes të borgjezisë së madhe kapitaliste.

Po t'i hedhim një sy të përgjithshëm situatës botërore, shohim se edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ngjet e njëjta gjë. Shoqëritë fashiste atje po shumëzohen e po aktivizohen. Në këtë vend, si kudo në botën kapitaliste, ekziston po ashtu një krizë e madhe ekonomike dhe politike, e cila reflekton dhe fuqizon krizën ekonomike edhe në të gjitha vendet e tjera kapitaliste që janë të lidhura me kapitalizmin amerikan.

Në Afrikë po ashtu shohim racizmin e bardhë që të dominojë dhe të luftojë me ashpërsinë më të madhe për të ruajtur pozitat e tij sunduese mbi popujt e varfër të këtij kontinenti të madh. Ky racizëm ndihmohet siç ndihmohet edhe brenda në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër zezakëve dhe kundër elementëve demokratë përparimtarë, nga ana e imperializmit amerikan. Organizohen shumë mbledhje, fliten shumë fjalë, mbahen shumë diskure për çështjen e Rodezisë, për çështjen e pakicës së bardhë që dominon në Afrikën e Jugut etj., etj., shkon atje Vensi apo Ovensi, por të gjitha këto janë demagogji për të gënjyer masat e gjera të popullit që ngrenë krye për çlirimin nga zgjedha e neokolonializmit.

Në gjithë këtë situatë ne shohim se edhe Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, trashëgimtare e Kinës së Mao Ce Dunit me politikën e saj kundërrevolucionare, po ndihmon ardhjen në fuqi të fashizmit. Kina aktualisht është bërë një nxitëse e luftës grabitqare imperialiste botërore dhe ndihmon me të gjitha forcat dhe mjetet e saj, propagandistike dhe ekonomike, këtë zhvillim të tmerrshëm të fashizmit dhe të një lufte të re botërore. **Ky është një krim i pafalshëm, një krim që do të mbetet një njollë e errët, e pashlyeshme në historinë e njerëzimit.**

E SHTUNË
20 MAJ 1978

MERCENARIZMI NË RENDIN E DITËS

Fuqitë e mëdha imperialiste, imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe imperialistët e tjerë, si ata francezë, anglezë e të tjerë për të ruajtur pasuritë ose më mirë shoqëritë e tyre që shfrytëzojnë ish-kolonitë e që aktualisht janë kthyer në neokoloni, përdorin vazhdimisht mercenarë.

Dihet se Republika Franceze ka me kohë një repart, i cili është bërë i famshëm dhe quhet *«Légion étrangèr»*[1]. Kjo është një njësi që i ka shërbyer asaj në Afrikë, në Meksikë e kudo ku ia ka dashur nevoja për të pushtuar koloni, për të shtypur revoltat e autoktonëve dhe për të mbajtur rendin dhe qetësinë në kolonitë.

Siç dihet «Legjioni i huaj» francez përbëhet nga «vullnetarë» me rrogë, vullnetarë të një biçimi të ri, njerëz kriminelë. Domethënë të gjithë ata të huaj që bëjnë pjesë në këtë legjion janë delinkuentë, njerëz që kanë bërë krime të natyrave të ndryshme, elementë aventurierë, *«desesperados»*, që shiten me kontratë për 5 ose për 10 vjet dhe komandohen nga oficerë francezë, ose oficerë të huaj që dalin nga vetë legjioni.

Në kohët e kaluara shumica e legjionarëve kanë qenë gjermanë, italianë, austriakë e të tjerë, trafikantë drogash, njerëz që merreshin me proksenetin e grave,

1 Frëngjisht — legjion i huaj.

vrasës. Të tillë njerëz, pra bënin pjesë në këtë legjion, prandaj kuptohet çfarë morali ka mbrojtur ai dhe çfarë aktesh të shëmtuara dhe në ç'mënyrë i kryente atje ku dërgohej. Shpjegime për këtë nuk duhen.

«Legjioni i huaj» francez ekziston akoma, bile ka dy-tri ditë që presidenti i Francës Zhiskar d'Estëni mori vendim dhe nisi 800 veta nga ky për në Katanga të Zaires, në Kongon Belge, për arsye se gjoja atje ndodhen nënshtetas francezë, specialistë që punojnë në miniera, të cilët «duhen mbrojtur» nga të ashtuquajturit xhandarë katangezë, që kanë hyrë nga kufiri i Angolës për të çliruar Zairen, duke filluar nga krahina e Shabës. Krahina e Shabës është domeni i vjetër i Çombes, ku ka miniera të pasura të uraniumit, të diamanteve etj. Atje janë ngulur edhe shoqëritë amerikane, angleze, franceze dhe belge. Me fjalë të tjera, Katanga dhe gjithë Zairja është nën sundimin e këtyre fuqive të mëdha imperialiste, që e shfrytëzojnë.

Sulmi mbi Katanga i të ashtuquajturve xhandarë katangezë bëhet për të dytën herë. Kush janë këta xhandarë katangezë? Këta nuk janë veçse mercenarë, të cilët përgatiten në Angola nga ana e socialimperialistëve sovjetikë dhe e kubanezëve dhe me siguri të shoqëruar edhe nga oficerë të këtyre dy shteteve. Ata i ndërmarrin këto ndërhyrje në Zaire për të rrëzuar Mobutun dhe për ta bërë Zairen një vend gjoja demokratik, bile edhe «socialist», siç mund ta quajnë nesër Etiopinë dhe të futet nën suazën e socialimperializmit sovjetik.

Pra, në Zaire kanë vajtur mercenarë belgë dhe mercenarë francezë. Por mund të shkojnë edhe mercenarë marokenë të cilët kanë pasë shkuar atje edhe herën e parë. Amerikanët nuk kanë dërguar akoma mercenarët e tyre në këtë vend, por Karteri deklaroi se do të dërgojë mjete, armatime dhe ndihma të tjera materiale për gjeneral Mobutun. Kina po e ndihmon po ashtu këtë

gjeneral «të famshëm» dhe agjencia kineze e lajmeve Hsinhua, si dhe gazeta «Zhenminzhibao» po gërthasin për këtë si gomari që pëllet kur ka uri, se edhe Kina ka uri për tregje.

E njëjta gjë u bë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kohën kur ishte gjallë presidenti Kenedi në sulmin që ndërmori ky kundër Kubës në Gjirin e Derrave, duke dërguar atje mercenarë kubanë që i kishte stërvitur në Majami, por në këtë rast këta mercenarë pësuan disfatë.

Kubanezët aktualisht janë bërë «Legjioni i huaj» i Bashkimit Sovjetik. Ushtria kubane po përdoret si mercenare nga sovjetikët, veçanërisht në Afrikë, në Etiopi kundër Somalisë, në Ogaden dhe në Eritre. Atje luftojnë trupa mercenarë kubanë që drejtojnë njëkohësisht trupat etiopianë për të pushtuar Eritrenë dhe për të likuiduar Somalinë, me fjalë të tjera për të krijuar atje një koloni të re sovjetike. Kjo u arrit edhe në Angola, ku kubanezët, të ndihmuar nga sovjetikët, mbështetën Neton, e sollën këtë në fuqi dhe aktualisht mbajnë një numër të konsiderueshëm mercenarësh kubanë në këtë vend për të luftuar kundërshtarët e Netos, domethënë njerëzit e amerikanëve dhe të ish-kolonizatorëve të tjerë, për të vendosur mirë influencën dhe tregun sovjetik në këtë vend.

Të njëjtat situata përgatiten në Rodezi, në Zambia, po kështu edhe kundër Sudanit. **Mercenarizmi sot është bërë i modës.** Mercenarët i futin në luftime kundër popujve që ngrihen për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare, për të hequr qafe zgjedhën e shfrytëzuesve imperialistë të jashtëm dhe të aleatëve të tyre të brendshëm. Mercenarët, të përdorur nga kapitalizmi botëror, quhen si ushtri çlirimtare që «mbrojnë» sovranitetin dhe lirinë e popullit në fjalë. Ka mercenarë, siç janë mercenarët shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e gjetkë

që armiqtë tanë i stërvitin për kohëra të volitshme për ta. Këta janë gjakatarët e «Ballit Kombëtar» dhe disa plehra të organizatave të tjera tradhtare, të cilët bashkëpunuan gjatë luftës me gjermanët dhe me italianët dhe tash hanë në grazhdin amerikan, bëjnë propagandë dhe stërviten. Por te ne nuk do t'u shkojë kjo lojë, jo me mercenarët, por as edhe me vetë ushtritë e imperialistëve ose të socialimperialistëve që do të guxojnë të prekin pavarësinë dhe kufijtë e atdheut tonë socialist.

Pra **mercenarizmi është një mjet që po zhvillohet për mbrojtjen e neokolonializmit dhe për të maskuar ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të forcave të armatosura të shteteve kapitaliste në vende të ndryshme të botës** ose për të fshehur qëllimet e rindarjes së tregjeve dhe të pushtimit të tokave të shteteve gjoja të pavarura, por që janë nën influencën e nën shfrytëzimin e një shteti tjetër imperialist.

Prandaj popujt që rrezikohen nga ndërhyrjet me armë dhe aktualisht nga diversioni i shumëllojtë i imperialistëve të huaj në bashkëpunim me shtypësit e brendshëm, duhet të jenë vigjilentë dhe të kuptojnë karakterin e pseudokryengritjeve të nxitura nga jashtë me qytetarë dhe nënshtetas të vendeve të tyre. Ata duhet të kuptojnë mirë se këta të arratisur politikë në përgjithësi përfshihen në «Legjione të huaja» të fuqive imperialiste. Këtu nuk përjashtohet që të ketë edhe ndonjë njeri që ka ndryshuar mendim dhe përpiqet të mbajë qëndrim të mirë, por, në përgjithësi, këta mbulohen nga qëllimi i keq dhe i përgjithshëm që është vullneti i asaj fuqie imperialiste që i përdor këta njerëz ose këto grupe njerëzish për të nënshtruar një popull, për të rrëzuar një udhëheqje kapitaliste dhe për të zevendësuar një tjetër, me fjalë të tjera për të fituar ose për të rifituar një treg të humbur. Prandaj populli dhe

revolucionarët e një vendi të tillë, siç është Zairja ose çfarëdo vendi tjetër, si Angola, Etiopia, Somalia, vendet e Azisë, ato të Azisë së Mesme etj., duhet të dallojnë mirë një kryengritje të brendshme të kurdisur nga elementët e reaksionit dhe të drejtuar nga fuqitë e huaja, nga kryengritësit dhe revolucionarët e vërtetë të përbërë nga elementë luftëtarë të popullit, që kanë në shpirt lirinë dhe pavarësinë e vendit të vet dhe që, për ta fituar këtë, bëjnë sakrificën më të madhe.

Çështja këtu qëndron në orientimet e drejta politike që duhet t'i jepen lëvizjes së brendshme për çlirim. Orientimi më i drejtë dhe më i saktë është orientimi marksist-leninist. Këtë orientim nuk mund ta japë dhe nuk mund ta zbatojë si duhet përveçse një parti marksiste-leniniste e vërtetë.

DURRËS, E ENJTE
1 QERSHOR 1978

TË DEMASKOJMË RENEGATËT E KOMBIT SHQIPTAR

Jemi në Durrës, pse sot hapet Kongresi i 8-të i Bashkimit të Grave.

Në pushimin e parë të Kongresit u thashë shokut Ramiz dhe shokëve të tjerë, sikur t'i japim përgjigje njëfarë Hyseni, «shqiptar» nga Maqedonia, nënkryetar a nuk e di se ç'është i Veçes së Shkupit të Maqedonisë, i cili, në një fjalim të tij, akuzon Shqipërinë se nxit nacionalizmin dhe irredentizmin dhe se ne gjoja nuk e trajtojmë mirë minoritetin maqedonas.

Duhet t'i bëjmë këtij një përgjigje të shkurtër, t'i japim një surup, ku ta cilësojmë si renegat të kombit shqiptar dhe si një shërbëtor të shovinistëve maqedonas. T'i themi që, më parë se të interesohet për një popullsi shumë të vogël me kombësi maqedonase, e cila jeton dhe ka të gjitha të drejtat në vendin tonë, është mirë të interesohet për popullsinë e madhe shqiptare që është sa një e treta e gjithë Maqedonisë dhe që shtypet e i mohohen shumë të drejta. T'i thuhet po ashtu se, në qoftë se dëshirojnë që ne të hapim defterët se kush është shovinist dhe irredentist, neve s'na bëhet vonë. Jemi gati ta bëjmë një gjë të tillë dhe bota do të kuptojë më mirë se kush është shovinist dhe kush është viktima e këtij shovinizmi, janë maqedonasit apo shqiptarët. Shokët ishin dakord t'i japim një surup kësaj qelbësire.

E SHTUNË
10 QERSHOR 1978

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT, MOMENT KRUCIAL NË HISTORINË HEROIKE TË POPULLIT TONË

10 qershori i vitit 1878, dita kur u mblodh në Prizren Lidhja e Shqiptarëve është një datë e shënuar e historisë heroike të popullit tonë. Ajo ishte një ngjarje me rëndësi të madhe historike për fatet e kombit tonë, pse bëhej në kohën kur Porta e Lartë, e Perandorisë Osmane, në bashkëpunim me carizmin rus dhe me perandoritë e tjera të Evropës, kërkonin ta copëtonin dhe e copëtuan atdheun tonë.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte ai moment krucial gjatë të cilit të gjitha energjitë e popullit tonë, patriotizmi i tij i pashoq, dashuria për atdheun, për tokën, për gjuhën, përpjekjet e tij politike dhe diplomatike e bashkuan atë si një grusht të vetëm për t'u bërë ballë turqve, serbëve, malazezëve, gjermanëve, austro-hungarezëve, grekëve, pse që të gjithë këta së toku ishin bashkuar kundër popullit shqiptar.

Këtë datë ne e kujtojmë kurdoherë me admirim dhe nderim të jashtëzakonshëm, pse ka qenë frymëzuese për luftërat e mëvonshme të popullit shqiptar deri në ditët tona. Të parët tanë rilindas, që me pushkë dhe me penë luftuan për truallin arbëror, na kanë lënë mbresa të pashlyeshme e që prej gati tre-katër brezash vlojnë në gjakun dhe në zemrat tona. Në Luftën tonë

Nacionalçlirimtare i kishim kurdoherë parasysh qëllimet e larta të tyre për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së vendit, për sovranitetin e atdheut, për çlirimin nga imperialistët e ndryshëm dhe nga feudalët e borgjezia e shitur te të huajt.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ishte vetëm një mbledhje udhëheqësish të shquar politikë, ushtarakë e të kulturës ose vetëm një mbledhje idealiste. Ajo përfaqësonte vullnetin e gjithë kombit shqiptar, që nga skaji i jugut deri në Mitrovicë e Kaçanik, në Plavë, në Guci e deri në Tivar. Udhëheqësit e saj ishin bij të popullit me mendje të ndritur dhe me një kurajë të hekurt që, për kompaktësinë e kombit shqiptar, për kompaktësinë e trojeve shqiptare, të cilat rrezikoheshin të copëtoheshin nga armiqtë e huaj shovinistë, kishin një qartësi të madhe ideologjike, politike dhe ushtarake.

Ata nuk u kufizuan në memorandume shterpe drejtuar Kongresit të Berlinit ose Fuqive të Mëdha, por këto memorandume u shoqëruan me një mobilizim të madh e të gjithanshëm të masave të popullit shqiptar në Kosovë, në Maqedoni, në Jug, në Grudë dhe në Hot, në Tivar e kudo. Dhe aksionet diplomatike të Lidhjes u shoqëruan edhe me aksione luftarake dhe me një propagandë e me një agjitacion të thellë e të zjarrtë.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u bë epiqendra e luftës çlirimtare, ajo demaskoi lakmitë e serbomëdhenjve, të shovinistëve malazezë e të grekëve. Të gjithë këta, sidomos sllavët, i ndihmonte carizmi rus që luftonte për pansllavizmin, për bashkimin e gjithë sllavëve, për të dalë në Mesdhe dhe në Adriatik. Dhe carizmi rus u favorizua nga perandoria e Giomit të parë dhe e Bismarkut.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta patriotike për të cilën bënte thirrje ajo ishte një nga pikat nevralgjike në Çështjen e Orientit. Çështjen e Orientit historianët e borgjezisë e kanë shkruar sipas qejfit të

tyre dhe Shqipërinë e kanë përdorur në këtë çështje si një monedhë tregu për të plotësuar dëshirat e carëve rusë, të kralëve serbë, të car Nikollës të Malit të Zi dhe të mbretërve të Greqisë, kurse popullin shqiptar, që ishte një popull me vitalitet të madh, me kulturën, me gjuhën dhe me shkollat e tij, një popull që kishte luftuar në shekuj dhe vazhdonte të luftonte, e harruan, ata nuk e përmendin në librat e tyre. Por populli shqiptar e shkruajti vetë historinë me armë në dorë, ai derdhi gjak, por edhe armiqtë nuk i la të qetë, u shkaktoi dëme të rënda. Për fat të keq, forcat e armiqve tanë të bashkuar i thyen përpjekjet e popullit shqiptar, por Lidhja Shqiptare që u mbajt në Prizren e që krijoi degët e saj në gjithë Shqipërinë, si dhe luftërat që bëri ajo për truallin arbëror, lanë mbresa aq të mëdha në mbarë popullin tonë, sa këto shërbyen e do të shërbejnë edhe më vonë për forcimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Shovinistët, cilëtdo qofshin këta, me çdo petk që të vishen dhe me çfarëdo ideologji që të mbulohen, çështjen e madhe të popullit shqiptar nuk do të mundin ta shuajnë dot kurrë, ajo çdo ditë që kalon po forcohet dhe po rrënjoset në zemrat e shqiptarëve, kudo që janë. Sidomos patriotizmi i vëllezërve tanë të Kosovës, të Dibrës, të Gostivarit, të Tivarit, të Ulqinit, të Plavës e të Gucisë etj., do të qëndrojë kurdoherë i ndezur për atdheun e përbashkët, për lirinë, për demokracinë, për unitetin kombëtar.

Në Prizren këto ditë u bë një mbledhje përkujtimore sa për të thënë se u kujtua kjo ngjarje. Ne dërguam në Kosovë delegacionin e shkencëtarëve tanë, me Stefanaq Pollon në krye, për të marrë pjesë në sesionin shkencor të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që do të mbahej në Prishtinë. Organizatorët kosovarë të këtij sesioni të cilëve u kishte zënë këmbët kjo datë kaq

e shënuar në disfavorin e tyre, u thanë shokëve tanë të ndryshonin referatet, të ndryshonin titujt dhe konkluzionet e kumtesave të tyre. Shokët tanë refuzuan dhe u nisën të largoheshin. Por pas pak ata, sigurisht pasi morën urdhër nga Beogradi, thanë se hiqnin dorë nga kërkesat e tyre dhe se shokët tanë mund t'i mbanin referatet. Kështu që tanët i mbajtën ato ashtu siç i kishin përgatitur. Megjithatë është fakt se Tanjugu nuk jep asnjë të dhënë mbi këtë sesion shkencor, ku për bujë kishin thirrur rreth 100 «shkencëtarë» borgjezë, pse, po të flitej për kumtesat e tyre, ishin të detyruar të flitnin dhe për kumtesat e shokëve tanë. Por ne nuk do t'i lëmë pa i transmetuar në radio kumtesat tona, që populli i Kosovës t'i dijë pikëpamjet tona shkencore rreth Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Disa udhëheqës kosovarë me gjithë Tanjugun, luftën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e kanë katandisur në një luftë gjoja për alfabetin, për shkollat, për pedagogjinë, gjëra fare për të qeshur. Kështu këta u shërbejnë shovinistëve serbë dhe përpiqen të deformojnë historinë. Ne e kemi të qartë se nuk mund të presim ndonjë gjë të mirë nga njerëz të tillë me kombësi shqiptare që deformojnë faktet, konkluzionet, rrjedhimet e kësaj lufte të madhe të popullit heroik të Kosovës dhe të të gjithë Shqipërisë.

Kurse te ne çështja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u bë një problem me të vërtetë i madh i mbarë popullit, po mbahen konferenca, shkruhen artikuj, vihen në dukje luftërat që janë bërë, njerëzit e shquar dhe idetë e mëdha që frymëzonin popullin.

Përveç kësaj propaganda jonë po shkon kreshendo dhe sot më 10 qershor, në orën 18^{00}, në sallën e Teatrit të Operës e të Baletit, do të mbahet një mbledhje solemne, ku do të flasë shoku Ramiz Alia mbi rëndësinë

e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në të janë ftuar edhe pleq patriotë nga të gjitha anët e Shqipërisë.

Nesër, në datën 11 qershor, do të bëhet një miting i madh solemn në sheshin «Skënderbej», ku përpara eshtrave të Abdyl e Naim Frashërit, të vëna në një shtrat topi dhe të mbuluara me Flamurin Kombëtar, do të parakalojë populli i Tiranës dhe ne do të vemë të bëjmë homazhe. Pastaj do të mbajë një fjalim të rëndësishëm shoku Mehmet Shehu për rëndësinë historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe për udhëheqësit e saj të shquar.

Pas mitingut në mënyrë solemne, jo si në një ceremoni funebre, por në mes entuziazmit dhe duke kënduar këngë patriotike, do t'i çojmë eshtrat e Abdylit e të Naimit në varrezat e reja që janë ndërtuar në Parkun e Madh të Tiranës. Tok me varret e dy përfaqësuesve të mëdhenj të Rilindjes sonë ne kemi përgatitur edhe varrin e Sami Frashërit, eshtrat e të cilit ndodhen akoma në Stamboll, pse qeveria turke nuk ka vendosur të na i japë. Qeveria osmane e ndau Kosovën dhe pjesë të tjera të tokave shqiptare nga Shqipëria, por aktualisht Republika Turke nuk duhet të ndajë vëllezërit Frashëri, të cilët vërtet janë tre, por për popullin tonë ata janë një e të pandarë, janë simboli i diturisë, i patriotizmit, i lirisë, i sovranitetit, i luftës së popullit shqiptar për pavarësi dhe sovranitet.

Në vendin tonë prej muajsh po zhvillohet një fushatë e gjerë për t'i shpjeguar popullit në mënyrë shkencore rëndësinë e madhe të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, luftërat e të parëve tanë me armë dhe me penë, me dituri e me diplomaci, për t'i treguar atij rezistencën e pashoqe që ka bërë kundër gjithë botës, që kërkonte t'i shkelte të drejtat e ta copëtonte, siç e copëtoi. Janë bërë dhe po bëhen nga të katër anët konferenca shkencore. Pra i madh e i vogël te ne tash e

ka të qartë këtë periudhë të lavdishme të historisë së tij. Edhe pas konferencës kombëtare shkencore që do të fillojë në datën 12 qershor në Tiranë do të bëhen po ashtu konferenca shkencore edhe në disa qytete të tjera kryesore si në Shkodër, Gjirokastër, Elbasan, Korçë, Dibër dhe Kukës.

Kështu që ne po forcojmë e po kalitim patriotizmin e popullit tonë, ndihmojmë po ashtu në forcimin e krenarisë së ligjshme dhe të frytshme të të gjithë vëllezërve tanë të Kosovës, të Malit të Zi e të Maqedonisë që vuajnë nën regjimin e serbomëdhenjve titistë.

E ENJTE
22 QERSHOR 1978

DISA MENDIME PËR KONGRESIN E 11-TË TË LIDHJES SË KOMUNISTËVE TË JUGOSLLAVISË

Kongresi i 11-të i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë i filloi punimet e tij më 20 qershor. Në këtë kongres, në qoftë se nuk gabohem, merrnin pjesë 2 000 e ca delegatë. Përveç delegatëve, në kongres merrnin pjesë 1 000 gazetarë, të ftuar të tjerë sa të duash dhe gjithë përfaqësuesit diplomatikë të akreditуar në Beograd me përjashtim të përfaqësuesve shqiptarë, vietnamezë, kubanë dhe kinezë. Megjithatë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës i kishte dërguar këtij kongresi një telegram të zjarrtë përshëndetjeje.

Me fjalë të tjera, ky kongres ishte një «panair», një panair i madh, që nuk u ngjan panaireve të zakonshme, që bëhen në qytete të ndryshme të botës, panaireve të veglave bujqësore, panaireve ekonomike, tregtare etj. Jo, ky ishte një panair i veçantë që u përngjet atyre panaireve, që në gjuhën frënge quhen *«foire»*, ku kushdo, me para apo pa para, mund të hyjë. Këto lloj panairesh bëhen nëpër sheshe dhe *esplanade* ku shiten çfarëdolloj plaçkash, që francezët i quajnë *«camelote»*, domethënë plaçka pa vlerë. Aty, që të shiten këto vjeturina e mbeturina të ndryshme, del ndonjë njeri që mban «fjalime», mburr mallin e tij të vjetër, të krimbur e bën pazarllëqe. Të tjerë më tutje bëjnë fokuse, ca luajnë kumar me letra, disa të tjerë qëllojnë me pushkë në stande, e rrëzojnë ato që u thonë «kokë turku» dhe marrin nga një shishe verë, që është treçerek ujë dhe një çerek bojë e kuqe, ose nga një kukull, ose ndonjë stilolaps. Të tilla janë këto panaire. Pastaj, në to ka një zhurmë shurdhuese që shkaktohet jo vetëm nga reklama boshe, pa kripë e shitësve llafazanë që duan të shesin vjetërsirat e tyre, por edhe nga disqet muzikore që dëgjohen nga standa e cilitdo që ka paguar vendin dhe ka ngritur një barakë në sheshin ku bëhet ky panair.

Me një panair të tillë mund ta krahasojmë këtë kongres të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Natyrisht, kasneci kryesor i këtij «panairi» ishte Josip Broz Titoja, i cili filloi t'i shesë *«les camelotes»*, plaçkat e tij të ndyra, me fjalë të tjera teoritë e tij antimarksiste dhe kapitaliste të falimentuara. Por kasneci i këtij «panairi» ka edhe një meritë dhe kjo konsiston në atë që ai ka mundur të rrojë mirë për vete, të hajë e të pijë në pallatet që ka ndërtuar dhe të arrijë moshën 86 vjeç. Kështu që këtij kasneci të këtyre teorive false, të veshur me rroba të shkëlqyeshme të bardha, i mungonin vetëm dekoratat se, po të fillonte t'i vinte, ato jo vetëm që do t'ia mbulonin krejtësisht gjoksin, por ca prej tyre do t'i duhej t'i varte edhe në pantallona.

Edhe muzika nuk mungoi. Në hapjen e këtij «panairi», me keqardhje duhet thënë se u këndua edhe himni i lavdishëm i klasës punëtore, i proletariatit botëror, «Internacionalja», megjithëse titistët e kanë flakur atë tej. Internacionalizmi i titistëve konsiston në kozmopolitizmin, në përhapjen e ideve tradhtare që kanë për qëllim robërimin e popujve nën sundimin e kapitalizmit.

Ajo që të binte në sy e të bënte përshtypje përnjëherë në këtë «panair» ishte se përrallat e Titos dëgjoheshin me mërzi, se ato ishin përralla të njohura e të përsëritura kushedi sa herë. Kur lexon raportin e

mbajtur nga Titoja, përgjithësisht të krijohet me të vërtetë një përshtypje mizerabël, por një gjë e tillë vihej re dhe në emisionet e televizorit jugosllav, në fytyrat e atyre që e dëgjonin këtë gjel të rrjepur, të cilit i mirrej goja dhe thoshte banalitete që i ka përsëritur për vite me radhë. Të gjitha ishin gjëra të përgjithshme, asgjë të re nuk kishte, gjëra me dy-tri kuptime, me të cilat mund të qëndrosh në të njëjtën kohë jo në dy, por në dhjetë karrige.

Në fytyrat e diplomatëve, kur fliste Josip Broz Titoja në këtë të ashtuquajtur kongres të Lidhjes të Komunistëve të Jugosllavisë, dukej një indiferentizëm i madh, kurse delegacionet, që janë 160 gjithsej dhe që përfaqësojnë lloj-lloj partish, disa dëgjonin me vërejtje, disa të tjerë bënin muhabet e s'çanin kokën fare për ato që përralliste Titoja. Edhe duartrokitje nga pjesëmarrësit në kongres kishte pak. E për çfarë të duartrokitnin? Asgjë të re s'kishte në raportin e Titos, atje nuk ekziston as unitet mendimi, as unitet veprimi, pavarësisht se Titoja e theksoi një gjë të tillë. Duartrokitje frenetike pati në sallën e kongresit, kur Titoja tha se nuk do ta lexonte të tërë raportin, veçse një shkurtim, disa pjesë të tij. Atëherë, po, me të vërtetë pati duartrokitje. Me këtë spektatorët e «panairit» donin t'i thoshin mirë ke menduar, sepse do të na mërzitësh, nuk të dëgjojmë dot.

Kjo ishte karakteristika e përgjithshme e këtij kongresi panair, për të cilin propaganda jugosllave, duke dashur t'i bëjë bujë të madhe, fitoi të kundërtën, domethënë fitoi pikërisht atë që ky kongres ishte me të vërtetë një panair, me shumë lloj njerëzish, me lloj-lloj mendimesh e lloj-lloj ngjyra fytyrash, me lloj-lloj veshjesh, me fjalë të tjera, ishte një karikaturë mendimesh, njerëzish dhe qëndrimesh.

Një kongres të tillë, ose një panair të tillë, natyrisht,

jugosllavët nuk mund ta bënin në një vend sidokudo, por në Beograd, dhe për t'i dhënë famë atij, si dhe herët e tjera, e bënë në pallatin «Sava». Në atë ndërtesë janë bërë mbledhjet e konferencës për «sigurimin evropian», mbledhjet e vendeve «të paangazhuara» që i udhëheq vetë Titoja dhe Jugosllavia. Kongresi, pra, u vendos të mbahej atje ku janë bërë mbledhje të tilla ku blihen e shiten vende dhe popuj. Këto lloj mbledhjesh, domosdo, duhet të bëhen edhe në një pallat madhështor. Ky është pallati «Sava» që, sipas Radio Beogradit, u ka kushtuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës 16 e ca milionë dollarë e sipas Tanjugut, është nga më modernët në Evropë.

Kështu të gjitha masat ishin marrë që ky kongres të ishte kongresi i hedhjes hi syve popujve, që nuk flenë. Ai u bë me një pompozitet banal dhe me një përmbajtje qesharake pa ideologji realiste, pale marksiste-leniniste që as mund të bëhet fjalë, pa një politikë të përcaktuar. E tërë përmbajtja e raportit ishte një përrallë e shthurur, tamam siç janë në realitet mendimet e veprimet anarkosindikaliste të Titos, të titizmit dhe të shtetit pseudosocialist jugosllav.

Në bazë të të dhënave të agjencisë jugosllave të lajmeve, Tanjug, Titoja, siç thashë më sipër, nuk e lexoi të gjithë raportin, por pjesërisht dhe për këtë ai u duartrokit nga ata që merrnin pjesë në këtë kongres. Kështu, mërzia që do të shkaktohej, po të lexohej i tërë raporti, u zvogëlua, si të thuash, por, të marra nga ana konkrete, ato që tha Titoja janë «kuintesenca» e gjithë mendimit dhe veprimit titist. Me fjalë të tjera, ato shprehin gjithë vijën e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Pra pjesët e raportit që lexoi Titoja dhe që i transmetoi agjencia Tanjug janë konsideruar kryesoret, të tjerat, pjesët e lëna jashtë, janë anësore, të parëndësi-

shme ose fletë fiku. Natyrisht, ky koment i shkurtër e i shpejtë që unë po u bëj thënieve të Titos, të këtij renegati të marksizëm-leninizmit, është i bazuar në atë çka thashë më lart, në versionin e shkurtër të raportit, por kur të kem kohë, gjatë pushimeve, mund t'i hedh një sy edhe tërë fjalimit të tij. Sido që e di që do të më hajë kohë, megjithatë, mendoj se ia vlen barra qiranë ta lexoj të tërë raportin e Titos për të parë si i shtron ai edhe çështjet sekondare.

Në këtë kongres, të cilit titistët jugosllavë i dhanë bujë kaq të madhe, u mbajt vetëm një raport, domethënë nuk raportoi njeri tjetër veç Titos. Ai u vendos në këtë kongres si shpirtadha e gjithë veprimtarisë së keqe të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ose, po të përdorim fjalë adapte për jugosllavët, Titoja, në pragun e vdekjes së tij, donte të afirmohej si një udhëheqës legjendar i Jugosllavisë, i cili ka bërë atje ligjin. E çfarë ligji ka bërë Titoja për 40 e ca vjet me radhë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë, që tash quhet Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, pra në këtë parti që tërë jetën e saj nuk ka qenë një parti komuniste e vërtetë, por një parti me plot rryma deviacioniste, që më vonë u shndërrua në një aneks të sigurimit të shtetit jugosllav, UDB-së? Ç'rol ka luajtur Titoja në këtë parti që në një moment u fsheh dhe ia la vendin Frontit Popullor të Jugosllavisë, i cili përmblidhte të gjitha shtresat e të gjitha botëkuptimet politike dhe ideologjike që përplaseshin në Jugosllavi? Më vonë, pas njëfarë eksperience të keqe, Titoja dhe shokët e tij ia kthyen plotësisht turirin kësaj partie 180 gradë dhe në fakt e likuiduan krejtësisht duke i lënë një rol krejt të parëndësishëm, pa asnjë efekt në realitet. Më vonë akoma, pavarësisht se Partia Komuniste e Jugosllavisë formalisht ekzistonte, ajo ishte si një organizatë amorfe, jovepruese, joluftarake. Por, kur në këtë parti, që po kthehej në një grup

inekzistues, përsëri u paraqit rreziku nga serbomëdhenjtë dhe nga mbeturinat rankoviçiane, atëherë Titoja bëri prapë një kthesë, si të thuash, liberalo-dogmatike, liberale në brendi, dogmatike në sipërfaqe, derisa të likuidonte kundërshtarët e tij.

Titoja, pra, dha vijën në këtë kongres para vdekjes së tij. Po çfarë vije? Pikërisht këtë duhet të analizojmë ne, natyrisht, në bazë të raportit të tij të shkurtuar. Por kjo s'ka rëndësi, se njësoj është si të analizosh raportin e plotë, apo versionin e shkurtuar, bile ky i fundit është më i qartë për të gjithë, se drurët e shtrembër, kur nuk ekzistojnë fletët e degëve të tyre, duken më mirë. Edhe «druri» atje është shtrembëruar dhe tharë, edhe fletët i kanë rënë, ashtu siç do të bien një ditë edhe Titoja dhe titizmi.

Në përgjithësi e theksoj, raporti i Titos, mbajtur në Kongresin e 11-të, pra vija e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, nuk ka asnjë bazë teorike. Ky raport është pasqyrimi më ekzakt i bisedimeve të përditshme që bën Titoja me lloj-lloj njerëzish, natyrisht me njerëz të kalibrit «të madh», të cilët ia kanë rritur mendjen aq tepër, saqë ai vetë ka arritur në konkluzionin se muhabetet e llogjet mbi politikën e përgjithshme dhe mbi koniunkturat në botë përbëjnë një thesar të madh, që ky goxha njeri «me kokë të madhe» na e përpunoka dhe na nxjerrka një «gjellë», të cilën, në mënyrën e tij, përpiqet që t'ua servirë gjithë atyre që kanë oreks ta hanë dhe t'i këndojnë këtij kuzhinieri të falimentuar hosanara pa baza.

Por, në fakt, Titoja është një barbar, është një judë e një agjent i vjetër i kapitalit botëror dhe pseudokonkluzionet ose formulimet, që gjoja ai nxjerr nga evenimentet që ngjasin në botë, nuk janë veçse fragmentare, të paqëndrueshme, pa kurrfarë baze teorike dhe vazhdimisht të ndryshueshme si ngjyra e kameleonit.

Në se konsistojnë vijat kryesore të ideologjisë titiste? Ç'të lexosh në raportin e Titos! Çdo gjë është për të vënë duart në kokë. Titoja, në vija të përgjithshme, thotë se ekzistojnë blloqe, ose grupime ushtarake shtetesh, nga njëra anë NATO-ja, nga ana tjetër Traktati i Varshavës. Ky është një realitet, por pse ekzistojnë këto dy grupime ushtarake? Pikërisht kësaj çështjeje as nuk i futet Titoja, se, po t'i futej, atëherë do të dilnin në shesh qëndrimet e vërteta të tij. Mirëpo Titoja qëndron në dy karrige, ose, siç pretendon ai, në një karrige «asnjanëse», gjoja në kundërshtim me njërin dhe me tjetrin. Dhe ky qëndrim na quhet «qëndrim i paangazhuar». Ky është «deduksioni i madh teorik» i këtij mburraveci, ose i një «*discoureur dans une foire aux puces*»[1].

Pra si konkluzion «i thellë» del që, nëse ekzistojnë vende të angazhuara me pakte ushtarake, ekzistojnë edhe vende «të paangazhuara», të cilat janë të organizuara dhe udhëhiqen nga Beogradi, nga Titoja, që e ka vënë veten në krye të tyre.

Tash unë nuk do të analizoj se ç'brendi ideologjike, politike dhe organizative ka kjo farë bote e paangazhuar, por dua të theksoj se kjo është ajo pseudoteori, ku mbështetet dhe me të cilën reklamohet ky renegat.

Çështja tjetër që Titoja ngre në raportin e tij është se pasuritë e botës nuk janë ndarë mirë, prandaj, në një dukje ai, shtetet e pasura duhet të ndihmojnë ato më të varfrat ekonomikisht, se, sa për vete të tij, Titoja ka marrë ndihma kolosale nga kapitalizmi botëror për shërbimin e madh që i ka bërë dhe vazhdon t'i bëjë për kaq dekada me radhë. Kjo është njëra dada e Titos që do të thotë shumë gjëra, por që s'thotë asgjë. Le të

1 Frëngjisht — ai që mburr mallin e vet me zë të lartë në një pazar plaçkurinash.

grijë ai sa të dojë për ndihmën që shtetet e pasura duhet t'u japin vendeve të varfra. Kapitalizmi dhe imperializmi botëror nuk u japin asgjë popujve, shteteve që vuajnë në varfëri, përveçse kërbaçit, robërisë, luftës dhe shtypjes së egër barbare.

Dadaja tjetër, ose kënga e përhershme e imperializmit, e shteteve të mëdha kapitaliste dhe e Titos së toku, është problemi i çarmatimit. Titoja bën thirrje «për çarmatim të plotë e të përgjithshëm». Të tërë, kapitalistë, imperialistë e revizionistë, duke e konsideruar këtë si një nga problemet më të rëndësishme që është i lidhur ngushtë me çështjet e paqes e të sigurimit ndërkombëtar, çirren për çarmatim, kurse në fakt të tërë po armatosen. Të gjitha këto shtete që gjoja janë për çarmatim, janë bërë tregtarë të armëve dhe Jugosllavia titiste është bërë një nga blerësit kryesorë të këtyre armëve të ndryshme, natyrisht, me kredi por edhe falas. Pra, ky kasnec i imperializmit amerikan, i revizionizmit sovjetik dhe i gjithë kapitalizmit botëror, flet «për çarmatimin», por flet me një «seriozitet» që s'bind njeri.

Titoja gjithashtu nuk harron t'u bëjë thirrje të dyja superfuqive që të bien në bisedime, të merren vesh me njëra-tjetrën. Kuptohet qartë se sa pa themel janë të gjitha këto thirrje, ose më mirë të themi muhabete që Josip Broz Titoja i bën nga të katër anët e botës, ku ka bredhur, ku ka marrë dekorata, ku ka ngrënë e ka marrë kredira. Prej këtej ky renegat ka arritur në një mendim të tillë se bota vjen rrotull kërthizës së tij dhe këto slogane, që ai lëshon si pa të keq, janë mendime të thella teorike e politike që vërtitin shoqërinë njerëzore. Sipas këtij tartareci bota ecën në rrugën e socializmit, të gjitha vendet «e paangazhuara» janë futur në socializëm. Teoria e Titos «shpjegon» që vajtja në socializëm nuk mund të realizohet në bazë të teorisë së Marksit dhe të Leninit, të teorisë e

të veprimit revolucionar, por nëpërmjet reformave. Dhe reformat për Titon janë muhabetet boshe, janë muhabetet që e largojnë revolucionin, që duan ta fikin revolucionin, që bëjnë të gënjehen popujt se gjoja me diskure, me votime, ose me një lëmoshë që mund t'u hedhin, të arrijnë në konkluzionin se kanë fituar të drejtën e vetëvendosjes, të mosangazhimit, se gjoja këta popuj e këto shtete po ngjitin shkallët njëra pas tjetrës me sukses drejt socializmit, duke pasur në krye Mobutun dhe gjithë kapitalistët e tjerë reaksionarë.

Po përse duhet Titoja të mendojë ndryshe në Jugosllavi? Ai nën këtë petk e nën këtë gënjeshtër po ndërton kapitalizmin, po krijon një shtresë kapitaliste të fortë dhe një pushtet kapitalist të drejtuar nga një diktaturë fashiste. Prandaj ky sharlatan, ky antimarksist, ky antidemokrat, regjimin dhe pikëpamjet e tij kërkon t'i shesë te të tjerët, që janë si edhe ai, si një ecje drejt socializmit. Vendet «e paangazhuara», vendet e «botës të tretë» të miqve të tyre kinezë ose të «botës në zhvillim», të mikut të Titos, Çausheskut, të gjitha së toku, sipas tij, përbëjnë atë forcë kolosale revolucionare që do të përmbysë kapitalizmin dhe do ta çojë botën në socializëm dhe në komunizëm.

Këto edhe një varg çështjesh të tjera të tilla përbëjnë atë pseudoteori titiste që Titoja zhvilloi në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Ai foli edhe për partinë, zuri në gojë edhe internacionalizmin. Por për çfarë partie foli ai, për një parti marksiste-leniniste, për një parti revolucionare? Jo, ai theksoi se duhet demokratizuar në shkallë të gjerë partia. Por, pavarësisht se tha që në gjirin e kësaj pseudopartie marksiste jugosllave ekziston centralizmi demokratik, domethënë që pakica i nënshtrohet shumicës, pavarësisht se me fraza ai u shpreh se brenda në partinë e tij lejohen të shfaqen mendimet hapur për ato probleme që diskutohet, se lejohen të ekzistojnë edhe pakica, të gjitha këto janë parulla boshe, sepse diktatura fashiste e partia fashiste nuk lejojnë kundërshtarë, i futin në burg këta, i internojnë, i pushkatojnë. Këtë gjë po e bën Titoja çdo ditë në Jugosllavi. Kjo që bën tash Titoja është një fasadë e rreme që ai përpiqet t'ia veshë Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Por Titos i duhet të flasë në këtë mënyrë për arsye se ai do që të shkëputet një herë e mirë nga teoria marksiste-leniniste. Për të Marksi, Engelsi dhe Lenini kanë vdekur, megjithëse në raportin e tij në këtë kongres nuk harroi të theksonte «domosdoshmërinë për të studiuar intensivisht krijimtarinë revolucionare dhe mendimin teorik të Marksit, Engelsit dhe Leninit, për të ndjekur studimet marksiste të kohës në botë». Teoria dhe praktika e revolucionit dhe ndërtimi i socializmit, sipas marksizëm-leninizmit, nuk kanë qenë dhe nuk janë kurrë të pranueshme nga Titoja, ato nuk mund të pranohen kurrë nga revizionizmi modern dhe nga socialdemokracia.

Të gjitha rrymat antimarksiste, që janë ose nuk janë në fuqi, teorinë dhe praktikën e revolucionit, sipas mësimeve të Marksit dhe të Leninit, i luftojnë me të gjitha mjetet, prandaj Titoja në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë u paraqit si përkrahës i të gjitha rrymave pseudomarksiste, si përkrahës i eurokomunizmit e i çfarëdolloj rryme e partie që ka në programin e vet, qoftë edhe formal, disa shenja që të çojnë në të ashtuquajturën demokraci ose përparim. Pra Titoja s'doli si përkrahës i pluralizmit në vendin e tij, por kudo në vendet e tjera. Ai predikoi pluralizmin dhe ngriti kapelën përpara këtyre varianteve të ndryshme të ndërtimit të socializmit ose pikëpamjeve të ndryshme të pseudokomunistëve, të cilët e shikojnë dhe duhet ta shikojnë, sipas Titos, zhvillimin në kushtet konkrete të vendit të tyre. Me një fjalë, ata duhet t'u adaptohen kapitalizmit dhe

reformizmit borgjez anarkosindikalist, fashistë të maskuar etj.

Është pikërisht për këtë vijë e për këto pikëpamje që predikoi Titoja që Kongresi i 11-të i tij mori tamam pamjen dhe përmbajtjen e një panairi, ku kishin ardhur delegacione të partive të ndryshme nga të katër anët e globit tokësor. Të kuptohemi një vend nuk përfaqësohej nga një parti e vetme në kongres, por nga 4-5 parti dhe të katër apo të pesë partitë janë ideologjikisht dhe politikisht të pranueshme për Titon, për këtë pseudomarksist. Me këtë vijë që ndjek Titoja do t'i tregojë botës se Jugosllavia po bëhet edhe qendra e një socializmi të vërtetë me fytyrë demokratike dhe është një vend ku konvergojnë të gjitha rrymat progresive. Pavarësisht se Titoja flet «për mundësinë e çdo përvoje specifike historike për të pasur një vlerë të përgjithshme», pra, se nuk duhet të ketë një qendër të vetme të drejtimit për lëvizjen punëtore, ai në fakt, e konsideron Jugosllavinë si një qendër të lëvizjes punëtore botërore, qendër që ia kalon edhe Moskës. Prandaj agjencitë e huaja njoftojnë se, kur fliste Titoja në këtë kongres, Kulakovi, anëtar i byrosë politike dhe sekretar i KQ që kryesonte delegacionin e Partisë Komuniste revizioniste të Bashkimit Sovjetik, shfrynte dhe i binte bankës i nevrikosur me kalemin e tij.

Tash t'i shikojmë një çikë më konkretisht këto probleme që trajtohen në raportin e Titos, që, në mënyrë të përgjithshme, i theksova më lart, por t'i marrim një nga një, ashtu siç i ka lexuar Titoja dhe siç i ka paraqitur agjencia shtetërore jugosllave, Tanjug.

Titoja tha: «Jugosllavia socialiste, e vetadministruar dhe e paangazhuar, qëndron në baza të forta dhe të shëndosha, të cilat janë shtyllat e sigurta të së ardhmes së saj». Në fakt realiteti qëndron ndryshe. Jugosllavia është një mozaik popujsh dhe përveç kësaj në këta popuj

është e zhvilluar ndjenja e nacionalizmit dhe e shovinizmit, mbi të gjitha ndjenja e shovinizmit serbomadh dhe kroatomadh. Të dyja këto tendenca në Federatën Jugosllave janë jo në disharmoni, por në kundërshtim të ashpër njëra me tjetrën, prandaj, pas vdekjes së Titos, gjithsecila prej tyre do të përpiqet të dominojë mbi të tjerët. Serbomëdhenjtë, për shembull, do të luftojnë të dominojnë jo vetëm mbi kroatët, por edhe mbi sllovenët, mbi bosnjakët, mbi shqiptarët dhe mbi maqedonasit. Kroatomëdhenjtë po ashtu do të kenë tendenca të theksuara për të dominuar mbi serbët dhe mbi popujt e tjerë.

Në mënyrë të vetvetishme i ashtuquajturi regjim socialist vetadministrues e ka krijuar një situatë të tillë të lëkundshme dhe aspak të qëndrueshme në Jugosllavi. Aktualisht, edhe tash që Titoja jeton, këto tendenca ekzistojnë të theksuara në Federatën Jugosllave, për arsye se Jugosllavia nuk është një vend socialist, por një vend kapitalist, që gjoja është i vetadministruar. Me fjalë të tjera, njeriun, të cilin jugosllavët e «kanë ngritur në piedestal», në fakt, është skllav i një shoqërie të re kapitaliste, e cila ekziston në shumë qendra jugosllave. Ekzistenca e këtyre qendrave me tendenca centrifugale e bën Jugosllavinë pseudosocialiste një vend jo të sigurt dhe aspak të qëndrueshëm.

Këto nuk mund të jenë spekulime, siç pretendon Titoja, por janë fakte të vërtetuara nga zhvillimi ekonomiko-politik dhe organizativ i Jugosllavisë. Këtë e shpjegon vetë gjendja aktuale jugosllave nga çdo pikëpamje. Në qoftë se shikohet në Jugosllavi njëfarë uniteti në Federatë, ky unitet është fiktiv, i mbajtur në këmbë për interesat imediate. Por në të ardhmen në Jugosllavi do të ketë friksione dhe fraksione të thella, pavarësisht se diku në këtë raport Titoja pretendon se në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë ka dhe duhet të ketë centralizëm demokratik, përndryshe i hapet rrugë fraksionizmit. Në

Partinë Komuniste të Jugosllavisë, që aktualisht quhet Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, fraksionizmi ka mbretëruar kurdoherë dhe kundër tij janë marrë masa të rrepta dhe të egra nga fraksioni që ka pasur fuqinë në dorë. Me një fjalë, fraksioni i kryesuar nga Titoja ka qenë dhe është më i forti, ai i ka eliminuar ose i ka tulatur fraksionet e tjera. Pra këto fraksione, që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë edhe sot, i japin trajtën Jugosllavisë aktuale dhe asaj të ardhshme.

Titoja, në raportin e tij prej 30 000 fjalësh, sipas Tanjugut, nënvizoi se «parimi i shumëllojshmërisë së formave të reja në rrugën e ndërtimit të socializmit, është një proces që po fuqizohet dhe që po i kalon kufijtë frenues të shteteve, rajoneve apo blloqeve». Kjo nuk është e vërtetë. Imperializmi dhe kapitalizmi botëror i çdo tipi, qoftë ai amerikan, qoftë socialimperializmi sovjetik, qoftë ai kinez, të gjithë e luftojnë socializmin shkencor, socializmin e vërtetë të ndërtuar në bazë të teorisë marksiste-leniniste, kurse socializmin ala titist ose socializmin që predikojnë eurokomunistët, ata në asnjë mënyrë nuk e kundërshtojnë, përkundrazi bëjnë përpjekje që si e si, edhe më shumë ta futin nën diktatin e tyre.

Vetëvendosja e popujve, që ngrihet gjoja prej Titos si një parim i madh, është një blof, sepse popujt nuk mund të vetëvendosin në një vend kapitalist. Është fakt se edhe pas çlirimit të Jugosllavisë popujt e ndryshëm, që luftuan për lirinë e tyre, nuk u lejuan të vetëvendosnin, të vepronin siç dëshironin, por ata me forcë u bashkuan në një Federatë, që u quajt Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë.

Një nga këta popuj, që nuk u la dhe nuk lihet në asnjë mënyrë edhe sot e kësaj dite që të vetëvendosë, është popullsia shqiptare prej afro dy milionë banorësh që rron në truallin e vet. Popullsia shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi nga numri e kapërcen popullsinë e Maqedonisë së bashku me atë të Malit të Zi.

Prandaj, të pretendosh dhe të luftosh gjoja për vetëvendosjen e popujve të tjerë, kur në vendin tënd dhe me teorinë tënde gjoja socialiste nuk e ke krijuar mundësinë dhe nuk e ke lejuar një gjë të tillë, ky, e theksoj përsëri, është një blof.

Titoja, siç e vura në dukje më lart, nuk i trajton problemet teorikisht, veçse konstaton se ekziston, për shembull, shfrytëzimi, duke marrë parasysh shpërndarjen e pasurive botërore nga disa blloqe shtetesh ose shtete të fuqishme. Prandaj ai bën thirrje që kjo shpërndarje të marrë një formë më të mirë. Por se si do ta marrë kjo shpërndarje këtë formë, me ç'forma e me ç'mënyra, ai nuk shprehet për këtë. Po të shprehet, atëherë ai do të dalë në rrugë të kundërt me atë që predikon. Prandaj Titoja vetëm konstaton dhe lutet që diçka të bëhet në këtë drejtim. Kjo është një tezë e njohur e Titos, tezë të cilën ai vazhdon ta llomotitë nga të katër anët, kudo që bredh.

«Marrëdhëniet në lëvizjen punëtore dhe në atë përparimtare në përgjithësi janë të pandashme nga rrymat e sotme botërore», tha presidenti Tito. Edhe për këtë problem duket sikur ka thënë një gjë të madhe, por në fakt ai vetëm konstaton një realitet dhe nuk thotë asnjë fjalë se çfarë duhet të bëjë kjo lëvizje punëtore dhe përparimtare. Natyrisht, ky renegat i marksizmit nuk shprehet, se s'ka se si ta thotë një të vërtetë të domosdoshme, reale, që është revolucioni. Por Titoja shprehu kënaqësinë «për zbatimin gjithnjë e më të madh në praktikë të parimit të barazisë midis partive dhe lëvizjeve, të pavarësisë së secilës dhe të përgjegjësisë së saj ndaj klasës punëtore, kombit dhe respektimit të parimeve të pavarësisë, mosndërhyrjes dhe marrjes parasysh të ndryshimeve».

Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që Titoja aprovon gjendjen aktuale në botë, rrymat dhe tendencat e ndry-

shme, sipas të cilave që të gjithë, edhe fashistët, edhe Pinoçeti, edhe Frankoja dhe regjimet e tyre paraqiten si demokratike dhe përparimtare. Pra të gjitha këto rryma Titoja i fut në një kanal: në kanalin e përparimit dhe ky kanal, sipas tij, lufton për pavarësinë e kombeve, lufton për socializmin. Ky është një absurditet i madh, është një aprovim në realitet i përpjekjeve politike dhe demagogjike të kapitalit botëror. Në këtë mënyrë Titoja përpiqet të mbrojë dhe mbron partitë e ndryshme të borgjezisë, të cilat i shërbejnë kapitalit të çdo vendi. Pra ai punon që ky kapital të riforcohet, të mund të mbajë nën zgjedhë punëtorët dhe të luftojë kundër rivendikimeve politike dhe ekonomike të klasës punëtore për ndryshimin e regjimit kapitalist. Domethënë Titoja është për statukuonë dhe ndihet mjaft i kënaqur që Jugosllavia titiste ka arritur në një gjendje që me të gjitha partitë, të çfarëdolloji që të jenë ato, të mbajë lidhje, të shkëmbejë mendime, të miqësohet, gjoja të diskutojë për problemet e lidhjes punëtore e të lëvizjes përparimtare, por në realitet që puna të ecë mbarë për kapitalizmin nën një formë pseudodemokratike.

Në një paragraf të raportit të mbajtur në kongres gjen një mendim shumë karakteristik të renegatit Josip Broz Tito. Ai, vë në dukje Tanjugu, vlerëson përpjekjet për të imponuar konceptet politike dhe ideologjike mbi partitë dhe lëvizjet brenda vendeve «të paangazhuara» dhe atyre «në zhvillim» si në kundërshtim me «interesat jetike të këtyre vendeve dhe të së drejtës së tyre për të vendosur lirisht rrugën e zhvillimit të tyre». Me fjalë të tjera, kjo do të thotë që teoria marksiste-leniniste, që është një armë e fuqishme për shkatërrimin e borgjezisë dhe për ndërtimin e socializmit, është një ideologji ose, si të thuash, një botëkuptim i papranueshëm nga ana e Titos për t'iu imponuar vendeve «të paangazhuara», dhe atyre «në zhvillim», për t'u treguar rrugën e vërtetë të

zhvillimit të tyre. Pra, sipas Titos, del që këto vende të pazhvilluara ose duhet të zhvillohen në mënyrë spontane, nën influencën e atyre shteteve të mëdha e të fuqishme që i kanë të dyja duart brenda këtyre vendeve, ose duhet të qëndrojnë në situatat aktuale pseudodemokratike, të rrojnë me këtë farë pavarësie dhe sovraniteti të rremë që u kanë dhënë kolonialistët e rinj edhe të vjetër. Kështu Titoja ndien një kënaqësi të madhe që këto vende në zhvillim të kullosin në ato ngastra të vogla që u kanë caktuar fuqitë imperialiste dhe kolonialiste.

Sigurisht, në raportin që i paraqitej Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, presidenti i famshëm jugosllav nuk mund të mos fliste gjerë e gjatë mbi situatën ndërkombëtare, por trajtimi i këtyre problemeve nga ana e tij ishte më tepër një numërim i thjeshtë faktesh dhe jo nxjerrja në shesh e shkaqeve që i shkaktojnë krizat sot në botë.

Titoja foli për krizën e Lindjes së Mesme, duke thënë se politika e Izraelit na qenka një politikë agresive dhe ekspansioniste. Ai tha se kriza e Lindjes së Mesme duhet zgjidhur dhe se një gjë e tillë duhet të arrihet me pjesëmarrjen në bisedime edhe të Organizatës për Çlirimin e Palestinës, e cila duhet të sigurojë të drejtat kombëtare të popullit palestinez.

Çfarë tregojnë këto që grin Titoja në këtë të ashtuquajtur kongres? Këto tregojnë dhe vërtetojnë atë që ai është një njeri i shitur tek imperialistët amerikanë, tek ata që Izraelin e kanë bërë veglën e tyre. As që u prishet punë Shteteve të Bashkuara të Amerikës apo ndonjë fuqie tjetër imperialiste, në rast se bëhen konstatime të tilla të sipërfaqshme, pa u futur në arsyet e vërteta të këtyre krizave të mëdha, pse Titoja nuk mungoi të fliste edhe për krizën e përgjithshme që ka përfshirë tërë botën kapitaliste.

Edhe gjendjes në Afrikë presidenti Tito i dha një «zgjidhje» dhe, siç pretendohet, përcakton si zgjidhje të vetme të vatrave të rrezikshme zhdukjen e plotë të mbeturinave të fundit të kolonializmit dhe të racizmit, dhënien e pavarësisë Namibisë e Zimbabvesë dhe dhënien fund të aparteidit në Republikën e Afrikës së Jugut.

Të gjitha këto janë thënë me qindra mijëra herë, prandaj as me një fjalim të Titos në Kongresin e 11-të të partisë së tij nuk shpjegohen dhe nuk zhduken neokolonializmi dhe shtypja e popujve në Afrikë e kudo gjetkë ku sundon kapitali. Por që t'i hyjë këtij problemi e ta analizojë atë nga ana teoriko-politike dhe organizative, këtë gjë nuk e bën Titoja, jo sepse nuk e kupton, por se është e rrezikshme ta bëjë një gjë të tillë, se, fundi i fundit, ai nuk e kupton një zgjidhje me të vërtetë radikale dhe marksiste-leniniste të kolonializmit. Vetë Jugosllavia e tij është një koloni e kapitalit amerikan dhe e gjithë kapitalit botëror, përderisa në këtë vend janë investuar me miliarda dollarë, përderisa tri të katërtat e pasurive jugosllave gjenden në duart e bankave dhe të koncerneve të huaja imperialiste.

Titoja hiqet si organizatori dhe udhëheqësi i të ashtuquajturave vende të paangazhuara, prandaj Organizatës së Unitetit Afrikan ai i jep «rëndësi të madhe» dhe rekomandon që parimet e saj të merren parasysh, të merren si bazë për zgjidhjen e problemeve në Brirën e Afrikës. Organizata e Unitetit Afrikan, që i shërben në fakt kolonializmit, se në të dominojnë klika kapitaliste në shërbim të imperializmit, i leverdis Titos, kurse organizatat e tjera, të cilat nuk i përshtaten drejtimit jugosllav, Titoja i quan si faktorë që përçajnë «lëvizjen e mosangazhimit». Kjo gjë u vu re edhe në fjalimin që mbajti në këtë kongres Miniçi, ministri i Jashtëm i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Ai atakoi, pa e zënë në gojë, edhe Kinën, e cila mbron teorinë e «botës së tretë». Me

teorinë e tyre të «botës së tretë», tha Miniçi, fuqi të mëdha kërkojnë të imponojnë vullnetin e tyre dhe të përçajnë «botën e paangazhuar».

Pra Titoja e mbron tezën e tij skllavëruese për popujt, por nën drejtimin e imperializmit amerikan, jo nën drejtimin e një fuqie tjetër imperialiste. Presidenti Tito tregohet shumë i bindur ndaj politikës agresive ekspansioniste dhe neokolonialiste të imperializmit amerikan, se nga ky imperializëm ai ka pasur dhe vazhdon t'i ketë të gjitha ndihmat, qofshin këto ndihma morale, materiale edhe ushtarake në rast nevoje.

Teorisë së tij të «lëvizjes së mosangazhimit» Titoja kërkon t'i japë një konsistencë, një fond të qëndrueshëm, që kjo nuk e ka dhe nuk mund ta ketë kurrë. Ai përpiqet që të luftojë të gjitha ato të ashtuquajtura interesa të huaja dhe politikën e blloqeve, të cilat duan që problemet ndërkombëtare, në përgjithësi, si dhe marrëdhëniet midis blloqeve dhe fuqive të mëdha, të influencojnë në kombet e ashtuquajtura të paangazhuara dhe ta përçajnë këtë lëvizje. Në fakt Titoja dëshiron të lihet i lirë, që ta drejtojë ky këtë farë lëvizje në interesin e kapitalit amerikan dhe të atij botëror.

Titoja mendon se vendet «e paangazhuara» kanë një vitalitet të madh dhe mund të përballojnë të gjitha rreziqet për të mbrojtur unitetin e tyre. Kështu ato mund të realizojnë aspiratat e tyre të përbashkëta dhe, sipas tij, të arrihet që gjithsecili të mbesë një shtet i pavarur revolucionar. Ai nuk mungoi të përmendë konferencën ministriale të vendeve «të paangazhuara» në Beograd, e cila duhet të japë fryte të veçanta për të kapërcyer gjoja vështirësitë e tanishme brenda lëvizjes. Ky është një blof. Asnjë vështirësi nuk po kapërcehet, e kundërta ngjet në realitet. Në këtë botë të ashtuquajtur të paangazhuar jo vetëm që ka kontradikta të thella midis vetë këtyre ven-

deve dhe midis tyre e imperializmit, por ka edhe luftëra të armatosura, ka gjakderdhje.

Për sa i përket gjendjes në Evropë Titoja vuri në dukje se ekzistojnë situata të paqëndrueshme dhe se problemi i «sigurimit evropian» është një problem me rëndësi të madhe që e duan popujt etj., etj. Që popujt e të gjitha vendeve të këtij kontinenti duan një Evropë pa luftëra, kjo është një e vërtetë, por këtë nuk e dëshirojnë ata që sundojnë mbi popujt. Pastaj që të arrihet ky «sigurim evropian», natyrisht, duhet të kalojë shumë ujë nën urë, domethënë duhet të zhvillohen më parë një sërë procesesh revolucionare kundër atyre shteteve evropiane që janë inkuadruar në blloqe dhe nuk e lejojnë këtë «sigurim evropian», gjithashtu duhet likuiduar kapitalizmi në përgjithësi në shtetet evropiane që nuk janë në blloqe dhe të vendoset shteti i diktaturës së proletariatit. Vetëm në këto rrethana mund të flitet për një sigurim të vërtetë evropian. Për një sigurim evropian ala Tito nuk mund të flitet, një gjë e tillë nuk mund të arrihet. Këto janë fjalë boshe për të bërë njëfarë pasqyre të përgjithshme të situatës në Evropë.

Por, me gjithë mossuksesin e saj, Titoja tha se është arritur një rezultat i rëndësishëm në procesin e detantës dhe këtë ai e lidh me personin e tij. Natyrisht, nuk flet Titoja për personin e tij, por për Beogradin që ka qenë një nga qendrat ku u bënë të famshmet mbledhje në erë të «sigurimit evropian», ose të mossigurimit evropian që nuk dhanë asgjë. Si shembull të bashkëpunimit të mirë që duhet ta ndjekë gjithë Evropa, ai përmend Jugosllavinë, e cila është bërë «model i përsosur» i zbatimit me konsekuencë në praktikë të dispozitave të Konferencës së Helsinkit.

Ç'tregon në realitet kjo që vetë Titoja pohon me gojën e tij? Kjo tregon se regjimi i tij është në bashkëpunim të plotë me të dy blloqet, si me NATO-n ashtu

edhe me Traktatin e Varshavës. Nga të dy blloqet Titoja përfiton, prandaj Jugosllavia ka marrëdhënie të mira me secilin nga këto blloqe. Atëherë kujt ia rekomandon ai një gjë të tillë? Natyrisht, ua rekomandon dy blloqeve dhe atyre vendeve evropiane që nuk janë futur në këto blloqe.

Pra, sipas Titos, të dy blloqet duhet të ndjekin atë rrugë që ka ndjekur dhe po ndjek Jugosllavia ndaj tyre. Dhe për sa i përket mbledhjes së Beogradit, domethënë vazhdimit të mbledhjes së Helsinkit për «sigurimin evropian», Titoja u bën elozhe të mëdha vendeve «të paangazhuara» për qëndrimin e tyre lidhur me këtë çështje të rëndësishme. Në fakt ato nuk luajtën asnjë rol në këtë maskaradë, por, që t'i japë një vlerë të madhe Jugosllavisë, që e udhëheq gjoja këtë lëvizje të vendeve të paangazhuara, Titoja pretendon se një qëndrim i tillë ndaj çështjes së sigurimit dhe të bashkëpunimit evropian nuk është vetëm në interesin e shteteve, por në interesin e popujve.

Pra Titoja na del gjoja se interesohet jo për çështjet e shteteve të atyre vendeve të Evropës që bëjnë pjesë në blloqe, por më shumë për çështjet e popujve të Evropës dhe të botës. Domethënë në një mënyrë false ai ngre autoritetin e paqenë të mbledhjeve të Helsinkit dhe të Beogradit, si dhe atë të vendeve «të paangazhuara», edhe pse këto shtete nuk përfaqësojnë aspak vullnetin e atyre popujve për të cilët flet ky kasnec i Beogradit.

Kasneci i Beogradit flet në emër të shtetit të tij dhe u drejtohet shteteve të tjera. Kështu ai njeh plotfuqishmërinë e shteteve kapitaliste që dominojnë botën. Konkretisht në vend që ky t'u thotë popujve se çfarë rrugë duhet të ndjekin që këto shtete kapitaliste të dobësohen dhe të shkatërrohen për të arritur në një unitet, në një sigurim jo vetëm evropian, por botëror, ai u drejtohet shteteve kapitaliste të Evropës për një bashkëpunim dhe

vëllazërim të ngushtë me njëri-tjetrin. Se çfarë është kjo, për të gjithë ne është e qartë. Kjo është një thirrje socialdemokrate, një thirrje e një elementi që i shërben me zell të madh kapitalit botëror.

Nga çështjet e Evropës presidenti jugosllav në raportin e tij hidhet e flet për turbullirat në botë dhe i numëron ato një e nga një. Ai përmend çështjen e Lindjes së Mesme dhe thotë se Izraeli ndjek një politikë agresive dhe ekspansioniste. Po përse Izraeli ndjek një politikë të tillë dhe kush është prapa këtij shteti agresiv dhe ekspansionist, këtë Titoja nuk e vë në dukje. Por ai thekson se kjo politikë e Izraelit përçan vendet arabe dhe nuk lejon një zgjidhje të qëndrueshme dhe të drejtë që në fakt kërkohet nga gjithë komuniteti ndërkombëtar.

Sipas Titos, zgjidhja e krizës së Lindjes së Mesme është në dorë të vendeve arabe. Po çfarë duhet të bëjnë këto vende? Të jenë në unitet, thotë Titoja. Por në ç'baza duhet të jetë ky unitet? Kush e krijon unitetin e vërtetë midis vendeve arabe dhe kush e përçan këtë? Në këtë analizë është e zorshme të futet një renegat i marksizëm-leninizmit, sepse ai nuk mund të bëjë një analizë klasore të gjendjes shoqërore, politike dhe ekonomike në vendet arabe dhe nuk mund të gjejë kyçin e këtij uniteti.

Titoja gjithashtu foli dhe për dy vatrat e turbullta në Afrikën e Jugut. Për Titon, problemi në këto vende zgjidhet me eliminimin e bastioneve të fundit të kolonializmit dhe të racizmit, domethënë me sigurimin e pavarësisë së Namibisë dhe të Zimbabvesë dhe dhënien fund të aparteidit në Republikën e Afrikës së Jugut. Është fakt që regjimi i Republikës së Afrikës së Jugut është një regjim me të vërtetë reaksionar, por kolonializmi nuk mbaron, siç thotë Titoja, me dhënien e lirisë namibianëve dhe zimbabvianëve. Kolonializmi është futur thellë në Afrikë, prandaj, për ta zhdukur atë, për të zhdukur shtypjen dhe koncesionet e imperialistëve dhe të kapitalistëve

të botës duhet të bëhet një qilizmë e thellë në këto vende. Në qoftë se duhet bërë një analizë e situatës së vendeve të Afrikës dhe të kolonializmit në këto vende, atëherë kjo duhet të jetë një analizë shkencore, një analizë klasore, ku të preken, kuptohet, të gjitha ato klika që janë të lidhura ngushtë me kolonizatorët e ndryshëm dhe që vazhdojnë të shtypin popujt afrikanë. Mirëpo një tradhtar i marksizëm-leninizmit nuk mund t'i hyjë një analize të tillë.

Titoja i përmend të gjitha ngjarjet që ndodhin në botë, në Evropë, në Azi, në Afrikë etj., etj., për të treguar se është në korent të tyre dhe jep nga një mendim të përgjithshëm se si duhet të jenë këta popuj dhe si duhet të përmirësohet kjo gjendje. Ai nuk e gjen të arsyeshme të futet thellë në trajtimin e këtyre problemeve, për arsye se gjoja për 40 vjet me radhë ka folur për to.

Po çfarë tha presidenti jugosllav për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për Bashkimin Sovjetik? Asgjë. Ai u bëri thirrje atyre që të kapërcejnë gjendjen e tanishme të pakënaqshme në marrëdhëniet midis tyre, domethënë i këshilloi që të miqësohen. Kjo gjë, vuri në dukje ai, nuk është vetëm në interesin e tyre, por është në interes edhe të të gjithë botës. Pra Titoja u bën thirrje dashamirësisë dhe zemërgjerësisë së imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik, që të ulen në bankë dhe të bisedojnë me njëri-tjetrin më qetë, miqësisht dhe t'i zgjidhin në paqe mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis tyre. Por cilat janë këto mosmarrëveshje, pse ekzistojnë këto midis tyre, ç'kërkojnë të bëjnë këto fuqi të mëdha imperialiste? Jo, këto çështje Titoja nuk mund t'i prekë dhe nuk i prek. Bile ai mundi të theksonte se gjendja e marrëdhënieve midis dy fuqive nuk është si në vitin 1961, kur konferenca e Beogradit e vendeve «të paangazhuara» u bëri thirrje fuqive të mëdha që të fillonin bisedimet midis tyre dhe të dobësohej lufta e ftohtë.

Kurse në realitet ishte politika oportuniste revizioniste e hrushovianëve që drejtohej drejt miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një miqësi, natyrisht, që Bashkimi Sovjetik t'ua hidhte Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të fituar hegjemoninë, për të rifituar tregje në botë, për të krijuar perandorinë e tij. Natyrisht Titoja e ndihmoi Bashkimin Sovjetik të ecte në rrugën që kishte hyrë. Ai ndihmoi gjithashtu edhe imperializmin amerikan që të ruante koncesionet që kishte në botë. Pra krijimin e një gjendjeje të tillë Titoja e konsideron si një akt të madh diplomatik që ka bërë ai për ujdinë e këtyre dy supershteteve imperialiste, për pazarllëqet e tyre në kurrizin e popujve.

Përsëri edhe në këtë raport, që i paraqitej Kongresit të 11-të, renegati Tito nuk mungoi të fliste për takimin e nivelit të lartë të vendeve «të paangazhuara» në Kolombo që gjoja u përpoq për uljen e tensionit. Në fakt, që prej asaj kohe tensioni në vend që të jetë ulur, është ngritur, veçse Titoja këtë ngritje tensioni e konsideron «ulje», jo vetëm në Evropë, por në të gjithë botën.

Rruga për të dalë nga vështirësitë e tanishme duhet të gjendet, vë në dukje Titoja, por nuk thotë asgjë se si mund të dilet nga këto vështirësi. Titoja thekson besimin e tij në shfrytëzimin, siç pretendon ai, të bisedimeve midis qeverive dhe personaliteteve të larta të shtetit si dypalëshe, ashtu edhe shumëpalëshe. Pra, për Titon, zgjidhja e problemeve ndërkombëtare varet nga personat kryesorë, nga klikat që sundojnë mbi vendet dhe mbi popujt. Me këtë, në fakt ai e hedh poshtë të gjithë pseudoteorinë e tij të vetadministrimit, të ngritjes së rolit të njeriut, të ngritjes së rolit të klasës punëtore etj. Domethënë, Titoja, duke dashur të shpjegojë një problem, rrëzon tezat e falsifikuara që mbron më poshtë. Ekzistojnë natyrisht kontradikta të mëdha në thëniet gjenerike të tij, për arsye se këto thënie nuk kanë asnjë

bazë teorike, asnjë bazë klasore. Te Titoja nuk mund të gjesh asnjë ide konsekuente të një udhëheqësi borgjez me mendime të qarta të përcaktuara. Tipike te Titoja është pikëpamja e një anarkosindikalisti të pafiksuar si duhet në mendimet e tij të ngatërruara dhe të sipërfaqshme.

Duke folur për çështjet ndërkombëtare, presidenti Tito ngre lart rolin e Jugosllavisë dhe politikën e saj të jashtme, e cilëson këtë si një politikë shumë aktive dhe jo vetëm shumë aktive, por edhe konsekuente, të bazuar në parimet e pavarësisë, të sovranitetit, të integritetit territorial, të mosndërhyrjes dhe të së drejtës së çdo vendi e kombi për një zhvillim të pavarur e të tjera, e të tjera profka të tilla.

Politika e Jugosllavisë është një politikë e varur, një politikë mashtruese, joparimore, një politikë që i çon ata që i besojnë asaj në skllavërim dhe në shfrytëzim nga fuqitë e huaja, është një politikë që kërkon të nxjerrë fitime të majme për Jugosllavinë dhe veçanërisht për klasën sunduese në Jugosllavi. E tillë është kjo Jugosllavi e Titos dhe kjo politikë e kësaj Jugosllavie.

Jugosllavia me politikën e saj nuk ka krijuar besim te popujt. Asnjëri nuk e dëgjon dhe asnjëri nuk ia var asaj. Jugosllavia e Titos dhe Titoja personalisht është vetëm një proksenet, që shkon andej e këtej, që flet e llomotit, që bën llogje pa bukë dhe ndërmjetëson te njëri e te tjetri, duke çuar llafet e njërit te tjetri dhe duke kërkuar lëmoshë për veten e tij, në radhë të parë, por edhe për të tjerët nga fuqitë e mëdha. Me fjalë të tjera, Titoja me politikën e tij është një transmetues i vullnetit të atyre që e paguajnë.

Titoja vuri në dukje shkëmbimet e mendimeve që po zgjerohen vazhdimisht midis Jugosllavisë dhe personaliteteve kryesore shtetërore (dhe këtu qëndron gjithë politika e Jugosllavisë në marrëdhëniet me personalitetet kry-

esore shtetërore dhe qeveritare) dhe marrjen shpeshherë parasysh të mendimit të Jugosllavisë. Pse, pyet Titoja, merret parasysh mendimi i Jugosllavisë? Për arsye, thotë ai, se ata kanë «respekt për përvojën e madhe» të këtij vendi lidhur me trajtimin e çështjeve kryesore, në vend që të thotë se kanë një respekt të madh për shërbimet që shërbëtori i bën zotnisë.

Me vendet «socialiste» ai tha se Jugosllavia ka marrëdhënie të mira dhe të frytshme. Kurdoherë Jugosllavia ka pasur marrëdhënie të mira me këto vende, sido që Titoja, si agjent i amerikanëve dhe i anglezëve, është përpjekur dhe përpiqet që këto vende t'i futë në suazën e dy padronëve ose të shumë padronëve të tij kapitalistë dhe t'i shkëputë nga tutela dhe shfrytëzimi i socialimperializmit sovjetik. Në këtë rrugë, natyrisht, Titoja nxjerr fitime për veten e tij, qoftë nga imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, qoftë edhe nga vetë këto vende të ashtuquajtura socialiste, të cilat duan të ndërrojnë zgjedhën, të dalin nga zgjedha e socialimperializmit rus dhe të futen nën zgjedhën e imperializmit amerikan apo të revanshistëve të Bonit me shokë.

Titoja gjithashtu foli dhe për marrëdhëniet jugosllave me fqinjët e saj. Si i paraqiti këto marrëdhënie ai në këtë raport? Ai i paraqiti të mira dhe dashamirëse nga ana e Jugosllavisë, por fakt është që as me Bullgarinë, as me Shqipërinë, as me Greqinë, as me Hungarinë këto marrëdhënie nuk janë ashtu siç thotë Titoja. Ka mosmarrëveshje midis Jugosllavisë dhe këtyre shteteve, bile mosmarrëveshje të mëdha që shkaktohen për arsye të politikës revizioniste fashiste qoftë të Bullgarisë, qoftë të Jugosllavisë e qoftë të Hungarisë. Pa për sa u përket marrëdhënieve me Shqipërinë, natyrisht, këto nuk mund të jenë të mira, për gjithë ato të këqija që ka bërë dhe po bën Jugosllavia titiste ndaj Shqipërisë dhe popullsisë shqiptare që jeton në tokat e veta në Jugosllavi.

Presidenti jugosllav theksoi më poshtë se çështjet nacionale në Jugosllavi i kanë zgjidhur më së miri. Ai nuk mungoi të kërkonte që edhe fqinjët e saj të sillen po në atë mënyrë me pakicat kombëtare jugosllave siç po sillet Jugosllavia me pakicat kombëtare në republikën e saj. Mirëpo, po të shikojmë historinë e qëndrimeve të mbajtura ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi, jo vetëm në kohën e kralëve serbë, por edhe në kohën e Titos deri tash, do të konstatojmë se ato janë qëndrime shoviniste të një shteti kapitalist, shfrytëzues. Vetë titistët kanë pohuar me gojën e tyre se Kosova është krahina më e prapambetur e Jugosllavisë. Lëndët e para të Kosovës kalojnë në republikat e tjera, asnjë investim me rëndësi e që duhet bërë atje nuk bëhet, Kosovën po e rrjepin nga pasuritë e saj dhe kosovarët po i lënë në varfëri. Fakt është se shqiptarët e Kosovës nuk kanë akoma atë liri dhe nuk gëzojnë akoma ato të drejta demokratike që pretendohet se ua kanë dhënë titizmi dhe socializmi vetadministrues. Këto janë një blof.

Një titist tjetër, njëfarë Vidiçi, që pak ditë më përpara foli në Kongresin e 8-të të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, e përmendi këtë qëndrim «demokratik socialist të Federatës dhe të Serbisë» ndaj shqiptarëve të Kosovës, veçse ai nuk mund ta mbulojë diellin me shoshë. Ky titist foli gjithashtu edhe për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, të cilën e quajti «ngjarje historike me rëndësi të madhe në luftën e popullit shqiptar kundër osmanëve». Por Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ka pasur vetëm këtë qëllim që përcakton ky, pra vetëm luftën kundër osmanëve. Qëllim kryesor ajo ka pasur ruajtjen e unitetit të kombit shqiptar, të trojeve shqiptare dhe pikërisht sepse ato u ndanë dhe iu dhanë Serbisë e Malit të Zi. Këto gjëra për të janë të shkuara, prandaj thotë se duhet të harrohen dhe kërkon që të pranohet realiteti ekzistues, domethënë,

sipas tij, shqiptarët të pranojnë të qëndrojnë nën thundrën e serbit dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë të mbyllë gojën për këtë realitet «të bukur».

Për sa u përket atyre kosovarëve, të cilët nga tribuna e Kongresit të 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e akuzuan Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë si një vend etatist dogmatik, si një shtet nacionalist irredentist etj., dua të theksoj se të gjitha këto që thanë ata janë pikëpamjet e qëndrimet e vërteta të regjimit titist ndaj popullsisë shqiptare që banon në tokat e veta në Jugosllavi dhe ndaj Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Pra nuk shërben shumë maska që përdor Titoja, sepse njerëzit e tij po i thonë haptazi ato që ai i thotë tërthorazi.

Si për Kosovën, ashtu edhe për gjithë Jugosllavinë, është një blof ajo që thotë Titoja se «veprimtaria jugosllave në çështjet e jashtme ka një bazë të gjerë sociale dhe pikërisht këtu masat tona punonjëse thonë fjalën e tyre vendimtare». Kjo nuk është e vërtetë. Njerëzit, punonjësit në Jugosllavi, nuk thonë asnjë fjalë vendimtare, fjalën vendimtare atje e thonë ushtria që drejton Lubiçiçi dhe sigurimi i shtetit jugosllav. Të tjerët punojnë dhe të tjerët fitojnë, punojnë robërit e rinj dhe fiton shtresa e kapitalistëve të rinj.

Në këtë raport Titoja bëri fjalë edhe për çarmatimin, por tezat e tij mbi çarmatimin janë të njohura, janë tezat e gjithë kasnecëve në botë, të të gjithë atyre që janë të lidhur pas qerres së fuqive të mëdha, nga të cilat marrin armë, marrin kredi, marrin teknologji, por që janë të lejuar të flasin fraza të përgjithshme për çarmatimin. Zaten edhe vetë fabrikantët e armëve flasin për çarmatimin, por të tjera thonë e të tjera bëjnë. Edhe Titoja po këtë gjë ka bërë dhe po bën. Pa ato që thotë ai se «në botë po forcohet besimi, se paqja dhe sigurimi ndërkombëtar nuk mund të ruhen përgjithmonë mbi një

ekuilibër forcash ushtarake dhe ndarjes në blloqe», janë fjalë boshe. Këto blloqe, si blloku i NATO-s, blloku i Traktatit të Varshavës e blloqe të tjera që do të krijohen në të ardhmen, do të ekzistojnë.

Kina është një nga këto fuqi të mëdha që shkon drejt krijimit të blloqeve, të cilat nuk mund t'i zhdukë fryma e shenjtë ose pallavrat e njëfarë antimarksisti, siç është Titoja. Këto do t'i zhdukë vetëm forca e popujve. Vetëm revolucioni, vetëm proletariati i frymëzuar nga ideologjia marksiste-leniniste mund t'i shkatërrojë blloqet, t'i prishë planet e imperialistëve dhe të marrë fuqinë në duart e tij. Marrja e pushtetit nga ana e proletariatit dhe e masave të gjera të popullit është ajo forcë që mund t'i shkatërrojë blloqet dhe mund të lejojë një zhvillim përparimtar të njerëzimit pa u mbështetur në forcat ushtarake të blloqeve. Blloqet nuk zhduken kështu siç veprojnë revizionistët kinezë, titistë, italianë e të tjerë.

«I gjithë komuniteti ndërkombëtar dëshiron të shohë dhënien fund të garës së armatimeve...», thotë Titoja. Po, po, komuniteti ndërkombëtar e kërkon një gjë të tillë, sepse armatimet gllabërojnë pasuri të mëdha materiale dhe ekonomike dhe gozhdojnë njerëz, që i përgatitin ato për gjakderdhje, por veçse zhdukja e këtyre situatave nuk mund të bëhet pa luftë dhe pa revolucion.

Luftërat duhet të jenë luftëra çlirimtare. Edhe Titoja flet për luftërat nacionalçlirimtare dhe arrin deri atje saqë të thotë që luftërat nacionalçlirimtare kanë shkaktuar likuidimin e plotë të kolonializmit dhe arritjen e së drejtës së popujve për vetëvendosje. Në fakt, nuk është kështu, siç pretendon ky kasnec i kapitalizmit. Këta popuj janë përsëri në skllavëri, të shtypur e të shfrytëzuar nga ana e kapitalit, por në forma të ndryshme, jo më në format e vjetra të kolonizimit, por në ato të neokolonizimit. Kurse Titoja, në vend që të predikojë, se si popujt mund ta shkundin zgjedhën, dhe këtë konkretisht ai

s'mund ta bëjë, flet se kjo zgjedhë gjoja mbahet nga disa «dogmatikë», «sektarë», ose «pseudorevolucionarë», prandaj duhet vepruar kundër tyre dhe pretendimeve monopolizuese, ngado që të vijnë këto. Me fjalë të tjera, ky renegat dëshiron që të ruhet statukuoja e sotme e botës. Këtu ai bashkohet plotësisht me kinezët: Që të ruhet kjo statukuo duhet të luftohen «dogmatikët», «sektarët», «pseudorevolucionarët», domethënë të gjithë ata që ndjekin dhe zbatojnë, në teori dhe në praktikë, teorinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Titoja të gjithë ne na quan pseudorevolucionarë.

Më poshtë në raport, duke folur për këtë problem, Titoja del me konkluzionin se vetëm pavarësia e vendeve e fituar në këto forma, në këto mënyra e të gjitha këto në këtë pasivitet ose në një aktivitet muhabeti midis krerësh kapitalistë, siç bëjnë Titoja dhe partnerët e tij, me fjalë të tjera, «e dhënë» nga imperialistët në format që njihen e që në realitet nuk japin as lirinë, as pavarësinë, as sovranitetin, përkundrazi lejojnë shfrytëzimin e popujve, përbëjnë premisat e përparimit për të arritur në sigurimin e paqes.

Pra teoria e Titos është e pleksur me një mënyrë të tillë që ai thotë se «në zhvillimin e komunitetit ndërkombëtar mbi bazën e avancimit të pashembullt të forcave prodhuese, nuk ka ekzistuar asnjëherë një ndërvartësi dhe lidhje kaq e madhe midis vendeve». Domethënë, ky «përparim» teknik i zhvilluar nga kapitalizmi botëror për interesat e tij dhe jo për interesat e popullit, është në favorin e komunitetit ndërkombëtar dhe kjo gjë i ka lidhur vendet njëri me tjetrin. Pra, këto vende, sipas Titos, duhet të jenë të kënaqura nga ky zhvillim. Por, në fakt, çfarë zhvillimi është, kush përfiton nga ky zhvillim i shkencës ose i teknikës? Natyrisht, siç e thashë, nuk fitojnë shtresat punonjëse, nuk fiton proletariati, nuk fiton fshatarësia. Teorizime të tilla gjenerike nuk e shërojnë plagën e madhe të shoqërisë që ka për emër fjalën e urryer kapitalizëm.

Titoja vuri në dukje se kjo situatë është e tillë, por ka edhe kontradikta të thella që shkaktohen, sepse pasuria e akumuluar në botë është në duart e disave. Kjo çështje, sipas tij, nuk është e drejtë, «këto kushte nuk janë të barabarta, janë thellësisht të padrejta dhe të papranueshme». Domethënë kini mëshirë, ju, imperialistë amerikanë ose socialimperialistë sovjetikë, ose ju vende të tjera kapitaliste që keni akaparuar pasuritë e botës dhe skllavëroni vendet, lëshoni disa thërrime që të rrojnë edhe popujt e vendeve të tjera. Titoja për veten e tij nuk ka pse të qahet, për arsye se ai ia ka hipur kalit. Cilit kalë? Kalit imperialist. Domethënë ai e ka shitur mirë vendin e tij te kapitalistët e huaj. Dhe që ky Tito dhe titizmi si teori të fshihen nën maskat gjoja demokratike, gjoja socialiste vetadministruese, kjo s'u prish shumë punë këtyre vendeve të huaja kapitaliste, përkundrazi u ndreq, sepse teori të tilla mund të gënjejnë njerëz dhe popuj.

«Aspiratat e popujve, thotë Titoja, po hasin në kundërshtimin e atyre, të cilët kërkojnë të ruajnë pabarazinë dhe pozitat e tyre monopoliste». Por imperializmi, kolonializmi ose neokolonializmi, që i rezistojnë me forcë përparimit, janë aleatë të Titos. Ky nuk u thotë popujve çfarë duhet të bëjnë dhe, natyrisht, nuk mund t'u thotë, sepse nuk pranon tezat leniniste, nuk pranon teorinë e Marksit. Si të gjithë revizionistët, Titoja është një reformist, një anarkosindikalist, një agjent i borgjezisë, i kësaj shoqërie me klasa ku mund të rrojnë të lumtur dhe të kënaqur vetëm ata që ruajnë pabarazinë dhe pozitat e tyre monopoliste.

Kështu duhet kuptuar gjoja mendimi filozofik i Titos ose pikëpamjet e tij gjoja revolucionare. Fraza bajate gjen sa të duash në 80 faqet e raportit të Titos. «Paqja duhet të ruhet, sepse është kusht vendimtar për ekzistencën e gjithë njerëzimit...», thotë ai. Por, si të ruhet

kjo paqe? Kush e prish këtë dhe cilët janë shkaktarët e luftërave? Për këto s'ndihet fare Titoja, ai vetëm thekson se «bashkekzistenca paqësore është e vetmja alternativë ndaj katastrofës bërthamore». E zbuloi gjithë të vërtetën! Dhe si konkluzion renegati Tito deklaroi: «Një përgjegjësi e madhe historike bie mbi këdo që luan me paqen... në kurriz të lirisë e të pavarësisë së popujve të tjerë». Pra nga ky konkluzion «i madh» Titoja nënvizon se «socializmi që prej kohësh ka dalë jashtë kuadrit të shteteve, rajoneve apo blloqeve dhe është bërë i paevitueshëm në zhvillimin shoqëror dhe në përgjithësi i pranueshëm, është evident në praktikë në një shkallë të lartë».

Domethënë, sipas Titos, shoqëria socialiste, ku më e plotë e ku më pak e plotë, është jo vetëm zhvilluar, por është vendosur në të gjithë rruzullin botëror, për arsye të dëshirës për paqe. Por ai nuk tregon në këtë raport të tij as si është vendosur ky socializëm, as se ç'luftëra janë bërë dhe ç'duhet bërë për këtë socializëm. Vetëm thotë se «çdo lëvizje përparimtare, nëpërmjet ideve dhe veprimeve të veta, jep kontribut në këtë luftë dhe, ndërsa bashkohen në rrymën kryesore botërore të luftës për një pamje socialiste të njerëzimit, këto tipare të ndryshme përbëjnë substancën, kuptimin dhe karakterin e socializmit si një proces botëror».

Këto janë fraza boshe tamam tipike revizioniste, reformiste dhe aspak revolucionare, që tingëllojnë si ajo kambana e prishur që nuk dëmton kërkënd dhe nuk mobilizon njeri. Krejt ndryshe mendojnë popujt që vuajnë. Aspiratat e tyre konkretizohen në luftëra të përgjakshme kundër shtypësve, kurse Titoja lufton me fraza. Lufta e Titos i përngjan luftës që thoshin francezët, *«en dentelles»* (me pambuk) dhe jo luftës revolucionare.

Titoja nuk tregon atë rrugë që duhet, rrugën e shfrytëzimit të kontradiktave që ekzistojnë, por të kundërtën. Ai vetëm konstaton se këto kontradikta ekzistojnë në

periudhën e zhvillimit të socializmit. Ç'bëjnë këto kontradikta? «Këto kontradikta sjellin si rezultat — thotë ai — arritjen e shpejtë të synimeve historike për emancipimin e punës dhe të njeriut në vendin e tij dhe afirmimin e atyre korenteve dhe rrymave demokratike në marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat lejojnë e nxitin transformimet përparimtare të shoqërisë dhe forcimin e pavarësisë, barazisë dhe bashkëpunimin e gjithanshëm».

Është i kuptueshëm absurditeti i këtyre frazave pa brendi, rreshtimi i disa ideve banale pa kurrfarë shpirti revolucionar. Nuk mund të gjesh shpirt revolucionar, nuk mund të gjesh shkaqet e vërteta ekonomike të ekzistencës së kontradiktave në ato që thotë Titoja, sepse ai nuk mund të mendojë mbështetur në materializmin historik dhe dialektik për t'i shpjeguar këto kontradikta, pse lindin, kush i shkakton dhe si duhen shfrytëzuar këto që të mund të sjellin atë çka predikon Titoja. Pra ai nuk bën gjë tjetër vetëm se llomotit.

Në këtë raport Titoja prek edhe problemin e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare, se këto e kanë mbajtur gjallë Jugosllavinë. Mirëpo këto marrëdhënie të Jugosllavisë me shtetet kapitaliste kanë qenë specifike. Titoja ua ka shitur Jugosllavinë kapitalistëve të huaj. Tri të katërtat e pasurive të këtij vendi mund të thuhet me siguri se janë në duart e të huajve.

Si konkluzion Titoja thotë se «vetëm me anë të një ndryshimi radikal në këto marrëdhënie do të ishte e mundur të koordinoheshin interesat e gjithë faktorëve të ekonomisë botërore dhe do të krijoheshin bazat për një siguri, paqe dhe begati të përgjithshme». Pastaj ai ankohet, duke thënë se «vendet e zhvilluara si një e tërë, nuk kanë treguar vullnet politik... në zgjidhjen e problemeve ekonomike të botës...». Për Titon vendet e zhvilluara janë një e tërë, ato nuk janë vende të shkëputura kapitaliste, ku gjithsecili sipas ligjit kapitalist e sipas

ligjit të xhunglës lufton kush e kush t'ia hedhë tjetrit, t'i imponohet tjetrit, të përfitojë nga tjetri me pak mundime, të shfrytëzojë masat e gjera të popujve. Prandaj Titoja ka shpresë dhe predikon që këto vende në unitet të tregojnë një vullnet politik e një gatishmëri të mjaftueshme për t'u angazhuar në masën e duhur për zgjidhjen e problemeve ekonomike të botës. Dhe më poshtë, duke folur për këtë problem, ky «burrë i madh» nuk mungon të tregojë «madhërinë e tij», duke thënë se «në kontaktet që ka pasur me udhëheqës të shteteve të tjera, pala jugosllave ka theksuar kurdoherë rëndësinë e krijimit të një rendi të ri ekonomik ndërkombëtar më të drejtë, duke theksuar se kjo është në interes të të gjithëve».

Pra kasneci jugosllav, që shkon në të gjitha kryeqytetet e vendeve kapitaliste e revizioniste, takohet e bisedon me njerëz të shquar të kapitalit dhe u thotë atyre që krijimi i një rendi të ri ekonomik botëror do të jetë në interes të të gjithëve. Domethënë Titoja i ka këshilluar ata që të shkarkohen ca nga pasuritë e mëdha që kanë dhe t'ua japin të tjerëve. Mirëpo ata nuk e kanë dëgjuar këtë profet të një «bote të re», së cilës nuk i vë emër, edhe pse e quan «socialiste». Në realitet ky socializëm nuk vlen për kërkënd, për popujt jo e jo, por as edhe për kapitalistët, miqtë e tij. Këta miq i japin Titos me shokë disa lëmosha për t'i mbajtur në fre njerëz të tillë, që propagandojnë ndyrësira, por që t'u japin nga pasuritë e tyre popujve të varfër, të cilët i krijojnë këto pasuri, kjo është gjë që s'bëhet dhe që nuk mund të fitohet, përveçse me luftë dhe me armë.

Por mbi këtë problem ky kasnec tjerr fraza dhe predikon se, po të zbatohen këto teori të tij, do të ketë një qëndrueshmëri ekonomike ndërkombëtare me pasoja të favorshme për vendet në zhvillim. «Këto marrëdhënie të drejta do të hapnin tregje me mundësi të

mëdha për shitjen e mallrave dhe shërbimet nga vendet industrialisht të zhvilluara. Shkurt do të krijoheshin marrëdhënie të reja tregtare, të cilat do të ishin edhe në përfitim të vendeve të zhvilluara», vë në dukje Titoja. Presidenti jugosllav u mëson kështu tregtarëve të mëdhenj të armëve dhe pasanikëve miliarderë se si duhet të zgjerohet tregtia dhe të zhvillohet ekonomia! Ata e dinë fare mirë këtë rrugë dhe e ndjekin atë, por në interes të tyre dhe jo në interes të popujve. Dhe pikërisht nga fitimet e këtyre tregtarëve e miliarderëve të mëdhenj përfiton Titoja, veç atij i duhet t'i thotë këto fraza, sepse duhet të fshihen lakmia, shtypja, shfrytëzimi i egër i kapitalizmit, miliardat që fitohen mbi kurrizin e popujve.

Dhe dadaja mbi dadatë e tjera të Titos është «lëvizja e mosangazhimit». Kjo, «lëvizja e mosangazhimit», jo vetëm që e preokupon Titon, por në sajë të kësaj lëvizjeje ai ka përfitime të mëdha, se i shërben ruajtjes së statukuosë imperialiste në kurriz të popujve, i sjell të ardhura të majme Jugosllavisë nëpërmjet kredive dhe shitjes së pasurive të saj të mbitokës dhe të nëntokës shteteve të huaja kapitaliste.

Ka vështirësi, thotë Titoja, në vendet «e paangazhuara», por këto do t'i kalojnë të gjitha. Ka rreziqe, dhe këto do t'i kalojnë të gjitha dhe do të ruajnë unitetin e tyre. Në realitet rreziqet aspak nuk kalohen, por vështirësohen dhe lëvizja nuk është aspak e paangazhuar, por është thellësisht e angazhuar me imperialistët e ndryshëm.

Ky revizionist u bën thirrje vendeve «të paangazhuara» që të mos përdorin forcën, të mos përdorin agresionin në marrëdhëniet reciproke midis tyre, sepse «qëndrime të tilla përbëjnë një kërcënim shumë të madh për marrëdhëniet ndërkombëtare» dhe për këtë është luftuar qysh në fillim. Pra Titoja këtyre popujve

që ai i quan se janë «të paangazhuar», u predikon bashkekzistencë paqësore revizioniste, një nënshtrim dhe një kërkim frazeologjik të të drejtave të tyre.

Por ç'duhet të bëjmë thotë Titoja? «Ne duhet të bashkohemi në përpjekjet e reja për të gjetur rrugën e drejtë për zgjidhjen paqësore të konflikteve për çdo rast konkret». Fjalë e madhe! Sikur këto zgjidhje nuk po bëhen! Por çështja shtrohet se kush i bën dhe si qëndrohet përpara këtyre zgjidhjeve, pse ekzistojnë konflikte, kush i nxit dhe si likuidohen këto konflikte?! Këto duhen shpjeguar, por pikërisht këto nuk i shpjegon Titoja e sigurisht, të tilla gjëra s'mund t'i shpjegojnë dot teoritë e tij false reaksionare. Ato i shpjegon vetëm marksizëm-leninizmi.

Titoja mendon se këto probleme do t'i zgjidhë konferenca e ardhshme ministriale e vendeve «të paangazhuara» që do të bëhet në Beograd, e cila «duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë gjetjes së zgjidhjeve të situatës së tanishme», sepse deri tashti s'është gjetur zgjidhja. Mirëpo kjo «lëvizje e mosangazhimit» nuk është një lëvizje e sotme. Ka dhjetëra vjet që Titoja e ka predikuar atë së toku me Nehrunë, me Sukarnon e me të tjerë dhe gjë nuk ka zgjidhur, përkundrazi ajo vështirësoi dhe vazhdon t'i vështirësojë të gjitha situatat. Është e kuptueshme që ajo do t'i vështirësojë situatat, për arsye se shërimi i vetëm, dalja e shpejtë e popujve nga një situatë e tillë, nuk realizohet me frazat boshe, me mbledhjet e famshme pa bukë të Beogradit e të Kolombos, por me luftë të përditshme të armatosur kundër shtypjes dhe shfrytëzimit kapitalist.

«Lëvizja e mosangazhimit» nuk luan asnjë rol në marrëdhëniet ndërkombëtare, siç pretendon presidenti i Jugosllavisë, përkundrazi është rezistenca e çdo populli dhe e grupe-popujsh të bashkuar për të mbrojtur të drejtat nga kolonizatorët ose neokolonizatorët, ajo që

mund të japë fryte dhe të luajë një rol në marrëdhëniet ndërkombëtare. Tjetër rrugë nuk ka, rruga e Titos është një rrugë e gënjeshtërt. Asnjë problem ndërkombëtar nuk ka zgjidhur «lëvizja e të paangazhuarve», përkundrazi, problemet ndërkombëtare po acarohen vazhdimisht dhe Titoja me shokët e tij bëjnë vetëm llafe, llogje, sa herë që u jepet rasti.

Vendet «e paangazhuara» nuk veprojnë asnjëherë të bashkuara, ato janë të përçara. Pretendimi i Titos se veprimtaria e tyre e përbashkët ka pasur pasoja në zhvillimin edhe në zgjidhjen e problemeve të vërteta thelbësore është një blof. Asnjë problem thelbësor nuk mund të zgjidhej nga një «front» ose nga një «lëvizje» e tillë pa baza teorike, pa qëllime të caktuara dhe pa një luftë të ashpër kundër të gjithë atyre që u dalin përpara. Pastaj ata që do ta bëjnë këtë luftë, dhe që Titoja i ka si shokë lufte, të tërë janë të angazhuar me fuqitë imperialiste dhe bëjnë lojën e tyre. Ata, pra, llafe mund të bëjnë sa të duan, por asgjë nuk kanë në torbë.

Pasi i thotë të gjitha këto, zoti Tito thekson se «lëvizja e mosangazhimit» ka hasur në «vështirësi». Kjo po, është e drejtë. Ai, gjithashtu, thotë se «kundërshtarët e saj përpiqen ta përçajnë dhe ta dobësojnë». Edhe kjo është gjithashtu e vërtetë, për arsye se «lëvizja e mosangazhimit» është një mashtrim për popujt, për revolucionarët, por ajo është një mashtrim edhe për imperialistët e ndryshëm. Disave kjo lëvizje u intereson, disa të tjerëve jo. Imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik u intereson kjo lëvizje, megjithatë ata kanë të angazhuarit e tyre që i tërheqin nga hunda, prandaj njëri përpiqet të kundërshtojë tjetrin, kurse marksistë-leninistët e luftojnë atë si një lëvizje antimarksiste, si një lëvizje në shërbim të superfuqive. Dhe kështu duhet konsideruar ajo e të luftohet kon-

kretisht kundër saj, jo me fjalë, jo në sipërfaqe, jo me parulla, por me luftë që me të vërtetë problemet thelbësore, për të cilat bën fjalë Titoja, të dalin në dritë. Pra lufta kundër atyre që i manipulojnë popujt me frazeologji dhe me të tilla grupime false, që nuk sjellin asnjë fitim për popujt është në interes të popujve.

Armiqtë e «politikës së mosangazhimit» janë marksistët e revolucionarët e vërtetë, por kundër janë edhe superfuqitë. Superfuqitë në aparencë janë për mosangazhimin, por në realitet janë për angazhimin e të gjithëve, mundësisht ndaj tyre. Titoja predikon «mosangazhimin», por në realitet nxit angazhimin, kurse ne, marksistët, ne, revolucionarët, e luftojmë «mosangazhimin», se e dimë ç'fshihet pas kësaj parulle. Nën maskën e «lëvizjes së mosangazhimit» fshihet nënshtrimi ndaj klikave kapitaliste, të cilat bëjnë llafe dhe shkëmbejnë pasuritë e vendeve të tyre vetëm në fitim të klasës që përfaqësojnë, të klasës së të pasurve.

«Lëvizja e mosangazhimit» nuk është aspak «faktor shumë i fuqishëm në balancën dhe në stabilitetin e tanishëm botëror. . .», siç pretendon Titoja. Përkundrazi, një pretendim i tillë nuk ka baza. Vetëm një parti e vërtetë marksiste-leniniste ka unitet, dhe nuk mund të flitet për unitet në një parti revizioniste, socialdemokrate, demokristiane apo republikane. Jo. Në të tilla parti ka fraksione të ndryshme, të cilat përbëjnë njëfarë uniteti për disa interesa të përbashkëta që i lidhin këto, në kundërshtim me tendencat e partive të tjera, por brendapërbrenda tyre nuk ka kurrfarë uniteti.

Ekziston unitet në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë? Pretendohet se po, por ky unitet konsiston në unitetin e asaj klase borgjeze kapitaliste që është krijuar në vend dhe që është lidhur me kapitalin e huaj për të luftuar

tendencat e ndryshme centrifugale, për të luftuar tendencat e shkëputjes të republikave nga Federata e cila lufton kundër tendencave shoviniste nacionaliste, që janë nxitur dhe po nxiten nga një regjim i tillë shfrytëzues kapitalist, siç është regjimi aktual jugosllav. Ekziston unitet në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë midis shtresave që janë të favorizuara, që së bashku me kapitalin e jashtëm përfitojnë nga grabitja e popullit jugosllav. Ne mund të themi se ky lloj uniteti ekziston në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, por unitet tjetër atje nuk ka dhe nuk mund të ketë. Përkundrazi, Partia Komuniste e Jugosllavisë asnjëherë nuk ka qenë një parti marksiste-leniniste. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, kur mendohej se Partia Komuniste e Jugosllavisë ishte me të vërtetë një parti që do të ndiqte rrugën marksiste-leniniste dhe do të ndërtonte socializmin në shembullin e praktikës leniniste, praktikës revolucionare të Bashkimit Sovjetik, e kundërta u vërtetua në jetë.

Në Jugosllavi pseudokomunistët, që kishin ardhur në fuqi me Titon në krye, që në fillim iu futën luftës kundër qenies së partisë një parti legale, një parti në udhëheqje, një parti që frymëzohet nga teoria e Marksit dhe e Leninit dhe nga praktika revolucionare e shembulli i Bashkimit Sovjetik. Sigurisht ata përdorën disa terma «autentikë», por kjo bëhej jo se jugosllavët dëshironin të ishin origjinalë ose specifikë në ndërtimin e socializmit në vendin e tyre. Jo. Këta janë terma që ata i kanë përdorur vetëm për t'u maskuar. Jugosllavia e Titos shkeli dëshirat, interesat dhe gjakun e popullit jugosllav dhe dëshironte, dhe për këtë u përpoq që në fillim dhe ia arriti, të ndërtonte në Jugosllavi jo socializmin, por të restauronte kapitalizmin e shkatërruar gjatë luftës kundër hitlerianëve, të ndër-

tonte një kapitalizëm nën drejtimin e një klase të re kapitaliste dhe jo nën drejtimin e Karagjorgjëve ose të kralëve të tjerë. Pra titistët, me Titon në krye, që në fillim i kishin sytë nga Perëndimi, nga fuqitë perëndimore dhe ata dëshironin, u përpoqën dhe e krijuan një parti të tillë, e cila t'i shërbente veprimtarisë së tyre të djallëzuar për të vendosur në Jugosllavi një regjim të ri kapitalist, i cili do të ishte në unitet me kapitalizmin botëror dhe në luftë me Bashkimin Sovjetik socialist, revolucionar, me atdheun e Leninit dhe të Stalinit.

Këtë çështje ne e kemi analizuar dhe herë të tjera. Nuk ishte e rastit që, në kohën kur Jugosllavia fitoi luftën, Titoja dhe grupi i tij në fakt luftuan të mbanin për një kohë në ilegalitet Partinë Komuniste të Jugosllavisë, ose t'i jepnin rëndësi të jashtëzakonshme organizimit të kësaj partie në format specifike. Për sa u përket punës politike dhe ideologjike, partia e zhvillonte nëpërmjet Frontit Popullor, frontit të gjerë të masave të popullit. Titizmi, pra, partinë u përpoq dhe e fshehu nën maskën e frontit që në fillim. Përse bëhej kjo? Kjo bëhej që të mos dukej përnjëherësh që kjo parti nuk ndiqte rrugën e Marksit, Leninit dhe Stalinit. Me rrugën që kishte nisur kjo parti do të bëhej dhe u bë, në fakt, një vegël në duart e sigurimit të shtetit, u kthye në një organ në shërbim të sigurimit të shtetit. Kjo ishte e organizuar gjoja si një parti, por Rankoviçi dhe Titoja e bënë atë konkretisht një vegël të tyre për të forcuar diktaturën fashiste, diktaturën kapitaliste që ata po vendosnin në Jugosllavi. Kjo mënyrë e të kuptuarit të rolit të partisë, të organizimit dhe të vijës së partisë, e realitetit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, bëri që të mos ndërtohej socializmi në fshat dhe ndërtimi i industrisë të merrte një rrugë drejt një bashkëpunimi të ngushtë me shtetet kapitaliste perëndimore, drejt një shkëputjeje progresive dhe më në

fund radikale me Bashkimin Sovjetik gjoja se ky ndërhynte në punët e brendshme të saj.

Jo, nuk është kjo arsyeja. Arsyeja ishte se e ashtuquajtura Parti Komuniste e Jugosllavisë, me Titon në krye, ishte kundër kolektivizimit. Ai bëri që fshati jugosllav të qëndronte në pozitat e mëparshme për sa i përket pronësisë, për sa u përket drejtimit dhe organizimit. Titoja shtetëzoi pasuritë e disa tradhtarëve të kohës së luftës dhe me këto krijoi fermat. Teoria që udhëhiqte Titon me shokë ishte teoria e Buharinit, e populistëve dhe e integrimit të kapitalizmit në «socializëm», gjë që do të thoshte të kundërtën, që socializmin ta integronte në kapitalizëm dhe këtë do ta bënte pikërisht ajo Parti Komuniste e Jugosllavisë që s'ishte një parti komuniste, por një parti antimarksiste në shërbim të sigurimit të shtetit.

Pra në Jugosllavi nuk udhëhiqte Partia Komuniste me një ideologji të vërtetë marksiste-leniniste, atje nuk ekzistonte dhe nuk u vendos diktatura e proletariatit. Jugosllavia u quajt një Federatë Demokratike Popullore, por në realitet ajo ishte dhe ecte në rrugën e një shteti borgjez kapitalist dhe drejt vendosjes së një diktature fashiste.

Kjo shkoi shumë larg, shkoi aq larg saqë, kur u vendos totalisht sistemi kapitalist në Jugosllavi, diktatura e UDB-së së Rankoviçit, u bë shumë e rrezikshme. E gjithë kjo u bë jo thjesht nga pikëpamja e titizmit, por sepse ekzistonin kontradikta midis grupeve. Grupi serb, duke pasur në dorë sigurimin e shtetit dhe ushtrinë, donte që të vendoste hegjemoninë e serbomëdhenjve në gjithë Jugosllavinë. Titoja është kroat, ai donte që të mbante ekuilibrin kapitalist, që natyrisht është e pamundur, midis këtyre tendencave shoviniste, të cilat mund të zhdukeshin vetëm duke pasur në krye një parti marksiste-leniniste. Përderisa kjo parti

marksiste-leniniste nuk ekzistonte në drejtimin e Jugosllavisë, këto tendenca shoviniste u theksuan, u acaruan më shumë, saqë grupi i Rankoviçit u bë i rrezikshëm për grupin tjetër, kroat, i cili dhe ky nga ana e tij për grupin slloven. Natyrisht, pas tyre do të vinin edhe malazestë, edhe shqiptarët, edhe maqedonasit. Për ta ruajtur këtë unitet kapitalist për një kohë të gjatë, që nga çlirimi i Jugosllavisë, që nga shkëputja prej Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera socialiste dhe deri te likuidimi i Rankoviçit, Titoja u detyrua të merrte masa dhe arriti të likuidonte grupin serb shovinist të Rankoviçit.

E çfarë bëri në këtë mes Titoja? Ai vuri njerëzit e tij të drejtonin. Ç'do të thotë vuri njerëzit e tij? Domethënë Titoja vuri ata njerëz që ishin për regjimin kapitalist dhe për zhdukjen e asaj force të partisë fashiste jugosllave në shërbim të UDB-së. Grupi i Titos, që fitoi kundër grupit serb, partinë e reduktoi në një organizatë amorfe dhe nëpërmjet kongresesh fiktive u bënë ndryshime në rolin e partisë. Këto ndryshime konsistonin në atë që partia të mos ishte më një vegël e Ministrisë së Brendshme, por kjo ministri të dominonte vazhdimisht në jetën jugosllave, grushti i saj të ndihej, të merreshin masa të rrepta dhe partia të bëhej një gjë e paqenë. Me fjalë të tjera partia të ruante emrin, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, një emërtim gjoja marksist, por në fakt partia nuk drejtonte më jetën në Jugosllavi, qoftë edhe në mënyrë fiktive. Asaj iu dhanë atributet e një grupimi pa konsistencë për edukimin e komunistëve dhe të masave, iu dha rëndësi Frontit (ideja e vjetër). Partinë titistët nuk mund ta likuidonin, atë duhej ta mbanin sa për formë, por në realitet roli i saj u zhduk, mori fund.

Lidhjet e ngushta të Jugosllavisë me kapitalin botëror kërkonin, natyrisht, që Jugosllavia të krijonte njëfarë drejtimi shtetëror dhe një administrim e zhvillim të ekonomisë së brendshme në rrugën josocialiste, duke e quajtur socialiste, por në të vërtetë adapte për interesat e kapitalizmit të huaj. Dhe kjo u bë. Vendimi i krijimit të vetadministrimit jugosllav u mor. Kjo është teoria gjoja e madhe marksiste-leniniste, modeli i fundit i socializmit specifik titist, por që sipas tyre i ka bazat në teorinë marksiste-leniniste. Gjithë kjo është një blof.

Të gjitha këto ndryshime e teorizime bëheshin që kapitalistët e huaj të siguroheshin jo vetëm ligjërisht, por edhe konkretisht, që kreditë dhe pasuritë e tyre të shfrytëzoheshin dhe të mos rrezikoheshin nga kryengritjet e masave punonjëse. Për këtë arsye u zhdukën edhe formalisht organet e pushtetit të diktaturës së proletariatit, u shkatërruan këshillat popullorë, baza e pushtetit të diktaturës së proletariatit, u decentralizuan ekonomia e planifikimi dhe u ruajt administrata burokratike në gjithë Jugosllavinë. Në duart e Federatës u konservuan drejtimi ushtarak, forca shtypëse, sigurimi i shtetit dhe e gjithë administrata, tregtia e jashtme, deri në njëfarë shkalle edhe arsimi e kultura. Por edhe këto të fundit u decentralizuan në një masë të madhe.

Federata mbajti grushtin kryesor të diktaturës dhe me këtë ruajti administratën, së cilës i dha një forcë të madhe. Njerëzit e administratës, qoftë në qendër, qoftë nëpër republika, do të ishin dhe u bënë shtresa e re kapitaliste e Jugosllavisë.

Për sa i përket ekonomisë, bazës së shoqërisë, ajo u decentralizua, u quajt vetadministruese dhe doli teoria pseudomarksiste, sipas së cilës gjoja janë vetë punëtorët që administrojnë pasuritë e tyre dhe nëpërmjet të deleguarve ata planifikojnë punët në ndërmarrjet e tyre, planifikojnë investimet, shpenzimet, planifikojnë edhe të ardhurat dhe i ndajnë këto të ardhu-

ra, i japin edhe një kuotë Federatës, që kjo të mbajë forcën goditëse dhe të ruajë pseudounitetin e Federatës Jugosllave.

Pra çdo republikë punonte për hesap të vet, secila nga ato udhëhiqej nga vetadministrimi «socialist». Të gjitha ndërmarrjet, brendapërbrenda republikës qofshin të mëdha, qofshin të vogla, kishin këshillat e veta të punëtorëve, që gjoja bënin ligjin dhe prodhonin sipas interesave të tyre të veçanta, pa marrë parasysh nevojat e republikës. Shkurt këto ishin «vetë zot, vetë shkop». Po kush ishte zot këtu? Ishin këshillat e punëtorëve, ishin punëtorët? Jo, në asnjë mënyrë. Gjithë kjo që thuhej ishte një blof. Zot në ndërmarrje ishin drejtuesit e këtyre ndërmarrjeve, të cilët bënin si të donin dhe i ndanin si të donin të ardhurat. Një administrim i tillë anarkist lejonte spekulime të mëdha, lejonte shfrytëzimin e krahut të punës dhe të mendjes së punëtorëve në favor të drejtuesve të ndërmarrjeve që majmeshin në kurriz të punëtorëve.

Kjo teori titiste u përngjiste atyre teorive dhe metodave që zhvillohen në vendet kapitaliste perëndimore të Evropës, ku edhe punëtorët kanë në ndërmarrje nga një aksion të vogël, por në realitet aksionet e mëdha të ndërmarrjeve janë në duart e kapitalistëve, ata bëjnë ligjin atje, kurse punëtorët quhen sikur marrin pjesë në administrim.

Pra në këshillin e administrimit të një ndërmarrjeje të madhe kapitaliste në Perëndim ka edhe ndonjë punëtor përfaqësues të këtyre aksioneve. Edhe në këshillat ose në të deleguarit, siç i quajnë titistët, në sistemin vetadministrues futet ndonjë punëtor. Por ç'kanë ata në duart e tyre? Kanë hapëset e kashtës, se pushtetin e mbajnë të tjerë në duar: ata që bëjnë tregtinë me jashtë, që caktojnë çmimet në treg, që planifikojnë se ku duhen e ku nuk duhen bërë investime, ku

nuk janë ato rentabël për ndërmarrjen, por janë rentabël për xhepin e tyre etj., etj. Këtej rezulton që një numër i madh njerëzish, që udhëheqin këto të ashtuquajtura ekonomi vetadministruese e që përbëjnë në tërësi socializmin vetadministrues jugosllav, janë pasuruar aq, saqë titistët, me Titon në krye, u alarmuan. Ata u alarmuan edhe për arsye se kishte lëvizje, kishte kontradikta të mëdha midis punëtorëve e drejtuesve të ndërmarrjeve dhe midis republikave. Disa republika ishin më të afta, disa jo për të siguruar kredi nga kapitalet e huaja dhe kapitalistët e huaj kishin interesa të veçanta. Nga njëra anë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e zhvilluara perëndimore kishin interesa të investonin dhe të akaparonin pasuritë e Jugosllavisë, por kishin preferenca të mëdha në Kroaci, në Slloveni, më pak në Mal të Zi, fare pak në Kosovë dhe hiç fare në Maqedoni. Nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik, i cili ka prirjet e tij për dominim në Jugosllavi, preferonte më tepër Serbinë dhe Malin e Zi, bastionet e vjetra të pansllavizmit.

Kështu që edhe në mes republikave ky farë administrimi i «socializmit specifik» krijoi turbullira të mëdha, por krijoi njëkohësisht atë shtresë kapitalistësh që u duhej regjimit të Titos dhe kapitalistëve të huaj të mëdhenj, që kishin investuar dhe që bënin nëpërmjet grupit të fuqishëm të Titos politikën në Jugosllavi dhe të gjithë atë politikë që përmendëm më lart, gjoja ndërkombëtare.

Në jetën ekonomike të Jugosllavisë ky vetadministrim solli të këqijat më të mëdha për arsye se regjimi i ri ishte një regjim kapitalist i pastabilizuar, domethënë klasa sunduese nuk ishte e formuar si duhet dhe nuk kishte në dorë, sidomos, frenat e ekonomisë dhe të pasurive të Jugosllavisë. Përqindja më e madhe e kësaj pasurie ishte në duart e koncerneve dhe të kapitaleve të

huaja, të cilat ishin futur thellë dhe i kishin aq të koklavitura punët në këtë rrjetë merimange, saqë këta njerëz, domethënë kjo shtresë e madhe kapitalistësh në Jugosllavi që po formohej, nuk kishte përveçse një synim: të mbushte xhepat e saj, pra të vidhte sa të mundte dhe si të mundte më mirë. Kështu që sot ne shohim një krizë të madhe në Jugosllavi në kuadrin e krizës së madhe të shteteve kapitaliste.

Jugosllavia është një shtet vasal i këtyre shteteve kapitaliste, prandaj kriza në këtë vend do të ndihej akoma më shumë, ajo do të ishte akoma më e madhe se në vendet kapitaliste, në padronët e saj. Sot kostoja e jetesës në Jugosllavi është ngritur pa masë dhe buxheti jugosllav ka një deficit të madh tregtar me miliarda, me gjithë miliardat që ajo ka marrë nga kapitali i huaj. Pra ekonomia jugosllave është krimbur, ajo është në duart e të huajve. Në Jugosllavi nuk ndërtohet socializmi, përkundrazi atje ekziston një kapitalizëm nën drejtimin e një shteti anarkosindikalist, fashist, vidh të vjedhim, siç i thonë një fjale. Diktatura fashiste që ekziston në këtë vend, bën çmos që ta mbajë këtë situatë dhe të sigurojë kapitalin e huaj dhe klasën borgjeze kapitaliste që është në zhvillim. Kjo bëhet në kurriz të punonjësve të Jugosllavisë, në kurriz të unitetit të Federatës Jugosllave dhe krijon e acaron kontradiktat midis klasave që u formuan në Jugosllavi, si dhe republikave të ndryshme jugosllave.

Prandaj nuk është i vërtetë, por i gënjeshtërt pretendimi i Titos se «Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë ka pasur dhe ka unitet për të gjitha problemet kryesore të ndërtimit socialist e të politikës së jashtme jugosllave». Sigurisht, Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë është kryesisht një komitet kapitalist që mbron interesat e klasës kapitaliste që sundon në Jugosllavi ose më mirë

të klasës që grabit atje, por Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka asnjë forcë se në të nuk ekziston një platformë marksiste-leniniste, kështu që nuk mund të ketë unitet në radhët e saj.

Titoja kërkoi që të ketë unitet mendimi dhe unitet veprimi në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë. Por, përderisa ajo nuk udhëhiqet nga një ideologji marksiste-leniniste, nuk mund të ketë në të unitet mendimi e as veprimi. Këtë e di mirë Titoja dhe prej kësaj vuan, por nuk mund ta vendosë dot një gjë të tillë, se është një antimarksist, është kapitalist, socialdemokrat, element parazitar.

Tash, në Kongresin e 11-të Titoja bëri thirrje për çështjen e centralizmit demokratik në parti. Por ky parim në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka asnjë kuptim marksist-leninist. Duke folur mbi centralizmin demokratik, Titoja kërkon të thotë që komunistët duhet t'i binden diktaturës fashiste të shtetit jugosllav, të administratës shtetërore kapitaliste jugosllave. Ky gjoja është thelbi i centralizmit demokratik në partinë titiste, të cilën Titoja e reklamon për t'i dhënë njëfarë konsistence, njëfarë qëndrueshmërie socializmit vetadministrues jugosllav.

Vetëm centralizmi demokratik, thotë Titoja, «garanton demokracinë më të gjerë e më të mundshme në formulimin e politikës, në aprovimin e vendimeve dhe në unitetin e fortë për zbatimin e tyre». Kjo, si dhe shumë të tjera, është një thënie boshe, se partia ose Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, është një front ku përplasen rryma të ndryshme, interesa të ndryshme vetjake. Nuk bëhet pa qëllim ajo që Titoja vë theksin në rolin kryesor të njeriut në shoqërinë socialiste vetadministruese, domethënë «në mbrojtjen e të drejtave të njeriut», siç thotë Karteri. Në fakt, qoftë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë në Jugosllavi, të drejtat

e njeriut janë reduktuar në zero. Njeriu në Jugosllavi është i shtypur nën peshën e grushtit të diktaturës fashiste, nën peshën e dyfishtë të kapitalizmit të huaj dhe të kapitalizmit shtetëror jugosllav.

Duke parë që nuk mund të ketë as unitet mendimi dhe as unitet veprimi në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, Titoja tha që mund të ekzistojnë edhe pakica në parti, dhe në fakt ato ekzistojnë. Prandaj në një parti të tillë, në një shtet të tillë pseudosocialist, nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet mendimi dhe veprimi. Titoja ekzistencën e pakicave dhe të mendimeve të ndryshme, e lejoi, si të thuash, por shtoi se çdo komunist duhet t'i bindet shumicës dhe shumica është grushti i diktaturës fashiste.

«Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e popullit punonjës dhe e qytetarëve në zgjidhjen e të gjitha problemeve të shoqërisë së tyre...» është një blof, sepse mbledhje mund të bëhen sa të duash në Jugosllavi, mund të merren dhe vendime në këto mbledhje, por vendimet zbatohen sipas interesit të klasës, sipas interesit të atyre që janë vënë në krye të punëve, në krye të ndërmarrjeve vetadministruese. Ata bëjnë ligjin dhe thonë fjalën e fundit në shtetin vetadministrues jugosllav.

Sistemit të delegatëve, që përmenda më lart, Titoja i vë një rëndësi të madhe, se gjoja krijon mundësinë që iniciativat e miliona vetave të gjejnë shprehje. Ky është një mashtrim. Këta delegatë, edhe sikur të jenë një unitet i zgjedhur, nuk kanë asnjë influencë dhe asnjë kompetencë në drejtimin e ndërmarrjes. Këta mund të blihen e të shiten kur të duash nga bosët e ndërmarrjes dhe nga vetë Titoja e Kardeli, me shokë. Në librin «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist», që Kardeli botoi para këtij kongresi, thuhet se ky sistem vetadministrues

ka edhe anët e tij të këqija, të cilat duhet të luftohen dhe të shërohen vetë, vetëm duke e ngritur në një lartësi të madhe ndërgjegjen e punonjësve, ndërgjegjen e njeriut. Në qoftë se ngrihet ndërgjegjja e njeriut, vazhdon Kardeli, atëherë ne do t'i zhdukim këto të meta. Po si mund të formohet ndërgjegjja e njeriut me një parti pseudomarksiste, me një parti që nuk ka një bazë teorike të shëndoshë dhe shkencore, siç është teoria e marksizëm-leninizmit? Si mund të flitet për një shkallë të lartë të ndërgjegjes së njeriut në një shoqëri me një zhvillim kaotik të ekonomisë ku grabitet, vidhet pasuria dhe ku çmimet ngrihen dita me ditë në interesin e klasës kapitaliste vendase dhe në interes të kapitalistëve të huaj që kanë investuar miliarda në këtë ekonomi të çoroditur? Dhe këtë realitet e njeh Titoja, sepse thotë që «ne nuk pretendojmë se çdo gjë në sistemin tonë funksionon në rregull, ose se të gjitha çështjet e paraqitura në kushtetutë janë zgjidhur praktikisht».

Ka akoma vështirësi, thekson pastaj Titoja, lidhur me bazën materiale të shoqërisë.

Jo ka akoma, por ka shumë. E tërë shoqëria jugosllave është e kalbur dhe Jugosllavia titiste është shndërruar në një shesh shfrytëzimi, grabitjeje dhe mjerimi për popujt që jetojnë në këtë vend. Vetadministrimi nuk ka sjellë asnjë zhvillim ekonomik dhe shoqëror në Jugosllavi. Atje janë ngritur ndërmarrje e prodhohen mallra, por të tëra këto, sikundër edhe në vendet kapitaliste, siç e vura në dukje dhe më lart, nuk shkojnë në interes të masave punonjëse, por të kapitalistëve.

Por me Jugosllavinë ku sundojnë revizionistët titistë ngjet edhe një gjë tjetër: dominojnë dumpingu dhe tregjet ndërkombëtare kapitaliste, që nuk e lejojnë këtë vend të eksportojë mallrat që prodhon pikërisht në këto ndërmarrje të përbashkëta me kapitalin e huaj,

Për këtë arsye tregtia jugosllave ka një disbalancë të jashtëzakonshme, me rreth afro 3 miliardë dollarë, në mos më shumë, sepse kapitalistët kurdoherë i fshehin si të ardhurat e tyre, ashtu edhe disfatat që pësojnë. Edhe një vend i krimbur si Jugosllavia në mënyrë të veçantë, që rrezikohet të rrëzohet si një kala prej karte, përpiqet ta fshehë kalbëzimin e saj.

Përparim ekonomik nuk duket në Jugosllavi; vetadministrimi nuk ka sjellë asgjë në këtë drejtim, asnjëfarë demokracie në vend dhe asnjë zgjidhje të problemeve të ndryshme të klasave që janë krijuar në shoqërinë jugosllave, të cilat janë në antagonizëm njëra me tjetrën.

I tillë është vetadministrimi jugosllav, e tillë është Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, i tillë është rendi ekonomik jugosllav, që kanë krijuar socializmi vetadministrues dhe gjoja politika e paangazhuar e Jugosllavisë. I gjithë ky mjerim, që ka mbuluar Jugosllavinë, fshihet nën këto parulla e teori. Për të gjithë njerëzit me mend në kokë, që dinë të analizojnë ngjarjet, faktet, që dinë t'i konfrontojnë ato, është e qartë se sistemi socialist vetadministrues është një formë rudimentare e një kapitalizmi kaotik anarkik, që ka siguruar pasurimin e një klase dhe u garanton të ardhura të mëdha investitorëve kapitalistë të huaj.

Sistemi socialist vetadministrues jugosllav i shërben kapitalizmit botëror, veçanërisht atij amerikan dhe kinez, që të mashtrojë popujt, t'i tërheqë këta nga rruga e socializmit dhe e revolucionit dhe t'u japë iluzionin ose t'u krijojë atë fokus që lëvizjet dhe përpjekjet e tyre për çlirim, për demokracinë e vërtetë dhe për vetëvendosje, t'i kanalizojnë në rrugën jugosllave. Prandaj kapitalizmi botëror investon në Jugosllavi dhe këtë e bën për dy arsye: Së pari, për shfrytëzimin e pasurive të Jugosllavisë dhe të krahut të lirë të punës të jugosllavëve dhe, së dyti, për të mbajtur gjallë një sistem

të tillë pseudosocialist që t'u shërbejë atij, pra kapitalizmit botëror dhe revizionizmit modern si zjarrfikës i revolucionit në të gjitha vendet ku këta kanë hedhur kthetrat e tyre.

Ky vetadministrim, kjo shoqëri vetadministruese, ka krijuar një papunësi të madhe në Jugosllavi dhe ka bërë që me qindra mijë, bile edhe miliona njerëz, të emigrojnë si në kohët e para në vende të tjera kapitaliste, ku bëjnë punë të rëndomta për të fituar bukën e gojës. Ata janë të detyruar të emigrojnë, sepse në këtë vend, të ashtuquajtur socialist, nuk kanë punë, «as punë krahu, as punë truri», pse, në qoftë se ekzistojnë në Jugosllavi vlera që krijohen si rezultat i punës mendore, këto blihen nga kapitalistët e jashtëm, ashtu siç blihet edhe forca e krahut. Forca e krahut të punës në Jugosllavi emigron jashtë dhe shpërblehet fare pak. Po edhe brenda në vend ajo shfrytëzohet me mëditje, me të ardhura të pakta dhe rron si mos më keq, duke qenë kurdoherë nën thikën e ngritjes së çmimeve, të uljes së nivelit të jetesës.

Për sa u përket njeriut dhe shoqërisë në Jugosllavi socializmi vetadministrues u ka sjellë këtyre degjenerimin, imoralitetin. Jeta perëndimore e shthurur, drogat dhe shtëpitë publike janë përhapur kudo. Vetë Titoja pohoi në raportin që i paraqiti Kongresit të 11-të se Jugosllavia është një shtet me kufij të hapur, kush dëshiron mund të hyjë atje, ashtu siç mund të dalë kur të dojë, kushdo është i lirë të bëjë kontrabandë nga jashtë ose nga brenda.

Atëherë mund të kuptohet fare lehtë se çfarë politikë moralizuese bëjnë kjo farë Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë dhe ky Front Politik Jugosllav. Asgjë të mirë nuk sjell kjo politikë, përkundrazi shtyn më tej njerëzit dhe shoqërinë jugosllave që po shkon drejt greminës. Në qoftë se në Jugosllavi ekziston një fond i

ndershëm, atë do ta gjejmë te shqiptarët, deri diku te malazezët dhe në disa vise të Serbisë, sidomos në malësi, kurse në qytete shoqëria është krejt e degjeneruar; shkollat janë kthyer në qendra degjenerimi; klubet e natës, sallat e vallëzimit janë bërë qendra drogash, ku «edukohet» lumpenproletariati dhe ku përpunohet degjenerimi i qytetarëve.

Kjo është e gjithë shoqëria vetadministruese socialiste e Jugosllavisë.

Pavarësisht se ne jemi kundërshtarë të rreptë të revizionizmit titist, të regjimit të tij kapitalist, raportin e Titos unë e lexova me vëmendje dhe përshtypja ime reale është se ky raport është si një kofin me plehra. Plehrat janë ato fraza të përgjithshme, fraza gjoja moralizuese, fraza që u përngjasin kryekëput gënjeshtrave të atyre diplomatëve kapitalistë borgjezë që, për të të futur në thes, të thonë fjalë të mira, të cilave vetë nuk u besojnë kurrë dhe që kanë për qëllim të të vënë në gjumë. Kështu është edhe ky raport, një raport frazash, pa brendi, pa moral, pa teori, apostafat i ndërtuar në një mënyrë të atillë për të gënjyer, por se sa do ta gënjejë popullin jugosllav edhe ky është një problem që shtrohet.

Populli jugosllav nuk është një popull budalla, që mund të hajë çfarëdo bari që i servir Titoja. Ai është një popull i zgjuar dhe që ka luftuar. Në qoftë se aprovon me kokë çka thotë ky kasnec i imperializmit amerikan, aprovimi është një blof, se populli jugosllav, në përgjithësi, e shikon realitetin e hidhur që ka sjellë ky regjim në vendin e tij dhe kjo e bën atë të mendojë për të ardhmen. Jo vetëm popullin jugosllav e shqetëson e ardhmja, por edhe kapitalistët që kanë investuar në Jugosllavi dhe ata nuk e kanë keq kur mendojnë se ç'do të bëhet pas Titos.

Realiteti i sotëm të bën të mendosh se pas vdekjes

së Titos në Jugosllavi do të ngjasin ndryshime, se duhet thënë që në mashtrime Titoja ka pasur autoritet dhe mashtrimet e tij kanë zënë vend, për arsye të grushtit të fortë që rëndonte mbi popujt në Jugosllavi. Ky grusht do të ekzistojë edhe në të ardhmen por, me vdekjen e Titos, acarimet midis shovinistëve serbë, kroatë dhe kontradiktat midis republikave të ndryshme do të thellohen më shumë dhe, qoftë «informbyroistët», siç i quan Titoja kundërshtarët e tij prosovjetikë, qoftë rrymat e tjera me tendenca ruse, bullgare, apo properëndimore, amerikane, franceze etj., etj., do të dalin më në pah, do të shfaqen, do të përplasen me njëri-tjetrin dhe nuk do të ekzistojë më ai autoritet pseudomoral që kishte Titoja për t'i qetësuar disi ato. Është fakt që Titoja, përveç mashtrimeve që përdorte, diti ta ngrejë personin e tij në një nivel të lartë dhe ta personifikojë këtë me «strategun e shquar që krijoi Jugosllavinë e re socialiste vetadministruese», pavarësisht se ky simbol e ky autoritet është i kalbur, i degjeneruar. Fakt është gjithashtu që ky autoritet, i ndihmuar nga klikat e brendshme, por edhe nga kapitalizmi i huaj, të cilit i ka shërbyer dhe i shërben, e krijoi këtë kult të Titos. Prandaj sa është gjallë Titoja, Jugosllavia disi po mbahet në këmbë, disi frenohen kontradiktat atje. A do të mundin Dolanci, Kardeli, Lubiçiçi të bëjnë presione ose të dominojnë mbi rrymat e kundërta që janë gjallë e të forta në Jugosllavi? Kjo do të duket më vonë, pas vdekjes së Titos, pse edhe aktualisht tendenca, rryma e presione ekzistojnë dhe këtë e vërtetojnë raporti i kongresit, fjalimet që u mbajtën atje, si edhe masat e tjera që u morën para kongresit për të shuar këtë rezistencë që shfaqej, që zhvillohej në forma të ndryshme, bile nganjëherë edhe të acaruara. si për shembull, në Kroaci, në Serbi dhe në Kosovë.

Me pak fjalë, Titoja bëri testamentin e tij politik,

siç thonë agjencitë e lajmeve, por ky testament ishte testamenti i një politikani të falimentuar, testamenti i falimentimit të Jugosllavisë, i falimentimit të kapitalizmit në Jugosllavi, i degjenerimit dhe i shitjes së Jugosllavisë.

Në këto drejtime mund të afirmojmë pra se raporti i Titos në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë ishte me të vërtetë një testament i përshtatshëm për personin e tij revizionist, antimarksist, për këtë renegat të marksizëm-leninizmit.

POGRADEC, E DIEL
30 KORRIK 1978

KINEZËVE IU DHA PËRGJIGJJA QË MERITONIN

Sot i dërgova një letër Hysniut ku i shpreha gëzimin tim të madh që u bë mirë. I shkrova me këtë rast edhe për Letrën e hapur që i dërguam KQ të PK të Kinës dhe qeverisë kineze për veprimin e tyre të pabesë e armiqësor kundrejt vendit tonë[1].

1 Letra është botuar në «Zërin e popullit» në datën 4 dhjetor 1980.

E MARTË
29 GUSHT 1978

TREKËNDËSHI I SUPERFUQIVE

Çështja e Kinës do të na preokupojë vazhdimisht, pse ajo me politikën e saj po kërcënon botën me një luftë të re botërore grabitqare, imperialiste. Kina ka hyrë me të dyja këmbët në këtë rrugë armiqësore kundër popujve dhe, pa i fshehur as edhe një grimë dhe në asnjë mënyrë synimet e saj, po ndërmerr të gjitha masat që të krijojë trekëndëshin e superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe vetë Kinës, dhe kështu të sundojnë mbi shtetet dhe mbi popujt, të shtypin çdo revolucion e çdo luftë nacionalçlirimtare të popujve dhe të dominojnë botën nga çdo pikëpamje. Ky është qëllimi i Kinës, të cilin udhëheqja e saj, që nga Mao Ce Duni dhe deri te Hua Kuo Feni e Ten Hsiao Pini, e ka shprehur haptazi. **Mao Ce Duni ka thënë që kinezët duhet të sundojnë botën.**

Kjo pikëpamje tash është e qartë. Në politikën e Kinës sot po vihet në zbatim kursi i shtetit të madh, i fuqisë së madhe, i hegjemonisë botërore, në atë rrugë, me atë politikë dhe me ato masa që mund t'i arrihet këtij objektivi, domethënë, duke luftuar kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit dhe duke eliminuar një nga superfuqitë.

Dy superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, natyrisht, nuk e duan ngjitjen e Kinës në një shkallë me to, por kjo nuk do të thotë

që njëra nga këto superfuqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kapitali botëror, të mos bëjnë me të punën e vet. Këta e financojnë Kinën që të realizojë planet e saj për t'u bërë një fuqi kapitaliste, një bastion kapitalist kundër revolucionit proletar dhe luftërave nacionalçlirimtare. Një gjë e tillë do të nxitë edhe kontradiktat që kanë filluar e do të shtohen më shumë në të ardhmen midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, për arsye se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndihmojnë njëkohësisht si Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe Kinën. **Kjo do të thotë se imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror e dozojnë ndihmën e tyre ndaj dy superfuqive të tjera.** Për ta socialimperializmi sovjetik është një fuqi e madhe imperialiste me një industri dhe me një ushtri të fuqishme dhe të modernizuar, kurse Kina, aktualisht, ka potencial vetëm nga popullata, se nga pikëpamja ekonomike e ushtarake ajo është shumë prapa. Dhe këto fuqi imperialiste, domethënë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, që ndihmojnë Kinën, e dinë fare mirë se programi i caktuar nga Kina, që brenda këtij shekulli të bëhet një superfuqi, nuk do të realizohet për shkak të prapambetjes së saj të madhe.

Kina, natyrisht, do të fuqizohet, por jo në atë shkallë që mendon dhe aspiron ajo. Edhe fuqitë e tjera kapitaliste do të fuqizohen gjatë kësaj kohe, kuptohet në qoftë se të dyja palëve politika u ecën si thika në gjalpë. Shkenca marksiste-leniniste, dialektika dhe zhvillimi materialist historik i shoqërisë na mësojnë se situatat nuk zhvillohen sipas dëshirës së imperializmit, që është faza e fundit e kapitalizmit. **S'ka dyshim që një gjë e tillë do të krijojë kontradikta të thella midis vetë superfuqive dhe midis tyre dhe shteteve e popujve të tjerë, që shfrytëzohen nga këto superfuqi.**

Prandaj politika e këtyre tri superfuqive përbën aktualisht një rrezik të madh për botën, pse që të tria

këto përpiqen të dominojnë mbi njëra-tjetrën, kuptohet, në kurriz të shteteve më të dobëta kapitaliste dhe gjithë popujve të botës në përgjithësi.

Kina haptazi ndërmerr aksione fillestare me karakter të gjerë me dy qëllime:

Së pari, që të sigurojë kredi, të marrë teknologji moderne nga kush të mundë dhe të sigurojë zhvillimin e kulturës e të arsimit për përdorimin e një teknologjie të këtillë.

Së dyti, të bëjë një propagandë në favor të vet, të aleatëve amerikanë dhe të borgjezisë kapitaliste botërore, të japë në këtë fushë ndihmë efektive pro tyre dhe kundër Bashkimit Sovjetik. Prandaj shohim që Kina po dërgon nga të katër anët emisarët e saj për këto dy qëllime. Vetë Hua Kuo Feni ka dalë me dhisk për ndihma ekonomike dhe për propagandë prokineze e proamerikane.

Në Evropë, pa neglizhuar kontinentet e tjera, shohim që Kina ka vënë të gjitha forcat e saj për të mbështetur ato aglomeracione politiko-ushtarake-ekonomike që mendon se ekzistojnë, i ndihmon që të konsolidohen dhe të mbrohen nga propaganda subversive e sovjetikëve. Këtë propagandë subversive ajo e quan paraprijëse të një lufte të re botërore që Bashkimi Sovjetik do t'i deklarojë Evropës. Por Kina me pseudoideologjinë e saj përpiqet të mbytë çdo tentativë revolte dhe revolucioni të proletariatit kundër fuqive kapitaliste ose revizioniste në Evropë. Prandaj ne shohim që Kina të mbështetë në Evropë, haptazi, Tregun e Përbashkët Evropian, që është gati një superfuqi ekonomike dhe ushtarake. Nga ky aglomerim ajo kërkon kredi, teknologji dhe njëkohësisht bën propagandë, duke i këshilluar shtetet kapitaliste, antisovjetike të regjura, që jo vetëm të kenë mendjen nga rreziku sovjetik, por të armatosen e të jenë gati për të sulmuar.

Kina mbështetet më shumë te Republika Federale Gjermane, sepse njeh potencialin e saj ekonomik e ushtarak dhe epërsinë e saj në Tregun e Përbashkët Evropian. Ajo mbështetet, gjithashtu, tek Anglia, më rrallë te Franca dhe përpiqet të futë këmbët në Ballkan. Për t'ia arritur këtij qëllimi, Kina, meqenëse nuk mundi ta thyente Shqipërinë socialiste ose ta bënte këtë revizioniste si veten, dhe meqë Partia jonë e demaskoi ideologjinë e saj kapitaliste, atëherë pothuajse i preu të gjitha marrëdhëniet me ne. Edhe marrëdhëniet diplomatike qëndrojnë në një fije peri, asnjë veprim nuk zhvillohet, veçse ne kemi ambasadën tonë në Pekin dhe ata kanë të tyren në Tiranë.

Në këtë situatë Kinës në Ballkan, hëpërhë, i duhej të zhvillonte aktivitetin e vet në drejtim të Jugosllavisë dhe të Rumanisë. Këto dy shtete janë revizioniste dhe puqen plotësisht me pikëpamjet ideologjike të saj. Por edhe për sa u përket qëndrimeve politike, Jugosllavia e Titos dhe Rumania e Çausheskut puqen me politikën kineze. Domethënë të dyja këto shtete, Jugosllavia dhe Rumania, kjo e fundit në pozita më të vështira se Jugosllavia, në thelb kanë qenë e janë antisovjetike, janë për një politikë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me kapitalizmin botëror. E tërë politika e tyre, veçanërisht e Titos, është një politikë në mbështetje të këtij kapitalizmi. Por në këtë rajon, natyrisht, nuk ekzistojnë vetëm Jugosllavia dhe Rumania, por edhe Shqipëria, Bullgaria, Greqia dhe Turqia.

Kinës, që të krijojë rrethin ose «kordonin sanitar» kundër Bashkimit Sovjetik, i duhet të ushtrojë ndikimin e saj edhe në shtetet e tjera të Ballkanit. Me Shqipërinë ajo i lau duart përfundimisht, në të gjitha drejtimet. Mbetet Greqia, por kjo nuk ka interesa të mëdha që të lidhet aq shumë dhe verbërisht me Kinën. Greqisë do t'i interesonte të bënte tregti me Kinën dhe do të bëjë

tregti me të, por pa u influencuar në asnjë mënyrë nga planet hegjemoniste të kinezëve. Ne shohim se Greqia simpatizon NATO-n dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglinë dhe Francën, por, edhe në këtë të ashtuquajtur miqësi me këto shtete, konstatojmë se nuk mungojnë divergjencat, nuk mungojnë lëkundjet.

Për sa i përket Turqisë, kjo është shumë larg Kinës dhe tradicionalisht në çdo pikëpamje është e lidhur ngushtë me imperializmin amerikan. Është e vërtetë se socialimperializmi sovjetik është rreziku i Turqisë, por s'është Kina ajo që do t'i vijë në ndihmë asaj, në rast të ndonjë lufte, ose të ndonjë sulmi sovjetik.

Për këto arsye Titoja ka qenë shumë i matur në bashkëbisedimet me Hua Kuo Fenin. Pavarësisht se është një antisovjetik, që në fillim të vizitës Titoja i vuri pikat mbi «i» në bisedimet me Hua Kuo Fenin në Jugosllavi. Titoja do të bëjë një politikë të balancës, ai nuk do që miqësia me Kinën të jetë shkak për prishjen ose keqësimin e marrëdhënieve me fqinjët e me shtetet e tjera. Me fjalë të tjera, Titoja i tregoi Hua Kuo Fenit se nuk mund të futet në aventurën antisovjetike në ato forma e në ato rrugë që do Kina, pra nuk mund të futet në armiqësi të hapët me Bashkimin Sovjetik, se në armiqësi është me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Po ashtu edhe nxitja kundër Bullgarisë do të bëhet sipas interesave të çastit dhe të diktatit që Bashkimi Sovjetik do të ushtrojë mbi Bullgarinë.

Kurse udhëheqja rumune, natyrisht, si agjenturë e sovjetikëve që është, ka në gjirin e vet forca që e duan lidhjen me Kinën, vetëm e vetëm për t'u shkëputur nga Bashkimi Sovjetik, megjithëse e dinë që ajo nuk mund të ndikojë në këtë drejtim; ka edhe të tjerë që janë proamerikanë, por ka edhe prosovjetikë. Sidoqoftë, udhë-

heqja aktuale e partisë dhe e shtetit në Rumani është në mëshirën e sovjetikëve.

Pra, mund të themi se Hua Kuo Feni, gjatë vizitës në Ballkan pati sukses vetëm në paradat që iu bënë në Rumani, por ca më shumë në Jugosllavi, duke e kaluar në mes të popullit, i cili tundte flamurë. Ndërsa, për sa u përket pikëpamjeve politike të tij, nuk mund të themi që pati sukses, veçse duhet vënë në dukje se Titos ai i thuri lavde, e bëri hero, shkurt e ngriti në qiell. **Huaja foli, gjithashtu, për miqësinë me titizmin dhe nuk harroi t'i kërkonte ndjesë Titos për sulmet që Kina dhe Mao Ce Duni u kanë bërë atij dhe titizmit. Ai ngriti lart vetadministrimin jugosllav dhe, sigurisht, përveç kredive që duhet t'i ketë dhënë, i siguroi Jugosllavisë titiste tregje në Kinë.** Dhe për të gjitha këto Titoja dhe banda e tij nuk munguan ta nxirrnin këtë marionetë kineze me automobila e me motoçikleta në mes popullit të Beogradit, Shkupit, Zagrebit e Brionit, t'i thoshin fjalë të mira, të propagandonin me forcë vetadministrimin jugosllav dhe, në mënyrë të veçantë, çështjen e partisë.

Jugosllavia është një «shembull i madh» për Kinën për sa i përket çështjes se si duhet likuiduar partia, ajo parti që s'ka qenë kurrë marksiste, por që duhet, qoftë edhe në formë e në emër, në mënyrë të falsifikuar, të duket se është një parti e proletariatit, domethënë një parti marksiste-leniniste. Hua Kuo Feni në Jugosllavi nuk e zuri në gojë fare marksizëm-leninizmin dhe këtë nuk e bëri pa qëllim. Ai i është adaptuar që përpara formulës revizioniste të titistëve dhe të eurokomunistëve. Pra, Lenini dhe Stalini nuk mund të kenë vend në ideologjinë kapitaliste kineze. Por edhe Karl Marksi do të qëndrojë vetëm si emër, ai do të zhduket nga ideologjia e tyre.

Ne do të shikojmë çfarë rruge do të marrë Kina,

por jemi të sigurt se atje do të vendoset kapitalizmi. **Prandaj klikës aktuale kineze, që të fuqizojë vijën e saj kapitalisto-imperialiste, që të thithë dhe të përfitojë nga teknologjia e re, nga kreditë e shumta që po merr, i duhet të gjejë format e përshtatshme ekonomike strukturore dhe superstrukturore për të krijuar një sistem të ri kapitalist.**

Natyrisht, në krijimin e këtij sistemi të ri kapitalist, do të mbahet parasysh madhësia e territorit kinez. Edhe në ndarjen administrative Kina do të ketë parasysh eksperiencën e vet, eksperiencë që nuk ka qenë socialiste, por kapitaliste me forma socialiste. Ajo do të bëjë një shartim të kësaj eksperience me vetadministrimin jugosllav, kuptohet, deri në njëfarë shkalle, për arsye se vetadministrimi jugosllav nuk mund t'u përshtatet si duhet territorit të gjerë dhe popullsisë së madhe kineze. Pastaj, ndryshe është situata në Jugosllavi, ndryshe është në Kinë. Megjithatë, ne do të shohim se si do të ecë ky proces në Kinë se përveç vetadministrimit jugosllav, për vendosjen e kapitalizmit, ajo, në radhë të parë do të marrë si model ndërtimin kapitalist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë. Këto dy shtete aktualisht janë aleate të Kinës dhe eksperiencat e tyre do të jenë pasqyra e ardhshme e ndërtimit të një strukture dhe superstrukture të re në Kinë.

Kapitalistët kinezë i kanë sytë te Japonia, sepse ata kanë parë që ajo, e djegur dhe e shkatërruar nga Lufta e Dytë Botërore, mundi në një kohë relativisht të shkurtër, me ndihmën e imperializmit amerikan, të bëhet një fuqi e madhe botërore. Atëherë këta kapitalistë kinezë thonë: Pse të mos shohim si e kanë ngritur japonezët fuqinë e tyre kapitaliste, imperialiste e militariste? Ashtu siç e kanë ndërtuar ata, po ashtu ta ndërtojmë edhe ne.

Pra në Kinë, mendoj unë, do të krijohen shoqëri e truste të mëdha kapitaliste si në Japoni, të cilat do të likuidojnë industrinë e vogël, duke krijuar në këtë mënyrë kuadrot dhe klasën që do t'i drejtojnë këto shoqëri të mëdha në bashkëpunim me shoqëritë e tjera shumëkombëshe dhe veçanërisht me shoqëritë japoneze, amerikane dhe me ato të Gjermanisë Perëndimore.

Traktati kino-japonez, siç e kam thënë dhe herë të tjera, është një traktat që kërcënon botën me një luftë të re dhe është e qartë se ai u bë nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky traktat është në favorin e kapitalizmit në botë, veçanërisht në favor të kapitalizmit kino-japonez.

Natyrisht, Kina kërkon që, tok me Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ruajë të paktën statukuonë në Lindjen e Largme, në Azinë Juglindore, në Indi dhe në Gjirin Persik, në mos e shtriftë dominimin e saj në gjithë këtë pellg. Vajtjet e ardhjet e kinezëve në Filipine, në Pakistan, Afganistan dhe tash së fundi në Iran, si dhe buzëqeshjet ndaj Indisë, tregojnë qartë synimet e tyre ekspansioniste.

Me Vietnamin udhëheqësit revizionistë kinezë kanë hyrë në një grindje të thellë dhe shkaktarë për këtë janë vetë, sepse edhe herë të tjera kanë shkaktuar grindje. Ndërkaq ata përpiqen që Korenë dhe Kim Ir Senin, t'i kenë në anën e tyre, natyrisht derisa ky të mos luajë përsëri kartën e sovjetikëve. Është e qartë se, kur Kim Ir Seni të shikojë se i ka ardhur fundi, dhe kinezët nuk janë më në gjendje ta financojnë, me siguri do të luajë kartën tjetër. Por revizionistët kinezë, duke u afruar me Korenë, duke u përpjekur që ta kenë atë nën influencën e tyre, përpiqen njëkohësisht që Koreja e Jugut të qëndrojë nën influencën amerikane. Ata veprojnë ashtu siç kanë vepruar deri tash edhe për Tajvanin, problemi i të cilit nuk hidhet më në tryezë si më parë. Përkundrazi, udhëheqësit kinezë dalin

kundër bashkimit të Tajvanit me Kinën. Dhe, pas ca kohësh, kur Kina të zërë pak a shumë ato pozita që synon, ajo do ta konsiderojë Tajvanin si një provincë autonome të saj. Me fjalë të tjera, me këtë Kina do t'i tregojë botës se çështja e Tajvanit u zgjidh me sukses të madh në mënyrë paqësore!

Kina, siç thashë më lart, ka synime edhe në Gjirin Persik. Për këtë flet fakti që sot, më 29 gusht, Hua Kuo Feni vete t'i bëjë vizitë shahut të Iranit, këtij monarku barbar mesjetar. Ai ia bën këtë vizitë shahut në një kohë kur në të gjitha qytetet e Iranit po zhvillohen demonstrata e po vriten me qindra njerëz të popullit, në një kohë kur fshatarësia iraniane vuan në tmerrin e urisë dhe të sëmundjeve të panumërta, kurse reaksionarët majmen me fitimet e mëdha që u vijnë nga nafta. Pra, kreu i udhëheqjes kineze vete në Iran pikërisht në këto kohë, dhe kur qeveria e shahut, për arsye të revoltave popullore ra dhe u krijua një qeveri e re, e cila pardje bëri betimin. Unë pashë në televizor ceremoninë e betimit të qeverisë së Iranit, gjithçka bëhej tamam si në mesjetë. Kryeministri dhe të gjithë ministrat me radhë bënë betimin përpara shahut të Iranit dhe i puthën dorën. Në këto momente, në këto situata, Hua Kuo Feni kinez shkon në Iran të puthet, të bisedojë miqësisht me shahun e Iranit dhe ta ndihmojë atë në luftën kundër lëvizjes kryengritëse të popullit iranian. Kjo është e qartë. Politika kineze është një politikë fashiste, një politikë kundërrevolucionare, e ujdisur me imperializmin amerikan kundër çdo lufte nacionalçlirimtare të popujve.

Natyrisht, vajtja e Hua Kuo Fenit në Iran do ta diskreditojë akoma më shumë Kinën. Ne ia çorëm maskën këtij regjimi antimarksist, kapitalist dhe socialimperialist. Por udhëheqja kineze ka arritur në atë shkallë saqë nuk i bëhet vonë në quhet apo nuk quhet më

socialiste Kina. Ajo nuk e peshon fare opinionin e popujve, për arsye se qëllimet e saj janë antipopullore. Kina synon të dominojë mbi ta. Këtë dominim ajo përpiqet ta arrijë sidomos në vendet afrikane, që janë, si të thuash, akoma të prapambetura ekonomikisht, të shfrytëzuara e të shtypura në kulm nga kapitalizmi amerikan dhe perandoritë e vjetra, të cilat kanë ruajtur në këto vende privilegjet, bankat, komptuaret, trustet, koncernet e tyre dhe shfrytëzimin. Pikërisht në kontinentin afrikan Kina shpreson të infiltrohet si gjarpri, me lëkurë të verdhë, për t'i bindur njerëzit me ngjyrë të zezë në drejtësinë e vijës së saj pseudosocialiste, duke pretenduar se tok me ta bëhet një barazh i fortë kundër socialimperializmit sovjetik dhe njëkohësisht edhe fuqive të tjera imperialiste. Ajo përpiqet t'u lërë të kuptojnë atyre se ndihma e saj është një ndihmë çlirimtare për ta.

Në përgjithësi kjo është strategjia e Kinës dhe e Hua Kuo Fenit, që po bredh e do të bredhë në të ardhmen në shumë vende të tjera të botës. Një gjë do të fitojë Hua Kuo Feni me këto vizita jashtë Kinës: reklamën që do t'i bëjë vetes brenda në vend, nëpërmjet dokumentarëve e telekronikave që do të shfaqen, për t'u treguar masave të gjera të popullit kinez se te ky ato kanë një «president të madh», që e zëvendësoi aq mirë Mao Ce Dunin, bile po e errëson pothuajse krejt figurën e Maos. Këtë gjë, do t'i thotë popullit Hua Kuo Feni, shiheni me sytë tuaj, këtë e vërtetojnë udhëtimet e mia «triumfale» në Bukuresht, në Beograd, në Teheran, e më vonë në Bon, në Londër e në vende të tjera.

Kjo, natyrisht, i shërben politikës së gënjeshtërt të udhëheqjes kineze, por jo për shumë kohë se fraksioni i Ten Hsiao Pinit, i cili rri në rojë dhe me siguri ka kontradikta me grupin e Hua Kuo Fenit, nuk do ta pëlqejë këtë tamtam e reklamë që po i bëhet kryetarit të padëshiruar. Prandaj vizitat pompoze, por pa rezul-

tate, pra, jo siç i do udhëheqja kineze, do të kenë edhe pluset, edhe minuset e tyre brenda në Kinë. Këto do të bëjnë që kontradiktat të thellohen dhe qëllimet e ndërtimit me aq shpejtësi e me aq siguri të kapitalizmit atje të hasin në vështirësi të panumërta. Megjithatë koha do t'i vërtetojë pikëpamjet tona.

Për sa i përket vizitës së tij në Jugosllavi e në Rumani, ne do të jemi vigjilentë, sepse Huaja, Titoja dhe Çaushesku kanë biseduar hollësisht kundër vendit tonë, kanë biseduar se si t'i dëmtojnë, t'i dobësojnë dhe t'i likuidojnë pushtetin e demokracisë së vërtetë proletare, Partinë marksiste-leniniste të Punës dhe socializmin në Shqipëri. Por ata do të na marrin të keqen, sepse ne do ta forcojmë situatën, brenda dhe jashtë, do ta ndërtojmë socializmin me forcat tona dhe do t'u tregojmë miqve dhe gjithë botës se socializmi është i pavdekshëm, se një popull i vogël, që u qëndron besnik parimeve themelore të doktrinës së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, bëhet shembull i një force të madhe.

Sot, kur avioni po transportonte Hua Kuo Fenin për në Teheran te shahinshahu i Iranit, nga Teherani nisej për në Moskë një avion tjetër, që transportonte princeshën Ashraf, motrën dhe këshilltaren e shahut, mikeshën e Mao Ce Dunit, të Çu En Lait dhe të Ten Hsiao Pinit, mikeshën e ish-ambasadorit amerikan Henderson. Kështu që shahu i Iranit po merr masa që të mos zemërojë sovjetikët, që edhe me ta punët t'i shkojnë mirë.

Shahu është një personalitet që rron në sajë të fuqive të mëdha. Njihen historia e ndyrë e jetës së tij, shtypja dhe barbarizmat ndaj popullit në kohën e borgjezit demokrat Mosadek, që përkrahej nga partia Tudeh, kur shahu u detyrua të lërë fronin dhe të nisej me avion për në Romë. Por gjatë kësaj kohe CIA, sipas

atyre që kemi lexuar, pagoi lumpenin e Teheranit me nga një dollar për kokë, vuri në lëvizje tanket e komanduara nga gjenerali Zahedi, agjent i saj, i cili gjoja për të mposhtur kundërshtarët e Mosadekut, sulmoi pallatin «Gjylamen», ku ndodhej qeveria dhe e arrestoi Mosadekun. Kështu që ky u fut në burg. Hendersoni u kthye menjëherë në Teheran dhe i bëri telegram shahut që të kthehej nga Roma. Ky erdhi me avion dhe përdori forcën derisa kryengritja e popullit të Iranit u likuidua. Sigurisht, pas kësaj, pasuritë e naftës u ndanë ose u rindanë më mirë. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në sajë të Hendersonit dhe të ndërhyrjes në favor të shahut, morën pjesën e luanit, anglo-persianët mbajtën pjesën më të vogël, kurse thërrimet i mbetën shahut.

Pra, të tillë lojë luajnë në kurriz të popujve shahu dhe miqtë e tij, qofshin këta amerikanë, kinezë apo sovjetikë. Irani është bërë një qendër intrigash dhe shahu e ndien të ftohtit e veriut rus, se brenda ziejnë azerbajxhanasit, të cilët u ngritën kundër tij, saqë në një kohë kryeministrit, Xhafar Sharif Emamit, iu desh të merrte masa drakoniane kundër tyre. Ky nuk i shtypi dot azerbajxhanasit e nxitur nga sovjetikët, por këta u tërhoqën. Megjithatë nuk do të na çuditë fakti që Rusia të kthehet përsëri në Iran, nga jashtë ose nga brenda, por më tepër mundësi ka nga brenda.

Këto ditët e fundit, pas formimit të qeverisë së re, kur gjithë anëtarët e kabinetit i puthën dorën me radhë shahut, ky u bë «reformator i madh demokrat» dhe lejoi krijimin e legalizimin e 16 partive. Të gjitha këto parti, me emra të ndryshëm, janë të djathta, besnike të reaksionit iranian. Mirëpo partinë Tudeh shahu nuk e lejoi të dilte nga ilegaliteti. Tudehu mbështetet nga sovjetikët dhe këta me siguri do të kenë protestuar për këtë «padrejtësi» të shahinshahut «demokrat». Nuk

është çudi që për këtë arsye vete princesha Ashraf në Kremlin, për t'u shpjeguar atyre përse nuk u rehabilitua partia Tudeh dhe për të marrë njëfarë sigurie prej tyre që këtë parti do ta legalizojnë, por me kusht që të mos ngrihet kundër shahinshahut.

Natyrisht, Kremlini do të bëjë sikur do ta pranojë një gjest të tillë mënjanimi të shahinshahut por ai nuk heq dorë nga ndërhyrja. Medoemos shahu, që mbështetet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Kina, por edhe nga gjithë imperialistët e tjerë që kanë fitime nga nafta e Iranit, do të qëndrojë vazhdimisht mbi gjemba dhe mbi zjarr të ndezur kundër tij nga sovjetikët, nga reaksioni i jashtëm, nga mbreti Saud.

Në këtë situatë marksistë-leninistët duhet të organizohen dhe të propagandojnë me forcë të madhe, në radhë të parë, luftën kundër shahinshahut, kundër borgjezisë anadollake, perandorake, mesjetare të tij, kundër socialimperializmit sovjetik, që kërkon të hedhë kthetrat në këtë vend, kundër imperializmit amerikan, kundër imperializmit anglez e socialimperializmit kinez që kanë filluar të depërtojnë në punët e Lindjes së Mesme në favor të imperializmit amerikan dhe në favorin e vet.

E ENJTE
31 GUSHT 1978

IDE TË TJERA PËR ARTIKULLIN MBI UDHËTIMIN E HUA KUO FENIT NË BALLKAN

Materialeve që i kam dhënë Ramizit për artikullin që duhet të bëjmë lidhur me vizitën e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi, u shtova edhe një sërë idesh të tjera me qëllim që ai të bëhet më i qartë dhe më aktual.

Ramizit i thashë së pari që në këtë artikull edhe një herë, natyrisht në mënyrë sintetike, duhet ta bëjmë të qartë ç'përfaqëson **teoria e «lëvizjes së paangazhuar» dhe ta demaskojmë atë,** pse parashikojmë që këtë problem Titoja do ta trajtojë me Hua Kuo Fenin bile do t'ia kundërvërë, pa e zënë fare në gojë, teorisë së «tri botëve» të Kinës. Nga ana e tyre kinezët, si marifetçinj e hipokritë që janë e të përulur përpara këtij miku që duan ta shfrytëzojnë, edhe pse e dinë që është dinak, do ta adoptojnë teorinë e «lëvizjes së paangazhuar» titiste, do të bëjnë sikur edhe ata po e mbështetin këtë teori dhe në fakt e mbështetin, pse shikojnë që teoria e tyre e «tri botëve» nuk ka shumë sukses, aq sa nuk ka sukses edhe teoria e «lëvizjes së paangazhuar». Sidoqoftë kjo teori, pjellë e imperializmit amerikan dhe e agjenturës së tij, titizmit, ka pasur një jetë më të gjatë dhe zotërinjtë kinezë, pas vdekjes së Titos, shpresojnë të marrin drejtimin e kësaj lëvizjeje e të bëjnë qinosjen e plotë të «lëvizjes së paangazhuar» me «botën e tretë».

Natyrisht, për të arritur këtu, sipas rregullave që nuk kanë asnjë bazë por që ka vendosur «lëvizja e të paangazhuarve», më parë duhet të pranohesh në këtë «lëvizje», pra edhe Kina duhet të pranohet në të. Mirëpo do të jetë e zorshme që ajo të pranohet veçanërisht në mbledhjen e ardhshme që do të mbahet në Mukavata, pse atje as Kuba e Fidel Kastros, as Algjeria dhe as shumë të tjerë nuk do të lejojnë jo vetëm që Kina të pranohet në këtë lëvizje si anëtare me të drejta të plota, por besoj as si dëgjuese apo pjesëmarrëse nga jashtë, siç kanë pranuar Rumaninë. Sidoqoftë në këtë artikull ne **duhet ta përcaktojmë «mosangazhimin» jugosllav si një teori false.**

Së dyti, duhet të theksojmë se **politika e «valles në litar» e Titos nuk u ka sjellë dhe nuk do t'u sjellë asgjë të mirë popujve të Jugosllavisë dhe popujve të tjerë.** Kjo politikë e «valles në litar» e Titos është një politikë akrobatike, e përshtatshme për ideologjinë e tij revizionisto-oportuniste dhe për qëllimet specifike të tij, që ta ketë mirë me të gjithë, të marrë nga të gjithë kredi, që të mund të lajë gradualisht kreditë e mëdha. Me fjalë të tjera politika gjoja e madhe e këtij revizionisti të paskrupullt ka për qëllim vazhdimin e robërimit të popujve për interesat personale të klasës kapitaliste jugosllave që ka krijuar titizmi.

Së treti, në fjalimet që mbajti Hua Kuo Feni qoftë në Rumani, por sidomos në Jugosllavi, tha shumë herë se miqësia në mes Jugosllavisë dhe Kinës është jo vetëm e sinqertë (kuptohet false), por i ka rrënjët të thella. Se ku i ka këto rrënjë të thella kjo miqësi në mes Jugosllavisë dhe Kinës merret me mend. Por kjo është vetëm një slogan, pse në realitet rrënjë të thella ajo nuk ka dhe nuk mund të ketë. Një Kinë revizioniste nuk mund të jetë mike me shtete të tjera, për arsye se politika e saj antimarksiste ka për qëllim hegjemoninë

kineze në botë, nënshtrimin e popujve ndaj politikës së saj dhe diktimin e dëshirave të saj të tjerëve. Prandaj **kjo farë miqësie me rrënjë «kaq të thella» duhet përmendur diku sa për ta vënë në dukje, se në fakt ajo është një blof.**

E vërteta është se **ideologjikisht titizmi dhe maoce-dunideja janë në një rrugë.** Ato pajtohen me njëra-tjetrën. Mao Ce Duni ka qenë me kohë pro Titos, e ka mbrojtur titizmin edhe në kohën e Informbyrosë, kur ne dhe të gjitha partitë marksiste-leniniste të asaj kohe bëmë demaskimin e këtij revizionizmi dhe të kësaj agjenture të kapitalizmit botëror. Por Maoja dhe udhëheqja kineze, natyrisht që nga 1948 e tëhu, kanë lëvizur njëqind herë në qëndrimet e tyre dhe s'mund të bënin ndryshe, për arsye se janë partizanë të «njëqind shkollave e të njëqind luleve». Pra një nga «lulet e bukura» të kopshtit kinez ishte dhe titizmi, era «e kundërmuar» e qelbësirës titiste.

Së katërti, duhet shtuar, gjithashtu, se **kjo farë miqësie që po lidhet në mes Jugosllavisë dhe Kinës tjerr rreziqe për popujt jugosllavë dhe për popujt e tjerë të Ballkanit.** Ideja është kjo që Hua Kuo Feni vete në Jugosllavi për të nxitur armiqësinë e titistëve kundër socialimperializmit sovjetik, për të krijuar tok me Rumaninë një front kundër Bashkimit Sovjetik dhe mundësisht për ta provokuar këtë të fundit që të bëjë një ndërhyrje qoftë në Rumani, qoftë në Jugosllavi dhe të vërtetohen kështu tezat false dhe dinakëria kineze. Por dihet që antisovjetizmi i kinezëve nuk është për qëllime parimore, po për qëllime dominimi në botë, prandaj kinezët kërkojnë të krijojnë në Ballkan një zonë influence për pikëpamjet e tyre politike dhe hegjemoniste.

Së pesti, duhet theksuar se **«diplomacia» e presidentit Tito që pretendohet se e ka bërë Jugosllavinë**

një vend të pavarur, në fakt e ka bërë atë plotësisht të varur, e ka angazhuar me fuqi të tjera kapitaliste dhe imperialiste. Këtë rrugë do të ndjekë edhe Kina, pavarësisht se është një kontinent i tërë, një shtet i madh me 800 milionë njerëz. Madhësia e saj territoriale është çështje tjetër, ndërsa ideologjia, politika e diplomacia e kinezëve do të jenë të njëllojta si ato të titistëve dhe do të çojnë në një varësi relative të Kinës ndaj fuqive kapitaliste dhe imperialiste.

Së gjashti, duhet të theksohet se **«miqtë e zemrës» të titistëve i shohin dhe i peshojnë këto rreziqe që paraqet kjo politikë diplomatike e Jugosllavisë.** Megjithatë ata e nxitin dhe e lejojnë, duke menduar e duke shpresuar se aktualisht janë të plotfuqishëm dhe mund të kontrollojnë veprimtarinë e socialimperializmit sovjetik, duke krijuar një «kordon sanitar» ose duke lejuar kinezët të krijojnë zonat e tyre në Evropë, kuptohet, zona fiktive, por që mund ta trembin socialimperializmin sovjetik në veprimtarinë e tij ekspansioniste dhe kapitaliste. Këta «miq» të Titos sigurisht mendojnë se në të njëjtën kohë kontrollojnë edhe veprimet e kinezëve dhe rezultatet e mundshme të tyre. Mirëpo një mendjelehtësi e tillë nuk mund ta evitojë katastrofën që do të vijë, për arsye se do të shtohen kontradiktat në Evropë. Këtë e dëshiron dhe për këtë bën shumë përpjekje Kina. Këto përpjekje të saj mund të zënë vend vetëm duke hapur gjerësisht dyert e Kinës për kapitalizmin ndërkombëtar, domethënë për të lejuar kapitalistët evropianë, amerikanë e japonezë të investojnë dhe të nxjerrin të ardhura të majme në kurriz të popullit kinez. Është e kuptueshme që mbi këto të ardhura edhe kinezët do të vënë disa kushte, të kenë edhe ata fitime nga ana e tyre dhe, në rast se nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit, ata janë mësuar dhe atëherë do të bëjnë pirueta politike dhe kthesa 90 dhe 180 gradëshe.

Kapitalizmi botëror, veçanërisht kapitalizmi evropian, me prerjen e ndihmave të Kinës për Shqipërinë, dukeshin si mjaft të alarmuar për qëndrimin që do të mbanim ne. Ata kishin frikë se mos ne u ndernim dorën socialimperialistëve sovjetikë. Megjithatë ata e gjejnë të natyrshme që flota sovjetike e luftës të ankorohet në portet jugosllave. Natyrisht, ankorimi i anijeve luftarake sovjetike në portet jugosllave ndjell një rrezik të madh për të gjitha vendet bregdetare të Adriatikut e të Mesdheut, veçanërisht për vendin tonë. Këtë ne e kemi theksuar, kemi qenë dhe jemi kundër këtij veprimi dhe do ta ngremë zërin deri në kupë të qiellit. Imperialistët dhe kapitalistët evropianë të mos «bëhen» merak për bregdetin tonë. Ai është e do të jetë i paprekshëm. Ne nuk do të lejojmë kërkënd të vërë këmbë në këtë bregdet. **Kush do të orvatet të vërë këmbë në bregdetin tonë, duhet ta ketë të qartë se do të ketë luftë me popullin shqiptar, se lufta do të jetë në favorin tonë dhe disfata e pashmangshme i pret shkelësit e kufirit shqiptar.**

I thashë shokut Ramiz që këto mendime dhe materialet që i kam dhënë si bazë për këtë artikull, të përpunohen dhe t'i botojmë sa më parë, pse mendoj që është e domosdoshme ta sqarojmë opinionin botëror mbi rreziqet e kësaj hapjeje reaksionare dhe hegjemoniste të Kinës, që fsheh jo miqësi, por rreziqe lufte, intriga për dominim nga ana e saj dhe forcim të dominimit të kapitalizmit evropian dhe botëror mbi shtetet e Evropës.

Hapja e Kinës në çdo vend, veçanërisht në Evropë, ku ekziston një proletariat i madh me eksperiencë, ka për qëllim që ta neutralizojë këtë forcë të madhe varrmihëse të kapitalizmit botëror. Këtu qëndron krimi më i madh i revizionistëve kinezë, prandaj ata haptazi predikojnë nënshtrimin e proletariatit botëror dhe veça-

nërisht të atij evropian nën thundrën e kapitalizmit, të së ashtuquajturës botë të dytë. Për këtë e zhvillojnë ata hapjen, këtë politikë e diplomaci të tyre, dhe, nga ana tjetër, financojnë disa lëvere, disa parti pseudomarksiste, të cilat shpifin kundër Partisë sonë dhe bëjnë zhurmë pro Kinës. Por realiteti qëndron në atë që Kina në mos sot, nesër, do të lidhet me të gjitha partitë revizioniste të Evropës dhe të botës, me të gjitha ato parti revizioniste që do të preferojnë më mirë të jenë të lidhura me Kinën revizioniste, sesa me Bashkimin Sovjetik revizionist, për arsye se politika e kapitalizmit të shtetit të tyre ka interesa më shumë për investime dhe shfrytëzim në Kinë, sesa në Bashkimin Sovjetik.

Prandaj partitë revizioniste eurokomuniste, që kanë tendenca të theksuara të marrin pjesë në qeveritë borgjeze, do të ndjekin po këtë politikë të qeverive të tyre, domethënë dashamirëse ndaj Kinës revizioniste, e cila i hap tregje të mëdha fitimi kapitalit botëror. Partia Komuniste e Kinës, që është një parti revizioniste, nuk ka se si të mos puqet, të mos lidhet e të mos veprojë së toku me të gjitha partitë e tjera revizioniste, me përjashtim, hëpërhë, të Bashkimit Sovjetik. Ashtu siç po bën aktualisht me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, me Partinë Punëtore Rumune, ashtu do të bëjë Partia Komuniste e Kinës edhe me Partinë Komuniste revizioniste të Francës, të Italisë, të Spanjës etj.

Revizionizmi kinez do të përpiqet të çajë frontin e revizionizmit që është nën drejtimin sovjetik, aq sa është ky front nën drejtimin sovjetik, dhe të krijojë, me aq sa do të ketë mundësi, një front revizionist nën drejtimin e Partisë Komuniste (revizioniste) të Kinës. Natyrisht partia kineze shkop dirigjenti nuk mund të bëhet, por orvatje do të bëhen.

Ne duhet të luftojmë me të gjitha forcat tona të gjithë revizionistët modernë, në të gjitha format që këta paraqiten, në të gjithë veprimtarinë që zhvillojnë kundër teorisë sonë, kundër partive marksiste-leniniste dhe veçanërisht kundër Partisë së Punës të Shqipërisë.

E PREMTE
22 SHTATOR 1978

TRE BANDITË POLITIKË DHE PROBLEMET E LINDJES SË MESME

Më 18 shtator agjencia e lajmeve Associated Press dha nga Uashingtoni tekstin e marrëveshjes që u arrit në Kemp Dejvid në takimin midis Xhimi Karterit, Anuar el Sadatit dhe Mënaem Beginit. U mblodhën tre kusarë, tre banditë imperialistë, për të biseduar mbi problemin e Lindjes së Mesme, problem që është me rëndësi të madhe jetike për popujt arabë e që njëkohësisht i intereson shumë edhe imperializmit amerikan.

Imperializmi amerikan në Lindjen e Mesme i ka futur thonjtë thellë dhe bën një politikë përçarëse në mes popujve arabë, të cilët nuk e kanë gjetur dhe nuk po e gjejnë me njëri-tjetrin fjalën e përbashkët edhe në këto momente kaq të vështira për të gjithë komunitetin arab. Kjo ngjet për arsye se pushteti në vende të ndryshme të këtij rajoni ndodhet në duart e borgjezisë së madhe reaksionare, shtypëse, shfrytëzuese e antipopullore, antiarabe. Borgjezia, në të gjitha vendet e këtij rajoni vetëm emrin ka arabe, sepse kokë e këmbë është shitur te të huajt, tek imperialistët amerikanë, në radhë të parë, te sovjetikët, te francezët, tek anglezët dhe te të gjithë reaksionarët e botës. Prandaj reaksioni botëror bën çdo përpjekje që këtë rajon ta mbajë të përçarë dhe shtetet e ndryshme arabe të rrojnë vazhdimisht në kontradikta me njëri-tjetrin. Domethënë reaksioni botëror synon t'i mbajë këta popuj nën zgjedhë, në interes të dinastive që mbretërojnë në këto vende, në varfëri, në robëri, bile mesjetare dhe t'i detyrojë të shesin pasurinë e tyre të madhe, naftën, për të nxjerrë prej saj përfitime përrallore.

Në këto situata Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë xhandari dhe padroni kryesor, si me thënë, i këtij pellgu, ndjekin vazhdimisht politikën «përça e sundo». Ato vënë njërin shtet kundër tjetrit, grupojnë disa shtete kundër shteteve të tjera, nxitin e zhvillojnë luftëra lokale në mes Izraelit dhe Egjiptit, në mes Izraelit dhe Sirisë, në mes Sirisë e marionetave libaneze, në mes irakianëve e sirianëve, në mes Arabisë Saudite dhe Jemenit të Veriut e të Jugut, krijojnë mosmarrëveshje në Gjirin Persik e të tjera komplote të tilla djallëzore.

Veçanërisht Izraelin imperializmi amerikan e ka përdorur si xhandar të vërtetë në shërbim të tij. Ky xhandar ka arritur të shkaktojë deri luftëra të përgjakshme me udhëheqjet reaksionare të Egjiptit, të Sirisë, të Libanit, të Jordanisë etj. Në Lindjen e Mesme dy grupe reaksionare janë vënë kurdoherë kundër njëri-tjetrit dhe Izraeli është mbështetur fuqimisht nga imperializmi amerikan me armë nga më modernet, bile aq sa thuhet se ai ka edhe bombën atomike, por nuk e ka përdorur. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë ndihmuar Izraelin gjithashtu edhe nga ana logjistike, për arsye të peshës së madhe dominuese që kanë qarqet reaksionare financiare sioniste në ekonominë kapitalisto-imperialiste botërore. Pra imperializmi amerikan e ka bërë Izraelin veglën e tij më të përshtatshme. Në momentet kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës acarohen me vendet arabe për naftën, për çështjen e furnizimit e të çmimit të saj, nëpërmjet veglës së tyre, Izraelit, krijojnë, sikurse kanë krijuar, incidente të përgjakshme që kanë vajtur deri në luftë.

Kështu Izraeli ka fituar mbi egjipto-sirianët e jordanezët dhe ka pushtuar territore të tyre, si Sinain, Cisjordaninë, Golanin, rripin e Gazës dhe as lëviz më që andej.

Me gjithë rezolutat e panumërta që janë marrë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kundër veprimeve të Izraelit, megjithëse shtetet e botës e kanë ngritur me të madhe zërin kundër tij, Izraeli ka vazhduar veprimtarinë e vet agresive. Ai jo vetëm ka pushtuar territore arabe, por në to, duke pranuar çifutë emigrantë nga Polonia, nga Rumania, sidomos nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vende të tjera të Evropës, ka krijuar koloni çifute.

Më tepër nga të gjithë popujt arabë po vuan populli heroik palestinez, i cili ka dekada të tëra që mban mbi shpinë mjerimin më të madh që ka parë njerëzimi. Ai rron si muhaxhir, duke u strehuar nëpër kasolle dhe në tenda të shkretëtirës, sepse ka humbur atdheun e tij që ia kanë pushtuar izraelitët dhe s'ia lëshojnë. Prandaj populli palestinez është ngritur në luftë të pamëshirshme, deri tash pa kompromis. Pavarësisht se brenda në lëvizjen çlirimtare palestineze ka grupe me pikëpamje të ndryshme, në përgjithësi të gjithë dëshirojnë çlirimin e vendit të tyre nga fashistët sionistë izraelitë.

Ku nuk e gjen popullin palestinez që rron i shpërndarë në të tëra vendet arabe: në Liban ku ai është i vendosur në fshatra që janë qendra luftarake, në Egjipt ku ka jetuar si muhaxhir dhe si luftëtar, por është persekutuar nga Sadati, në Siri ku herë lejohet të luftojë, herë nuk lejohet, sipas politikës së qeverisë borgjeze siriane, ka jetuar e jeton edhe në Jordani, ku është shtypur barbarisht; në Irak, në Arabinë Saudite, në Jemen, në Gjirin Persik, bile edhe në Francë etj. Ai është një popull i hallakatur por trim, luftëtar, që s'e ka pushuar rezistencën e vet asnjë ditë. Kudo që është, në rajonin e Lindjes së Mesme, ai lufton në forma të organizuara

gueriljesh, kurse në vende të tjera të botës bën sabotazh kundër gjithçkaje izraelite, organizon atentate, të cilat bota kapitaliste i quan terrorizëm, sepse ajo kërkon qetësi, për të shfrytëzuar si duhet e sa i duhet pasurinë e këtyre vendeve që ka nën sundimin e vet.

Tash, në këto situata të vështira dhe pak a shumë paqësore, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijuan në mes Egjiptit dhe Izraelit, pas shumë diskutimesh, manovrash, prapaskenash e dredhish të panumërta, të tre këta kalanderë u mblodhën në Kemp Dejvid, gjoja për të rregulluar çështjen e Lindjes së Mesme. Ata diskutuan kokë më kokë trembëdhjetë ditë. Bile Xhimi Karteri u bë pjesëtar aktiv i këtyre bisedimeve, domethënë bisedimet nuk zhvilloheshin më midis Sadatit dhe Beginit, por midis Karterit, Sadatit dhe Beginit. Karteri u quajt kështu si një partner i tretë i këtyre bisedimeve për të vendosur gjoja paqen në Lindjen e Mesme. Natyrisht nga e gjithë kjo «punë» «mali polli një mi». Ky mi përfaqëson atë çka «fitoi» ose nuk fitoi populli palestinez dhe në përgjithësi popujt arabë. Në Kemp Dejvid, sipas komunikatës, imperializmi amerikan arriti «të përfundonte» njëfarë pajtimi në mes Izraelit të Beginit dhe Egjiptit të Sadatit për një paqe të përkohshme, për një rregullim të përkohshëm të zonës së Cisjordanisë, të rripit të Gazës dhe të shkretëtirës së Negevit.

Në të vërtetë asgjë konkrete nuk u arrit. Mund të themi se u përcaktua vetëm që brenda 5 vjetësh duhet të veprohet në atë mënyrë që pjesërisht Izraeli të tërhiqet nga bregu perëndimor i lumit Jordan (Cisjordania) dhe nga Gaza, me qëllim gjoja që aty të vendoset autonomia e banorëve palestinezë të këtyre zonave. Administrata palestineze autonome, natyrisht, do të garantohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kurdoherë e indirekt do të jetë nën sundimin ose vëzhgimin e Izraelit, të Egjiptit dhe të Jordanisë.

Egjiptit iu dhanë edhe disa satisfaksione të vogla. Kështu, për shembull, u bë fjalë për njëfarë tërheqjeje të Izraelit nga një pjesë e gadishullit të Sinait. E gjithë kjo është një manovër djallëzore e imperializmit amerikan dhe e dy agjentëve të tij, Sadatit dhe Beginit. Kjo është, si me thënë, një fitore e përkohshme për imperializmin amerikan, sepse, siç thashë më lart, është caktuar që brenda 5 vjetëve gjoja do të punohet për të arritur në një «vetëqeverisje» në bregun perëndimor të lumit Jordan dhe në rripin e Gazës. Kjo e ashtuquajtur vetëqeverisje gjatë kësaj kohe do të ketë njëfarë force policore të vetën në këto rajone, por në to kurdoherë do të jenë të pranishme forcat ushtarake e policore izraelite për të ruajtur kufijtë, si dhe forcat jordaneze. Kështu palestinezët, natyrisht, do të kenë vetëm hapësat e kashtës. Dhe në rast se arrihet një statukuo e tillë, siç u vendos në Kemp Dejvid, atëherë mund të nënshkruhet një marrëveshje paqeje midis Egjiptit dhe Izraelit. Gjithë synimi është që gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare imperializmi amerikan të ketë njëfarë qetësie për ta shtrydhur mirë «lopën» arabe, që nafta të rrjedhë me lehtësi në cisternat dhe në naftësjellësit amerikanë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të zhvillojnë një fushatë intrigash në të gjitha shtetet arabe për të pranuar vendimet e Kemp Dejvidit dhe për të arritur në një konkluzion të përbashkët rreth një paqeje gjoja të përgjithshme. Mirëpo populli palestinez me të drejtë asgjë nuk pranon në gjithë këtë dallavere të Sadatit, të Beginit dhe të Xhimi Karterit, sepse në fakt, nuk fiton asgjë. Atdheu i tij është i pushtuar, prandaj me të drejtë ai do të luftojë deri në fund për çlirimin e tokave të atdheut të vet dhe për vendosjen e një qeverie të vërtetë të popullit palestinez, pa ndërhyrje dhe pa tutelë të armiqve të tij të përhershëm.

Por është për t'u çuditur se me paturpësinë më të madhe në komunikatë thuhet se marrëveshja e arritur

bëhet edhe me pjesëmarrjen e Jordanisë, kurse kjo nuk ishte fare në Kemp Dejvid. Qeveria jordaneze e mbreti Husein, megjithëse dihet ç'janë, deklaruan se s'kanë asnjë angazhim për sa është vendosur në Kemp Dejvid.

Deklaratë bëri edhe mbreti Saud i Arabisë, i cili nuk e pranon marrëveshjen e Kemp Dejvidit, për arsye se nuk u lejua formimi i një shteti palestinez, nuk u çliruan tokat arabe dhe Jerusalemi i pushtuar nga Izraeli. Kështu vepruan, natyrisht, edhe Siria, e cila e quan Sadatin tradhtar të kombit arab, edhe Algjeria, Maroku, Libia dhe të gjitha vendet e tjera arabe. Pra e gjithë kjo dallavere u bë vetëm në mes tre kalanderëve.

Natyrisht, për të bindur ata që kundërshtuan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë këtyre 5 vjetëve do të bëjnë dallavere të tjera të panumërta, bile këto filluan. Në fakt, pas botimit të komunikatës sekretari i Departamentit të Shtetit, Sajrus Vens, u nis për në Lindjen e Mesme që të bisedojë me mbretin Saud, me mbretin Husein, me Sadatin, me Asadin etj., me qëllim që si e si t'i bindë, t'u bëjë presione ose t'u japë «këste» që të pranojnë zgjidhjen që i dha kësaj çështjeje të përkohshme Xhimi Karteri. Kështu do të vejë kjo punë.

Në këtë mes Kina botoi në shtypin e saj një njoftim për marrëveshjen e Kemp Dejvidit. Tani për tani nuk mban qëndrim të hapët, por kuptohet se ajo qëndron në anën e imperializmit amerikan dhe të Sadatit. Më vonë do ta shfaqë më hapur këtë mbështetje, sepse ajo lufton për statukuonë aktuale në Lindjen e Mesme, domethënë që atje të sundojë imperializmi amerikan e jo vetëm atje po kudo në botë, bile edhe afër saj në Japoni, në Kore, në Tajvan e gjetkë dhe Kina të përfitojë nga lëmoshat e nga kreditë e tij për t'u bërë superfuqi. Dhe tërë kjo politikë bëhet për arsye se gjoja luftohet socialimperializmi sovjetik.

Natyrisht edhe socialimperializmi sovjetik përfiton

nga këto situata dhe ndodhet automatikisht në krah të regjimeve të tjera, gjoja të forta, që mbajnë qëndrim kundër marrëveshjes Sadat-Begin.

Ne duhet të përgatitim një artikull që ta demaskojmë këtë lojë të imperializmit amerikan, i cili kërkon të mbajë në robëri popujt arabë, t'i shfrytëzojë këta, t'i intrigojë, t'i përçajë, të bëjë që populli palestinez të mos fitojë kurrë tokat e veta dhe të mos vendosë kurrë qeverinë e tij. Njëkohësisht të demaskojmë Izraelin, i cili është vegla e përhershme barbare fashiste e imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme.

E PREMTE
29 SHTATOR 1978

PËRSE DISA PARTI (M-L) TË AMERIKËS LATINE NUK I KUPTOJNË GABIMET DHE FAJET E MAO CE DUNIT

Po konstatojmë se midis partive komuniste, marksiste-leniniste, të vendeve të Amerikës Latine disa probleme aktuale të komunizmit ndërkombëtar, veçanërisht për sa i përket deviacionit revizionist kinez, ka që i kuptojnë, po ka edhe që nuk i kuptojnë.

Se ç'është udhëheqja e sotme kineze, pas vdekjes së Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait, ato e kuptojnë dhe mund të themi e kuptojnë drejt. Domethënë ato kuptojnë se banda e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe po e çojnë Kinën drejt një vendi revizionist, kapitalist, po e bëjnë një superfuqi socialimperialiste. Me fjalë të tjera mjaft nga këto parti e dënojnë qëndrimin aktual të Kinës. Kjo do të thotë se historinë e Kinës ose lëvizjen marksiste-leniniste në këtë vend ata e ndajnë në dy: para vdekjes së Çu En Lait dhe të Mao Ce Dunit dhe pas vdekjes së tyre. Para vdekjes së Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait Kina, sipas tyre, ka qenë një vend socialist, Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist dhe Partia Komuniste e Kinës një parti marksiste-leniniste, kurse pas vdekjes së tyre udhëheqja e re që mori fuqinë në dorë është një udhëheqje renegate, revizioniste, që ka devijuar nga marksizëm-leninizmi.

Disa parti si ajo e Kilit, e Kolombisë e disa të tjera si këto, e dënojnë gjithë veprimtarinë politike, ekonomike dhe ushtarake të Kinës së sotme të Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit. Ato veçanërisht dënojnë teorinë e «tri botëve». Për këtë teori, si edhe për problemet e tjera, po veçanërisht për këtë, këto parti janë plotësisht dakord me Partinë tonë, meqë kjo e atakoi për herë të parë këtë teori antimarksiste dhe mund të themi se luftën kundër kësaj teorie deri diku ato e kanë kuptuar dhe këtë teori e luftojnë.

Por këto parti nuk thellohen, ose edhe mund të mos kenë sa duhet të dhëna për t'u thelluar më shumë dhe për të gjetur origjinat e vërteta të këtij devijimi antimarksist të Partisë Komuniste të Kinës, prandaj periudhën e sotme të tradhtisë e presin si me thikë, sikur kjo ka lindur brenda ditës dhe pa pasur asnjë burim të mëparshëm. Këtu qëndron gabimi, ose si me thënë mosthellimi nga ana e tyre. Kjo ose merret lehtë nga ana e tyre, ose ato nuk duan që t'i atakojnë Partinë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunin për gabimet që ky ka bërë dhe që kanë sjellë pasojat e sotme.

Siç e kam thënë edhe herët e tjera, një taktikë të këtillë ndjek edhe borgjezia kapitaliste, e cila, për të luftuar marksizëm-leninizmin, mbron ata persona që janë quajtur ose janë hequr e njohur si marksistë-leninistë dhe kanë fituar njëfarë fame, por në realitet koha vërtetoi se ata nuk ishin të tillë, po mund të ishin dhe në fakt ishin vetëm revolucionarë përparimtarë, por jo marksistë-leninistë. Borgjezisë kapitaliste i intereson që këta persona të vazhdojnë të quhen marksistë-leninistë dhe komunistë. Ajo mbështetet në pseudoteorinë e këtyre të ashtuquajturve marksistë-leninistë, domethënë mbështetet në një teori që s'është marksiste-leniniste. Në këtë mes, në rast se marksistë-leninistët nuk thellohen në çështjet, në problemet dhe nuk i shohin këto dhe

evenimentet me syrin marksist-leninist, atëherë fiton kauza e kapitalizmit. Kjo ngjet, pra, për sa i përket çështjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe personalisht të Mao Ce Dunit.

Udhëheqësit e partive në fjalë bëjnë disa krahasime mekanike me hrushovizmin dhe me luftën që ky i bëri Stalinit dhe e barazojnë këtë situatë me atë të Kinës. Kështu, sipas tyre, Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist, i cili sot sulmohet nga banda e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit që nuk janë përveçse hrushovianë. Pra Mao Ce Duni na qenka një marksist-leninist si dhe Stalini, kurse Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin janë revizionistë si Hrushovi.

Në qoftë se bëhet një paralelizëm i tillë shumë i gabuar dhe antimarksist, atëherë është e pamundur që t'i shohësh ngjarjet në prizmin e marksizëm-leninizmit e të dialektikës marksiste-leniniste. Stalini ka qenë një marksist-leninist dhe nuk ka gabuar as në teori, as në praktikë. Ai ka mbrojtur teorinë leniniste mbi partinë, mbi ndërtimin e socializmit, mbi diktaturën e proletariatit, mbi luftën e klasave, mbi zbatimin e normave marksiste-leniniste në parti. Në bazë të leninizmit ai nuk lejoi që në parti të mbretëronin fraksionet, krijoi unitetin parti-popull. Në kohën e tij në Bashkimin Sovjetik ekzistonte diktatura e proletariatit, ishte në fuqi klasa punëtore në aleancë me kolkozianët, kurse në Kinë punët nuk qëndrojnë kështu. Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist. Ai ka qenë një demokrat borgjez përparimtar revolucionar që udhëhoqi luftën e çlirimit, bëri disa reforma, por dhe këto mbetën në mes të rrugës. Maoja, pra, filloi të zbatonte disa reforma për të ecur në rrugën drejt socializmit, por rruga që ndoqi ai nuk çonte në ndërtimin e vërtetë të socializmit. Ajo ishte rruga e një «demokracie të re», siç e quajti ai. Kjo ndodhi për arsye se Mao Ce Duni nuk e shikonte partinë e tij si një parti

marksiste-leniniste, nuk e ndërtoi atë në bazë të teorisë marksiste-leniniste, në parti nuk ekzistonin normat leniniste. Maoja predikonte se në partinë e tij ekzistonin dy vija që ishin në luftë të vazhdueshme me njëra-tjetrën, predikonte se revolucioni nuk do të merrte fund kurrë, as për 10 mijë vjet. Në çdo periudhë, që bile ai e përcaktonte me vite, në 7 ose në 8 vjet një herë, do të kishte, sipas tij revolucion, pastaj kundërrevolucion dhe kështu pa mbarim.

Megjithëkëtë udhëheqësit e disa partive të vendeve të Amerikës Latine njohin disa gabime të Mao Ce Dunit, por përciptazi dhe nuk thellohen mbi origjinën e tyre. Për shembull, ata thonë se Mao Ce Duni ka bërë gabim që priti Niksonin dhe këtë e quajnë si një pritje të thjeshtë kortezie dhe nuk thellohen të gjejnë se pritja e Niksonit është ndërrimi i një strategjie ose vazhdimi me një forcë më të madhe i strategjisë së Mao Ce Dunit dhe të Partisë Komuniste të Kinës drejt afrimit me imperializmin amerikan.

Pra Mao Ce Duni dhe Çu En Lai nuk e pritën Niksonin si me thënë sa për ta pritur, por e pritën për të lidhur një aleancë të ngushtë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror, me synimin e ndërtimit të Kinës me ndihmën e imperializmit amerikan dhe për të përgatitur një luftë kundër socialimperializmit sovjetik tok me imperializmin, me kundërrevolucionarët dhe me imperialistët e tjerë.

Për sa u përket «botës së tretë» dhe aleancës së kësaj bote me dy «botët» e tjera, pra teorisë së «tri botëve», udhëheqësit e partive të disa vendeve të Amerikës Latine gjykojnë pa u thelluar sa duhet se nuk është Mao Ce Duni që e ka predikuar këtë teori, por Ten Hsiao Pini. Në qoftë se pranohet që Mao Ce Duni ka bërë gabim që ka pritur Niksonin dhe nuk thellohen arsyet pse e

priti atë, ngjarje kjo që solli pasojat e mëvonshme, atëherë mund të thuhet që teoria e «tri botëve» është e të tjerëve dhe jo e Maos. Por, në fakt, kjo teori është e Maos, jo vetëm sepse vetë ky i ka predikuar këtë teori dhe këtë aleancë, por pritja e Niksonit dhe marrëveshja e arritur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë prova që vërtetojnë se kjo ishte teoria e Mao Ce Dunit.

Çështje tjetër, udhëheqësit e këtyre partive dënojnë ekzistencën e dy vijave në partinë kineze, por, derisa këta e dënojnë ekzistencën e dy vijave në parti, atëherë duhet t'i futen thellë kësaj çështjeje dhe t'i gjenden rrënjët se ç'do të thotë të lejosh dy vija në parti. Por këtu nuk është çështja vetëm e dy vijave. Këtu është çështja e shumë vijave, është çështja e «shumë luleve», e «shumë shkollave» që Mao Ce Duni ka pasë predikuar të lulëzonin, është çështja e pluralizmit të partive dhe e kompetencave të barabarta të partive të borgjezisë me partinë komuniste në pushtet, pas çlirimit të Kinës.

Të gjitha këto ç'vërtetojnë? Ato vërtetojnë se Mao Ce Duni nuk ndiqte rrugën marksiste-leniniste në ndërtimin e partisë, nuk ndiqte vijën e proletariatit. Pra në Kinë nuk ishte në fuqi proletariati, partia e tij, por ishin shumë parti. Këto parti të shumta përfaqësonin klasa dhe shtresa të ndryshme. Kështu problemi i fshatarësisë në pushtet dhe në udhëheqje nuk është një fjalë boshe, por është një teori e tërë që ka mbrojtur dhe ka zbatuar Mao Ce Duni gjatë gjithë jetës së tij, kurse proletariati për atë ka qenë aleati i fshatarësisë. Kështu, në qoftë se analizohen deri në fund këto çështje, del se Mao Ce Duni nuk ka qenë një marksist-leninist, po një demokrat borgjez përparimtar.

Shokët e partive të disa vendeve të Amerikës Latine thonë se Mao Ce Duni ka gabuar që caktoi Lin Biaon si zëvendësin e tij dhe këtë e vuri dhe në statutin e

partisë. Domethënë, ata pranojnë se ky ishte një gabim teorik dhe organizativ, që nuk përputhet me demokracinë proletare të një partie komuniste. Atëherë ky caktim i Lin Biaos si zëvendës i Mao Ce Dunit prej vetë Mao Ce Dunit shpreh një botëkuptim të tërë, ai pasqyron një botëkuptim të veçantë mbi normat e partisë, mbi demokracinë proletare, pasqyron çfarë konsiderate ka ai për partinë e proletarëve. Të caktosh zëvendësin e partisë, se kështu ta dashka qejfi, kjo nuk është një normë marksiste-leniniste dhe pikërisht këtë duhet ta thellojnë shokët e disa partive marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine dhe jo vetëm të thonë që ky ishte një gabim.

Në këtë mënyrë ata numërojnë një sërë gabimesh, por, kur e bëjnë këtë, nuk thellohen, gjë që do të thotë se ose nuk kanë atë logjikë të fortë marksiste-leniniste që t'u venë çështjeve deri në fund, ose nuk janë të ngritur teorikisht, ose me ndërgjegje nuk duan të thellohen. Natyrisht këtë ne do ta shohim gjatë veprimtarisë së mëtejshme të tyre, po kur i pyet ata përse është Mao Ce Duni marksist-leninist, të përgjigjen: është marksist-leninist, për arsye se ndihmoi në çlirimin e popujve të botës e të tjera gjëra të tilla. Ndërsa në fakt nuk ishte Mao Ce Duni që ka ndihmuar në çlirimin e popujve të botës. Natyrisht lufta e popullit kinez ka pasur influencë pozitive në çështjen e çlirimit të popujve. Ideologjia e Mao Ce Dunit dhe teoria e tij nuk e ndihmuan këtë çlirim. Po ta analizojmë këtë çështje, çlirimin e popujve, do të shohim se influenca politiko-ideologjike e Kinës, për të mos thënë ekonomike ose ushtarake, nuk ka qenë ndonjë ndihmë kushedi se si e se çfarë, për arsye se Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës nuk kanë qenë kundër imperializmit amerikan.

Një çështje tjetër që këta shokë përdorin për të ilustruar tezën e tyre në favor të Mao Ce Dunit është ajo

sipas së cilës ai është autori i pikëpamjes që brenda në revolucionin proletar duhet të vazhdohet revolucioni. Në Kinë kjo pikëpamje nuk shpreh një realitet të shëndoshë marksist-leninist, për arsye se i ashtuquajturi Revolucion i Madh Kulturor Proletar nuk ishte një revolucion me karakteristikat e një revolucioni klasik kundër borgjezisë që kishte marrë fuqinë. Përkundrazi, Revolucioni Kulturor nuk u udhëhoq nga partia, qoftë edhe ashtu siç ishte kjo parti. Ky revolucion ishte vepra e Mao Ce Dunit dhe e grupit të tij, i cili, duke u mbështetur në autoritetin e Maos, ngriti studentët, rininë në një ecje të pandalshme, me slogane e me dacibao dhe urdhëroi likuidimin e shtabeve të partisë, të organizatave të masave. Me një fjalë, për interesin e grupit të tij, ai likuidoi të gjithë ata që e pengonin të ecte ashtu siç kishte vendosur. Ata kundër të cilëve Mao Ce Duni ngriti rininë në Revolucionin Kulturor ishin edhe më të djathtë e më reaksionarë se vetë Maoja me grupin e tij.

Prandaj, po të analizohet në një prizëm të shëndoshë Revolucioni Kulturor, në të nuk shihet ndonjë gjë me të vërtetë marksiste-leniniste, po përsëritja e traditës së vjetër kineze e luftës për pushtet nga ana e grupeve të ndryshme, luftë që ka ekzistuar para, gjatë dhe pas luftës nacionalçlirimtare. Pra lufta filloi dhe u vazhdua në një rrugë jo mbi kritere revolucionare marksiste-leniniste, përkundrazi mbi kritere puçiste. Një botëkuptim i tillë mbi revolucionin vazhdoi edhe më vonë, pse prapë për pushtet luftuan, me puç, edhe Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni dhe të tjerë shokë të tyre që rrëmbyen pushtetin në Kinë. Ata mund të thonë fare lehtë që ndjekim vijën e Mao Ce Dunit, domethënë se po vazhdojnë revolucionin brenda revolucionit proletar.

Në fakt, në Kinë nuk ekziston rendi proletar, po ekziston një rend demokratiko-borgjez, i cili aktualisht po merr karakter të theksuar kapitalist, që po e shndërron

gjithë ekonominë e këtij vendi në një ekonomi kapitaliste, ndërsa jashtë, duke u bashkuar në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me të gjithë kapitalizmin botëror, lufton për të shuar revolucionin dhe përgatitet për t'i shpallur luftë superfuqisë së dytë, Bashkimit Sovjetik. Qëllimi është që Kina të bëhet një forcë e madhe kapitaliste në botë.

Këtë nuk po e kuptojnë akoma shokët e disa partive komuniste marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine. Natyrisht, ne duhet të kemi durim. Të kemi durim, do të thotë të mbrojmë pikëpamjet e Partisë sonë për këto çështje dhe të mos bëjmë lëshime, të kemi durim do të thotë të bëjmë përpjekje për t'u argumentuar shokëve të këtyre partive me fakte, me të dhëna, me analiza marksiste-leniniste, se pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre për këto çështje nuk janë të bazuara dhe nuk mbështeten në parimet e marksizëm-leninizmit, prandaj nuk janë të drejta. Ato janë pikëpamje të cekta apo sentimentale, që mund të lidhen me faktin se këto parti kur u formuan, sepse ato u formuan në kohën e Revolucionit Kulturor Proletar kinez, kanë mbajtur pozita pro Kinës dhe pro Mao Ce Dunit, atëherë ka mundësi të gjejnë forca që këtë gjendje ta kapërcejnë në mënyrë revolucionare, marksiste-leniniste, ashtu siç e kapërceu edhe Partia jonë.

Edhe Partia jonë për një kohë ka konsideruar se Kina ndërtonte socializmin, se ajo ishte shtylla e revolucionit botëror, se Mao Ce Duni ishte një marksist-leninist i madh. Por, kur ajo pa se këto konsiderata nuk kishin baza, kur pa se në Kinë nuk ndërtohej socializmi dhe Mao Ce Duni nuk ishte një marksist-leninist, pa lëre i madh, atëherë kërkoi të shpjegohej me ta, të shprehte pikëpamjet e veta. Udhëheqësit kinezë nuk i pranuan takimet me Partinë tonë dhe kishin arsye të mos i pranonin, sepse do të ndesheshin me ne dhe nuk

do të binim dakord. Prandaj edhe ne mbajtëm qëndrimet tona, i kapërcyem këto situata.

Shokët tanë, duhet t'i sqarojnë me fakte e argumente shokët e partive motra, në mënyrë që ata të kenë përshtypjen se Partia jonë nuk ia imponon kujt pikëpamjet e saj, por këto pikëpamje që ka ajo i mbron dhe në të njëjtën kohë është nga ato parti që, kur të tjerët ia argumentojnë se një pikëpamje e saj e dhënë nuk ka baza, nuk është marksiste-lenineiste, ajo, domethënë Partia jonë, është e gatshme, ta njohë dhe ta korrigjojë atë. Por shokët e disa partive të vendeve të Amerikës Latine, për sa u përket Kinës dhe Mao Ce Dunit nuk japin arsye të kundërta që të na vërtetojnë neve se Mao Ce Duni ishte një marksist-leninist i madh, se në Kinë para vdekjes së Maos ndërtohej socializmi, kurse pas vdekjes së tij ndryshoi gjithë situata. Prandaj ne duhet të vazhdojmë të punojmë me durim me këta shokë, pse armiku imperialist, kapitalist, revizionist lufton me forma të ndryshme kundër socializmit dhe kundër teorisë marksiste-leniniste.

Aktualisht është ngritur një fushatë e madhe kundër Leninit dhe leninizmit dhe kjo ka arsyet e saj. Autorët e kësaj fushate, Marksin e konsiderojnë si filozof të një epoke të vjetër, kurse sot ata pretendojnë se bota ka ndryshuar, domethënë imperializmi është forcuar, se tash pra është epoka e imperializmit të fortë. Mirëpo këtë epokë të imperializmit Lenini e ka analizuar dhe ka treguar rrugët e vërteta se si duhet ta kuptojë atë proletariati dhe si duhet ta luftojë ai imperializmin. Lenini me mësimet e tij të pavdekshme na udhëheq në këtë fazë dhe na tregon qartë se si proletariati duhet të ecë në revolucion dhe të rrëzojë pushtetin e kapitalit. Pikërisht për këtë arsye borgjezia kapitaliste ia ka frikën dhe përpiqet të mbrohet nga Lenini dhe leninizmi, dhe pikërisht për këtë, qoftë në programin e revizionis-

tëve modernë të të gjitha rrymave, qoftë në veprimtarinë e socialdemokracisë ndërkombëtare, u është shpallur luftë leninizmit dhe Leninit, duke e quajtur teorinë leniniste mbi revolucionin si një teori të paqenë, si një teori që nuk mund të zbatohet aktualisht.

Disa thonë se ajo u zbatua në Bashkimin Sovjetik në periudhën e paraluftës, ndërsa aktualisht, pas Luftës së Dytë Botërore, bota paska ndryshuar, botëkuptimet kanë ndryshuar, proletariati ka ndryshuar dhe se në shoqërinë aktuale janë bërë shumë ndryshime të tjera. Prandaj, thonë ata, duhen gjetur teori dhe forma të reja lufte për të shkuar në socializëm. Dhe një nga këto forma të reja është vetadministrimi jugosllav, janë teoritë e reja që po ndërtojnë revizionistët sovjetikë dhe adeptët e tyre, është maocedunideja dhe teoria e «tri botëve», ose forma dhe mënyra e botëkuptimit dhe e organizimit të pseudosocializmit në Kinë, domethënë qëndrimi në vend, ruajtja e statukuosë dhe e kapitalizmit botëror.

Partia jonë dhe gjithë marksistë-leninistët duhet të ngrihen në një luftë të ashpër për t'i luftuar këta renegatë, këta armiq dhe për të mbrojtur teorinë tonë të pavdekshme, marksizëm-leninizmin.

E DIEL
31 DHJETOR 1978

MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE GJATË VITIT 1978

Nesër fillon viti i ri. Sot është dita e fundit e vitit 1978, pra mund të bëjmë një përmbledhje të gjendjes së strategjisë botërore në përgjithësi dhe të superfuqive në veçanti.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, dy fuqi të mëdha bërthamore, vazhdojnë armatimin e tyre. Pavarësisht nga disa marrëveshje, që kanë nënshkruar dhe nga disa projekte SALT, që nuk po realizohen, fakt është se që të dyja këto superfuqi përpiqen të konsolidojnë pozitat e tyre botërore dhe t'i dalin përpara rrezikut të një lufte bërthamore. Natyrisht, këtë luftë, qoftë Bashkimi Sovjetik, qofshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk e duan, por thellimi i krizës do ta krijojë një situatë të tillë. Në fillim lufta mund të jetë e zakonshme dhe më pas të kthehet në bërthamore.

Prandaj Bashkimi Sovjetik, përveç shtimit të armatimeve, nëpërmjet Traktatit të Varshavës dhe KNER-it, përpiqet të konsolidojë «aleancat» me vendet e «demokracisë popullore». Këto vende janë të pushtuara nga Bashkimi Sovjetik dhe prej tij konsiderohen si një *glacis*[1] midis tij dhe Evropës Perëndimore. Sot Bashkimi Sovje-

1 Frëngjisht — ledh ndarës ndërmjet ndërluftuesve.

tik është një vend revizionist, socialimperialist. Atje nuk veprojnë ligjet e një shteti socialist. Pavarësisht nga fjalët që thonë, në Bashkimin Sovjetik sot dominojnë rusët, «rusët e bardhë». Pra në këtë vend nuk ekziston më dhe nuk mund të ekzistojë ai konsolidim i Bashkimit Sovjetik leninist-stalinian, nuk mund të ekzistojnë ai unitet dhe ajo kompaktësi përpara një lufte të re botërore, si ishte në luftën kundër hitlerianëve. Të gjitha republikat e Bashkimit Sovjetik nuk janë të qeta, bile, në kohë krize, mund që të mos shkojnë në unitet në luftë kundër një pushtuesi të mundshëm. Është revizionizmi ai që e shkaktoi këtë mundësi përçarjeje. Kjo është njëra anë.

Ana tjetër është se Bashkimi Sovjetik sot ndodhet përballë shumë rreziqeve, por sidomos përballë dy fronteve: frontit të Evropës Perëndimore, NATO-s, në unitet dhe në aleancë luftarake dhe ekonomike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Lindje përballë frontit kino-japonez e prapa tyre profilohen përsëri Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kështu që Bashkimi Sovjetik sot ndodhet në mes dy zjarresh, sidomos në Azi. Tash Kina po armatoset me shpejtësi të madhe, sigurisht për të sulmuar Bashkimin Sovjetik, kuptohet, në qoftë se do të vazhdojë kjo situatë, se ne mund të asistojmë edhe në një kthesë të politikës kineze ndaj Bashkimit Sovjetik, pra, në krijimin e një situate kur çështjet nuk do të shkojnë siç paraqiten sot.

Por nënshkrimi i traktatit kino-japonez dhe afrimi kaq i ngushtë i Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet e tjera të Tregut të Përbashkët Evropian dhe me kapitalin botëror e bën më iminente rrezikshmërinë e luftës kundër Bashkimit Sovjetik në frontin aziatik. Prandaj këtij i duhet ta shpartallojë këtë front tani, kur ky akoma nuk është konsoliduar

dhe nuk është bërë i rrezikshëm për shpërthimin e një lufte frontale. Për këtë Bashkimi Sovjetik mund të përfitojë nga gjendja e dobët aktuale e Kinës, nga pamundësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe e vendeve të Evropës Perëndimore, që të bëjnë ligjin kudo, dhe të fillojë të grumbullojë rreth vetes së tij një numër shtetesh të lidhura me të në një formë ose në një tjetër, me qëllim që të mund të dominojë në shumë vende të botës, ashtu siç dëshirojnë edhe rivalët e tij.

Ne konstatojmë se Bashkimi Sovjetik përpiqet të futet në Afrikë, përpiqet të futet në Lindjen e Mesme, në Afganistan, në Pakistan, mundësisht dhe në Indi. Gjithashtu, aktualisht, ne vëmë re se lidhjet e Bashkimit Sovjetik me Vietnamin dhe me Laosin po forcohen. Kjo përbën një *glacis* tjetër sovjetik, por edhe pikë sulmi eventual kundër Kinës nga juglindja e Azisë së Largme.

Në kontinentin afrikan, pavarësisht nga fjalët që thuhen, por, po të studiohet imtësisht situata, del se qofshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë Bashkimi Sovjetik, qofshin edhe shtetet e Evropës së Bashkuar nuk janë në gjendje të investojnë aq sa duhet. Në Afrikë, në përgjithësi, Evropës së Bashkuar i duhet, sipas statistikave, të investojë të paktën 15 miliardë dollarë në vit, kurse ajo nuk mund të investojë veçse 3 miliardë. Në këtë kontinent më shumë investon Franca, e cila bën një politikë më të afërt me Afrikën e Zezë. Kjo vjen për shkak të lidhjeve të saj të vjetra koloniale me këto vende, të cilat propagandohen gjoja si lidhje kulturore, shoqërore, ekonomike etj. Dhe Franca ka tendencë që të influencojë në Tregun e Përbashkët Evropian dhe së toku të krijojnë bllokun euroafrikan, se Afrika për ta është një kontinent me shumë rëndësi, me popullsi të paktë dhe me lëndë të para në sasi të pallogaritshme. Në përgjithësi Afrika është pak e shfrytëzuar, por megjithatë Afrika Jugore furnizon Evropën

me shumë materiale, bile me materiale të rëndësishme strategjike.

Por çështja qëndron në atë se shkalla e investimeve aktuale të Evropës së Bashkuar është shumë e paktë, prandaj tendenca e shteteve që e përbëjnë këtë, është që të krijojnë lidhje midis Afrikës së Veriut dhe asaj të Jugut dhe të mos lejojnë që Bashkimi Sovjetik, por edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të hedhin kthetrat e tyre në kontinentin afrikan. Një gjë e tillë bëhet shkak për lindjen e një konkurrence në mes të dyja superfuqive dhe shteteve të Evropës së Bashkuar të marra së toku dhe veç e veç.

Për sa u përket investimeve të Bashkimit Sovjetik në Afrikë, këto janë minimale, por tash së fundi ky ka filluar të futet ushtarakisht atje, kërkon baza detare, por ka ndërhyrë edhe me ushtri, si në Angola tok me kubanezët, në Etiopi dhe në Eritre, në Somali, në Aden e gjetkë. Pra Bashkimi Sovjetik vepron në dy drejtime: për të krijuar *glacis*-in sovjetik dhe për ta përçarë këtë unitet luftarak që përgatitet dhe zhvillohet nga të dy krahët e tij. Një gjë të tillë Bashkimi Sovjetik do ta bëjë edhe në Evropë, edhe në Azinë e Vogël. Dhe në fakt e ka filluar këtë punë, megjithëse ka pasur dhe disfata. Sidoqoftë, aktualisht, për të një rëndësi të madhe strategjike merr Mesdheu, sepse nëpërmjet tij pengon NATO-n, mund të rrezikojë ushtrinë e këtij pakti në një konflikt me të, por njëkohësisht i pret rrugën mundësisë së Evropës së Bashkuar për një bashkim euro-afrikan.

Kështu që Bashkimi Sovjetik, nga ana e vet, duke u infiltruar me shumë mënyra, qoftë me investime, por këto, siç e vura në dukje, janë të pakta, qoftë me propagandë dhe me diversion, përpiqet që Sirinë, Irakun dhe Afganistanin t'i ketë të vetët, në mos plotësisht, por treçerek; çështja është që dhe këto të mos jenë të rrezikshme për të, por aleate të tij në një luftë kundër Lindjes, domethënë në një luftë kundër treshes Kinë, Japoni, Shtete të Bashkuara të Amerikës, ose në gjithë këtë pellg, të mund të krijojë, duke kapërcyer Gjirin Persik duke kaluar në Pakistan e në Indi, një *glacis* të madh, me qëllim që të dobësojë rrethimin e vet.

Kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga ana e tyre përpiqen të financojnë dhe të armatosin Kinën për ta pasur atë kurdoherë si një faktor të rrezikshëm kundër Bashkimit Sovjetik që do të përpiqet të paktën «të mbrojë» perandorinë e vet, Siberinë, Mongolinë dhe Azinë Qendrore, ose «të përballojë» një sulmues, kuptohet, të fuqizuar me një potencial të madh ushtarak dhe ekonomik duke pasur përkrah edhe Japoninë militariste të superindustrializuar dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Gjithashtu Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen që në konfliktet me Bashkimin Sovjetik të ruajnë Oqeanin Indian, t'i kenë Indinë dhe Birmaninë me vete dhe ta pengojnë infiltrimin e Bashkimit Sovjetik qoftë në Oqeani, qoftë nga toka në gjithë këtë rrip që të çon drejt Gjirit Persik dhe Azisë Qendrore.

Pra, aktualisht gjendja paraqitet e tillë: përgatitjet për luftë po bëhen në ethe; shtetet imperialiste, në radhë të parë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Kina po armatosen, midis tyre ka kontradikta, të cilat thellohen dhe, për të mos arritur në një luftë bërthamore të përgjithshme, nxitin luftëra lokale. Bashkimi Sovjetik përpiqet të arrijë një detantë me Tregun e Përbashkët Evropian dhe me NATO-n, përpiqet gjithashtu t'i zbutë kontradiktat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bën një politikë për çarjen e fronteve. Po ashtu Evropa, për të cilën Bashkimi Sovjetik përbën një rrezik të madh, nuk do që të digjet. Ajo është e gatshme të vërë të tjerët, sidomos frontin e lindjes kino-japonez, që të përleshet me Bashkimin So-

vjetik dhe të nxjerrë për të gështenjat nga zjarri. Prandaj shohim që investimet dhe shkëmbimet tregtare në mes Tregut të Përbashkët Evropian dhe Bashkimit Sovjetik nuk pengohen, ato zhvillohen jo vetëm me Bashkimin Sovjetik, por edhe me aleatët e tij, me satelitët e Lindjes, pjesëtarë të Traktatit të Varshavës.

Kurse në Afrikë situata është akoma e papërcaktuar, për arsye se në shtetet afrikane, që janë «të lira» dhe «të pavarura», sundojnë klika të borgjezisë së madhe, sundojnë bajraktarë dhe feudalë të mëdhenj të lidhur, natyrisht, me ata që u japin më shumë. Dhe këta, në radhë të parë janë anglezët, francezët, gjermanoperëndimorët, amerikanët pastaj të tjerët, kurse Kina s'u jep gjë fare. Pra ajo i ka këmbët e shkurtra atje. Asaj i duhet shumë kohë që të futet në Afrikë. Në këtë pellg Kina luan rolin e pllakës së gramafonit për të gjithë. Ajo mbështet Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbështet Evropën e Bashkuar dhe u predikon këtyre që ta ndihmojnë atë me çfarë të mundin dhe Bashkimit Sovjetik të mos i japin kredi, që ta dobësojnë. Bile kinezët këtë e kanë deklaruar.

Prandaj situata aktuale, në pragun e Vitit të Ri 1979, mua më duket se është e mbushur me plot rreziqe, është e turbullt, por njëkohësisht është edhe revolucionare, se politika e të mëdhenjve imperialisto-revizionistë nuk është e pranueshme nga popujt, këta mbahen me forcë nën zgjedhën dhe nën diktatin e tyre. Popujt i kuptojnë intrigat, manovrat, strategjinë dhe taktikat e tyre dhe nuk rrinë me duar lidhur. Lëvizjet çlirimtare popullore po ngrihen, po shpërthejnë hapur, por ende janë të dobëta. Këto shpërthime mund të jenë momentale, mund të jenë të shkurtra, por prapë janë shpërthime, të cilat i shërbejnë dobësimit të fuqive të mëdha dhe pengojnë shpërthimin e një lufte të re botërore.

Në këtë drejtim ne duhet të punojmë, të luftojmë, të zgjerojmë sa të jetë e mundur kontaktet me masat e gjera të popujve të botës. Duke u lidhur ngushtë me partitë marksiste-leniniste, me njerëzit përparimtarë dhe nëpërmjet tyre drejtpërdrejt me popujt e botës, ne t'u japim atyre mendimin e Shqipërisë socialiste dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë.

1979

ARSYET E ECEJAKEVE TË KARTERIT NË LINDJEN E MESME

Presidenti amerikan Karter u kthye në Uashington nga Lindja e Mesme. Natyrisht, në aerodrom, siç e pamë edhe në televizor, atij iu bë një pritje e përgatitur me duartrokitje dhe me lule për të dhënë përshtypjen se kthehej si një triumfator nga vizita e tij në Egjipt dhe në Izrael. Edhe zëvendëspresidenti Mondeil si të tillë e paraqiti Karterin.

Këtë që bëri ky president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk e ka bërë asnjë nga paraardhësit e tij, përveç sekretarit të shtetit Kisinger, i cili e kishte për «detyrë» të vente e të vinte, të shiste e të blinte, të bënte kërcënime e të fërkonte krahët e njërit e të tjetrit. Pra, presidenti Karter shkoi në Egjipt e në Izrael për bisedime të shumta me Sadatin dhe me Beginin. Bisedimet ai i filloi dhe i mbaroi me Sadatin, duke kaluar nga Kajroja, në Jerusalem, në Asuan, këtej shkoi prapë në Jerusalem dhe nga Jerusalemi përsëri në Kajro, pastaj u largua për në Uashington.

Karteri, siç mësojmë nga agjencitë e ndryshme të lajmeve, pati bisedime me krerët e dy vendeve, por pati dhe kundërshtime, presione nga njëri dhe nga tjetri, edhe nga izraelitët, edhe nga egjiptianët. Presionet më të mëdha presidentit amerikan iu bënë nga izraelitët,

nga Begini, kurse Sadati u tregua më mikpritës, më i moderuar ndaj propozimeve të tij.

Me fjalë të tjera, Sadati, siç lihet të kuptohet nga lajmet e agjencive të ndryshme, nuk ishte shumë ekzigjent në kërkesat e veta, të cilat në shumë pika puqeshin me ato të Karterit. Vetëm disa gjëra të vogla, siç pohoi vetë Karteri, i ndanin pikëpamjet amerikane nga ato egjiptiane.

Kurse me Izraelin fasada dukej ndryshe. Përpjekjet me Izraelin sipas agjencive të lajmeve, ishin më «të ashpra». Një gjë e tillë u vu re si në bisedimet e presidentit Karter me Beginin dhe në ato me qeverinë izraelite, po ashtu edhe në fjalimin që ai mbajti në kneset, në parlamentin e Izraelit. Dhe këtu Begini u duk sikur u kundërshtua me gjithë mend në planin që i paraqiste Karterit. Në televizor ne pamë deputetë të ndryshëm të parlamentit izraelit, sidomos një grua, e cila nuk e linte Beginin as të fliste. Deputetja në fjalë, fliste me një vrull të madh dhe më në fund, siç duket për të treguar që traktati që po përgatiste Begini me Sadatin ishte një copë letër, ajo mori një letër nga banka para saj dhe e çori atë copë e çikë. Për të qeshur ishte qëndrimi i një deputeti tjetër afër saj, i cili e këshillonte atë të ishte më e moderuar dhe këto bëheshin kur qëndronte në vend të nderit në një qoshe Karteri që asistonte në këto debate. Mundet që kjo të ishte një *«mise en scène»* e bukur për t'i thënë Karterit se «Unë, Begini, dëshiroj të afrohem me pikëpamjet e tua, por gjendem në pamundësi t'i realizoj ato që dëshiron ti, president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për arsye të opozitës së madhe që më bëhet në parlament. Prandaj, Shtetet e Bashkuara duhet të bëjnë ç'është e mundur që nga egjiptianët të marrin koncesione më të mëdha e më të shumta në favor të Izraelit».

Pas kësaj, Karteri u kthye përsëri në Kajro, bisedoi

me Sadatin ndonjë orë e gjysmë ose dy në sallat e aeroportit dhe, pastaj, duke u përqafuar e puthur me të, ashtu si në Jerusalem me Beginin, i la lamtumirën dhe u kthye në Uashington.

Në fjalën e tij, në Uashington, presidenti amerikan deklaroi se kishte arritur një sukses. Dhe ky sukses ishte që u sheshuan një sërë çështjesh për nënshkrimin e traktatit egjiptiano-izraelit. Traktati, sipas tij dhe Beginit, në qoftë se nuk ngjet ndonjë mosmarrëveshje tjetër gjatë kësaj kohe, do të nënshkruhet javën që vjen.

Pra, që të gjykojmë se ç'lëshime ka bërë njëri dhe ç'lëshime ka bërë tjetri, duhet të presim tekstin e traktatit, por ne qysh tash mund të japim mendimin tonë për qëllimet e vajtjes së presidentit amerikan në Egjipt dhe në Izrael. Ulja e autoritetit të këtij presidenti në një shkallë me atë të një ministri të jashtëm, ka arsye të thella dhe jetike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është e lidhur me gjithë çështjen e Lindjes së Mesme. A do të bëhet Lindja e Mesme një domen i amerikanëve, do të futet ajo nën influencën e sovjetikëve apo në këtë rajon do të shpërthejë revolucioni demokratiko-borgjez, siç ndodhi në Iran? Dhe në qoftë se në Arabinë Saudite, në Egjipt, në vendet e tjera të Lindjes së Mesme ngjet ajo që ngjau në Iran, atëherë situata për imperializmin amerikan dhe për të gjitha shtetet kapitaliste perëndimore do të jetë katastrofike.

Nafta nuk është e sigurt për amerikanët, prandaj me vajtjen e tij në Lindjen e Mesme presidenti Karter vuri në balancë autoritetin e tij si president i sotëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe si president i ardhshëm, në qoftë se vë kandidaturën në zgjedhjet e ardhshme.

Konkluzioni i vajtjes së Karterit në këto dy vende të Lindjes së Mesme duhet të jetë ky: në mes Izraelit

dhe Egjiptit të ekzistojë paqja, por jo vetëm kaq. Izraeli dhe Egjipti bashkërisht të përbëjnë një xhandar më të fortë se ç'ishte Izraeli më parë për të mbrojtur pellgun e naftës nga dy rreziqe: nga rreziku sovjetik dhe nga rreziku i revolucionit. Kështu që qëllimi i presidentit Karter, si dhe i gjithë kapitalistëve perëndimorë, është që në këtë pellg të naftës të mos ngjasin më turbullira, siç ngjanë në Iran, ku akoma nuk është stabilizuar gjendja. Dhe se si do të stabilizohet gjendja atje, kjo është një pikëpyetje për imperialistët amerikanë dhe për të gjithë kapitalistët perëndimorë.

Pra po bëhet luftë për naftën dhe më parë po përgatitet mbrojtja e saj nga çdo rrezik. Por, siç e vura në dukje, kjo bëhet në rast se ndodh një sulm sovjetik i shkaktuar nga arsye të tjera luftënxitëse, por edhe në qoftë se shpërthen një revolucion kundër udhëheqjeve aktuale të shumë shteteve të këtij rajoni, që janë në shërbim të imperializmit, që kanë shitur vendin te kapitalizmi botëror dhe shtypin popullin.

Për këto arsye Karteri shpalli se do t'u japë një ndihmë të madhe si Izraelit, edhe Egjiptit që arrin në 4 miliardë e ca dollarë, në qoftë se nuk gabohem. Dhe, sigurisht, këta 4 miliardë dollarë do të jenë kryesisht për armatime. Presidentit amerikan i intereson që Egjipti, pasi të vendosë traktatin e paqes me Izraelin në kundërshtim me Sirinë, me Irakun dhe me të gjitha vendet e tjera arabe, të krijojë një «ushtri skifterësh», siç është ushtria izraelite. Dhe pastaj, të dy tok, në unitet, të fillojnë agresionin dhe shtypjen e klikave që sundojnë në vendet e tjera të këtij pellgu ose më larg këtij pellgu si, për shembull, në Libi. Edhe ky vend është një zonë e nxehtë vajgurore, së cilës ia kanë vënë syrin edhe imperialistët amerikanë, edhe kapitalistët perëndimorë, edhe socialimperialistët sovjetikë.

Pra qëllimi i vajtjes së Karterit në Egjipt dhe në

Izrael, ishte forcimi i aleancës midis këtyre dy vendeve, shpallja e një plani gjoja ekonomik ndihme «Karter», për të mos e quajtur «Plan Marshall», për këto dy shtete mike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për krijimin e një ushtrie të gatshme për të ndërhyrë në Jemenin e Veriut, në Oman, në qoftë se rrezikohen, dhe për të mbrojtur, gjithashtu, Arabinë Saudite, në rast se në Iran vazhdon të thellohet revolucioni në mënyrë më radikale.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës shikojnë se po u rrezikohen rrugët ujore, kanali i Suezit, prandaj u duhet t'i forcojnë pozitat e tyre atje. Por Adeni, dalja në Detin e Kuq, tash është në duart e sovjetikëve, për arsye se këta janë të lidhur me etiopianët, të cilët kanë pushtuar Eritrenë. Sovjetikët dhe kubanezët janë brenda në Jemenin e Jugut dhe që andej kanë përgatitur e kanë shpërthyer luftën kundër Jemenit të Veriut, që është një barrikadë për të mbrojtur Arabinë Saudite. Jemeni i Veriut u ndihmua një herë nga Naseri, i cili dërgoi atje forcat e tij dhe qeveritarët e Jemenit i pritën me entuziazëm të madh. Tash ka mundësi që ushtria e Sadatit, e forcuar me armë moderne, të vejë përsëri në ndihmë të Jemenit të Veriut dhe të rrezikojë Jemenin e Jugut.

Kështu që, në perspektivë, në gjithë këtë rajon të madh, të zjarrtë, ne do të shohim përpjekje në mes dy superfuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, secila për të kapur kyçe dhe pozita strategjike. Pikërisht për këtë qëllim të dyja superfuqitë do të përpiqen të krijojnë aleanca me shtetet e këtij rajoni dhe të fillojnë luftime të pjesshme, jo një luftë të përgjithshme. Këto luftime të pjesshme bëhen duke ndihmuar drejtpërdrejt ose tërthorazi me armë ose me këshilltarë klikat reaksionare në vendet e Lindjes së Mesme. Shtëpia e Bardhë, për

shembull, deklaroi tash së fundi se do të dërgojë 3 mijë veta si këshilltarë në Jemenin e Veriut. Kjo do të thotë që ajo të dërgojë në Jemenin e Veriut një forcë të fuqishme ushtarake. Dhe sa për armë masat janë marrë që më përpara, që kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjoja lejuan Arabinë Saudite t'i japë Jemenit të Veriut nga armët që ka marrë prej tyre.

Por çështja tani është se si venë punët në Iran. Atje asgjë nuk është stabilizuar. Khomeini ka pasë menduar se me rrëzimin e shahut, ai do ta drejtonte revolucionin sipas qejfit të tij, me fjalë të tjera, në frymën e Kuranit, në frymën e koncepteve mesjetare, të cilat t'i paraqiste si demokratike, gjoja për lirinë e plotë, për demokracinë e vërtetë islamike etj., etj.

Tash, jo se situata i ka shpëtuar nga duart Khomeinit, por revolucioni në Iran që lidhej me rrëzimin e monarkisë së Pahlevëve, me likuidimin e kësaj monarkie mesjetare, nxori në dritë elementë të organizuar, shumë më radikalë, shumë më përparimtarë se Khomeini, të cilët po veprojnë për një Iran demokratik, borgjez, me të drejta të mëdha. Po sa do t'ia arrijnë këta këtij qëllimi, këtë do ta shohim.

Këto lëvizje të fuqishme në Iran udhëhiqen sigurisht nga disa parti, nga disa fronte, të cilat quhen se janë të pavarura nga fuqitë e huaja, por në të vërtetë nuk është kështu. Sovjetikët kanë punuar brenda në Iran me partinë Tudeh, që ne nuk e dimë se në ç'gjendje është. Por edhe kinezët, nën mbrojtjen e shahut, kanë punuar për të krijuar partinë e tyre maoiste, e cila të ndihmonte shahun për të qëndruar në fuqi dhe, në kohë rreziku, kur monarkia e Pahlevëve të likuidohej, të dilte në dritë si parti gjoja marksiste-leniniste. Dhe kjo parti thuhet se ekziston atje. Kurse partia e Khomeinit, ose fronti i tij, duket të jetë më i fuqishëm. Në

Iran ekzistojnë, gjithashtu, dhe elementë propalestinezë.

Natyrisht të tëra këto parti e fronte luftojnë për të fituar pozita, për të krijuar në Iran një qeveri të atillë që të mbrojë interesat e një borgjezie «të re», më demokratike, por, në fakt, përsëri të një borgjezie, e cila do të përpiqet të mbajë kërbaçin nga prapa krahëve për të goditur lëvizjet popullore revolucionare më radikale që do të dëshirojnë ta çojnë revolucionin iranian më tej.

Në këtë kryengritje të madhe popullore, siç shkruanim në artikullin tonë: «Klasa punëtore iraniane zbriti në fushën e betejës, përmbysi shahun dhe trondit botën kapitaliste», botuar në gazetën «Zëri i popullit»[1], ne shohim të hyjnë në skenë forca të mëdha që kërkojnë të drejta e përcaktojnë programe për transformime të thella në shumë fusha të jetës.

Gratë iraniane janë në lëvizje dhe në demonstrata. Ato kërkojnë të drejta të barabarta me burrat dhe hedhjen poshtë të perçes, të cilën Khomeini e mbron si shenjë të islamit. Shumë studentë përparimtarë gjithashtu janë në lëvizje. Mijëra studentë bëjnë demonstrata brenda në Universitetin e Teheranit, të tjerë kërkojnë që ushtria të jetë një ushtri e popullit, që oficerët të zgjidhen nga populli. Gjykatat popullore në Iran po ekzekutojnë gjeneralë, oficerë madhorë, oficerë të sigurimit dhe gjithfarë satrapësh që i shërbenin shahut. Me fjalë të tjera, atje po bëhen spastrime, pavarësisht nëse i do ose nuk i do Khomeini. Armë janë shpërndarë ose janë rrëmbyer me shumicë, kurse Khomeini bën thirrje që këto të dorëzohen, por askush nuk i dorëzon.

Natyrisht, Irani do të rrojë dhe pasuria kryesore e tij është nafta. Tash ai ka filluar të nxjerrë naftë, por jo në sasinë e mëparshme, bile ka filluar të ngrejë

1 Nr. 42 (9530), 18 shkurt 1979.

dhe çmimet e saj. Qeveria aktuale provizore iraniane ka në plan dhe ka marrë masa të shtetëzojë shoqëritë e huaja që shfrytëzonin naftën në Iran. Në qoftë se ajo arrin ta realizojë këtë masë, kjo është diçka pozitive. Pastaj është tjetër çështje se si do të administrohet e kush do ta drejtojë atë pasuri kaq të madhe të këtij vendi. Për këtë atje do të bëhet luftë dhe duhet të bëhet luftë në mes partive të ndryshme, që nga ajo e Khomeinit dhe deri te partia Tufan.

Por populli iranian duhet të bëhet i ndërgjegjshëm që kjo pasuri e madhe që ka të administrohet nga ai vetë, me fjalë të tjera, nga një organizim shtetëror dhe partiak i ri i Iranit. Por se si do të zhvillohet puna në këtë drejtim, do ta shikojmë. Vetëm tani për tani shohim që edhe qeveria amerikane sillet si qengj me qeverinë aktuale, derisa të fitojë pozitat, në mos siç i kishte më parë, por diçka më të mira nga ç'janë aktualisht, pse hëpërhë janë mjaft të këqija.

Khomeini ka deklaruar se do të luftojë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër çdo fuqie tjetër që do të përpiqet të futë nën zgjedhë Iranin. Natyrisht, lufta e Khomeinit është luftë e një borgjezi fetar që s'mund të shkëputet nga borgjezia kapitaliste e huaj. Për të përcaktuar mbështetjen e tij te njëri ose te tjetri, varet nga presionet që ai do të ketë. Populli iranian nuk duhet të lejojë që kjo mbështetje të jetë skllavëruese. Gjithashtu populli përparimtar i Iranit të luftojë që të qërojë elementët e rrezikshëm, të shkulë rrënjët e thella të agjenturave të ndryshme që ekzistojnë atje dhe për këtë do të duhet një kohë e gjatë, dhe të mos lejojë agjenturat amerikane, sovjetike etj., të drejtpërdrejta, nën maskën e specialistëve ose të partive të ndryshme gjoja demokratike, gjoja komuniste, të vendosin influencën e superfuqive në këtë vend të pasur, por njëkohësisht të mjeruar.

Influenca e revolucionit iranian do të jetë e madhe dhe do t'i kapërcejë kufijtë e tij. Dhe fakt është se kjo influencë ndihet në Emiratet e Gjirit Persik, por edhe në Irak, në Siri, në Arabinë Saudite, në Oman dhe në të gjitha principatat e tjera të Gjirit Persik. Por Irani duhet të jetë vigjilent, të ketë parasysh edhe rreziqet e mëdha që mund t'i vijnë qoftë nga imperialistët amerikanë, qoftë nga socialimperialistët sovjetikë. Bashkimi Sovjetik ka një kufi të gjatë me Iranin dhe popullsia e Azerbajxhanit iranian ka lidhje të ngushta me Azerbajxhanin sovjetik. Kështu që këtej do të hyjnë e do të dalin nga Irani agjentura sovjetike për të organizuar edhe sabotazh, edhe kryengritje, për të bërë edhe kërkesa autonomie, për të kërkuar edhe koncesione etj., etj.

Në këto situata vetëm një forcë politike e shëndoshë revolucionare marksiste-leniniste, që të ketë mbështetjen e klasës punëtore dhe të popullit, mundet të fitojë dalngadalë terren dhe t'u rezistojë të gjitha këtyre rreziqeve që u turren Iranit dhe gjithë botës. Them dhe botës për arsye se i gjithë pellgu i Lindjes së Mesme është një rajon konfliktesh shumë më të mëdha, nga ç'ishin konfliktet ballkanike në shekullin e kaluar. Të gjitha shtetet e këtij rajoni janë nën influencën e të huajve, të cilët mbështetin klikat e tyre dhe i nxitin këto për luftëra të pjesshme.

Tash shohim aleancën egjiptiano-izraelite, asistojmë në përpjekjet që bëjnë sirianët dhe irakianët për t'u bashkuar, po se sa do të bashkohen, ky është një problem tjetër. Gjithashtu konstatojmë që Egjipti e ka syrin nga Libia dhe që Sadati ka miqësi të ngushtë me Sudanin. Prandaj ka mundësi që të shpërthejë ndonjë konflikt edhe në mes libianëve, egjiptianëve dhe sudanezëve

për dominim, për shkak të naftës, si dhe për të penguar depërtimin sovjetik në Afrikë.

Socialimperialistët sovjetikë tash po e furnizojnë Kadafin e Libisë me armë. Sigurisht atje ka shtabe sovjetike që po e stërvitin ushtrinë e këtij vendi. Kjo, pra, Libia, nga ana e saj ka pretendime ndaj Egjiptit dhe vendeve të tjera në jug të saj. Atje ka akoma rivendikime për shkretëtirën në jug, ku dominon influenca franceze. Kjo shkretëtirë nuk ka ujë, por në thellësi të saj ka naftë. Këtu luftohet për naftën, prandaj mund të ngjasin turbullira.

Nuk është aspak pa kuptim vizita e Zhiskar d'Estënit në Afrikën frankofone dhe përpjekjet që po bën ai për ta lidhur atë fort pas qerres së vet, për t'i shfrytëzuar mirë këto vende nëpërmjet bankave dhe shoqërive shumëkombëshe, për të investuar në ish-kolonitë e vjetra franceze, për të thithur në këtë mënyrë pasuritë e mëdha të këtyre vendeve dhe që klikat e tyre t'i ketë në shërbim të Elizesë.

Natyrisht, Franca nuk i vjen kot në ndihmë Mobutus, nuk nxit kot Marokun që t'i vejë atij në ndihmë. Ajo nuk e harron Algjerinë, përkundrazi, pret momentin e volitshëm që nëpërmjet Saharasë ose Marokut përsëri të shpërthejnë turbullira edhe atje. Aktualisht, këto nuk duken në horizont, por turbullirat, konfliktet janë pjella e kapitalizmit dhe e imperializmit, që i organizojnë ato për të mbrojtur interesat e tyre dhe të klikave që janë të lidhura me ta.

Prandaj në kontinentin afrikan dhe në Lindjen e Mesme shohim një situatë të turbullt, ku përplasen interesa të mëdha të imperializmit, por njëkohësisht vëmë re edhe një zgjim të revoltës popullore, të popujve të shtypur që shikojnë se kush i shtyp, kush intrigon, kush i zhvat dhe kush pasurohet me gjakun dhe me djersën e tyre. Dhe, natyrisht revolta popullore ngrihet, ngjitet dhe shpërthen, mundet që nganjëherë nuk ka rezultate, por shpërthimi

sjell shpërthimin në mënyrë të njëpasnjëshme e formon një zinxhir të fortë.

Pra shtypja dhe shfrytëzimi imperialist do të sjellin me vete reagimin e masave popullore të vendeve të shtypura për çlirim.

E SHTUNË
31 MARS 1979

NJË TRAKTAT IMPERIALIST ANTIARAB

Siç dihet, këto ditë në Uashington, në një tendë të madhe të ngritur posaçërisht nga Karteri në sheshin përpara Shtëpisë së Bardhë, e përpara një mijë e ca vetave, përveç publikut që bënte sehir prapa kangjellave të parkut, mbi një bankë tradicionale, ku janë nënshkruar traktate të ndryshme imperialiste, skllavëruese nga amerikanët, u nënshkrua Traktati i paqes midis Egjiptit dhe Izraelit e u firmos edhe nga Karteri me funksionin e dëshmitarit.

Pra, u nënshkrua një traktat imperialist pas një lufte agresive grabitqare imperialiste të deklaruar nga sionizmi izraelit, i mbështetur fuqimisht me armë e me municione dhe i financuar nga imperializmi amerikan. Kjo luftë grabitqare e Izraelit ka pasur për qëllim, e që e kishte arritur, të likuidonte atdheun e palestinezëve, të pushtonte Jerusalemin, bregun perëndimor të lumit Jordan, rripin e Gazës, të pushtonte gjithë Sinain, bile t'u rrinte mbi krye si shqiponjë Libanit dhe Egjiptit. Përveç kësaj, ushtritë agresive të sionizmit izraelit pushtuan, gjithashtu, lartësitë e Golanit, që i përkasin Sirisë.

Ky ishte qëllimi i luftës agresive imperialiste kundër popujve arabë palestinezë, sirianë, egjiptianë, jordanezë dhe tërthorazi edhe kundër të gjithë popujve të tjerë arabë. Kjo luftë grabitqare e Izraelit, e mbështetur fuqimisht nga imperializmi amerikan, kishte gjithashtu për qëllim të mbante nën sundimin e vet rajonin e pasur të naftës të Lindjes së Mesme, me fjalë të tjera Arabinë Saudite, Emiratet e Gjirit Persik, Kuvajtin, Iranin etj. dhe të krijonte një barrierë të fortë ekonomiko-ushtarake kundër vendeve arabe dhe partnerëve të tyre, vendeve kapitaliste perëndimore, të cilat rrojnë në sajë të naftës së Lindjes së Mesme.

Egjiptianët, sirianët dhe jordanezët, gjoja në unitet, po në fakt të përçarë, e përballuan disa herë këtë luftë agresive, veçse pa sukses, për arsye se nuk ishin seriozisht të bashkuar në luftën e tyre kundër këtij invadimi barbar dhe u thyen që në kohën e Farukut, të Naserit, po dhe tash të Sadatit, gjithashtu dhe nën mbretërinë e Huseinit. Kurse Libani kozmopolit, ku ishin fiksuar një numër i madh palestinezësh, sidomos në jug të këtij vendi dhe në kufijtë e Izraelit, është bërë preja e vazhdueshme e këtij dhe ka mbetur përsëri i tillë përballë sulmeve barbare të këmbësorisë, artilerisë dhe aviacionit izraelit. Gjithashtu Libani është kthyer në një vend luftërash civile midis sirianëve, maronitëve ortodoksë dhe arabëve.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Izraelin përveç përdorimit të armëve, kanë ditur, gjithashtu, të kombinojnë ndërmjet tyre edhe metodat e përçarjes, pavarësisht nga ato që trumbetojnë çdo ditë dhe vazhdimisht vendet arabe se gjoja kombi arab është një komb i bashkuar. Nga njëra anë veprimtaria e imperializmit amerikan dhe lufta agresive e Izraelit, koburja e tyre në Lindjen e Mesme, nga ana tjetër edhe socialimperializmi sovjetik, bëjnë punën e tyre për shkatërrimin e këtij uniteti. Uniteti arab, pra, nuk është tjetër veçse një formulë. Të gjitha këto forca të errësirës, imperializmi, socialimperializmi dhe veglat e tyre shkaktojnë përçarje në këto vende e në këta popuj dhe

kjo përçarje e ka bazën edhe në udhëheqjet reaksionare kapitaliste të këtyre vendeve, të cilat kanë interesa të ndryshme, kanë qëllime dominimi mbi njëri-tjetrin etj. Në vendet arabe, natyrisht, dominojnë ato shtete që janë më të pasura në naftë, pra Arabia Saudite, Iraku, Kuvajti, Emiratet e Gjirit Persik që, megjithëse nuk kanë një forcë ushtarake të atillë që të mund të sundojnë në vendet e tjera, kanë një forcë ekonomike të madhe nëpërmjet së cilës influencojnë, pikërisht mbi klikat që janë në fuqi qoftë në Siri, në Liban, në Jordani, në Jemen, në Egjipt dhe në të gjithë popujt e tjerë të Afrikës Veriore.

Pra, nëpërmjet forcës së madhe ekonomike të veglave të tij, të cilat ka ditur t'i manipulojë, imperializmi amerikan ka mundur të akaparojë pjesën e luanit në të ardhurat e naftës, veçanërisht në Iran e në Arabinë Saudite. Si rrjedhim edhe në Emiratet e Gjirit imperializmi amerikan ka pasur një influencë të madhe, që vazhdon ta ketë edhe aktualisht. Kjo mund të jetë e përkohshme për arsye se shahu i Iranit u rrëzua, dhe interesat e imperializmit amerikan në këtë shtet u dobësuan në një masë të dukshme.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës aktualisht luftojnë që të rivendosin dominimin e vet në Iran, qoftë edhe nën petkun e Ajatollah Khomeinit. Edhe socialimperializmit sovjetik i është hapur oreksi. Ai influencon në gjendjen e Iranit nëpërmjet kurdëve, azerbajxhanasve dhe partisë së vjetër gjoja komuniste Tudeh. Por në Iran, që në kohën e shahut, janë krijuar nën maska të ndryshme edhe parti maoiste, trockiste, të cilat vegjetonin nën mbikëqyrjen e SAVAK-ut iranian dhe tash, me kryerjen e revolucionit demokratiko-borgjez, ato dolën mbi ujë dhe disa mbrojnë Khomeinin, që është për një republikë islamike, disa kërkojnë një demokraci disi më të gjerë.

Pikërisht dje u bënë votimet në Iran dhe do të shohim rezultatet e tyre.

Pra, interesat ekonomike të lidhura me naftën të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Iran e si rrjedhim në Lindjen e Mesme, janë dëmtuar pjesërisht e jo përfundimisht, dhe aktualisht lufta e tyre në këtë vend synon që të ristabilizojë gjendjen, jo duke risjellë shahun në fuqi, por duke shfrytëzuar Khomeinin ose partitë e tjera.

Për këtë gjë Shtetet e Bashkuara të Amerikës po veprojnë me shpejtësi të madhe dhe me presione kërcënuese ndaj Izraelit dhe kryeministrit të tij Beginit, që të nënshkruante një traktat paqeje me Egjiptin, por më mirë të thuhet një traktat kashtë. Egjipti me nënshkrimin e këtij traktati po bie në kundërshtim me të gjitha shtetet e tjera arabe. Sadati dëshironte që, qoftë edhe për sy e për faqe, të merrnin pjesë në këtë marrëveshje edhe palestinezët, të cilët refuzuan, ose të vihej në këtë traktat ndonjë klauzolë e tillë që palestinezëve gjoja t'u njihet në të ardhmen e drejta për të pasur atdheun e vet, të cilin ua ka gllabëruar sionizmi izraelit. Por natyrisht ai punonte që të gjendeshin disa formula që në të vërtetë të mos i njihej kurrë këtij populli një e drejtë e tillë e ligjshme e natyrale.

Sadati u bind që të pranonte pikëpamjet amerikane dhe solli edhe Beginin në atë rrugë që kishte zgjedhur imperializmi amerikan. Traktati izraelito-egjiptian në fakt nuk është traktat në mes këtyre dy shteteve, të cilat kanë qenë dhe janë në luftë midis tyre, por është një traktat amerikan, traktat imperialist, që ruan dhe mbron interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lindjen e Mesme. Në këtë traktat prej 9 nenesh, natyrisht, Egjipti rimerr një pjesë të Sinait me një sërë kushtesh, rimerr puset e vajgurit në Sinai të shfrytëzuara nga izraelitët, detyrohet që gjirin e Akabës dhe ngushticën e Tiranit t'i

deklarojë ndërkombëtare, të pranojë që anijet e çdo lloji të kalojnë lirisht në kanalin e Suezit, të ketë disa të drejta në rripin e Gazës dhe kaq. Kurse Izraeli, natyrisht, mban mjaft territore arabe nën pushtimin e vet, i ka inkluduar këto në shtetin e vet sionist. Izraeli nuk pranon të lëshojë në asnjë mënyrë sidomos Cisjordaninë dhe Jerusalemin. Jerusalemi, deklaroi Begini, do të mbetet kryeqyteti i Izraelit.

Për gjithë këtë rezultat, për këtë traktat imperialist Shtetet e Bashkuara të Amerikës u paguan izraelitëve dhe egjiptianëve nga 2 miliardë dollarë secilit, domethënë i bleu që të dy. Natyrisht sasia më e madhe e këtyre 2 miliardëve do të jepen në armë. Pra industria amerikane e armëve do të zhvillohet akoma më shumë dhe imperializmi amerikan do t'i furnizojë me armë këto dy kobure të saj, që i lidhi për interesat e veta e për t'i drejtuar ato kundër të gjitha vendeve të tjera arabe që do të përpiqen të prishin këtë «statukuo» të vendosur në tendën përpara Shtëpisë së Bardhë. Ky është qëllimi dhe kuptimi i këtij Traktati të paqes, i cili nuk sjell paqen, por luftën, për arsye se nuk është në interesin e popujve dhe të shteteve arabe, qofshin këto edhe shtete borgjeze kapitaliste.

Kundër Traktatit izraelito-egjiptian në mënyrë të papajtueshme janë në radhë të parë palestinezët. Këta deklaruan me të drejtë në mënyrë të hapët, të fortë dhe kurajoze se do t'u bëjnë një luftë të pamëshirshme këtij traktati dhe këtyre rezultateve. Ata e deklaruan Sadatin tradhtar dhe se «do t'ia presin duart dhe kokën». Këta janë termat që ka përdorur kundër tij Arafati, sipas agjencive të huaja.

Me palestinezët janë bashkuar në radhë të parë sirianët, pse këta kanë përpara një «unitet» egjiptiano-izraelit, gjë që ua bën më të vështirë rimarrjen e lartësive të Golanit. Pra, në qoftë se ata do të orvaten të

marrin Golanin e tyre, atëherë duhet të lidhen ngushtë në një unitet luftarak me vendet e tjera arabe, që kundërshtojnë këtë traktat. Por një unitet i tillë luftarak është zor të arrihet nga ana e tyre. Që para traktatit që deklaruar se do të bëhej në Bagdad mbledhja e të gjitha vendeve që kundërshtojnë Traktatin izraelito-egjiptian. Në fakt atje u mblodhën përfaqësuesit e këtyre vendeve, po shpejt u shpërndanë përsëri, pse nuk ishin dakord të pritnin marrëdhëniet me Egjiptin, ta bojkotonin këtë dhe ta deklaronin Sadatin si tradhtar të kauzës arabe, që i shiti këto tek Izraeli dhe tek imperializmi amerikan. Natyrisht, në këtë mbledhje Siria edhe Iraku mund të ishin më afër njëri-tjetrit dhe treçerek në krah të më të vendosurve që janë palestinezët, mirëpo të ftohta u treguan Arabia Saudite dhe vendet e Emiratit të Gjirit, kurse Algjeria, Tunizia dhe Libia bëjnë llafe shumë dhe punë pak. Ndër këta të fundit Libia e Kadafit ngre zërin një çikë më lart dhe ka lëvizur trupa drejt Egjiptit, natyrisht për demonstrim, kurse Sadati, përpara se të kthehet në Egjipt, u dha urdhër edhe ai trupave të tij të lëvizin në drejtim të perëndimit, pse aktualisht i kanë krahët të lira nga ana e kanalit të Suezit, prandaj po e drejton ushtrinë në kufirin me Libinë.

Kështu që Egjiptit i mbetet vetëm një mbështetje, Sudani, të cilin Sadati përpiqet me të gjitha forcat që ta mbajë afër që të jenë të lidhur së toku në eventualitetin e një gërvishtjeje të mundshme nga ana e Libisë.

Arabia Saudite dhe Emiratet e Gjirit, tok me Jordaninë, natyrisht, e dënuan Traktatin izraelito-egjiptian, por nuk na qenkëshin dakord ta bojkotojnë Egjiptin, të prishin marrëdhëniet me të dhe më në fund të organizojnë edhe ndonjë luftë të vogël kundër tij, pse lufta e vogël kundër Egjiptit do të drejtohej edhe kundër Izraelit, aleatit të Egjiptit, do të drejtohej sido-

mos kundër imperializmit amerikan, i cili, kur populli iranian rrëzoi shahun, dërgoi në Arabinë Saudite dhe në gjithë pellgun e Lindjes së Mesme sekretarin e shtetit për Mbrojtjen të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Braun, i cili punoi në këto vende për ta penguar unitetin arab. Pas Braunit shkoi edhe Brzezhinski, ndihmës i Karterit për sigurimin kombëtar, i cili bisedoi me mbretin e Arabisë Saudite dhe me sunduesit e Omanit dhe të Emirateve të Gjirit Persik. Natyrisht në këto kushte mbledhja e Bagdadit rezultoi, si thotë fjala e popullit tonë, «ku ishe? — hiç gjëkundi».

Pra asnjë unitet nuk u arrit në vendet që gjoja e kundërshtojnë Traktatin egjiptiano-izraelit. Propagandë, natyrisht, bëhet shumë dhe sa të duash, duke thënë se ky traktat nuk mund të ketë jetë, se popujt arabë janë kundër këtij traktati, se popujt arabë do ta likuidojnë Izraelin, se popujt arabë do të likuidojnë Sadatin, bile edhe fizikisht, se 2 miliardë dollarët amerikanë nuk do ta përmirësojnë jetën në Egjipt etj., etj. Natyrisht këto e shqetësojnë Sadatin dhe i krijojnë telashe brenda, pse populli egjiptian nuk është i tëri me të, por duhet njohur që populli i Egjiptit nuk është aq luftarak sa mund të mendohet. Ai në fund bëri një sforco, kapërceu kanalin dhe u fut në Sinai. Izraeli në luftën e Kipurit u gjend në befasi. Megjithatë, me anë manovrimesh ushtarake, u doli prapa krahëve ushtrive sulmuese egjiptiane që u futën në Sinai, i bllokoi këtu, dhe kështu pengoi avancimin e tyre të mëtejshëm. Sidoqoftë kjo luftë krijoi një gjendje disi të favorshme për Egjiptin në vendet arabe, por kjo gjendje e favorshme rezultoi në situatat e sotme, të cilat janë në disfavorin e popujve arabë, të vetë popullit egjiptian, të popullit sirian, të popullit palestinez, në radhë të parë, pastaj edhe të të gjithë popujve të tjerë arabë.

Me fjalë të tjera aktualisht me Traktatin sionisto-

-egjiptian imperializmi amerikan e mballosi një situatë shumë kritike që u krijua në Lindjen e Mesme me rrëzimin e shahut të Persisë. Ky traktat mund të konsiderohet si një sukses i vogël elektoral i Karterit, por ai nuk është një traktat, për të cilin mund të thuhet se do të ketë jetë të gjatë.

Sadati, në të kthyer nga Uashingtoni, s'mungoi të drejtohej në Bon dhe të kërkonte jo një miliard dollarë kredi, por 20 miliardë. Agjencitë e lajmeve të Gjermanisë Perëndimore flasin për pritjen e përzemërt që iu bë nga ana e presidentit të Bonit Karsten dhe e kancelarit Shmidt. Ato thonë se Gjermania Perëndimore do ta ndihmojë Egjiptin me kredi për përmirësimin e gjendjes së tij ekonomike dhe një gjë e tillë do të bëhet, por, natyrisht, jo me 20 miliardë. Kjo është një shifër e ekzagjeruar dhe imperialistëve amerikanë nuk u intereson një gjë e tillë, pse do të prisheshin ekuilibri dhe statukuoja që mezi i krijuan në Lindjen e Mesme. Sidoqoftë kreditë që Egjipti mund të marrë nga Boni, duhet të kthehen me interesa të mira dhe në kohën e caktuar. Kështu Egjipti u fut kokë e këmbë në sferën e influencës dhe nën diktatin e imperializmit amerikan dhe të revanshistëve të Bonit.

Natyrisht, në këtë mes socialimperializmi sovjetik përpiqet që vendet arabe që kundërshtojnë Traktatin izraelito-egjiptian, t'i nxitë në luftë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, domethënë kundër Izraelit dhe Egjiptit dhe t'i bashkojë nën drejtimin dhe influencën e vet. Për këto arsye, akoma pa u nënshkruar traktati, një ditë para, në qoftë se nuk gabohem, Gromikoja bëri një vizitë në Siri e në Irak. Është e qartë se qëllimi i kësaj vizite ishte si kundërpeshë e vizitës së Beginit dhe të Sadatit në Uashington për të nënshkruar traktatin. Sigurisht gjatë vizitës Gromikoja ka bërë «muhabete», ka dhënë premtime, ka paraqitur plane etj. por mbledhja

e Bagdadit megjithatë nuk dha ndonjë rezultat. Këto shtete arabe mund të marrin vetëm armë nga Bashkimi Sovjetik dhe asgjë tjetër, bashkimi i tyre nën shkopin e sovjetikëve nuk arrihet dhe nuk do të arrihet. Vendet e tjera arabe përpiqen t'i përmirësojnë lidhjet në mes tyre. Flitet edhe për një bashkim të Sirisë me Irakun, por ky bashkim do t'i përngjasë bashkimit para disa vjetësh të Sirisë me Egjiptin. Në mes tyre ka kontradikta të mëdha, të cilat thellohen midis partive Baas dhe udhëheqjeve të këtyre dy vendeve.

Për sa u përket përpjekjeve që bëjnë këto për t'u lidhur me Iranin, natyrisht edhe kjo është hipotetike. Irani ka qëllimet e veta, ka megalomaninë e vet, ka interesat e tij ekonomike, që e shtyjnë në një rrugë jo në akord me vendet arabe, përkundrazi. Kurse Arabia Saudite ka nën influencën e vet Emiratet e Gjirit Persik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana e tyre po e forcojnë Arabinë Saudite, po e armatosin. Kjo, megjithëse popullsinë e ka shumë më të vogël nga Irani, mund të bëhet promotori i bashkimit të të gjithë Gadishullit Arabik në një shtet konfederativ të vetëm, ku të sundojë natyrisht Arabia Saudite dhe pas saj të qëndrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të realizohet me fjalë të tjera, uniteti i dy Jemenëve, të bashkohet me ta edhe Omani, Arabia Saudite, Kuvajti e të tjera, mundësisht të krijohen marrëdhënie me Iranin shumë më të mira nga ato që kanë qenë në kohën e shahut të Pahlevëve. Atëherë Shtetet e Bashkuara të Amerikës e mbështetnin fort shahun e Iranit për ta pasur si një kundërpeshë kundër Arabisë Saudite, kurse tash kjo është bërë vajza më e preferuar e imperializmit amerikan që ia mbyll synë Ajatollah Khomeinit dhe i bën shenjën e afrimit. Sa do t'i arrihet këtij qëllimi, do ta shohim. Sidoqoftë aktualisht, megjithëse vendet e naftës e të OPEK-ut i kanë ngritur shumë çmimet dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me vendet

e tjera kapitaliste janë të detyruara ta pranojnë këtë ngritje çmimesh, derisa të stabilizojnë më mirë gjendjen e turbullt që ekzistonte dhe që u krijua edhe më shumë në Lindjen e Mesme, ky rajon përsëri mbetet si kurdoherë një vatër zjarresh.

E DIEL
15 PRILL 1979

RRETH GJENDJES NË VENDET REVIZIONISTE

Të gjitha vendet revizioniste të Evropës dhe të Azisë, ku në fuqi janë parti pseudokomuniste, gjenden në një falimentim të plotë politiko-ekonomik. Këtë situatë në këto shtete e ka krijuar vetë sistemi i tyre. Koha e shkurtër, brenda së cilës vendet dikur socialiste bënë kthesën e tyre regresive në vende kapitaliste, ka kaluar nga disa faza të turbullta kaotike nëpër të cilat kanë kaluar më përpara edhe vetë vendet kapitaliste, por me kohë ato disi e kanë stabilizuar gjendjen.

Shtetet aktuale revizioniste të Evropës dhe të Azisë u përpoqën të ruanin fasadat dhe të shkatërronin strukturat e superstrukturat e mëparshme. Me fjalë të tjera, kush më shumë e kush më pak, duke u quajtur të gjitha vende socialiste dhe partitë e tyre marksiste-leniniste, u futën në disa labirinte, me qëllim që të shkaktonin çoroditjen e masave të gjera punonjëse dhe të udhëheqjeve të tyre. Udhëheqjeve të këtyre vendeve, sigurisht me pikëpamje borgjeze kapitaliste, për të ruajtur fasadën pseudokomuniste, u është dashur të krijonin një klasë funksionarësh burokratë që t'u shërbenin atyre dhe regjimit që po ndërtonin.

Pra duhej të bënin njëkohësisht edhe seleksionimin e njerëzve dhe shkatërrimin e sistemit të mëparshëm politik, ideologjik, juridik dhe ekonomik. Kjo, natyrisht,

nuk mund të bëhej brenda një dite e as kudo njësoj. Në përgjithësi, në të gjitha vendet revizioniste të Evropës, me Bashkimin Sovjetik në krye, pas ardhjes së hrushovianëve në fuqi, u shpreh dëshira e zjarrtë e një «çlirimi» nga sistemi socialist dhe secili shtet me udhëheqjen e tij iu vu punës me zell për të çarë rrugën drejt kapitalizmit, duke rritur e duke forcuar klasën e re borgjeze revizioniste dhe duke kryer me shpejtësi transformimet ekonomiko-shoqërore.

Natyrisht, të parët, revizionistët sovjetikë me Hrushovin në krye, dhe më vonë pasardhësit e tij me Brezhnjevin, u përpoqën të dominonin mbi të gjitha shtetet e tjera revizioniste në Evropë, pra t'i kishin ato në zap. Duke e ditur se një çështje e tillë ishte e vështirë, ata forcuan në radhë të parë garnizonet e tyre ushtarake të vendosura në këto vende, me fjalë të tjera proceduan drejt pushtimit të vendeve të Evropës Lindore, të ashtuquajtura vende të demokracisë popullore. Vetëm me Shqipërinë nuk e bënë dot një gjë të tillë, megjithëse u orvatën, sepse ajo i dëboi dhe u çori maskën.

Çështja tjetër ishte që Bashkimi Sovjetik t'u imponohej këtyre vendeve për t'i futur në sistemin e vet kapitalist të zhvillimit. Natyrisht, në këtë drejtim gjente pengesa, për arsye të zhvillimit jo të barabartë, mbasi sistemi në të cilin po kalohej ishte një sistem kapitalist, që kishte si objektiv të pasuronte më të madhin në kurriz të më të vegjëlve. Pra, midis këtyre vendeve dhe Bashkimit Sovjetik krijoheshin kontradikta, të cilat sa vinin e thelloheshin. Në përgjithësi ato huazonin mënyrat e drejtimit të ekonomisë në disa sektorë, ngulnin këmbë në shkëmbim eksperience, zhvillonin tregti midis tyre, natyrisht, të pabarabartë, por tendencat centrifugale shtoheshin. Kështu që Bashkimi Sovjetik, si shteti më i madh revizionist, KNER-in, organizatën e përbashkët ekonomike, e transformoi në një mjet për t'u imponuar

vendeve satelite të tij pikëpamjet e veta në zhvillimin e ekonomisë dhe në koordinimin e planeve të prodhimeve e të shkëmbimeve. Me fjalë të tjera u vendos ndarja e punës njëlloj si në një shtet federativ, pa qenë federatë, domethënë të mirat materiale, më të shumtat dhe më të çmuarat, i përkitnin shtetit më të fuqishëm.

Megjithëse e kishte organizuar punën në këtë drejtim, Bashkimi Sovjetik hasi dhe do të haste më vonë në kontradikta të mëdha politiko-ekonomike, prandaj i duhej ta forconte gjendjen e pushtimit. Me fjalë të tjera zinxhirët që u kishte hedhur satelitëve të tij, duhej të forcoheshin më tepër. Për këtë qëllim u gjend mënyra për furnizimin e industrisë së këtyre vendeve me lëndë të para të tilla si, për shembull, me naftë, mineral hekuri, energji elektrike, çeliqe e të tjera, në atë masë që këto, domethënë ish-vendet e demokracisë popullore, të mos kishin një industri të pavarur.

Kështu, nëpërmjet garnizoneve të tij ushtarake të vendosura në këto vende Bashkimi Sovjetik i pushtoi ato ushtarakisht dhe i lidhi pas qerres se vet ekonomikisht. Me këtë u krijuan mundësitë që ai t'u imponontе interesat e veta të zhvillimit të ekonomisë e të shpërndarjes dhe prodhimin e specifikuar për çdo vend. Ai i detyroi këto vende që, para së gjithash, t'i paguanin borxhet Bashkimit Sovjetik me mallra të fabrikuara prej tyre, dhe me çmime më të lira, gjithashtu edhe me prodhime bujqësore.

Një gjendje e tillë, natyrisht, solli varfërimin e vendeve të ish-demokracisë popullore, shtoi zemërimin kundër partnerit të madh ose padronit të tyre, Bashkimit Sovjetik, me të cilin u thelluan kontradiktat e u acarua gjendja, u bë eksplozive, ndonëse akoma nuk po ngjasin shpërthime. Këto me siguri do të dëgjohen më vonë. Megjithëkëtë, kjo situatë nuk e çoi ekonominë e Bashkimit Sovjetik atje ku synohej, pra nuk e bëri të

begatshëm. As gjendjen politike Bashkimi Sovjetik nuk e stabilizoi dot dhe s'mund ta stabilizonte; po kështu edhe çështjen nacionale jo vetëm nuk e forcoi, por përkundrazi e shpartalloi, gjë që i shtoi edhe më tepër kontradiktat në gjirin e popujve sovjetikë.

Bashkimit Sovjetik që kishte marrë tipare të qarta të një superfuqie imperialiste, i duhej t'i vinte një rëndësi të madhe industrisë së rëndë, në dëm të industrisë së lehtë e të bujqësisë, të krijonte një ushtri të madhe, një flotë ajrore dhe detare të fuqishme. Nuk mund t'i mjaftonte atij Evropa Lindore, prandaj duhej të konkurronte Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të krijonte sferat e tij të influencës e të tregtisë edhe në kontinente të tjera. Për t'ia arritur kësaj, i duhej të fuqizohej ekonomikisht dhe ushtarakisht në një shkallë të atillë që në fakt, ishte e pamundur për të në atë kohë.

Kjo rrugë, së cilës i qe futur Bashkimi Sovjetik, e detyroi të kërkonte ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet perëndimore kapitaliste të përparuara. Ishte i detyruar Bashkimi Sovjetik të merrte kredi prej tyre, të lejonte krijimin e shoqërive shumëkombëshe në territorin e vet, të bënte një politikë sipas parimit të «bashkekzistencës paqësore» hrushoviane me kapitalizmin, të hynte në ujdi e në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të krijonte një potencial të atillë që të konkurronte partnerët e tjerë të fuqishëm në pushtimin e tregjeve. Imperializmit amerikan dhe atij botëror u leverdiste që të investonin në këtë rrugë më Bashkimin Sovjetik, të nxirrnin fitime të mëdha për veten e tyre dhe të rritnin, gjithashtu, influencën e tyre në botë, të zinin pikat kyçe dhe të riforconin sistemin neokolonialist, pra, t'i bënin popujt e botës të varur sa më shumë nga kapitali i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që

për këta popuj do të thoshte të humbitnin edhe atë liri, pavarësi dhe sovranitet borgjez që gjoja kishin.

Në këto situata satelitët e Bashkimit Sovjetik u gjendën në vështirësi të mëdha. Ata po e shihnin se interesat dhe sistemi i tyre kapitalist, të cilin po përpëliteshin ta vendosnin, po rrezikoheshin, bile edhe nëpërmjet vetë krijesave të përbashkëta të tyre me Bashkimin Sovjetik, KNER-in dhe Traktatin e Varshavës. Kështu këto vende përpiqeshin të dilnin nga kthetrat e padronit të tyre, Bashkimit Sovjetik socialimperialist, mbasi popujt e tyre nuk mund të sakrifikonin çdo gjë për interesat e një shteti të madh. Prandaj ato kërkuan të merrnin kredi nga shtetet borgjeze kapitaliste dhe nga imperializmi amerikan, i cili i vëzhgonte me kujdesin më të madh këto ndryshime politiko-ekonomike dhe bënte çmos që ta minonte më tej këtë gjendje të krijuar, për favorin e vet. Ai nuk mungoi, pra, që të infiltrohej, bile të depërtonte thellë me kapitalet e tij në të gjitha këto vende duke filluar që nga Polonia e deri te Bullgaria. Kështu influenca e Bashkimit Sovjetik në këto vende mbahej vetëm me forcën e armëve, sepse asnjëfarë simpatie nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë në mes këtyre vendeve e padronit të tyre të madh, përderisa, si në çdo vend kapitalist, edhe në vendet revizioniste ekziston ligji i xhunglës. Vendet e ish-demokracisë popullore fare lehtë, bile që nesër, janë gati të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik dhe të lidhen me kampin perëndimor, në mos të futen në NATO, por në shoqëritë e përbashkëta medoemos, duke u kthyer në neokoloni të kapitalit amerikan dhe perëndimor. Por ato s'lëvizin dot në këtë drejtim, sepse Traktati i Varshavës, kjo mburojë e interesave të socialimperializmit sovjetik, u qëndron mbi kokë duke i kërcënuar vazhdimisht. Kjo është, pra gjendja e Bashkimit Sovjetik në vendet satelite të tij.

Gjendja ekonomike në këto vende është shumë e rëndë, çmimet ngrihen çdo ditë, inflacioni është i madh, ka mungesë prodhimesh bujqësore e industriale. Përpjesëtime të mëdha ka marrë numri i disidentëve të djathtë e ultra të djathtë. Një diktaturë e egër shtypëse rëndon mbi popujt e mbi revolucionarët e këtyre vendeve. Çdo ditë që kalon në këto vende rritet e zhvillohet me vrull degjenerimi në të gjitha fushat, janë përhapur në shkallë të gjerë përdorimi i narkotikëve, krimet, pornografia dhe spiunazhi. Familja, si celulë e shoqërisë, po shkatërrohet, po merr tipare më të dobëta e më të shthurura të familjes borgjeze. Në këtë drejtim një ndihmë të pakursyer japin vetë regjimi dhe kreditorët e mëdhenj të huaj që kanë investuar e po investojnë në këto vende.

Një vend revizionist nga më të çorodituri, nga më të falimentuarit, nga më të degjeneruarit është Jugosllavia titiste, e cila, siç dihet, ka hyrë në rrugën e kapitalizmit kaotik më përpara nga vendet e tjera të ish-demokracisë popullore. Këto të fundit e simpatizonin titizmin, por ishin të detyruara nga orientimi hrushovian të bënin një politikë balancimi ndaj Jugosllavisë. Ne i kemi ndjekur me vëmendje të gjitha këto balancime të politikës së tyre, por kemi ndjekur e demaskuar, gjithashtu, edhe degjenerimin flagrant e total të Jugosllavisë titiste.

Ky vend është një nga shembujt më tipikë të një shteti kapitalisto-revizionist, i cili jo vetëm ka degjeneruar, por është bërë një koloni e vërtetë e imperializmit amerikan dhe e të gjitha shteteve borgjezo-kapitaliste pa përjashtim, është bërë një lypës i ndyrë për çfarëdo ndihme, e çfarëdo natyre nga çdo anë që t'i vijë. E në të njëjtën kohë është përpjekur që jo vetëm ta quante veten vend «socialist», por, për të mbuluar kalbëzimin e vet, është orvatur gjithashtu të krijojë disa teori, të

cilat nuk janë aspak teori të reja revizionisto-kapitaliste, por teori anarkiste, socialdemokrate, të vjetra, që në kohën e armiqve të Marksit, të Engelsit, të Leninit. Megjithatë, grupi titist ruante tiparet e një partie gjoja të vërtetë marksiste-leniniste. Nën këtë maskë nga periudha pas luftës kundër pushtuesve që ishte faza e rreme e një fillimi gjoja të ndërtimit të socializmit në Jugosllavi, u kalua në një fazë tjetër që u quajt faza Tito-Kardel--Rankoviç.

Për të ndërtuar sistemin kapitalist Titoja dhe grupi i tij duhej të likuidonin hovin revolucionar të masave jugosllave, atë hov që e treguan me tërë forcën e tyre në luftën e çlirimit nacional. Për këtë qëllim ata ndërmorën, në radhë të parë, shkatërrimin e Partisë Komuniste. Megjithëse kjo parti kishte bërë gabime në të kaluarën, në kohën e luftës kundër fashizmit ata i dhanë asaj forma organizative të ngjashme me ato të Partisë Bolshevike. Por udhëheqja jugosllave kishte në plan, dhe ia arriti qëllimit, që kjo parti të ndryshonte në drejtimin regresiv, duke u shndërruar në një vegël në duart e sigurimit të shtetit, me fjalë të tjera, kjo parti të ndryshonte ngjyrën krejtësisht dhe, nga një parti qoftë edhe socialdemokrate, se komuniste as që mund të quhej, të bëhej një agjenturë e stërvitur e sigurimit të shtetit të Rankoviçit, i cili të vepronte me lehtësi për likuidimin e komunistëve të vërtetë, për likuidimin e revolucionarëve dhe për vendosjen e diktaturës fashiste, natyrisht të kamufluar.

Titizmi ishte në konflikt me Bashkimin Sovjetik të udhëhequr nga Stalini që në kohën e luftës. Ky konflikt u zgjerua dhe kontradiktat u shtuan pikërisht sepse Partia Komuniste e Jugosllavisë po ndryshonte dhe shteti jugosllav i krijuar pas Luftës së Dytë Botërore po merrte format fillestare të një shteti kapitalist me

karakteristikat e një borgjezie të re, të paformuar akoma, por në formim e sipër. Kjo do të ishte borgjezia serbomadhe, kroatomadhe, e cila ndjenjat shoviniste dhe prepotente që e karakterizonin do t'i zhvillonte në gjithë Jugosllavinë.

Kështu, regjimi i pasluftës në Jugosllavi dhe partia pseudokomuniste jugosllave e cila do të bëhej dhe u bë agjenturë e Inteligens Servisit dhe e imperializmit amerikan, ndërmorën një veprimtari të gjerë, të kamufluar deri diku, për të shkaktuar një të çarë në unitetin socialist që u krijua pas Luftës së Dytë Botërore. Por në një situatë të tillë kur në botë, përveç Bashkimit Sovjetik, u krijuan edhe vende të tjera socialiste, dhe u dallua më mirë orientimi i çdo vendi dhe i çdo partie që quhej marksiste-leniniste, veprimet titiste, lidhjet e titizmit me vendet kapitaliste perëndimore, veçanërisht me anglezët dhe me amerikanët, nuk kishte si t'i shpëtonin syrit vigjilent revolucionar të komunizmit ndërkombëtar.

Grupi titist evoluoi në një situatë të tillë ndërkombëtare të pasluftës, kur forcat kapitaliste perëndimore, imperializmi amerikan dhe imperializmi anglez bënin çdo gjë kundër Bashkimit Sovjetik, e në të njëjtën kohë edhe për të dëmtuar ndërtimin e socializmit në Evropën Lindore dhe në Ballkan.

Kjo situatë, natyrisht, u dha dorë Titos, Kardelit e Rankoviçit për të manovruar në atë drejtim që ishte i favorshëm për imperialistët, pra të përpiqeshin që të bëheshin liderë të këtyre vendeve të Evropës Lindore dhe të Ballkanit, të cilat kishin fituar lirinë, pavarësinë e sovranitetin dhe kishin hedhur themelet e ndërtimit të socializmit. Grupi Tito-Kardel-Rankoviç u përpoq qysh në ditët e para të çlirimit që t'u imponohej të gjitha këtyre vendeve, veçanërisht vendit tonë, duke menduar se, meqë ne ishim një vend i vogël, mund të na shtinte lehtë në dorë.

Titizmi, që në fillim, i përdori për qëllimet e veta situatat e vështira të krijuara në Ballkan. Nën këtë maskë ai tregohej si mbrojtës i vendeve socialiste të Ballkanit, veçanërisht i Shqipërisë, nga pretendimet e monarko-fashistëve grekë. Me këtë pretekst ai u orvat të pushtonte Shqipërinë *manu militari*. Pas Çlirimit ai vendosi me ne edhe marrëdhënie ekonomike, për të cilat ne ishim dakord, mbasi mendonim me sinqeritet se kishim të bënim me një vend që kishte luftuar kundër fashizmit e po ndërtonte socializmin.

Titoja shfrytëzoi, gjithashtu, edhe pikëpamjen e dikurshme të Dimitrovit, i cili para luftës mendonte për krijimin e një Federate Ballkanike, për të cilën pas luftës as që mund të bëhej fjalë. Pra, megjithëse kjo ishte e pamundur, Titoja u përpoq ta përdorte këtë kartë, por nuk i shkoi as te Pushkimi Sovjetik i Stalinit, as te Bullgaria e Dimitrovit dhe as te Partia jonë Komuniste. Klika Tito-Rankoviç e shtoi luftën kundër Shqipërisë, në radhë të parë, duke komplotuar nëpërmjet Koçi Xoxes për të likuiduar Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë sonë Komuniste e shokët e tij dhe për ta bërë Shqipërinë një republikë të shtatë të Jugosllavisë. Më vonë ai intrigoi edhe kundër Bullgarisë.

Kështu Jugosllavia titiste shkoi duke i shtuar zullumet politike e ideologjike deri në vitin 1948 kur u detyruam ta godasim, ta demaskojmë.

Gjoja për t'u mbrojtur nga një invadim sovjetik, siç trumbetonte, gjë që është pa baza, kjo klikë u lidh me padronët e saj të vjetër, me imperializmin anglez dhe atë amerikan dhe në të gjitha fushat, politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake filloi ndërtimin e hapët të kapitalizmit në Jugosllavi. U shkatërrua çdo gjurmë e ndërtimit socialist që mund të kishte mbetur, filloi terrori i madh rankoviçian, filloi gjenocidi kundër shqiptarëve që jetonin në tokat e veta në Jugosllavi. Vërshuan «ndihmat» e mëdha të imperialistëve në këtë vend e investimet nga të katër anët. Mirëpo të gjitha këto kërkonin, që huadhënësit të vinin dorë plotësisht mbi shtetin jugosllav dhe kjo u arrit. Duheshin transformuar krejtësisht struktura dhe superstruktura e Jugosllavisë, duke iu përshtatur nevojave të padronëve neokolonialistë, gjë që edhe kjo u arrit. Kështu, pas një peripecie, pas dallaveresh të shumta, pas intrigash, fjalimesh, diskuresh demagogjike të Titos e të shokëve të tij dhe pas shkëmbimeve të delegacioneve të shumta me vendet kapitaliste, u arrit më në fund që të mëkëmbej njëfarë kapitalizmi kaotik në Jugosllavi, i cili nuk i përngjiste edhe shtetit më të dobët kapitalist. Megjithatë u krijua një borgjezi e re e fuqishme, e mbështetur në një diktaturë fashiste të fortë, e cila e shfrytëzonte sistematikisht popullin. Tri të katërtat e «ndihmave» të investitorëve venin në favor të rritjes dhe të forcimit të pasurisë private të borgjezisë së re jugosllave. U likuidua në Jugosllavi prona e përbashkët shtetërore, në qoftë se kishte, dhe iu dha zhvillim legal pronës private dhe pronës shtetërore kapitaliste.

Me ardhjen e hrushovianëve në fuqi, natyrisht dhe me autokritikën që bëri ndaj Titos, Hrushovi, i cili me peripecitë e tij klouneske e ndihmoi Titon t'i ngrihej nami, Kardeli me Titon sajuan teorinë e vetadministrimit jugosllav, domethënë legalizuan kapitalizmin, shoqërinë borgjeze kapitaliste në Jugosllavi. Këtë e kemi sqaruar në librin ««Vetadministrimi» jugosllav — teori dhe praktikë kapitaliste».

Aktualisht ne konstatojmë se në Jugosllavi është një rrëmujë e madhe, ku «nuk e njeh qeni të zonë», siç thotë populli. Titoja po çahet andej-këndej për të mbjellë njëfarë uniteti, të cilin s'mund ta arrijë kurrë, sepse atje nacionalitetet e ndryshme të republikave që

formojnë Federatën Jugosllave janë në luftë të vazhdueshme, që sa vete e rritet. Disa duan të thonë se vetëm ekzistenca e Titos i mban ata në fre, gjë që nuk është e vërtetë. Nuk mund të mohohet që Titoja ka njëfarë autoriteti, por në të vërtetë janë diktatura fashiste dhe forcat e ushtrisë dhe të UDB-së ato që veprojnë me terror në Jugosllavi dhe mbajnë frerët. Aktualisht investitorët i kanë forcuar mjaft pozitat e tyre brenda klanit borgjezo-kapitalist jugosllav. Atje tani janë krijuar klane të ndryshme proamerikane, profranceze, proruse e çfarë të duash. Këto veprojnë si e si të forcojnë pozitat e tyre.

Megjithëse pozitat e shteteve imperialiste, nuk janë për t'u neglizhuar, duhet thënë se Jugosllavia e sotme është vazhdimi i Jugosllavisë së regjimeve monarkiste serbokroate, te të cilat ka ekzistuar ndjenja e përçarjes dhe e unitetit, domethënë ndjenja e përçarjes në mes serbëve dhe kroatëve dhe ndjenja e ruajtjes së unitetit të republikave nën drejtimin hegjemon të njërës prej këtyre kombësive. Kështu që çështja e brendshme luan dhe do të luajë vazhdimisht një rol vendimtar, pavarësisht se ç'bluan propaganda e jashtme kapitaliste. Shumë shpresa vihen në klanet, e të tëra klanet i vënë shpresat e tyre dhe mbështeten te Titoja, i cili është një moderator i falimentuar dhe aventurier.

Sa për influencat e ndryshme që mund të ketë Perëndimi ose Lindja mbi Jugosllavinë, për fatet e këtij vendi gjoja të unifikuar në një Federatë, kjo është një çështje tjetër, që varet, siç e theksova, më parë nga situata brenda vendit sesa nga rrethanat e jashtme.

Por aktualisht, në ngrysjen e jetës së Titos, bëhen shumë spekulime. Perëndimi propagandon çdo ditë se Bashkimi Sovjetik do ta gllabërojë Jugosllavinë, të tjerët thonë se do të jenë anglo-amerikanët ata që do të vendosin influencat e tyre në Jugosllavi pas Titos.

Perëndimi për hesapet e tij i bën shumë propagandë «influencës» së Bashkimit Sovjetik në Jugosllavi pas vdekjes së Titos. Ai nuk mungon të vërë në majë të gjilpërës, për ta parë i gjithë opinioni, se Bashkimi Sovjetik po bën manovra të mëdha e të vogla, se po bën lëvizje trupash në kufirin hungarez, çekosllovak, bullgar, se prapa rivendikimeve të Bullgarisë mbi Maqedoninë gjendet Bashkimi Sovjetik, se ky ka një influencë të madhe të vjetër në Serbi, se klanet serbe të eliminuara nga klani i Titos janë pro Bashkimit Sovjetik, se po zëvëndëson trupat e tij në vendet e Traktatit të Varshavës me trupa të rinj, se ato kanë një kohë të gjatë që po vërtiten nëpër këto garnizone të posaçme e të tjera. Të gjitha këto krijojnë në botë dhe në Ballkan një situatë të acaruar që në realitet nuk mund të themi se është një fokus nga të dyja anët. Por nuk është dhe aq e lehtë të ndodhë ashtu siç e paraqet Perëndimi, që thotë se gjoja Bashkimi Sovjetik nuk pret veçse vdekjen e Titos për të sulmuar Jugosllavinë.

Sipas mendimit tim, Perëndimi e bën një propagandë të tillë për të vënë në dukje, gjë që është e vërtetë, frymën ekspansioniste të influencës sovjetike në Ballkan dhe në vende të tjera. Veçse lëvizjet e trupave të rinj të Traktatit të Varshavës, ose manovrat e trupave sovjetikë në vendet e Evropës Lindore, që janë satelite të tij, nuk bëhen të gjitha për të sulmuar Jugosllavinë, por bëhen po ashtu për t'i pasur më mirë në zap këto vende dhe për të përforcuar frontin që ka Traktati i Varshavës me NATO-n.

Partnerët e NATO-s, natyrisht, flasin për potencialin e madh ushtarak të Bashkimit Sovjetik e nuk thonë se ai bëhet kërcënues për NATO-n, por e paraqesin si rrezik kërcënues vetëm për Rumaninë dhe për Jugosllavinë, natyrisht edhe për Shqipërinë, sido që

nuk flitet shumë nga ana e tyre për vendin tonë. E gjithë kjo zhurmë shurdhuese që bëhet nga perëndimorët ka për qëllim t'u futë frikën edhe popujve të vendeve të Evropës që janë anëtare të Traktatit të NATO-s, por gjithashtu edhe popujve të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, të cilëve u thonë se Bashkimi Sovjetik, pas vdekjes së Titos, do të ndërhyjë *manu militari* në Ballkan. Kështu zotërinjtë e NATO-s hiqen sikur kjo ndërhyrje ushtarake e Bashkimit Sovjetik nuk i prek interesat e aleancës së tyre agresive. Është e qartë se ky është një blof. Në realitet të dyja superfuqitë armatosen më së miri me bomba atomike e me hidrogjen bile edhe me neutron, dhe Ballkani është një pikë nevralgjike për të dyja palët siç mund të jetë, gjithashtu, edhe një pikë neutrale. Unë mendoj se hyrja e Bashkimit Sovjetik në Jugosllavi do të thotë që në të njëjtën kohë të hyjë në luftë edhe me NATO-n.

Por propaganda shurdhuese e Perëndimit në këtë çështje, natyrisht, bën efekt të madh në popujt jugosllavë, në popujt e tjerë të Evropës dhe në popujt e botës, që i kanë mbuluar frika e një lufte atomike, kriza e madhe ekonomike e superprodhimit dhe kriza e përgjithshme në çdo pikëpamje. Pra një zhurmë të tillë luftëdashëse borgjezia e vendeve perëndimore e bën për të kaluar vështirësitë kolosale që po hasin të gjitha vendet kapitalisto-revizioniste në këto momente tragjike për to, për pushtetin e tyre, për ekonominë e vet, për qenien e tyre si shtete kapitalisto-revizioniste dhe imperialiste. Pra, kjo më tepër është përgatitje e një lufte imperialiste, një psikozë lufte sesa një përgatitje ndaj një eventualiteti të mundshëm dhe qind për qind të një sulmi sovjetik mbi Jugosllavinë.

Është e kuptueshme që udhëheqja e Jugosllavisë e falimentuar katërcipërisht, e këtij vendi që ka një

deficit vjetor prej 4 miliardë dollarësh, është futur deri në grykë në borxhe, aq sa Titoja është bërë «specialist» për të vëzhguar lëvizjen e buzëve ose të vetullave të njërit udhëheqës apo të tjetrit. Kur Brezhnjevi buzëqesh nga pak, atëherë Titoja thotë se marrëdhëniet midis Jugosllavisë e Bashkimit Sovjetik po përmirësohen, ndërsa kur ai mbledh vetullat e trasha, Titoja thotë se marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik janë acaruar. Kjo taktikë nga ana e tij është bërë një politikë shfrytëzimi, një politikë lakei dhe një politikë zhvatjeje kredish ose shtytje afatesh të kredive nga kreditorët anglezë e amerikanë, francezë, gjermanoperëndimorë dhe sovjetikë.

Titoja, natyrisht, përpiqet me mjeshtëri që sa është gjallë të përfitojë nga kjo situatë dhe të bëjë përpjekje për të forcuar diktaturën fashiste e ushtrinë, që, kur të vdesë, atëherë kur nuk do të ndihen më dora dhe mendja e tij e djallëzuar, të ekzistojë dora e fortë e ushtrisë fashiste që t'i vërë në zap ata që do të përpiqen të marrin pushtetin, të cilët aktualisht janë kundër Titos, ose të dijë të manovrojë me të dyja superfuqitë.

Këto situata, pra, janë si me thënë të organizuara, të koordinuara, të sistemuara. Që Bashkimi Sovjetik revizionist ka qëllime të ketë në Jugosllavi një udhëheqje pro tij, kjo nuk ka asnjë diskutim, por duhet pasur parasysh se tash Bashkimi Sovjetik revizionist nuk ka asnjë udhëheqje revizioniste të klanit të vet që të jetë besnike ndaj tij. Bile edhe Zhivkovi i Bullgarisë, që është shërbëtori më i bindur i revizionizmit sovjetik, në një përqindje të ndjeshme nuk e pranon grushtin sovjetik.

Duke marrë parasysh këtë situatë kuptohet se është larg që Bashkimi Sovjetik të ketë atë influencë që mendojnë disa se ai e ka në Jugosllavi, veçanërisht në Serbi e në Mal të Zi; këto janë mbeturina të pikëpa-

mjeve të vjetra pansllaviste, pikëpamjet e vjetra cariste në një periudhë historike të caktuar për mbrojtjen e sllavëve të jugut, për t'u dhënë pseudopavarësinë këtyre popujve, duke i çliruar nga Turqia. Çlirimi nga Turqia për carët rusë ishte t'i ngulte thikën «të sëmurit të Bosforit».

Nuk mund të themi se në ato kohë nuk ekzistonin një simpati e një miqësi e madhe në mes rusëve dhe serbëve e malazezëve. Por kohët ndryshuan. Jugosllavia e Karagjorgjeviçëve ishte më tepër properëndimore, ishte shumë më afër Francës së Klemansoit, të Puankaresë etj. Bile ishte ajo Francë dhe ajo qeveri që erdhën pas Traktatit të Versajës, ishte ai ministër i Jashtëm Bartu, i cili ra, tok me Aleksandrin e parë Karagjorgjeviç, në rrugët e Marsejës nga një atentat i terroristëve kroatë, që krijuan mbretërinë serbokroate dhe i dhanë Serbisë prioritetin dhe predominencën mbi Jugosllavinë ku jetonin popuj të ndryshëm, të cilët i lidhën sipas qejfit të fituesve të Luftës së Parë Botërore.

Kjo mbretëri e Karagjorgjeviçëve që u krijua pas Luftës së Parë Botërore dhe vazhdoi si një mbretëri që robëronte popuj të ndryshëm, pas Luftës së Dytë Botërore u shndërrua në një mbretëri të re me forma të reja konstitucionale, ndonëse s'u quajt më mbretëri e Karagjorgjeviçëve, por u emërtua Federata Demokratike Popullore e Jugosllavisë. Në krye të saj ishte gjoja një parti komuniste me udhëheqës njëfarë Titoje, «i deleguar» i Kominternit, i cili kishte likuiduar fraksionin e Gorkiçit dhe ishte emëruar sekretar i përgjithshëm i partisë.

Kjo Jugosllavi, natyrisht, si të gjitha vendet e tjera në atë kohë, kaloi nëpër Luftën e Dytë Botërore, e cila i shkaktoi asaj gjakderdhje të madhe. Popujt e Jugosllavisë e panë se fitorja e tyre kundër nazizmit, kundër italianëve, kundër bullgarëve të Borisit, u arrit me

luftë e jo vetëm me luftën e tyre, por edhe me ndihmën e Ushtrisë së Kuqe të Stalinit, për të cilin kishin një dashuri dhe respekt të madh, njëkohësisht edhe me luftën e popujve të tjerë, me luftën e anglezëve, me rezistencën dhe me luftën nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe me rezistencën e popujve të tjerë. Kjo, mendoj unë, ka lidhje me pikëpamjet që u krijuan gjatë luftës në Jugosllavi, pikëpamje të cilat, natyrisht, forcuan ndjenjën e përgjegjësisë së këtyre popujve si shtet dhe si Federatë.

U krijuan te këta popuj, po ashtu, konceptet e fillimit mbi lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e Federatës, koncepti i aleancave me Bashkimin Sovjetik të Stalinit dhe me perëndimorët. Por, siç e theksova edhe më parë, kjo situatë evoluoi në udhëheqjen e Jugosllavisë, evoluoi në çuarjen e këtij vendi drejt rrugës kapitaliste, në shndërrimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në një parti vegël dhe në shërbin të sigurimit të shtetit jugosllav, derisa më në fund grupi Tito-Kardel-Rankoviç, e orientoi politikën e Federatës Jugosllave më shumë drejt Perëndimit sesa drejt Bashkimit Sovjetik stalinian.

Kështu që prej një kohe të gjatë ajo e quajtura simpati dhe miqësi, ose influencë pansllave, që pretendojnë sociologët e historianët perëndimorë dhe sovjetikë, nuk ekziston në Jugosllavi, është larg, shumë larg ai mentalitet i vjetër pansllav, prorus, pra është e zorshme, për të mos thënë e pamundur, që kjo të jetë vendimtare pas vdekjes së Titos. Unë mendoj se ky është një blof i kurdisur me qëllim nga të gjitha palët, përkundrazi, gjatë gjithë kësaj periudhe, në Jugosllavi është krijuar një mentalitet tjetër antirus.

Kjo nuk ekskludon një sulm nga ana e sovjetikëve mbi Jugosllavinë, flas për sulm të armatosur, sepse një sulm psikologjik, politik, një sulm ekonomik nuk

ka munguar as me Titon gjallë, ai ka ekzistuar dhe vazhdon të ushtrohet pa ndërprerje. Se sa e fortë do të jetë kjo influencë për të krijuar në udhëheqjen e Federatës Jugosllave një klan prosovjetik dhe antiperëndimor, ky për mua është një problem, zgjidhja e të cilit është kjo: ky klan do të humbasë.

Por edhe në qoftë se në fuqi vjen një klan i tillë kundër klanit titist, kroat dhe slloven, domethënë në qoftë se vjen në fuqi një klan serb biçim Rankoviçi, Popoviçi, Nikeziçi e të tjerë, ai do të përpiqet ta ruajë Federatën, t'u japë serbëve epërsinë dhe hegjemoninë mbi gjithë Jugosllavinë, t'i japë njëfarë pjesëmarrjeje të vogël pa zarar, në këtë fuqi, kroatëve dhe sllovenëve, por jo të bëhet koloni e rusëve. Jugosllavia nuk bëhet koloni e Rusisë brezhnjeviane ose e çfarëdo Rusie që të jetë. Për këtë jam i bindur.

Jugosllavët janë shovinistë, dhe tash që ky shovinizëm ka marrë përpjesëtime të mëdha, nuk pranojnë mbi kokë një shovinizëm të ri më të fuqishëm dhe as e ndiejnë veten inferiorë përpara shovinizmit sovjetik revizionist. Përkundrazi, ata e ruajnë shovinizmin serbokroat dhe do t'i shtypin popujt e republikave të tjera të Jugosllavisë. Por ky shovinizëm është i pleksur njëkohësisht me një kozmopolitizëm perëndimor, me një mënyrë jetese perëndimore. Udhëheqja aktuale dhe e ardhshme e Jugosllavisë është e do të jetë e degjeneruar dhe përpjekjet e saj për të dominuar do të mbështeten në një aleancë më tepër perëndimore, sepse interesat e saj do të jenë më të mëdha, duke pasur shanse më shumë që të jenë si me thënë me një liri e pavarësi të rreme, por jo nën thundrën e Ivanit shovinist rus.

Prandaj udhëheqja e ardhshme, qoftë serbe, qoftë kroate, qoftë serbokroate, nuk do ta ulë kurrizin përpara sovjetikëve. Ajo mund të bëjë një politikë të balancuar, mund t'u buzëqeshë edhe njërit, edhe tjetrit, duke vazh-

duar të zhvatë njëkohësisht edhe njërin, edhe tjetrin, por nuk do t'i shesë lirinë dhe pavarësinë false, ashtu siç i shiti në kohën e Aleksandrit të parë Karagjorgjeviç, i cili kërkoi nga qeveria franceze që ajo ta ndihmonte për të dominuar mbi Kroacinë, ose do të jepte dorëheqjen, duke bërë kështu që qeveria franceze të kontraktonte aleancë me mbretërinë serbokroate dhe kroatët t'i nënshtronte ndaj serbëve.

Këto situata e ndodhi të mundshme, që unë parashikoj të ngjasin në Jugosllavi, mund edhe të mos jenë kështu, por konkludoj duke gjykuar mbi bazat që i njoh. Mbi këto baza, mendoj se, pas vdekjes së Titos, ka mundësi që në Jugosllavi, të ketë lëvizje, por kjo lëvizje në vitet e para do të jetë një përpëlitje, si me thënë, për të tatuar terrenet. Disa mendojnë se vdekja e Titos do të jetë fatale, se, pa u futur akoma trupi i tij në gropë, Jugosllavia do të ndizet zjarr. Unë mendoj se kjo nuk është reale. Titoja që e ka kuptuar fare mirë falimentimin e regjimit të tij, ka marrë dhe po merr masa; ai shpreson në format e strukturës që ka krijuar, të cilat po i ndryshon herë pas here. Bile tash ai ka krijuar sistemin e drejtimit kolegjial ku presidenti i republikës nuk duhet të qëndrojë më tepër se një vit në fuqi. Por, përveç këtyre, Titoja ka menduar, sidomos, për diktaturën, e cila të paktën në vitet e para nuk do të lejojë një shpërthim në Jugosllavi, jo vetëm shpërthim nga jashtë, por edhe nga brenda. Popujt e ndryshëm që formojnë Jugosllavinë, natyrisht do të lëvizin, por me kujdes dhe do ta ndiejnë veten të pasigurt. Atyre do t'u duhet njëfarë kohe për të manovruar dhe për të forcuar rezistencën e tyre në një drejtim ose në një drejtim tjetër.

Pra në të njëjtën mënyrë fuqitë e mëdha imperialiste, qoftë Bashkimi Sovjetik, qoftë anëtaret e NATO-s nuk do të hyjnë përnjëherë me lugët në brez në supën jugosllave. Secili prej tyre do të forcojë pozitat e veta

brenda, do të forcojë, natyrisht, edhe pozitat jashtë, përpara një sulmi eventual të papritur mbi Jugosllavinë. Prandaj në këtë çështje ato do ta shikojnë njëri-tjetrin, siç thotë francezi, *«en chiens de faïence»*.

Bëhet shumë zhurmë aktualisht për rivendikimet bullgare mbi Maqedoninë. Ky është një problem akut. Jugosllavët e bëjnë këtë akoma më akut, bullgarët ca më tepër, të shtyrë nga rusët. Pra, pas dy vjetësh mund të acarohen situatat, mundet që Bullgaria të bëjë orvatje, dhe kjo s'i kushton gjë rusit ta shtyjë këtë gur shahu, bile edhe në veprime luftarake, ta shtyjë përpara dhe ta tërheqë, pra ta tatojë pulsin jo vetëm brenda në Jugosllavi, por edhe pulsin e opinionit ndërkombëtar. Megjithatë, në të dyja çështjet sovjetikët nuk mund të luajnë me zjarrin dhe nuk mund të zhvillohet një luftë e pjesshme në mes Bullgarisë dhe Maqedonisë. Lufta do të jetë midis Traktatit të Varshavës dhe Jugosllavisë, mundet edhe NATO-s, por me Jugosllavinë medoemos, e cila nuk do të lejojë që të sulmohet Maqedonia. Unë kam bindjen se ajo do të hyjë në luftë në rast të një agresioni, qoftë në Maqedoni, qoftë në anët e tjera të kufijve të Jugosllavisë.

Natyrisht, një veprimtari e tillë e sovjetikëve është shumë e rrezikshme për ta dhe për botën, opinioni botëror do të ngrihet në këmbë, siç u ngrit për Çekosllovakinë. Populli çekosllovak dhe udhëheqja e tij nuk hodhën asnjë pushkë, kurse unë kam bindjen se në Jugosllavi do të luftohet këmba-këmbës dhe nuk do të lejohen brezhnjevianët sovjetikë të hyjnë në tokën jugosllave pa u gjakosur mirë me popullin jugosllav. «Armikun mos e duaj, por pjesën ia ruaj», thotë populli ynë. Është fakt se populli jugosllav është popull trim dhe udhëheqja revizioniste jugosllave nuk do t'i nënshtrohet sulmit sovjetik, siç bëri udhëheqja çekosllovake.

Për sa u përket shqiptarëve që jetojnë në trojet e

veta në Jugosllavi, në një rast të tillë, në rast se sovjetikët do të sulmojnë, jemi të sigurt se do të ngrihen e do të luftojnë... Ne nga ana jonë, jemi dhe do të jemi kurdoherë në gatishmëri për të mbrojtur atdheun tonë dhe për të ndihmuar Jugosllavinë në luftën e çlirimit kundër të njëjtit armik, ashtu siç e kemi deklaruar.

E ENJTE
26 PRILL 1979

TEORIA E «BOTËS SË PAANGAZHUAR» PO FALIMENTON

Teoria e «botës së paangazhuar», e kësaj bote që renegati i marksizëm-leninizmit dhe agjenti i imperializmit botëror, Titoja, përpiqet ta udhëheqë, po falimenton kokë e këmbë. Siç kam shkruar në shkrimet e mia edhe më përpara, kjo pseudoteori ose pseudopolitikë që kanë ndjekur Naseri, Nehruja, Sukarnoja, Titoja e ndonjë tjetër, ka pasur për qëllim që imperializmi të ruante dominimin e vet politik, ekonomik dhe ushtarak mbi vendet e vogla, të kontinenteve të ndryshme të cilat pas Luftës së Dytë Botërore dolën nga kolonializmi shumëvjeçar dhe u futën nën një zgjedhë të re neokolonialiste nga imperialistët amerikanë dhe imperialistët e tjerë nën pretekstin e dhënies atyre të njëfarë lirie e pavarësie të rreme.

Këta agjentë të imperializmit, natyrisht, e shpikën këtë krijesë, teorinë e «botës së paangazhuar», për t'u dhënë përshtypjen popujve të atyre vendeve, ku sundonin klika borgjezo-kapitaliste, se këto shtete ishin çliruar, ishin gjoja me të vërtetë të pavarura dhe pra edhe popujt ishin gjoja të lirë e të pavarur. Me fjalë të tjera, kjo agjenturë ndërkombëtare e imperializmit mori përsipër të ruante atë statukuo që krijuan pas Luftës së Dytë Botërore, për interesat e veta të mëdha, imperializmi amerikan kryesisht dhe shtetet e tjera kapitaliste si Anglia, Franca etj.

Natyrisht u gjend edhe termi i përshtatshëm për këto vende. Ato u quajtën «të pavarura». Po nga kush ishin të pavarura? Nga shtetet e tjera që në të kaluarën kishin bërë ligjin mbi to, domethënë nga shtetet imperialisto-kapitaliste. Por a ishin me të vërtetë të pavarura këto vende? Në asnjë mënyrë nuk ishin e nuk kishte se si të ishin, për arsye se ekonomikisht qenë krejtësisht të dobëta. Ato nuk mund të rronin të pavarura dhe s'mund të quheshin të tilla në atë formë shtetërore borgjeze të sapokrijuar me forcat e tyre, të dala nga një kolonializëm i egër.

Për sa i përket pavarësisë politike, për shumë nga këto shtete, as që mund të flitej, për arsye se politika e këtyre shteteve pseudo të pavarura, jo vetëm ishte një politikë borgjeze kapitaliste e bazuar në struktura akoma të paformuara të borgjezisë industriale ose uzurare, por shumë prej tyre ishin akoma në feudalizëm, akoma nën regjimin e vjetër të tribuve. Pra, nga ana politike ato nuk kishin asnjëfarë pavarësie. Udhëheqësit e këtyre vendeve, natyrisht, ishin kapitalistë dhe kapitalizmi i vuri në fuqi ata, u dha njëfarë kushtetute, duke përcaktuar një rend politiko-ekonomik dhe kështu vende të tilla mbetën të varura nga politika e imperializmit amerikan ose e zonave të sterlinës dhe e zonave të frangut.

Natyrisht gjatë viteve të pasluftës këto shtete, të krijuara nga kolonializmi, i cili nuk mund të mbahej më në këmbë në ato forma dhe me ato struktura shtypjeje e shfrytëzimi, do të pësonin disa evolucione. Evolucionet në këto vende, bëheshin sipas interesave të padronëve të tyre të vërtetë, të cilët, në mënyrë të hapët ose të tërthortë, drejtonin jetën e tyre nëpërmjet klikave në fuqi, nëpërmjet shoqërive ekonomike, koncesioneve ekonomike ose specialistëve të degëve të ndryshme dhe synonin të ndryshonin, herë pas here, liderët e këtyre shteteve gjoja të pavarura.

Mirëpo këto evolucione shoqëroheshin me një shfrytëzim të madh, edhe më të egër nga ai i mëparshmi, për arsye se pasuritë e mbitokës dhe të nëntokës së këtyre vendeve në kontinente të ndryshme filluan të shfrytëzohen më egërsisht, më barbarisht, me metoda më moderne. Kolonizatorët e specializuar u bënë kolona kryesore, të cilët i përdorën autoktonët (vendasit) si punëtorë të thjeshtë. Ata që bëheshin vegël e tyre, i dërgonin nëpër shkolla e në universitete në metropol. Ky instruktim i tyre, sidoqoftë, edhe në këto vende solli një frymë disi të ndryshme nga regjimet shtypëse koloniale të mëparshme. Zhvillimi u hapi sytë shumë prej njerëzve të inteligjencies së re, të cilët filluan të gjykonin mbi format dhe metodat që përdoreshin për shtypjen dhe për shfrytëzimin e popujve të tyre.

Kështu që neokolonializmi, me gjithë shtypjen, solli edhe njëfarë zgjimi disi më të madh në këto shtete të reja të kontinenteve të ndryshme. Kjo bëri që përkrah organizatave të mëdha ndërkombëtare, siç ishte Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe degët e saj të ndryshme, të specializuara, të krijoheshin edhe organizata të tjera ndërkombëtare, gjoja për mbrojtjen e interesave të një grupi shtetesh në Afrikë, ose të shteteve arabe etj. Kjo gjë krijoi një gjendje disi më të vështirë për neokolonialistët, mbasi kërkesat u bënë më të theksuara e këtyre, medoemos, u duhej bërë ballë, u duhej bërë ballë brendapërbrenda, gjithashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Përpara opinionit botëror duhej krijuar e forcuar përshtypja se këto shtete pseudo të lira e sovrane ishin me të vërtetë të lira e sovrane, se gjoja kishin të drejtë ta thoshin fjalën e tyre në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në organizata të tjera të ndryshme ndërkombëtare. Por historia e gjithë periudhës, që nga krijimi i tyre e deri sot, tregon se në Organizatën e Kombe-

ve të Bashkuara, për shembull, të gjitha këto shtete të ashtuquajtura të pavarura votonin në bllok me imperializmin amerikan. Me dekada të tëra u duk qartë që këto shtete, të ashtuquajtura të pavarura, ishin krejtësisht të varura nga imperializmi amerikan, nga Franca, nga Anglia dhe nga shtetet e tjera kolonialiste, aq më tepër kur në këto organizata u pranua edhe Gjermania e Bonit, edhe Japonia militariste e mikados etj.

Brenda secilit prej këtyre vendeve, natyrisht, duheshin përballuar revoltat e masave të gjera, antagonizmat që krijoheshin në mes shfrytëzuesve të huaj e vendas që pasuroheshin dhe popujve të këtyre vendeve që shtypeshin, i duhej bërë ballë polarizimit të brendshëm. Natyrisht, borgjezia përdori taktikën e saj të vjetër; kështu në këto vende u krijuan parti të ndryshme me programe të ndryshme që përfaqësonin shtresa ose klasa të caktuara, parti që kishin organet e tyre të shtypit, ku shfaqnin opinionet politike. Në këto vende bëheshin zgjedhje gjoja demokratike, krijoheshin parlamente, bëheshin mbledhje të pambaruara, por asgjë nuk ndryshonte, çdo gjë bëhej për të forcuar klikat në fuqi dhe padronin e tyre të madh që kishin mbi kokë.

Lindën kontradikta të mëdha midis këtyre shteteve të ndryshme të sajuara, dolën rivendikime tokësore, gjë që do të thotë se kufijtë midis tyre nuk ishin caktuar drejt, bile këto shtete midis tyre shfaqën edhe pretendime territoriale dhe arritën deri aty sa t'i shpallin edhe luftë njëri-tjetrit. Borgjezitë kapitaliste të këtyre vendeve, të mbështetura nga fuqitë e ndryshme imperialiste, nxitnin luftërat lokale midis shteteve për të zgjeruar pushtetin dhe fitimet e tyre, me qëllim që t'i siguronin padronit të vet ato pozita kyçe, që rrezikoheshin nga kundërshtari i tij politik e sidomos ekonomik.

Pra gjatë gjithë kësaj periudhe në formacionin e këtyre shteteve gjoja të pavarura, që ishin nën sundimin

e neokolonializmit, nën sundimin e klikave kapitaliste borgjeze të shitura dhe të varura nga kapitalizmi ndërkombëtar, u krijuan situata të tilla, që kërkonin të gjendeshin forma më të reja, domethënë më të rreme, më të alambikuara, më të sofistikuara, për shfrytëzimin maksimal të pasurive të këtyre vendeve dhe për zhdukjen sa më shpejt dhe sa më mirë të tendencave e lëvizjeve liridashëse dhe revolucionare të popujve të tyre.

Pra, në këto situata ne shohim që grupi i Tito-Nehru-Naserit e të tjerëve krijoi këtë farë organizate të vendeve «të paangazhuara», që gjoja nuk kishte formë organizative, por kishte si parim çështjen e mospjesëmarrjes në organizatat ushtarake që kishte krijuar imperializmi amerikan dhe në Traktatin e Varshavës që e krijoi Bashkimi Sovjetik për t'u mbrojtur, e që më vonë, me ardhjen e hrushovianëve në fuqi, u bë një traktat agresiv. Natyrisht, gjatë kësaj kohe, gjatë kësaj periudhe dekadash, imperializmi amerikan krijoi baza dhe flota ushtarake në vende të tjera, krijoi konsorciume, monopole, shoqëri të mëdha të përbashkëta, zhvilloi flotën e madhe oqeanike. Gjithashtu zhvilloi armët moderne atomike e konvencionale dhe, tok me krijimin e bazave tokësore, detare e ajrore në territore të vendeve të tjera dhe me forcimin e tyre me trupa amerikanë, armatosi shtetet që kishte nën drejtimin e vet si dhe udhëheqjet e këtyre shteteve, pse vetëm kështu imperializmi amerikan do t'i bënte ballë socialimperializmit sovjetik që kërkonte rindarjen e botës, do t'i bënte ballë hovit revolucionar të masave punonjëse të varfëruara e të mjeruara të kontinenteve të ndryshme, të inkuadruara në shtete me një regjim neokolonialist. Këta popuj, gjoja të pavarur, ai do t'i shfrytëzonte nga ana ekonomike nëpërmjet ndihmave dhe shoqërive të përbashkëta, kredive që jepte e investimeve që bënte në to.

Përveç NATO-s imperializmi amerikan krijoi edhe

organizata të tjera si SEATO-n, SENTO-n etj., për t'u bërë ballë njëkohësisht edhe socialimperializmit sovjetik hrushovian, por edhe revolucionit që mund të përgatitej, të merrte frymë e gjallëri dhe të shpërthente në shtetet që shtypeshin me forma të reja.

Titoja, që mbeti gjallë pas vdekjes së gjithë liderëve të vendeve aziatike dhe afrikane, natyrisht, me ndihmën e teoricienëve e të dollarit amerikan, u përpoq që t'i jepte njëfarë forme organizative kësaj «lëvizjeje të të paangazhuarve», t'i jepte njëfarë baze teorike, të përcaktonte qëllimet e kësaj lëvizjeje të pakufi, pa kokë, pa këmbë, pa zemër. Me fjalë të tjera, Titoja, me ndihmën e amerikanëve, u përpoq dhe përpiqet që këtë lëvizje ta quajë organizatë. Më në fund ai arriti të krijojë një komitet ekzekutiv të kësaj organizate, i cili mblidhet herë pas here dhe bën muhabete e llogje, që nuk kanë asnjë vlerë dhe s'hapin asnjë perspektivë për këto vende, të cilave nuk u jepet as minimalja që kërkojnë, megjithëse lëmoshat vazhdojnë t'u jepen sipas interesave të fuqive imperialiste që kanë influencë në këto vende të ndryshme, në këtë stan lepujsh që ka grumbulluar Titoja.

Në punën e tij për ta bërë operuese këtë organizatë të vendeve «të paangazhuara» Titoja ka marrë shumë kredi, bile kolosale, për Jugosllavinë. Këto kredi jo vetëm e kanë bërë Titon gjoja liderin e vërtetë të vendeve «të paangazhuara», por edhe Jugosllavinë e kanë bërë prototipin e një vendi të falimentuar në organizimin shtetëror, politik dhe ekonomik. Jugosllavia është një nga vendet prototipe ku ekziston një diktaturë fashiste e kamufluar me gjoja liri demokratike, me të drejtat e njeriut ashtu siç pretendojnë se i kanë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mirëpo në Jugosllavi kush ngre krye kundër klikës në fuqi, futet përnjëherësh në burg.

Po t'i hedhim një sy gjendjes aktuale të vendeve «të paangazhuara», shohim se kjo është jashtëzakonisht e

çoroditur dhe e çorganizuar. Ajo nuk ka qenë kurrë e organizuar, por edhe atë formë të lehtë organizimi që kishte mundur të krijonte imperializmi me Titon, edhe ajo po thërrmohet. Në fakt vendet që bëjnë pjesë në këtë të ashtuquajtur organizatë, nuk janë dakord as për mbledhjen e të ashtuquajturit komitet ekzekutiv, ose mbledhja e përfaqësuesve të vendeve «të paangazhuara», jo vetëm për qëllimet e mbledhjes, por as për vendin se ku duhet të bëhet mbledhja, për arsye se grupe të ndryshme shtetesh, por edhe shtete të veçanta të këtij grupimi janë në grindje, janë në luftë, janë në kontradikta të mëdha me njëri-tjetrin, janë në kontradikta gjithashtu me shtetet imperialiste që mbështetin njërin apo tjetrin grupim.

Le t'i shikojmë pak më konkretisht këto grindje, këto mosmarrëveshje, në këtë farë grupimi të vendeve «të paangazhuara». Vendet arabe, që bëjnë pjesë në vendet «e paangazhuara», janë çorbë. Egjipti, një nga vendet «e paangazhuara», është në konflikt gati me të gjitha vendet e tjera arabe, për arsye të Traktatit të paqes që nënshkroi me Izraelin. Vendet e tjera arabe si Siria, Iraku, Arabia Saudite, Emiratet e Gjirit Persik, Libia, Tunizia, Algjeria, dy Jemenët janë kundër Egjiptit dhe i prenë marrëdhëniet diplomatike me të njëri pas tjetrit, domethënë nuk ekziston më ai «unitet» i vendeve arabe kundër Izraelit dhe për krijimin e shtetit palestinez. Palestinezët, nga ana e tyre luftojnë me armë sa mundin kundër Izraelit, për të fituar të drejtat e tyre.

Arabia Saudite ndjek rrugën e shteteve të tjera arabe, se nuk ka ç'të bëjë, por është e plogët. Megjithatë, ajo një sy e mban nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, syrin tjetër e mban nga vendet e tjera arabe, dorën ia ka dhënë Egjiptit për t'i lëshuar pak ndihma; natyrisht, në sipërfaqe nuk e ndihmon, por nën rrogoz po.

Pra në mbledhjen e vendeve «të paangazhuara», vendet arabe do të gjenden në konflikt; në vend që të flitet për gjoja unitetin e këtyre vendeve, do të flitet për dizunitetin e tyre dhe do të sulmohet Egjipti, do të sulmohet Izraeli, imperializmi amerikan po e po që do të sulmohet, gjë që nuk i leverdis Titos.

Të shohim çështjen e Iranit. Ky mund të konsiderohet si një vend i paangazhuar, mirëpo atje akoma nuk ka stabilitet. Ai është në një konfuzion të madh dhe kërkon të angazhohet diku, por ka frikë edhe nga Bashkimi Sovjetik, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra ky vend «i paangazhuar» mezi do të vejë në atë mbledhje në qoftë se bëhet ose do të mbyllë gojën atje ku do të vejë. Por çështja qëndron më larg: imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, si njëri, edhe tjetri, nga ana e tij edhe imperializmi kinez, luajnë atje kartën e tyre.

Karta e «tri botëve», «teoria» e famshme e Mao Ce Dunit, ra në ujë. Kjo pseudoteori u dogj nga ne dhe nuk përmendet më. Tash, në qoftë se përmendet ndonjë çikë, është «bota e paangazhuar» dhe kjo ndodh për arsye se po organizohet mbledhja. Natyrisht, në këtë «botë të paangazhuar» luajnë rolet e tyre edhe imperializmi amerikan, edhe socialimperializmi sovjetik, edhe socialimperializmi kinez.

Vjen çështja e Vietnamit. Disa janë dakord që Vietnami të vejë në mbledhje, disa duan ta përjashtojnë nga mbledhja, gjoja pse sulmoi Kamboxhian. Në Kamboxhia është krijuar një qeveri e re kundër qeverisë së Pol Potit. Kjo e fundit është dëbuar nga Kamboxhia, por qëndron në organizatën e «të paangazhuarve». Kina është kundër Vietnamit dhe kundër Kamboxhias «së re e demokratike», është gjithashtu kundër Kubës, kurse sovjetikët po përpiqen dhe do të përpiqen që Vietnami të qëndrojë në atë organizatë, që edhe qeveria e re e Kamboxhias të bëjë pjesë atje, që edhe Kuba të qëndrojë në organiza-

tën e kombeve «të pavarura e të paangazhuara» dhe mbledhja që është caktuar të bëhet në Havanë.

Në qoftë se mbledhja e kësaj farë organizate do të bëhet në Havanë, atje asaj do t'i këndohet *De profundis*-i. Përse? Sepse është edhe çështja e shteteve afrikane. Angola është nën varësinë e sovjetikëve e të kubanezëve, kështu ajo, si vend «i paangazhuar», do të mbajë anën e sovjetikëve dhe të kubanezëve, pra kundër gjithë të tjerëve që do të duan të përjashtojnë Vietnamin dhe Kamboxhian e re. Etiopia është nën influencën e sovjetikëve, kështu që edhe ajo do të mbajë po këtë pozitë të Angolës. Po Somalia ku është? «As te hopi as te hupi», është edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe me Bashkimin Sovjetik, edhe vend i angazhuar, edhe gjoja i paangazhuar. Niererja është në luftë me Idi Aminin në Ugandë. Uganda tash është gjoja një shtet i ri nën influencën e Niereres, kurse kaporali mareshal, Idi Amini, mbështetet nga Libia. Natyrisht, Libia nuk do ta njohë qenien në këtë organizatë të shtetit të Niereres, por do të mbrojë shtetin e Idi Aminit e kështu me radhë.

Prandaj aktualisht «bota e paangazhuar» është bërë një botë fiktive, një botë që emri i qëndron vetëm mbi kartë dhe asgjëkundi tjetër. Do të bëhen përpjekje për ta shtyrë këtë mbledhje, siç po duket, do të përpiqen të gjejnë një *modus vivendi* për të mos e bërë mbledhjen në Havanë, me qëllim që të neutralizojnë ndërhyrjet sovjetike dhe të triumfojë teza amerikane e Titos. Pra shohim se kjo «botë e paangazhuar» që gjoja ka qëllime të larta, që gjoja i është kundërvënë imperializmit, po ndahet edhe kjo në blloqe. Kështu janë vendet e konglomeracionit afrikan, vendet e botës arabe, vendet aziatike, Afganistani, Pakistani, të cilat janë ndarë disa nën influencën e sovjetikëve, disa nën influencën e kinezëve etj.

Me fjalë të tjera, është ajo që thashë më parë: kjo «botë e paangazhuar» është një blof i vërtetë, është një

skandal, është një krijesë kukull, e veshur me një petk të botës kapitaliste, revizioniste, titiste, për të shtypur revoltat, kryengritjet e popujve të ndryshëm, që kërkojnë liri e demokraci brenda vendit dhe nga zgjedha e neokolonialistëve të huaj. Pra, po afrohet *De profundis*-i i mbledhjes së «të paangazhuarve» dhe i jetës së Titos, se tok me Titon do të mbarojë edhe ky sharlatanizëm politik i kurdisur nga imperializmi amerikan.

E DIEL

13 MAJ 1979

SALT-2

Dy fuqitë më të mëdha imperialiste të botës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, po bëjnë një zhurmë të madhe në lidhje me çarmatimin, veçanërisht në lidhje me armët bërthamore.

Më në fund u deklarua se marrëveshja SALT-2, rreth së cilës ka një kohë të gjatë që bëhet fjalë, u përfundua në Uashington midis përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ambasadorit Dobrinin të Bashkimit Sovjetik. Kjo marrëveshje, pasi të nënshkruhet nga Brezhnjevi dhe Karteri, duhet të ratifikohet nga Senati Amerikan dhe nga Sovjeti Suprem i Bashkimit Sovjetik.

Brezhnjevit i është zënë goja dhe mezi flet, Karteri është bilbil, por sidoqoftë të dy imperializmat i kanë sytë të çelur, gërmazin të hapët dhe kanë marrë të gjitha masat që armatimet e tyre atomike të vazhdojnë të prodhohen, pavarësisht nga marrëveshje të tilla. Edhe Karteri, edhe Brauni, sekretari i Shtetit për Mbrojtjen të SHBA-së, si edhe Brzezhinski kanë deklaruar se me nënshkrimin e marrëveshjes SALT-2 asgjë nuk ndryshon, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë marrë të gjitha masat për t'u mbrojtur gjoja nga socialimperializmi sovjetik. Me fjalë të tjera, ata janë mbushur deng me armë bërthamore, siç është mbushur deng edhe Bashkimi Sovjetik.

Çështja qëndron në atë, siç përsëritin në konferenca shtypi këta udhëheqës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, se Senati Amerikan duhet ta aprovojë këtë marrëveshje, të mos bëjë zë, të jetë i kënaqur, sepse një gjë e tillë është në interesin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Karteri thotë se, natyrisht, marrëveshja SALT-2 nuk i përmbush të gjitha dëshirat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por është diçka më mirë se hiçi.

Marrëveshja SALT-2 ka për qëllim të kontrollojë ekuilibrin e forcave atomike të të dyja superfuqive, domethënë që si njëra, edhe tjetra, të ecin paralel në armatimet atomike e bërthamore si dhe me armët sekrete të sofistikuara. Prandaj e nënshkruan këtë marrëveshje që të kenë të drejtë të vëzhgojnë, qoftë brenda vendit, qoftë nëpërmjet bazave të afërta që kanë të dyja palët, në territoret e shteteve të tjera fqinje të njëri-tjetrit, pra të kontrollojnë ajrin, detin dhe tokën nëse njëri partner ose tjetri shpik apo krijon një armë të re, ose shton një armë që e posedon aktualisht. Se sa efikase do të jetë një gjë e tillë, këtë do ta shikojmë, por kjo nuk ndalon që si njëri, ashtu edhe tjetri, haptazi ose fshehtazi ta shkelin këtë marrëveshje dhe, kur ta zbulojë këtë shkelje atëherë gati i ka edhe mjetet, mënyrat e teknologjinë e prodhimit për të njëjtën armë. Për këtë punojnë ditë e natë të dyja superfuqitë.

Pse u nënshkrua marrëveshja SALT-2? Në radhë të parë ajo u nënshkrua për të gënjyer popujt që janë ngritur dhe në mënyra e në forma të ndryshme po luftojnë kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe kundër të gjithë atyre që kanë bomba atomike, duke kërkuar likuidimin e këtyre armëve. Mirëpo një gjë e tillë nuk arrihet nëpërmjet mitingjeve e demonstratave, por vetëm me forcën revolucionare të popujve, me kryengritje në çdo vend, gjë që do të arrihet jo kudo përnjëherë. Por bota zien dhe një ditë në vende të ndryshme «kapaku i kusisë» do të hidhet në erë.

Kriza e madhe e shumanshme botërore politike, ushtarake, financiare e superprodhimit i detyron të dyja superfuqitë që t'i frenojnë disi shpenzimet ushtarake, për arsye se nuk mund të vazhdohet pa fund gara e armatimeve atomike në mes tyre. Atyre u duhet të marrin një qëndrim, që të jetë pa humbje për interesat e veta imperialiste, për arsye se kanë një epërsi jashtëzakonisht të madhe mbi vendet e tjera. Ne mendojmë se, aktualisht, gjatë kësaj krize ata do të frenohen, për sa i përket garës së armatimeve, mbasi, në rast se do ta vazhdojnë, do t'u duhet të shpenzojnë me qindra miliardë dollarë në vit. Por ajo që i detyron më tepër të frenohen është kriza monetare dhe e energjisë. Ky frenim mund të jetë i përkohshëm, sepse nuk duket akoma në horizont një shenjë sado e vogël që ta lehtësojë krizën, bile e kundërta po ngjet në të gjitha vendet kapitaliste. Çështja e energjisë elektrike është bërë një problem shumë akut, aq sa të gjithë veç e veç dhe të grumbulluar, qoftë në Tregun e Përbashkët Evropian, qoftë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Amerikën e Jugut etj., etj. po bëjnë mbledhje dhe po marrin vendime për pakësimin e harxhimit të energjisë elektrike, domethënë të naftës.

Pra, nafta është një armë fort e rrezikshme për kapitalizmin, për shtetet imperialiste, për shtetet «e modernizuara» e që kanë një teknologji të lartë. Pa energji elektrike, pra, pa karburant, çdo gjë pushon.

Në Iran populli e rrëzoi shahun dhe grevat e punëtorëve bënë që nafta të mos rrjedhë më në atë sasi që e merrnin dikur Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera kapitaliste. Pakësimi i furnizimit të naftës nga Arabia Saudite dhe në përgjithësi nga gjithë Lindja e Mesme i ka detyruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ato të Evropës që të marrin masa. Bashkimi Sovjetik po merr masa edhe ai vetë për kursime dhe për fitime. Satelitëve të tij ua ka mbyllur rubinetat dhe pika e naftës është një pikë në kokat e tyre, të cilën duhet ta paguajnë shtrenjtë. Bashkimi Sovjetik ruan rezerva për kohë të këqija dhe pak punë i prish nëse u mungon nafta satelitëve apo vendeve të tjera që i furnizon me të.

Kështu që në gjithë botën janë mbyllur mjaft fabrika, me miliona automobila janë futur nëpër garazhe dhe janë vënë në qarkullim autobusët e trenat. Por kjo zgjidhje ka shkaktuar një krizë tjetër, krizën e qymyrit. Qymyri, që deri tani ishte lënë pas dore, tash deri diku po kërkohet përsëri. Vendet që e prodhojnë atë e japin me çmime të larta.

Për sa i përket jehonës që pati nënshkrimi i marrëveshjes SALT-2, mund të themi se disa e pëlqejnë, disa nuk e pëlqejnë. Për shembull, qeveria franceze nuk e pëlqeu këtë marrëveshje. Franca që në kohën e Dë Golit e zhvilloi vetë forcën persuazive të bombës atomike që të mos mbetej nën ombrellën amerikane, dhe as në bashkëpunim të ngushtë me të, siç bëri Anglia. Dë Goli e dinte që në një luftë eventuale në Evropë Franca s'mund të merrte asnjë iniciativë, pse sustën e bombës atomike do ta përdornin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe vetëm atëherë kur ta shikonin se interesat e tyre ishin prekur, pa i përfillur aspak interesat e Francës. Kështu, Dë Goli u shkëput nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Franca vazhdoi të zhvillojë armën atomike në mënyrë të pavarur.

Aktualisht Zhan Fransua Ponse, ministër i Jashtëm i Francës, deklaroi se Franca nuk do të bashkohet në marrëveshjen SALT-2, ajo do ta zhvillojë armën atomike jashtë kësaj marrëveshjeje, për interesat e mbrojtjen e saj. Me fjalë të tjera, Zhiskar d'Estëni dhe qeveria e tij nuk pranojnë që të futen në zinxhirët e dy superfuqive, të cilat kanë stoqe jashtëzakonisht të mëdha armësh e bombash atomike. Kurse Gjermania Perëndimore e Bonit, nëpërmjet kancelarit të saj Shmidt, e aprovoi marrëveshjen SALT-2.

Duket qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania Perëndimore janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Shtetet e Bashkuara e konsiderojnë Gjermaninë Perëndimore si avanpostin e tyre në Evropë në rast të një lufte bërthamore me Bashkimin Sovjetik, me fjalë të tjera financojnë hitlerizmin e kohëve tona. Anglia akoma nuk e ka shpallur qëndrimin e saj për marrëveshjen SALT-2, po kryeministrja e re konservatore, Margaret Theçer, la të kuptohet se Anglia do ta zhvillojë vetë armën atomike. Kjo, thënie e saj, në qoftë se do të realizohet, deri diku do të thotë se jemi para njëfarë shkëputjeje të Anglisë nga aleati i vet, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për sa i përket zhvillimit të armëve atomike. Theçeri dha arsyen se Anglia dëshiron të ketë armën e saj për t'u mbrojtur nga çdo eventualitet.

Popujt e tjerë të botës, natyrisht, nuk gënjehen nga SALT-2. Kësaj marrëveshjeje, ata që e nënshkruan, me siguri do t'i vënë lule për ta zbukuruar, por prapa saj ka marrëveshje të tjera, të fshehta e protokolle të shumta që dëshmojnë për ujdinë e arritur midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik në shumë çështje që lidhen me armët bërthamore dhe me armët konvencionale.

Karteri është i shqetësuar dhe thekson se marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Bashkimin Sovjetik do të ashpërsohen shumë në rast se Senati Amerikan nuk e ratifikon marrëveshjen SALT-2 për kufizimin e armëve sekrete e të armëve strategjike. Karteri pretendon se kjo marrëveshje që është arritur është nga më të mirat, natyrisht, jo më e përsosura. Në qoftë se senatorët nuk e pranojnë këtë marrëveshje, shton Karteri, kjo gjë do të ketë pasoja nga më shkatërrueset për vendin tonë e për paqen në botë, gjithashtu do t'i ashpërsojë në një masë të konsiderueshme marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik.

PANORAMË POLITIKE

Gjendja në botë është e turbullt dhe e shqetësuar. Popujt, qeveritë, partitë e ndryshme janë në ethe, janë në lëvizje. Është krijuar një gjendje kaotike në politikë e kudo, si rezultat i krizës së përgjithshme dhe të thellë që ka mbërthyer në një darë të fortë vendet kapitalisto-revizioniste. Natyrisht kjo gjendje shkakton perturbacione të mëdha në jetën shoqërore të popujve e të vendeve dhe shqetësime të mëdha e të pazgjidhshme për qeveritarët që sundojnë mbi këta popuj e mbi këto vende.

Një situatë e tillë shqetësuese është shumë e rrezikshme për ata që dëshirojnë statukuonë. Prishja e kësaj statukuoje, e cila përbëhet nga marrëveshje e aleanca të ndryshme midis vendeve kapitaliste e revizioniste, mund të shkaktojë katastrofa të vogla, por mund të çojë edhe në katastrofën e madhe. Pikërisht kësaj të fundit i ruhen ata sa të jetë e mundur, prandaj punojnë për katastrofa të vogla, për kombinime të reja politiko-ekonomike-ushtarake në mes tyre. Të gjitha këto i bëjnë për të shuar ose për të dobësuar lëvizjen e madhe shoqërore të popujve, të cilët çdo ditë që kalon shohin më mirë e më qartë se ku po i çojnë shtypja e jashtme dhe e brendshme, sundimi i monopoleve të imperializmit dhe të socialimperializmit, si edhe shtypja e brendshme nga klasat e pasura që sundojnë mbi këta popuj në bashkëpunim të ngushtë me kapitalizmin e jashtëm dominues.

Në këtë situatë, përveç të tjerave, mund të përcaktohen dy qendra nevralgjike. Këto janë Afrika dhe Lindja e Mesme.

Afrika është një kontinent i madh në zgjim. Natyrisht ky zgjim nuk është kudo njëlloj, por sidoqoftë ky proces nuk ka dyshim që shoqërohet me kundërshtime nga ana e të sunduarve, shkakton greva e demonstrata, të cilat shtypen me gjak nga klikat e ndryshme në fuqi si dhe nga neokolonizatorët, që nuk janë tjetër veçse kolonizatorët e vjetër, e në radhë të parë nga ata amerikanë. Këta, kanë investuar shuma të mëdha në vendet afrikane, bashkëpunojnë me qeveritarët reaksionarë të këtyre vendeve dhe janë të lidhur me shtetet e tjera imperialiste, neokolonialiste, nëpërmjet koncerneve, trusteve e shoqërive të përbashkëta. Por ne konstatojmë se përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Afrikë kanë influencën e vet edhe Anglia e Franca dhe tash sapo kanë futur duart edhe socialimperializmi sovjetik si dhe ai kinez, i cili, si një nepërkë e hutuar kërkon të gjejë ndonjë të çarë për t'u futur me pesë rup në dasmë.

Këto fuqi kolonizatore përpiqen që në Afrikë të ruajnë statukuonë e vendosur pas Luftës së Dytë Botërore. Pra, të ruajnë atë statukuo që lidhet me momentin e dhënies prej tyre të njëfarë lirie dhe pavarësie të sipërfaqshme një vargu shtetesh afrikane, kufijtë e të cilave ato i përcaktuan sipas interesave të veta dominuese. Franca u detyrua t'u jepte «liri» dhe «pavarësi» të gjitha kolonive të saj, Anglia po ashtu, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse nuk kishin koloni në atë kuptim që i jepnin kësaj fjale Franca dhe Anglia, prapëseprapë kishin në Afrikë influencë shumë të madhe, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa Gjermania e humbi influencën e vet, mbasi e humbi Luftën e Dytë Botërore. Vetëm Portugalia vazhdonte edhe pas Luftës së Dytë Botërore, bile deri tash në fund, të ruante kolonitë e veta në Afrikë, si

në Angola, në Mozambik, në ishujt e Kepit të Gjelbër e gjetkë. Pas vdekjes së diktatorit fashist, Salazarit, tash edhe në këto vende u bënë ndryshime, u fitua e u njoh pavarësia, u përcaktuan disa kufij shtetërorë. Megjithatë kufijtë e shteteve afrikane, sidomos të atyre që ndodhen në Afrikën Lindore, Qendrore dhe Jugore, janë përcaktuar formalisht. Pikërisht ky përcaktim formal i imponuar nuk e lejon atë statukuo që kërkojnë aktualisht shtetet e mëdha kapitaliste neokolonialiste në Afrikë, për arsye se, kur u bë ndarja e këtyre shteteve, nuk u mbajt në konsideratë formimi i kombësive dhe Afrika që ka me qindra popuj të ndryshëm u copëtua në shtete të veçanta. Tash afro 400 popuj të kombësive të ndryshme, të nxitur edhe nga të tjerët, kërkojnë të shkëputen ose të ndahen nga shtetet e krijuara dhe të krijojnë shtete të reja, më vete.

Në këto vende kapitalistët e Evropës Perëndimore, ata amerikanë e sovjetikë kanë interesa të mëdha. Minierat dhe pasuritë e shumta të nëntokës e të mbitokës shfrytëzohen prej tyre në mënyrë moderne dhe me krahë pune vendas jashtëzakonisht të lirë. Prandaj neokolonialistët e të gjitha ngjyrave, për të ruajtur në këto shtete dominimin e tyre financiar dhe ekonomiko-politik, për të ruajtur strukturat dhe infrastrukturat e tyre të vjetra, me disa ndryshime të vogla, krijuan njëfarë inteligjencie të re që e mësuan në metropolet e tyre, për të dhënë përshtypjen e rreme të një vetëdrejtimi të këtyre shteteve. Por në realitet dihet se kush drejton atje. Për shembull, në tërë Afrikën Franceze, sipas statistikave, janë 50 mijë francezë që punojnë e drejtojnë. Kështu ngjet edhe në Afrikën e Jugut, ku vetëm një grusht njerëzish të bardhë dominojnë dhe shtypin gjithë atë pjesë të madhe të kontinentit, që përbën Afrikën e Jugut, vendin e zimbabëve. Dhe, për t'u dhënë një formë ekzotike këtyre shteteve, kanë ngritur në fuqi njerëz të tillë si Mobutun, Bokasanë, ish-kaporal në Luftën e Indokinës dhe të tjerë si këta. Në

këto shtete afrikane të privilegjuarit janë kolonizatorët, që qëndrojnë në qytetet e ndërtuara prej tyre me komoditete të mëdha, pastaj është një shtresë tjetër, e përbërë nga nëpunës të rangjeve të ulëta, që marrin rroga mesatare dhe në fund është një proletariat-fshatar i hedhur jashtë këtyre shtresave, një proletariat indigjen shumë i varfër, që prodhon gjëra të vogla në mënyrë primitive dhe është aq i varfër saqë as nuk mund të shesë, as nuk mund të blejë.

Një gjendje të tillë nuk mund ta pranojnë elementët përparimtarë të cilët, sidomos inteligjencia e re, duke u zhvilluar, shohin me të vërtetë shfrytëzimin barbar që u bëhet popujve të tyre nga sunduesit e huaj e vendas dhe i rritin kërkesat ndaj padronëve, duke mos i lënë rehat këta që të jetojnë e të shfrytëzojnë ashtu si u do qejfi.

Në situatat e sotme që krijon rivaliteti ndërimperialist për ndarjen e rindarjen e zonave të influencës e të tregjeve lindin edhe fërkimet dhe ambiciet midis fuqive kapitaliste për skllavërimin e Afrikës. Kështu, për shembull, belgët, francezët, anglezët, amerikanët, sovjetikët dhe kinezët jo vetëm përpiqen të krijojnë ose të forcojnë influencat e tyre në shtetet e Afrikës së Veriut si në Marok, Algjeri, Tunizi, Libi, Egjipt, Sudan, Tanzani, por, veçanërisht në ato vende që e kanë njohur vonë pavarësinë, ata përpiqen të infiltrojnë në dëm të njëri-tjetrit për t'u zgjeruar e për të zënë vend atje më mirë. Për këtë qëllim Franca e Zhiskar d'Estënit zhvillon në vazhdimësi një politikë eurafrikane, së cilës tash i ka shtuar edhe termin arab, eurafrikano-arabe. Me këtë politikë Franca jo vetëm synon të ruajë privilegjet e saj në vendet afrikane frankofone, por ta shtojë e ta zgjerojë influencën e saj edhe në vendet arabe.

Franca ka pasur koloni në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme, si për shembull në Siri, në Liban, ku aktualisht influenca e saj e dikurshme është gërryer nga shtetet e

tjera imperialiste. Megjithatë, atje Franca, në mos influencë të madhe ekonomike, ka influencë politike dhe kulturore, të cilat përpiqet t'i shfrytëzojë. Këtë gjë ajo do ta bëjë, sepse shikon që Anglia, në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me regjimin racist reaksionar të Afrikës së Jugut, ka zënë pozita të forta në kontinentin afrikan. Përveç rrezikut anglez, rrezik të madh Franca shikon edhe nga ana e Gjermanisë së Bonit, e cila përpiqet dhe ka arritur të ketë vendin e parë në Tregun e Përbashkët Evropian dhe në Evropën e Bashkuar, vend të cilin e aspiron Franca. Por, që kjo aspiratë të realizohet, duhet që Franca të sigurojë një forcë të atillë ekonomike e ushtarake sa të jetë në gjendje të përballojë influencën e Gjermanisë Perëndimore.

Kështu që për Francën Afrika përbën një fushë shahu ku po përpiqet t'i lëvizë gurët në favorin e saj për t'i bërë mat të tjerët. Një nga këta të tjerë, përveç atyre që thamë, është edhe Bashkimi Sovjetik, i cili, me ndërmjetësinë e kubanezëve dhe nëpërmjet kredive, natyrisht, jo shumë të mëdha, por të vazhdueshme, ka hyrë në Angola, në Etiopi, në Eritre dhe përpiqet të infiltrojë edhe ku të mundet tjetër, ku të gjejë një vrimë për t'u futur.

Koalicioni i shteteve perëndimore në Afrikë po përpiqet pra, me grindje e me kontradikta në mes tyre, të forcojë pozitat e veta. Në mënyrë të veçantë ky koalicion përpiqet të pengojë socialimperializmin sovjetik që të mos ketë mundësi të futet në këtë kontinent, ku ai synon të krijojë tregje dhe të zërë pozita strategjike luftarake.

Në këtë lëvizje të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake shohim se si këto fuqi imperialiste nxitin edhe luftëra të pjesshme në mes vendeve afrikane si, për shembull, luftërat e pjesshme në mes Marokut dhe Frontit POLISARIO, nxitin mëritë në mes Marokut dhe Algjerisë, në mes Mauritanisë dhe Frontit POLISARIO. Ne

shohim Zairen të hyjë në luftë me Ugandën, e cila tash po pushtohet nga Tanzania; në Angola, situata nuk është e qetë, po ashtu në Etiopi ka një situatë akoma të pastabilizuar, pavarësisht se u likuidua Haile Selasieja, i cili ishte një Bokasa etiopian. Tash, ky vend, i ndihmuar nga sovjetikët, është në luftë me Eritrenë dhe me Somalinë. Edhe kjo e fundit dikur kishte mbështetjen e Bashkimit Sovjetik, kurse tash e ka kthyer fytyrën për të marrë ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Kina. Gjithë klikat që janë në fuqi në këto shtete përpiqen të sigurojnë pozita të majme për vete dhe të shtypin revoltat e masave popullore, revolta të cilat nuk janë të vazhdueshme, janë sporadike e të paorganizuara si duhet, sepse njerëzit janë akoma të paformuar ideologjikisht e politikisht. Natyrisht këto lëvizje s'ka si të jenë të organizuara përderisa nuk është krijuar si duhet ai faktor objektiv që të kërkojë edhe krijimin e faktorit subjektiv ose ta forcojë, në qoftë se ekziston, për ta udhëhequr popullin në një revoltë të hapët dhe fitimtare kundër shtypësve të jashtëm e të brendshëm.

Në Afrikën Qendrore dhe në Afrikën e Jugut situatat janë shumë të ndryshueshme, pra të paqëndrueshme, kurse në Afrikën frankofone ka njëfarë stabiliteti. Siç duket këtu infrastrukturat, shoqëritë dhe koncernet franceze kanë zënë njëfarë pozite të shëndoshë dhe kanë krijuar një strukturë organizative të përshtatshme si ajo e metropolit, por sidoqoftë të papërshtatshme për kolonitë e reja që ajo ka nën drejtimin e vet ekonomiko-ushtarako-politik.

Në Afrikën e Veriut, Algjeria, Maroku, Tunizia, Egjipti, Libia, paraqiten gjoja më të pavarura dhe bëjnë gjoja një politikë jo sipas interesave të fuqive të mëdha. Të gjitha këto flasin për unitetin arab, vetëquhen vende të pavarura, por në realitet, po të analizosh përmbajtjen e tërë këtyre emërtimeve që i vënë vetes, del se nuk është ajo që duan të paraqesin. Me fjalë të tjera, këto janë vende arabe, por në realitet asgjë nuk i bashkon veçse feja myslimane, e cila nuk ka se si të jetë kurrë një mjet shpirtëror i atillë që të zhdukë kontradiktat ekonomike e politike midis tyre. Sot nuk jemi aspak në kohën e profetit dhe të kalifëve, nuk sundon as Damasku, as Bagdadi, as edhe Teherani, por interesat e klasave dhe feja myslimane, si edhe fetë e tjera, është bërë ndihmësja e drejtpërdrejtë e klasave të pasura sunduese, për t'i shfrytëzuar e për t'i mbajtur në errësirë proletariatin dhe masat e shtypura, për t'u premtuar atyre një të ardhme të lumtur, veçse jo në këtë botë, por «në botën tjetër».

Atje ku mundet dhe ku u puqen interesat ekonomike ose politike vendet arabe dhe myslimane përpiqen që fenë ta bëjnë një mjet unifikimi, por ajo bëhet edhe një mjet lufte kur interesat e tyre bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Konkretisht ne shohim se në Afrikën e Veriut nuk ka unitet mendimi dhe do të jetë absurde të mendohet se mund të ekzistojë unitet në mes regjimeve kapitalisto-borgjeze dhe feudale. Gjithashtu është një gabim trashanik të thuhet se këto vende janë të pavarura nga fuqitë e mëdha imperialiste. Ato jo vetëm që nuk janë të pavarura, por janë të lidhura e të ndërlidhura me interesat e kapitalizmit botëror dhe, për t'u shërbyer këtyre interesave, klikat udhëheqëse të vendeve në fjalë lidhin dhe zgjidhin marrëveshje në favor të tyre me ato shtete të zhvilluara kapitaliste, të cilat u japin një mbështetje të fuqishme në realizimin e qëllimeve të veta.

Natyrisht, nuk mund të themi se në programin e qeverive të këtyre vendeve të Afrikës së Veriut nuk ka diçka progresive. Por duhet thënë se kjo diçka progresive në atë shkallë të dobët që ekziston, i shërben klasës në fuqi dhe jo masave të shtypura, të cilat prodhojnë e shfrytëzohen, kurse pasanikët fitojnë e sundojnë. Prandaj aktualisht atje ekzistojnë kontradikta, të cilat, në marrëdhëniet në mes klasave brenda këtyre shteteve, thellohen dhe

shkaktojnë prishjen e asaj statukuoje që duan të ruajnë neokolonialistët, gjithashtu prishin harmonizimin e interesave të tyre në marrëdhëniet që kanë disa shtete me njëri-tjetrin.

Vetëm ai që nuk merr vesh nga politika, që nuk është në gjendje të analizojë realisht politikën që zhvillohet në këto vende dhe gjendjen e tyre sociale, mund të arrijë në konkluzionin se në këto vende, në këto situata, ato që veprojnë janë vetëm kontradiktat në mes shteteve dhe harron se kontradiktat e tjera, të cilat Lenini i ka përcaktuar drejt, ekzistojnë dhe zhvillohen në çdo kohë e në çdo situatë, duke e bërë të pamundur statukuonë e dëshiruar nga kapitalistët.

Po ashtu mendohet cekët se vetëm imperialistët dhe socialimperialistët janë ata që bëjnë ligjin e se janë kontradiktat, mosmarrëveshjet dhe lufta antagoniste në mes tyre që e shkaktojnë këtë prishje të statukuosë. Këtej rrjedh që klasat sunduese, për të gënjyer masat e popullit, natyrisht, mbështeten te njëri imperialist ose te tjetri, duke e paraqitur njërin të mirë e tjetrin të keq, kështu që shkaku i të këqijave ose i «të mirave» i hidhet vetëm mbështetjes në këtë ose në atë imperializëm. Në fakt kontradiktat veprojnë në front në mënyrë intensive, në mënyrë më pak intensive ose në forma latente, por ato bëjnë punën e vet.

Le të shohim disa prej tyre, pa u futur në hollësi.

Maroku ka qenë koloni e Francës, e cila e ka shfrytëzuar atë me dhjetëra vjet. Në këtë vend ajo ka pasë vendosur hegjemoninë e vet, forma të tilla të superstrukturës dhe të strukturës që t'u përgjigjeshin nevojave të metropolit. Marokenët kanë qenë mercenarët e ushtrisë franceze dhe kanë derdhur gjakun për Francën, për metropolin, për kolonitë e dyqind familjeve franceze.

Sot në Marok sundon një mbret, që quhet Hasani i Dytë. Pas shumë peripecive që kaluan gjyshi dhe i ati

i tij, froni i mbeti këtij mbreti, i cili përpiqet të hiqet demokrat dhe të luajë një rol gjoja përparimtar, por në të vërtetë ai është një sovran mesjetar, barbar, që mbahet në fuqi nga intrigat e imperialistëve. Maroku është në kontradikta të thella me shtete si Mauritania, me Frontin POLISARIO dhe me Algjerinë.

Mbretëria e Marokut, natyrisht, e ndihmuar nga imperializmi francez dhe nga ai amerikan, nuk dëshiron që Algjeria të ketë influencë në Frontin POLISARIO dhe Mauritaninë kërkon ta ketë vartësen e vet. Këtu, gjithashtu, zhvillohen edhe intriga e rivalitete midis amerikanëve e sovjetikëve. Këta të fundit përpiqen që në Atlantik të krijojnë baza detare të tyret, prandaj bëjnë ç'është e mundur të influencojnë në Algjeri, në Frontin POLISARIO dhe kërkojnë të gjejnë momentet më të përshtatshme që mbretërinë e Marokut ta bëjnë satelit të tyre për kohë të vështira. Por aktualisht nuk ngjet një gjë e tillë, Bashkimi Sovjetik nuk influencon dot në Marok, në të kundërtën.

Algjeria është i vetmi vend i Afrikës së Veriut që ka luftuar, mund të themi heroikisht në luftë kundër pushtuesve francezë, duke fituar lirinë dhe pavarësinë nacionale borgjeze.

Në Algjeri janë bërë reforma shoqërore, por të pakta e të çala. Atje ka një zhvillim kulturor islamik dhe modern, ekziston kurdoherë influenca e kulturës franceze dhe me Francën ajo mban marrëdhënie të rëndësishme ekonomike, sidomos për sa i përket eksportimit të krahëve të punës, të verërave e të rrushit algjerian e në radhë të parë shfrytëzimit të naftës e të gazit të Saharasë. Nafta dhe gazi i saj luajnë një rol vendimtar për të gjitha vendet që kanë pjesë në këtë shkretëtirë, e cila është shumë e pasur me naftë dhe me gaz e mundet edhe me minerale të tjera të çmueshme. Për këtë arsye ekzistojnë konflikte të vazhdueshme në mes shteteve kufitare dhe si pasojë kufijtë e vendosur janë sa për formë, se lëvizen

sipas interesave të njërit ose të tjetrit. Fakt është se çdo shtet i Afrikës së Veriut si Algjeria, Maroku, Libia, Tunizia, Sudani, Egjipti etj. kërkojnë si e si t'i lëvizin këta kufij, kush në kurriz të Libisë, kush në kurriz të Algjerisë, kush në kurriz të Çadit, kush në kurriz të Egjiptit e kështu me radhë.

Aktualisht Algjeria luan një rol të rëndësishëm në çështjen e unitetit të vendeve arabe si edhe në të ashtuquajturat vende të paangazhuara. Titoja, që kërkon të jetë lideri i këtyre vendeve «të paangazhuara», ka shpresa të mëdha tek Algjeria që kjo të influencojë në vendet e tjera për të ruajtur të ashtuquajturin bashkim të këtyre vendeve, bashkim që as ka ekzistuar, as nuk do të ekzistojë kurrë sepse varësia e këtyre vendeve, ku më shumë e ku më pak, është vepruese në drejtimin e fuqive të mëdha.

Libia është një vend që u çlirua, ose u bë «e pavarur», kur kolonel Kadafi me grusht shteti rrëzoi mbretin Idriz. Është fakt se Libia, ish-koloni italiane, tash me Kadafin në krye, përpiqet të luajë rolin e një vendi «socialist» mysliman, puro islamik. Kadafi, një çunak me ide të pakristalizuara borgjeze, fashiste, zhvillon një politikë aventureske. Ai ka synime të shumta: kërkon që Egjipti të jetë nën varësinë e Libisë, ka synime mbi disa shtete të Afrikës Qendrore dhe përpiqet të marrë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në çështjen arabe.

Egjipti, dikur me Naserin në krye e tash me Sadatin, ka qenë dhe është një vend borgjez kapitalist, feudal, si të thuash edhe pse s'ka në krye një mbret. Demokratët borgjezë pasanikë e nxorën jashtë mbretin Faruk, dhe bënë mirë, por këta nuk e drejtuan Egjiptin në rrugën e një shteti demokratiko-borgjez. Përkundrazi atje reformat ekonomike ishin të paqena dhe politikisht Egjipti, qoftë i Naserit, qoftë i Sadatit, u bë një lojë shahu e superfuqive imperialiste, e Bashkimit Sovjetik dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Si pasojë e politikës së çoroditur të Naserit e të Sadatit Egjiptit iu shkaktuan humbje të mëdha gjatë luftërave që iu imponuan nga Izraeli, i cili ishte i armatosur deri në dhëmbë dhe i shkatërroi në mënyrë të tmerrshme forcat e pastërvitura dhe të paarmatosura egjiptiane. Bile vetë Kajroja u gjend nën rrezikun e pushtimit izraelit, por ndërhynë dhe e shmangën këtë gjë fuqi të tjera imperialiste, të cilat me pushtimin e plotë të Egjiptit shihnin një katastrofë edhe më të madhe në detin Mesdhe. Megjithatë Izraeli mundi ta forcojë shtetin e vet sionist, të pushtojë tokat egjiptiane dhe Golanin, një vend dominues strategjik, pushtimi i të cilit ishte në disfavor të Sirisë.

Me Egjiptin dhe konfliktin midis tij dhe Izraelit, me të cilin nënkuptohet konflikti midis të gjitha vendeve arabe, përfshirë edhe popullin palestinez, kundër Izraelit agresor, kalojmë në pikën e dytë nevralgjike të situatës aktuale ndërkombëtare.

Me nënshkrimin e Traktatit të paqes në mes Egjiptit dhe Izraelit u krijua një situatë e re. Të gjitha vendet arabe, me përjashtim të Marokut, i cili haptazi është solidar me shtetet e tjera, kurse fshehtazi e aprovon, e kundërshtojnë këtë traktat se ai është një traktat i padrejtë dhe i jep haraç interesat e popullit palestinez. Në fakt, Egjipti e nënshkroi këtë traktat me Izraelin që është një agjenturë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lindjen e Mesme, mori vetëm një pjesë të tokave të pushtuara nga Izraeli, në kundërshtim me politikën e përbashkët të vendeve arabe, dhe Golanin e palestinezët i harroi. Kjo është arsyeja që ai kundërshtohet «rreptësisht» nga të gjitha vendet e tjera arabe, gjithashtu nga Irani i Ajatollah Khomeinit. Por në këtë aleancë, gjoja arabike, nuk ekziston një unitet i plotë pikëpamjesh dhe veprimesh kundër Egjiptit për tradhtinë që i bëri ai kauzës së përbashkët të palestinezëve dhe të Sirisë. Për shembull Arabia Saudite, si edhe Emiratet e Gjirit Persik, sido që bëjnë pjesë në këtë grumbullim, që kundërshton Trak-

tatin egjiptiano-izraelit, prapëseprapë e kanë një dorë këtej, një dorë tek imperializmi amerikan, sepse e kanë hallin te petrodollarët.

Kështu Siria, në fakt, ndodhet në luftë me Egjiptin dhe me Izraelin. Tok me të edhe Iraku. Këto dy shtete, Iraku dhe Siria përpiqen të bashkohen me njëri-tjetrin e të krijojnë një unitet. Është e qartë se fjalë bëhen, por këtij qëllimi nuk mund t'i arrihet kurrë për arsye të kontradiktave të mëdha që ekzistojnë në mes dy regjimeve të këtyre shteteve dhe të disnivelit ekonomik të tyre, po ashtu edhe për shkak të pozitës strategjike të njërit e të tjetrit. Por edhe fuqitë e ndryshme imperialiste janë kundër një bashkimi të këtillë dhe prandaj bëjnë përpjekje që ai të mos arrihet.

Siria dhe Iraku janë dy republika me një kulturë islamike të vjetër dhe të shkëlqyer, por si infrastrukturë ato qëndrojnë në pozitën e vendeve feudalo-borgjeze, ku sundojnë pasanikë dhe fetarë. Në këto vende feja mund të themi luan një rol mjaft të madh në shtypjen e masave punonjëse. Në Siri e në Irak, në të parën kultura franceze, në të dytën ajo angleze kanë luajtur dhe luajnë, gjithashtu, një rol të madh.

Në Irak ekziston minoriteti kurd, një popull mjaft i madh, i shpërndarë në shumë vende nga traktatet e padrejta të imperialistëve. Kurdë ka edhe në Turqi, në Bashkimin Sovjetik e në Iran. Në Irak, lufta në mes kurdëve dhe irakianëve ka dalë në sipërfaqe shumë herë. Atje ekzistojnë kontradikta të mëdha nacionale, të cilat nxiten sidomos nga sovjetikët dhe herë pas here dalin mbi ujë.

Kur qeveria e Bagdadit luan si të thuash mbi litar, vendet e tjera arabe në Gjirin Persik e sidomos Arabia Saudite, e pasur në naftë dhe e lidhur ngushtë me imperializmin amerikan nëpërmjet shoqërisë së madhe të naftës, ARAMKO, të krijuar që në kohën e Rusveltit, luan një rol të madh e të dyfishtë gjoja në interes të popujve arabë, gjoja kundër Izraelit, gjoja të pavarur nga Shtetet

e Bashkuara të Amerikës. Në fakt, ajo është kurdoherë një shtet i fuqishëm kapitalist për sa i përket pasurisë dhe i dobët nga ana politiko-ushtarake. Politika saudite është vetëm një politikë e dollarëve, e naftës dhe asgjë më tepër.

Natyrisht, Arabia Saudite ka një influencë mjaft të madhe në të gjitha vendet arabe, këto nga ana e tyre kanë interesa të marrin kredi nga Arabia Saudite dhe kjo nga ana e saj u dikton atyre, deri në njëfarë shkalle mbrojtjen e interesave të saj dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pra, Arabinë Saudite mund ta quajmë si një treçerek mbështetjeje të politikës imperialiste amerikane, kurse Irani deri dje ishte i tëri një çiflig i amerikanëve. Por, me rrëzimin e shahut, si rezultat i demonstratave të mëdha popullore në të gjitha qytetet e Iranit dhe sidomos të punëtorëve të naftës dhe me ardhjen e Ajatollah Khomeinit në fuqi, situata në këtë vend ndryshoi: Irani u shndërrua nga një vend skllav i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në një vend pak a shumë të revoltuar ndaj shtypjes dhe shfrytëzimit të egër të imperialistëve amerikanë, anglezë etj.

Natyrisht, një gjë e tillë nuk do të thotë se Irani u bë një republikë demokratike përparimtare. Jo në asnjë mënyrë, por veprimtaria e masave popullore i dha veprimtarisë islamike retrograde të Ajatollah Khomeinit një ngjyrë pak a shumë progresive, se këto masa rrëzuan perandorinë e Pahlevëve dhe vunë në zbatim gjykatat «revolucionare» islamike, të cilat deri tash kanë prerë disa koka shërbëtorësh e agjentësh të shahut e të amerikanëve që kishin lyer duart me gjakun e popullit iranian. Do të vazhdojnë këto gjykata të presin kokë të tjera në Iran? Kjo nuk dihet.

Por çështja tjetër, dhe më e rëndësishmja, është se grevat e mëdha të punëtorëve të naftës në Iran kanë shkaktuar një krizë të madhe ekonomike, energjetike në të gjithë botën, veçanërisht në vendet imperialiste perën-

dimore me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Situata e krijuar në Iran vërtetoi se CIA e fuqishme nuk kishte mundur ose e kishte nënvleftësuar forcën e popullit iranian, e cila shpërtheu pa dashjen dhe pa dijeninë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto u treguan mendjeshkurtra për interesat e tyre hegjemoniste dhe mendonin se shahu i Iranit, nën sundimin e drejtpërdrejtë të tyre, do të jetonte gjithmonë dhe do të vazhdonte ta shfrytëzonte mirë popullin iranian. Mirëpo ngjau e kundërta. Tash në Iran akoma asgjë nuk është stabilizuar. Medoemos, gjatë kësaj periudhe, imperialistët dhe socialimperialistët me politikën e tyre manovrojnë si e si të shuajnë gjakrat, të zbutin revoltën në interes të klasave të pasura, të evitojnë kërdinë në likuidimin e agjenturës së tyre dhe të sjellin në fuqi njerëz të rinj që pak a shumë ta stabilizojnë këtë ekuilibër të rëndësishëm ose më mirë të themi këtë dezekuilibër të madh që u shkaktoi problemi iranian. Këtë e vërteton shumë qartë fakti që vetë Senati Amerikan vazhdon të ndërhyjë në punët e brendshme të Iranit, duke e kërcënuar të marrë vendime kundër gjykimit dhe pushkatimit të vrasësve përkrahës të shahut. Ndërsa Ajatollah Khomeini këtë ndërhyrje e kundërshton rreptësisht dhe e kundërshton duke vazhduar të lejojë gjykatat islamike të bëjnë punën e tyre.

Ne mund të themi se në Iran forcat popullore janë në lëvizje, momenti objektiv është në zhvillim, por çështja e udhëheqjes akoma nuk është vendosur. Udhëheqja aktuale më e fuqishme është ajo islamike e Ajatollah Khomeinit me shumë tendenca, por prapë me njëfarë uniteti, kurse në qeverinë e Bazarganit, shihen tendenca pajtimi me imperialistët e vjetër dhe ky pajtim, natyrisht, në qoftë se arrihet, do të realizohet në forma që do të ndryshojnë nga ato që ekzistonin në kohën e shah Reza Pahlevisë.

Por sidoqoftë kryengritja e popullit të Iranit kundër monarkisë feudale të shahut ka pasur influencë kudo në

të gjithë botën, jo vetëm në aspektin ekonomik, gjë që tregon se sa e fuqishme është arma e naftës, armë e cila mundet ta bëjë luftën të pamundur, se pa naftë nuk mund të vihen në lëvizje makinat luftarake kundër popujve, por edhe në aspektin politik. Kjo kryengritje, si lëvizje çlirimtare, ka krijuar në të gjithë pellgun arabik dhe afrikan një situatë të favorshme dhe popujt mund të marrin shembull për t'u ngritur në luftë kundër kushteve të vështira, të mjeruara, shtypëse, që ekzistojnë në vendet e tyre.

Populli palestinez gjithashtu nuk i hedh armët, me luftën e tij ai tregon një shpirt luftarak të paepur, por e keqja e madhe është se ky popull ka mbetur pa atdhe dhe lufton atje ku ka mundësi të vendoset. Egjipti mban një qëndrim kundërshtar të rreptë kundër palestinezëve, veçse të rreptë në dukje, sepse nuk është çudi që Arafati dhe Al Fatahu nën rrogoz e në mënyrë të fshehtë të intrigojnë me egjiptianët për të arritur që rripin e Gazës dhe Cisjordaninë t'i kthejnë në një shtet me njëfarë autonomie për palestinezët. Kjo mund të jetë një ide në erë, por jo pa baza. Kurse palestinezët, të vendosur në Liban, pësojnë vazhdimisht sulmet e avionëve bombardues izraelitë, në përgjigje të çdo aksioni nga ana e tyre. Aksionet e vazhdueshme që bëjnë palestinezët, janë shprehje e luftës së tyre për çlirimin e atdheut të humbur.

Aktualisht, të gjitha vendet që kundërshtojnë Egjiptin, mbrojnë çështjen palestineze, por kjo mbrojtje diku është më substanciale, diku e tulatur, diku vetëm me fjalë. S'është çudi që palestinezët e vendosur në Siri, në Irak e gjetkë dhe sidomos në Emiratet e Gjirit Persik dhe në Iran shërbejnë si mjet presioni kundër imperializmit amerikan nga ana e këtyre shteteve (ku ndodhen palestinezët), por në të njëjtën kohë edhe si një pengesë për marrëveshjet që këto shtete mund të bëjnë me fuqitë imperialiste e socialimperialiste.

Edhe palestinezët nuk janë të lidhur midis tyre në një unitet të fortë. Gjendja e tyre është pasqyrë e kon-

tradiktave të shumta që brejnë vetë popujt dhe shtetet arabe. Në gjirin e luftëtarëve palestinezë ka shumë fraksione të ndryshme. Politika që ndjekin Arafati dhe Al Fatahu, për shkak të luhatjeve të tyre të dyshimta, nuk mund të përcaktohet se ç'politikë është, ndërsa Habashi, që hiqet shumë intransigjent kundër Izraelit dhe nuk bie dakord me Al Fatahun për t'ia arritur qëllimit të tij, mund të bjerë dakord me Bashkimin Sovjetik socialimperialist.

Kështu që Lindja e Mesme nuk është dhe nuk do të jetë kurrë e qetë dhe, pavarësisht se pozitat e imperializmit amerikan u forcuan disi me nënshkrimin e Traktatit egjiptiano-izraelit, prapëseprapë politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjendet në vështirësi të mëdha në këtë pellg të madh të ashtuquajtur pellg i naftës, pellg arab. Në këtë rajon nuk do të ketë qetësi, sepse kontradiktat ndërmjet imperialistëve amerikanë, anglezë, francezë e sovjetikë dhe klikave të ndryshme sunduese, që do të mbajnë anën e njërit ose të tjetrit shtet imperialist, si dhe kontradiktat e popujve kundër klasave sunduese, do të vijnë duke u shtuar.

Tash të shohim ç'vend zë Shqipëria në popujt e Afrikës dhe të vendeve arabe. Ne mund të themi se Shqipëria socialiste, sido që është e vogël, nëpërmjet kontakteve politike, ekonomike e kulturore është bërë e njohur dhe gëzon një emër shumë të mirë në të gjithë popujt e këtyre vendeve, bile edhe në shumë udhëheqës të tyre, që kanë kontradikta me superfuqitë dhe me shtetet e zhvilluara kapitaliste. Në këto vende, pra, ka një admirim për Shqipërinë, për politikën parimore të saj, për guximin, për trimërinë, për pavarësinë dhe për sovranitetin që ajo e ruan të paprekur dhe të pavarur nga fuqitë e huaja.

Qëndrimi dhe politika jonë bëjnë përshtypje të madhe në këta popuj që aspirojnë për liri e pavarësi të vërtetë. Përshtypje bën gjithashtu rendi ynë socialist, të cilin ata e ëndërrojnë, por akoma nuk e shohin dhe nuk realizojnë

qartësisht se si mund të arrihet dhe si mund të ndërtohet shoqëria e re si në vendin tonë.

Ne kemi bindjen se shoqëria e re do të ndërtohet edhe atje, se marksizëm-leninizmi do të triumfojë, pavarësisht nga shpifjet e mëdha që bëhen kundër kësaj doktrine nga propaganda borgjeze, pavarësisht nga diskreditimi që i kanë bërë dhe përpiqen t'i bëjnë revizionistët me ata sovjetikë në krye. Propaganda borgjezo-revizioniste nuk e ka atë efekt që dëshirojnë të arrijnë këta armiq të popujve.

Shtypja, varfërimi, mjerimi, diferenca e theksuar klasore, kontradiktat e ashpra që ekzistojnë në këto vende i bëjnë njerëzit përparimtarë, proletarët e qyteteve dhe të fshatrave e inteligjencien progresiste që, pa e njohur si duhet marksizëm-leninizmin, të mendojnë dhe të arrijnë në konkluzionin se kjo teori e praktikë revolucionare luftohet me kaq forcë nga kapitalistët dhe revizionistët për arsye se është kundër këtyre, kundër shtypësve dhe pro të shtypurve.

Prandaj ne konstatojmë se materialet e Partisë sonë, që arrijnë në këto vende lexohen e studiohen dhe edhe përqafohen. Kjo, midis të tjerave, flet për atë terren të përshtatshëm që është përgatitur dhe po përgatitet për luftëra nacionalçlirimtare dhe më vonë për luftëra revolucionare proletare në këto vende.

Prandaj në këto situata në Afrikë, në Evropë dhe në Lindjen e Mesme lipset që elementët përparimtarë me në krye komunistët marksistë-leninistë të luftojnë për hartimin e një vije të drejtë lufte, organizimi dhe uniteti. Dhe këto forca në këto vende ekzistojnë; ato kanë një eksperiencë të tyre lufte dhe bëjnë përpjekje të përparojnë.

Natyrisht nga të gjithë marksistë-leninistët, nga të gjitha partitë marksiste-leniniste duhet bërë një punë e madhe e diferencuar që, kudo ku ato mund të kenë influencë dhe kontakte, të njohin mirë këto vende, këta popuj,

të analizojnë konkretisht gjendjen politike dhe shoqërore të tyre dhe të dinë ta shpjegojnë në ta marksizëm-leninizmin, rrugën dhe perspektivat që hap teoria jonë, teoria e çlirimit kombëtar dhe shoqëror.

Kjo, që mund të duket një ambicie e madhe, nuk është pa baza e pa perspektivë, përkundrazi është e mundshme e me rezultate të mundshme. Do të ngjiten shkallët e revolucionit njëra pas tjetrës, do të këputen hallkat e zinxhirit të kalbur kolonial e neokolonial, borgjez dhe monarkist atje ku kontradiktat janë më të mëdha, ku faktori objektiv është në ngjitje të madhe dhe faktori subjektiv ka arritur në një shkallë të atillë që është në gjendje të organizojë luftën e armatosur dhe të shpërthejë revolucionin.

Dhe shpërthimi i revolucioneve nuk është i pamundur. Marksistë-leninistët e kanë të qartë se revolucioni është një problem aktual që po përgatitet dita-ditës dhe duhet të punojnë që kjo ide të përvetësohet edhe nga njerëzit e popullit, njerëzit përparimtarë e të ndershëm. Në të gjitha vendet e botës, në të gjitha kontinentet duken shfaqje revolucionare, me intensitet të ndryshëm. Si duhet të veprohet në këto momente? Si duhen interpretuar e shfrytëzuar këto shfaqje? Natyrisht marksistë-leninistët e kanë për detyrë internacionaliste t'i interpretojnë drejt ato, por u përket elementëve përparimtarë dhe veçanërisht proletariatit të çdo vendi, që, duke u zgjuar, të punojnë për t'i shfrytëzuar këto shfaqje dhe për të krijuar kushtet e nevojshme për marrjen e fuqisë në duart e tyre.

Sigurisht fuqia nuk mund të merret aq kollaj. Në qoftë se ne, marksistë-leninistët dhe popujt që janë të shtypur, i konsiderojmë superfuqitë imperialiste dhe socialimperialiste si të pathyeshme, sikur janë ato që bëjnë kohën e mirë ose kohën e keqe për popujt e botës, atëherë jemi larg asaj që revolucioni të triumfojë. Prandaj një mendim i tillë duhet flakur tej. Në realitet superfuqitë imperialiste e socialimperialiste janë në kalbëzim, janë të krimbura, të degjeneruara dhe bazat e tyre janë të tronditura. Ndodh kështu, sepse rendi i tyre është në krizë të madhe, sepse popujt janë ngritur në luftë kundër tyre. Megjithatë këto superfuqi me makinën e tyre ushtarake, me forcën dhe me organizimin e strukturave ekonomike e të superstrukturave të tyre politike, të cilave u japin pamje të ndryshme, përpiqen t'i bëjnë njerëzit të mendojnë se atyre nuk mundet t'u bëhet dot ballë. Dhe fakt është që ka njerëz që e ushqejnë dhe e pranojnë një mendim të këtillë.

Çështja është që superfuqitë imperialiste e socialimperialiste të konsiderohen ashtu siç janë realisht, as të nënvleftësohen, por as edhe të mbivlerësohen. Vetëm në këtë mënyrë do të gjenden të çarat e tyre, të cilat janë të dukshme dhe në të cilat mund të hyhet me forcë revolucionare për të shpërthyer themelet në ndërtesën e tyre të krimbur e për ta hedhur pastaj në erë të gjithë ndërtesën.

Siç e theksova edhe më sipër, aktualisht imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik bëjnë përpjekje të mëdha për t'u fuqizuar e për t'u dukur si dy superfuqi të mëdha të pamposhtshme. Është e vërtetë se ata kanë një potencial të madh ushtarak atomik, kanë një forcë ekonomike të madhe, bëjnë një politikë botërore skllavëruese, influencojnë dhe ndërhyjnë në punët e brendshme të popujve dhe të shteteve të tjera, bëjnë ligjin në shumë vende, diku në mënyrë të ashpër, diku tërthorazi, por prapëseprapë ata janë në kalbëzim, pozitat e tyre janë lëkundur. Ata përpiqen t'i forcojnë pozitat e tyre, por është e pamundur t'ia arrijnë këtij qëllimi në kurriz të popujve që shtypin. Sa më shumë kohë kalon, aq më shumë edhe popujt shikojnë se në botë po polarizohen forcat ndërmjet atyre që duan revolucionin dhe atyre që duan ta shtypin atë. Janë popujt ata që do ta bëjnë revolucionin, prandaj ata duhet të ndalojnë luftërat gra-

bitqare imperialiste dhe të ndezin luftërat nacionalçlirimtare, që i hapin rrugën revolucionit proletar botëror.

Të kesh armë, të kesh dollarë, nuk do të thotë se ke një fuqi të pamposhtshme. Po të kesh popullin politikisht të ndërgjegjshëm dhe të organizuar për një rezistencë të ashpër, atëherë po, mund të thuash se e ke fuqinë në dorë për t'i rrëzuar këta gogolë. Dihet se këta «gogolë» brehen nga kontradikta të thella në mes tyre, të cilat përpiqen t'i evitojnë, por është e kotë. Ne luftojmë kundër luftërave të padrejta, luftërave imperialiste, sepse ato bëhen në kurriz të popujve, por edhe nga ana e imperialistëve, veçanërisht në kushtet aktuale të zotërimit të armëve atomike dhe zgjimit të ndërgjegjes së popujve, bëhen përpjekje për t'i evituar kontradiktat, sepse e dinë se, po shpërtheu një luftë e re botërore atomike, ajo do të jetë në të njëjtën kohë në dëm të tyre dhe në fitim të revolucionit, do t'i sjellë njerëzimit humbje kolosale, por do të vërë në rrezik edhe rendin e imperialistëve.

Në këtë kuptim marrëveshjet SALT dhe pazarllëqet e tjera që bëjnë superfuqitë, i bëjnë nga frika e revolucionit, nga kriza ekonomike e superprodhimit, nga kriza politike, ideologjike dhe ushtarake. Me marrëveshjet SALT ato kërkojnë të balancojnë armët atomike dhe, në të njëjtën kohë, fuqinë ekonomike, që mund të ekonomizojnë nga harxhe të tilla, t'ua kushtojnë, nëpërmjet investimeve, shtypjes së popujve, shfrytëzimit të djersës dhe pasurive të këtyre popujve në interesin e metropoleve, për krijimin e një jete të begatshme dhe përrallore për shoqërinë e zotërinjve të mëdhenj.

Synimi i imperialistëve të ndryshëm amerikanë, sovjetikë, kinezë, japonezë, francezë, anglezë etj., është pra të balancojnë fuqitë e tyre ekonomike dhe ushtarake, si midis njëri-tjetrit ashtu edhe midis grupimeve të ndryshme. Natyrisht kjo arrihet duke nënshkruar marrëveshje të ndryshme të hapëta dhe të fshehta.

Socialimperializmi i ri kinez i etshëm për pushtime të

reja, për të pushtuar tregje të reja, është hapur drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Japonisë dhe vendeve kapitaliste të zhvilluara. Qëllimi i Kinës është që ajo të bëhet superfuqi ekonomike dhe ushtarake dhe të dominojë të gjithë Azinë Juglindore, të bëjë ligjin në vendet e ASEAN-it dhe mundësisht edhe në Pacifik e t'i presë rrugën Japonisë. Mundet që Kina të sulmojë edhe Siberinë, por mund të bashkohet edhe me socialimperialistët sovjetikë për të kundërshtuar imperialistët amerikanë. Por në rast se këta të fundit e ndihmojnë Kinën, duke mbyllur sytë përpara qëllimeve të saj, atëherë kjo mund të bëhet një rrezik shumë i madh edhe për vetë ekspansionin imperialist të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prandaj, aktualisht, ne shohim që Kina, me një regjim fashist, me përpjekje të pamatura e të pabazuara në zhvillimin e ekonomisë, me ambicie megalomane për realizimin e «katër modernizimeve» në një periudhë, si të thuash, sa hap e mbyll sytë, dhe këtë me ndihmën e imperialistëve amerikanë, japonezë dhe të kapitalistëve të tjerë, gjendet në një kaos të madh. Gjendja në Kinë është e pastabilizuar dhe pa stabilizim nuk mund të ecet dot në rrugën e pushtimeve të mëdha dhe të konkurrencës së madhe kundër superfuqive. Prandaj bëhen përpjekje të përditshme, por të kota hëpërhë, për «unitet», për disiplinë kundër të djathtëve, kundër të majtëve, kundër së djathtës ekstreme e së majtës ekstreme, kundër radikalëve e demokratëve.

Kjo tregon se Kina nga ana politike është në kaos të madh, atje ekziston pushteti i zotërinjve, se në Kinë asnjëherë nuk është ndërtuar socializmi, asnjëherë nuk ka ekzistuar diktatura e proletariatit, veçse diktatura personale ose e grupit. Dhe tash këto grupe po luftojnë njëri kundër tjetrit kush e kush të dominojë, por dominimi i plotë i njërit apo i tjetrit grup është i pamundur. Për këtë do të duhet një kohë mjaft e gjatë. Megjithatë kjo situatë favorizon aventurat e fashistëve kinezë. Aven-

tura e parë është hapja e Kinës me një vrull të tillë të madh drejt Perëndimit; aventura e dytë është lufta e Vietnamit dhe këmbëngulja për t'i dhënë «mësime» të tjera atij. Por këto «mësime» që Kina u jep, përveç Vietnamit edhe Laosit, Kamboxhias dhe vendeve të tjera të ASEAN-it, që nga Filipinet deri në Indonezi, kanë vetëm një qëllim: që këto të futen në orbitën politiko-ekonomike dhe ushtarake të Kinës.

Ne, gjithashtu, konstatojmë se Evropa e Bashkuar, Evropa e reaksionit, e kapitalizmit, Evropa që hodhi dy herë botën në zjarr që nga 1914-a dhe që mund ta hedhë edhe për herë të tretë, përbën një forcë të madhe ekonomike, politike dhe ushtarake. Por si forcë ushtarake kjo nuk mund ta përballojë dot forcën sovjetike pa ndihmën e imperializmit amerikan, kurse si forcë ekonomike mund të luajë kartën e saj. Natyrisht në format e ndërlikuara që ekzistojnë aktualisht në këtë fushë ndërmjet fuqive imperialiste, edhe Evropa e Bashkuar nuk mund t'u shpëtojë dot, si një entitet, këtyre lidhjeve me imperializmin amerikan.

Ky imperializëm do të jetë për Evropën e Bashkuar kurdoherë një mbështetje e orës 12^{00} kundër një invadimi sovjetik. Politikisht Evropa e Bashkuar përpiqet që ta zbutë politikën me Bashkimin Sovjetik, se ka interesa të mëdha ekonomike dhe kërkon si e si të evitojë një konflagracion në mes saj dhe Bashkimit Sovjetik. Kësaj i intereson më shumë që kontradiktat të thellohen ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Kinës dhe kjo të rezultojë në një luftë në Lindjen e Largme, i intereson, gjithashtu, që kontradiktat të ashpërsohen në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mes Kinës nga njëra anë dhe Japonisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga ana tjetër. Kështu Evropa e Bashkuar mendon që të tjerët t'i nxjerrin gështenjat nga zjarri për të. Por këto janë iluzione, siç janë shpresa pa baza të shëndosha edhe ato për unifikimin e kësaj Evrope të shteteve të ndryshme,

me kultura, me interesa ekonomike të ndryshme dhe me ambicie të ndryshme dominimi, qoftë në Tregun e Përbashkët Evropian, qoftë në aleancën e Evropës së Bashkuar, qoftë edhe në Afrikë edhe në vendet e tjera koloniale.

Kështu që edhe Evropa e Bashkuar, për të cilën aktualisht bëjnë zhurmë të madhe të gjitha shtetet e botës, nuk është veçse një zgjidhje efemere e një politike reaksionare, e një politike kapitaliste, që, shpejt ose vonë, do të gjendet përballë vështirësive të panumërta, të shumanshme dhe të natyrave të ndryshme, të cilat në vend që ta forcojnë, do ta dobësojnë atë.

Proletariati evropian nuk mundet vazhdimisht t'u bindet bosëve sindikalistë dhe partive të ashtuquajtura socialdemokrate dhe revizioniste që llomotitin se me zhvillimin e strukturave, me rrugën parlamentare ose me rrugën e reformave do të fitohet një e ardhme më e mirë. Çdo ditë e më e qartë po bëhet se Evropa e Bashkuar e errëson ëndrrën e proletariatit dhe të popujve të Evropës për një të ardhme të lumtur. Prandaj grevat dhe demonstratat që po zhvillohen në Evropë, papunësia, drogat, degjenerimi, inflacioni, që kanë përfshirë vendet e këtij kontinenti, të gjitha këto nuk do të mund të frenojnë pjesën e madhe të shëndoshë të këtyre popujve që revoltohen kundër regjimeve reaksionare në fuqi. Dhe, në një moment, kjo revoltë do të arrijë kulmin që kërkon patjetër zgjidhje.

I njëjti proces, natyrisht, me karakteristika të ndryshme, po ndodh edhe në Amerikën Latine. Imperializmi amerikan ndikon më fuqimisht në këto vende të Amerikës së Jugut, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë punuar më me forcë, në mënyrë më radikale dhe kanë arritur të krijojnë në udhëheqjet ushtarake të këtyre vendeve ndjenjën e një qeverisjeje me mënyra puçiste dhe gjoja në forma demokratike. Puçet sjellin në fuqi gjeneralë të ndryshëm, qeveri që krijojnë përshtypjen sikur gjoja bëjnë reforma ekonomike dhe politike, por në rea-

litet këto nuk janë veçse qeveri ushtarake diktatoriale, shfrytëzuese të pamëshirshme të popujve të Amerikës Latine dhe bashkëpunëtore të imperializmit amerikan.

Amerika e Veriut e quan Amerikën e Jugut, si të thuash, një çiflig të sajin. Edhe Kuba me pikëpamje gjoja revolucionare, e cila gjoja do t'i vinte zjarrin revolucionar Amerikës së Jugut, ka hequr krejtësisht dorë nga revolucioni që me vdekjen e Çe Guevarës. Aktualisht Kuba mercenare e Bashkimit Sovjetik po dërgon me dhjetëra mijë ushtarë në Afrikë gjoja për të mbështetur «revolucionet» në vende të ndryshme të këtij kontinenti, por një gjë e tillë, në fakt, bëhet për të përgatitur neokolonializmin për socialimperialistët sovjetikë.

Pra si konkluzion ne mund të themi se panorama aktuale politike është kjo: imperializmi amerikan, sovjetik, kinez, japonez duken si forca të mëdha që bëjnë ligjin në botë, por, po të analizohet gjendja më thellë, nuk është tamam kështu. Këto forca të mëdha, ushtarake dhe ekonomike, po dobësohen çdo vit e më shumë. Kriza e gjithanshme që ka mbërthyer fort këto vende, miliona të papunë, inflacioni dhe rënia e përqindjes së prodhimit industrial të këtyre vendeve, të tëra e tregojnë këtë dobësi, tregojnë, gjithashtu, varfërimin e madh të masave punonjëse që sjell me vete revoltën e tyre kundër padronëve.

Në këtë situatë çdo ditë më e fuqishme zhvillohet lufta e pandërprerë e popujve kundër fuqive imperialiste dhe klikave sunduese vendase. Kjo luftë është e ndjeshme, është e dukshme, është e prekshme. Disa herë kjo duket e pashpresë, por nuk është ashtu. Mund që në një moment lufta revolucionare të pësojë edhe një disfatë, por kjo është e përkohshme. Pas disfatës përgatitet përsëri revolucioni e vjen fitorja. Në këtë luftë të masave të shtypura, ne shohim një lëvizje të gjallë, një organizim, ku më të fortë e ku në embrion, kundër manovrimeve të fuqive të mëdha imperialiste, të cilat janë të detyruara

të përdorin të gjitha taktikat e mundshme për të gënjyer, për të mashtruar dhe për t'i larguar popujt nga rruga e drejtë e tyre.

Prandaj është e domosdoshme që nga ne, marksistë-leninistët, nga revolucionarët dhe popujt të kuptohen mirë taktikat e ndryshme të fuqive imperialiste, të shihet qartë si zhvillohen, si kurdisen e ç'synime kanë, me qëllim që të përcaktohet drejt se si duhet të veprojmë që të bëjmë të dështojnë ato, njëra pas tjetrës. Dështimi i tyre krijon premisa për kundërshtime, të cilat ndjekin njëra-tjetrën derisa arrihet në kryengritje të përgjithshme.

E HËNË
28 MAJ 1979

TITOJA DHE VENDET «E PAANGAZHUARA»

87-vjeçari Tito është i sëmurë, por me sa duket jo fizikisht sepse më 25 maj e pamë në stadium të lyer si një konkë. I ndriste fytyra nga kremi dhe nga masazhi që i kishin bërë, ndërsa leshrat e kokës i kishte skuqur e bërë flakë.

Në vendin tonë thonë se kuqalashët janë të pabesë. Mundet që kjo nuk është kështu, është një pikëpamje raciste. Ama për sa u përket pabesisë, dredhisë, tradhtisë, Titoja është mjeshtër. Ky mjeshtër i gënjeshtrës kërkon të gënjejë edhe me trupin e tij dhe të bëhet «i bukur», në mënyrë që fjalët e tij të rreme të besohen.

Por çështja është se Titoja vuan nga «ethet e kalit» përpara vdekjes së afërt, pse ai kërkon që ta mbarojë jetën e tij aventureske dhe tradhtare pa «një njollë», pa «një disfatë», edhe pse në të vërtetë ajo s'ka veçse disfata.

Aktualisht dadaja më e preferuar e Titos është teoria e vendeve «të paangazhuara». Me këtë teori ai ka gjetur një «qoshe» dhe i përmbahet kësaj, pse i ka sjellë shumë dollarë si nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe nga vendet e tjera kapitaliste. Por e ashtuquajtura teori e «të paangazhuarve», që gjoja grumbullon të gjitha shtetet që «zyrtarisht» nuk bëjnë pjesë në blloqe e veçanërisht në atë të NATO-s e në atë të Varshavës, i lejon ata të bëjnë pjesë në blloqe të tjera ushtarake a çfarë të duan, në të cilat, në fakt, ata bëjnë pjesë dhe për

këtë nuk pyesin njeri. Kjo teori e Titos, pra, siç e kam thënë edhe herë të tjera, ka qenë dhe është në leverdinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste që e financojnë.

Për këtë teori nuk ka qenë financuar vetëm Titoja, por edhe njerëz të tjerë si Naseri, Nehruja, Sukarnoja, Nkruma dhe deri në njëfarë shkalle dhe në një formë tjetër të maskuar edhe Çu En Lai, pse edhe ky ishte partizani i një miqësie të ngushtë me amerikanët, por rrethanat e pengonin që ta shpallte në dritën e diellit dashurinë e tij për Perëndimin.

Kështu që këta njerëz, kryetarë shtetesh, që financoheshin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet kësaj teorie përpiqeshin të ruanin statukuonë neokolonialiste, të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore, të ndihmonin Shtetet e Bashkuara të Amerikës të invadonin tregjet e botës veçanërisht tregun e sterlinës e atë të frangut dhe të pengonin zhvillimin neokolonialist të socialimperializmit sovjetik.

Mirëpo njëri pas tjetrit, këta të ashtuquajtur liderë të popujve të tyre vdiqën. Vdiq Naseri, vdiq Nehruja, vdiq Nkruma, vdiq Sukarnoja, vdiq edhe Çu En Lai dhe ngeli vetëm Titoja. Tash ky është bërë si «perandori» i kësaj «mbretërie të pavarur», që në të vërtetë është varur në litar. Mbiquhet «perandor» për politikën që ai zbaton dhe që gjoja mbështetet nga të gjitha këto vende. Edhe nga pikëpamja e jetesës që bën Titoja jo vetëm i ngjet një perandori, perandorit Bokasa të Afrikës Qendrore, por ia tejkalon edhe oborrit mbretëror të Britanisë së Madhe. Edhe mbretëresha Elizabeta ka një kufi në ceremonitë, në udhëtimet, në shpenzimet që bën. Bile ka disa vjet ajo bëri edhe një kërkesë në Dhomën e Komuneve që t'i shtohej rroga, sepse nuk i «mjaftonte» për shpenzimet e mëdha që bënte. Ajo, natyrisht, ka disa pallate ku vete herë pas here dhe jep disa shfaqje mbretë-

rore, kurse Titoja s'ka llogari fare për këtë çështje. Të gjitha kështjellat e vjetra dhe të reja të Jugosllavisë janë mobilizuar dhe janë modernizuar për të dhe çdo javë ai i ndërron ato, siç thotë populli, «si mbreti gratë».

Udhëtimet e tij jashtë janë bërë të panumërta, aq sa nuk mund të quhen veçse aventureske. Vetëm një aventurier mund të udhëtojë në një mënyrë të tillë, një aventurier që kërkon të fitojë të holla si ata mesitët e kompanive të mëdha tregtare që shëtitin nga të katër anët e botës me valixhe e me kampionë në duar për të shitur kamelotën e padronit. Kështu po bredh kudo edhe Titoja. Në të gjitha shtetet e botës ka shkuar jo nga një herë, po nga shumë herë. Vetëm në Shqipëri ai nuk ka ardhur, e nuk mund të vijë kurrë.

Mirëpo kjo jetë aventureske perandorake bokasiane, ose puna prej sharlatani, ka bërë që, pavarësisht nga kreditë prej miliarda dollarësh që ka marrë, Jugosllavia të katandiset në një vend nga më të mjeruarit që mund të ketë në botë e ku mbretërojnë papunësia, inflacioni, emigracioni, korrupsioni në të gjitha shkallët aq sa, i tmerruar nga kjo gjendje, vetë Titoja, në fjalimet që mban, u thotë borgjezëve të rinj të bëjnë ca kujdes në vjedhjet që kryejnë, për arsye se ngrihet deficiti. Si pasojë mund të mos jetë larg ajo kohë, që Jugosllavia do të jetë plotësisht e shitur te borxhlinjtë e mëdhenj e të shumtë.

Por, sidoqoftë, e ashtuquajtura teori e vendeve «të paangazhuara» i ka sjellë këtij aventurieri kënaqësi personale e oborrtare dhe është pompuar aq shumë nga ata që kërkojnë që ky njeri i paturp të shesë plaçkat e tyre, saqë i është mbushur mendja me lakra aq të kota, sa edhe gjoksi me nishane. S'ka mbetur nishan e dekoratë pa marrë nga një, nga dy, nga çdo shtet. Me gjithë këto, me gjithë përpjekjet e tij, me gjithë rrahjen e ujit në havan, teoria e tij e vendeve «të

paangazhuara» po shkoqet dita-ditës më shumë. Zaten bota e «të paangazhuarve» s'ka qenë kurrë një kalli, sepse më të shumtat e vendeve që e përbëjnë atë kanë qenë kokrra të krimbura nga borxhet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të vendeve të pasura perëndimore. Tash atyre u ka hyrë edhe krimbi sovjetik dhe po përpiqet të futet edhe krimbi kinez.

Titoja, pra, ka rënë në hall, jo pse po i shkatërrohet perandoria e paqenë, por pse edhe hija e saj po zbehet. Dhe është e natyrshme që ajo të zbehet pse vendet në fjalë fjalën e Titos e kanë në vend të... Mbase ata edhe gënjehen dhe arsyet kryesore për këtë janë kontradiktat, të cilat Titoja i di fare mirë që ekzistojnë, por bashkë me padronët e tij është përpjekur që, me intriga, me kredi, me borxhe, me komplote e puçe pallatesh, t'i zvogëlojë, t'i zhdukë ato.

Pra Titoja, për sa i përket politikës me këto vende, ka ndjekur vijën e imperializmit amerikan dhe të vendeve të tjera të pasura perëndimore dhe ky myteber vente e vinte poshtë e përpjetë sikur gjendej në punë. Beogradi dhe Brioni u bënë qendrat e vajtje-ardhjeve të shumë politikanëve të falimentuar që mendonin se vajtja te Titoja dhe ndërmjetësimi i tij te padronët e mëdhenj mund t'u siguronte diçka, ndonjë thërrime edhe atyre. Por vajtje-ardhjet në Beograd dhe në Brioni nuk i përmirësonin as pozitat e Titos, as ato të atyre që bënin vizitën. Pozitat e Titos demaskoheshin më shumë, ndërsa kontradiktat midis vendeve të ndryshme të ashtuquajtura të pavarura apo të paangazhuara, ashpërsoheshin deri edhe në konflikte të armatosura.

Këto kontradikta pra, dashkan apo s'dashkan imperializmi amerikan dhe shërbëtori i tij Tito, dashkan apo s'dashkan Begini, Sadati, iksi dhe ipsiloni, veprojnë dhe thellohen. Ato thellohen edhe më shumë, sepse socialimperializmi sovjetik është bërë shumë agresiv

dhe i rrezikshëm aq sa agresiviteti i tij ka arritur të jetë i njëllojtë me atë amerikan. Pra ka dalë në skenë një konkurrent tjetër i fuqishëm, i cili kërkon që të ashtuquajturat vende të paangazhuara, domethënë koloni të mundshme, vende të mundshme për shfrytëzim, të jenë në këtë lëvizje dhe mundësisht nën drejtimin e sovjetikëve. Prandaj konkurrenca në mes të dyja superfuqive ka marrë një formë të ngatërruar dhe luftohet në të gjitha vendet për influencë. Lufton imperializmi amerikan kundër socialimperializmit sovjetik, lufton imperializmi dhe militarizmi japonez kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mënyrë të kamufluar, kundër Bashkimit Sovjetik po ashtu në mënyrë të kamufluar, lufton Gjermania Perëndimore për të zgjeruar zonën e markës, lufton Kina revizioniste e Mao Ce Dunit pa një rup në xhep, por me shpresa se imperializmi amerikan dhe të tjerët do ta ndihmojnë për t'u bërë një superfuqi kundërshtare e Bashkimit Sovjetik, lufton Franca borgjeze, lufton edhe Tregu i Përbashkët Evropian, me një fjalë luftojnë të gjithë.

Të gjithë po sulmojnë. Po ku po sulmojnë? Kudo në botë, edhe atje ku kanë pasur influencë, edhe atje ku duan të krijojnë influenca të reja. Kuptohet ndeshjet që lindën nga këto sulme nuk mund të zgjidhen as me udhëtimet e Miniçit, as me vajtje-ardhjet e Titos. Këto kontradikta janë të thella, janë klasore. Ato do të thellohen dhe do të mbërrijnë deri në pikën kulminante, kur shpërthen revolucioni. Pikërisht kundër kësaj mundësie, kundër shpërthimit të këtij revolucioni, luftojnë të gjithë këta imperialistë, kapitalistë dhe borgjezë me Titon së bashku.

Bashkimi Sovjetik nuk është futur në «botën e paangazhuar» dhe, kuptohet, as në «botën e tretë», siç është futur Kina, e cila me teorinë e saj të «tri botëve» ka dashur të krijonte atë situatë që do të çonte në forcimin e pozitave të saj imperialiste, por që Partia e Punës e Shqipërisë ia demaskoi.

Sidoqoftë, Bashkimi Sovjetik jo vetëm që në mjaft vende të «botës së paangazhuar» e të «botës së tretë» ka influencë ekonomike, politike e ushtarake, por ka filluar të nxjerrë në gjirin e këtyre shteteve një grup tjetër shtetesh, të cilat dëshirojnë dhe luftojnë që t'i kthejnë edhe të tjerat nga Bashkimi Sovjetik, ta kthejnë rrotën nga ana e Bashkimit Sovjetik dhe jo më nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndër këto shtete, miq të Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë janë Kuba, Vietnami, Laosi, Kamboxhia, por ka edhe vende të tjera të Afrikës, të cilat kanë kontradikta në mes tyre, si për shembull vendet arabe me Sadatin. Edhe këto vende nuk dëshirojnë që Sadati të bëjë pjesë në vendet «e paangazhuara» dhe e kanë bojkotuar atë. Ka edhe vende të tjera që, për arsye të ndryshme, nuk mund të jenë dakord as me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as me Titon, as me Bashkimin Sovjetik. Në këtë stan me lepuj, pra, kanë hyrë zagarë të ndryshëm dhe po i trembin. Kështu që mbledhjet formale që organizon Titoja nën drejtimin e amerikanëve do të vazhdojnë të bëhen, por me pengesa të mëdha. Këtë gjë e vërteton edhe situata që është krijuar lidhur me mbledhjen e ardhshme që do të mbahet në Havanë.

Mbajtja e konferencës së vendeve «të paangazhuara» në Havanë, natyrisht, bëhet në një vend jo të favorshëm për Titon, pse Kuba ka pretendime të mëdha që të zërë vend kryesor në të ashtuquajturën udhëheqje të këtyre vendeve «të paangazhuara». Nga ana tjetër, Vietnami dëshiron që të dëbohet nga lëvizja qeveria e Pol Potit dhe në vend të saj të futet qeveria e re e Kamboxhias. Vendet arabe do të kërkojnë që të përjashtohet Egjipti, po ashtu Tanzania nga ana e saj do të kërkojë të përjashtohet Uganda e Idi Aminit, ndërsa

Kadafi mbështet Aminin, kurse Algjeria nuk dimë nga do t'ia mbajë. Me fjalë të tjera, e famshmja teori e Titos është katandisur në një çorbë derri dhe kjo gjë ka bërë që t'i futen Titos «ethet e kalit».

Prej muajsh agjentët e Titos, si Miniçi, po bredhin nga të katër anët për të bindur, për të blerë e për të financuar udhëheqës, natyrisht, me paratë e amerikanëve që të ruhet nën ombrellën e tyre statukuoja dhe «uniteti» i vendeve «të paangazhuara» dhe të mos dëgjohen përçarësit, që janë të kampit sovjetik. Kështu që në organizatën e këtyre vendeve «të paangazhuara» duken disa çengelë për të varur mishrat: çengeli sovjetik, çengeli amerikan dhe një çengel tjetër ende i lirë, ku Kina përpiqet të varë mishrat e saj. «Të pavarurit» janë pra të tërë të varur në ankand. Ç'do të dalë nga kjo supë e Havanës? Asgjë e mirë, vetëm turp, diskreditim, kontradikta dhe thellim i këtyre të fundit.

Si një element aventurier dhe fodull, që i shkatërroi Jugosllavinë dhe popullin jugosllav, Titoja ka frikë të madhe nga Bashkimi Sovjetik, por dëshiron të hiqet si i pafrikshëm. Ai, «i pavarur» nga kurrkush, është i varur më shumë nga amerikanët e nga perëndimorët, më pak nga sovjetikët, por prapëseprapë është shumë i varur dhe shumë i ndjeshëm nga këta të fundit. Ai merr ndihma ekonomike dhe ushtarake edhe nga sovjetikët. Një pjesë e madhe e ushtrisë së tij është e pajisur me armë sovjetike.

Por, përveç kësaj, Titoja bën edhe tregti të madhe me Bashkimin Sovjetik e me satelitët e tij dhe këta përpiqet t'i nxitë e t'i ketë si një barrierë përballë sovjetikëve, por edhe për të intriguar me ta. Mirëpo këta nuk i hanë kollaj vickat e veprimet e Titos, prandaj përpiqen t'ia prishin planet dhe t'i futin frikën në pleqëri, me fjalë të tjera Jugosllavinë e kërcënojnë me

shkatërrim pas vdekjes së tij, pavarësisht se aktualisht japin përshtypjen sikur as nuk u shkon ndër mend një gjë e tillë. Brezhnjevi dhe shokët e tij që në publik e konsiderojnë Titon si «mik» e si «shok», në fakt e urrejnë.

Mirëpo edhe ky nuk i ha të puthurat e Juda Iskariotit ortodoks të kishave të Kremlinit. Herë pas here ai ia hipën avionit dhe shkon në Moskë, gjoja për të zgjidhur problemet bilaterale dhe edhe ato ndërkombëtare. Mbi të gjitha Titos i ka rënë në qafë Zhivko bullgari, me një fjalë nacionalizmi bullgar, shovinizmi bullgar, që është në rivalitet me shovinizmin serbomadh ose titomadh.

Bullgarët pretendojnë se maqedonasit janë bullgarë, kurse titistët pretendojnë ndryshe, se maqedonasit janë një komb i veçuar dhe nuk i kanë borxh kurrkujt dhe është Bullgaria ajo që i ka borxh Maqedonisë titiste, domethënë duhet t'i kthejë asaj Maqedoninë Pirine ose të pranojë që ekziston një minoritet maqedonas në Bullgari. Bullgarët kanë shkuar më tej dhe me një dekret e kanë likuiduar minoritetin maqedonas pirin dhe kanë hapur defterët e vjetër të kralëve dhe të historiografëve shovinistë për të vërtetuar se Maqedonia është pjesë e Bullgarisë.

Në këtë lodër të madhe të dyja palët harrojnë se një pjesë e kësaj Maqedonie, në ata kufij në të cilët e paraqesin ata, është tokë shqiptare, se atje ka edhe shqiptarë dhe se një pjesë e konsiderueshme e Maqedonisë është kufi me motrën e saj Shqipërinë dhe Kosovën. Por kjo është një çështje tjetër. Kështu në mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë ekziston një gozhdë e Nastradinit që herë hyn thellë, herë tërhiqet, por përgjithësisht lëviz, tërhiq e mos e këput nga të dyja anët. Kur është fjala për t'i bërë presion Jugosllavisë, ngri-

het Bullgaria dhe bën zhurmë, kur ka interesa, ulen pak pretendimet dhe violina bie në surdinë.

Por këtë herë Titoja shkoi te Bashkimi Sovjetik dhe i kërkoi personalisht Brezhnjevit të marrë masa që kubanezët, vietnamezët e miq të tjerë të Bashkimit Sovjetik të mos turbullojnë ujërat në konferencën e Havanës. Duke lexuar fjalimin e Brezhnjevit del se Bashkimi Sovjetik as çau kokën fare çfarë i tha Titoja. Në fakt fjalimi i Titos ishte shumë i gjatë. Aty ai tirrte shumë probleme, në atë formë diplomatike e me ato formulime, të cilat ai i ka bërë hezber prej 30 vjetësh. Të gjitha ç'tha Titoja, Brezhnjevit nga një vesh i hynë nga një vesh i dolën. Ai foli shkurt për miqësinë me popujt jugosllavë dhe asgjë tjetër.

Përveç kësaj Titoja kishte edhe një çështje tjetër për ta biseduar me Brezhnjevin, çështjen bullgare, domethënë të ndërhynte Bashkimi Sovjetik që Bullgaria të heqë dorë nga pretendimet që ka ndaj Maqedonisë. Natyrisht Brezhnjevi, të paktën në fjalimet e tij zyrtare, as që denjoi të fliste për këtë dhe as që mund t'i premtonte Titos diçka në këtë drejtim, jo vetëm pse ai nuk do t'i japë asnjë favor Titos për këtë çështje, por edhe për formë ai hiqet sikur s'përzihet në çështjet e Bullgarisë, as në ato të Vietnamit, megjithëse dihet se dora e tij kaurdis në këto vende fare lehtë dhe me mjeshtëri.

Kështu që Titoja u kthye nga Moska në Beograd si rruar qethur. Megjithatë propaganda jugosllave bëri ç'bëri e tha se Titoja shtroi një sërë problemesh që shqetësojnë Jugosllavinë dhe botën. Natyrisht shqetësimet e botës janë të mëdha, por këto shqetësime nuk i zgjidh dot Titoja. Ato do t'i zgjidhë revolucioni që do t'i përlajë Titon, padronët dhe bashkëbiseduesit e tij.

Jugosllavët këtë udhëtim të Titos në Moskë e mbuluan me datëlindjen e tij që e festuan si çdo vit me

madhështi, pa marrë parasysh as gjendjen kaotike të Jugosllavisë, as mjerimin ekonomik dhe pa përmbajtur aspak dorën në harxhet kolosale. Për fat të keq u gjend edhe një vajzë kosovare që doli dhe i dha Titos stafetën e rinisë jugosllave.

Por ç'tregon kjo? Kjo tregon se titizmi ndodhet në hall të madh me politikën e tij të çoroditur, të poshtër, antimarksiste, kapitaliste dhe me shtimin e me acarimin e kontradiktave në mes serbëve e kroatëve, në mes shqiptarëve dhe serbëve, në mes maqedonasve dhe serbëve, maqedonasve dhe shqiptarëve, kështu që Titoja kërkon ta ngjitë kupën e thyer si ajo fallxhesha me fjalët e saj «të rrjedhshme», por të gjitha pa baza dhe të rreme.

Thonë se pas disa ditësh ai do të shkojë edhe në Algjeri. Vajtja e tij në këtë vend lidhet patjetër me çështjen e konferencës së Havanës, por ai dëshiron të piqet me presidentin e Algjerisë, i cili ka njëfarë dinjiteti dhe nuk e merr mundimin të vijë në Jugosllavi dhe të piqet me Titon, por kërkon që të shkojë ky atje, pse ka nevojë. Dhe Titoja shkon dhe kërkon që Algjeria të ndërhyjë që në Havanë të mos ngatërrohen punët akoma më tepër nga sa janë ngatërruar. Këtu është çështja e Sadatit, çështja e kërkesave për përjashtimin e tij, gjoja nëpërmjet ngritjes në këtë mbledhje të vendeve «të paangazhuara» të konfliktit arabo-izraelit. Por Titoja edhe këtu nuk do të ketë sukses. Prandaj jeta e këtij sharlatani me flokë të kuq do të jetë një disfatë e turpshme dhe, pas vdekjes së tij, bota do të shohë akoma më mirë çfarë jete, çfarë veprimesh të këqija, të poshtra, të liga ka bërë ky njeri. Tash nuk flitet për këto, por më vonë do të hapen gojët dhe atëherë ato që do të thuhen do t'i ngjasin një gjirizi të madh e të pashtershëm, ku qelbësira e tradhtisë, kalbësira revizioniste, kalbësira kapitaliste do të kundërmojnë ane-

kënd dhe popujt e brezat e ardhshëm do ta mallkojnë këtë rrymë revizioniste të kurdisur nga kapitalizmi botëror për të penguar ecjen përpara të revolucionit dhe ndërtimin e socializmit.

Revolucioni nuk mund të ndalet dhe socializmi nuk mund të errësohet, ai do të bëhet një realitet i madh në të ardhmen.

VLORË, E ENJTE
7 QERSHOR 1979

PAPA PRITET NË POLONI SI PERËNDI E SI SHPËTIMTAR

Vizita e papa Xhovani Pavlit të 2-të në Poloni nuk është e rastit. Polonia është cilësuar dhe cilësohet edhe tash si bija e madhe e besnike e Vatikanit. Këtë gjë e vërtetojnë dhe ngjarjet e tashme. Këtë e kanë vërtetuar edhe kohërat e mëparshme deri para çlirimit. Pas çlirimit udhëheqja e Partisë Komuniste të Polonisë i lejoi zhvillimin dhe influencën e fesë në këtë vend, pavarësisht se në kohën kur në krye të partisë ishte Bieruti, një gjë e tillë nuk bëhej në mënyrë aq të hapët e të autorizuar si sot. Por, pas vdekjes së tij, katolicizmi në Poloni mori frenat në dhëmbë dhe kjo gjë u thellua me kundërshtimet në mes shtetit dhe kishës. Veçse duhet theksuar se këto kundërshtime ishin më tepër të sipërfaqshme sesa të detyruara nga revizionizmi hrushovian, apo të shkaktuara nga mosbesimi ndaj kishës nga ana e udhëheqësve polakë, të partisë në Poloni.

Kristianizmi në Poloni i ka rrënjët të thella. Ato u forcuan akoma më shumë si rezultat i politikës reaksionare, revizioniste antimarksiste të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe të udhëheqjes së saj, si dhe nga shtypja antimarksiste, hegjemoniste e shovinizmit rusomadh të revizionistëve sovjetikë, me Hrushovin në krye.

Dihet se armiqësia midis popullit polak dhe popullit

rus, i cili e dominonte të parin, është e lashtë dhe të dy popujt nuk kanë jetuar kurrë në harmoni, polakët kanë qenë të shtypur dhe pjesë përbërëse e Perandorisë Ruse.

Natyrisht, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më vonë u shtua numri i komunistëve të vërtetë nga radhët e klasës punëtore, megjithëkëtë influenca e madhe e reaksionit polak jo vetëm nuk u zhduk, por qëndroi e paprekur dhe, në forma të reja, ai diti të ruajë veten, të ruajë edhe fuqinë e tij ekonomike. Kjo për arsye se Polonia nuk eci si duhet në rrugën e socializmit, në shembullin e Bashkimit Sovjetik, por në mënyrë të çalë në një kapitalizëm shtetëror, ku reforma agrare dhe më vonë kooperativizmi në fshat as nuk filluan dhe as që u mor mundimi më i vogël që të fillonin.

Kështu që kisha, me gjithë kontradiktat dhe mosmarrëveshjet e herëpashershme që kishte me disa persona në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Polonisë, të cilët hiqeshin si përparimtarë, i bënte ballë politikës gjoja socialiste të Polonisë. Ajo **ishte bërë mbështetja më e madhe, më e tërbuar dhe më e egër e reaksionit, e kontëve dhe e pasanikëve polakë,** të cilët, edhe pse u ishte konfiskuar pasuria, dikujt e tëra, dikujt i ishte lënë gjysma, prapë mbretëronin në fshatin polak.

Dhe pra, në shkrimet e mia të mëparshme, mund të gjejmë pasqyrimin e kësaj politike dhe të këtyre përpjekjeve të kishës katolike në Poloni, të lidhura këto me emrin e kardinal Vishinskit, i cili jeton dhe drejton sot kishën dhe ka bërë që ajo të arrinte të kishte edhe shkollat e saj, pale kishat në një numër të madh, bile të kishte edhe priftërinj në ushtri, të cilët i bënin ushtrisë popullore polake katekizmin në orët e caktuara të javës.

Kardinali Vishinski u bë një mbret i dytë në Republikën «Socialiste» të Polonisë dhe kisha me primatin

e saj përfaqësonin, siç thoshin ata, të kaluarën «e lavdishme» të mbretërve të Polonisë, përfaqësonin datat historike të popullit polak në luftë kundër shtypjes cariste. Pra, kisha dhe hierarkia e saj, bija më e shtrenjtë, më e madhe dhe më besnike e Vatikanit, fitonte dita-ditës nga viti në vit terren në Poloni, në popullin polak dhe në zyrtarët polakë. Ajo **punonte në mënyrë të rafinuar, siç e planifikonte Vatikani, kjo merimangë, kjo vemje e madhe që gërryen shpirtërat e njerëzve për t'i shtypur ata fizikisht, moralisht dhe ekonomikisht.**

Dhe ja, erdhi dita, erdhi koha që politika e kishës në Poloni të mos luftohet më me atë ashpërsi që pretendohej. Sa më tepër shtohej presioni hrushovian mbi Poloninë, aq më e lirë, aq më vepruese dhe aq më nxitëse bëhej kisha polake kundër këtij presioni revizionist, socialimperialist sovjetik.

Giereku që u bë sekretar i parë i Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, pas rënies së Gomulkës, dhe që hiqet se është komunist, por në fakt nuk është dhe as ka qenë kurrë i tillë (ai duhet të jetë një agjent i borgjezisë), ka bërë e po bën një politikë me dy faqe, gjoja në ujdi me revizionistët sovjetikë. Në realitet politika e tij është orientuar drejt kishës, drejt Perëndimit. Dhe në Traktatin e Varshavës ai qëndron sa për sy e faqe, se nuk ka ç'bën, sepse forca të fuqishme sovjetike ndodhen brenda në Poloni. Pra Bashkimi Sovjetik revizionist ushtarakisht nuk e lë kollaj Poloninë të kthehet në një Poloni të Bekut ose të bëhet aleate zyrtare e shteteve perëndimore dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Por, në fakt, Polonia e sotme, e drejtuar nga e ashtuquajtura Parti Punëtore e Bashkuar e Polonisë me Gierekun në krye, ka një mbështetje të fuqishme te kisha katolike, me të cilën gjoja është në kundërshtim. **Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë, e cila e ka li-**

dhur ekonomikisht ngushtë vendin me Perëndimin dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka marrë me siguri pjesë në mënyrë të fshehtë në zgjedhjen e papës Vojtiva me origjinë polake, nënshtetas polak, kardinal polak, nxënës besnik i kardinalit Vishinski.

Në tratativat e fshehta që janë bërë për zgjedhjen e këtij pape polak, me siguri kisha polake, dhe nëpërmjet saj Polonia, kanë influencuar jashtëzakonisht, dhe këto së toku me imperializmin amerikan, me CIA-n dhe me agjentura të tjera mund të kenë vepruar që paraardhësi i papë Vojtivës të qëndronte jo më tepër se një muaj në fronin e shën Pjetrit. Kështu që ky papë «vdiq» pas disa dhjetëra ditësh omelie dhe meshash, megjithëse dukej me shëndet të mirë dhe relativisht ishte i ri në moshë. Pra si zor të vdiste papandehur ky njeri dhe si zor të zgjidhej nga konklavi një papë gjoja i sëmurë dhe që nuk ishte ankuar kurrë se ishte i sëmurë. Përkundrazi, konklavet e Vatikanit, pas vdekjes së një pape, bëjnë zgjedhje të menduara e të studiuara mirë, sepse kanë parasysh influencën që duhet të ketë papa në kishën universale, siç e quajnë ata kishën katolike romane. Ai që zgjidhet papë nuk duhet të jetë i ri, por i moshuar, me qëllim që mbretëria e tij të mos zgjatë më shumë se 15 ose 20 vjet. Edhe kjo bëhet për arsye politike, se Vatikani është një qendër politike me rëndësi e reaksionit dhe në një periudhë 10-15-vjeçare ngjajnë evenimente të mëdha në botën kapitaliste, e cila kërkon ndihmën dhe mbështetjen e Vatikanit. Kështu që sipas situatave dhe koniunkturave zgjidhet edhe papa, një njeri që t'u përshtatet këtyre koniunkturave.

Pra, papa që u zgjodh para Vojtivës nuk i leverdisi reaksionit botëror dhe në radhë të parë reaksionit amerikan. Kjo sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në përgjithësi të gjitha shtetet e tjera kapitaliste të përparuara dhe të fuqishme, donin që Vatikani të mos

përfaqësohej më nga një papë italian, i cili të ishte pjesë përbërëse e politikës së çoroditur të Italisë kapitaliste. Nuk e meritonte Italia, për mendimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të aleatëve të tyre, që në krye të Vatikanit të kishte kurdoherë një papë italian, i cili të ndërhynte dhe të ngatërrohej në punërat e shtetit italian, punëra që diskreditonin gjithë reaksionin botëror dhe e pengonin atë të zhvillonte në qetësi dhe në mënyrë të padukshme luftën e tij kundër popujve. Prandaj këto shtete kapitaliste dëshironin që Vatikani të përfaqësohej nga një personalitet më i fuqishëm dhe ky të mos ishte as italian, as amerikan, as me origjinë nga Evropa Perëndimore. Dhe duhet thënë se në këtë çështje kanë luajtur rol kontradiktat që ekzistojnë ndërmjet shteteve të ndryshme imperialiste. **Pra u gjend e arsyeshme që në Vatikan të vinte përfaqësuesi i kishës polake, kishë e cila kishte treguar rezistencë dhe kishte fituar terren të madh në Evropën Lindore dhe që mund të bëhej e do të bëhet në fakt një nga çerdhet më të fuqishme të katolicizmit për të dobësuar revizionizmin modern sovjetik, në veçanti, dhe atë të Evropës Lindore, në përgjithësi.**

Është më e madhe fuqia e kishës polake nga ajo e Estergomit dhe e Mindzentit, i cili mori pjesë në kryengritjen reaksionare hungareze dhe u detyrua nga forcat përparimtare të atyre kohërave të mbyllej në ambasadën amerikane, duke e treguar mirë veten si agjent i amerikanëve. Kurse kisha katolike e Polonisë ruante gjoja personalitetin e saj dhe vepronte në mënyrë të shkathët si brenda edhe jashtë.

Kështu që zgjedhja e një pape polak i rregullonte punë reaksionit ndërkombëtar. Dhe ai zgjodhi papë kardinalin Vojtiva, i cili ishte krahu i djathtë i Vishinskit, por ky nuk kishte hyrë në luftë të hapët, siç bënte kryetari dhe mësuesi i tij. Pra ky burrë nga

Krakovi i Polonisë, urtë e butë e plot tigani, siç i thonë një fjale, erdhi në Vatikan dhe filloi të ndjekë një politikë gjoja popullore, duke përkëdhelur kalamanët, duke biseduar me të rriturit italisht kudo që shkonte, nga të katër anët e vendit. Polaku papë puthte e ngalaste popullin me qëllim që t'i jepte vetes ngjyrën e italianizmit dhe t'i tregonte Italisë se nuk do të largohet nga traditat e kishës katolike romane.

Por nga ana tjetër ky «i dërguar i Krishtit» bënte plane tok me Brzezhinskin dhe me reaksionarë të tjerë për të vepruar në shkallë të gjerë dhe në mënyrë aktive kundër komunizmit dhe për thellimin e përçarjes në mes Bashkimit Sovjetik revizionist dhe vendeve të tjera revizioniste që janë nën sundimin e Bashkimit Sovjetik.

Dhe, pra, në këto kushte papa Vojtiva vendosi të ndërmarrë udhëtimin e tij për në Poloni, në çerdhen e vjetër dhe të thellë të kishës katolike romane dhe që andej ta rindërtonte më të fuqishme rrjetën e merimangës. Tash ka disa ditë që ai ndodhet në Poloni, si papë i Vatikanit. Ashtu si shën Pjetri që e la varkën, — siç tha papë Vojtiva në një fjalim, — dhe ndoqi Krishtin, kështu edhe ky e la varkën polake dhe ndoqi rrugën e Krishtit. Pra papa Xhovani Pavli i 2-të shkoi në Poloni si përfaqësues i Krishtit dhe i shën Pjetrit.

Dhe vajtja e tij në Poloni nuk gjeti asnjë kundërshtim jo vetëm nga Perëndimi që e përgatiti këtë udhëtim, por as nga Bashkimi Sovjetik dhe as nga vendet e tjera satelite të tij. Me siguri që Bashkimit Sovjetik nuk i ka ardhur mirë për këtë udhëtim të papës, pavarësisht se revizionistët sovjetikë, si antimarksistë nuk janë kundër fesë; në rast se feja i mbështet, ata janë gati ta mbështetin fenë e vet ortodokse, se fenë katolike e dinë që e kanë kundër tyre. Revizionistët sovjetikë nuk e donin këtë udhëtim, se një gjë e tillë do ta

thellonte ndarjen, do të këpuste lidhjet formale që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Polonisë.

Vajtja e Vojtivës në Poloni do të vërtetonte se shteti polak nuk është një shtet komunist, se populli polak nuk e do komunizmin, se ai është një popull katolik, antirus dhe antisovjetik. Pra kjo vizitë e tij do të vërtetonte se fijet që e lidhnin Poloninë me Rusinë e Brezhnjevit janë vetëm vargu i tankeve, i topave, i raketave dhe i bazave ushtarake të mëdha e të forta që ekzistojnë në të gjithë Poloninë, nën maskën e Traktatit të Varshavës.

Këto ishin qëllimet e mëdha të papa Vojtivës, të amerikanëve dhe të kishës polake, dhe unë besoj se këtyre qëllimeve ata ia arritën. **Papa Xhovani Pavli i 2-të u prit në Poloni si perëndi,** të themi **si shpëtimtar i Polonisë**; me miliona njerëz grumbulloheshin në shesh, në kisha dhe dëgjonin fjalën e «Krishtit të ri» të ardhur nga Roma. Dhe ky e filloi misionin e tij kishtar e sabotues, antikomunist në mënyrë kreshendo, derisa arriti të flasë haptazi që në Poloni, në zemrat e polakëve, në shtëpi dhe në shkolla duhet të ekzistojë Krishti, që është perëndia e polakëve.

Dhe nga çka po shohim në televizor dhe nga ato që po lexojmë nëpër gazeta, konstatojmë se këta miliona njerëz, që e ndjekin papën këmba-këmbës në çdo shesh e në çdo kishë, dëgjojnë me vërejtje të madhe predikimet e tij kishtare, antisocialiste dhe kudo këndojnë këngë kishtare, sikur të gjithë t'i kishte mësuar dikush të këndonin himnet e kishës. Dhe në fakt kështu është, kishat kanë mbuluar Poloninë me kohë, por sidomos kohët e fundit; atje janë shtuar priftërinjtë, saqë ruajtja e papës dhe e qetësisë nëpër sheshet e mbushura me miliona njerëz, bëhej nga xhakonë të veshur me rroba kishtare, të cilët njiheshin në turmë dhe në rrugë

ku kalonte papa Vojtiva herë me automobil, herë në këmbë, por gjithmonë me kryq në dorë.

Në sheshin më të madh e më të vjetër historik të Varshavës ishte ngritur një kryq i madh prej 10 metrash dhe një tribunë madhështore ishte vendosur nën këtë kryq dhe që andej papa Vojtiva iu drejtua Polonisë. Ky papë i mësuar, i djallëzuar, që e njeh mirë katekizmin, shumë herë doli me platformë politike dhe me omelitë, me elozhet që u bëri mbretërve polakë që kanë luftuar për «lirinë» e Polonisë, me himnet që i këndoi kishës polake, nacionalizmit polak, dhe me elozhet e mëdha që i bëri Vishinskit për përpjekjet e tij për të mbajtur gjallë frymën e Krishtit në Poloni, goditi tërthorazi dhe haptazi regjimin e tanishëm polak, nxiti mërinë kundër sovjetikëve pa i përmendur këta, por duke folur për të drejtat e njerëzve, për lirinë e fesë, për përhapjen e mësimeve fetare në çdo institucion dhe në çdo shërbim. Natyrisht, ai nuk harroi të fliste kundër luftës, për paqen kristiane dhe për «zemërgjerësinë» dhe «zemërbardhësinë» e Vatikanit dhe të pushtetit të tij të madh në botë.

Me fjalë të tjera, papa polak, një papë dinak, i zgjuar, diti në 6-7 ditë të ngrejë peshë popullin polak nën hundën e udhëheqësve gjoja komunistë, se këta në të vërtetë e përgëzonin dhe e duartrokitnin në heshtje, e pritnin në belvedere dhe i uronin mirëseardhjen me buzëqeshje deri në vesh, duke i dhënë botës të kuptojë se gjoja komunizmi është armiku i popujve dhe feja është shpëtimtarja e tyre. Turmat që dolën për ta pritur papa Vojtivën në Poloni, ai i përdor për të luftuar komunizmin, që ai e di fort mirë se ç'është. Këtë luftë e fillon duke sulmuar doktrinën materialiste të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, duke i quajtur Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera, ku nuk ekziston liria dhe të drejtat e njeriut, gjoja shtete socialiste, që udhëhiqen nga idetë e marksizëm-leninizmit.

Ky është një blof i madh, që e përdorin imperializmi dhe reaksioni botëror dhe tok me ta Vatikani, agjentura e madhe e të gjitha kohërave, ndihmësja aktive dhe e përgatitur e reaksionit botëror obskurantist, i cili bën çdo përpjekje që të shtypë popujt, t'i mbajë këta në errësirë dhe në frikën e zotit e të Krishtit.

Udhëtimi i papë Vojtivës ka gjithashtu një influencë të madhe në vendet e tjera të ish-demokracisë popullore, në satelitët e Bashkimit Sovjetik, në radhë të parë, në Çekosllovaki, në Hungari, në Gjermani, pavarësisht se këtu ekziston edhe protestantizmi, në Rumani, por edhe Bullgarinë nuk e lë pa e prekur, për të mos folur për Jugosllavinë, se kjo fërkon duart për këtë çështje. Vizita e Titos në Moskë, para vajtjes së Vojtivës në Poloni, nuk mund të konsiderohet se u bë vetëm për çështjet e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë ose për mosmarrëveshjet e Bullgarisë me Jugosllavinë për çështjen e Maqedonisë. Ajo u bë edhe për t'i lënë Bashkimit Sovjetik të kuptojë, pa ia thënë shprehimisht, se forca e reaksionit, që mbështet Jugosllavinë titiste, është e madhe dhe se këtë do ta shikonin më vonë.

Kjo që bën tash Vojtiva, është ajo që ka kërkuar të bëjë Titoja gjatë gjithë periudhës që ai mbretëron në Jugosllavi, por që nuk ka mundur t'ia arrijë. Papa Vojtiva po e fillon këtë gjë dhe ka shpresa të mëdha që influenca e kishës katolike të jetë e fortë jo vetëm në Poloni (se kjo duhet të jetë një bazë e shëndoshë për reaksionin botëror), por të ringjallet në Hungari, në Çekosllovaki, në Rumani, në Gjermani, në Bullgari dhe në vendet e tjera kapitaliste.

Prandaj kreu kishtar u qa ca në radion polake dhe tha se pengohet që fjalët dhe meshët e tij të dëgjohen si duhet në vendet e tjera socialiste, siç i quan ai. Pra

ai u thotë atyre që te ju mbretëron thundra e «komunizmit», domethënë thundra e Bashkimit Sovjetik. Pra ju duhet të merrni shembullin e Polonisë. Dhe mua që nuk jam as polak, as çek, as hungarez, po jam universal, më ftoni, ose të biem në ujdi që të vij edhe te ju për një vizitë zyrtare si kryetar i një shteti (se Vatikani konsiderohet shtet) dhe si udhëheqës shpirtëror i kristianizmit romak.

Dhe një gjë e tillë unë besoj se do të ndodhë. Papa Vojtiva në mos sot, nesër do të shkojë edhe në Hungari, edhe në Çekosllovaki, mundet në Rumani më përpara, pavarësisht se revizionistët sovjetikë do të bëjnë presione të mëdha në këtë drejtim, për t'ia prerë rrugën këtij akti diversionist ndaj Bashkimit Sovjetik, akt që ka si pikësynim likuidimin e perandorisë sovjetike reaksionare, që kërkon ta dobësojë partnerin dhe kundërshtarin e tij të madh për shtypjen e popujve të botës dhe që vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mundësisht dhe Evropa e Bashkuar reaksionare të bëhen hegjemone në botë.

Ja ku të çon tradhtia revizioniste, tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit! Ja ku të çojnë hrushovizmi, titizmi dhe të gjitha klikat e tjera eurokomuniste dhe kineze që luftuan dhe luftojnë me tërbim marksizëm-leninizmin dhe ndërtojnë në vendet e tyre kapitalizmin.

Revizionizmi, siç e kam theksuar dhe herë të tjera, nuk mund të sillte veçse përçarjen. Kampi i socializmit u përça pas vdekjes së Stalinit dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe, për arsye se vetëm diktatura e proletariatit, lufta e klasave, sipas mësimeve të Marksit dhe të Leninit, mësimeve që i ka vërtetuar koha, krijojnë unitetin e shëndoshë në popull dhe unitetin midis kombeve që kanë fituar lirinë dhe demokracinë e vërtetë. Kurse revizionizmi sjell me vete kontradiktat midis shteteve, grabitjen, shfrytëzimin e njëri-tjetrit dhe krijon klasën e re shfrytëzuese kapitaliste, e cila sjell në fuqi edhe kapitalistët e

vjetër. Kjo klasë manovron me politikën e vjetër kapitaliste në koniunktura të reja dhe krijon atë mënyrë mendimi, veprimi, jetese, atë strukturë dhe infrastrukturë që mbartin shtypjen e popujve, shtypjen e lirisë dhe të demokracisë dhe shkaktojnë kontradikta të mëdha në mes popujve, të cilat, natyrisht, çojnë në një luftë të pjesshme ose në një luftë botërore. Dhe në këtë drejtim ecën gjithë veprimtaria e imperializmit amerikan, e socialimperializmit sovjetik, kinez, e imperializmit të Evropës së Bashkuar, të Japonisë dhe e imperializmit shpirtëror, por dhe material, të Vatikanit.

Prandaj marksistë-leninistët duhet të qëndrojnë në ballë, të palëkundshëm, dhe, duke përvetësuar si duhet idetë materialiste të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, të luftojnë pa pushim e me kurajë të madhe kundër rrymës regresive obskurantiste të Vatikanit dhe kundër fuqive imperialisto-revizioniste që përpiqen t'i robërojnë botën, popujt dhe të mbajnë në këmbë sundimin e zotërinjve.

E MËRKURË
13 QERSHOR 1979

NJË PARLAMENT FORMAL

Parlamenti evropian u zgjodh pas një propagande të zbehtë. Rezultati i pjesëmarrjes në votime ishte një fiasko e vërtetë, mbasi përqindja e votuesve në të gjitha vendet e Evropës Perëndimore që formojnë këtë parlament të përbashkët evropian, ishte shumë e ulët.

Përqindja më e lartë e pjesëmarrësve në votime, 65 për qind, në qoftë se nuk gabohem, ishte në Gjermani, por përsëri larg përqindjes së votuesve që morën pjesë në votimet e përgjithshme që u bënë për Bundestagun në Republikën Federale Gjermane, të cilat arritën deri në 90 për qind. Në Francë në votimet morën pjesë nja 55 për qind, kurse Anglia kishte përqindjen më të ulët në këto votime.

Përshtypja e përgjithshme që krijohet nga komentet e shtypit të këtyre vendeve është se interesimi për këtë parlament dhe rëndësia e tij janë shumë të vogla dhe formale. Çfarë kompetencash do të ketë ky parlament mbi vendet e ndryshme, këtë do ta shohim më vonë, por, siç mendoj unë, kompetencat konsistojnë në atë që nga 200 e ca veta që ishin, tash u bënë 450 veta. I dhanë këtij parlamenti evropian një numër më të madh deputetësh që t'i përshtatej Evropës së Bashkuar e qeverisë gjoja të Evropës së Bashkuar!

Natyrisht, ky parlament do të marrë disa kompetenca të përgjithshme pa ndonjë rëndësi të madhe e nuk do t'i

imponojë asnjë shteti anëtar asnjë mendim ose veprim. Secili nga këto shtete ka parlamentin e qeverinë e vet, të cilat marrin urdhra nga borgjezia kapitaliste e vendeve të tyre, nga trustet dhe koncernet e vendit të tyre dhe nga shoqëritë e përbashkëta, në bazë të aksioneve që ato kanë, që influencojnë në parlamentet dhe në qeveritë e veçanta të çdo shteti të Evropës së Bashkuar.

S'ka asnjë dyshim se ky organizëm i emërtuar **Evropa e Bashkuar ka një karakter reaksionar** dhe përpjekjet e këtij bashkimi qëndrojnë në atë që të eliminojnë disi, po të jetë e mundur, konkurrencën në mes shteteve pjesëmarrëse, të kundërshtojnë zhvillimin e njërit më përpara nga tjetri, të pushtojnë si njëri dhe tjetri tregje të huaja, pavarësisht nga vendimet që kanë marrë se gjoja do të veprojnë në unitet, se në fakt ky unitet duhet kuptuar në disunitet të madh, e kështu me radhë.

Evropa e Bashkuar **është një organizëm politiko-organizativ-ekonomik i koncerneve të mëdha të këtyre shteteve, i shoqërive të përbashkëta të këtyre shteteve.** Këto koncerne dhe shoqëri të përbashkëta, me fjalë të tjera kapitalistët ose peshkaqenët e mëdhenj, bëjnë e do të bëjnë tratativa e do t'i përdorin organizmat e Evropës së Bashkuar si mjete lufte për dominim. Pikërisht me këtë mund të shpjegohet ajo ftohje që vihet re nga ana e Francës për sa u përket Evropës së Bashkuar, parlamentit etj. sepse ajo shikon që në këtë Evropë të Bashkuar dominon dhe do të dominojë Gjermania Federale, dominim ky që nuk i pëlqen asaj. Kurse imperializmit amerikan nuk i pëlqejnë aspak Evropa e Bashkuar, parlamenti dhe qeveria e Evropës së Bashkuar, Tregu i Përbashkët Evropian, për arsye se, sido që të ndodhë, një «unitet» i këtyre shoqërive të përbashkëta, i këtyre koncerneve, pavarësisht se amerikanët janë brenda në to, kokë e këmbë, sadopak, do t'i bëjë njëfarë hije ekspansionit amerikan. Shtetet e Bashkuara kanë në Gjermaninë

Perëndimore dhe në vendet e Evropës veç e veç, mundet edhe bashkërisht, edhe një konkurrent të fortë dhe kjo gjithashtu atyre nuk u pëlqen.

Por imperializmi amerikan, si gjithë imperializmat e tjerë, ndjek politikën «përça e sundo», kështu që ai mund t'u vijë rrotull e vërdallë më mirë këtyre shteteve, po të jenë të përçara sesa të bashkuara. Pra Shtetet e Bashkuara nuk dëshirojnë që përballë kësaj politike të tyre, përballë potencialit ekonomik dhe politik që kanë, të ngrihet një fuqi tjetër akoma e pakonsoliduar, si kundërshtare ose si konkurrente e saj, siç mund të jetë Evropa e Bashkuar.

Dhe natyrisht gjatë këtyre zgjedhjeve parlamentare ne pamë që Karteri mori masa drakoniane në lidhje me naftën, gjë që i ka çoroditur dhe i ka zemëruar evropianët. Bile për këtë çështje Gjermania Perëndimore dërgoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vetë Shmidtin dhe Franca, Fransua Ponsenë. Siç duket veprimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lidhje me naftën dhe me energjinë elektrike i shkaktojnë Bonit dëme më të mëdha sesa Francës. Kjo duket nga niveli i delegacionit që u dërgua për të biseduar me Karterin. Do të shohim ç'do të bëhet më vonë, por sidoqoftë, në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i zbatojnë masat që morën, kontradiktat do të thellohen.

Edhe Bashkimit Sovjetik nuk i intereson shumë Tregu i Përbashkët Evropian, natyrisht jo nga ana ideologjike, se edhe Bashkimi Sovjetik i sotëm kapitalist është, ashtu siç janë dhe këta. Por si shtet kapitalist që është, Bashkimi Sovjetik bën llogari dhe sheh se tash ka përpara një Evropë më të bashkuar e jo të përçarë, prandaj manovrat e tij, natyrisht, do të jenë të dyllojshme: edhe buzëqeshje e tratativa me Evropën e Bashkuar, por edhe veç e veç me çdo shtet që bën pjesë në këtë Evropë të Bashkuar. Natyrisht revizionistët sovjetikë hiqen se luftojnë kundër këtij bashkimi evropian nga pozitat gjoja ideologjike leniniste, duke nxjerrë gjoja edhe arsyet, se ky është një bashkim i shteteve kapitaliste në interes të kapitalit evropian dhe jo në interes të punëtorëve. Por sidoqoftë në përgjithësi duhet thënë se edhe Bashkimit Sovjetik nuk i pëlqen një organizëm i tillë.

Prandaj si konkluzion, ne do të shikojmë se, pavarësisht nga kontradiktat e veçanta, do të krijohen gjithashtu edhe kontradikta grupimesh, forcash imperialiste si imperializmi amerikan, imperializmi i Evropës së Bashkuar, imperializmi sovjetik dhe imperializmi kinez e japonez në Lindjen e Largme etj.

U fol gjithashtu, por vetëm nga një gazetë evropiane apo nga një bankier i Çikagos, siç thonë agjencitë e lajmeve, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina dhe Japonia do të krijojnë edhe ato një treg të përbashkët amerikano-aziatik. Kjo natyrisht, nuk është e vërtetë. Edhe mund të krijohet një treg i tillë i përbashkët, por unë mendoj se nuk mund të bëhet, për arsye se Shtetet e Bashkuara të Amerikës me atë zhvillim aq të madh që kanë, nuk mund të bashkohen në një organizëm si ky me një Kinë të pazhvilluar. Nga ana tjetër edhe Japonia nuk mund të futet në një darë të tillë nën drejtimin e drejtpërdrejtë të amerikanëve dhe në krah të saj të ketë një Kinë të dobët, e cila do t'i lutet t'i japë kredi dhe teknologji të re. Pastaj, sa për influencën ekonomike e strategjike në Azinë e Largme, në Azinë Juglindore, në Indi e në rajone të tjera, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Japonia s'kanë nevojë ta krijojnë një treg të tillë amerikano-aziatik, mbasi ato janë në gjendje, pa pasur nevojë për Kinën, ta bëjnë vetë një gjë të tillë, të bëjnë njëkohësisht edhe një luftë të ashpër konkurrence, bile edhe luftë me armë kundër imperialistëve të tjerë të mëdhenj, në qoftë se këta kërcënojnë interesat e tyre.

Prandaj zgjedhjet e parlamentit evropian ishin një flluskë sapuni, sa për sy e për faqe, për të gënjyer popujt

dhe proletariatin. Në vendet e Tregut të Përbashkët Evropian ka 7 milionë krejt të papunë, për të mos folur për ata që punojnë gjysmë dite ose nga një orë në ditë, që, po të bashkohen edhe këta, bëhen me dhjetëra milionë; çmimet ngrihen në qiell, konkurrenca është e madhe si brenda, edhe jashtë këtij tregu evropian, jashtë kësaj Evrope të Bashkuar. Në realitet e si rezultat nga kjo **Evropë e Bashkuar asgjë e mirë nuk vjen për popujt e saj,** mjerimi i tyre vazhdon. Por edhe lufta e këtyre popujve duhet të vazhdojë e ashpër kundër kapitalizmit të brendshëm dhe kundër këtij «uniteti» të kapitalistëve e të koncerneve, të këtij uniteti fals që bëhet vetëm për të ulur pak efektet katastrofike të krizës së madhe që ka mbuluar kapitalizmin evropian e atë botëror dhe të zbutë kontradiktat ose konkurrencën e ashpër. Por asgjë nuk mund t'i shërojë këto plagë të përhershme të kapitalizmit, që aktualisht janë jashtëzakonisht të rënda.

PANORAMË POLITIKE

Në Vjenë, midis Karterit dhe Brezhnjevit u arrit marrëveshja SALT-2. I pashë në televizor të dy presidentët: njëri i fryrë, tjetri më i hollë, njëri nga Ukraina, tjetri nga Karolina. Edhe njëri edhe tjetri, të dy këta esklavazhistë u puthën e u ngalasën si në vajtje, edhe në ardhje. Nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik po i bëjnë një bujë të madhe, sikur ky të jetë një eveniment që do të evitojë luftërat bërthamore. Në fakt kjo është një gënjeshtër e madhe që bëhet me qëllim, është një ujdi në mes të dy imperialistëve, të cilët përkohësisht, duke ruajtur të gjithë arsenalin kolosal atomik, marrin disa masa anësore për interesat e tyre, për të pakësuar disi shpenzimet në këtë fushë, sepse që të dy imperializmat, qoftë ai amerikan, qoftë ai sovjetik, janë në krizë të madhe. Pra, ata tani duhet t'i bëjnë ballë kësaj krize, ndryshe i pret katastrofa. Kështu që marrëveshja SALT-2 nuk është gjë tjetër veçse një pauzë e përkohshme në rrugën e superfuqive për zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve për shfarosjen në masë. Por kjo pauzë nuk i shlyen në asnjë mënyrë arsenalin e madh atomik dhe armët konvencionale e të sofistikuara që kanë superfuqitë dhe që i zhvillojnë çdo ditë.

Sovjetikët nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje e quajnë një sukses të madh dhe duan të krijojnë përshtypjen në botë e para popujve se regjimi i tyre ka karakter

socialist, se ata janë kundër luftës, kundër ekspansionit, kundër shtypjes, kundër grabitjes. Në këtë drejtim, me dashje pa dashje, ata i ndihmon edhe imperializmi amerikan, për arsye se për këtë pauzë, nga e cila nuk i vjen asnjë dëm imperializmit amerikan, pretendohet se Karteri gjoja ka hasur në kundërshtimin e Senatit. Pra, senatorët gjoja bëjnë zhurmë se kjo marrëveshje është në disfavorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e se presidenti i tyre po i bëka lëshime Bashkimit Sovjetik. Është për të qeshur që të tillë senatorë bloferë lënë të kuptohet se gjoja presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është aq naiv sa të arrijë t'i bëjë lëshime Bashkimit Sovjetik në armatime, kur çështja e armatimeve dhe e luftës është çështje e dorës së parë për ta, mbasi dihet se fuqia e tyre qëndron në armët që përdoren në luftën kundër popujve, kundër kryengritjeve revolucionare, kundër proletariatit.

Kina, natyrisht, edhe ajo bën lojën e senatorëve amerikanë, gjoja është kundër Karterit, bën një politikë të tillë që të tregojë se ja, Bashkimi Sovjetik i Brezhnjevit përfitoi mbi këtë gjë. Por e dimë që politika e Kinës është një politikë e çoroditur; kinezët herë thonë që marrëveshja SALT-2 ka rëndësi, herë thonë s'ka rëndësi, herë thonë që nga kjo përfiton Bashkimi Sovjetik, herë tjetër, në një artikull thonë të kundërtën. Në përgjithësi artikujt kinezë janë kundër marrëveshjes SALT-2, domethënë janë me ata senatorë që bëjnë zhurmë se gjoja Shtetet e Bashkuara të Amerikës po i bëjnë lëshime Bashkimit Sovjetik, kurse në realitet ato nuk i bëjnë atij asnjë lëshim. Mbi këtë marrëveshje foli edhe vetë Hua Kuo Feni në mbledhjen e Asamblesë Popullore Kombëtare që po i zhvillon punimet në Pekin.

Nënshkrimi i marrëveshjes SALT-2 nga ana e dy superfuqive nuk u sjell asnjë fitim popujve, nuk e ndalon aspak luftën botërore, përkundrazi e acaron më tepër. Marrëveshja SALT-2 mund t'u pëlqejë amerikanëve dhe

sovjetikëve, por nuk u pëlqen shteteve perëndimore të Evropës së Bashkuar që janë në NATO, për arsye se nenet e kësaj marrëveshjeje, të cilave u hodha një sy kalimthi, mbasi kam pasur shumë punë dhe s'munda dot t'i lexoja me vërejtje, kufizohen vetëm në caktimin e rrezes së veprimit të avionëve të rëndë bombardues, që të mos kalojnë të 5 mijë km. Pra, as ata amerikanë të mos kalojnë në Bashkimin Sovjetik, as këta të Bashkimit Sovjetik të mos kalojnë në kontinentin amerikan, kurse në Francë, në Angli, në Gjermaninë Perëndimore, në Itali ata mund të kalojnë kur të duan e mund të lëshojnë bomba kur të duan. Prandaj në shtypin perëndimor vihen re vërejtje të hapëta dhe të maskuara që shprehin pakënaqësinë e qeverive të këtyre vendeve mbi përmbajtjen dhe objektivat e kësaj marrëveshjeje të arritur nga ana e të dyja superfuqive.

Qeveritë e vendeve perëndimore me siguri janë vënë në dijeni e janë pyetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për këtë çështje, por këtij veprimi i përshtatet shumë mirë fjala e urtë e popullit tonë që thotë: «Të vura kadi që të më gjykosh, por të rruajta mjekrën».

Gjatë kësaj kohe kriza në botën kapitaliste vazhdon. 14 milionë punëtorë italianë dje ishin në grevë të përgjithshme. Të tilla greva po bëhen në Francë, në Angli e kudo gjetkë. Krijimi i parlamentit të përbashkët të Evropës së Bashkuar do t'i shtojë akoma më tepër fatkeqësitë e popujve, kurse, nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se brenda 5 vjetëve fitimet e trusteve të mëdha janë rritur dyfish dhe trefish, në kurriz të masave të gjera punonjëse.

Kina e Ten Hsiao Pinit i dha, sipas shprehjes së tij, një «mësim të mirë» Vietnamit, i cili edhe ky nga ana e tij po i jep Kinës një «mësim të mirë», aspak humanitar, duke dëbuar nga Vietnami me qindra mijë vietnamezë me origjinë kineze (shumica ish-tregtarë, të pasuruar gjatë luftës), të cilët bredhin nëpër oqeane me varka të

prishura dhe askush nuk i qas në portet e tyre, as Malajzia, as Indonezia, as Filipinet, as Singapori, as vetë Kina. Po bëhet një bujë e madhe për këta, aq sa edhe Italia e Andreotit ka pranuar në Itali nja «njëqind» (!) veta nga këta qindra mijë që mund të jenë ndoshta edhe një milion. Merret me mend se ç'tragjedi është kjo. E një tragjedi e tillë nuk po luhet për herë të parë, ka ndodhur më përpara me popullin palestinez, i cili u la në mes të rrugëve, vdiq i uritur, i zhveshur në vapën e shkretëtirës, u vra e u pre dhe tash hallakatet nga të katër anët, në luftë të përditshme me Izraelin, i cili ia ka pushtuar tokat, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës duartrokasin, se dhe Egjipti nënshkroi Traktatin e paqes me Izraelin. Izraelitët, Moshe Dajani me shokë, që dikur pësuan atë katastrofë të madhe që njohim nga hitlerianët, tash janë bërë vetë Hitlerë çifutë kundër palestinezëve e kundër arabëve.

Marrim vesh se Siria me Irakun nënshkruan një marrëveshje për krijimin e një shteti të bashkuar. Kjo është një gjë e mirë, por në ç'baza është bërë? Natyrisht, në baza kapitaliste dhe dyshoj se mos jetë si bashkimi i dikurshëm i Egjiptit me Sirinë, i cili u prish akoma pa u bërë. Bashkimi i Sirisë me Irakun, i këtyre dy popujve me tradita të njëjta, me kulturë të njëjtë, mund të jetë diçka e mirë në këto situata të vështira që po kalon Lindja e Mesme. Mund të formohet me të vërtetë një mburojë kundër synimeve imperialiste amerikane, sovjetike dhe izraelite. Megjithatë, unë mendoj se ky bashkim me siguri nuk është bërë në ato baza të shëndosha që të ketë si qëllim themelor mbrojtjen e popujve të këtyre vendeve dhe të popujve të tjerë arabë, në radhë të parë të palestinezëve nga armiqtë imperialistë, nga lodrat e rrezikshme të tyre. Këtë e them për arsye se këto dy shtete janë shtete borgjeze kapitaliste dhe në mes tyre, pavarësisht se kanë disa pika të përbashkëta, përsëri ekzistojnë kontradikta; në qoftë se këto kontradikta e sidomos ato midis dy partive që kanë fuqinë në secilin nga këto vende lihen në heshtje për një kohë të gjatë, atëherë mund të dalë diçka e mirë, por, në rast se këto kontradikta thellohen, dhe të jemi të ndërgjegjshëm se si sovjetikët ashtu edhe amerikanët do të punojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi për ta përçarë këtë unitet, atëherë kjo do të jetë «një vërë në ujë», siç themi ne, shqiptarët.

POGRADEC, E MARTE
17 KORRIK 1979

FOKUSET E PRESIDENTIT KARTER

Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjenden në një krizë të thellë dhe të tmerrshme politiko-ekonomike, aq sa presidenti Karter u detyrua t'i drejtohej popullit me një fjalim në televizor. Ai foli për naftën, por tok me të zuri në gojë edhe krizën nëpër të cilën po kalon kombi amerikan. Karteri tha se kishte bërë një mbledhje në Kemp Dejvid ku për 12 ditë kishte biseduar me njerëz gjoja nga populli, se ata gjoja edhe e kishin kritikuar, edhe e kishin këshilluar, por edhe e kishin mësuar. E gjithë kjo, pretendimi se ja, unë dal nga Shtëpia e Bardhë për të marrë vendime me rëndësi jetike për vendin dhe këto vendime i konsultoj me popullin, nuk është veçse një fokus i presidentit amerikan që do t'i shërbejë për të shkarkuar nga vetja arsyet e kësaj krize të madhe dhe për të përgatitur fushatën e ardhshme elektorale. Por ky popull me të cilin thotë se është këshilluar, nuk ishin veçse miqtë e tij guvernatorë ose edhe ndonjë qytetar i thjeshtë. Aty ai, siç e kanë zakon presidentët amerikanë, gjoja për të marrë mendimin e tyre, hodhi në tryezë pikëpamjet e tij të mëparshme, domethënë mendimet e trusteve që përfaqëson. Dhe për t'i hedhur hi syve popullit amerikan, ai shtoi se edhe fjalimin që e kishte përgatitur më përpara e që do ta mbante në televizor, e hodhi poshtë, sepse «kishte nxjerrë» konkluzione nga bisedimet në Kemp Dejvid.

Karteri tha se njerëzit që i kishin shkuar në Kemp

Dejvid, i kishin folur hapur. Ai citoi një guvernator nga Jugu i vendit, i cili i paskësh thënë: «Zoti president, ju nuk po e udhëhiqni këtë komb. Ju vetëm se po administroni qeverinë», ndërsa një vizitor tjetër i kishte thënë që të mos deklaronte se «zgjidhja e problemit të energjisë bëhej me një mënyrë të ngjashme me luftën dhe pastaj t'u jepte njerëzve pushkë — lodra për ta luftuar atë».

Karteri deklaroi se kombi amerikan kërcënohet nga një krizë besimi. «Kjo, tha ai, është një krizë që godet në zemrën, shpirtin dhe frymën e dëshirës sonë kombëtare. Gërryerja e besimit tonë në të ardhmen, kërcënon të shkatërrojë strukturën social-politike të Amerikës».

Kështu Karteri kërkon t'ua mbushë mendjen dëgjuesve të tij se vetëm tash ai e pa këtë gjendje të kombit, këtë shpirt, këtë frymë e këtë dëshirë që ka hyrë në krizë, por nuk foli aspak për fitimet e mëdha që kanë realizuar trustet e kompanitë amerikane të naftës. Me fjalë të tjera për çështjen e energjisë, Karteri tha se kombi nuk mund të vazhdonte duke konsumuar 20 për qind më shumë energji sesa prodhon. «Kur importojmë naftë, thekson ai, ne importojmë edhe inflacion, edhe papunësi». «Ne, vazhdoi ai, u mësuam të përdorim sa të kemi» dhe e «kemi zgjatur kokën mbi gardh, ndërsa OPEK-u matanë është me thikë në dorë».

Fjalimi i Karterit është, pra, edhe një kërcënim për vendet prodhuese të naftës, anëtare të OPEK-ut, është një kërcënim për Lindjen e Mesme, prodhuesen e naftës, vendet e së cilës i kërcënon me luftë, në rast se do të vazhdojnë të ngrenë çmimet e naftës ose të pakësojnë nxjerrjen e saj. Ky është një presion i madh e i drejtpërdrejtë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës u bëjnë këtyre vendeve, pasi kanë krijuar pasuri të mëdha nga shfrytëzimi i naftës së tyre.

Karteri tha, gjithashtu, se që nga viti 1978 e këndej nuk do të importonte më asnjë pikë të vetme naftë mbi ni-

velin e vitit 1977. Në këtë vit Shtetet e Bashkuara të Amerikës importonin 8 milionë e gjysmë fuçi nafte në ditë. Edhe ky është një kërcënim tjetër që u bëhet vendeve arabe për të zgjedhur dy rrugë: ose të vazhdojnë nxjerrjen e naftës, ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të blejnë më naftë dhe prandaj Karteri i bën thirrje popullit amerikan që të bëjë kursime. Për këtë ai jep një sërë këshillash që të importohet më pak naftë, vetëm brenda kuotave që cakton qeveria, të bëhet ekonomi në çështjen e energjetikës, urdhëroi që shoqëritë që e përdorin atë të shkurtojnë përdorimin në masë të naftës dhe të përdorin karburante të tjera, sidomos qymyrin, nga i cili të bëjnë edhe naftë sintetike. Ai kërkoi, gjithashtu, që të bëhen investime për energjinë diellore, propozoi që gjatë 10 vjetëve të shpenzoheshin 10 miliardë dollarë të tjerë për të përforcuar mjetet e transportit masiv, bëri thirrje për krijimin e një banke kombëtare diellore, e cila, tha Karteri, «do të ndihmojë të arrijmë objektivat vendimtarë të plotësimit 20 për qind të nevojave tona rreth vitit 2000». Kjo, natyrisht, është pasojë e krizës së madhe që ka mbuluar botën kapitaliste.

Në mënyrë të veçantë kriza energjetike e naftës dhe e energjisë ua ka vënë këmbët në një këpucë jo vetëm imperializmit amerikan, por të gjitha vendeve të tjera kapitaliste të botës. Presioni i këtyre vendeve kapitaliste të botës kundrejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka qenë dhe vazhdon të jetë i madh. Janë bërë mbledhje në Paris, në Tokio, në Bruksel e gjetkë. Në këto mbledhje Shteteve të Bashkuara të Amerikës u është kërkuar të reduktojnë përdorimin e naftës. Me fjalë të tjera, në qoftë se jemi për kursime dhe duhet të bëjmë, thonë këto shtete kapitaliste, ato nuk duhet të bëhen vetëm në kurrizin tonë, por duhet të bëhen edhe në kurrizin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dhe në fakt pas fjalimit të Karterit udhëheqësit japonezë, ata francezë e të Gjermanisë Perëndimore dhanë menjëherë intervista duke përkrahur masat e tij të domosdoshme mbi kursimet e naftës dhe të energjisë.

Kjo është një kontradiktë e madhe që po zhvillohet midis kapitalizmit botëror dhe imperializmit amerikan, i cili po tronditet në sundimin e tij në shumë fusha, në atë ushtarake, ekonomike dhe tash edhe në fushën e energjetikës.

Natyrisht kjo krizë do të vazhdojë 10-15 vjet dhe kudo janë duke u marrë masa që industria, e cila punon me naftë, të punojë pjesërisht me qymyre dhe me energji bërthamore apo diellore. Nga ana tjetër nuk mungojnë presionet, shantazhet, kërcënimet mbi vendet prodhuese të naftës për të prodhuar sa më shumë e për t'u shitur sa më shumë, këtyre shteteve, dhe me çmime sa më të ulëta. Kjo mund të sjellë edhe turbullira politike, edhe goditje, edhe grushte shteti, por edhe luftëra lokale që mund të shënojnë fillimin e një lufte të madhe botërore.

Nafta është «gjaku» i trupit kapitalist, dhe dihet se po shteroi «gjaku», shteroi forca e imperializmit, forca e tij ekonomike e ushtarake. Prandaj popujt, vendet e të cilëve disponojnë naftë, duhet të qëndrojnë të fortë në pozitat e tyre revolucionare për mbrojtjen e pasurive, të lirisë e të sovranitetit të tyre kundër grabitqarëve dhe luftënxitësve imperialistë, kundër shtypësve të popujve të botës.

POGRADEC, E ENJTE
19 KORRIK 1979

KRONIKA E NGJARJEVE TË KËTYRE DITËVE DHE ÇFARË KONKLUZIONESH MUND TË NXJERRIM PREJ TYRE

Detyra jonë e madhe është të vigjilojmë dhe ta ruajmë atdheun tonë socialist nga pasojat që mund të shkaktojnë turbullirat e mëdha e të thella që po ngjasin në botë. Për këtë arsye po ndjek vazhdimisht me kujdesin më të madh situatat ndërkombëtare dhe përpiqem, aq sa mund të gjykoj, t'u jap disa shpjegime ngjarjeve të veçanta dhe të përgjithshme, reperkusioneve që këto kanë në botë dhe rrezikut që mund t'i vijë vendit tonë nga përplasjet e mëdha, nga kontradiktat e thella dhe nga kriza shumë e madhe që po e bren përbrenda botën kapitaliste, imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik, socialimperializmin kinez, kapitalizmin botëror dhe vendet e tjera të vogla ose «vendet në zhvillim», siç i quajnë revizionistët sovjetikë dhe rumunë.

Është fakt i padiskutueshëm që kriza ekonomike po thellohet dhe ka mbërthyer në grykë gjithë botën kapitaliste, pa përjashtim, e në radhë të parë imperializmin amerikan.

Siç e kam shënuar në Ditarin tim, imperializmi amerikan mendoi se arriti një sukses «të madh» me marrëveshjen që bëri me Kinën. Marrëveshja Ten Hsiao Pin-Karter u trumbetua si një fitore «e madhe» kino-amerikane. Nuk mund të themi se për Shtetet e Bashkuara të Amerikës kjo ishte një fitore e vogël, kurse për Kinën kjo

marrëveshje ishte një fiasko, në kuptimin që ky vend i rraskapitur, i dobësuar e në krizë të çdollojtë, tash u fut në robërinë e kapitalizmit botëror dhe kryesisht të atij amerikan, japonez dhe gjermanoperëndimor. Mirëpo megjithëse e arritën këtë të ashtuquajtur sukses, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat përpëliten në gjirin e kësaj krize të madhe ku është zhytur gjithë bota kapitalisto-revizioniste, e ndiejnë veten të pasigurt. Vetë Karteri në fjalimin e fundit që mbajti pohoi se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ekziston një mosbesim i madh në vetvete i kombit amerikan, një mosbesim në zhvillim, pra një tronditje e thellë në fuqinë ekonomike dhe në rrezatimin e mënyrës së jetesës amerikane.

Natyrisht, fjalët e Karterit pasqyrojnë realitetin dhe ai nuk i tha këto nga e mira, po nga e keqja, sepse ndodhet në pozita shumë të vështira. Imperializmit amerikan ia kanë vënë këmbët në një këpucë, në radhë të parë, vendet prodhuese të naftës e partnerët e tij në NATO si dhe vende të tjera në të gjithë botën mbi të cilat ai bënte ligjin, investonte dhe zhvillonte ekonominë e tij në të gjitha fushat, industriale, bujqësore dhe ushtarake, duke rënduar, në radhë të parë, mbi kurrizin e popujve që shfrytëzonte.

Kriza e naftës e tronditi në një mënyrë të atillë imperializmin amerikan saqë fjalimi i Karterit, pavarësisht se, sikurse u tha. mundi të kishte aprovimin e një përqindjeje relativisht të mirë të shtresave të mesme të popullsisë amerikane, shkaktoi kundërshtimin e korporatave dhe të trusteve të mëdha, të cilave Karteri u cenoi të ardhurat jo vetëm për arsye të mungesës së naftës dhe të moszhvillimit të industrisë (sigurisht të pjesshme) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për një periudhë krize, por edhe sepse imperializmi amerikan kërkon të dalë nga situata e rëndë në të cilën ndodhet, i kredhur në detyrime të mëdha që arrijnë miliarda dollarë, për arsye të rënies së kursit të këtij të fundit, sidomos ndaj Japonisë dhe ndaj Re-

publikës Federale të Bonit. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të dalë nga kjo situatë dhe për të mbajtur disi të palëkundshme vlerën e dollarit, i ngarkoi me taksa të reja trustet dhe koncernet e mëdha amerikane. Por, natyrisht, po t'i prekësh ato në kallo, menjëherë hidhen përpjetë dhe kjo «dansë» u vërtetua me dorëheqjen e gjithë kabinetit të Karterit. Tash ka dy ditë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës s'kanë qeveri; i gjithë kabineti dha dorëheqjen. Kjo tregon për një krizë të madhe dhe me aq sa njohim është e para krizë e këtij lloji, që i tërë kabineti i një presidenti amerikan të japë dorëheqjen. Këtë e bënë jo vetëm pjesëtarët e kabinetit, por edhe shumë funksionarë të lartë të Shtëpisë së Bardhë. Me siguri atje do të ngjasë ashtu siç thotë një fjalë e urtë franceze: *«Prendre les commandes»*. Edhe Karteri do të marrë përfaqësues të tjerë të trusteve, do të bjerë në ujdi me ata që janë të revoltuar dhe do të formojë një kabinet tjetër, i cili do të vërë në zbatim çfarë tha ai, në qoftë se ia pranon Senati Amerikan. Ndryshe do të fillojë «dansa» edhe për vetë personin e Karterit, i cili mund të fluturojë në mos aktualisht, por në zgjedhjet e ardhshme, duke puthur pragun e Shtëpisë së Bardhë, për të mos u kthyer më atje.

Kriza e naftës u shkaktoi Shteteve të Bashkuara të Amerikës një gjendje të rëndë ekonomike që, natyrisht, ka edhe rrjedhime politike. Kështu, atje po ngrihen çmimet, po shtohet papunësia, po shtohet inflacioni. Këto dy ditë nga mbikëqyrjet që i janë bërë kursit të dollarit shihet se ky vazhdon të bjerë në krahasim me floririn, bile edhe në krahasim me monedhat e tjera të Evropës Perëndimore. Merret me mend, deri ku ka arritur puna, sa edhe lireta italiane ngrihet e dollari amerikan ulet. Konkluzioni është se lideri i imperializmit, imperializmi amerikan, po pëson një disfatë të madhe politiko-ekonomike.

Mungesën e naftës imperialistët amerikanë dhe kapitalistët e tjerë e ndiejnë si mungesën e «gjakut» në luftën

e madhe që po përgatitin. Natyrisht, kur mungon «gjaku» duhet luftuar që të fitohet ky «gjak», pra duhet fituar nafta, prandaj edhe situata ndërkombëtare bëhet akoma më e rrezikshme, shtohen kërcënimet e një lufte botërore ose të luftërave lokale. Mirëpo pa naftë është e pamundur që lufta botërore të zhvillohet në atë shkallë si e mendonin imperialistët amerikanë e të tjerë dhe socialimperialistët sovjetikë njëkohësisht, ose siç bërtiste tellalli kinez.

Edhe nënshkrimi i Traktatit egjiptiano-izraelit u duk se ishte një sukses për imperializmin amerikan. E kam theksuar se ky traktat u realizua nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat duan të kenë në Lindjen e Mesme dy kobure e jo një për të ruajtur krahët e pellgut të naftës nga një invadim politiko-ekonomik e më vonë ushtarak i sovjetikëve. Megjithatë duhet thënë se armiqësia e imperializmit amerikan me vendet e tjera arabe mbetet kurdoherë. Natyrisht, kjo është armiqësi e diferencuar për arsye se mungon ai unitet që duhet të ekzistojë midis vendeve arabe për t'iu kundërvënë intrigave të mëdha të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Sidoqoftë Traktati egjiptiano-izraelit i zemëroi shtetet e tjera arabe, të cilat e kundërshtuan këtë traktat kush më nxehtë e kush më ftohtë, por në të gjithë mund të themi se ky kundërshtim ishte mesatar. Kjo mesatare u shfaq, natyrisht, më me forcë në Iran ku u rrëzua shahu dhe u ngadalësua nxjerrja e naftës dhe shitja e saj në radhë të parë tek amerikanët. Por edhe te të tjerët u reflektua e si pasojë u ngritën çmimet e naftës. Edhe Arabia Saudite u bashkua në këtë veprim, megjithëse është mike, si me thënë, e amerikanëve; ajo veproi pa e prishur, por edhe pa e shfaqur këtë miqësi në mënyrë të hapët. Këto situata shkaktuan që brenda në vendet arabe të nxiten mosmarrëveshjet midis tyre dhe është e kuptueshme që këto mosmarrëveshje vijnë si rezultat i politikës së përgjithshme të imperializmit

amerikan, të kapitalizmit botëror dhe të socialimperializmit sovjetik, duke futur këtu edhe socialimperialistët kinezë, të cilët në këto situata duan të përfitojnë.

Kështu ne asistuam në përpjekjet për bashkimin e Sirisë me Irakun, mirëpo ky bashkim rezultoi me dorëheqjen e Al Bakrit dhe të kryetarit të partisë Baath dhe me ardhjen në fuqi të një zëvendësi tjetër të Al Bakrit dhe të kësaj partie. Kjo duhet të ketë ndodhur jo pse Al Bakri ishte plak. Jo, Al Bakri s'është plak, porse nuk dihet mirë se sa ishte i lidhur ai me sovjetikët. Unë mendoj se në Irak sovjetikët i luajnë të dyja kartërat, edhe të kurdëve, edhe të Al Bakrit, me anën e të cilit ata e kishin vënë në heshtje problemin kurd. Tash, në këto turbullira, sovjetikët kanë vënë në lëvizje kurdët, të cilët po ngrihen në Irak, në Siri, në Iran, natyrisht në favorin e sovjetikëve dhe në disfavorin e amerikanëve. Kështu që CIA, e cila pësoi një disfatë të madhe në Iran, tash po përpiqet të fitojë terren. Sa dhe si do t'ia arrijë kësaj, ne duhet të vëzhgojmë. Nuk është çështja që vendet arabe të arrijnë të shkëputen nga intrigat e brendshme dhe të jashtme që kurdis reaksioni, ato i kanë rrënjët të thella. Për të dalë nga kjo gjendje duhet që gradualisht lëvizjet e mëdha popullore të udhëhequra nga marksistë-leninistët të arrijnë të krijojnë një unitet jo si ai që mendonte të bënte Naseri me Sirinë ose Siria me Irakun, por një unitet veprimi kundër imperializmit amerikan dhe klikave në fuqi. Prandaj tash çështja shtrohet se si do t'i rezistojnë vendet arabe presionit të imperialistëve të jashtëm e të brendshëm dhe si do të manovrojnë me dy problemet e rëndësishme që unë mendoj se u takojnë edhe Lindjes së Mesme, edhe luftës ose paqes botërore: çështja e të drejtave të popullit palestinez dhe çështja e naftës. Këtë e them sepse amerikanët, me masat që morën dhe me masat e tjera që do të marrin, brenda 10 apo 15 vjetëve, për të prodhuar benzinën sintetike dhe

për të futur në shkallë edhe më të gjerë në shërbim të energjetikës qymyret dhe fuqinë diellore apo atë bërthamore, i bëjnë presion ekonomik OPEK-ut. Me këtë ata duan t'u thonë shteteve prodhuese të naftës se nuk do të kenë më fitime të mëdha nga nxjerrja e saj, kurse në fakt vendet arabe, megjithëse e kanë shitur naftën për një krodhë bukë, përsëri kanë pasur fitime kolosale, natyrisht, jo populli, por krerët në fuqi, shahu, sheikët dhe mbreti Saud i Arabisë.

Në fjalimin e tij Karteri i kërcënoi vendet arabe edhe me thikë, kur tha se OPEK-u qëndron me thikë hapur kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Natyrisht, me këto fjalë ai donte të tregonte që edhe Shtetet e Bashkuara do ta ngrejnë thikën kundër OPEK-ut. Zaten thikën e kanë mbajtur kurdoherë jashtë këllëfit Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aq më tepër do ta mbajnë tash kur u rrezikohen interesat.

Pra të dyja superfuqitë manovrojnë shumë në Lindjen e Mesme. Begini dhe Sadati po bëjnë takime vazhdimisht e po forcojnë «miqësinë» e tyre. Në parlamentin egjiptian Sadati propozoi dhe ai aprovoi që Egjipti t'i japë strehim shahut. Ky është një kërcënim i drejtpërdrejtë për revolucionin iranian. Me këtë popullit të Iranit i thuhet se dy janë alternativat: ose ky të nënshtrohet e të vijë në ujdi me imperializmin amerikan, ose do të kërcënohet me kthimin e shahut në Iran. Nëse ky do të rikthehet apo jo, kjo varet nga populli iranian, por hëpërhë është e zorshme. Veprimi i Sadatit duket si një gjest simbolik, ose si një kundërpërgjigje ndaj kundërshtimit që i bëjnë vendet e tjera arabe Traktatit izraelito-egjiptian.

Kjo çështje e madhe, që trajtova, është bërë epiqendra e intrigave dhe e makinacioneve të mëdha botërore, sepse në çështjen e naftës janë të ndërlikuara të gjitha vendet.

Edhe Bashkimi Sovjetik është i ndërlikuar në këtë problem kaq të madh, sepse edhe ky, tok me imperializ-

min amerikan, ka hyrë në një krizë të papërshkruar, për të mos folur pastaj për Kinën e Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit, e cila është në një rrëmujë të madhe.

Evropa, në përgjithësi, veçanërisht Evropa Perëndimore, po kalon ditë të vështira dhe të errëta, ditë të cilat, sado që të përpiqet, nuk do t'i ndritë dot parlamenti evropian që u zgjodh me vota të përgjithshme. Para dy-tri ditësh u mbajt sesioni i parë i tij, që ishte një seancë karnavaleske, ku të gjithë u ngritën dhe shprehën pikëpamjet e tyre të ndryshme dhe s'mund të bënin ndryshe, mbasi, pavarësisht nga marrëveshjet dhe traktatet që i lidhin njëri me tjetrin pjesëtarët e Evropës së Bashkuar, kjo është një xhungël ku ujqit po shqyejnë njëri-tjetrin. Kryetare e parlamentit u zgjodh një franceze me shumicë votash, por kjo s'ka rëndësi, ajo që ka rëndësi janë problemet që i brejnë përbrenda vendet anëtare të këtij parlamenti, të cilave ato nuk u japin dot zgjidhje.

Kriza e naftës i ka prekur edhe këto vende, të cilat janë alarmuar dhe kanë marrë masa, bile masa drakoniane, natyrisht, në kurriz të popujve të tyre, sepse nuk ka akoma shenja që të duket se trustet, kartelet, shoqëritë shumëkombëshe evropiane po e ndiejnë si duhet krizën e madhe që ka shpërthyer. E gjithë pesha e kësaj krize ka rënë në kurrizin e punonjësve të këtyre vendeve të Evropës së Bashkuar. Çdo ditë miliona prej tyre hidhen në grevë. Kjo dëshmon për keqësimin e situatës në këto shtete kapitaliste dhe për përpjekjet që bëjnë regjimet e tyre për të hedhur poshtë kërkesat e masave punonjëse, për të shtypur revoltat dhe kryengritjet që mund të shpërthejnë atje. Sidoqoftë, në këto vende vazhdon të rritet me të madhe papunësia, çmimet po ngrihen në qiell, inflacioni është i madh, pasiguria në punë dhe pasiguria e jetës së njerëzve s'kanë të mbaruar; janë zhvilluar në shkallë të gjerë banditizmi, vrasjet, vjedhjet, grabitjet, Evropa e Bashkuar është bërë një klub banditësh, legalë dhe ilegalë.

Kur Kina i hapi portat e saj edhe për kapitalistët evropianë, u mendua se deri në njëfarë shkalle tregu kinez do të sillte një lehtësim të krizës edhe në Evropë. Kinezët i bënë shumë reklamë vetes, dërguan dhe shumë delegacione në të katër anët e kontinentit evropian, firmuan edhe kontrata, të cilat që të gjitha u rrëzuan, sepse ishin pa baza. Kur erdhi çështja te konkretizimi i pretendimeve të Kinës, imperialistët amerikanë, japonezë, po ashtu edhe ata të Evropës Perëndimore panë se Kina nuk kishte të paguante dhe nuk ishte e zonja të merrte në duar teknologjinë moderne, pra, nuk ishte e mundur të realizoheshin fitimet që ëndërronin të nxirrnin kapitalistët e ndryshëm nga investimet e bëra atje. Kështu që të dyja palët ranë nga fiku. I pari ra Ten Hsiao Pini, i cili pësoi një disfatë brenda në Kinë, ku Asambleja e madhe Popullore Kombëtare e Kinës u detyrua të ndryshojë politikën e «katër modernizimeve» e të bëjë rirregullimin e ekonomisë nga e para. Rirregullimi i ekonomisë do të thotë të mos bëhen investime të mëdha në industrinë e rëndë, të mbështeten gjoja në forcat e veta, të zhvillohet industria e vogël private, të lejohen privatët të kenë punëtorë dhe të vazhdojë prodhimi i artikujve për konsumin e gjerë dhe për eksport.

Këto masa të reja u morën në asamble, pa miratimin e Komitetit Qendror dhe të kongresit, por me aprovimin e rrëmujës dhe të disfatës së brendshme politike dhe ekonomike. Li Hsien Nieni deklaroi se ligji që u aprovua nga Asambleja Popullore Kombëtare, për sa u përket mbështetjes dhe sigurimit të investimeve të huaja, «nuk është i përsosur» dhe se praktika ndërkombëtare prej 51 për qind dhe 49 për qind, nuk do të mbahet në këtë shkallë, por të huajt, tha ai, mund të kenë aksione edhe më të mëdha nga kinezët, veçse drejtori kinez do të ketë të drejtën e vetos. Me fjalë të tjera ata u thonë investitorëve të huaj: mos u trembni se ne do ta përmirësojmë ligjin dhe ju do të

keni të drejtë që javash-javash ta gëlltitni të tërë pasurinë e Kinës.

Nga ana tjetër, Li Hsien Nieni tha se Kina do të mbështetet në forcat e veta dhe kjo u vërtetua me anulimin e një sërë kontratave për investime të mëdha si, për shembull, kontrata e lidhur me francezët për tre gjeneratorët e mëdhenj bërthamorë. Dje apo pardje ministri i Industrisë i Francës shkoi në Pekin për të biseduar lidhur me këtë çështje dhe lajmet tregojnë se ambasada franceze në Pekin është e alarmuar për këto qëndrime të Kinës. E kanë kot që alarmohen francezët se ata e kanë nxjerrë vetë shprehjen: «Shih e mos vri». Kinezët kurrë nuk e kanë mbajtur fjalën, qoftë edhe me kontratat e nënshkruara. Ashtu siç bënë me ne, do të bëjnë edhe me të tjerët, s'duan të dinë ata se kush jemi ne dhe kush janë të tjerët, ata shikojnë vetëm interesat e veta, mirëpo këto nuk dinë t'i mbrojnë as si kapitalistë që janë, por e tregojnë hapur pazotësinë e tyre.

Për të kundërbalancuar këtë disfatë të brendshme e të jashtme, nga 20 korriku a më vonë flitet se do të vejë në Moskë një zëvendësministër i Punëve të Jashtme i Kinës dhe nga Bashkimi Sovjetik do të caktohet Firjubini ose një zëvendësministër më i rëndësishëm. Firjubini është «miku» ynë i vjetër, burri i Furcevës i cili, sipas mendimit tim, nuk ka shumë tru në kokë. Koka e tij është me lakra, por janë të tjerë njerëz ata që do t'i hedhin një çikë vaj lakrorit me lakra të kokës së Firjubinit. Sidoqoftë, sovjetikët janë djaj të mëdhenj dhe do të dinë që në këto situata të përfitojnë nga dobësitë dhe nga marazi i madh ekonomiko-politik që ka mbuluar Kinën e Hua Kuo Fenit.

Natyrisht të dyja këto vende i luajnë kartërat ndaj Perëndimit: Kina për t'u bërë presion atyre që u ka kërkuar kredi dhe, nga ana tjetër, Bashkimi Sovjetik po ashtu i bën presion Perëndimit për t'i treguar se Kina nuk

është në gjendje të luajë rolin e partnerit në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të Evropës së Bashkuar, e se nuk mund të jetë në gjendje ta ngacmojë ose t'i shpallë luftë Bashkimit Sovjetik. Kina nuk po përrallis më për luftën iminente, për të cilën tashti flitet pak, sepse po flitet më shumë për të mbushur barkun me bukë dhe për të kërkuar lëmosha.

Agjencitë e huaja të lajmeve thonë, dhe kjo mund të jetë e vërtetë, se shoqëritë e mëdha të vajgurit: japoneze, amerikane, angleze dhe gjermanoperëndimore, bashkë me to edhe shoqëritë italiane, kanë nënshkruar kontrata për të bërë kërkime në Detin e Kinës Jugore dhe për të nxjerrë naftë. Natyrisht, nxjerrja e naftës nga deti do të kushtojë shumë, sidomos për Kinën, sepse të ardhurat në naftë bruto do të sigurohen për huadhënësit dhe Kina do të marrë fitimin minimal. Pra, do të veprohet ashtu siç kanë bërë imperializmi amerikan dhe partnerët e tij për një kohë shumë të gjatë me vendet arabe që prodhojnë naftë dhe me OPEK-un.

Situata e vështirë në Evropë, në Bashkimin Sovjetik, në Kinë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka bërë që vendet e Azisë Juglindore të përfitojnë e të lëvizin disi, delegacione të tyre venë e vijnë, shkëmbejnë mendime etj. Me fjalë të tjera, mendoj që këto vende, për t'u vënë fre pretendimeve të mëdha që kanë superfuqitë, përpiqen të përfitojnë nga këto situata, megjithëse përfitimet do të jenë të pakta.

Ne shohim që Kina vazhdon presionet ndaj Vietnamit, bile tash ajo ka vënë një kusht të ri: në bisedimet vietnamezo-kineze duhet të diskutohet çështja e Kamboxhias. Se si do të diskutohet kjo çështje, është një pikëpyetje. Tash po duket se Sihanuku, që ndodhet në Phenian, nuk është në akord me kinezët. Ai deklaroi se do të shkojë në Francë, në qoftë se kjo do ta lejojë, ose në një vend tjetër ku do të formojë një qeveri në vend të huaj kun-

dër qeverisë së Pol Potit dhe kundër qeverisë aktuale të Kamboxhias. Me fjalë të tjera, ai do të krijojë frontin e bashkuar të Kamboxhias me veten e tij në krye, bile Sihanuku u shpreh: «Unë jam mbreti i Kamboxhias».

Unë mendoj se kinezët do të pranojnë më mirë Sihanukun sesa vietnamezët dhe partnerët e këtyre, që qëndrojnë në Kamboxhia. Por çështja, natyrisht, nuk është e zgjidhur, varet shumë nga qëndrimi në unitet i vietnamezëve, i kamboxhianëve dhe i laosianëve për të përballuar hegjemoninë kineze, varet po ashtu edhe nga gjendja ndërkombëtare, veçanërisht nga qëndrimet e sovjetikëve, të cilët janë gati të sakrifikojnë edhe Vietnamin, edhe Kamboxhian, deri në njëfarë shkalle, por të hedhin Kinën në dorë dhe ta bëjnë këtë të paktën një gjysmësatelite të tyren. Megjithatë, nuk them se sovjetikët do ta lënë pas dore Vietnamin. Në bisedimet që sovjetikët do të zhvillojnë me kinezët çështjet nacionale të Indokinës nuk duhet të preken, por edhe në qoftë se ngjet e kundërta se sa duhet të preken, këtë e ka merak vetë Bashkimi Sovjetik. Ky di të shesë, të blejë dhe të luajë në kurrizin e të tjerëve; pastaj, kur ka luajtur në kohën e luftës vietnamezo-amerikane, pse të mos luajë edhe tash në luftën vietnamezo-kineze?

Duhet të kemi parasysh që edhe Bashkimi Sovjetik, gjithashtu, po kalon një krizë shumë të rëndë brenda, krizë ekonomike, por edhe krizë politike, bile atje nuk ekziston më as uniteti në mes kombësive, ai mbahet me forcat e ushtrisë. Flitet se Brezhnjevi është sëmurë dhe s'është çudi që të jetë sëmurë, sepse në televizor shohim që mezi hedh këmbët dhe mezi flet, po, se kur do të vdesë, këtë nuk e dimë, dimë vetëm një gjë: se ajo që dominon në Bashkimin Sovjetik është forca e ushtrisë sovjetike, e mareshalëve, dhe aspak forca e partisë, forca e parimeve. Partia dhe parimet e saj janë përtokë, janë vetëm sa për emër, sa për të maskuar veprimtarinë e një diktature të tmerrshme imperialisto-fashiste.

Bashkimi Sovjetik ka mosmarrëveshje të rënda edhe në gjirin e së ashtuquajturës bashkësi socialiste. Kohët e fundit u bë një mbledhje në Berlin, e cila kishte karakterin e unifikimit dhe të shtimit të propagandës kundër propagandës borgjezo-kapitaliste. Kjo mbledhje, ku secili mbajti nga një fjalim, i nisur vetëm nga interesat e tij, në fund doli si bishti i peshkut. Jepnin përshtypjen gjoja sikur po e ndanin në mes tyre punën e agjitacionit e të propagandës. Fjalimi i përfaqësuesit sovjetik i dha tonin e përgjithshëm se ata do të merrnin përsipër luftën kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit kinez. Kurse Rumania nxori zërin e bilbilit të ngjirur duke thënë se nuk ishte e drejtë që në një mbledhje si ajo e Berlinit të atakoheshin parti «komuniste» që nuk merrnin pjesë në të. Dhe me kaq mbledhja mbaroi. Puna do të vazhdojë si më parë. Ashtu si më parë revizionistët do të bëjnë një propagandë revizioniste, e cila nuk do të ketë asgjë as kundër imperializmit, as kundër kapitalizmit perëndimor. Do të ketë vetëm disa fraza boshe stereotipe, kurse nga ana tjetër do të ketë marrëveshje, lutje, kërkesa për investime, lajka e fërkim krahësh për të marrë ndonjë këst ose për të shtyrë afatet e borxheve që i kanë mbuluar këto shtete.

Shtetet aleate të Bashkimit Sovjetik, anëtaret e Traktatit të Varshavës, janë kredhur në borxhe dhe janë lidhur ngushtë e me zor me zinxhirët e Bashkimit Sovjetik, i cili i furnizon me lëndë të para dhe me lëndë të përpunuara, duke u kërkuar çmime të larta. Në rast se këto vende dëshirojnë ta përmirësojnë një çikë situatën, si për lëndët e para, ashtu edhe për ato të përpunuarat, duhet të investojnë shuma kolosale në Siberi, ku gjenden këto lëndë të para, duhet të investojnë kapitale, të dërgojnë makineri moderne dhe specialistë, të inkuadruara gjoja të tëra këto në rregullat e KNER-it, për arsye se këto janë lëndë të «fushave të betejës» (strategjike). A do ta hanë këtë

hile të Bashkimit Sovjetik vendet anëtare të KNER-it, kjo varet nga thellësia e krizës, por sidomos varet edhe nga përkrahja dhe nga ndihma konkrete me investime ose me lëndë të para që mund t'u japin atyre perëndimorët.

Rumania është një vend i falimentuar, një vend i shitur te sovjetikët, të cilët aktualisht kanë përfituar nga bankëruta dhe e kanë hedhur plotësisht Çausheskun në xhep. Pavarësisht se ç'thotë ai, është fakt se atje janë futur oficerë sovjetikë, kanë vërshuar armatime të reja sovjetike, fillojnë ligjet e Traktatit të Varshavës të veprojnë dhe Çaushesku të këndojë me bilbilin e tij të një shteti gjoja të pavarur.

Ne shohim se aktualisht gjermanolindorët, polakët po ashtu çekët i janë vërsulur Afrikës gjoja për të ndihmuar çlirimin e popujve afrikanë, por ata venë atje për të shitur armë, për të organizuar grushte shteti dhe për të siguruar tregje. Në këto situata të gjithë kërkojnë të peshkojnë në ujë të turbullt.

Jugosllavia ka mbetur si peshku pa ujë, ekonomia e saj është përtokë, një miliard e gjysmë dollarë në vit i duhen që të paguajë borxhet dhe 20 për qind e industrisë nuk punon. Edhe pjesa tjetër e industrisë nuk punon me rendiment të plotë dhe mallrat jugosllave nuk kalojnë dot në tregjet e Evropës dhe të botës, për arsye të konkurrencës së madhe që u bëjnë shtetet e mëdha kapitaliste. Kështu që në Jugosllavi po shtohen papunësia e inflacioni dhe çmimet janë ngritur aq shumë sa të vësh duart në kokë, aq sa jugosllavi po shtrëngon rripin. Emigracioni jugosllav që po mbulon Evropën është njësoj si emigracioni vietnamez që bredh deteve. Tash, e detyruar nga krizat, Evropa po mbyll fabrikat e po hedh në rrugë punëtorët e saj, aq më tepër pastaj mbetet pa punë emigracioni jugosllav, i cili do të detyrohet të kthehet në vendin e tij, ku e pret mizerja.

Kontradikta dhe një armiqësi e egër ekzistojnë në

mes republikave të ndryshme të Jugosllavisë, të cilat brehen nga një ideologji antimarksiste, shoviniste, kapitaliste dhe nga sistemi vetadministrues i ashtuquajtur socialist, i cili ka krijuar borgjezinë e re dhe disnivelin e standardit të jetesës në republika dhe në krahina. Kështu është gjendja në Jugosllavi, një gjendje e tendosur lufte e vazhdueshme.

Thuhet se atje gjoja mbahet situata pse qenka Titoja në këmbë, por qenia e Titos në këmbë e acaron akoma më tepër kontradiktën, pse ai është i pafuqishëm për ta nxjerrë nga kjo gjendje. Bëri ç'bëri, ai e shkatërroi Jugosllavinë dhe tash që është plak ky vend po vazhdon të shkatërrohet akoma më thellë, kontradiktat po shtohen, dhe më kot Bakariçi bërtet e mban fjalime për të thënë se duhet t'i jepen kompetenca më të mëdha partisë që ta drejtojë më mirë Jugosllavinë, më mirë bashkim-vëllazërimin dhe unitetin në mes republikave. Por Bakariçi është një kroat shovinist, i cili ka frikë nga serbomëdhenjtë dhe nga ana tjetër Kroacia, në qoshe të Veriut të Jugosllavisë, ka standardin më të lartë të jetesës në Jugosllavi dhe bën ç'bën mendon se fundi i fundit një shkëputje e saj do ta ruajë këtë standard që ka krijuar.

Ç'do të ngjasë në Jugosllavi pas vdekjes së Titos, natyrisht, ky është një problem që na preokupon edhe ne, por ne kemi qenë, jemi e do të jemi vigjilentë për sa i përket zhvillimit që mund të marrin ngjarjet në këtë vend.

Edhe Italia gjendet në një krizë të përhershme dhe vazhdon të jetë pa qeveri. Demokristianët nuk i lënë socialistët të formojnë qeverinë dhe me miliona grevistë janë nëpër rrugë. Anjelët, Montekatinët e të tjerë, nuk lëshojnë asnjë grimë nga pasuritë e tyre, kapitalet italiane vërshojnë jashtë, investohen, sepse kështu sigurojnë fitime.

Pra, kjo është gjendja në pellgun e Ballkanit e rreth

nesh prandaj ne duhet të jemi shumë vigjilentë, për arsye të gjendjes shumë kritike politike, ekonomike dhe ushtarake.

Ne do të mbajmë këtë politikë aktuale, e cila është një politikë e drejtë ndaj Jugosllavisë, ndaj Rumanisë edhe ndaj Greqisë. Ne do të përpiqemi që me Greqinë të zhdukim qoftë edhe mosmarrëveshjen më të vogël. Grekët duhet të heqin dorë nga kauza e gjendjes së luftës, sepse kjo është anakronike, anormale, në një kohë kur ne po zhvillojmë marrëdhënie miqësie me popullin grek. Duhet të shtojmë marrëdhëniet tona ekonomike dhe kulturore, të cilat nuk shkojnë keq, e jo vetëm me Greqinë, por edhe me Jugosllavinë e me Italinë.

Në pikëpamjet ideologjike, ne me këto vende, qoftë me Italinë, me Greqinë dhe me Jugosllavinë titiste, nuk do të puqemi kurrë, përkundrazi, do të jemi në luftë të vazhdueshme për të demaskuar politikën e tyre dhe veçanërisht renegatët revizionistë jugosllavë, se, për sa i përket politikës kapitaliste të Italisë dhe të Greqisë, është më se e qartë që do ta luftojmë hap pas hapi në çdo manifestim të saj.

Por ne shohim që në politikën ballkanike të shteteve të Ballkanit kanë futur hundët fuqitë e mëdha, të cilat po bëjnë përpjekje për të krijuar gjoja marrëveshje në mes këtyre shteteve. Kjo gjë jam i mendimit që nuk do të arrihet kurrë, për arsye se ne nuk futemi në këto hile të kapitalizmit dhe të revizionizmit botëror. Gjithashtu ekzistojnë kontradikta të mëdha midis Jugosllavisë dhe Bullgarisë, midis Greqisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë, të pahapura, dhe midis Greqisë e Turqisë, açik, që janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Turqia kërkon të ndajë shellfin kontinental të Egjeut, kurse Greqia nuk pranon një shellf tjetër përveç atij që është vendosur deri tani. Në kufirin greko-turk ngjasin incidente. Po ashtu Turqia kërkon të ketë sundimin e vet edhe në ajër,

në zonën mbi detin Egje, në mos plotësisht, por të paktën kjo të ndahet ose të bihet në marrëveshje që të mund të qarkullojnë lirisht avionët e të dyja palëve. Kundërshtimi këtu është i vazhdueshëm, përveç kundërshtimit për problemin e Qipros. Aktualisht, meqë Greqia futet në krahun jugperëndimor të NATO-s, amerikanët përpiqen që komandanti i këtij krahu të mos jetë as turk, as grek, por të jetë amerikan dhe zëvendëskomandantët të jenë njëri turk e njëri grek, me fjalë të tjera, këta t'ia varin në qafë mëlçitë e tyre ujkut amerikan.

Si Turqia edhe Greqia janë në krizë dhe kanë nevojë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veçanërisht në Turqi situata është shumë e nderë; në mes partisë së Çevitit dhe të Demirelit ka grindje të mëdha dhe këtu është dora amerikane që bën lojën e saj, po ashtu edhe dora sovjetike, e cila bën përpjekje të mëdha për ta mbështetur Demirelin, por ky është shumë i kujdesshëm si ndaj amerikanëve, ashtu edhe ndaj sovjetikëve.

Sidoqoftë politika e Turqisë si edhe ajo e Greqisë është një politikë e varur dhe shumë delikate. Prandaj ka mundësi që të acarohen më tej kontradiktat në mes tyre dhe ne duhet të bëjmë kujdes sepse acarimi i situatave në mes këtyre dy shteteve mund të sjellë një dobësim të kufirit greko-bullgar dhe jugosllavo-bullgar. Mirëpo prapa bullgarëve është e qartë se kush qëndron, janë sovjetikët, të cilët në një rast krize, do ta përdorin Bullgarinë si mish për top, duke e vënë përpara rivendikimeve tokësore në Maqedoni, që Bullgaria dëshiron ta ketë për vete të saj dhe e quan tokë të popullit bullgar, kurse jugosllavët pretendojnë të kundërtën, ekzistencën e një kombi maqedonas, bile kërkojnë që edhe bullgarët të njohin minoritetin maqedonas irindas.

Titizmi është një regjim i falimentuar krejtësisht. Aktualisht po dëgjoj në radio se në Beograd ndodhet për vizitë Maknamara dhe se bankat amerikane i akorduan

Jugosllavisë një kredi prej 130 apo 150 milionë dollarësh, për arsye se ajo do të falimentojë në qoftë se nuk ia japin këtë kredi. Pra, Jugosllavia është krejtësisht e shitur tek imperializmi amerikan, por nuk mungon të hedhë «valle mbi litar», të luajë edhe kartën e sovjetikëve; këtë «valle mbi litar» Titoja e quan si një politikë të zgjuar, kurse në realitet s'është veçse politikë e falimentuar.

Në përgjithësi në Evropën Perëndimore socialdemokracia është krahu i fortë dhe mbështetës i së djathtës tradicionale reaksionare, qoftë kjo si e djathta franceze, apo siç janë demokristianët në Itali, kristiano-demokratët e Shtrausit në Gjermani, apo konservatorët e Theçerit në Angli. Pra, socialdemokracia llogaritet në përbërjen qeveritare të këtyre vendeve. Monopolet e mëdha dhe shoqëritë e përbashkëta, që sundojnë dhe bëjnë ligjin në të gjitha këto pseudorepublika demokratike, i përdorin partitë e socialdemokracisë me emra të ndryshëm për të qeverisur, ose më mirë me thënë për të zbatuar urdhrat e tyre, për të krijuar përshtypjen se qeveritë «e zgjedhura» janë qeveri të popullit, janë përfaqësuesit e shumicës në parlament, si rezultat i zgjedhjeve të lira. Këto parti, natyrisht, kanë influencën e tyre dhe manipulojnë në interes të monopoleve masa mjaft të gjera, masa me nuanca të ndryshme. Vetëm në raste të veçanta midis tyre e monopoleve shfaqen disa kontradikta, por, kur vjen çështja e krizës, ato bien në ujdi duke i lëshuar diçka njëra-tjetrës, me fjalë të tjera duke i bërë një trust tjetrit disa lëshime në kurriz të popullit të këtyre vendeve.

Kurse aktualisht partitë socialiste, që përpiqen të përfaqësojnë një pjesë të klasës punëtore dhe të hiqen si krahu i majtë i socialdemokracisë në këto vende, po futen në rreshtat e influencës amerikane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të fuqishme ekonomikisht e ushtarakisht dhe vendet perëndimore sidomos, pranojnë që partitë socialiste të mund të marrin pjesë edhe në qeveri, bile të formojnë

edhe qeveri, por me kusht që të mos arrihet «bashkimi i majtë», domethënë të mos bëhet bashkimi me «komunistët», pse amerikanët akoma nuk kanë besim te partitë revizioniste, sido që këto i kanë braktisur të gjitha pa përjashtim marksizëm-leninizmin, revolucionin, luftën e klasave. Megjithëkëtë, amerikanët nuk kanë arritur në atë shkallë dhe monopolet e vendeve perëndimore nuk kanë atë besim që revizionistët, të cilët mbahen për komunistë, të mund të marrin pjesë në qeveri dhe bëjnë çdo përpjekje që uniteti elektoral për pushtet në mes partive socialiste dhe «komuniste» të dështojë kurdoherë.

Kjo ngjet në Itali midis partisë së Kraksit dhe të Berlinguerit, apo në Francë midis partisë së Miteranit dhe të Zhorzh Marshesë. Më kot Zhorzh Marsheja me Miteranin përpiqen të bashkohen dhe të formojnë një qeveri të majtë. Ata arrijnë deri në njëfarë shkalle të merren vesh, pastaj kjo përpjekje e tyre për bashkim dështon. Kështu fillojnë përsëri polemikat kundër njëri-tjetrit. Miterani është i amerikanëve, kurse Marsheja është edhe i amerikanëve, edhe i sovjetikëve. Pse është edhe i sovjetikëve? Për arsye të bazës, sepse baza e Partisë Komuniste Franceze është ende e gënjyer me mendimin se në Bashkimin Sovjetik gjoja ndërtohet njëfarë socializmi. Pra Zhorzh Marsheja dhe shokët e tij nuk mund ta braktisin përnjëherë dhe katërcipërisht një pikëpamje të tillë, për arsye se do të humbasin votat, do të humbasin trupin elektoral dhe pikërisht aty përpiqen të fitojnë terren reaksioni dhe Miterani mbi partinë komuniste, ta reduktojnë sa të jetë e mundur atë duke e shkrirë ashtu siç shkriu, si floku i borës në ujë, partia radikalsocialiste e Eduard Herriotit, e Daladiesë dhe e Shreberit.

Në Angli vazhdon politika e balancës midis partisë laburiste dhe partisë konservatore. Aktualisht Theçeri është në fuqi, kurse Kallagani në opozicion. Do të vijë koha që, kur ta shikojnë se situatat do të ndryshojnë,

domethënë në qoftë se klasa punëtore angleze do të lëvizë disi për të kërkuar me forcë disa të drejta ekonomike, atëherë do të ndryshojë edhe ai trup elektoral, balanca do të rëndojë nga laburistët dhe do të vijë një Kallagan i ri t'i zërë vendin Theçerit. Pra në Angli luhet karta e dy partive.

Një situatë e tillë ekziston edhe midis të gjitha partive të tjera të kapitalit. Edhe partitë revizioniste të tilla janë. Të njëjtën situatë e shohim të pasqyruar edhe në partitë e shteteve të ndryshme në kontinentin afrikan, në kontinentin aziatik dhe kudo ku sundon kapitali, duke kujtuar një përshtypje të rreme gjoja të njëfarë demokracie. Natyrisht, në këtë luftë, partitë marksiste-leniniste hëpërhë janë akoma të dobëta, të paformuara si duhet, jo të regjura në luftë dhe në shumë vende ato ekzistojnë vetëm në grupe, kundër të cilave, për t'i përçarë, luftojnë qoftë sovjetikët, qoftë kinezët, qoftë kubanezët e kështu me radhë gjithë revizionistët, pa përmendur këtu kapitalistët vendas dhe imperialistët amerikanë.

Në këtë situatë politike, siç paraqitet dhe siç u përpoqa ta përmbledh shkurtimisht, politika e Partisë dhe e shtetit tonë socialist të diktaturës së proletariatit dallohet katërcipërisht nga politika e të gjitha shteteve të lartpërmendura dhe është në kundërshtim të hapët me të gjitha rrymat e ndryshme të tyre në ideologji, në organizime shtetërore e në luftë të papajtueshme me shfrytëzimin kapitalisto-revizionist që rëndon mbi popujt e ndryshëm.

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë bënë që të habiten jo vetëm njerëzit përparimtarë, por edhe kancelaritë e vendeve kapitaliste e revizioniste.

Për sa u përket vendeve revizioniste, informatat janë të tilla që, kur ne atakuam Kinën, ato, me Bashkimin Sovjetik në krye, kishin shpresa të na afronin pas vetes. Por pas luftës së gjatë dhe të rreptë që bëmë ne dhe qëndrimeve të prera e të palëkundshme kundër tyre, ata

mendojnë se «ne do ta paguajmë gabimin» e mosrealizimit të ëndrrës së tyre. Ata s'duan t'i acarojnë situatat me ne, por ne do t'i demaskojmë politikisht dhe ideologjikisht në çdo hap që do të bëjmë. Bota, miqtë, e pëlqejnë politikën tonë, e gjejnë të drejtë atë, e gjejnë kurajoze. Miqtë e kuptojnë deri diku pse është kaq e qartë e kaq e guximshme politika e një partie të vogël dhe e një vendi të vogël, siç janë Partia dhe vendi ynë. Kurse kapitalistët e revizionistët nuk e kuptojnë dot politikën tonë, për arsye se nuk arrijnë të konceptojnë dot se është pikërisht marksizëm-leninizmi ajo shkencë që e udhëheq Partinë tonë në politikën e vendosur e të drejtë të saj.

Kundërshtarët tanë nuk arrijnë t'i kuptojnë analizat që bën Partia jonë, të cilat janë analiza të drejta siç mendojnë miqtë tanë, që e kanë veshin në fjalën e Partisë sonë për të dëgjuar cili është mendimi i saj për një problem ose për një problem tjetër. Pra ata nuk arrijnë ta kuptojnë pse pikëpamjet e Partisë sonë janë reale e të drejta. Kjo vjen për arsye se ata e luftojnë marksizëm-leninizmin, të cilin e konsiderojnë si një shkencë të vjetruar dhe prandaj i shpjegojnë qëndrimet tona vetëm me karakterin tonë të fortë prej malësori, me patriarkalizmin, me vuajtjet shekullore që kemi provuar nga të gjithë imperialistët. Natyrisht, këto të fundit janë të drejta, por ajo që është kryesore dhe na udhëheq ne në rrugën tonë është marksizëm-leninizmi, i cili i ka forcuar këto tradita të lavdishme dhe e ka ruajtur Shqipërinë nga ndikimet e kapitalizmit botëror, të feudalizmit, të borgjezisë dhe të kapitalit vendas.

Lufta Nacionalçlirimtare ishte një luftë e ashpër, antiimperialiste, ajo ishte njëkohësisht një luftë sociale. Me këtë luftë, duke çliruar atdheun, ne likuiduam borgjezinë, feudalizmin dhe shfrytëzuesit e ndryshëm dhe vendosëm diktaturën e proletariatit. Por është marksizëm-leninizmi që krijon atë forcë të madhe, që i bën aq të qarta e të

zhdërvjellta pikëpamjet tona politike, shikimin e drejtë të problemeve të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, të ndërtimit organizativ, politik dhe kulturor të vendit, nën prizmin e ideologjisë marksiste-leniniste në kushtet konkrete të vendit tonë, të cilat nuk kanë qenë aq të lehta, bile kanë qenë shumë të vështira dhe mbeten përsëri të vështira. Natyrisht, vështirësitë e mëdha janë kapërcyer, por ekzistojnë akoma të tjera dhe lindin vazhdimisht vështirësi të reja, sepse Shqipëria, pavarësisht se ka fituar autoritet në botë, ka armiq të shumtë që e presin në pusi për ta goditur. Vetëm se vigjilenca e Partisë sonë dhe e diktaturës së proletariatit është e tillë që çdo dru i vënë në rrotat e zhvillimit tonë socialist do të thyhet e do të dërrmohet. Këtu qëndron forca e ideve marksiste-leniniste të Partisë dhe të diktaturës së proletariatit në vendin tonë.

Këtë politikë dhe këto ide ne duhet t'i mbrojmë me forcë të madhe, me kurajë, në mënyrë të zhdërvjellët, me një shpejtësi të madhe, të prekim sa të jetë e mundur më thellë e më gjerë zemrat e punëtorëve e të njerëzve përparimtarë në botë dhe të çarmatosim ata që kërkojnë ta dëmtojnë e ta zvogëlojnë jehonën e politikës së drejtë të Partisë sonë. Kjo është arma jonë e madhe, të cilën duhet ta përdorim, se armë tjetër nuk kemi. Arma jonë është marksizëm-leninizmi i zbatuar me shkathtësi të madhe dhe me vendosmëri, është politika jonë ndërkombëtare e drejtë dhe ndërtimi me konsekuencë i socializmit në vendin tonë. Njerëz nga vende të ndryshme të botës vijnë në vendin tonë për të parë se ç'do të thotë diktaturë e proletariatit, ç'do të thotë ndërtim i socializmit, ç'do të thotë një shoqëri e re pa klasa, një shoqëri e re ku ekziston lufta kundër mbeturinave të klasave sunduese e shfrytëzuese, por ku është vendosur mirëqenia për mbarë popullin, ku nuk ngrihen çmimet, ku nuk ka papunësi, ku arsimi e kultura po lulëzojnë e do të lulëzojnë vazhdimisht. Ky vend i vogël me këtë Parti të vogël, por të vendosur, marksiste-leniniste, në krye, di të zhvillojë ekonominë e vet, të mbrojë kufijtë e atdheut, të thotë fjalën e tij në arenën ndërkombëtare dhe jo vetëm të bëhet i paprekshëm nga armiqtë, por edhe më tepër t'i detyrojë këta dhe të krijojë në botë një miqësi sa më të gjerë e sa më të thellë me popujt.

Mjetet e tjera që duhet të përdorim, natyrisht, janë të pakta. Ne duhet ta vazhdojmë këtë politikë të zgjuar dhe parimore, të vazhdojmë të zhvillojmë tregtinë reciproke me shtetet kapitaliste dhe me shtetet revizioniste, me përjashtim të imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik dhe të disa vendeve ku sundojnë fashistët e racistët. Ne duhet të përpiqemi që këto shkëmbime të jenë me leverdi reciproke dhe pa u bërë atyre shteteve asnjë koncesion politik dhe ideologjik, përkundrazi t'i luftojmë ato me këmbëngulje në të dyja këto drejtime vendimtare dhe kardinale. Nga ana tjetër, politika jonë ekonomike e kulturore duhet të jetë një politikë e ndershme, parimore dhe të ndihmojë popujt e proletariatin e të gjitha atyre vendeve, me të cilat bëjmë tregti, që ata të shohin me të vërtetë se një vend i vogël mund të rrojë i lirë, i pavarur e sovran, pa marrë asnjë kredi nga kurrkush dhe pa pasur ndihmën e fuqive të mëdha, por vetë, me djersën e tij, me forcën e tij, të Partisë dhe të ideologjisë së saj, ai do të ecë përpara dhe do të ndërtojë shoqërinë socialiste. Pra, kjo është arma jonë, tjetër armë për ne nuk ka. Ne jemi një shtet i vogël, një shtet pa forcë ekonomike të madhe, një shtet të cilit edhe mund t'i krijohen vështirësi në drejtimet që theksova më lart, por shteti ynë socialist është një shtet unikal, i paprekshëm. Të tillë atë e ka krijuar Partia jonë sepse ka ditur dhe di t'i shfrytëzojë edhe kontradiktat e mëdha që ekzistojnë në mes shteteve të ndryshme kapitalisto-revizioniste, e ka krijuar diktatura e proletariatit.

Pra, është e domosdoshme që ne të ndjekim hap pas hapi zhvillimin e situatave në jetën ndërkombëtare dhe të dimë të shpjegojmë rrënjët dhe arsyet e këtyre ndryshimeve, të këtyre kontradiktave, të këtyre goditjeve që të mos biem kurrë në kurthin e tyre, të mos bëjmë kurrë një politikë koniunkturale, por të hedhim në çdo rast hapa të matur, të ndjekim shprehjen e popullit tonë: «Mat tetëmbëdhjetë herë dhe pre një herë». Kjo do të thotë të jemi të matur, vigjilentë, se përpara kemi një mori të madhe armiqsh që na presin në pusi për të na goditur.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne duhet të rrimë duarlidhur, përkundrazi duhet të jemi kurdoherë në ofensivë. Sulmi ynë politik dhe ideologjik kundër armiqve është forca tjetër jona, asnjëherë këtë të mos e ndalojmë, se, po e ndaluam ofensivën kundër armiqve, po nuk i demaskuam deri në fund manovrat, strategjinë dhe taktikat e tyre djallëzore, atëherë ne do të humbasim, po do të humbasë edhe revolucioni dhe kështu nuk do të jemi në gjendje t'u japim atë ndihmë që duhet shokëve tanë marksistë-leninistë në botë, proletariatit botëror dhe partive marksiste-leniniste motra që luftojnë edhe ato si ne, por që janë akoma larg për të marrë pushtetin. Lufta e tyre është e ashpër, e koklavitur dhe qëndrimet tona duhet t'u shërbejnë atyre, për t'i ndihmuar që të konsolidohen dhe t'u bëjnë ballë reaksionit të brendshëm dhe reaksionit imperialisto-revizionist të jashtëm.

POGRADEC, E HËNË
23 KORRIK 1979

UNITETI NDËRKOMBËTAR I EVROPËS MUND TË ARRIHET VETËM NË BAZË TË MËSIMEVE TË MARKSIZËM-LENINIZMIT

Veprat dhe mendimet gjeniale të Leninit ndritin dhe do të ndritin popujt e botës si tash ashtu edhe në të ardhmen për të fituar lirinë, demokracinë, sovranitetin e vërtetë e për të ndërtuar shoqërinë e re socialiste dhe më vonë atë komuniste.

Mendimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, sipas të cilave shoqëria borgjezo-kapitaliste do të zëvendësohet me një shoqëri të re, me shoqërinë socialiste, pa asnjë dyshim do të bëhen realitet në kohën e vet dhe me luftë e me revolucion.

Aktualisht kapitalizmi ndodhet në fazën e tij të fundit, në fazën e kalbëzimit, në atë të imperializmit. Në këtë fazë kapitalizmi, për të zgjatur jetën e vet, ka krijuar forma të reja organizative, ekonomike, ushtarake dhe politiko-ideologjike. Të gjitha këto forma të strukturës dhe të superstrukturës kapitalisto-revizioniste, imperialisto-socialimperialiste, të krijuara në këtë fazë të re e më të lartë të kapitalizmit, kanë për qëllim të shtypin revolucionet proletare dhe nëpërmjet luftërave t'u bëhet e mundur fuqive imperialiste të ruajnë e të ndajnë pasuritë e botës në mes tyre.

Koha po vërteton çdo ditë e më qartë tezat e Marksit dhe të Leninit se prona private, mjetet e prodhimit në

duart e kapitalistëve dhe të borgjezisë janë burim shfrytëzimi i pamëshirshëm mbi proletariatin dhe popujt, që i vënë këta në një zgjedhë të shumëfishtë politike, ekonomike e i kthejnë në mish për top për të ruajtur interesat e padronëve kapitalistë.

Natyrisht, prona në imperializëm merr format e reja të monopoleve dhe të trusteve të mëdha, të shoqërive të përbashkëta kapitaliste, të cilat likuidojnë ndërmarrjet e vogla, monopolizojnë çdo gjë dhe në të njëjtën kohë krijojnë forma të reja monopolizimi të pushtetit dhe të veprimeve të tij. Këto truste dhe monopole, këto shoqëri të bashkuara, që janë zhvilluar si ventuzat e ushunjëzës në trupin e popujve, kërkojnë forma të reja strukturore dhe një politikë e një ideologji pak a shumë të koordinuar, të harmonizuar për të shmangur në mes tyre goditjet. Natyrisht, këto goditje do të jenë fatale për ta dhe ky fatalitet është një realitet, sepse, sado që ato të përpiqen të harmonizojnë veprimet e tyre, prapëseprapë këto veprime, qofshin të strukturës, qofshin të politikës apo të marrëveshjeve ekonomiko-ushtarake, s'janë përveçse pjellë e shoqërisë kapitaliste. Kapitalizmi ka në vetvete luftën grabitqare, shfrytëzimin dhe kontradiktat që e brejnë përbrenda, që e dobësojnë, që e kalbëzojnë dhe që krijojnë ato kushte objektive dhe subjektive për shpërthimin e revolucionit proletar dhe shkatërrimin e shoqërisë kapitaliste.

Një nga këto forma strukturore është Evropa e Bashkuar. Kjo përpiqet të ndërtohet nën shembullin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose të Bashkimit Sovjetik. Dihet se Bashkimi Sovjetik është vepra e madhe e Revolucionit të Tetorit, vepra e Leninit dhe e pasardhësit të tij të madh, Josif Stalinit, të cilët ndoqën me besnikëri teorinë e Marksit dhe krijuan atë unitet të popujve dhe të republikave socialiste sovjetike që ishte një strukturë përparimtare e socialiste. Kjo ndodhi sepse Bashkimi Sovjetik udhëhiqej nga një Parti Bolshevike dhe nga një teori përparimtare revolucionare siç ishte ajo e Marksit dhe e Leninit. Është për këtë arsye që Bashkimi Sovjetik i Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit ishte shembulli i atij uniteti të strukturës dhe të superstrukturës që duhet të ndjekin edhe në të ardhmen popujt e botës.

Natyrisht, një shembull i tillë do të ndiqet nga çdo vend në veçanti, në radhë të parë nga ato vende, që janë hallka më të dobëta në zinxhirin kapitalist, ku, po të krijohen edhe kushtet subjektive, shpërthen dhe fiton revolucioni proletar. Pastaj nëpërmjet luftës së klasave, që duhet të zhvillohet sipas parimeve të Marksit e të Leninit dhe në të gjitha ato vende ku ka fituar revolucioni, do të arrihet një bashkim progresist i strukturave, sepse ideologjia është e njëjtë, përparimtare. Duke u udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste dhe duke e zbatuar atë në praktikë në përputhje me kushtet konkrete të çdo vendi është arritur e arrihet fitorja e revolucionit dhe do të arrihet gjithashtu edhe uniteti i proletarëve të të gjitha vendeve.

Evropa e Bashkuar nuk mund të krahasohet as edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për arsye se këto u krijuan dhe u përbënë nga një emigracion i madh, nga një *«ruée vers l'or»*[1] i popujve të ndryshëm, të cilët, për disa shekuj, me valë të mëdha e të njëpasnjëshme, u dynden e u stabilizuan në Amerikë, krijuan atje njëfarë uniteti, që u transformua më vonë në shtete të ndryshme, me ligje të ndryshme. Pastaj u kalua në Luftën e Secesionit në mes industrialistëve të Veriut dhe latifondistëve esklavazhistë të Jugut dhe nëpërmjet një kushtetute federale, gjatë kohës së Uashingtonit, të Xhefersonit, të Linkolnit e të tjerëve, u krijua një shtet me shtete të bashkuara kapitaliste. Pra Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke shfrytëzuar krahun e punës dhe djersën e po-

1 Frëngjisht — dyndje drejt arit.

pujve, u pasuruan, pastaj, nëpërmjet luftërave grabitqare, me armë dhe me politikë, me investime si dhe duke zhvilluar ekonominë e tregtinë brenda dhe jashtë vendit, arritën që në ditët e sotme të jenë lidershipi i botës kapitaliste.

Por as me Kinën nuk mund të krahasohet Evropa e Bashkuar. Kina është një vend i prapambetur, një vend i formuar prej shumë kombesh, por ku dominon kombi i hanëve. Ky komb, qoftë në kohën e perandorëve, qoftë në kohën e Sun Jat Senit apo të Mao Ce Dunit, ka dominuar në forma dhe në mënyra të ndryshme mbi të gjithë popujt e tjerë. Këtej del se Kina nuk paraqitet si një grumbullim popujsh me karakteristikat e tyre kombëtare, etnike, kulturore etj., por si një shtet i vetëm, i madh sa një kontinent.

Kurse Evropa, përkundrazi, përbëhet prej popujsh të ndryshëm që gjatë historisë kanë krijuar unitetin e tyre si komb, si shtet, si kulturë, si formë organizative dhe si potencial ekonomik. Pra këto shtete, pavarësisht nga prejardhja e tyre e vjetër, pavarësisht nga bagazhi i popujve dhe i shkëmbimeve ekonomike e kulturore në mes tyre, kanë fiksuar karakteristikat e tyre kombëtare, kufijtë (pa dyshim të diskutueshëm shumë herë dhe të zgjidhur nëpërmjet luftërash), dhe kanë krijuar kulturën dhe format e drejtimit ekonomik e kulturor të tyre.

Natyrisht, shtetet evropiane u zhvilluan jo në mënyrë të barabartë, në shekuj këto shtete kanë qenë të forta, disa janë dobësuar, të tjera janë ngritur, të tjera janë ulur, por sidoqoftë çdo shtet ka ruajtur karakteristikat e veta kombëtare. Të gjitha shtetet e Evropës u industrializuan, bile këto ishin shtetet e para ku u bë industrializimi që solli me vete lindjen e proletariatit, e varrmihësit të kapitalit. Në këto vende u zhvilluan revolucionet demokratiko-borgjeze dhe borgjezia, e cila në fillim ishte përparimtare. u bë shtypësja e popujve dhe krijoi strukturën e

superstrukturën e vet, zhvilloi industrinë, bujqësinë, me fjalë të tjera gjithë ekonominë, krijoi kulturën e vet dhe këtë ua imponoi edhe popujve të tjerë me armë, duke krijuar kështu kolonitë e saj.

Për të mos u zgjatur, duhet thënë se uniteti i Evropës, domethënë Bashkimi Evropian është një formë e re që u përshtatet fazës së imperializmit në kalbëzim, monopoleve dhe trusteve. Kjo Evropë e Bashkuar pas shumë përpjekjesh e pas shumë kontradiktash, të cilat në të vërtetë nuk janë zhdukur e nuk mund të zhduken, ka arritur në disa rezultate, por **Lenini i madh ka parashikuar që në kushtet e kapitalizmit krijimi i shteteve të bashkuara të Evropës nuk arrihet, ose, në qoftë se arrihet, ky bashkim shtetesh do të jetë reaksionar.** Pra çdo veprim që ndërmerret në këtë drejtim nga kapitalistët evropianë ka karakter reaksionar kapitalist.

Tash është formuar Këshilli i Evropës së Bashkuar, njëfarë qeverie, u zgjodh edhe parlamenti me vota të fshehta dhe të përgjithshme, por, natyrisht, në përpjesëtim me madhësinë e shteteve dhe çdo shtet i ndau kolltuqet në këtë parlament fiktiv në mes partive sipas madhësisë së tyre. Kështu që kontradiktat në fushën kombëtare do të shtohen në Evropën e Bashkuar, në unitetin ndërkombëtar të Evropës.

Pra iu arrit qëllimit të madh të diplomatit «të shquar», «i shquar» si diplomat deri në buzëqeshje dhe deri në majat e thonjve, siç e cilësonin amerikanët Çu En Lain, i cili predikonte dhe mbronte Evropën e Bashkuar në Tregun e Përbashkët Evropian.

Për Partinë tonë qëllimet e Çu En Lait kanë qenë fare të qarta. Ai ishte një mandarin, një përfaqësues i kapitalizmit kinez i maskuar nën petkun e komunistit. Ky tok me Mao Ce Dunin dhe me grupin e tyre kishin krijuar atë plan që Kina të orientohej drejt Perëndimit në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me këtë

Evropë të Bashkuar, me Japoninë dhe me gjithë reaksionin botëror. Pra ata kishin planifikuar transformimin nga rrënjët të Kinës në një vend kapitalist, gjithashtu hapjen e saj drejt kapitalizmit në botë, prandaj nuk kishte se si të mos i mbronin Evropën e Bashkuar dhe Tregun e Përbashkët Evropian. Këtë ata e bënin edhe për ta nxjerrë Kinën nga prapambetja shekullore se u duhej medoemos të ndillnin kapitalet amerikane, japoneze dhe të Evropës Perëndimore me qëllim që të ndihmohej kjo fuqi e madhe kapitaliste që po mëkëmbej. Kështu pra, mendimi i fshehtë i «diplomatit të madh» Çu En Lai, dhe i ëndërruesit «gjenial» Mao Ce Dun, ishte që Kina të bëhej një superfuqi botërore për sa u përket gjerësisë së territorit dhe madhësisë së popullsisë, të shtonte edhe forcën ekonomike e ushtarake që të errësonte në këtë mënyrë edhe imperializmin amerikan, edhe socialimperializmin sovjetik e gjithë kapitalizmin botëror. Kjo ishte ëndrra e çmendur e Çu En Lait, që ai nuk arriti dot ta shihte të realizuar sepse nuk e la sëmundja e kancerit. Sidoqoftë Çuja mundi të përgatiste këlyshët e tij Hua Kuo Fenin, Ten Hsiao Pinin, të cilët i nxori si qole, i vuri në poste drejtuese, u dha fuqi, Tenin e rimëkëmbi (gjoja i riedukoi nga gabimet që kishin bërë) dhe i lëshoi si qen të tërbuar për të kapur copat e mishit që do të binin nga qiejt.

Natyrisht, Çu En Lai me Mao Ce Dunin ishin revizionistë dhe ëndërronin që strukturës kapitaliste të Kinës t'i vishnin një superstrukturë revizioniste. Që t'i arrihej këtij qëllimi duhej sakrifikuar kultura e vjetër kineze, duhej adoptuar mënyra e jetesës evropiano-amerikane, duhej marrë shembull nga shtypja dhe shfrytëzimi i klasës punëtore që bënin Japonia dhe gjithë vendet e tjera kapitaliste, duhej, gjithashtu, që komunistët e vërtetë të luftonin revolucionin, partitë e vërteta marksiste-leniniste. Dhe aktualisht këtë gjë po e bëjnë në shkallë të gjerë, me rezultate të ndryshme, të dy pasardhësit e Maos dhe të

Çu En Lait. Ne shohim, gjithashtu, përpjekjet e ndryshme të brendshme e të jashtme të politikës kineze për të vënë në jetë qëllimet e ëndërrimtarëve Mao e Çu që Kina të bëhet superfuqi botërore. Në këtë shënim unë nuk do të flas për kaosin e brendshëm kapitalist në zhvillim, për kreditë që lypin kinezët andej-këtej, për «modernizimet» që kërkojnë të bëjnë, nuk do të flas as edhe për përpjekjet në kërkimin e unitetit me revizionistët e tjerë, me eurokomunistët dhe më në fund me Bashkimin Sovjetik revizionist, me të cilin po hidhen urat e marrëveshjes.

Aktualisht në kuadrin e çështjes së Evropës së Bashkuar konstatojmë një fenomen të ri dhe ky është eurokomunizmi. Eurokomunistët janë kapitalistë që kanë qenë maskuar si komunistë dhe që maskohen akoma me një cipë, me një cergë të hollë komuniste, por që kërkojnë të paraqiten si një fuqi e madhe në çdo shtet dhe të krijojnë një unitet me Evropën e Bashkuar. Prandaj kjo Evropë e Bashkuar, socialdemokracia dhe «demokracia evropiane» po e demaskojnë këtë përpjekje të eurokomunistëve, veçse do të jetë e zorshme që kjo të mund të likuidohet, për arsye se eurokomunistët nuk janë komunistë dhe ata, në mos sot, nesër do ta shpëlajnë edhe atë farë ngjyre trëndafili që u ka mbetur në trup. Eurokomunistët luftojnë që të bindin reaksionin amerikan dhe atë botëror, si dhe partitë «komuniste» revizioniste të Evropës e të vendeve të tjera, që nuk kanë pasur e as nuk kanë për qëllim revolucionin me dhunë, sepse i kanë braktisur tezat e Marksit e të Leninit mbi revolucionin proletar dhe kanë adoptuar tezat e evolucionit kinez, të Kautskit, të Bernshtajnit, të socialdemokracisë etj.

Kjo socialdemokraci, që është e dënuar qysh me tradhtinë e Internacionales së Dytë, tash është bërë mbështetja ideologjike e kapitalizmit dhe, tok me krahun e djathtë të kapitalizmit, të grumbulluar në parti të ndryshme demokristiane, demokrate e të tjera, bën lojën parlamentare «de-

mokratike». Këtë lojë do të përpiqen ta bëjnë edhe revizionistët e tjerë modernë, veçanërisht eurokomunistët. Por këtë lojë përsëri e pengojnë partitë reaksionare të Evropës.

Në konferencën e partive centriste të djathta dhe të udhëheqësve të 19 vendeve të Evropës Qendrore për të zgjeruar programin për zhvillimin e energjisë bërthamore si një pjesë e politikës së gjerë të energjisë Alois Mok, që u zgjodh kryetar i Bashkimit Demokrat Evropian, tha se ekziston alternativa e bashkimit të Evropës. Ky zotni në fjalimin e tij, përveç problemeve të tjera siç është shtimi i prodhimit të energjisë bërthamore për dekadat e ardhshme, vuri në dukje se ndërmarrjet e përbashkëta për pasurimin dhe përpunimin e uraniumit kanë një rëndësi të madhe. Pra ai u bën thirrje shoqërive të përbashkëta, që merren me këtë lëndë kaq të vlefshme, të unifikojnë akoma më shumë monopolin e tyre. Por çështja tjetër që theksoi ky farë zotnie ishte: «një herë e një kohë socialistët thoshin se Evropa ose do të bëhet socialiste ose nuk do të ekzistojë fare, kurse sot ne duhet t'u tregojmë atyre, ashtu siç e treguan edhe zgjedhjet evropiane deri në njëfarë mase, se ekziston alternativa e vërtetë e bashkimit të Evropës». Shikoni se si ky kapitalist e deformon pikëpamjen e Leninit, i cili e ka përcaktuar shumë qartë këtë problem jo vetëm për kohët aktuale, por edhe për të ardhmen për çdo përpjekje nga ana e kapitalistëve në këtë drejtim në kushtet më të vështira për ta.

Kjo konferencë, sipas të dhënave, e dënoi njëzëri eurokomunizmin për arsyet mendoj unë, që thashë më sipër, duke e konsideruar atë si rrezikun më të madh për demokracinë evropiane. Për fat të keq, eurokomunizmi nuk është rreziku më i madh i demokracisë evropiane, rreziku i saj është komunizmi i vërtetë, prandaj më pas ai thotë se për sa i përket komunizmit ne duhet ta luftojmë atë në çfarëdo formë që të shfaqet.

Ky është mendimi i kësaj konference të 19 vendeve të Evropës Qendrore dhe të partive centriste të djathta dhe e kryetarit të Bashkimit Demokrat Evropian, Mok. Kështu quhej edhe socialisti francez që lëshoi qentë e tërbuar kundër punëtorëve të Parisit në grevë. Pra «bëmë baba të të ngjas», thotë një thënie e popullit shqiptar. Socialistët, të cilët populli i merr për komunistë, nuk janë përveçse vegla të kapitalit monopolist dhe të imperializmit, shërbëtorë besnikë të tij.

Dhe së fundi, për fat të keq të Çu En Lait dhe të diplomacisë së tij «të zgjuar», çdo gjë vërteton se ai ka pasë menduar dhe mbështetur kapitalin monopolist, imperializmin, strukturën e superstrukturën e tij.

POGRADEC, E HËNË
13 GUSHT 1979

LËKUNDJE E MADHE NË POLITIKËN E IMPERIALIZMIT DHE TË REVIZIONIZMIT

Asnjëherë më parë nuk është ndier një lëkundje kaq e madhe si tani në politikën e imperializmit dhe të revizionizmit modern. Këtë lëkundje të fuqishme e ka shkaktuar kriza e madhe e përgjithshme ekonomike, monetare, politike dhe ushtarake, e ka shkaktuar lëvizja e gjerë e popujve kundër shtypjes së kapitalizmit monopolist, qoftë ky perëndimor ose lindor, e ka shkaktuar gjithashtu kriza e thellë në Republikën Popullore të Kinës, në vendet e Azisë Juglindore dhe në Lindjen e Mesme.

Afrika po lëviz. Shtetet afrikane nuk janë të qeta. Atje po zhvillohet luftë klasore si brendapërbrenda, ashtu edhe në planin e jashtëm kundër metropoleve që sundojnë me anë të politikës neokolonialiste.

Le të fillojmë më parë me situatën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Bashkimin Sovjetik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës po kalojnë një krizë të madhe, të brendshme dhe të jashtme. Kjo gjendje e ka detyruar presidentin Karter të marrë masa drakoniane për të përballuar krizën energjetike. Por kriza energjetike nuk është gjë përpara humbjes së besimit të popullit amerikan në të ashtuquajturën demokraci amerikane. Prestigji i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në arenën ndërkombëtare ka rënë, dollari amerikan po rrokulliset dita-ditës. Brenda vendit inflacioni është rritur. Duke qenë

në këto pozita financiare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë zhytur në një krizë të madhe, ekonomiko-financiare e si rezultat edhe politike, janë kredhur në borxhe ndaj Japonisë, Gjermanisë Federale dhe vendeve të tjera kapitaliste. Kështu që deficiti aktual në bilancin e tregtisë amerikane nuk është parë ndonjëherë.

Kjo situatë tepër e vështirë e detyroi Karterin të ndërrojë shumë nga kuajt e karrocës së tij, të qeverisë imperialiste amerikane duke mbajtur vetëm ata që ruajnë kyçet. Këto ndryshime në administratën e Karterit prekën interesat e disa trusteve e monopoleve amerikane, pra shkaktuan një konfuzion të madh dhe revoltën e tyre. Kuptohet se këto truste nuk janë dakord me Karterin që të forcojë pozitën e partisë së vet e të trusteve që ai përfaqëson, në kurriz të shkurtimit të fitimeve të tyre.

Një e treta e naftës që përdorin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mos dy të tretat, importohet. Për t'u bërë ballë të papriturave presidenti amerikan po përpiqet ta zëvendësojë naftën natyrore me naftë sintetike të nxjerrë nga qymyri. Por ky zëvendësim kërkon investime të cilat nëpërmjet taksave që shtohen, rëndojnë edhe mbi trustet dhe monopolet, prandaj këto janë të pakënaqura.

Të gjitha këto vështirësi kanë shkaktuar që politika e brendshme amerikane të bjerë në një konfuzion të madh dhe pozitat e Karterit si president të dobësohen shumë. Sido që Karteri bën thirrje që industria amerikane të prodhojë sa më shumë, prapë, në qoftë se vazhdon konfuzioni i tanishëm, shanset për rizgjedhjen e tij në krye të ekzekutivit amerikan në zgjedhjet e ardhshme do të jenë edhe më të pakta.

Por rrëmuja nuk qëndron vetëm në politikën e brendshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ajo vihet re dhe vazhdon edhe në politikën e tyre të jashtme. Në këto situata ku gjendet administrata amerikane, ato dëshirojnë që me Bashkimin Sovjetik të ruhet statukuoja

aktuale. Këtë kërkon edhe Bashkimi Sovjetik, për arsye se edhe ky është mbërthyer nga një krizë po kaq e thellë ekonomike e politike brenda vendit dhe në marrëdhëniet me satelitët e tij e me vendet e tjera.

Edhe Bashkimi Sovjetik, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka rënë në krizë për caktimin e udhëheqësit kryesor të partisë e të shtetit. Leonid Brezhnjevi, sikundër njoftojnë agjencitë e lajmeve, është i sëmurë rëndë. Herë pas here atë e shohim të duket në televizor si i mbajtur me zor. Edhe sikur Brezhnjevi të mos vdesë shpejt, ai duhet të zëvendësohet me një tjetër që të jetë më aktiv se ky. Brezhnjevi, siç dihet, është një oportunist i madh brenda radhëve të oportunistëve, prandaj imperializmi amerikan, bota perëndimore, kanë frikë nga zëvendësimi i tij me njerëzit e një krahu të fortë revizionist. Për arsye të krizës ekonomike, të krizës së gjithanshme të brendshme, që thashë më parë, si dhe të krizës që do të shkaktojë zhdukja e Brezhnjevit nga skena politike, Bashkimi Sovjetik do të kërkojë njëfarë qetësie për një periudhë kohe relativisht të gjatë.

Për këto arsye politika aktuale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e Bashkimit Sovjetik, si dy superfuqi të mëdha, është që të ruhet statukuoja dhe, sa të jetë e mundur, të shmangen turbullirat dhe luftërat çlirimtare të popujve. Me fjalë të tjera ato do të duan të merren vesh përkohësisht që të mos u ngjasin trazira të mëdha si këto që po ndodhin aktualisht çdo ditë.

Në Nikaragua, diktatori Somoza, i mbështetur nga imperializmi amerikan, u likuidua pas 40 e ca vjet sundimi diktatorial. Ai u dëbua me armë, me luftë. Ç'janë këta që kanë ardhur aktualisht në fuqi në Nikaragua? Nuk pretendojmë të themi ne fjalën e fundit në këtë drejtim, por, me sa na jepet mundësia të gjykojmë nga çka thuhet në shtypin e huaj, na duket se nuk janë tjetër gjë përveçse mjekroshë anarkistë, kastristë, njerëz që kërkojnë

të ndihmohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas njoftimit të agjencive të lajmeve anëtarja e Juntës të Rindërtimit Kombëtar të Nikaraguas, Violeta de Çomoro, bëri thirrje më 11 gusht për «solidaritet ndërkombëtar», duke nënvizuar se Nikaragua ndodhet në gjendje falimentimi, ndërsa komandanti Eden Pastora deklaroi se qeveria e Nikaraguas do ta ndryshonte armatimin e ushtrisë së saj «në rast se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të na japin pajisjet e nevojshme». Agjencitë e ndryshme të lajmeve bëjnë gjithashtu të ditur se duke pasur frikë se në vendet e tjera të Amerikës Qendrore dhe të Amerikës së Jugut mund të pëlcasin revolta dhe kryengritje kundër diktatorëve, Sekretari i Departamentit të SHBA-së, Vens foli më 11 gusht në Kuito, ku kishte shkuar për të marrë pjesë në ceremoninë e investiturës së presidentit të ri të Republikës së Ekuadorit, Roldos, për kthimin e «demokracisë» në Amerikën Latine.

Sipas agjencisë AFP, edhe kryetarët e qeverive të shteteve që morën pjesë në këtë ceremoni biseduan dy ditë me radhë për kthimin e «demokracisë» në Amerikën Latine sipas shembullit të Ekuadorit, që i dha fund diktaturës shumëvjeçare. Kjo lëvizje kundër diktaturave fashiste në kontinentin amerikan i ka shqetësuar shumë Shtetet e Bashkuara, të cilat, për të ruajtur ndikimin politik dhe kapitalet e tyre të investuara, si dhe për të mos pësuar edhe shtetet e tjera latino-amerikane fatin e disa klikave të Amerikës Qendrore, u rekomandojnë diktatorëve që të zbutin disi politikën kundër masave të gjera të popullit.

Shtypja e rëndë e kapitalit dhe thundra e gjakosur e imperializmit amerikan po zhduken përpara rezistencës së popujve të Amerikës Latine. Në këto kushte Karteri dëshiron ta zbutë gjendjen me ngut. Ai synon të qetësojë situatën revolucionare konkrete që po zhvillohet në këto

vende dhe të ruajë statukuonë në favor të kapitalizmit amerikan, të trusteve dhe të monopoleve që kanë hedhur thonjtë dhe bëjnë ligjin në këto vende.

Në Lindjen e Mesme amerikanët qëndrojnë më fort në pozitat e përkrahjes së aleancës së Egjiptit me Izraelin. Imperialistët amerikanë nuk dëshirojnë të marrin kontakt me OÇP-në (Organizata e Çlirimit të Palestinës), e cila, nëpërmjet Arafatit, kërkon me këmbëngulje të përfitojë nga situata e krijuar, që të marrë kontakt me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të njihet prej tyre. Kjo do të thotë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të ndërhyjnë pranë qeverisë së Izraelit që t'i lëshojë OÇP-së njëfarë rripi toke, ku kjo të krijojë një qeveri «autonome». Nuk dihet akoma se deri ku do të vazhdojë kundërshtimi i Karterit kundër OÇP-së, por dihet me siguri se në këtë mes rol të madh do të ketë qëndrimi i të gjitha shteteve arabe. Këto shtete po zhvillojnë një politikë të lëvizur si rëra e Saharasë përpara erërave të forta të ditës dhe të natës, ku sot krijohen male rëre e nesër ato zhduken përsëri. Sidoqoftë, nën këtë rërë, nën këto shkretëtira gjendet nafta. Dhe nafta për imperializmin amerikan e vendet perëndimore është vetë jeta.

Natyrisht, atje ku dëgjohen «bubullima» ndërhyjnë edhe agjentët sovjetikë, si Kastroja me shokë, për të nxitur turbullira në dobi të vet.

Kjo situatë i karakterizon aktualisht këto dy superfuqi, të cilat janë në hall dhe, të dyja së bashku, përpiqen të lidhin e të zgjidhin marrëveshje të reja secila më të favorshme për veten e vet e të zbutin kontradiktat sa të mundin. Në radhë të parë synimi i tyre është të qetësojnë opinionin botëror e të mënjanojnë konfuzionin e shkaktuar për arsye të mjerimit të madh të masave të popullit, sepse e dinë që ky shkakton kryengritje.

Në situatat revolucionare ekzistuese duket më qartë kalbëzimi i regjimeve kapitalisto-revizioniste. Kjo ngjet

edhe me regjimin titist. Për të ruajtur aparencat e për të vazhduar mashtrimin, ky regjim po mbështetet në dadanë e tij, në të ashtuquajturat vende të paangazhuara, që na qenka gjoja forca e madhe e «botës së tretë», që mund t'u bëjë ballë imperializmit dhe socialimperializmit.

Kjo forcë emrin e ka «e paangazhuar», kurse në realitet është një mishmash. Përgatitja e mbledhjes së Havanës është një fiasko në thelbin e saj. Pavarësisht se kjo mbledhje do të zhvillohet e se atje do të mbahen shumë fjalime, çdo gjë do të përfundojë me dështim. Asgjë të mirë nuk do t'u sjellë ajo popujve të botës.

Në Havanë mund të ketë edhe përpjekje e kundërshtime nga përkrahësit e Bashkimit Sovjetik, që kërkon t'i dalë zot botës «së paangazhuar». Në fakt me rastin e kësaj mbledhje gazeta «Pravda» po e trumbeton atë me të madhe duke thënë se kjo forcë e vendeve «të paangazhuara» është e rëndësishme dhe duhet të fuqizohet.

Fletushka zyrtare e vendit që kryeson Traktatin e Varshavës dhe që sundon egërsisht mbi pjesëtarët e këtij traktati, i bën thirrje për «unitet» botës «së paangazhuar» titiste që ajo të qëndrojë e «paangazhuar»! Me fjalë të tjera Bashkimi Sovjetik revizionist i bën thirrje kësaj «bote» që të angazhohet me të, të braktisë «botën e tretë» të Kinës, të mos lidhet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fundi i fundit sovjetikët i kërkojnë kësaj «bote» që të ruajë statukuonë. Në mbështetje të kësaj propagande «Pravda» boton artikuj të mëdhenj për t'u mbushur mendjen të tjerëve se gjoja Bashkimi Sovjetik u paska dhënë ndihma të mëdha vendeve «të paangazhuara» dhe po ndërtoka në to afro katërqindetridhjetë ndërmarrje të mëdha etj., etj. Kjo zhurmë është shprehje e zakonit të keq të fuqive të mëdha, që, kur ua lyp interesi, trumbetojnë pa pikë turpi edhe ato pesë grosh kredi që japin për të mbajtur nën thundër e mjerim vendet e pazhvilluara.

Një çështje tjetër, që ka dalë tash në skenë, është

«modernizimi i Kinës». Ky vend, me një popullsi të madhe, është në rrëmujë e sipër. Atje ka mosmarrëveshje të thella në gjirin e udhëheqjes. Disfata e politikës së Tenit në arenën ndërkombëtare është e turpshme. Besimi i vendeve kapitaliste ndaj zhvillimit të Kinës nuk është më ai i ditëve të para. «Triumfi» i Tenit ishte një zjarr kashte. Aktualisht, imperialistët dhe kapitalistët, që e panë realitetin ekonomik dhe politik të Kinës, mendojnë ndryshe për të.

Siç e dimë të gjithë dhe sikurse e kam thënë edhe herë tjetër programi ekonomik në Kinë është ndryshuar. «Katër modernizimet» që filluan të trumbetoheshin, sikur s'po ndihen më si më parë. Tani kinezët i kanë ulur pendët dhe kanë filluar punën për «rindërtimin e ekonomisë dhe të politikës», se politika e ndjekur deri tash nuk u ka dhënë rezultatet që kërkojnë. Rehabilitimi dhe ardhja në fuqi e gjithë tradhtarëve kapitalisto-revizionistë në Kinë kanë shkaktuar pakënaqësi të mëdha në disa qarqe dhe sidomos në popull. Pekini mbushet vazhdimisht me dacibao, që dallohen për dy drejtime kryesore: Shumica e tyre është për atë që të vazhdohet rehabilitimi i plotë i reaksionit, t'u kthehen pasuritë e shpronësuara të pasurve shfrytëzues, të ngrihen rrogat etj., etj., por nuk mungojnë edhe kundërshtimet ndaj kësaj politike reaksionare, gjë që kuptohet nga kërcënimet e «Zhenminzhibaos» kundër provincave të tëra që nuk e pranojnë situatën aktuale në Kinë. «Zhenminzhibaoja», në një artikull të saj, shkruan se në provincën ku ka lindur Çian Çini po ngjasin turbullira të mëdha, dhe nuk ngurron të kërcënojë me këtë rast me masa ndëshkimore.

Në Pekin duken vazhdimisht grupe fshatarësh të rrjepur e të rreckosur, që kërkojnë bukë, kërkojnë strehim, kërkojnë punë. Ata shtrihen përpara selisë së Komitetit Qendror, ku rrethohen nga policë të armatosur me uni-

formë ose pa uniformë. «Zhenminzhibaoja» dhe agjencitë e huaja të lajmeve thonë se këta fshatarë janë 200 veta, por e vërteta është ndryshe, ata janë shumë më tepër. Ndër 950 milionë kinezë, shumica dërrmuese e të cilëve janë fshatarë, numri i atyre që bien në dëshpërim dhe ankohen është shumë i madh. Çështja e fshatarësisë qindramilionëshe kineze, që jeton në mizerje, është tepër e ndërlikuar, prandaj edhe përfaqësuesit e asaj shumice dërrmuese të Kinës që shkojnë në Pekin të pangrënë nuk janë 200.

Në Kinë aktualisht udhëheqja revizioniste po i bën thirrje rinisë që të shkojë përsëri në fshat. Kjo tregon se ajo po kthehet në pozitat e Çian Çinit, të Jao Ven Juanit ose të Mao Ce Dunit, që Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini i kanë kritikuar shumë, duke pretenduar se ata «kishin dërguar rininë me zor që të punonte nëpër komuna». Tash, duke bërë të njëjtën gjë, këta thonë se gjoja nuk i dërgojnë të rinjtë në komuna, por i çojnë për të punuar në tokat kufitare. Lojë fjalësh. Dërgimi i të rinjve në thellësitë e Kinës për të punuar tokat që të zhvillohet bujqësia, se ndryshe njerëzit vdesin urie, në thelb ka qenë një politikë e drejtë. Klika që erdhi në fuqi, të gjitha veprimet qofshin ato të mira ose të këqija të paraardhësve, i hodhi në shportën e plehrave. Tash që ka rënë vetë në hall, kthehet prapë dhe lëpin ato që ka pështyrë.

Në këto situata të paqëndrueshme brenda edhe jashtë saj, Kina kërkon njëfarë stabiliteti. Natyrisht, kërkon edhe ndihma, e të tilla ajo ka marrë dhe do të marrë nga imperializmi amerikan, nga Japonia, nga Gjermania dhe nga vendet e tjera imperialiste.

Për të kundërbalancuar dështimin e synimit të saj që të shpërthente lufta midis fuqive perëndimore e imperializmit amerikan, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër, udhëheqja tradhtare kineze po i kthen sy-

të edhe nga Bashkimi Sovjetik. Ne kemi thënë se politika kineze ka qenë dhe është kurdoherë e lëkundshme si lavjerrësi i sahatit, që shkon sa majtas djathtas. Nga vjeshta kinezët dhe sovjetikët do të shkëmbejnë delegacione qeveritare për përmirësimin e marrëdhënieve të acaruara. Në fillim do të vejë zëvendësministri i Jashtëm kinez në Moskë për të biseduar me zëvendësministrin e Jashtëm sovjetik, pastaj ky i fundit do t'i vazhdojë bisedimet në Pekin.

Pra, që Kina të kundërbalancojë disfatat e saj, po rifillon dashuriçkat me Bashkimin Sovjetik. Me gjithë këta hapa politikë që po bën, Kina nuk i ka rregulluar situatat e vështira që duhet të përballojë. Mbeten si probleme të mëdha çështja e marrëdhënieve me Vietnamin dhe me vendet e tjera të Azisë Juglindore. Qëllimi i udhëheqësve të sotëm të Kinës për afrim me Bashkimin Sovjetik është që ky i fundit të ndikojë te vietnamezët që këta të ulin pendët. Dhe duhet menduar se qeveria sovjetike mund t'i ketë kërcënuar vietnamezët për të mos bërë shumë zhurmë dhe për të tërhequr gradualisht trupat nga Kamboxhia, duke dhënë sigurime ndërkombëtare se Kina nuk do të ndërhyjë në punët e brendshme të Kamboxhias dhe të Laosit.

Siç po duket vietnamezët nuk kanë më besim as te sovjetikët, as te kinezët dhe as te ndonjë zgjidhje ndërkombëtare e çështjes së Kamboxhias. Nga agjencitë e huaja thuhej se Sihanuku do të kalonte nga Koreja për të bërë mbledhjen e refugjatëve kamboxhianë, që të formonte një qeveri në mërgim, por më pas këto agjenci njoftuan deklaratën e Sihanukut se ky e ka lënë këtë projekt, duke sqaruar se kush dëshiron të bisedojë me të, mund të shkojë në Kore në pallatin e tij të veçantë jashtë Phenianit.

Franca nuk dëshiron të ngatërrohet në marrëdhëniet në mes Bashkimit Sovjetik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës, prandaj Vietnamit i mbetet të merret vesh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin

Sovjetik dhe me Kinën. Po t'i shikojmë problemet e Vietnamit në vetvete, del se ato janë të sëkëlldisura; në udhëheqjen e Vietnamit me siguri ekziston përçarja, në radhët e saj ka elementë prokinezë, nga të cilët njëri u arratis dhe shkoi në Pekin. Një pjesë e udhëheqjes vietnameze është prosovjetike. Pjesa tjetër është properëndimore. Që të tria këto fraksione në gjirin e udhëheqjes luftojnë kundër njëra-tjetrës. Fraksioni prokinez qëndron në fund të shkallëve dhe ruhet fort nga fraksionet e tjera më të fuqishme të udhëheqjes. Nga kjo gjendje e gjërave duhet kuptuar që Vietnami me Kinën qëndrojnë përballë njëri-tjetrit me thikë në brez. Vietnamezët pretendojnë se kinezët po grumbullojnë forca për t'i risulmuar, kurse kinezët nga ana e tyre pretendojnë se vietnamezët po përforcojnë kufirin.

Për sa u përket sovjetikëve, natyrisht ata e ndihmojnë Vietnamin, por, duke gjykuar politikën e përgjithshme aktuale që po zhvillohet në këto situata, ata nuk mund të jenë shumë entuziastë për ta ndihmuar gjatë Vietnamin kundër Kinës. Ky qëndrim i sovjetikëve do të mbahet për arsye se Kina po bën lëshime drejt Bashkimit Sovjetik, të cilit i interesojnë shumë këto. Bashkimi Sovjetik kërkon ta zbutë situatën me Kinën që të dëmtojë ndikimin amerikan dhe evropianoperëndimor në këtë vend të madh fqinj.

Me fjalë të tjera socialimperializmi sovjetik përpiqet që brenda në Kinë të mos mbretërojnë Ten Hsiao Pini dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por Brezhnjevi dhe Bashkimi Sovjetik revizionist. Kjo është arsyeja që Bashkimi Sovjetik qëndron mbi kalë në mes Kinës dhe Vietnamit. Vietnamezët këtë qëndrim të sovjetikëve e shikojnë, prandaj aktualisht atje është rinxitur dëshira e madhe e grupit të proamerikanëve, e grupit të properëndimorëve për lidhje diplomatike dhe për të kërkuar ndihmë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto javët e fundit vajtën në Hanoi jo 1, por 15 se-

natorë amerikanë, të cilët qëndruan atje disa ditë dhe biseduan mbarë e prapë me udhëheqjen vietnameze. Sigurisht ata kanë rënë në marrëveshje që ne nuk i dimë, se nuk janë bërë të njohura, por e kuptojmë që këto delegacione senatorësh përgatitin terrenin për një politikë të re amerikano-vietnameze, për një kompensim të humbjes që mund të pësojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në skakierën kineze.

Vietnami, për të përballuar kërcënimin kinez, e sidomos për të marrë kredi dhe për të përmirësuar gjendjen e mjeruar ekonomike, dëshiron të hedhë «valle në litar» me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Amerikanët, si shpërblim të atyre që u lypin vietnamezët, kërkojnë shumë koncesione, duan, në radhë të parë, që vietnamezët të heqin dorë nga Kamboxhia e nga Laosi, pra duan që Azia Juglindore të mos kërcënohet më nga Vietnami dhe nga një aleancë vietnamezo-sovjetike. Vietnami do t'u japë koncesione edhe amerikanëve. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në të njëjtën kohë do të përpiqen që Kina të mos ndikojë në këto marrëdhënie dhe të mos krijojë perandorinë e saj në Azinë Juglindore.

Pra, po shohim se një valle po hidhet dhe ai që e drejton këtë thërret: «ndërroni damat». Të gjitha fuqitë e mëdha po rishikojnë pozitat e tyre të brendshme dhe të jashtme, aleancat, miqësitë dhe armiqësitë. Tani është epoka e «ndërrimit të grave». Nga kjo situatë e sëmurë do të lindë një disfatë e turpshme ekonomike, politike dhe ushtarake për kapitalizmin.

Popujt e botës, marksistë-leninistët revolucionarë, njerëzit përparimtarë, duhet të përfitojnë nga kjo situatë.

Ne, nga ana jonë, duhet t'i analizojmë këto situata në prizmin e marksizëm-leninizmit, të mbajmë qëndrime të drejta për të gjitha këto që po ndodhin dhe të zbulojmë të vërtetën, të cilën, me sa të mundemi, t'ua bëjmë të njohur të gjithë atyre që kanë mundësi të na dëgjojnë dhe të na kuptojnë, të gjithë popujve. Këtyre situatave që po zhvillohen, popujt e botës duhet t'u vënë përballë rezistencën e madhe të tyre, duke u ngritur në luftën nacionalçlirimtare kundër klikave sunduese të brendshme dhe kundër imperializmit e socialimperializmit amerikan, sovjetik, kinez e të çfarëdolloji tjetër me çfarëdo maske që të mbajnë në fytyrë. Maska u duhet çjerrë, por vetëm kaq nuk mjafton. Popujt, të cilët vuajnë nga shtypja e shfrytëzimi i fuqive të mëdha imperialiste dhe nga klikat në shërbim të tyre, duhet të ngrihen në greva e në demonstrata, në barrikadat e luftës klasore, në revolucion. **Revolucioni do t'i godasë të gjithë ata që kërkojnë t'i mbajnë popujt në robëri e në mjerim.**

E DIEL
19 GUSHT 1979

MBLEDHJA E VENDEVE «TË PAANGAZHUARA» NË HAVANË NJË TEATËR KUKULLASH

Aktualisht titistët po çahen e po ndahen, si i thonë fjalës, po bëjnë përpjekje të mëdha, po bëjnë shpenzime të panumërta, natyrisht, të paguara nga imperializmi amerikan dhe po dërgojnë delegacione në të katër anët e botës, për të propaganduar mbi ekzistencën dhe mbi nevojën e veprimtarisë politike të të ashtuquajturave vende të paangazhuara në marrëdhëniet ndërkombëtare. Por të gjitha këto veprime të tyre kanë vetëm një jehonë të zbehtë, pa brendi dhe pa konkluzione.

Së shpejti në Havanë do të mbahet një mbledhje e të ashtuquajturave vende të paangazhuara. Tendenca e këtyre vendeve, të cilat në fakt janë të angazhuara, është që të krijohen përsëri në mënyrë fiktive grupe të ndryshme, që gjoja formojnë këtë lëvizje ndërkombëtare dhe në këtë «teatër kukullash», natyrisht, fuqitë e mëdha të vazhdojnë të lëvizin penjtë e marionetave të veta.

Tash në «lëvizjen e të paangazhuarve» po ndërhyn edhe Bashkimi Sovjetik, i cili ka krijuar klikat e veta midis vendeve që bëjnë pjesë në këtë lëvizje. Më kryesoret nga këto janë Kuba me Kastron në krye, Vietnami, Laosi, Angola, Etiopia e disa vende të tjera. Natyrisht këto do të përpiqen që të ashtuquajturat vende të paangazhuara, të cilat në fakt janë të angazhuara ca me imperializmin, ca me socialimperializmin, të kalojnë

në anën e socialimperializmit sovjetik. Këtu ato bien në kundërshtim me jugosllavët, të cilët nuk dëshirojnë që të jenë të varur plotësisht nga socialimperializmi sovjetik, por duan që vendet e «paangazhuara» të qëndrojnë më mirë të shkëputura fije-fije e të shpërndara kokrra-kokrra dhe të kenë një politikë gjoja të përbashkët në marrëdhëniet ndërkombëtare, të bëjnë gjoja kërkesa dhe lëvizja të marrë pamjen e një faktori të pavarur në çështjet botërore. Ky është qëllimi gjoja strategjik i vendeve «të paangazhuara».

Të tillë koment i bën udhëheqja jugosllave kësaj «lëvizjeje» dhe me keqardhje thotë se ajo nuk mund të realizohet plotësisht në kushtet e sotme ndërkombëtare, sepse rrethanat nuk janë përmirësuar dhe politikisht e ekonomikisht në botë nuk ekziston ai vullnet nga fuqitë e mëdha, por edhe nga vetë të ashtuquajturat vende të paangazhuara, për t'u bërë një faktor i tillë në marrëdhëniet akoma të pademokratizuara në të gjitha fushat e problemeve ndërkombëtare. Por, natyrisht, kur s'ke ç'bën, do t'i buzëqeshësh edhe fatit të keq, kështu po bëjnë edhe jugosllavët, të cilët, për të mashtruar të tjerët, pretendojnë se mbledhja që do të bëhet në Havanë, si të gjitha takimet e këtij lloji të nivelit të lartë, do të mbajë qëndrim lidhur me problemet, qëndrim që, siç thonë ata, do të bazohet në qëllimet dhe në parimet e politikës së vendeve «të paangazhuara».

Por në realitet kjo politikë e vendeve «të paangazhuara» është një politikë e varur nga shtetet e ndryshme kapitaliste, se në të vërtetë shtetet e ashtuquajtura të paangazhuara ose janë grumbulluar në disa grupe, të cilat natyrisht s'kanë asnjë konsistencë dhe asnjë vijë politike të përbashkët, ose janë të varura nga të tjerët. Megjithatë jugosllavët përpiqen t'u mbushin mendjen të tjerëve, duke thënë se mbajtja e qëndrimeve të pavarura do të përcak-

tojë në të vërtetë qëndrimin e lëvizjes ndaj njërës apo tjetrës fuqi ose bllok dhe kjo do të varet para së gjithash nga qëndrimi i vetë fuqive ose blloqeve, ndaj çdo problemi konkret ndërkombëtar.

Është e qartë sa e ndërlikuar dhe sa e parealizueshme është kjo thënie dhe kjo paraqitje e pozitës «së madhe» të Titos. Në kundërshtim me çka thonë jugosllavët, asnjë nga këto shtete nuk përpiqet ta forcojë këtë «unitet» të lëvizjes dhe rolin e saj në zhvillimin ndërkombëtar. Kështu, në këto vende konstatojmë grindje të panumërta, deri në luftëra e komplote të organizuara nga fuqitë e mëdha dhe nga agjenturat e tyre brenda vendit, të udhëhequra nga klikat kapitaliste në fuqi, që natyrisht janë të lidhura me fuqitë e huaja. S'është aspak e vërtetë se kjo lëvizje, siç pretendojnë jugosllavët, është afirmuar, ka afirmuar autoritetin, natyrën e «pavarur e pa blloqe» dhe veprimtarinë e saj e se kjo lëvizje në të gjitha takimet e zhvilluara deri më sot paska vërtetuar universalitetin e saj politik e ideologjik që ofron vetëm një alternativë: paqe, bisedime e bashkëpunim(!). Titoja dhe shokët e tij duhet të thonë më mirë që këto mbledhje janë maskarada, janë shfaqje karnavalesh, ku flitet e llomotitet, ku merren disa vendime pa bazë e pa qëllime të caktuara dhe nuk arrihet në asnjë rezultat. Ata do të mblidhen vetëm sa të hanë e të pinë gjatë këtyre ditëve dhe t'u tregojnë popujve se gjoja ekzistoka një lëvizje e tillë, nga e cila ata duhet të presin «çlirimin» ose «ndihma» materiale, që «të përmirësojnë jetesën» apo «të pasurohen».

Këto mbledhje bëhen me të vetmin qëllim për të përfituar disa klika të këtyre vendeve, që kanë tradhtuar kauzën e popujve të tyre dhe që janë futur në shërbim të plotë të superfuqive, siç janë ato të Jugosllavisë, të Kubës, të Vietnamit e të shumë vendeve të tjera, që na hiqen si udhëheqëse të kësaj «lëvizjeje të paangazhuar».

Edhe Kina bën punën e vet, si ai laroni në panair, siç thotë francezi. Kina, përpiqet të ketë edhe ajo partnerët e saj në këtë mbledhje të «të paangazhuarve», ose siç i quan ajo të «botës së tretë», mbasi nuk ka asnjë ndryshim në mes «botës së tretë» dhe «botës së paangazhuar».

E MARTE
4 DHJETOR 1979

GJERMANOPERËNDIMORËT JANË TË DETYRUAR TË NA PAGUAJNË DËMSHPËRBLIMET

(Teza)

Në takimin që pata me shokët sekretarë të Komitetit Qendror u interesova të mësoja nëse janë vënë në qarkullim dhe nëse janë shitur pulla poste përkujtimore për 35-vjetorin e Çlirimit të Atdheut, dhe në rast se janë marrë masa për të vënë në qarkullim pulla përkujtimore edhe për 100-vjetorin e ditëlindjes së Stalinit. Ramizi më informoi se për të dy rastet është vepruar.

Bisedova pastaj me shokët për problemin e dëmshpërblimeve nga gjermanoperëndimorët. Aktualisht shumë korrespondentë të shtypit të huaj po flasin për këtë çështje, moszgjidhjen e së cilës nga ana e gjermanëve e justifikojnë dhe fajin për pengesat që ngrihen ia hedhin ambasadorit gjerman në Beograd.

Në këtë situatë mendoj që për këtë çështje ne mund të përgatitim një artikull, të cilin ta botojmë në një moment të përshtatshëm. Një moment i tillë, mund të jenë, zgjedhjet parlamentare, që do të bëhen në vitin e ardhshëm në Gjermaninë Perëndimore. Për këtë problem formimi i opinionit te gjermanët ka rëndësi të veçantë. Prandaj artikulli që në titull, në mënyrë të hapët e shprehimisht, t'i drejtohet popullit të Republikës Federale Gjermane. Shkurtimisht mendoj që ai të përmbajë këto ide:

E para, ushtria hitleriane gjermane vrau popullin shqiptar dhe Shqipërinë e bëri shkrumb e hi. Ju e dini

këtë, t'i thuhet në artikull popullit gjerman, por ne jemi të detyruar t'jua kujtojmë përsëri. Dëshirojmë t'jua kujtojmë këtë edhe për faktin që ne, si pjesëtarë të aleancës antihitleriane, ushtrinë hitleriane e thyem në fushën e betejës. Si rrjedhim, ju jeni të detyruar moralisht, nga norma të së drejtës ndërkombëtare dhe nga vendime konferencash e organesh ndërkombëtare, që të na paguani dëmshpërblime për dëmet kolosale që na keni shkaktuar.

E dyta, aleatët, që mundën ushtrinë naziste gjermane, kanë caktuar Republikën Federale Gjermane që t'ia paguajë Shqipërisë dëmshpërblimet e luftës. Këtë e theksojmë, sepse ka njerëz që thonë se edhe Republika Demokratike Gjermane duhet të paguajë dëmshpërblime. Është fakt që edhe Republika Demokratike Gjermane është caktuar të paguajë dëmshpërblime, por është vendosur që kjo t'ua paguajë shteteve të tjera e jo vendit tonë.

E treta, qeveria juaj shteteve të tjera ua ka paguar dëmshpërblimet, ndërsa shtetit shqiptar nuk ia ka paguar dhe nuk dëshiron t'i paguajë asnjë fenih, me gjithë kërkesat zyrtare, jo një herë, por shumë herë, që i janë bërë asaj nga ana e Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

E katërta, mospranimit të kërkesave tona të ligjshme qeveria juaj u kundërvë arsyetime pa baza dhe pa asnjë logjikë, si për shembull:

a) Qeveria e Bonit nuk pranon bisedime me Qeverinë Shqiptare për dëmshpërblimet.

b) Se në Republikën Federale Gjermane qenka aprovuar një ligj, në bazë të të cilit qeveria as mund të bisedojë për dëmshpërblimet e luftës, as edhe t'i paguajë ato përpara se të jetë nënshkruar traktati i paqes me Gjermaninë. Kjo do të thotë që çështja e dëmshpërblimeve ndaj vendit tonë të shtyhet për në kalendat greke.

c) Qeveria juaj dëshiron vetëm të vendosë lidhje diplomatike me shtetin tonë.

E pesta, në artikull, gjithmonë duke iu drejtuar popullit gjerman, të theksohet se këto qëndrime të qeverisë suaj janë të padrejta, amorale, antidemokratike, mospërfillëse për detyrimet që ka ndaj të tjerëve dhe se me këtë qëndrim të saj ajo shkel e përbuz të drejtat e popujve që vuajtën nga hordhitë naziste dhe luftuan kundër tyre. Ju nuk duhet t'i lejoni këto qëndrime të qeverisë suaj, përkundrazi, t'i dënoni dhe ta detyroni atë të paguajë dëmshpërblimet, ndryshe tok me të bëheni edhe ju përgjegjës përpara popujve dhe historisë.

E gjashta, qeveria juaj, të vihet në dukje në artikull, na thotë se rinia gjermane nuk do t'ia dijë për krimet që kanë bërë prindërit e saj. Kjo do të thotë se ajo nuk dëshiron të mbajë përgjegjësi për krimet e baballarëve të saj. Lidhur me këtë të shtrohet pyetja: Po a e dini vallë ju se çfarë mendon rinia e vendit tonë për nënat, baballarët, motrat e vëllezërit që u janë vrarë pikërisht nga baballarët e rinisë suaj të sotme, nga nazistët gjermanë, të cilët e dogjën anembanë vendin tonë? A ia bëni ju këtë pyetje vetes? Harroni ju se në atë drekë apo në atë darkë të mirë e të pasur që hani, ka edhe gjak e hi të shqiptarëve të vrarë dhe të Shqipërisë së shkatërruar prej tyre? Ky gjak e këto shkatërrime duhen larë. Ato nuk duhet dhe nuk mund të harrohen apo të kalohen lehtë-lehtë, as me pretendimin pa kurrfarë logjike që rinia e sotme gjermane nuk dashka t'ia dijë për krimet që kanë bërë prindërit e saj gjatë periudhës hitleriane. S'do t'ia dijë ajo, por duam t'ia dimë ne, që u vramë e u dogjëm prej baballarëve të saj.

E shtata, qeveria juaj invokon ligjet që ka aprovuar për dëmshpërblimet dhe me këtë e bllokon këtë çështje. Sigurisht, atë s'e ndalon askush të shpallë një apo njëqind ligje. Por edhe ne kemi të drejtë t'ju pyesim: Çfarë do të thoshit ju, gjermanë, sikur një apo disa shtete të tjera një mëngjes të bukur të shpallin ligje, në bazë të të cilave

të mos ju paguajnë juve borxhet që ju kanë marrë e nëpërmjet të cilave ekonomikisht ju jeni bërë një nga shtetet më të fuqishme në botë? Ju nuk doni t'i paguani borxhet për krimet e kryera dhe dëmet që i keni bërë një vendi të vogël, duke menduar: e ç'do të na bëjë neve Shqipëria, po s'ia dhamë dëmshpërblimet?! Por mos harroni se edhe vende e popuj të tjerë mund të marrin vendime të tilla, për të mos ju paguar juve borxhet skllavëruese që u keni imponuar atyre. Vallë, ç'do të bënit ju në këtë rast? Do t'u shpallnit luftë? Apo mendoni se ata do të thyhen ose do të vdesin urie, po të marrin një vendim të tillë? Jo! Ju gaboheni rëndë. Do të jeni ju ata që do të pësoni fatkeqësi e do të dëmtoheni ekonomikisht, po të ndodhë një gjë e tillë.

E teta, në artikull popullit gjerman t'i drejtohet edhe kjo pyetje: Përse u dashka atëherë të kemi ne më parë marrëdhënie diplomatike me një shtet dhe me një qeveri që vepron në këtë mënyrë ndaj popullit dhe vendit tonë?

Së fundi, gjermanëve t'u thuhet: Ju duhet të mendoni për këto çështje, sepse janë parimore. Kërkesat tona janë të drejta dhe të moralshme. Ne kemi respekt për popullin demokrat gjerman, por edhe ju duhet të keni respekt për popullin shqiptar. Ne kurrë s'i kemi bërë ndokujt ndonjë të keqe, pra as popullit gjerman. Kurdoherë e kundërta ka ngjarë. Prandaj ju bëjmë thirrje t'i jepni rrugë të drejtë e të shpejtë problemit të ligjshëm të dëmshpërblimeve, ndryshe opinioni publik botëror do t'ju dënojë!

Kaq. E tillë të jetë, në vija të përgjithshme, përmbajtja e këtij artikulli, u thashë shokëve. Me këtë ne të mos i drejtohemi qeverisë gjermane, sepse kjo, në mënyra të ndryshme, e ka thënë fjalën e saj jo me pozitën e rinisë, jo me ligjin që ndalon diskutimin e dëmshpërblimeve e të tjera e të tjera. Pikërisht për këtë arsye ne t'u drejtohemi tani popullit gjerman dhe opinionit publik botëror. Artikulli të përgatitet në mënyrë që të bjerë në sy dhe të

mos humbasë në konsiderata lumë, të jetë i prerë dhe pa fjalë të tepërta, veçse idetë tona t'i vëmë një çikë të ujdisura mirë.

Ideja qendrore e artikullit të jetë e thjeshtë dhe e kuptueshme: ne t'i drejtohemi popullit gjerman, duke i treguar atij se qeveria federale gjermane nuk dëshiron të na i paguajë dëmshpërblimet; t'u themi gjermanëve që ne kemi besim te ju, po edhe ju duhet të keni besim te ne, ne kemi respekt për ju, po edhe ju duhet të keni respekt për ne; ju na sulmuat, na dogjët, na keni vrarë, por më së fundi u thyet. Ju u keni paguar dëmshpërblime të tjerëve, kurse neve jo. Bile, mendoj që në fund të këtij artikulli, atje ku do të flitet për çështjen e marrëdhënieve diplomatike, mund të vëmë në dukje se Republika Federale Gjermane nuk ka marrëdhënie diplomatike vetëm me shtetin më demokratik, me shtetin shqiptar. Të theksohet se me këto qëndrime nuk mund të ketë marrëdhënie diplomatike midis shtetit tonë dhe shtetit të Gjermanisë Federale.

Për botimin e një artikulli të këtillë duhet të zgjedhim momentin e përshtatshëm, ta botojmë kur të afrohen zgjedhjet, që të prekim opinionin publik dhe ta nxitim këtë që të reagojë në favorin tonë. Momenti më i përshtatshëm është ai i fillimit të fushatës elektorale. Të mësojmë më parë datën kur do të bëhen votimet dhe, meqenëse fushata atje do të fillojë dy muaj përpara ditës së votimeve, artikullin mund ta botojmë 15 ditë përpara këtij momenti. Opinionit publik gjerman dhe qeverisë së Bonit ne do t'u themi me këtë artikull: këtë borxh ju duhet ta shlyeni ndryshe ne do të dalim me një artikull tjetër për sqarimin e mëtejshëm të opinionit publik botëror.

Gjithë puna është t'i detyrojmë gjermanoperëndimorët që të na paguajnë dëmshpërblimet, se për këtë ka ligje e vendime ndërkombëtare. Duhet të mos harrojnë gjermanët se gazetarët, që flasin për këtë çështje, kanë

mendimet e veta. Disa prej tyre janë përparimtarë dhe me siguri këta do ta kapin çështjen që do të ngremë në artikull ne dhe do të themi: ju nxirrni një ligj, por edhe shtetet e tjera mund të nxjerrin ligje e të marrin vendime për të mos ju paguar juve borxhet. Dhe gati është Titoja për një gjë të tillë.

Pra t'u themi gjermanëve se duhet t'i paguajnë këto borxhe, se edhe të tjerëve ua kanë paguar për dëmet që u kanë shkaktuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, si rrjedhim ato duhet të na i paguajnë medoemos dhe neve.

Pa dyshim që opinioni përparimtar do të na japë neve të drejtë dhe do të thotë që Shqipëria është një vend i vogël, që u dogj e u përvëlua gjatë luftës kundër pushtuesve nazistë, atëherë çfarë kërkon ti, Gjermani, pse nuk ia jep këtij populli të drejtën që i takon? Të paktën shtrohu e bisedo me të për këtë çështje një herë dhe paguaja paratë, se ky është një problem që duhet përballuar medoemos.

E PREMTE
21 DHJETOR 1979

EMRI DHE VEPRA E J. V. STALINIT NUK DO TË VDESIN NË SHEKUJ

Sot është 100-vjetori i lindjes së revolucionarit të madh, Josif Visarionoviç Stalinit, marksist-leninistit të shquar, një nga klasikët e mëdhenj të kohës sonë. Ky njëqindvjetor u festua me madhështi kudo te ne. Qysh prej disa muajsh me radhë, në kuadrin e këtij jubileu të madh, janë zhvilluar aktivitete të shumta, ku është folur për jetën dhe veprën e Stalinit në udhëheqje të revolucionit, në mbrojtje të marksizëm-leninizmit dhe në ndihmë të popullit shqiptar. Me këtë rast në gjithë vendin, në fshatra, në kooperativa të bashkuara e në rrethe të ndryshme u organizuan aktivitete të panumërta, si konferenca etj. Mbrëmë në Tiranë, në Teatrin e Operës e të Baletit, u mbajt konferenca solemne ku foli shoku Ramiz Alia dhe sot, më 21 dhjetor, po mbahet sesioni jubilar për 100-vjetorin e Stalinit, që është organizuar nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe nga Shkolla e Lartë e Partisë. Aty do të mbahen një sërë referatesh.

U shtypën dhe dolën në qarkullim vëllimi me vepra të zgjedhura të Stalinit, si dhe një sërë veprash të tjera të tij me tematikë të veçantë. U botua gjithashtu edhe libri me titull «Me Stalinin» ku unë kam shkruar kujtimet e mia nga takimet që kam pasur me të. Kurse gjetkë nuk po shohim të bëhet asgjë. Vetëm «Pravda» botoi një artikull redaktorial, që i kushtohet 100-vjetorit të Stalinit. S'ka dyshim që ky është një artikull demagogjik. Aty

Stalini cilësohet gjoja si një figurë e shquar e Partisë Komuniste, e shtetit sovjetik dhe e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Siç po duket brenda në Bashkimin Sovjetik, në popull dhe në parti ka reaksion, se, natyrisht, atje ka njerëz që nuk pajtohen me tezat e Kongresit të 20-të dhe me tradhtinë që iu bë Stalinit e tok me të Leninit dhe ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

«Pravda» thotë se «Stalini është një figurë historike shumë komplekse dhe kontradiktore» dhe shton se «Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik e ka trajtuar gjerësisht veprimtarinë e Stalinit në rezolutat e kongreseve të saj si dhe në vendimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të 30 qershorit të vitit 1956 «Mbi eliminimin e kultit të individit dhe pasojave të tij»». Me fjalë të tjera udhëheqja tradhtare revizioniste sovjetike nga njëra anë bën demagogji, nga ana tjetër godet figurën e madhe dhe veprën e shquar të Josif Stalinit. Për demagogji «Pravda» thotë se «duke qenë një përkrahës i Vladimir Iliç Leninit, Stalini iu përmbajt vazhdimisht strategjisë dhe taktikës së bolshevikëve në revolucionin e parë rus, rrugës së Partisë për rrëzimin e carizmit dhe demaskoi oportunizmin e menshevikëve. Si një revolucionar i shquar, ai u arrestua dhe u internua më se një herë e mori pjesë aktive në përgatitjen dhe në suksesin e Revolucionit të Madh të Tetorit, në shpartallimin e armiqve të Republikës Sovjetike gjatë viteve të luftës civile e të intervencionit të huaj».

«Stalini, vazhdon «Pravda», mbrojti në mënyrë aktive parimet e marksizëm-leninizmit dhe çështjen e partisë, luftoi me vendosmëri kundër trockistëve, oportunistëve të krahut të djathtë, nacionalistëve borgjezë dhe kundër intrigave të imperializmit. Në këtë luftë politike dhe ideologjike Stalini fitoi autoritet dhe popullaritet të madh». Këto janë lulet false që revizionistët sovjetikë i hedhin Stalinit.

Më poshtë fillon pastaj denigrimi i tij: «Por, veprimtaria e tij, thuhet në artikull, u ekzagjerua shumë. Atij iu rrit mendja nga lavdërimet, gjë që nxori në pah më shumë tiparet negative të karakterit të tij, rreth të cilave Lenini kishte paralajmëruar Partinë» (gjoja në letrën që ka shkruar Krupskaja. Shënimi im). «Më vonë, vazhdon artikulli, ai nisi ta mbivlerësonte veprimtarinë e tij dhe ta quante veten të pagabueshëm. Filloi të kthente në norma disa kufizime brenda në parti dhe në demokracinë sovjetike, të cilat ishin të domosdoshme në situatën e luftës së ashpër kundër armikut të klasës dhe agjentëve të tij, duke e motivuar këtë me tezat e tij të gabuara mbi acarimin e luftës së klasave në kushtet e socializmit». Pra, sipas «Pravdës», mosekzistenca e luftës së klasave në Bashkimin Sovjetik nuk vërtetohet vetëm tani. Lufta e klasave nuk ka ekzistuar as pas Luftës së Dytë Botërore, kur jetonte Stalini, prandaj ai bëri gabim në këtë drejtim dhe «pati shkelje të rënda të ligjshmërisë sovjetike dhe raprezalje në masë».

Dhe kështu do të vazhdojnë ta denigrojnë në të gjitha drejtimet Josif Stalinin renegatët e Moskës për të vënë në dukje se e ashtuquajtura parti komuniste e tyre, pavarësisht nga «kulti i personit të Stalinit», dhe pa u cenuar nga veprimtaria e tij e keqe, paska ecur përpara në rrugën drejt socializmit e komunizmit. Me fjalë të tjera kërkojnë të nxjerrin në pah se hrushovianët, me Hrushovin në krye, kanë qenë në rrugë të drejtë kur e dënuan Stalinin, dhe aktualisht, me Brezhnjevin, janë gjithashtu në rrugë të drejtë, domethënë në atë rrugë me të cilën i kanë vënë kazmën socializmit e komunizmit në Bashkimin Sovjetik dhe ndërtojnë kapitalizmin.

Revizionistët e vendeve të tjera të ish-demokracisë popullore nuk e përmendin fare 100-vjetorin e lindjes së Stalinit, bile as për demagogji. Natyrisht, ata kanë frikë ta bëjnë një gjë të tillë, se nuk kanë sy e faqe, mbasi e

dinë që vendet e tyre janë shndërruar në vende kapitaliste. Kurse gazeta «Zhenminzhibao» vetëm sa njofton për 100-vjetorin e datëlindjes së Stalinit. Me këtë rast, në Kinë u vunë në qarkullim dy pulla dhe asgjë tjetër. Mbrëmë «Zhenminzhibaoja» dha një korrespondencë të vogël gjoja nga Gori, ku tregonte, as më shumë e as më pak se atje na qenka një shtëpi e vogël me dy dhoma, në një prej të cilave rrinte familja Xhugashvili dhe në tjetrën jetonte i zoti i shtëpisë. «Dhoma e Josif Stalinit, shkruhej në këtë korrespondencë, ishte jashtëzakonisht e thjeshtë, nuk kishte veçse një tavolinë, një fron, një krevat të vjetër edhe një llampë me vajguri».

Por s'ka gjë, lufta dhe jeta do të bëjnë punën e vet, emri dhe vepra e Stalinit nuk do të vdesin. Në shekuj, komunistët dhe revolucionarët jo vetëm do ta kujtojnë atë për luftën e tij, për udhëheqjen e tij të qartë dhe vendimtare, për triumfin e revolucionit dhe të socializmit, por do të mbështeten në mësimet e tij, do të ndërtojnë edhe ata partitë e tyre të tipit leninist dhe do ta udhëheqin popullin në revolucionin demokratiko-borgjez dhe në revolucionin socialist proletar.

Në shtypin borgjez deri tani nuk kam lexuar dhe nuk po dëgjohet të flitet për 100-vjetorin e kësaj figure të madhe, të udhëheqësit të lavdishëm të popujve sovjetikë dhe të Ushtrisë së Kuqe, e cila me të në krye dërrmoi hitlerizmin. Ka mundësi që të ketë disa artikuj për Stalinin, natyrisht negativë, por deri tani nuk kam lexuar asnjë të tillë.

Kurse partitë komuniste motra, marksiste-leniniste, kudo ku jetojnë dhe militojnë, e kanë festuar 100-vjetorin e lindjes së Stalinit të madh, duke organizuar aktivitete, si konferenca, ku janë mbajtur fjalime dhe kanë shkruar artikuj në organet e tyre qendrore.

Sonte korrespondenti i rubrikës «Tam-Tam» të televizionit italian, dha nga Bashkimi Sovjetik disa inter-

vista në rrugët e Tbilisit e të Moskës. Në të gjitha përgjigjet që i jepnin njerëzit e popullit këtij korrespondenti shpreheshin dashuria, dhembshuria dhe respekti për Stalinin e madh; dukej qartë se ata përgjëroheshin për të. Kjo është një karakteristikë me rëndësi të madhe që tregon se populli sovjetik nuk e ka harruar Stalinin dhe nuk i pranon vendimet e poshtra që janë marrë nga hrushovianët kundër tij. Kjo sigurisht ka bërë që «Pravda», siç e theksova më sipër, të shkruante atë artikullin eklektik, më shumë demagogjik, për të gënjyer popullin, sesa për të thënë të vërtetën. Të vërtetën e tha populli sovjetik, e cila iu bë e njohur botës nëpërmjet një emisioni të televizionit italian.

E ENJTE
27 DHJETOR 1979

LARG DUART NGA IRANI!

(Teza për artikull)

Ramizit i dhashë tezat për të shkruar një artikull tjetër mbi Iranin. Ky artikull, që është i treti ose i katërti që po shkruajmë për ngjarjet në këtë vend, duhet të ketë për objekt mbrojtjen e Iranit nga kërcënimet amerikane. Me fjalë të tjera, në këtë artikull me titull: «Larg duart nga Irani!»[1], ne duhet të shprehim mendimin tonë.

Për përmbajtjen e artikullit duhet të marrim shkas nga deklaratat e Karterit dhe nga veprimet e imperializmit amerikan, që ka vendosur të vërë bllokadën e plotë ekonomike kundër Iranit. Tani ai ka bllokuar në bankat amerikane dhe në filialet e tyre pasuritë e Iranit, qofshin ato të shtetit iranian, qofshin miliardat e grabitura nga shahu. Pra, imperializmi amerikan kërcënon Iranin në fillim me luftë të ftohtë për ta kthyer atë më vonë në luftë të nxehtë. Kuptohet pse e bën këtë imperializmi amerikan, sepse ai po merr grushte të rënda nga populli i Iranit dhe po pëson disfata në çdo ndërmarrje të tij. Disfata të tjera do të pësojë imperializmi amerikan në qoftë se nuk heq dorë nga kërcënimet dhe lufta grabitqare. Por imperializmi

1 Botuar në «Zëri i popullit» më 30 dhjetor 1979.

amerikan s'ka se si të mos e mbrojë «perandorinë» e vet. Kjo do të thotë që ai të vazhdojë të përpiqet që të mbajë nën zap Iranin, domethënë naftën e këtij vendi. Pra, mbron grabitjet në kurriz të popullit iranian, mbron xhelatin e popullit iranian, shahun Pahlevi, i cili është agjent i tij dhe njëkohësisht vrasës gjakatar i popullit të vet.

Përballë imperializmit amerikan është ngritur populli iranian, i cili po bën një luftë të drejtë, të pamëshirshme kundër tij. Pra lufta e popullit iranian është në rrugë të drejtë dhe duhet të mbështetet, kurse lufta që po përgatit imperializmi amerikan është një luftë grabitqare dhe duhet të dënohet. Këto që theksova duhet t'i shërbejnë si sfond artikullit, kurse rreth këtij sfondi duhet të vëmë në dukje se imperializmin amerikan në veprimtaritë e tij e mbështetin kush më shumë e kush më pak, kush hapur e kush fshehtazi, gjithë imperialistët e tjerë dhe vendet kapitaliste perëndimore, po ashtu satelitët e tyre si Titoja e Ten Hsiao Pini me shokë pastaj, drejtpërdrejt ose tërthorazi, e mbështet edhe Bashkimi Sovjetik.

Por në fakt, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po luftojnë për të ndarë sferat e influencës në këtë rajon. Deri tani Irani ka qenë nën sferën e amerikanëve, kurse në këto koniunktura, socialimperializmi sovjetik përpiqet edhe t'u zërë vendin amerikanëve. Këtë ai e bën edhe me presione të fshehta dhe me kërcënime të hapëta, nga njëra anë, gjoja për të mbrojtur pavarësinë e Iranit dhe, nga ana tjetër, duke parë situatat kërcënuese që krijon imperializmi amerikan grumbullon forca të armatosura në Azerbajxhanin sovjetik, shkakton turbullira me agjenturën e vet brenda në Azerbajxhanin e në Kurdistanin iranian etj.

Mbrëmë Departamenti i Shtetit Amerikan dhe agjencitë e huaja të lajmeve njoftuan se sovjetikët kanë zbarkuar rreth 50 mijë trupa si dhe një numër tankesh në Afganistan dhe kryen një grusht shteti kundër kryeministrit Hafizullah Amin, i cili hiqej si prosovjetik dhe, siç dihet, erdhi në fuqi po me grusht shteti, pasi rrëzoi dhe vrau Tarakin, që edhe ky ishte prosovjetik. Si duket këtu luhet një lodër e dyfishtë, pra edhe nga ana e sovjetikëve, edhe nga ana e amerikanëve. Në llogari të përgjithshme të gjitha këto bëhen në kurriz të Iranit, ku superfuqitë përpiqen të realizojnë synimet e tyre ekspansioniste.

Është e qartë se veprimet grabitqare, të fshehta ose të hapëta, të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik në këtë rajon, presionet mbi Iranin, pushtimi i drejtpërdrejtë i Afganistanit, janë pjesë të komploteve të bashkërenduara imperialiste kundër Iranit, Gjirit Persik dhe synimeve për të shuar kryengritjet në Lindjen e Mesme, domethënë në vendet arabe.

Në këtë artikull ne duhet të theksojmë se lufta e popullit iranian është një luftë çlirimtare, kundër feudalizmit dhe kundër imperializmit, prandaj e mira është që populli iranian të jetë i bashkuar përpara armiqve kryesorë që e kërcënojnë, imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Këtu ne mund të flasim edhe për Khomeinin dhe të themi se me filozofinë e tij idealiste islamike ne nuk jemi dakord, por jemi dakord me qëndrimet e tij politike, me luftën e tij antiimperialiste, antiamerikane dhe e mbështetim atë në këtë luftë.

Pastaj duhet të themi që më vonë, pasi të konsolidohet pavarësia e Iranit dhe të shtyhet rreziku që e kërcënon atë nga imperializmi amerikan e nga socialimperializmi sovjetik, populli iranian duhet të luftojë për të drejtat demokratike, për tokën, për bukën, për lirinë e tij.

Ne duhet të theksojmë se veprimet e amerikanëve do të sjellin turbullira të rrezikshme, të cilat mund të çojnë në luftë botërore. Ajatollah Khomeini deklaroi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë të bllokojnë Iranin, gjë që do të thotë luftë e armatosur në mes tyre dhe se kjo luftë do të kthehet në një luftë të përgjakshme botërore. Imam Khomeini ka të drejtë, sepse, në qoftë se imperializmi amerikan sulmon Iranin, duhet të marrë parasysh që gjithë Lindja e Mesme, gjithë pellgu i naftës, do të marrë zjarr dhe në këtë luftë popujt e këtyre vendeve nuk mund të mos e mbrojnë popullin iranian që është i një besimi me ta, pavarësisht nga kontradiktat midis tyre që mund të kenë qeveritë e vendeve të këtij rajoni. Pra, në Lindjen e Mesme, një luftë në mes amerikanëve dhe iranianëve do ta prishë koniunkturën aktuale të lëkundshme të ndërtuar me intriga dhe në konflikt do të futen Bashkimi Sovjetik, Anglia, Franca e vende të tjera.

Kështu Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në rast lufte, do të kenë përballë jo vetëm popullin e Iranit, por edhe popujt e tjerë të Gjirit Persik, popujt e Lindjes së Mesme në përgjithësi. Nga ana tjetër veprimet luftarake të amerikanëve ose bllokadat e tyre do të gjejnë medoemos kundërshtim nga vetë partnerët e aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga Japonia, Anglia, Franca, Italia, Gjermania Perëndimore, të cilët do të dëmtohen ekonomikisht, pse do t'u priten burimet e naftës. Këto vende nuk mund të rrojnë pa naftën, pa të ata nuk mund të bëjnë dot luftë. As Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të vazhdojnë gjatë luftën pa naftën e Lindjes së Mesme. Në rast se Shtetet e Bashkuara luftën e ftohtë kundër Iranit e kthejnë në luftë të nxehtë, do ta humbasin naftën.

Ne duhet të theksojmë se imperializmi amerikan dhe imperialistët e tjerë kanë në Iran agjenturat e tyre të

vjetra, të cilat do të veprojnë kundër kryengritjes popullore antiimperialiste të Iranit, kundër studentëve, që janë në pararojë. Prandaj populli iranian, klasa punëtore, studentët dhe fshatarësia, duhet të jenë vigjilentë dhe të qëndrojnë të bashkuar në bllok, kundër armikut, të jashtëm e të brendshëm, që manovron me një mijë mënyra, të hapëta ose të fshehta, në formë lëvizjesh pseudodemokratike ose në formë komplotesh.

Të gjitha këto komplote dhe lëvizje pseudodemokratike janë të lidhura me imperialistët e jashtëm, të cilët duan të kthejnë në Iran regjimin e vjetër, vegël të tyre, agjentin e vjetër shahun, ose njerëzit e tij, që t'u shërbejnë më mirë dhe t'u sigurojnë naftën e Iranit.

Ne duhet të theksojmë se robërit e ambasadës amerikane, të ashtuquajtur diplomatë, nuk janë veçse një agjenturë. Aktualisht diplomacia amerikane, diplomacia sovjetike dhe ajo e mjaft shteteve të tjera, nuk ka më karakterin e vërtetë të një diplomacie dhe nuk zbaton ato parime që shprehen kur ambasadorë të këtyre vendeve paraqesin letrat kredenciale përpara shtetit ku janë akreditуar; në fakt të gjithë këta janë agjentë të CIA-s, FBI-së, të KGB-së etj. dhe në këto vende ku janë akreditуar, organizojnë rrjetat e spiunazhit dhe të komplotuesve kundër lirisë, demokracisë e pavarësisë së popujve të atyre vendeve.

Pra, të tillë janë diplomatët amerikanë, që mbështetin shahun dhe njerëzit e tij për të fituar pasuritë përrallore të Iranit.

Ajatollah Khomeini, studentët dhe populli iranian, kanë pasur dhe kanë të drejtë që këta njerëz t'ia kalojnë gjyqit për të dhënë llogari mbi veprimtarinë diversioniste që kanë zhvilluar në bashkëpunim me shahun e Iranit.

Këtë veprim të drejtë të popullit iranian bota borgjeze e quan si një shkelje të normave ndërkombëtare që rregullojnë statusin e diplomatëve dhe marrëdhëniet di-

plomatike, por harron të thotë se këta diplomatë, qysh përpara i kanë shkelur rregullat e normat në fjalë në kurriz të popullit iranian. Edhe papa, një nga kapitalistët më të mëdhenj të botës, nga penxherja e Vatikanit, e këtij institucioni që ka hedhur rrjetën e merimangës së zezë në të gjithë botën, kërcënoi Iranin «duke iu lutur» Khomeinit që të lirojë pengjet. Por papës së Vatikanit nuk iu ndie zëri atëherë kur amerikanët nëpërmjet CIA-s e ambasadorit Henderson kaluan me tanke mbi popullin e Teheranit që rrëzoi shahun në kohën e Mosadekut.

Sigurisht papa polak Vojtiva është në akord të plotë me polakun amerikan Brzezhinski, shefin e këshillit të sigurimit kombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe arkitektin kryesor të përgatitjes së luftës së ftohtë dhe të luftës së nxehtë kundër Iranit.

Por populli i Iranit, studentët dhe Ajatollah Khomeini, siç po shohim, mbajnë një qëndrim burrëror dhe të drejtë jo vetëm kundër agresorëve imperialistë amerikanë, por kundër të gjithë lakenjve të tyre, të cilët kush me petkun e kishës, kush me petkun e diplomatit dhe me «letra e rekomandime» të presidentëve të shteteve të tyre, venë në Iran për t'i bërë presion, në formën e këshillave ose të lutjeve, Ajatollah Khomeinit që të lirojë pengjet, pse gjoja po shkel të drejtat diplomatike të vendosura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara ose nga traditat e diplomacisë. Por duhet kuptuar dhe është e qartë se të gjithë këta nuk e kanë parasysh asnjë grimë interesin e madh të popullit të Iranit e të të gjithë popujve të tjerë të shtypur nga imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe kapitalizmi botëror, por kanë interesat e veta, interesat e klikave të tyre që janë të bashkuara me këta imperialistë në luftë me popullin e Iranit dhe me popujt e tjerë.

Të gjithë këta, të cilët kërkojnë që Irani të marrë vendime të padrejta për interesat e veta kombëtare e të

favorshme për amerikanët, fshihen nën maskën e «miqësisë» me Iranin, nën maskën gjoja të demokracisë dhe të mirësjelljes. Por nuk ka mirësjellje ndaj armiqve të popujve, nuk mund të ketë drejtësi në qëndrimet diplomatike, kur këto shkelen nga të tjerët, nga më të mëdhenjtë, ose qoftë edhe nga të vegjlit e djallëzuar. Dhëmb për dhëmb duhet të zhvillohet lufta kundër imperializmit, veglave e veprimeve të tij.

E HENË
31 DHJETOR 1979

VITI 1979 MBYLLET ME SITUATA REVOLUCIONARE

Viti 1979 në arenën ndërkombëtare po mbyllet me situata revolucionare, që janë rezultat i kryengritjeve popullore kundër zgjedhës së imperializmit dhe të kapitalizmit botëror. Veçanërisht javën e fundit një ngjarje me rëndësi ndodhi në një vend të Azisë, në Afganistan, ku u krye një grusht shteti që rrëzoi regjimin prosovjetik të Aminit, i cili kishte zëvendësuar po me grusht shteti ish-regjimin përsëri prosovjetik të Nur Tarakit. Tash prosovjetiku Amin u zëvendësua me prosovjetikun Karmel. Të tria qeveritë kanë qenë e janë agjentura të sovjetikëve e njëkohësisht edhe agjentura të fshehta të amerikanëve.

Fakt është se sovjetikët, duke ndërhyrë ushtarakisht, vranë të parin, vranë të dytin dhe sollën tjetrin, të tretin, nga Çekosllovakia, ku ishte ambasador, duke e vënë në krye të pushtetit.

Flitet se dy-tri divizione sovjetike, me tanke e me avionë, kanë ndërhyrë në Afganistan ashtu siç ndërhynë edhe në Çekosllovaki më 1968. Tani ata bëjnë ligjin në këtë vend nën pretekstin se Amini ishte tradhtar dhe agjent i imperializmit amerikan, gjë që edhe mund të ketë qenë kështu, gjithashtu thonë se ata kanë ndërhyrë në bazë të traktatit të bashkëpunimit e të miqësisë që kanë nënshkruar me Afganistanin.

Siç dihet, në Afganistan ka lëvizje të shumta kryengritjeje, të udhëhequra nga patriotë që nuk e dëshirojnë as zgjedhën sovjetike, as zgjedhën e agjentëve të saj, por ata cilësohen si myslimanë dhe lëvizja e tyre patriotike antiimperialiste cilësohet si lëvizje islamike. Kjo është një parullë e përbashkët që përdor kapitalizmi botëror për të ringjallur mëritë dhe luftën fetare, për t'u dhënë lëvizjeve çlirimtare kuptimin mesjetar të luftërave të tilla. Nuk ka dyshim se luftëtarët çlirimtarë afganë, të ngritur kundër zgjedhës së imperializmit, socialimperializmit e monarkisë, janë elementë që besojnë. Afganistani është një nga ato vende ku feja është akoma e gjallë dhe vepruese. Por nuk është vetëm feja ajo që i bën këta popuj të ngrihen me armë në dorë kundër pushtuesve të atdheut të tyre. Natyrisht, marksistë ata nuk janë, por janë patriotë që duan çlirimin e atdheut të tyre, janë përfaqësues të borgjezisë demokrate. Ata nuk dëshirojnë të rrojnë nën zgjedhën e të huajve, pavarësisht se pikëpamjet e tyre janë akoma larg atyre pikëpamjeve demokratiko-borgjeze revolucionare që të shprehen në reforma të thella në interes të popujve të tyre.

Por lufta që ata po zhvillojnë ka një rëndësi të madhe jo vetëm për Afganistanin, por edhe për popujt e tjerë. Është e qartë se Bashkimi Sovjetik, me ndërhyrjen e tij në Afganistan, realizon planet strategjike imperialiste për të pasur pozita kyçe luftarake në këto vende, veçanërisht për të zgjeruar sundimin e tij imperialist në zemër të Azisë dhe të Lindjes së Mesme. Dihet se Afganistani është vend kufitar me Kinën dhe me Pakistanin, pra Bashkimi Sovjetik dëshiron të forcojë pozitat e tij luftarako-strategjike përballë Kinës dhe Pakistanit proamerikan ose proanglez. Nga ana tjetër, dihet se Afganistani është në kufi me Iranin, bile kryengritësit afganë hiqen si miq, dashamirës e bashkëluftëtarë të Khomeinit. Pra është e favorshme për Khomeinin, në rast se krye-

ngritësit afganë fitojnë mbi sovjetikët dhe mbi veglat e tyre. Kjo, natyrisht, nuk është një punë e lehtë, as një punë që mund të kryhet me sot, me nesër, por sidoqoftë populli i Afganistanit, që është vëlla në fe me shiitët iranianë, u sjell kokëçarje imperialistëve e socialimperialistëve.

Sovjetikët, me ndërhyrjen e tyre ushtarake në Afganistan, po e rrethojnë Iranin nga jugu e nga veriu dhe, në rast se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ndërhyjnë me forca të armatosura në Iran, atëherë edhe Bashkimi Sovjetik do të fillojë veprimet e tij në këtë drejtim, natyrisht për të kapur një pjesë të Iranit, por ende jo, mendoj unë, për t'u ballafaquar në një luftë të armatosur me imperializmin amerikan.

Sovjetikët, pra, përgatiten për një luftë eventuale që mund të zhvillohet në pellgun e madh të naftës në Lindjen e Mesme. Siria, ku influenca sovjetike është më e dukshme, nuk e ka dënuar ende ndërhyrjen sovjetike në Afganistan, por vendet e tjera arabe, duke përfshirë edhe Arabinë Saudite dhe Egjiptin, e dënuan këtë agresion. Pra, të gjitha këto vende u shprehën kundër sovjetikëve për veprimet barbare dhe qëllimet sunduese mbi Afganistanin. Prandaj në këto situata vendet arabe s'ka se si të pranojnë një ndërhyrje të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me forca të armatosura në Iran.

Kështu gjithë opinioni botëror është ngritur kundër veprimeve sovjetike dhe, sikurse njoftojnë agjencitë e huaja të lajmeve, Moska është detyruar të deklarojë se do t'i tërheqë trupat e saj menjëherë nga Afganistani, pasi të stabilizohet situata. Ky është një avaz i njohur që e përdorin vazhdimisht imperialistët, pasi ndërhyjnë ushtarakisht, duke pushtuar vende dhe popuj. Por reagimi i opinionit botëror kundër ndërhyrjes sovjetike e bën më të pamundur ose më të zorshme ndërhyrjen e amerikanëve në Iran. Me fjalë të tjera, bota po e shikon

se imperialistët dhe socialimperialistët janë agresorë, janë shtypës të popujve dhe shfrytëzues të pasurive të tyre.

Natyrisht, për ndarjen e zonave të influencës midis tyre, të dyja superfuqitë bëjnë marrëveshje të fshehta, por kjo ndarje zonash krijon edhe kundërshtime të mëdha, një reaksion të ashpër luftarak e revolucionar nga ana e masave të popujve, mbi kurrizin e të cilëve bien pasojat e këtyre marrëveshjeve; kjo gjendje i nxit popujt e tjerë të ngrenë krye kundër shtypjes së jashtme e të brendshme të kapitalizmit vendas dhe të atij botëror.

1980

NGJARJET QË PO ZHVILLOHEN NË VENDET MYSLIMANE DUHET TË SHIKOHEN NË DRITËN E MATERIALIZMIT DIALEKTIK E HISTORIK

Aktualisht gjendja ndërkombëtare paraqitet mjaft e nderë. Në shumë rajone të botës, e kryesisht në pellgun e madh të vendeve naftëmbajtëse, sidomos të Azisë, lufta midis dy superfuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, pa përjashtuar Kinën imperialiste dhe fuqitë e tjera kapitaliste për ndarjen e rindarjen e tregjeve e të zonave të influencës, për t'i futur bërrylet njëri-tjetrit, ashtu siç është parashikuar me të drejtë prej kohësh nga Partia jonë, ka arritur përmasa të reja e të mëdha. Presionet e komplotet e tyre shoqërohen me përpjekjet dhe zhurmën diplomatike e propagandistike për «ujdira e kompromise» gjoja për të ruajtur paqen dhe ekuilibrin e forcave. Në fakt, siç po tregojnë ngjarjet e kohëve të fundit, pavarësisht nga acarimi i madh i rivalitetit, ne shohim se ujdia dhe kompromisi janë ende parimi bazë i politikës së tyre ndaj njëri-tjetrit. Por një ditë rivaliteti midis tyre do të arrijë në një pikë, të cilën nuk do të mund ta zgjidhin e ta kapërcejnë dot më, veçse me konfrontim luftarak. Pasojat e një konfrontimi të tillë, sikurse ka ndodhur edhe në luftërat e mëparshme imperialiste, do të bien mbi popujt.

Rezultati më i freskët i këtij rivaliteti është agresioni ushtarak i socialimperialistëve sovjetikë kundër Afga-

nistanit, është pushtimi me forcën e armëve i këtij vendi nga njëra prej superfuqive imperialiste. Është fakt se ajo çka u bë tash në mënyrë të hapët e me forca të armatosura nga sovjetikët kundër sovranitetit të popullit afgan, është gatuar prej kohësh nga politikanët e ushtarakët shovinistë socialimperialistë sovjetikë dhe agjentët e tyre afganë. Si të parët, ashtu edhe të dytët, për të arritur aty ku arritën sot, shfrytëzuan rrëzimin, në fillim të mbretit Mohamed Zaher Shah në vitin 1973 dhe, më vonë, më 1978, përmbysjen e princit Daut. Për qëllimet e tyre të këqija, ata shfrytëzuan edhe dëshirën për çlirim shoqëror të popullit afgan, i cili e ndiente shtypjen e monarkisë absolute dhe të miqve të saj të huaj, në radhë të parë të sovjetikëve, që e financonin dhe e mbanin atë në fuqi. Pra, socialimperialistët sovjetikë, me gjithë «aleancën» që kishin me mbretin e Afganistanit, punuan dhe vepruan për rrëzimin e tij. Për të maskuar qëllimet e veta imperialiste, në fillim sollën në fuqi njerëzit e tyre gjoja me ndjenja më përparimtare. Pastaj si rezultat i orvatjeve për influencë në Afganistan të socialimperializmit sovjetik dhe të imperializmit amerikan edhe këta u ndërruan njëri pas tjetrit me veprime gjakderdhëse, me puçe e me tanke, u çuan në satër, siç ndodhi me Nur Muhamed Tarakin dhe me Hafizullah Aminin.

Por asnjë pushtues i huaj, sado i fuqishëm e i armatosur të jetë, nuk mund ta mposhtë përgjithmonë popullin kundër të cilit ka bërë agresion. Pushtuesit e huaj, përveç klikave agjenturore, antikombëtare e antipopullore, kudo që janë futur janë pritur e priten nga popujt me urrejtje e rezistencë në fillim sporadike, pastaj me revolta më të organizuara që dalngadalë kthehen në kryengritje popullore, në luftëra çlirimtare. Këtë ne po e shohim të vërtetohet edhe në Afganistan, populli i të cilit është ngritur në këmbë e po lufton me ashpërsi në qytete, në fshatra e në male kundër ushtrive pushtuese sovjetike. Kjo luftë e popullit afgan gëzon përkrahjen dhe simpatinë e

popujve liridashës e të forcave revolucionare të mbarë botës. Atë e mbështet me të gjitha forcat edhe populli ynë. Lufta e popullit afgan kundër socialimperialistëve sovjetikë është një luftë e drejtë, prandaj ajo do të triumfojë.

Lufta aktuale e popullit afgan kundër agresionit ushtarak sovjetik si dhe revolta popullore antiimperialiste, antiamerikane e antifeudale e popullit iranian duhet të na bëjnë të mendojmë një çikë më shumë e më thellë, nga ana politike, teorike dhe ideologjike edhe për një problem tjetër të madh, që në situatat aktuale e në këtë zhvillim të ndërlikuar botëror po del gjithnjë e më shumë në pah: për kryengritjet popullore me «frymëzim islamik», siç duan t'i përcaktojnë këto lëvizje borgjezia dhe revizionistët vetëm sepse në pararojë të lëvizjes çlirimtare janë vënë popujt myslimanë të vendeve arabe dhe të vendeve të tjera. Ky është një fakt, një realitet objektiv, në këto vende ka lëvizje kryengritëse. Në qoftë se këto lëvizje e kryengritje të popujve myslimanë do t'i shohim e do t'i gjykojmë në mënyrë shumë sempliste, të sipërfaqshme, si lëvizje me karakter thjesht islamik, pa u thelluar në arsyet e vërteta që i shtyjnë përpara masat e gjera të popujve, mund të biem në pozitat e revizionistëve dhe të imperialistëve, vlerësimet e të cilëve ndaj këtyre lëvizjeve janë denigruese dhe fshehin synime skllavëruese ndaj popujve.

Ne, marksistë-leninistët, e kemi gjithnjë të qartë se feja është opium për popujt. Në asnjë rast nuk e ndërrojmë pikëpamjen tonë lidhur me të dhe nuk duhet të biem në gabimet e «socializmit fetar» etj. Edhe feja myslimane është e tillë. Megjithatë aktualisht shohim se masat e gjera të popujve myslimanë, në vendet arabe e në vende të tjera, janë ngritur e po ngrihen në luftë kundër imperializmit e neokolonializmit për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror. Këta popuj, që jo pa qëllim ishin

lënë në errësirë në të kaluarën, dhe gjenden akoma sot prapa në botëkuptimet e tyre, tani po i ndiejnë shtypjen e madhe dhe shfrytëzimin e egër që u kanë bërë kolonizatorët e vjetër, që vazhdojnë t'u bëjnë edhe kolonizatorët e rinj e klikat feudo-borgjeze kapitaliste të brendshme. Ata po i kuptojnë arsyet politiko-ekonomike të shtypjes, dhe, pavarësisht se janë myslimanë e të prapambetur, janë duke treguar një vitalitet të madh dhe po japin një kontribut të rëndësishëm në revolucionin demokratiko-borgjez antiimperialist që i hap rrugën atij proletar. Janë regjimet shtypëse antipopullore dhe klerikët reaksionarë ata që kanë adoptuar dhe kanë përdorur fenë myslimane për të ushtruar shtypjen shoqërore mbi këta popuj dhe për t'i shfrytëzuar ata në mënyrë më të egër. Pushtetin e tyre gjakatar ata e kanë ruajtur dhe e ruajnë nëpërmjet armëve dhe përkrahjes që kanë marrë nga jashtë, domethënë nga fuqitë imperialiste e neokolonialiste grabitqare, si edhe duke nxitur e duke zhvilluar fanatizmin fetar. Kështu zhvillimi i ngjarjeve po vërteton gjithnjë e më shumë tezën marksiste-leniniste se armiqtë e brendshëm bashkëpunojnë ngushtë me armiqtë e jashtëm për të shtypur popujt e vet dhe se feja përdoret nga ana e tyre si armë për të mbajtur në errësirë dhe për të shtypur popujt.

Ngjarjet që po jetojmë tregojnë qartë se popujt arabë myslimanë janë luftëtarë. Kryengritjet e luftërat e tyre antiimperialiste, antikolonialiste dhe antifeudale shoqërohen dhe përfundojnë me përleshje të armatosura. Këto luftëra e kryengritje e kanë burimin e tyre në shtypjen e egër që ushtrohet mbi këta popuj, në ndjenjat e tyre liridashëse e përparimtare. Po të mos jesh përparimtar e liridashës, nuk mund të ngrihesh në luftë për liri e pavarësi kombëtare, kundër shtypjes së dyfishtë, të brendshme dhe të jashtme.

Një shkak tjetër shoqëror e nxitës i fortë për kryengritje antiimperialiste, antikolonialiste e antifeudale është gjendja e rëndë ekonomike e këtyre popujve, uria dhe vuajtjet që rëndojnë mbi ta. Pra nuk mund të mos marrim në konsideratë zgjimin politik, por deri diku edhe atë shoqëror të tyre.

Duke i hedhur një vështrim luftës së popujve me besim mysliman vëmë re se në zhvillimin e saj ka ndryshime të theksuara, ka ngjitje, por ka edhe rënie ose qëndrim në vend, ka amulli që krijohet nga faktorë të ndryshëm e sidomos nga borgjezia pseudoprogresiste që ndodhet ose vihet në krye të këtyre popujve.

Kështu, për shembull, në Marok ka pasur njëfarë lëvizjeje, por lëvizja antifeudale dhe antiimperialiste e popullit të këtij vendi nuk është në lartësinë e vendeve të tjera, përkundrazi monarkia dhe feudalizmi dominojnë mbi këtë popull me dhunë, me pseudoreforma liberale, por duke përdorur edhe ndjenjat fetare.

Në Algjeri populli bëri luftën nacionalçlirimtare kundër kolonizatorëve francezë dhe, megjithëse nuk udhëhiqej nga një parti marksiste-leniniste, por nga borgjezia nacionale, lufta për çlirimin kombëtar përfundoi me largimin e pushtuesve të huaj, por ajo nuk u çua më tej. Kjo ndodhi sepse borgjezia e re liberale që erdhi në fuqi, edhe pse populli algjerian bëri një luftë të madhe dhe të përgjakshme, pengoi evolucionin përparimtar të vendit, reformat ekonomiko-shoqërore qenë të pjesshme, nuk u çuan përpara dhe vendi ra në amulli politiko-ekonomike në disfavor të masave punonjëse.

Në Tunizi populli është i përgjumur dhe paraqitet shumë apatik, nuk po shihet që të zgjohet, sido që nuk është dhe aq i prapambetur. Kohët e fundit u fol atje për një lëvizje sindikaliste, u arrestua edhe sekretari i përgjithshëm i sindikatave, po asgjë më shumë nuk ndodhi më tej.

Në Egjipt, në vitin 1952, ndodhi gjithashtu një re-

voltë. Rrëzimi i monarkisë u bë pa gjakderdhje. Mbreti Faruk u dëbua nga Egjipti nga një grup oficerësh. Ata që e shfronësuan e shoqëruan deri në Aleksandri, i dhanë para, e hipën në vapor dhe e ndihmuan që të ikte e të shpëtonte. Me një fjalë i thanë monarkut të largohej më mirë vetë dhe të shpëtonte lëkurën, se në vend nuk mund të qëndronte më, atje s'kishte më rrënjë. Kështu grupi i oficerëve, me Naserin, Nagibin e Sadatin në krye, bënë si me thënë një *«colpo di stato»* ushtarak pa gjak kundër një monarkie krejtësisht të degjeneruar dhe morën në dorë fuqinë. Ç'ishte e ç'përfaqësonte grupi i oficerëve puçistë egjiptianë? Këta oficerë ishin njerëzit e borgjezisë, përfaqësuesit e saj, ishin antianglezë, por midis tyre kishte edhe prohitlerianë. Njëri nga këta, që ka bashkëpunuar me «ujkun e shkretëtirës», mareshalin nazist Romel, siç e deklaron vetë, bile për këtë edhe mburret, është Anuar el Sadati, presidenti i tanishëm i Egjiptit. Kjo ngjarje, domethënë dëbimi i Farukut nga froni, u pompua jashtëzakonisht shumë derisa u quajt «revolucion». Por nga gjithë kjo populli egjiptian, masat punonjëse të këtij vendi, nuk patën asnjë përfitim. Pothuajse asnjë lloj reforme nuk u bë në të mirën e popullit. Edhe njëfarë reforme agrare që filloi, përfundoi në favor të feudalëve e të pronarëve të pasur të tokave. Pra iku një mbret, erdhi një mbret tjetër në formë të re. Të riardhurit në fuqi, nën maskën e unitetit të popujve arabë, u përpoqën të bënin edhe «bashkimin» e Egjiptit me Sirinë. Po çdo përpjekje në këtë drejtim ishte e kotë, sepse edhe në Siri, në këto kohëra, borgjezia kapitaliste në udhëheqjen e shtetit kishte ndërruar vetëm kuajt dhe padronin. Bashkimi Sovjetik imperialist kishte zëvendësuar atje Francën. Ai e sabotoi këtë «bashkim» pa baza dhe nguli thonjtë në këtë vend.

Edhe në Libi, siç dihet, në vitin 1969 pati një revoltë; u rrëzua dinastia e mbretit Idriz dhe në fuqi erdhi një

grup oficerësh të rinj, me Kadafin në krye, i cili hiqet si antiimperialist. Këtë revoltë, këtë lëvizje, në fillim ne mund ta cilësojmë si përparimtare, por më vonë kjo lëvizje u topit dhe aktualisht ka rënë në amulli. Kadafi që erdhi në fuqi, i cili e mban veten si kryetar i islamizmit, e shfrytëzoi fenë myslimane për ta paraqitur Libinë si një vend «përparimtar», bile e quajti edhe «socialist», por, në realitet, kjo klikë ka arritur deri atje sa ndjenjat liridashëse e antifeudale të popullit t'i përdorë për të shtypur vetë popullin libian dhe për të shfrytëzuar pasurinë e madhe të vendit, naftën, për qëllimet e veta të mbrapshta, aventureske e shumë të dyshimta. Natyrisht, për demagogji dhe për arsye se të ardhurat që sigurohen nga shitja e naftës janë me të vërtetë të mëdha, kjo klikë e ka përmirësuar pak jetën e popullit në qytete, por nomadizmi në shkretëtirë vazhdon të qëndrojë një plagë shoqërore. Kadafi, siç e dimë, ka qenë një nxënës i Naserit si në politikë, në ideologji e në bindjet fetare, ashtu edhe në synimet hegjemoniste panarabe.

Në kryeqytetin e Irakut, në Bagdad, ndodhi më 1958 një kryengritje diçka më e avancuar, më revolucionare, kundër monarkisë, që përfundoi me vrasjen e mbretit Faisal dhe të kryeministrit Nuri Said. Fuqinë atje e morën «komunistët» tok me gjeneral Kasemin, përfaqësues i oficerëve liberalë. Por 4 vjet më vonë, më 1962, atje ndodhi një grusht shteti dhe Kasemi u ekzekutua. Në vend të tij erdhi në fuqi një oficer tjetër, koloneli Aref. Në vitin 1968 doli në krye gjenerali Al Bakr dhe përsëri në fuqi erdhi partia Baath, një parti e borgjezisë reaksionare, feudale, kompradore dhe në aleancë me imperialistë të ndryshëm.

Ngjarjet që po ndodhin në Iran e në Afganistan përbëjnë një shembull pozitiv për popujt e shteteve fqinje, për Pakistanin, Arabinë Saudite, për Irakun, për Emiratet e Gjirit Persik, për Sirinë, Egjiptin e shumë të tjerë,

por ato përbëjnë një rrezik të madh edhe për klikat sunduese të këtyre vendeve. Pra gjithë bota arabe është në lëvizje, në evolucion.

Jehona e kësaj lëvizjeje antiimperialiste që po e trondit imperializmin në bazat e tij ekonomike dhe në synimet për hegjemoni botërore, shtrihet deri në Indonezi, por atje lëvizja është më e dobët sesa në vendet e Azisë Qendrore, të Lindjes së Afërt e të Mesme, apo edhe të Afrikës Veriore, ku islamizmi si fe është më kompakt dhe pasuritë janë më të mëdha. Në këto rajone ka një zgjim progresist të masave, të cilin tani për tani, siç po ndodh në Iran, e udhëheqin, në përgjithësi elementë fetarë që dinë t'i shfrytëzojnë ndjenjat për liri të këtyre popujve, ndjenjat e tyre kundër imperializmit shtypës, kundër krerëve monarkistë e klikave feudale grabitëse, vjedhëse e vrasëse të egra të tyre etj., etj. Prandaj ne duhet t'u bëjmë analizë marksiste-leniniste këtyre situatave. Ne nuk mund të pranojmë e të jemi dakord me zërat që po përhapin propaganda borgjezo-revizioniste, imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror sikur Ajatollah Khomeini, iksi apo ipsiloni në Iran janë njerëz që nuk kuptojnë nga politika ose janë aq të prapambetur sa kanë qenë imam Aliu, imam Hasani e imam Hyseni. Kjo nuk është e vërtetë. Përkundrazi, faktet tregojnë se njerëzit si ai dinë ta shfrytëzojnë si duhet lëvizjen aktuale të këtyre popujve, që në esencë dhe në fakt është një lëvizje progresiste, demokratiko-borgjeze dhe antiimperialiste.

Këto lëvizje, në rrugë e me mjete të ndryshme, po përpiqen t'i mbështetin e t'i bëjnë për vete, për qëllimet e tyre, edhe imperialistët e socialimperialistët e ndryshëm. Mirëpo ato aktualisht janë në disfavorin e tyre, janë kundër tyre. Kjo është aq e vërtetë sa socialimperialistët sovjetikë u detyruan të futnin regjimentet e tyre tankiste dhe dhjetëra mijëra ushtarë sovjetikë në Afganistan, të kryenin me një fjalë një agresion të hapët fashist ndaj një vendi të pavarur, për të vënë e për të mbajtur në fuqi kukullat vendase të tyre, të cilat nuk ishin në gjendje ta ruanin pushtetin pa ndihmën e bajonetave e të tankeve të ushtrisë sovjetike, të forcave të armatosura të Bashkimit Sovjetik.

Kuptohet se kjo ngjarje, ky pushtim i armatosur sovjetik i Afganistanit, do të shkaktonte reagime e shqetësime në opinionin publik ndërkombëtar, do të shkaktonte zemërim të madh e urrejtje te popujt liridashës dhe te forcat përparimtare dhe, nga pikëpamja strategjike, nervozizëm te rivalët e tyre për hegjemoni e sidomos te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në fakt, po vëmë re se këto ditë presidenti amerikan Karter sikur kërkon të lëvizë ca, me sa duket për t'i nxjerrë ndonjë vështirësi Bashkimit Sovjetik dhe të forcojë pozitat e tij që po i dobësohen vazhdimisht, kërkon të marrë masa për të penguar një invadim të mundshëm sovjetik në Pakistan, ose më mirë të them të pengojë shfrytëzimin nga socialimperialistët sovjetikë, për qëllimet e tyre të ndjenjave revolucionare antiimperialiste të popullit mysliman të Pakistanit. Populli pakistanez ushqen simpati për lëvizjen antiimperialiste të fqinjëve të tij iranianë dhe mund të ngjasë edhe atje ajo që po ngjet në Iran. Pikërisht, për t'i dalë përpara këtij eventualiteti, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidenti i tyre Karter i kanë propozuar qeverisë pakistaneze që të dërgojnë në Pakistan 50 mijë ushtarë dhe të shtojnë furnizimet me armatime, gjoja për të përballuar rrezikun sovjetik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dërguan po ashtu në Kinë ministrin e tyre të Mbrojtjes për të konkretizuar dhe për të aktivizuar aleancën kino-amerikane. Gjatë kësaj vizite, të dyja palët shprehën shqetësimin e tyre për zgjerimin e ekspansionit të socialimperialistëve

sovjetikë në këtë rajon dhe lidhur me këtë vendosmërinë e tyre për të mbrojtur interesat imperialiste të veta e të njëri-tjetrit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës i premtuan Kinës armatime moderne nga më të sofistikuarat.

Po a ekziston rreziku sovjetik për Pakistanin? Po, ekziston. Po në Pakistan zemërimi kundër Zia Ul Hakut, i shoqëruar me simpatinë për Khomeinin, mund të shpërthejë edhe pa ndërhyrjen e sovjetikëve. Vetë Zia Ul Haku, për t'i shpëtuar një presioni sovjetik dhe kryengritjes së popullit pakistanez, mund të bashkohet me sovjetikët dhe këta e justifikojnë kështu ndërhyrjen e tyre në këtë vend. Prandaj edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës po aktivizojnë paktet e tyre ushtarake me Pakistanin.

Karteri përpiqet ta ruajë nga ana e tij ekuilibrin, sepse një ndërhyrje e Bashkimit Sovjetik në Pakistan përbën rrezik për imperializmin amerikan në këtë rajon të botës. Karteri ka e duhet të ketë influencë në Pakistan edhe për arsye se ky vend ka një traktat të mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç kësaj Karteri, në situatat e reja që janë krijuar këto kohë në Azinë Qendrore, sheh edhe rreziqe të tjera, siç është rikthimi në fuqi i Indira Gandit, e cila po ndjek politikën e saj prosovjetike. Në rast se sovjetikët do të arrijnë t'i forcojnë pozitat e tyre në Indi, që është në konflikt me Pakistanin, ky i fundit mund të jetë më i prekshëm nga ana e sovjetikëve, me një fjalë rritet dhe bëhet më i lehtë depërtimi i influencës sovjetike atje. Ja pra, përse imperialistët amerikanë kërkojnë t'i dalin përpara eventualitetit të një ndërhyrjeje ushtarake ose të rritjes së influencës së Bashkimit Sovjetik në Pakistan. Nga ana tjetër Shtetet e Bashkuara janë shumë të shqetësuara nga mundësia e një presioni sovjetik edhe ndaj Iranit nën pretekstin e ndihmës kundër kërcënimeve që i bëhen këtij vendi nga imperializmi amerikan.

Është e qartë se popujt e këtij rajoni janë myslimanë dhe, kur e themi këtë, kemi parasysh faktin që shumica e tyre besojnë, por besimi i tyre është relativ dhe nuk predominon mbi politikën. Ka atje edhe njerëz përparimtarë që Kuranin dhe fenë i besojnë dhe i respektojnë më shumë si zakon e si traditë sesa si diçka që errëson objektivat politikë. Kur flasim për shumicë dërrmuese, kemi parasysh atë pjesë të popullit, së cilës fenë myslimane ia kanë paraqitur si një fe liberale, përparimtare, që u shërben interesave të popullit dhe se gjithçka predikohet në emër të saj, «është për të mirën e tij», mbasi «të marrësh avdes, të falesh, të agjërosh është në të mirën e shëndetit, të forcimit fizik e të kënaqësisë shpirtërore të njeriut» etj., etj. Me një fjalë njerëzve u thuhet se ritet e kësaj feje «janë të dobishme» jo vetëm për këtë jetë, por edhe për «jetën tjetër», pas vdekjes. Dhe kjo gjë predikohet hapur. Por mjerimi dhe shtypja, shkolla dhe njëfarë zhvillimi politik, ia kanë tronditur themelet këtij besimi.

Në përgjithësi, nga të gjitha këto ngjarje e zhvillime, shohim se si imperialistët, ashtu edhe socialimperialistët, në këto rajone të botës i kanë pozitat të vështira. Është e kuptueshme që tok me ta të vështira i kanë pozitat edhe kukullat e tyre. Si për të parët, edhe për të dytët, këto pozita shumë të vështira i shkakton lëvizja revolucionare, përparimtare, antiimperialiste, antikolonialiste e antifeudale e masave popullore të popujve arabë myslimanë, qofshin ata shiitë apo sunitë. Gjithë kjo gjendje në këtë rajon është pozitive, e mirë dhe flet për një situatë revolucionare, për një lëvizje të madhe të këtyre popujve. Por, në të njëjtën kohë, shohim se bëhen përpjekje nga ana e armiqve të tyre për ta frenuar këtë lëvizje ose për t'i ndryshuar drejtimin dhe intensitetin.

Këto situata, këto luftëra e këto kryengritje të këtyre popujve ne duhet t'i shohim, pra, si lëvizje shoqërore,

revolucionare, pavarësisht se në pamjen e parë ato kanë karakter fetar, e se i ndjekin njerëz besimtarë ose jobesimtarë, por që luftojnë kundër imperializmit të huaj, neokolonializmit apo monarkive ose feudalizmit shtypës brenda vendit. Historia na jep plot shembuj pozitivë në këtë drejtim, kur lëvizje të gjera masash popullore e revolucionare, në pamjen e jashtme, kanë pasur karakter fetar. Të tilla kanë qenë: Lëvizja e Vahabitëve në Indi që parapriu kryengritjen e madhe popullore kundër kolonizatorëve anglezë në vitet 1857-1859; lëvizjet Babide në Iran në vitet 1848-1851; lëvizjet fshatare në kohën e Reformacionit në shekullin e 16-të që përfshinë shumicën e vendeve të Evropës dhe sidomos Gjermaninë. Vetë Reformacioni, ndonëse ishte veshur me petkun fetar, përfaqësonte në vetvete një lëvizje të gjerë shoqërore politike të ngritur kundër sistemit feudal dhe kishës katolike që mbronte këtë sistem.

Kur cenohen interesat jetike të një populli, liria dhe pavarësia e tij, ai ngrihet në luftë kundër kujtdo agresori qoftë, edhe pse ai mund të ketë të njëjtën fe. Kështu ndodhi për shembull në Jemenin e Veriut në vitin 1962 kur Naseri, ky hegjemonist panarab, dërgoi ushtrinë egjiptiane gjoja për ndihmë, por në fakt e pushtoi atë. Pas disa kohësh ai u detyrua të largonte nga Jemeni trupat që dërgoi, sepse filloi një konflikt i ashpër midis popullit të këtij vendi dhe ushtrisë egjiptiane, pavarësisht se të dyja palët besonin në një fe.

Në Jemenin e Jugut, ku jeton një popull mysliman që beson, ekzistonte një lëvizje revolucionare popullore kundër imperializmit anglez që zotëronte portin e Adenit. Vullnetarisht Anglia nuk do të largohej kurrë nga porti i Adenit, që përbën një kyç strategjik me rëndësi të madhe në Oqeanin Indian dhe në hyrjen e Detit të Kuq, por ishte lufta antiimperialiste e popullit të Jemenit që e detyroi atë të shkulej andej, sepse qëndrimi atje iu bë i

pamundur. Pas kësaj në vitin 1970 në Jemenin e Jugut u krijua një regjim «demokratiko-popullor», i cili hyri dalngadalë nën ndikimin e socialimperialistëve sovjetikë. Lëvizja revolucionare kundër socialimperializmit sovjetik, në mos sot, nesër edhe këtu do të marrë zjarr.

Tani në gjithë principatën e Omanit ka lëvizje revolucionare antiimperialiste e antikolonialiste, si dhe kundër vetë sulltanit sundimtar të vendit. E njëjta situatë do të ndodhë edhe në Etiopi, në Somali, në Eritre e në vendet e Gjirit Persik.

Popujt e vendeve të këtij rajoni janë të tërë fetarë, njerëzit atje u besojnë Kuranit dhe Muhametit dhe çështjen e luftës kundër shtypjes imperialiste ata e lidhin me fenë. Ky është një realitet. Por, gjithashtu, kuptohet se ne nuk mund të dalim në konkluzione se është feja ajo që i shkakton këto revolta dhe këtë zgjim revolucionar. Në asnjë mënyrë. Veçse nuk mund ta injorojmë faktin që këta popuj besojnë në fenë myslimane e në të njëjtën kohë luftojnë heroikisht kundër imperializmit të çdo ngjyre, për çlirimin e tyre shoqëror e kombëtar.

Në Shqipëri para Çlirimit kishte njerëz që besonin në fenë myslimane, po fanatizëm nuk kishte. Edhe në vendet arabe apo në ato myslimane, të Azisë së Mesme, sidomos sot, nuk mund të ekzistojë fanatizmi klasik i dikurshëm. Një fanatizëm i tillë nuk mund të ekzistojë jo vetëm te myslimanët, por as te katolikët, te kalvinistët e shizma të tjera të kristianizmit. Të mos harrojmë epokën në të cilën jetojmë. Ne nuk mund të mos mbajmë parasysh sot zhvillimin e madh të shkencës, rritjen dhe fuqizimin e proletariatit revolucionar, përhapjen e ideve të marksizëm-leninizmit. Fanatizmin, në kuptimin klasik të tij, sot e nxitin në këto vende krerët reaksionarë fetarë, shërbëtorë të rendit feudal e të monarkive shtypëse të lidhur me ta, që duan t'i mbajnë popujt në errësirë e nën zgjedhë dhe të luftojnë lëvizjet e tyre çlirimtare.

Për sa i përket Khomeinit, ky është një udhëheqës fetar, një besimtar i devotshëm, një filozof idealist. Ai mund të jetë edhe «fanatik», po shohim se në të njëjtën kohë pajtohet e bashkohet me frymën revolucionare të popullit iranian. Khomeini ka marrë anën e kundërshtarëve të monarkisë. Borgjezia imperialiste, përkrahësit e monarkisë Pahlevi dhe forca të tjera reaksionare në botë, thonë se ai kërkon të bëhet vetë monark. Le ta thonë këtë, le ta thotë këtë edhe Sadati, por është fakt se lëvizja çlirimtare antiimperialiste, antikolonialiste e antifeudale në Iran është në ngritje dhe Khomeini vazhdon të qëndrojë në pozita të mira për sa i përket kësaj lëvizjeje.

Ajo çka po ngjan në Iran, mund të ngjasë edhe në Pakistan, mund të ngjasë edhe në vendet e Gadishullit Arabik, ajo mund t'i japë zjarr gjendjes revolucionare në Turqi, mund t'i japë zjarr gjendjes edhe në vetë Bashkimin Sovjetik, për arsye se socialimperializmi dhe revizionizmi e bartin kudo me vete shtypjen nacionale dhe, si pasojë, ngjallin ndjenjat e çlirimit kombëtar të popujve. Vetëm socializmi dhe teoria marksiste-leniniste i japin zgjidhje në rrugë të drejtë çështjes nacionale. Sot të drejtat nacionale të kombeve e të popujve janë shkelur e janë marrë nëpër këmbë në Bashkimin Sovjetik dhe kudo ku sundojnë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi ndërkombëtar. Atje ka shtypje të madhe, prandaj, logjikisht, me siguri ka dhe do të ketë edhe lëvizje.

Aktualisht në Iran ngjarjet ne duhet t'i shohim dhe t'i analizojmë ashtu si zhvillohen dhe këndej të nxjerrim konkluzione në bazë të mësimeve të teorisë sonë marksiste-leniniste. Në kryengritjen antiimperialiste dhe kundër monarkisë në këtë vend, në pararojë të forcave aktive janë fetarët, rinia studenteske, punëtorët, intelektualët. Pra nuk janë në udhëheqje të lëvizjes as proletariati dhe as partia e tij e vërtetë marksiste-leniniste. Në këtë çështje duhet të kemi parasysh edhe faktin se ne nuk dimë mirë forcën

dhe bazën e korrenteve të ndryshme politike në këtë lëvizje. Nga eksperienca jonë dimë që edhe te ne klasa punëtore nuk ishte e zhvilluar, por megjithatë, duke ekzistuar faktori objektiv dhe subjektiv, në kushtet e okupacionit e të Luftës Nacionalçlirimtare, Partia e udhëhoqi popullin në fitore duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, që do të thotë i vuri klasën punëtore dhe pararojën e saj, domethënë veten në drejtim, në udhëheqje. Në Iran nuk ndodh kështu. Ekziston në këtë vend një parti marksiste-lenineniste, Partia Komuniste Punëtore e Fshatare e Iranit, parti e re që sapo është formuar, po kjo është ende e vogël, e pakalitur, jo e lidhur me klasën punëtore e me masat etj., ndërsa partia revizioniste Tudeh ka ekzistuar legalisht dhe në ilegalitet, tash prapë është legale, por ajo është vegël e Bashkimit Sovjetik. Kjo parti, duke u mbuluar me parulla marksiste-leniniste, saboton luftën revolucionare antiimperialiste të popullit iranian dhe përpiqet ta futë Iranin në sferën e influencës e të zgjedhës sovjetike. Prandaj ndodh që populli mysliman iranian, që është ngritur në revoltë, nuk e njeh teorinë marksiste-leniniste, as si teori as si praktikë revolucionare. Studentët, që studiojnë në universitetet myslimane me tradita të mëdha të Iranit dhe të sektit shiit-islam, edhe besojnë në fenë, edhe nuk besojnë. Për sa u përket elementëve përparimtarë laikë, ka nga ata që besojnë dhe luftojnë për një pushtet borgjezo-demokratik-liberal, ka nga ata që besojnë në një shoqëri kapitaliste «progresiste» por antikomuniste, ka nga ata që vazhdojnë të mendojnë se Bashkimi Sovjetik është një vend socialist, që përfaqëson dhe zbaton leninizmin. Është pikërisht kjo një nga arsyet që marksizëm-leninizmi i vërtetë ende nuk e ka fituar të drejtën e qytetarisë në Iran, prandaj atje po luftohet për çlirimin e popullit nga zgjedha e imperializmit amerikan dhe nga influenca sovjetike, por nën flamurin e islamizmit. Kjo do të thotë që klerikët myslimanë shiitë janë në udhëheqje, në pararojë të kësaj kryengritjeje, por ne nuk

kemi iluzione dhe e dimë që janë për një regjim borgjez kapitalist me predominancë fetare, pra teokratike. Se ç'rrugë do të marrë më tutje lëvizja antiamerikane dhe kundër monarkisë barbare dhe kompradore të Pahlevëve, kjo varet kryesisht nga forcat e brendshme që po ziejnë.

Cilat janë këto forca në bazë të një përcaktimi të përgjithshëm që mund t'u bëhet?

Në gjendjen aktuale botërore e në stadin e tanishëm të lëvizjes së popujve për çlirimin e tyre shoqëror e kombëtar, revolta popullore revolucionare në Iran përfaqëson një etapë të re. Këtë etapë ne duhet ta vëmë më mirë në evidencë dhe ta analizojmë në mënyrë kritike marksiste-leniniste, pa marrë parasysh çfarë bëjnë e çfarë thonë të tjerët.

Irani është një vend shumë i pasur me naftë, pra ka një klasë punëtore të përbërë nga naftëtarë, punëtorë industrie, por ka edhe artizanë. Nga një popullsi prej 33 milionë banorësh që ka Irani, afro 17 milionë veta janë në fshat, punojnë tokën. Këta janë të mjeruar, të shtypur, të shfrytëzuar në kulm nga mullahët, vakëfi, nga borgjezia e madhe e tokave në shërbim të Pahlevëve, nga borgjezia e pasur tregtare dhe uzurare e lidhur me monarkinë. 99 për qind e popullsisë së Iranit konsiderohet e besimit mysliman dhe shumica janë të sektit shiit.

Regjimi i Pahlevëve ishte nga më barbarët, nga më gjakatarët, nga më shfrytëzuesit dhe nga më të korruptuarit e botës së sotme. Ai shtypi me gjak e me terror çdo lëvizje përparimtare, çdo manifestim, qoftë edhe të zbehtë liberal, çdo protestë e çdo grevë të punëtorëve, të studentëve dhe çdo përpjekje për të zhvilluar një ekonomi të vogël ndihmëse për të jetuar. Diktatura e egër e Pahlevëve mbështetej te feudalët e mëdhenj, te pasanikët e mëdhenj që krijoi regjimi, tek ushtria reaksionare dhe kasta e saj drejtuese si edhe te SAVAK-u, policia e fshehtë, që,

siç e cilësonte vetë shahu, ishte «shtet brenda në shtet». Pahlevët sundonin me terror, grabitnin popullin, pasuroheshin në mënyrë skandaloze, ata ishin personifikimi i degjenerimit moral dhe politik, ishin ortakë dhe të shitur tek imperializmi anglez, amerikan etj. Pahlevët ishin bërë xhandarët më të armatosur të Gjirit Persik nën urdhrat e CIA-s.

Irani shtypej, por populli ziente, megjithëse pushkatimet në masë ishin në rend të ditës. Ajatollahët që u prekën nga regjimi lëviznin. Më 1951 Musadeku, një përfaqësues i borgjezisë i mbështetur nga mullahët antishah dhe nga partia Tudeh, mori fuqinë. Më 1953 shahu u largua, por rrëzimi dhe largimi nuk qenë përfundimtarë, pse CIA organizoi puçin, rrëzoi Musadekun dhe risolli shahun në Iran e në fron. Kështu Irani u bë pronë e amerikanëve dhe e shahut dhe nafta arma e tyre e fuqishme.

Karakteristikë e revoltës së popullit iranian është ajo që, me gjithë terrorin e madh, nuk u shua, por vazhdoi, me ndërprerje, në forma të ndryshme dhe me intensitete të ndryshme. Ky proces revolucionar i pandërprerë u ngrit në cilësi dhe e kapërceu stadin e frikës nga shtypja.

Në vitin 1977, me gjithë terrorin e madh, opozita kundër shahut filloi të manifestohej më me forcë, u bë më e hapët dhe më operuese. Po t'i ndjekim në mënyrë fragmentare këto rryma kundër shahut dhe regjimit të tij, do të konstatojmë se ato janë disi autonome, por me strategji të përbashkët. Kështu shohim kundërshtimin e musadekistëve, rezistencën e fetarëve, veprimet dhe demonstratat e studentëve, qëndrimet kundër regjimit të intelektualëve, nëpunësve, shkrimtarëve, poetëve, artistëve në mitingje, në universitete e në vende të tjera publike, etj. tok me të gjitha këto rryma shohim edhe vetëmbrojtjen e rezistencën e klasës punëtore dhe të të gjithë popullit që shtypej e shfrytëzohej. SAVAK-u godiste pa mëshirë, por edhe shtypja e vrasjet shtonin zemërimin e

masave. Kjo rezistencë u kthye në një veprimtari permanente, u kapërcye stadi i frikës.

Në të njëjtat periudha ne shohim rizgjimin e opozitës politike të musadekistëve të Frontit Kombëtar. Një nga elementët e këtij korrenti ishte edhe Shapur Baftiari, i cili, në pragun e përmbysjes së shahut Pahlevi, u bë kryeministër. Ky ishte fisheku i fundit i shahut dhe i imperialistëve amerikanë kundër revolucionit antiimperialist iranian dhe Khomeinit.

Nga peripecitë e kësaj opozite politike u shkëputën «Lëvizja e çlirimit të Iranit», «Partia e Iranit», «Liga socialiste e lëvizjes nacionale të Iranit». «Lëvizja e çlirimit të Iranit», që kishte në krye Bazarganin e që pas largimit të shahut u bë kryeministër, ishte më afër Khomeinit dhe imamëve të tjerë.

Duhet të kemi kurdoherë parasysh se, si të gjitha këto opozita politike, edhe opozita fetare kundër Pahlevëve, nuk ishte e bashkuar. Një pjesë e atyre që e përbënin këtë opozitë ishte kundër së ashtuquajturës reformë agrare, kundër së drejtës të votës së grave etj. Kjo pjesë, e përbërë nga klerikë konservatorë, po e humbiste nga koha në kohë influencën fetare në masat, të cilat afroheshin më shumë me klerikët që luftonin hapur diktaturën e shahut në bazë të principeve shiite të fesë islame. I tillë ishte Ajatollah Khomeini, që u burgos, u torturua, u riburgos, i vranë edhe djalin dhe u nxor jashtë në mërgim. Kjo ia shtoi influencën imamit në popull, në «Bazar» (qendra kryesore e tregut të Teheranit), pra te tregtarët, por edhe te punëtorët. Në valën e agjitacionit e të demonstratave të mëdha kundër shahut kërkohej nga masat kthimi në atdhe i imamit. Vdekja e djalit të tij, si edhe e personalitetit politik, Ali Shariat, në rrethana misterioze, bëri që elementët fetarë të dalin në krye të përleshjeve dhe me ta të bashkohej gjithë populli veçanërisht në Tabriz më 18-19 shkurt të vitit 1977 si edhe në Teheran, në Kom

e në qytete të tjera iraniane. E tërë kjo dëshmon për shpirtin luftarak të popullit të Iranit. Kjo bëri që monarkia e Pahlevëve të mos u rezistonte dot sulmit dhe valëve të njëpasnjëshme të popullit kryengritës.

Në këtë klimë kryengritëse progresiste, pra, kundër feudalizmit, monarkisë dhe imperializmit, marksistë-leninistët duhet të bëjnë analizën e tendencave të ndryshme politike, të orientimeve të këtyre tendencave, të aleancave dhe të kontradiktave në mes tyre brenda në Iran dhe jashtë këtij vendi me botën kapitaliste, revizioniste.

Aktualisht shohim një unitet të kryengritjes në mënyrë aktive dhe luftarake kundër imperializmit amerikan e shahut dhe deri në njëfarë shkalle edhe kundër socialimperializmit sovjetik, e në të njëjtën kohë një rritje të vigjilencës dhe të kundërshtimit kundër të gjitha shteteve të tjera kapitaliste, por jo aq hapur e në mënyrë aktive sa kundër të parëve. Këto situata patjetër do të pësojnë evolucione. Ne shohim se universitetet në Iran janë bërë qendra të manifestimeve të zjarrta qofshin këto me tendenca politike ose fetare, shohim po ashtu që edhe opozita fetare dhe ajo politike po bashkohen. Pra, musadekistët dhe khomeinistët, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë në mes tyre, duket se po afrohen me njëri-tjetrin. Në Tabriz, që është një vend ku përveç punëtorëve të naftës, ekziston njëkohësisht një klasë punëtore e rëndësishme, mund të themi se u bë ky unitet. Po kështu ndodh në Abadan dhe në rajonet e tjera ku ekzistojnë fusha nafte dhe rafineri.

Forca dhe orientimet e klasës punëtore duhet të bëhen nga ana e marksistë-leninistëve iranianë, në mënyrë të veçantë, objekt i një analize në prizmin marksist-leninist dhe partia e tyre të mbështetet tek ajo, të futet te klasa, ta edukojë dhe ta sqarojë atë politikisht dhe ideologjikisht dhe të kalitet tok me të në këtë luftë klasore revolucionare që sapo ka filluar, që nuk ka mbaruar dhe

që do të marrë me siguri aspekte të ndryshme. Vetëm veprimtaria revolucionare e klasës punëtore dhe ideologjia marksiste-leniniste duhet të bëhen faktori vendimtar i orientimeve të drejta që duhet të marrë ky revolucion demokratiko-borgjez e antiimperialist. Sigurisht në gjendjen aktuale në Iran mund dhe duhet të përfitohet shumë nga forca revolucionare e klasës punëtore iraniane, nga elementët progresistë dhe veçanërisht nga studentët dhe fshatarësia e varfër dhe e mesme.

Do të jetë gabim në qoftë se marksistë-leninistët nuk i kuptojnë dhe nuk i shfrytëzojnë drejt situatat e krijuara, në qoftë se paraqiten si luftëtarë antifetarë, duke dëmtuar unitetin antiimperialist dhe antifeudal edhe me partizanët e Ajatollah Khomeinit dhe me lëvizjet demokratiko-borgjeze të musadekistëve, të Bazarganit ose me parti dhe lëvizje të tjera antiimperialiste.

Marksistë-leninistët iranianë, duke qenë antifetarë në parimet e tyre, nuk duhet të zhvillojnë në këto momente luftë kundër besimit fetar të popullit, që është ngritur në kryengritje kundër shtypjes dhe që politikisht bën një luftë të drejtë, por që ideologjikisht është i paformuar dhe ndodhet përpara një shkolle të madhe ku do të mësojë. Marksistë-leninistët duhet ta mësojnë popullin që t'i gjykojë ngjarjet që po zhvillohen në dritën e materializmit dialektik dhe historik. Por botëkuptimi ynë nuk mund të përvetësohet lehtë dhe i shkëputur nga hovi revolucionar i masave dhe as i izoluar nga rrymat antiimperialiste që përpiqen të qëndrojnë në udhëheqje dhe të manovrojnë për të penguar reformat demokratiko-borgjeze të revolucionit. Marksistë-leninistët dhe klasa punëtore iraniane duhet të luajnë një rol të madh në këto lëvizje revolucionare dhe të kuptojnë qartë momentet nëpër të cilat kalojnë; ata duhet të mos e lënë revolucionin të bjerë, «të mos e lënë zogun t'u shpëtojë nga dora». Klasa punëtore dhe pararoja e saj e vërtetë marksiste-leniniste duhet të

mos kenë asnjë iluzion në veprimet dhe në reformat «e thella» demokratiko-borgjeze që mund të bëjnë klerikët shiitë ose elementët kundër shahut të borgjezisë nacionale të vjetër dhe të re. Me siguri, në rast se nga klasa punëtore, fshatarësia e varfër dhe studentët përparimtarë, besimtarë ose jobesimtarë, do të lihet që të bjerë hovi i revolucionit, gjë që do të thotë të mos ecet me ngulm, me pjekuri në aleanca e në veprime drejt reformave të njëpasnjëshme politike dhe ekonomiko-shoqërore, atëherë revolucioni do të ngelë në mes të rrugës, masat do të zhgënjehen dhe shfrytëzimi i tyre do të vazhdojë në forma të tjera, nga të tjerë njerëz pseudodemokratë të lidhur me aleanca të reja me imperialistët e ndryshëm.

Këto situata të veçanta, të reja dhe revolucionare që po zhvillohen në popuj me besim fetar islamik, lipset të studiohen, të nxirren konkluzione dhe të gjenden forma të reja lufte, veprimi dhe aleancash. Këto situata revolucionare janë shumë më të avancuara nga situatat në Evropë dhe në Azi, bile deri në njëfarë shkalle edhe në Amerikën Latine, ku lëvizjet revolucionare kanë marrë një formë të ngrirë, të inkuadruar dhe të drejtuar nga socialdemokracia dhe revizionizmi modern reformist dhe kundërrevolucionar.

Kështu në Evropë, ku ekziston një proletariat i madh e i fuqishëm, ne nuk shohim të ngjasin revolta të tilla me frymë të theksuar revolucionare e politike. Për ç'arsye? Për të gjitha ato arsye që dihen dhe që kanë të bëjnë me ndikimin e rëndë kundërrevolucionar e sabotues të socialdemokracisë e të revizionizmit modern. Këtu, në Evropë, klasa punëtore deri diku është borgjezuar, është futur në rrugën socialdemokrate të reformave. Nuk është çështja se në kontinentin tonë nuk ka shfrytëzim, prandaj nuk ka edhe lëvizje. Jo. Edhe këtu ka gjithashtu shfrytëzim, ka edhe lëvizje, por këto janë të një natyre tjetër. Ato nuk janë, siç i quajnë socialdemokratët, revi-

zionistët e shërbëtorë të tjerë të borgjezisë kapitaliste «lëvizje shumë të thella revolucionare marksiste-leniniste», që presin «të piqen situatat» etj. Jo. Vetë borgjezia kapitaliste dhe shërbëtorët e saj nuk lejojnë që të piqen situata të tilla e të ndodhë siç ndodh aktualisht në vendet arabo-myslimane, ku masat revolucionare ngrihen në luftë dhe krijojnë situata të vështira për imperializmin, feudalizmin dhe borgjezinë kapitaliste e kozmopolite.

Disa thonë se popujt arabë e të vendeve myslimane lëvizin se «janë të varfër»! Po, ata janë të varfër. Por, ata që thonë kështu, duhet të pranojnë se vetë janë borgjezuar, prandaj nuk ngrihen kundër shtypjes e shfrytëzimit, kurse e vërteta është se kudo kapitalizmi shtyp e shfrytëzon barbarisht popujt pa përjashtim.

Thonë, gjithashtu, se në vendet me fe islame, «masat janë prapanike», prandaj vihen lehtë në lëvizje. Kjo do të thotë se pretenduesit e këtij arsyetimi, kanë degjeneruar dhe nuk janë për revolucion, sepse në një kohë kur kapitalizmi është në kalbëzim, njerëzit e ndershëm duhet të jenë revolucionarë dhe të ngrihen në luftë kundër kapitalizmit dhe armët që kanë në dorë t'i drejtojnë kundër atij. Por këtu, në Evropë, nuk e shohim një gjë të tillë, përkundrazi shohim të predikohet «teoria» e përshtatjes me situatën ekzistuese.

Debate politike organizohen në të katër anët e vendeve kapitaliste. Në këto vende është bërë e modës që si socialdemokratët, demokristianët, revizionistët e gjithfarëlloj njerëzish të tjerë të flasin për «revolucion» e për veprime gjoja revolucionare dhe në këtë mënyrë secili prej tyre përpiqet me këto slogane të hutojë e të mashtrojë masat punonjëse. «Të majtët» çirren për «masa revolucionare», por pastaj caktojnë menjëherë kufirin, «duke shpjeguar» se «jo kudo e në çdo fushë duhen ndërmarrë masa revolucionare», por vetëm «të bëhen disa ndryshime», pra, të jepet një kockë, pikërisht për të ma-

shtruar masat që kërkojnë ndryshime rrënjësore revolucionare, për ta penguar e për ta sabotuar vrullin revolucionar të masave.

Këto situata e fenomene duhet t'i analizojmë edhe me artikuj teorikë apo me forma e me mjete të tjera të propagandës në rrugën marksiste-leniniste, me qëllim që të shpjegojmë thelbin e revoltës e të kryengritjeve të popujve kundër imperializmit, neokolonializmit e sundimtarëve të brendshëm, të shpjegojmë çështjen e besimit akoma në traditat e vjetra fetare etj. Kjo nuk përjashton përkrahjen e lëvizjeve çlirimtare nga ana jonë, sepse të këtilla lëvizje janë vërtetuar edhe para Marksit, siç përmendëm edhe më lart. Të presësh që të zhduket më parë feja, pastaj të bësh revolucionin, nuk është në favor të revolucionit e të popujve.

Në situatat e sotme njerëzit që janë ngritur në revoltë dhe që besojnë te feja, nuk janë më në stadin e ndërgjegjes e të vetëdijes së Spartakut, i cili u ngrit kundër Perandorisë Romake, kundër skllavopronarëve, por janë mbushur me ndjenjat e revoltës kundër shtypjes e shfrytëzimit dhe kundër politikës barbare të imperializmit e të socialimperializmit. Revolta e skllevërve, e udhëhequr nga Spartaku, siç e shpjegojnë Marksi dhe Engelsi, ishte përparimtare, ashtu edhe fillimi i kristianizmit.

Në këto situata shumë të rëndësishme vëmë re se edhe popujt e tjerë të Afrikës janë ngritur, por jo me forcën e me hovin revolucionar të popujve arabë, iranian etj. Ky është një problem tjetër që, gjithashtu, duhet parë për të gjetur shkaqet, përse nuk ngrihen e përse nuk frymëzohen edhe ata në të njëjtën shkallë si popujt që përmenda? Ç'është e vërteta edhe popujt afrikanë janë të shtypur, bile ata janë shumë më të shtypur nga ç'janë popujt arabë, ai iranian etj. Edhe në Afrikë marksizmi ende nuk ka hyrë si duhet, pastaj edhe atje ekziston in-

fluenca e fesë, megjithëse jo në atë shkallë si në vendet myslimane. Në Afrikë duhet punuar që të përhapet më gjerë e më thellë teoria jonë marksiste-leniniste. Atje gjendet një terren akoma më i virgjër, me popuj të shtypur, ku ndjenja e fesë është në një stad akoma foshnjor. Popujt e Afrikës rrojnë më shumë me besimin te fuqia hyjnore e diellit, e hënës, te magjitë etj., besime këto pagane që nuk janë kristalizuar në një ideologji e në një teologji konkrete, siç është feja myslimane, pa lëre pastaj fenë katolike, budiste e sektet e tyre. Ndonëse në Afrikë ka një shtypje e shfrytëzim të egër, lëvizja në këtë zonë të botës është më e ngadalshme. Kjo për arsye se edhe stadi i zhvillimit shoqëror në Afrikë është më i ulët.

Po t'i marrim e t'i shohim këto çështje në unitetin e tyre, do të vëmë re se në stadin aktual të zhvillimit, islamizmi, në përgjithësi, luan një rol aktiv në luftërat çlirimtare e antiimperialiste të popujve myslimanë, ndërsa në vendet evropiane e në disa vende të tjera ku vepron feja katolike, e cila predikon nënshtrimin, që, siç thuhet në filozofinë kristiane, «po të të qëllojnë në njërën faqe, ktheji atij që të ra edhe faqen tjetër», shikojmë që udhëheqësit e saj mbajnë qëndrim reaksionar dhe përpiqen të pengojnë lëvizjen e masave, revoltën, kryengritjen e tyre për çlirim shoqëror e kombëtar. Në këto vende, natyrisht, është më e madhe edhe forca shtypëse e borgjezisë dhe e kapitalizmit, e socialdemokracisë, e revizionizmit modern, por edhe feja katolike shërben për të shtypur frymën revolucionare të masave, për ta mbajtur gjendjen në amulli.

Popujt myslimanë nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik janë mbajtur prapa; në dekadat e shkuara, si pasojë e pushtimeve kolonialiste e të shfrytëzimit kolonialist e neokolonialist, feja myslimane në këto vende është shtypur nga feja katolike ose protestante që përfaqësoheshin nga pushtuesit e huaj, gjë që nuk ka kaluar pa pasoja e pa

rezistencë dhe këtu mund të gjejmë dhe një arsye politike e ideologjiko-fetare të revolucionit antiimperialist të popujve myslimanë.

Çështja shtrohet që ne të shikojmë tani stadin e zhvillimit të fesë myslimane në krahasim me shekujt e kaluar. Zhvillimi i shoqërisë njerëzore ka ndikuar që besimi fetar mysliman të bëhej gjithnjë e më pak operues, domethënë në të ka depërtuar njëfarë liberalizmi që duket në faktin se besimtari mysliman vërtet beson në fenë islame, por sot ai nuk është më si besimtari i shekujve të mesjetës apo të shekujve të fundit, të 17-s, të 18-s apo të 19-s.

Sot gruaja me çarçaf në vendet myslimane ka po ato ndjenja që kishte para Çlirimit gruaja jonë e mbuluar me çarçaf, siç ndodhte, fjala vjen, në Kavajë, por sigurisht jo plotësisht të një gruaje përparimtare në atë shkallë siç ishte gruaja jonë. Megjithatë ndjenjat e revoltës brenda në shpirtin e saj ekzistojnë dhe bile shprehen deri në atë masë që e lejon opinioni. Gruaja persiane është angazhuar sot në lëvizjen e gjerë të popullit iranian kundër shahut e imperializmit.

Pra shohim që shtypja fetare ekziston edhe në vendet me popullsi myslimane, por si fe ajo ka bërë njëfarë evolucioni, sidomos në anën e saj të jashtme. Të kuptohemi, feja nuk është zhdukur në këto vende, por sot ka ardhur një kohë në të cilën fryma e revoltës nga njëra anë dhe liberalizimi i fesë nga ana tjetër, i bën njerëzit që besojnë te dogmat islamike të ngrihen kundër atyre që quhen fetarë e kërkojnë të ushtrojnë normat e mëparshme të fesë për t'i shtypur e për t'i mbajtur popujt në mjerim. Pikërisht me këtë lidhet edhe lufta e tyre kundër imperialistëve, të cilët vazhdojnë të quhen të pafe, domethënë armiq të tyre, armiq të fesë së tyre. Këta popuj e kuptojnë se pushtuesit e huaj janë njerëz të besimeve katolike apo protestante, që kërkojnë t'i shty-

pin si vende e si fe. Këtë antagonizëm fetar, që ka përbrenda edhe antagonizmin klasor ndaj pushtuesve të huaj, perëndimorët e quajnë vetëm luftë fetare ose i vënë epitete të tjera denigruese të padrejta. Kështu i trajtojnë sot ata luftërat çlirimtare të popujve myslimanë, të vendeve arabe e joarabe, në Azi e në Afrikë, bile edhe luftën çlirimtare të popullit irlandez, ku shumica e popullsisë është katolike, kundër pushtuesve të tyre anglezë, që janë protestantë. Në të njëjtën kohë shfaqje të padrejta shohim edhe te popujt myslimanë që janë ngritur në revoltë. Edhe këta thonë: «Po na shtyp kauri, njerëzit pa din e pa iman, që janë kundër fesë sonë» etj. Kështu çështjen e çlirimit kombëtar ata e bashkojnë me çështjen fetare, pra shtypjen shoqërore dhe ekonomike që u bën imperializmi e shohin si shtypje fetare. Nesër edhe popujt e tjerë myslimanë në këto çështje patjetër do të arrijnë në atë stad zhvillimi që kanë arritur populli algjerian, ai i Irakut, i Sirisë apo i vendeve të tjera.

Këto luftëra çojnë jo vetëm në shtimin e simpatisë për popujt që ngrihen në revoltë, por edhe në bashkimin e tyre, sepse të tërë janë myslimanë. Nëse një popull ngrihet kundër imperializmit dhe krerëve reaksionarë sundues të vendit të vet, të cilët e përdorin fenë për shtypje, kjo kryengritje e shpartallon ndjenjën e fesë edhe tek ata që tani besojnë te Muhameti. Kur një popull ngrihet në kryengritje kundër shtypjes, atëherë tek ai zgjerohet e thellohet ndjenja revolucionare dhe njerëzit arrijnë në një stad që i bën të mendojnë një çikë më mirë për çështjen e fesë. Fshatari i varfër i Iranit deri dje thoshte vetëm «ishalla» dhe me këtë ngushëllohej, po tani e kupton që me «ishalla» nuk fitohet gjë. Përpara kudo te këta popuj thuhej «kështu ka qenë shkruar», por besimtarët tani janë ngritur në masë të bashkuar e dalin nëpër rrugë me armë në dorë për të kërkuar të

drejtat e tyre, lirinë e tyre. Dhe me siguri, kur të kërkojnë që të marrin tokën, fshatarët në këto vende patjetër që do të ndeshen edhe me pasuritë e mëdha të xhamive e të kishave, pra me klerin. Prandaj forcat e errëta të reaksionit bëjnë zhurmë të madhe rreth anës fanatike, rreth çështjes së rivendosjes së perçes së gruas e të tjera, e të tjera, sepse përpiqen ta diskreditojnë revolucionin iranian, sepse imperializmi dhe kapitalizmi botëror te feja kanë një mbështetje të madhe, kolosale. Kështu është çështja edhe me Vatikanin, me politikën e kësaj qendre të madhe të obskurantizmit më reaksionar botëror, me mentalitetin dhe me botëkuptimet e katolikëve. Por revolucioni e shpërndan mjegullën fetare. Kështu do të ngjasë patjetër edhe me popujt arabë, me popujt e tjerë myslimanë që ngrihen në kryengritje dhe me popujt me besime të tjera, domethënë do të ecet drejt zhdukjes, drejt eliminimit të besimeve fetare dhe të udhëheqjes fetare. Ky është një problem i madh.

Këtu është fjala për popuj të tërë që po ngrihen në revoltë në vendet myslimane, qofshin këto arabe ose jo. Në Evropë nuk ka lëvizje të këtilla. Në këtë kontinent veprojnë parti dhe forca socialdemokrate reformiste; numri i partive marksiste-leniniste këtu është ende i vogël, kurse ka parti revizioniste të mëdha, të cilat veprojnë në kundërshtim me interesat dhe me ndjenjat e njerëzve, kanë humbur besimin në popull, mbështetin kapitalizmin, imperializmin dhe socialimperializmin. Popujt myslimanë të vendeve arabe e joarabe nuk kanë besim as tek imperialistët amerikanë, as te socialimperialistët sovjetikë, sepse këta përfaqësojnë fuqi të mëdha që luftojnë t'i shtypin e t'i grabitin; dihet se ata nuk kanë besim, gjithashtu, edhe si myslimanë në besimet fetare të këtyre fuqive.

Si rezultat, kryengritja që po zhvillohet në Iran e në Afganistan ka e do të ketë rrjedhime në gjithë botën myslimane. Prandaj, po t'i kuptojnë mirë e drejt grupet mark-

siste-lenineste, shokët tanë në Turqi, në Iran, në Siri e gjetkë, çështjet që dalin nga ngjarjet në Iran, në Afganistan e në vendet e tjera myslimane, atëherë janë të gjitha mundësitë të bëhet nga ana e tyre shumë punë. Po natyrisht atje duhet punuar me kujdes. Në këto vende nuk ka se si ta zhdukësh fenë me direktiva, me parulla ekstremiste, por as me analiza të padrejta. Ne, për të gjetur të vërtetën, duhet të analizojmë veprimtarinë e këtyre forcave në kushtet konkrete aktuale, sepse thuhen shumë gjëra, të qena e të paqena, siç ndodh edhe me Ajatollah Khomeinin. Ky vërtet është fetar, por pavarësisht nga kjo, duhet bërë analiza e qëndrimeve dhe e veprimtarisë së tij antiimperialiste që dashje pa dashje çon ujë në mullirin e revolucionit.

I gjithë ky zhvillim ngjarjesh është shumë interesant. Këtu, në simpatinë e solidaritetin midis popujve, plekset çështja e fesë me çështjet politike. Dua të them që, në qoftë se udhëheqja e Turqisë, për shembull, do të ngrihet kundër revoltës së popullit iranian, atëherë ajo do të humbasë pozitat politike brenda dhe populli i këtij vendi do të ngrihet kundër, do ta akuzojë qeverinë për lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me «kaurët», se këta janë kundër myslimanizmit. Ndodh kështu sepse për ta myslimanizmi është «përparimtar», ndërsa Shtetet e Bashkuara përfaqësojnë atë forcë që shtyp popujt jo vetëm nga ana shoqërore, por edhe nga ana shpirtërore. Prandaj shohim se, në përgjithësi, asnjë prej këtyre vendeve nuk po del hapur për të dënuar ngjarjet në Iran.

Pengesa tjetër që nxjerr reaksioni për të sabotuar revolucionin demokratiko-borgjez në Iran, është ajo e futjes së grindjeve dhe ngritja e çështjes së pakicave kombëtare. Për të dobësuar këtë kryengritje të madhe antiimperialiste dhe «promyslimane» të popullit iranian, reaksioni nxit ndjenjat nacionale në Azerbajxhan, nxit kurdët e të tjera, e të tjera. Çështja e nxitjes së ndjenjave

nacionale ka qenë dhe është një armë në duart e imperializmit dhe të socialimperializmit, të gjithë reaksionit për të sabotuar luftërat nacionalçlirimtare, luftërat antiimperialiste. Prandaj është e drejtë teza e Partisë sonë, sipas së cilës, aktualisht, çështja e zgjidhjes së problemeve të pakicave kombëtare nuk është një problem kryesor. Tani kurdi, taxhiku, azerbajxhanasi e të tjerë duhet të ngrihen në luftë kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij dhe, po të jetë e mundur, të ngrihen sipas mësimeve dhe frymës marksiste-lenineste. Edhe kurdët, taxhikët e azerbajxhanasit që jetojnë në Bashkimin Sovjetik, që aktualisht janë të shtypur e të robëruar, duhet të ngrihen në radhë të parë kundër socialimperializmit rus.

Kështu paraqitet, në vija të përgjithshme, situata në këto rajone dhe këto janë disa nga problemet që dalin. Me siguri ngjarjet do të zhvillohen më tej. Detyra jonë është që këto situata dhe këto ngjarje, që po zhvillohen në botën myslimane, t'i analizojmë në bazë të teorisë marksiste-lenineniste dhe të përcaktojmë qëndrimet tona në mënyrë që të ndihmojmë në kuptimin e drejtë të tyre dhe të japim kështu kontributin tonë në zhvillimin me sukses të lëvizjes revolucionare të popujve.

E MËRKURË
13 SHKURT 1980

PANORAMË E GJENDJES NDËRKOMBËTARE

Josip Broz Titoja është duke vdekur. Siç dihet, para pak ditësh atij i prenë këmbën, pse iu rrezikua nga gangrena. Me këtë operacion përkohësisht u duk sikur e kapërceu lumin, por operacioni i shkaktoi dobësimin e zemrës, të veshkave, të sistemit të tretjes etj.

Lëvizjes komuniste ndërkombëtare Titoja i bëri shumë dëm. Në historinë e kësaj lëvizjeje ai do të figurojë si një nga renegatët dhe tradhtarët kryesorë të kohërave tona. Ai u përpoq dhe deri diku i ndihmoi revizionistët sovjetikë që të forconin punën e tyre sabotuese, të cilën e kishin filluar me kohë Hrushovi me shokët e tij, dhe të punonin nën rrogoz për goditjen e tmerrshme që i dhanë socializmit në Bashkimin Sovjetik e në arenën ndërkombëtare.

Titoja dhe Kardeli, pas një sërë peripecish, të ndihmuar fuqimisht nga imperializmi amerikan dhe imperializmi botëror, ndërtuan sistemin e tyre kapitalist që e quajtën vetadministrimi jugosllav. Kjo çështje njihet dhe s'është nevoja të zgjatemi, por gjatë sundimit të titizmit në Jugosllavi, kapitalet amerikane dhe ato të Evropës Perëndimore, në radhë të parë, pastaj edhe ato sovjetike kanë zënë vende të rëndësishme kyçe në ekonominë jugosllave. Sistemi i vetadministrimit s'është gjë tjetër veçse një mbulesë e përciptë, e hollë e këtij sundimi ndërkombëtar në Jugosllavi të kapitalit financiar amerikan, gjermanoperëndimor, sovjetik etj., etj. Këto kapitale brenda ekonomisë jugosllave kanë zonat e tyre të shfrytëzimit, dhe, si rrjedhim, kanë edhe influencën e tyre mbi njerëzit që drejtojnë Republikën Federative Socialiste Jugosllave.

Përveç kësaj cipe të hollë që ka mbuluar formën e vërtetë të rendit kapitalist në Jugosllavi, Titoja e Kardeli me shokët e tyre kanë krijuar, gjithashtu, njëfarë udhëheqjeje «kolegjiale», e cila gjoja drejton, në mënyrë kolegjiale, edhe tash që Titoja është i sëmurë rëndë, por që do të drejtojë më konkretisht pas vdekjes së tij. Pra, sipas teorisë dhe punës konkrete organizative që kanë shtjelluar Titoja me Kardelin, kjo udhëheqje e Federatës «është siguruar» edhe pas vdekjes së Titos. Unë mendoj se nuk mund të ketë udhëheqje kolegjiale në një vend kapitalist. Në vendet kapitaliste ekziston sundimi i kapitalit financiar dhe i trusteve të mëdha kombëtare ose shumëkombëshe. Një gjë e tillë do të ndodhë, bile ajo ekziston që tani edhe në Jugosllavi.

Përveç kësaj ky vend është një Federatë e përbërë nga shumë kombe, të cilat, pas Traktatit të Versajës dhe Luftës të Dytë Botërore, hiqen sikur janë në harmoni e në unitet, po realiteti është ndryshe, ai është krejt i kundërt. Këto kombe kanë grindje të thella në mes tyre. Republikat e Federatës Jugosllave ndodhen midis kontradiktash të mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike. Gjatë sundimit Tito-Kardel-Rankoviç në sipërfaqe dukej se ekzistonte «bashkim-vëllazërimi». Të tre këta përpiqeshin, sa u ishte e mundur, dhe deri në njëfarë shkalle ia arritën, që për sy e faqe të dukej se Federata ekzistonte, bile se ajo drejtonte, pavarësisht pse kishin krijuar sistemin e vetadministrimit, por, në realitet, dihet se në mes serbëve dhe kroatëve, në mes sllovenëve dhe serbëve, në mes shqiptarëve dhe serbëve, në mes maqedonasve,

shqiptarëve dhe serbëve e kështu me radhë, kanë ekzistuar dhe ekzistojnë kontradikta të mëdha.

Sistemi i vetadministrimit, këto kontradikta jo vetëm nuk i ka shuar, por i ka shtuar. Në udhëheqjen kolegjiale secili klan manovron e vepron në interesin e kombit që përfaqëson e në dëm të kombit të klanit tjetër. Kështu serbët kanë punuar që të dominonin në Federatë dhe për këtë shkak janë goditur nga kroatët e sllovenët. Kroatët nga ana e tyre kanë luftuar të dominonin mbi serbët, por edhe këta kanë dështuar, se Serbia është një republikë me peshë të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake.

Ne shohim se këto kontradikta janë rrjedhim i pabarazisë së zhvillimit midis republikave, shohim se vetadministrimi, që nuk është veçse një pasqyrim i regjimit kapitalist të bankave dhe të kapitalit botëror, disa republika i ka favorizuar, disa të tjera i ka varfëruar. Në disa republika janë bërë investime të mëdha, në disa zhvillimi i ekonomisë është lënë krejt pas dore. Në Sllloveni, për shembull, të ardhurat janë të mëdha, se janë bërë shumë investime, në Kroaci po ashtu, në Serbi më pak, ndërsa në Kosovë s'është bërë asgjë, në Maqedoni e në Mal të Zi po e njëjta gjë.

Kështu që sot njerëzit presin ç'mund të ngjasë në Jugosllavi pas vdekjes së Titos. Vendet kapitaliste trumbetojnë se Bashkimi Sovjetik do ta pushtojë Jugosllavinë dhe këtë zhurmë e këtë parashikim i kanë ngritur deri në atë shkallë saqë në të vërtetë i thonë Bashkimit Sovjetik ta bëjë një gjë të tillë. Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të tjerëve kjo gjë u shërben që ta trembin Jugosllavinë dhe ta bëjnë që pas vdekjes së Titos (në të vërtetë nën sundimin e tij Jugosllavia *de facto* varej më shumë nga kapitali perëndimor) të jetë nën sqetullën e plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve kapitaliste të Perëndimit. Për këtë gjë Karteri, në

një konferencë shtypi që mbajti dy-tri ditë përpara, midis të tjerave, deklaroi se ka biseduar me udhëheqësit e tjerë të vendeve aleate të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për fatin e Jugosllavisë pas Titos dhe se, në qoftë se ajo do të kërkojë ndihmë, në rast të një sulmi sovjetik, kërkesa e saj do të studiohet me seriozitetin më të madh.

Mendimi im është se në këto situata ndërkombëtare Bashkimi Sovjetik nuk do ta sulmojë Jugosllavinë me ushtri. Ai do t'i bëjë Jugosllavisë shantazhe të shumëllojta dhe do ta frikësojë, por kufijtë e saj nuk do të cenohen nga trupat e Traktatit të Varshavës. Në periudhën e parë Bashkimi Sovjetik do të bëjë të gjitha përpjekjet që influenca e tij politike dhe ekonomike në Jugosllavi të shtohet nëpërmjet kredive dhe qëndrimeve politike gjoja dashamirëse. Nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik do të bëjë të gjitha përpjekjet që ta dobësojë klanin properëndimor, proamerikan. Këtë gjë ai do ta bëjë me çdo mjet duke përdorur edhe subversionin, duke përdorur, gjithashtu, edhe elementët e lëkundshëm ose prorusë. A ekzistojnë në Jugosllavi elementë të tillë, shtresa të tilla? Nuk mund të themi se nuk ekzistojnë, por nuk është reale të mendohet se influenca e Bashkimit Sovjetik mbi popujt jugosllavë është ashtu siç ishte në kohën e knjazëve, të Karagjorgjeviçëve dhe të Obranoviçëve.

Jugosllavët nuk e pranojnë pansllavizmin, sidomos dominimin rus. Miq të Bashkimit Sovjetik mund të ketë si në klanin serb ashtu edhe në atë kroat, por në bazë të parimit ti në shtëpinë tënde, unë në shtëpinë time. I këtillë është mentaliteti i serbëve, i kroatëve, i sllovenëve, i shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi. Për maqedonasit nuk mund ta them këtë. Pra në këto forma do të përpiqet Bashkimi Sovjetik të shtojë kredinë e vet në Jugosllavi. Këto situata udhëheqja e ashtuquajtur kolegjiale jugosllave pas Titos, medoemos do t'i ketë parasysh, sepse e njeh situatën në vend më mirë nga ne

dhe shumë më mirë nga perëndimorët e nga rusët. Duhet thënë se titistët armiq i kemi pasur e armiq i kemi, por budallenj ata nuk kanë qenë dhe nuk janë. Serbët, kroatët, sllovenët dhe malazestë, për të mos folur për shqiptarët, pse këta janë vëllezërit tanë, nuk janë aq leshko sa të pranojnë dënglat e Brezhnjevit e të Suslovit ose ligjet e Traktatit të Varshavës, të lejojnë trupat e Zhivkovit ose propagandën e tij të depërtojë lehtësisht në Jugosllavi e veçanërisht në Maqedoni.

Prandaj udhëheqja «kolegjiale» jugosllave pas vdekjes së Titos do të ketë si objektiv kryesor ruajtjen e Federatës dhe uniteti do të konsistojë në moslejimin e cenimit të kufijve të Jugosllavisë dhe ndjekjen e politikës së «mosangazhimit» jashtë dhe të vetadministrimit brenda.

«Mosangazhimi» jashtë do të theksohet vazhdimisht nga udhëheqja e pas Titos. Ajo, si deri tani, do të bëjë akrobaci në këtë drejtim, pse në fund të fundit nuk ishte vetëm Titoja ai që i bënte këto akrobaci, por i tërë klani i tij që luan «vallen mbi litar» sa nga Lindja, nga Perëndimi, domethënë që shtrinte të dy duart sa nga njëra anë, aq edhe nga ana tjetër. Udhëheqja «kolegjiale» do të shfrytëzojë me mjeshtëri kontradiktat që ekzistojnë në mes Lindjes dhe Perëndimit, në mes përpjekjeve të njërit dhe të tjetrit jo vetëm kundrejt Jugosllavisë, por në të gjithë skakierën ndërkombëtare dhe me një politikë të tillë pehlivanësh, kjo udhëheqje ka ndër mend të ruajë pavarësinë e Federatës Jugosllave.

Natyrisht kjo pavarësi do të mbrohet prej saj nëpërmjet ushtrisë dhe UDB-së, të cilat do të jenë arma e sigurt e klanit më të fuqishëm që do të dominojë në këtë udhëheqje gjoja kolegjiale, dhe ushtria në Jugosllavi do të ketë fjalën e parë dhe të fundit. Të gjitha veprimet politike, ekonomike, ideologjike do të mbështeten në forcën e armëve. Ushtria, pra, në të ardhmen do të luajë një

rol shumë të rëndësishëm në Federatën Jugosllave. Me fjalë të tjera, pa vendosur *de jure* dhe pa e shpallur publikisht, në Jugosllavi do të ketë një diktaturë ushtarake të klanit më të fuqishëm në pushtet, i cili do të vazhdojë të quhet vetadministrim jugosllav dhe Federata një «federatë socialiste» me një politikë «të paangazhuar», jashtë blloqeve.

Si do të zhvillohen situatat brenda, kjo është një çështje me rëndësi të madhe, që do të influencojë në qenien të fortë ose në dobësimin e Federatës, do të favorizojë shkaqet e ndërhyrjes dhe të rritjes së influencës të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit perëndimor apo të revizionizmit sovjetik dhe të influencës së Traktatit të Varshavës.

Këto kontradikta patjetër do t'i thellojë sistemi i vetadministrimit, se Serbia do të përpiqet të dominojë në Federatë, kroatët po ashtu dhe, kur ekzistojnë kontradikta në mes këtyre dy republikave më të fuqishme, është e natyrshme që rreth tyre të krijohen klanet mbështetëse, sllovenët do të mbështetin kroatët, mundet që edhe Vojvodina të mbështetë Kroacinë, kurse Mali i Zi mundet dhe duhet të ketë tendenca të bashkohet me Serbinë; shqiptarët, natyrisht, do të luftojnë për llogari të tyre, për çlirimin e tyre të vërtetë, kurse Maqedonia do të influencohet shumë nga propaganda sovjeto-bullgare dhe do të ketë tendenca të mbështetë klanin serb.

Me këto të çara të theksuara aktuale dhe më të theksuara në të ardhmen, do të llogaritin dhe do të luajnë lojërat e tyre të fshehta e të hapëta si sovjetikët, ashtu edhe perëndimorët. Prandaj s'ka se si që një situatë e tillë të mos influencojë ose në dobësimin e Federatës, ose në forcimin e diktaturës ushtarake, në dhënien e goditjeve të forta kundër atij klani që, në stadin e sotëm ndodhet në pozita inferiore, por do të kërkojë të marrë epërsinë.

A do të shkojë një gjendje e tillë deri në një luftë të brendshme? Mundet edhe të shkojë, por pas një periudhe disavjeçare, pse kryengritjet ose orvatjet për kryengritje menjëherë pas vdekjes së Titos do të goditen ashpërsisht nga udhëheqja gjoja kolegjiale dhe nga ushtria nën pretekstin e mbrojtjes së Federatës dhe të kufijve të saj. Çdo lëvizje në këtë drejtim ata do ta konsiderojnë si një veprim subversiv të nxitur nga socialimperialistët dhe nga imperialistët, pra do t'i zënë në gojë që të dy, me qëllim që të ruajnë balancën e qëndrimeve të tyre politike «të paangazhuara».

Në këto situata neve na vihet si detyrë të ndjekim me vigjilencë zhvillimin e ngjarjeve në Jugosllavi pas Titos derisa atje të stabilizohet situata. Në periudhën e parë ne duhet të vërejmë tendencat centrifugale dhe koncentrike që do të zhvillohen në udhëheqjen kryesore të Federatës, domethënë qëndrimet e grupimeve të ndryshme të kombësive, të republikave dhe të krahinave të Jugosllavisë.

Unë mendoj se gjatë kësaj periudhe mbrojtja jonë duhet të jetë në gatishmëri pse situatat që do të krijohen mund të sjellin çdo gjë. Por mendoj se hëpërhë që në fillim nuk mund të krijohet një situatë që të vështirësojë gjendjen në Jugosllavi, e si pasojë edhe në Shqipëri. Sidoqoftë në kufirin me Jugosllavinë ne duhet të qëndrojmë të zgjuar, domethënë vigjilentë, pse mundet që në Kosovë disa shqiptarë që nuk e kuptojnë mirë zhvillimin e ngjarjeve të gabojnë në vlerësimin e tyre, ose vetë provokatorë serbomëdhenj të krijojnë brenda në krahinë situata të vështira e kështu t'u japin armë klaneve serbomëdha dhe kroatomëdha për t'i armiqësuar popujt e Jugosllavisë kundër shqiptarëve.

Në Kosovë, pra, mund të ketë edhe disa elementë të pafrenuar në «entuziazmin e tyre», të cilët të mendojnë se ka ardhur koha për veprime gjoja patriotike, mirëpo

veprime të tilla do të goditen nga udhëheqja e Federatës dhe s'është e pamundur që elementë të tillë të kërkojnë pastaj të vijnë në Shqipëri. Pikërisht këtu qëndron provokacioni i padëshirueshëm që mund të na shkaktojë vështirësi, jo ndonjë vështirësi të madhe, por situata të papëlqyera e të papajtueshme me qëndrimet tona të sotme, të cilat marrin parasysh rrezikun e madh kryesor që mund t'i vijë vendit tonë nga një sulm eventual kundër Jugosllavisë nga ana e forcave të Traktatit të Varshavës ose të ndonjë fuqie tjetër agresive. Në rast se Traktati i Varshavës vepron kundër Jugosllavisë me armë, atëherë shtrohet çështja çfarë do të bëjë NATO-ja. Do ta shikojë ajo një sulm të tillë duke lidhur duart apo duke bërë protesta me gojë e me shkrim kundër ndërhyrjes sovjetike në Jugosllavi ose luftës që në një rast të tillë do të zhvillohet midis sovjetikëve e jugosllavëve, apo do të ndërhyjë edhe ajo?

Qëndrimin tonë ne e kemi deklaruar. Ne do të luftojmë së toku me jugosllavët, në rast se ata sulmohen nga cilado anë që të jetë. Pra për politikën tonë të drejtë ka rëndësi që Jugosllavia të qëndrojë kështu siç reklamohet, domethënë se gjoja është e paangazhuar, as nga Lindja, as nga Perëndimi. Kjo sepse ne e dimë se qëndrimi aktual i Jugosllavisë është dhe anon nga imperializmi amerikan dhe nga vendet perëndimore, por ajo e zgjat dorën edhe nga Lindja.

Do ta lënë Jugosllavinë të qëndrojë në këto pozita «të paangazhuara»? Këtë do ta shohim. Por me siguri të tërë do të manovrojnë. Vetë jugosllavët, në radhë të parë, do të përpiqen të mbajnë ekuilibrin në kontradiktat e brendshme dhe në arenën ndërkombëtare në mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Perëndimi kapitalist do ta ndihmojnë Jugosllavinë që të qëndrojë në këto pozita pseudoasnjanëse, Bashkimi Sovjetik me fjalë do të kërkojë që Jugosllavia

të qëndrojë në këto pozita, por me fakte do të përpiqet që të organizojë subversionin serbomadh dhe ustashët kroatë. Me siguri një gjë të tillë do të bëjnë edhe perëndimorët. Në lidhje me të ardhmen e Jugosllavisë ekzistojnë, pra, kontradikta të jashtme dhe të brendshme, gjë të cilën ne lipset ta vëzhgojmë dhe të mbajmë qëndrime të përshtatshme me sigurimin e vendit tonë, me forcimin ekonomik dhe mbrojtjen e Republikës sonë, me forcimin e pozitave tona ndërkombëtare nëpërmjet një politike të zgjuar, të drejtë e të vendosur. Ne duhet të demaskojmë jo vetëm ato fenomene e zhvillime që do të kenë lidhje e do të influencojnë për ndryshime në Jugosllavi, në Greqi e gjetkë në Ballkan, por të themi fjalën tonë edhe për problemet e ndryshme aktuale ndërkombëtare, pse, siç po zhvillohen gjërat, ato marrin një rëndësi të jashtëzakonshme dhe po bëhen kërcënuese.

Edhe më parë situatat kanë qenë kërcënuese, por këto kërcënime dhe parapërgatitje të luftërave lokale apo të një lufte të përgjithshme po bëhen më të përcaktuara pas ngjarjeve në Iran dhe pas agresionit sovjetik kundër Afganistanit, domethënë pas pushtimit me tanke dhe me ushtri të këtij vendi nga ana e Bashkimit Sovjetik.

Siç e kam trajtuar edhe herë të tjera, Lindja e Mesme, pellgu i madh i naftës, sot është bërë një vatër zjarri në botë, është ajo pjesë e globit tokësor ku përplasen e ku përleshen interesat grabitqare politiko-ekonomiko-strategjike të fuqive të mëdha e në radhë të parë ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, pastaj edhe ato të Kinës e të vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore, të Japonisë etj. Këtu, në këtë pellg, po zhvillohen edhe kryengritjet e popujve, të cilët rrojnë nën shfrytëzimin e shtypjen e dyfishtë të shoqërive të mëdha shumëkombëshe të naftës dhe të klikave, të mbretërve, të sheikëve, të feudalëve, të emirëve dhe të borgjezisë kapitaliste vendase.

Problemi i energjetikës në botë, që lidhet edhe me prodhimin dhe me shpërndarjen e naftës, dhe që zë vendin e parë për sa i përket energjisë elektrike, është bërë shumë i mprehtë. Kjo ka shkaktuar thellimin e madh e të mëtejshëm të krizës së përgjithshme ekonomike botërore.

Rrëzimi i shahut natyrisht krijoi probleme të mëdha brenda dhe jashtë Iranit. Ana pozitive e kryengritjes së popullit iranian, pavarësisht se kush e udhëheq këtë kryengritje, është se çoi në rrëzimin e shahut, shërbëtor i imperializmit amerikan dhe rrezikoi akoma më tej furnizimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me naftë. Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara pësuan edhe një goditje tjetër të madhe politike, pse populli e studentët iranianë sulmuan dhe pushtuan ambasadën amerikane në Teheran, mbajnë akoma rob gjithë personelin e kësaj ambasade dhe kanë shtënë në dorë të gjitha dokumentet e ambasadës që vërtetojnë veprimet kriminale të CIA-s dhe të shahut.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga ngjarjet në Iran u përpoqën të shpëtonin pa plagë, qofshin ato ekonomike apo politike, prandaj kërcënuan me sulm të armatosur, dërguan dhe po mbajnë në afërsitë e Gjirit Persik dhe në Oqeanin Indian flotën e tyre luftarake. Presidenti Karter shpalli një numër masash ekonomike e masa të tjera që do të merrte si mjete presioni kundër Iranit. Në të vërtetë këto masa nuk qe e mundur të viheshin në zbatim dhe të kishin efektin e dëshiruar për autorët e tyre, por ato krijuan shkaqet që priste Bashkimi Sovjetik, i përgatitur me kohë për të ndërhyrë në Afganistan, ku kukullat që ai kishte sjellë në fuqi po viheshin në rrezik nga kryengritja «popullore» islamike. Them «popullore», sepse në të vërtetë populli afgan është ngritur kundër kukullave sovjetike, por lëvizja udhëhiqet nga kinezët, nga amerikanët, nga pakistanezët. Pikërisht nga kjo situatë e turbullt dhe nga kërcënimet e Karterit

kundrejt Iranit, siç thashë, përfituan sovjetikët për të futur tanket e veta në Afganistan.

Natyrisht ky agresion e ky pushtim, krijuan në botë një situatë të rrezikshme dhe e bënë Lindjen e Mesme një zonë shumë delikate ku superfuqitë u vunë afër e afër e në gjendjen e një lufte të ftohtë, e cila në çdo moment rrezikon të kthehet në një luftë të nxehtë.

Sidoqoftë imperializmi amerikan, pas veprimit të hapët agresiv të Bashkimit Sovjetik në Afganistan, i ka ulur ca pendët kundër Iranit, por kjo nuk do të thotë se ka hequr dorë nga manovrat dhe komplotet e brendshme, as nuk përjashton përpjekjet për të arritur me udhëheqjen aktuale iraniane disa kompromise, me qëllim që të evitojë zjarrin e luftës në pellgun e naftës. Megjithëkëtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbajnë luftanijet dhe kanë rritur numrin e forcave të këmbësorisë detare në këtë pellg, po forcojnë bazat ushtarake që kanë në Gjirin Persik, siç janë ato në Arabinë Saudite, në Emiratet e Bashkuara, në Oman dhe përpiqen të krijojnë baza të tjera në Somali, në Eritre dhe në Jemenin e Veriut për të kundërbalancuar pikat strategjike të rëndësishme që ka zënë socialimperializmi sovjetik në Jemenin e Jugut, në Etiopi e sidomos në Afganistan.

Në Afganistan sovjetikët gjetën rezistencë. Qeveritarët amerikanë e shfrytëzuan këtë në mënyrë të hapët, u morën vesh me udhëheqjen reaksionare të Pakistanit dhe deklaruan se do t'i japin, dhe i dhanë, ndihma ekonomike dhe ushtarake Pakistanit për t'u mbrojtur nga një sulm eventual sovjetik dhe për të financuar luftën guerile të afganëve.

Siç dihet në Islamabad u mbajt edhe mbledhja e vendeve myslimane. Atje u vendos që të gjithë popujt myslimanë ta ndihmojnë popullin afgan dhe të ashtuquajturin komitet që brenda në Afganistan drejton luftën kundër sovjetikëve. Në këto veprime e manovrime, subversive dhe të hapëta, merr pjesë edhe Kina, e cila ka deklaruar se ndihmon refugjatët afganë në Pakistan me armë e me municione, u jep edhe ndihma ekonomike. Pra mund të themi se rreth kufijve të Afganistanit, brenda të cilit janë vendosur forcat sovjetike, ka lindur një konfrontim i ri: nga njëra anë është ushtria sovjetike që lufton kundër kryengritësve afganë, nga ana tjetër janë Pakistani e Kina dhe pas tyre Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ndihmojnë kryengritësit. Pra në këtë zonë ekziston një ndeshje lokale e hapët midis sovjetikëve dhe afganëve dhe e maskuar midis sovjetikëve e amerikanëve në prapaskenë dhe zyrtarëve aktualë afganas e kinezëve po kështu në prapaskenë.

Në vendet e tjera të Lindjes së Mesme aktualisht ka, si me thënë, njëfarë statukuoje, në të cilën në të vërtetë vihet re një përpëlitje në pozitat e shteteve të ndryshme të vendeve të këtij pellgu në mbrojtje të revolucionit iranian e të popullit afgan, vihen re përpjekje për një lidhje më të hapur të disave me Bashkimin Sovjetik dhe të disa të tjerëve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me fjalë të tjera aleatët e Uashingtonit në këtë pellg të naftës përpiqen të konsolidojnë miqësinë e tyre në radhë të parë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga ana tjetër ta çojnë Iranin e Khomeinit në një ujdi me imperializmin amerikan. Sovjetikët, nga ana tjetër, përpiqen që Sirinë e Irakun të mos i lënë pas dore e të bëhen miq të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por të qëndrojnë «miq e dashamirës» të Bashkimit Sovjetik.

Kështu gjendja në botën arabe vazhdon të jetë ajo e mëparshmja, me një ndryshim që Egjipti dhe Izraeli vazhdojnë konsolidimin e aleancës dhe të miqësisë së tyre nën ombrellën amerikane, vazhdojnë ta ndjekin me vëmendje dhe me armiqësi lëvizjen popullore në Iran, vazhdojnë të gërthasin dhe të nxitin Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të marrin ndaj Bashkimit Sovjetik masa

akoma më shtrënguese nga ato të mosvajtjes në lojërat olimpike etj. Shohim, gjithashtu, se në Tunizinë e fjetur ka filluar ndërhyrja nga ana e Libisë së Kadafit, i cili dërgoi në qytetin Gafsa komandot e tij, bëri atje një katrahurë, e cila natyrisht u shtyp, por në arenën e kësaj zone solli një faktor tjetër, faktorin francez. Franca në fakt i dërgoi ndihmë ushtarake Tunizisë. Pra po duket akoma më qartë se Franca po përgatitet ushtarakisht për të mbrojtur shtetet frankofone të ashtuquajtura të pavarura dhe sovrane, ku kapitali francez ka interesa të mëdha shfrytëzuese. Pikërisht ajo e bën Francën të mos angazhohet në konfliktin amerikano-sovjetik dhe të mbajë qëndrime politike të kundërta me propozimet e Karterit si, për shembull, me propozimin për të mos shkuar në lojërat olimpike dhe me propozimin tjetër me shumë rëndësi për thirrjen e një mbledhjeje të ministrave të jashtëm të vendeve të Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të diskutuar agresionin sovjetik kundër Afganistanit dhe masat e propozuara nga Karteri. Edhe Gjermania Perëndimore nuk është bashkuar plotësisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këtë çështje.

Pra ne shohim se në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës e Gjermanisë ekzistojnë kontradikta për probleme të mëdha ndërkombëtare. Këto kontradikta vijnë për arsye se këto dy vende kapitaliste evropiane të zhvilluara me një industri të madhe kanë nevojë për naftën e Iranit dhe për naftën e vendeve anëtare të OPEK-ut, domethënë të vendeve të tjera të Lindjes së Mesme, të disa vendeve afrikane e të Venezuelës. Pra nuk dëshirojnë të futen në ingranazhin e turbullt të interesave amerikane, por dëshirojnë të qëndrojnë të veçuara nga veprimet e administratës së Karterit, me fjalë të tjera nuk duan të bëjnë lojën e CIA-s. Shohim, pra, se këto dy vende, Franca dhe Gjermania Perëndimore,

për të mbrojtur interesat e tyre jetike në çështjen e naftës, kërkojnë jo acarimin e situatave, por vazhdimin e «detantës» në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prandaj si Parisi, ashtu edhe Boni e dënuan hyrjen e forcave ushtarake sovjetike në Afganistan, por me zë të ulët, gjë që solli një kontradiktë në mes politikës amerikane dhe asaj të këtyre dy shteteve. Nga vendet e Evropës Perëndimore vetëm Anglia po tregohet një skifter më agresiv. Megjithëkëtë dhe ajo prapëseprapë, duke ndjekur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk harron të bëjë, ose të vazhdojë të bëjë politikën e saj të zigaresë, të peshojë dhe nga Perëndimi dhe nga Lindja, të ketë një sy edhe në Evropë, edhe në Amerikë, edhe në Bashkimin Sovjetik, edhe në Evropën Lindore.

Për sa u përket vendeve të Evropës Lindore, satelite të Bashkimit Sovjetik, ato u detyrohen vendeve perëndimore miliarda dollarë. Kjo bën që kapitalistët perëndimorë që kanë në këto anë interes të madh të mos i prishin punët me Bashkimin Sovjetik dhe me satelitët e tij. Pra fuqitë perëndimore kanë burime tregjesh në këto vende, bëjnë investime dhe prandaj dëshirojnë dhe punojnë që në mes tyre dhe Bashkimit Sovjetik të evitohet një acarim i mëtejshëm i marrëdhënieve ashtu siç po zhvillohet në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Politika e vendit tonë kundrejt të gjitha këtyre ngjarjeve dhe qëndrimeve politike në shkallë botërore është e drejtë. Ajo i analizon situatat dhe mban qëndrim në bazë të konkluzioneve që ne nxjerrim nga zhvillimi i ngjarjeve. Fakt është që qëndrimet tona politike, të shprehura në artikujt e në librat tanë, gjejnë jehonë të madhe në botë, pëlqehen dhe aprovohen. Diplomatë gati nga të gjitha kontinentet, me të cilët diplomatët tanë kanë kontakte, e afirmojnë këtë aprovim të politikës sonë duke

u shprehur me fjalë të mira e duke thënë se pavarësisht pse pikëpamjet tuaja (domethënë tonat) ideologjike janë në kundërshtim me pikëpamjet ideologjike tonat (domethënë të tyret), ne aprovojmë qëndrimet tuaja. E gjithë kjo për vendin tonë ka krijuar një situatë të favorshme në gjirin e masave të gjera të popujve ku arrin zëri i radios sonë dhe lexohen shtypi dhe literatura jonë.

Qëndrimet tona politike gjejnë po ashtu jehonë, sipas rastit e sipas koniunkturave, edhe në shumë qeveri borgjeze. Pse e them këtë? Sepse kur ne sulmojmë socialimperializmin sovjetik për aventurat e tij gjakatare, kur ne sulmojmë imperializmin amerikan për veprimet e tij agresive, ky qëndrim yni i drejtë aprovohet edhe nga qeveritarët e shumë shteteve që bëjnë pjesë në bllokun e NATO-s ose të vendeve të tjera të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine.

Ne konstatojmë se veçanërisht në Greqi, qoftë në qarqet qeveritare, qoftë në popull, midis intelektualëve dhe në opinionin e partive të ndryshme, politika jonë ka një hov të madh pozitiv. Gati të gjitha gazetat greke nuk lënë pa e vënë në dukje, bile me një bujë të jashtëzakonshme, asnjë eveniment politik, kulturor ose ideologjik të Partisë dhe vendit tonë, gjë kjo që ka krijuar një opinion shumë të favorshëm për vendin dhe për Qeverinë tonë në Greqi.

Qëndrimet tona dashamirëse për Greqinë, të deklaruara haptazi se asaj kurrë nuk do t'i vijë e keqja nga vendi ynë, bile do të ndihmohet në qoftë se i ngjet ndonjë fatkeqësi, nga ndonjë agresion nga çdo anë që të jetë, ka bërë që politika jonë të pëlqehet nga populli grek dhe të lavdërohet.

E njëjta gjë ngjet edhe në Turqi. Opinioni përparimtar turk dhe partia marksiste-leniniste turke, bëjnë një propagandë të madhe e të theksuar në favor të Shqipërisë. Edhe atje gati të gjitha gazetat shkruajnë pozitivisht për vendin tonë, zyrtarët turq, në bisedime me shokët e ambasadës sonë, flasin me simpati, bile shumë herë edhe me admirim për politikën e pavarur të shtetit tonë.

Tani në Turqi ka ardhur në fuqi Demireli, një grup ky më i djathtë se ai i Eçevitit dhe nga raportet e ambasadës sonë del se aktualisht po merren masa ndëshkimore kundër elementëve përparimtarë e të majtë. Natyrisht këto masa do të prekin edhe propagandën e favorshme që bëhet për vendin tonë nga komunistët marksistë-leninistë dhe nga elementët përparimtarë, por mund të themi se masa të tilla akoma nuk po duken ndaj politikës së drejtë të Partisë e të Qeverisë sonë.

Kurse Italia si kurdoherë mbetet një vend që e ka shikuar Shqipërinë socialiste me smirë armiqësore dhe zor që të shkëputet nga pozitat e saj të vjetra politike dhe ideologjike kundër vendit tonë.

Në Itali situata është jashtëzakonisht e turbullt, terrorizmi po përhapet në shkallë të gjerë dhe po parapërgatit ardhjen në fuqi të fashizmit. Partia fashiste italiane, që mban emrin «Movimento sociale italiano, destra nacionale» ka propozuar që Ministrinë e Brendshme ta marrin ushtarakët dhe të vendoset dënimi me vdekje. Ky është hapi tjetër që kërkon të bëjë reaksioni italian drejt vendosjes së fashizmit.

Sidoqoftë pushteti aktual në Itali është në një kaos të vazhdueshëm dhe nën presionin e një çorientimi të madh politik, të një degjenerimi moralo-politik, nën presionin e grabitjeve të mëdha dhe të terrorizmit të paparë ndonjëherë në vendet kapitaliste. Me Italinë ne vazhdojmë të kemi marrëdhënie tregtare dhe mund të themi se ato shtohen. Italianët janë të interesuar të blejnë nga ne mallra që kanë nevojë dhe të na shesin mallra që ne kemi nevojë. Në këtë drejtim mund të themi se është krijuar një situatë më e favorshme, por ajo është ko-

niunkturale, për arsye se politikisht Italia ka qenë dhe është në kundërshtim me rendin tonë socialist.

Në bazë të kësaj panorame të gjendjes ndërkombëtare, për ne në rend të ditës duhet të qëndrojë kurdoherë vigjilenca revolucionare dhe kjo vigjilencë revolucionare duhet të forcohet me ngritjen e mëtejshme politike dhe ideologjike të masave të gjera të popullit, e në radhë të parë të komunistëve. Kjo do të thotë që të shpjegohen sistematikisht dhe të kuptohen thellësisht nga të gjithë situatat nga ku kalojnë bota dhe vendi ynë, dhe duke pasur këtë parasysh, në të gjithë gamën duhet të forcohet mbrojtja e vendit. Me fjalë të tjera kjo do të thotë që parulla e Partisë sonë: «I gjithë populli ushtar», duhet të konkretizohet në jetë duke mos lejuar asnjë dobësi në disiplinën e stërvitjeve ushtarake të popullit dhe mungesa në kryerjen e detyrave për fortifikimet dhe për të gjitha problemet e tjera që i përkasin mbrojtjes.

Po ashtu të kuptohet mirë se këto situata lypin të realizohen planet ekonomike, me qëllim që të krijohen vazhdimisht rezerva për kohë të rrezikshme dhe mundësi të mira e të reja që niveli i jetesës së popullit tonë të ngrihet, pra, të luftojmë për ngritjen e mirëqenies së tij, duke e zhvilluar ekonominë tonë të shumanshme e të centralizuar dhe duke bërë edhe kursime. Këtë duhet ta bëjmë jo vetëm me masa administrative, por duke e ngritur ndërgjegjen e punonjësve që të mos prishet, të mos cenohet e të mos dëmtohet asgjë, përkundrazi të forcohet disiplina proletare në punë, të forcohet morali proletar në njerëzit dhe në shoqëri dhe t'u bëhet ballë me sukses të gjitha vështirësive që hasim brenda dhe në marrëdhëniet tregtare që kemi me shtetet e Lindjes dhe të Perëndimit.

E ENJTE
21 SHKURT 1980

«FRYMËZIMI» I FUNDIT I TITIZMIT NË PRAGUN E VDEKJES SË «BABAIT» TË TIJ

Këto ditë një ndër zëdhënësit kryesorë të titizmit, anëtari i Kryesisë së Komitetit Qendror të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, Aleksandër Grliçkov, foli në një aktiv të komunës Vozhdovac dhe u përpoq «të justifikojë» pozitat e errëta, revizioniste të kësaj «Lidhjeje» për disa çështje të gjendjes ndërkombëtare aktuale, si «detanta», «mosangazhimi», «bashkekzistenca paqësore», «socializmi vetadministrues» etj.

Nga përmbajtja e këtij fjalimi bien në sy shqetësimi dhe frika që i ka kapur titistët, në çastet kur Titoja është në agoni, për dështimin e politikës së tyre në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar, si dhe orvatjet për të maskuar me demagogji pasigurinë e tyre për të nesërmen.

Le t'u referohemi disa deklaratave që bëri Grliçkovi në Vozhdovac e që i transmetoi agjencia e lajmeve Tanjug.

Ai tha se bota «asnjëherë nuk ka qenë përballë rreziqeve kaq të mëdha, se asnjëherë nuk ka provuar kaq shumë të papritura dhe se asnjëherë nuk është gjendur para kaq shumë çështjeve të pazgjidhura... Mungesa e përgjigjeve të drejta për kontradiktat e sotme të botës edhe sot të çon deri në atë pikë saqë zgjidhja të kërkohet në luftërat e kufizuara, lokale, në luftërat e ashtuquaj-

tura të pakontrolluara». Por ai nuk u fut dhe nuk mund të futej në analizën e shkaqeve dhe të faktorëve realë që e kanë shkaktuar këtë gjendje, sepse ideologjia reaksionare që përfaqëson dhe mbron, e pengon ta kuptojë thelbin e luftës si vazhdim të politikës së klasave kundërshtare me mjete dhune.

Të konstatosh me kaq vonesë se kontradiktat e botës së sotme kanë çuar në luftëra lokale nuk është ndonjë punë e madhe. Këtë bota e ka mësuar prej kohësh. Proletariati, masat punonjëse, njerëzit revolucionarë e përparimtarë e dinë se, përderisa do të ekzistojnë kapitalizmi, imperializmi dhe socialimperializmi, do të ketë edhe luftëra grabitqare. Çështja është të shpjegohet se cila është rruga e zhdukjes së rreziqeve të luftës. Vetëm marksizëm-leninizmi është ai botëkuptim revolucionar i klasës punëtore që shpjegon shkencërisht se rrezikun e luftës e zhduk revolucioni me dhunë. Kjo ideologji shkencore sqaron mendjet e miliona njerëzve në botë dhe i armatos ata me idenë e aksionit revolucionar për përmbysjen e borgjezisë e të kapitalizmit dhe për vendosjen e socializmit e të diktaturës së proletariatit. Pikërisht këtyre ideve u shmanget me qëllim ky revizionist dhe manovron me termat e njohur të ideologëve borgjezë gjoja për të kritikuar sistemin botëror të marrëdhënieve aktuale ndërkombëtare.

Grliçkovi thotë se «mekanizmat e përputhjes së interesave të ndryshme për zgjidhjen e konflikteve janë bërë gjithnjë e më pak efikasë..., sa ky sistem marrëdhëniesh do të çahej nëpër të qepurat e tij». Tashmë dihet se sistemi i shtypjes e i shfrytëzimit do të përmbyset një ditë, po kush e ka marrë në mbrojtje gjer më sot këtë sistem të padrejtë dhe mekanizmat e ndryshëm për t'i zgjatur jetën kapitalizmit? Ka qenë dhe është pikërisht titizmi ajo ideologji antipunëtore dhe fund e krye kapitaliste që është munduar të mbulojë qepjen me pe

të bardhë të sistemit aktual kapitalist botëror dhe të përkrahë mekanizmin e përputhjeve dhe të puthjeve të interesave të shumëllojshme të shteteve të ndryshme kapitaliste, pra t'u zgjatë jetën sistemit kapitalist dhe shtypjes kapitaliste mbi masat punonjëse.

Grliçkovi ka shprehur pikëpamjen se strukturat e deritanishme botërore, siç i quan ai, qenkan krijuar për të përputhur gjoja interesat e ndryshme dhe për të ruajtur balancimin e paqen botërore(!). Por, duke qenë i bindur se këtë demagogji nuk do ta pranojë njeri, pse popujt e dinë që strukturat dhe organizmat e sotëm janë krijuar nga borgjezia për interesat e saj kundër lirisë dhe pavarësisë së popujve, është detyruar të pohojë se këto struktura «nuk janë të mjaftueshme të arrijnë këtë qëllim bile edhe kur bindja kombinohet me presione dhe me përdorimin e forcës» dhe pastaj ai vazhdon: «Në skenën botërore kanë dalë forca të reja shoqërore, të cilat kërkojnë ndryshimin me themel dhe tërësisht të marrëdhënieve ndërkombëtare të mbështetura në të drejta të barabarta».

Të studiuara me kujdes këto deklarata tregojnë pa shumë fjalë se politika titiste e «valles mbi litar» ka dështuar. Titistët, ashtu si revizionistët e tjerë, për të përligjur me çdo mënyrë qëndrimin e tyre proimperialist në mbrojtje të mekanizmave kapitalistë ekzistues, duan të thonë se ata i kanë përkrahur këta mekanizma të manipuluar nga superfuqitë, sepse paskan dashur të ruajnë paqen, por, meqenëse zhvillimi historik ka nxjerrë në skenë forca të reja shoqërore, ata tani na qenkan për marrëdhënie ndërkombëtare të mbështetura në të drejta të barabarta(!). Dhe tërë këtë arsyetim, ky zëdhënës i titizmit e bën për të mbrojtur «detantën», e cila, sipas tij, vërtet ndodhet në krizë, por ideja e përgjithshme e saj nuk e paska marrë goditjen vendimtare.

Shpresat për «marrëdhënie ndërkombëtare, të mbë-

shtetura në të drejta të barabarta» ky «teoricien» i var te «detanta» dhe jo te revolucioni, të cilin e ka frikë si vdekjen, prandaj dhe bën thirrje për «detantën», e cila «do të siguronte paqen dhe bashkekzistencën paqësore... do të çlironte edhe forcat, të cilat luftojnë për pavarësinë kombëtare, transformimin shoqëror dhe socializmin». E tërë kjo teori revizioniste për të zëvendësuar revolucionin me «detantën», nuk është asgjë tjetër, veçse një thirrje drejtuar kapitalistëve, imperialistëve, pra, borgjezisë kapitaliste që të ulë tensionin për të shpëtuar nga revolucioni. Kjo gjë është e qartë si drita e diellit.

Dihet se në të gjitha rendet shoqërore, ku sundojnë marrëdhëniet ekonomike shfrytëzuese, tipike janë kontradiktat antagoniste. Metodat kryesore për zgjidhjen e këtyre kontradiktave janë lufta klasore revolucionare dhe revolucioni shoqëror, por asnjëherë nuk kanë qenë dhe nuk mund të jenë paqja shoqërore mikroborgjeze dhe bashkekzistenca paqësore revizioniste.

Duke u ndeshur në faktin se, me gjithë thirrjet për ruajtjen e «detantës», tensioni në marrëdhëniet ndërkombëtare po ngrihet dita-ditës, Grliçkovi, për t'u treguar gjoja realist, pranon se vetëm «detanta bipolare», domethënë ulja e tensionit në marrëdhëniet që manipulohen nga të dyja superfuqitë, imperializmi amerikan dhe ai sovjetik, ka pësuar krizë. Dhe sa për t'u bërë qejfin Evropës së Bashkuar, Kinës dhe Japonisë, që aspirojnë të përfshihen në lojën e të mëdhenjve, ai shprehet se për jugosllavët një «detantë multipolare» «do të ishte më dialektike nga ajo e vjetra bipolare», sepse kështu «ndoshta do të shpreheshin dhe do të përputheshin më shumë interesa, do të kishte një bazë më të gjerë»(!).

Megjithëse nuk janë plotësisht dakord me «detantën multipolare», revizionistët jugosllavë e pranojnë këtë më me qejf edhe për arsye se ajo është më afër teorisë së tyre të «mosangazhimit». «Detanta», që do ta dëshironin

Grliçkovët, është ajo që ata e quajnë «detantë universale», që, sipas tyre, do të çoka në marrëdhënie «të qëndrueshme» në botë, pra në «paqen qiellore», në «paqen kristiane», në «zhdukjen» e kontradiktave me një të rënë të shkopit, siç predikon në thelb politika e «mosangazhimit». Këto ide metafizike e çojnë revizionistin jugosllav në arsyetimin banal që ai e përmbledh me këto fjalë: «Vetvetiu del konkluzioni se kontradiktat dhe ndryshimet në interesa, si dhe përcaktimi i interesave të përbashkëta mund të zgjidhen vetëm me pjesëmarrjen me të drejta të barabarta dhe në mënyrë të pandarë të të gjithë popujve»(!). Po si mund të arrihet barazia e popujve në marrëdhëniet ndërkombëtare, pa revolucion?! Duke vijuar logjikën e revizionistit, përgjigjja do të ishte: «Me frymën e shenjtë! Amin»!

Në vazhdim të së ashtuquajturës kritikë kundër «bipolarizmit» të fuqive të mëdha, Grliçkovi thotë se ato, pra, superfuqitë, «do të ishin më pak realiste në qoftë se zgjidhjet e çështjeve më pluraliste se asnjëherë tjetër dhe, në të njëjtën kohë, më vendimtare për fatet e botës, do të përpiqeshin t'i vendosnin në vizionin dhe në kuadrin e bipolarizmit». Sido që qëndrimi i tij kundërshtues ndaj «bipolarizmit» është tepër i matur, prapë del qartë se, edhe me këto që thuhen, «bipolaristët» s'qenkan treguar «të arsyeshëm», siç janë paraqitur gjer më sot nga revizionistët.

Duke folur për «bipolarizmin» në marrëdhëniet ndërkombëtare, Grliçkovi merr nëpër gojë Konferencën e Jaltës sikur kjo paska nxitur konflikte të reja luftërash dhe një përhapje të re të potencialeve ushtarake! Revizionisti, për qëllime aspak të ndershme, identifikon Konferencën e Jaltës me veprimet e imperializmit amerikan në bllokun e NATO-s dhe të socialimperializmit sovjetik në Traktatin e Varshavës. Ai ngatërron me dashje natyrën agresive dhe luftënxitëse të kapitalizmit botëror me marrëveshjen

që u arrit në shkurt të vitit 1945 nga kryetarët e shteteve të Bashkimit Sovjetik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Anglisë për kapitullimin pa kushte të Gjermanisë hitleriane dhe çmilitarizimin e saj, për krijimin e OKB-së etj.

«Koncepti i blloqeve dhe ai bipolar mbi detantën dhe balancimin botëror jo vetëm janë të pamjaftueshëm për mbajtjen e paqes, por gjithnjë e më shumë po bëhen burim të konflikteve të reja» deklaroi Grliçkovi në Vozhdovac, duke dashur të krijojë përshtypjen sikur tha ndonjë gjë të re. Edhe kjo është një manovër e hollë që synon të mbulojë politikën proimperialiste të Jugosllavisë titiste, sepse dihet që «detanta» dhe paqja nuk janë ruajtur e nuk do të ruhen nga superfuqitë dhe nga kapitalizmi botëror, një variant i të cilit është edhe vetadministrimi jugosllav. Janë pikërisht këta revizionistë që kanë ushqyer iluzionet më të çuditshme për ruajtjen e «detantës» nga fuqitë e mëdha dhe që sot, kur kanë rënë keq dhe e ndiejnë veten ngushtë, përpiqen të prezantohen sikur janë realistë në politikë dhe po zbulojnë të fshehtat e botës!

Revizionistët jugosllavë nuk mund të mos e shikojnë sot rivalitetin e superfuqive dhe mosbesimin që ekziston në marrëdhëniet midis tyre, prandaj dhe Grliçkovi tha se çdo marrëveshje midis superfuqive «është vetëm pranim i barazimit momental në potencialet e tyre, një pushim i shkurtër, i cili krijon fazën e re të rivalitetit». Veza e Kolombit të Grliçkovit! Po kush tjetër, vallë, përveç socialdemokratëve, titistëve dhe revizionistëve të tjerë, e ka ushqyer gjer më sot besimin ndaj ujqve kapitalistë? Popujt e botës, klasa punëtore dhe marksistë-leninistët e vërtetë nuk kanë harruar asnjëherë se midis shteteve imperialiste nuk mund të ekzistojë kurrë atmosfera e besimit reciprok. Në koniunktura të caktuara po, superfuqitë mund të merren vesh, bile mund të hyjnë

edhe në aleanca kundër të tjerëve për të mbrojtur interesat e veta, por prapë ato, nga natyra e tyre agresive, do të veprojnë hapur dhe fshehur kundër njëra-tjetrës. Kjo është dialektika e marrëdhënieve midis kapitalistëve.

Grliçkovi tha gjithashtu se pjesa më e madhe e vendeve, duke përfshirë këtu edhe një pjesë të mirë të vendeve që u përkasin këtyre blloqeve, mbrojtjen e tyre nuk e kërkojnë nën ombrellën e blloqeve. Në të vërtetë nuk është kështu. Pjesëmarrësit në blloqe ushtarake, ashtu si edhe padronët e tyre, po armatosen çdo ditë për t'i ngrënë kokën njëri-tjetrit. Superfuqitë po përpiqen të shtojnë sferat e ndikimit, duke përdorur si justifikim rrezikun e agresionit të rivalit. Të pretendosh dobësimin e blloqeve ushtarake për të mbrojtur bashkekzistencën paqësore dhe OKB-në, siç bën ky anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendror të së ashtuquajturës Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, do të thotë t'i bësh shërbim të keq botës të mbarsur me shumë rreziqe e të mbushur me vatra të nxehta tensioni.

«Paqja dhe bashkekzistenca paqësore janë bërë më shumë se asnjëherë më parë një koncept i pandarë» deklaroi Grliçkovi. Për të argumentuar tezën e paqes dhe të bashkekzistencës paqësore si një «fakt historik», ai deklaron se këto janë shprehur në parimet e OKB-së. Ky «argument» ka po atë vlerë sa ka aktualisht edhe parulla e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës: «*Liberté, egalité, fraternité*»[1]. Për sa u përket revizionistëve jugosllavë, paqja dhe bashkekzistenca paqësore revizioniste vërtet janë bërë të pandara, por të pandara nga kreditë, nga dollarët dhe nga monedhat e tjera që ata marrin nga të katër anët si shpërblim për veprimtarinë e urryer që zhvillojnë në dëm të lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit të popujve.

1 Frëngjisht — Liri, barazi, vëllazërim.

Për sa i përket OKB-së, Grliçkovi thotë se ajo nuk ka dhënë përgjigje për të gjitha çështjet e botës së sotme, megjithëkëtë «është ajo së cilës i përket më tepër nga të gjithë t'i kërkojë ato dhe është më e afta t'i gjejë ato». Pallavra! OKB-ja ka disa dekada që është krijuar, por asgjë me rëndësi s'ka zgjidhur dhe asgjë nuk mund të zgjidhë. Të drejtat, liritë, pavarësinë dhe sovranitetin e shteteve të botës asnjëherë nuk i ka mbrojtur OKB-ja. Ç'bëri kjo organizatë kundër agresionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Vietnam e në vende të tjera? Ç'bëri për agresionin e Bashkimit Sovjetik revizionist kundër Çekosllovakisë më 1968 dhe aktualisht kundër Afganistanit? Asgjë. Përkundrazi shpeshherë flamuri i OKB-së është ngritur për të mbrojtur agresionet e superfuqive dhe për të shtypur viktimat e këtyre agresioneve. Vetëm lufta revolucionare, vetëm revolucioni dhe marksizëm-leninizmi mund të japin të vetmet përgjigje të sakta për zgjidhjen e kontradiktave të thella të botës së sotme. Më kot revizionistët jugosllavë i kërkojnë këto zgjidhje nga një organizatë, e cila ka kohë që është kthyer në një instrument që manipulohet nga superfuqitë.

Gjithë këto arsyetime banale për «detantën» dhe OKB-në, Grliçkovi i përdor për të dalë atje ku atij dhe shokëve të vet u djeg më tepër: te teoria e famshme dhe e qelbur e «mosangazhimit». Pikërisht këtu fle lepuri titist. Por «lëvizja e mosangazhimit», që s'është tjetër veçse lëvizje e angazhimit total me kapitalizmin, ka falimentuar. Asaj, ashtu sikurse shpikësve dhe mbrojtësve të vet, i ka dalë boja. Kjo e ashtuquajtur lëvizje që është sajuar për t'iu kundërvënë revolucionit, është katandisur si mos më keq. «Lëvizja e mosangazhimit», sipas Grliçkovit, na qenka mohimi i «detantës bipolare» dhe «multipolare», ajo qenka shprehje e «detantës universale»(!). Me shprehje të tilla bombastike, me «zbulime» të tilla

sensacionale si «detantë universale», titistët kujtojnë se të tjerët do t'i çmojnë si njerëz që nxjerrin nga goja fjalë ari.

Duke e dredhur dhe duke e përdredhur gjykimin se gjoja një pjesë e kontradiktave të sotme në gjirin e «të paangazhuarve» janë pjellë e koncepteve «bipolare» e «multipolare» dhe jo të natyrës së rendit kapitalist, revizionisti Grliçkov kërkon t'u mbushë mendjen njerëzve që t'u besojnë koncepteve «universale», me të cilat ai kupton konceptin jugosllav mbi «mosangazhimin». Kontradiktat antagoniste në radhët e «të paangazhuarve» ai nuk i sheh në papajtueshmërinë e interesave të klasave, të grupeve dhe të forcave shoqërore, që janë në armiqësi të hapët me njëra-tjetrën dhe, për rrjedhim edhe rrugën e zgjidhjes së këtyre kontradiktave, nuk e gjen në luftën klasore revolucionare dhe në revolucionin shoqëror, por në konceptin e «mosangazhimit» si «shprehje dhe bartës i detantës universale»(!).

«Për të evituar» këto kontradikta, ai u rekomandon «të paangazhuarve» «mbrojtjen e parimeve themelore të universalitetit të problemeve botërore dhe të demokratizimit të plotë të zgjidhjes së tyre»(!). Për një njeri që e njeh sadopak dialektikën materialiste, nuk do të ishte aspak e zorshme të kuptonte absurditetin e këtyre gjykimeve të revizionistëve jugosllavë. Megjithëse këta revizionistë «mohojnë» «bipolarizmin», duke i kundërvënë «detantën universale», imperialistët e socialimperialistët nuk i janë trembur kurrë këtij «universaliteti» të «të paangazhuarve», por e kanë përkrahur, e kanë ushqyer dhe e kanë mbajtur gjallë, duke mos i kursyer as dollarët, as rublat apo monedha të tjera.

Grliçkovi, duke bërë poza prej megalomani, ka marrë përsipër t'i shpjegojë botës edhe se si mund të parandalohen të papriturat. Çelësin magjik të kësaj zgjidhjeje ai e ka gjetur te «kthimi në detantë si e vetmja

rrugëdalje e mundshme», sepse shton ai, «përveç detantës, në fakt, nuk ka alternativë tjetër». Po revolucionin, si proces të kalimit nga një rend i vjetër në një rend të ri shoqëror, të cilin e rekomandojnë si të vetmen rrugëdalje klasikët e marksizëm-leninizmit, ku e lë ai? Për këtë nuk bëjnë fjalë «revolucionarët» e kallëpit të Titos dhe këlyshët e tij. Ata bëjnë thirrje për bisedime në kuadrin e «detantës», por, që të kenë jetë të gjatë marrëveshjet, thotë Grliçkovi, duhet që këto të mos mbeten çështje të teknikës diplomatike(!). Duke dëgjuar këto llafe, padashur lind pyetja: Si është e mundur që tani jugosllavët e trajtojnë si të pamjaftueshme «teknikën diplomatike», kur e tërë ideologjia dhe politika titiste nuk ka qenë dhe nuk është tjetër veçse një «teknikë e diplomacisë» e varur nga diplomacia e kapitalizmit botëror?! Këto janë pehlivanllëqe politike në orvatje për t'iu përshtatur kohës.

Funksionari i lartë titist, duke folur diku për revolucionin thotë se sot në botë, në të njëjtën kohë, po vazhdojnë tri revolucione: nacionalçlirimtar, shoqëror dhe teknologjik. Titizmi na nxori kështu tri revolucione që zhvillohen në «paqe», urtë e butë, pa ua prishur terezinë sundimtarëve kapitalistë, borgjezisë kapitaliste. Në të vërtetë titistët, sido që i zënë në gojë shkarazi luftërat nacionalçlirimtare, janë haptazi kundër tyre, ndërsa revolucionin proletar ata e «harrojnë», as që e zënë në gojë. Grliçkovi thotë: «Paqja e ruajtur me dhunën nacionale, dhunën klasore ose dominimin ekonomik, në radhë të parë, do të ishte paqe antihistorike dhe më pas si «e imponuar»». Sipas tyre del se revolucioni proletar qenka demoduar, sepse proletariati, nën udhëheqjen e komunistëve, duke bërë revolucionin për përmbysjen e borgjezisë, përdor dhunën e vet klasore kundër dhunës së borgjezisë, pra, prish «paqen klasore». Kjo logjikë e tyre të çon në përfundimin që për hir të paqes, më mirë le të

durohet shtypja, pa çka se Karl Marksi, duke e parë luftën e klasave si forcë kryesore lëvizëse të zhvillimit të shoqërisë së ndarë në klasa antagoniste, ka argumentuar shkencërisht pashmangshmërinë dhe ligjshmërinë e zëvendësimit të mënyrave të prodhimit dhe vdekjen e pashmangshme të kapitalizmit; pa çka se Vladimir Iliç Lenini ka theksuar se shkatërrimi i makinës shtetërore borgjeze është një domosdoshmëri historike.

Duke folur më tej për tri revolucionet, ashtu si i përfytyrojnë ato titistët, në fjalimin e revizionistit Grliçkov thuhet: «Revolucioni shoqëror paraqitet si monopol i një blloku... Revolucioni teknologjik manipulohet në interes të bllokut të dytë. Çlirimeve kombëtare përpiqen t'u ngjitin etiketa lindore ose perëndimore...». Me këto fjalë ai do të thotë se revolucionin shoqëror dhe kombëtar e ka monopolizuar Bashkimi Sovjetik, revolucionin teknologjik e kanë monopolizuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse titizmit i mbetet ta shkatërrojë këtë skemë me «mosangazhimin» dhe vetadministrimin, që t'u hapë rrugën «sigurimit të paqes në përparim dhe përparimit në paqe»! Këto fraza (për të cilat me sa duket titistët e kanë vrarë shumë mendjen për t'i gjetur) janë thurur që të ndërtohet «teoria e krimbur» ala titiste, me qëllim që revolucioni të mos bëhet kurrë.

Rrethi i «teorizimit» titist mbi revolucionin dhe socializmin mbyllet, duke thënë: «Vetëm detanta universale, me pjesëmarrjen e të gjithëve, mund të sigurojë një paqe të tillë të përgjithshme, që i nevojitet përparimit të shumëllojshëm, gjë që për ne do të thotë socializëm»(!).

Përveç sa u tha për revolucionin, titistët, duke vazhduar me konsekuencë politikën e tyre kundërrevolucionare edhe socializmin e konceptojnë jo si një rend shoqëror që vendoset me revolucionin proletar, me përmbysjen e sundimit të borgjezisë dhe me vendosjen e diktaturës së proletariatit, ku baza e marrëdhënieve në pro-

dhim është prona kolektive e mjeteve të prodhimit, por si një «sistem paqeje të përgjithshme dhe përparimi të shumëllojshëm!». Përkufizime të tilla mbi socializmin mund të jenë gjithçka, por marksiste kurrë. Këto qëndrime nuk na çuditin aspak, se nga ata që i kanë vënë vetes për detyrë të minojnë revolucionin dhe socializmin nuk mund të presësh gjë tjetër, veçse demagogji pa fre për të mashtruar naivët dhe për të kënaqur armiqtë e komunizmit.

Kështu mund të shpjegohet edhe qëndrimi që mbahet në fjalimin e Grliçkovit dhe të udhëheqësve të tjerë titistë kur thuhet: «Në terrenin e transformimeve shoqërore dhe të revolucioneve... është kapërcyer sistemi i monocentrizmit ideologjik dhe politik. Ai është bërë faktor kufizues në zgjerimin e socializmit si proces botëror. Forca, forma dhe manifestime socialiste ka gjithnjë e më shumë». Sipas titistëve mund të ketë aq lloj socializmash në botë, sa mund të jenë edhe vendet që e quajnë veten socialiste. Kjo do të thotë se teoria marksiste-leniniste nuk qenka e vetmja doktrinë shkencore në bazë të parimeve universale të së cilës çdo vend mund të bëjë revolucionin dhe të ndërtojë socializmin në kushtet e veta. Përkundrazi cilido që pretendon se është vend socialist, sipas revizionistëve jugosllavë, mund të quhet i tillë, pavarësisht se atje sundojnë borgjezët ose feudalët dhe kjo qenka kështu, sepse çdo vend e ndërtoka socializmin sipas kuptimit dhe mënyrës së vet, qoftë kjo shoqëri krejt ndryshe nga ajo që në të vërtetë është socialiste.

Socializmin e vërtetë shkencor zyrtari titist e quan «formë të kufizuar të socializmit në botë», sepse ligjet e përgjithshme të marksizëm-leninizmit, në bazë të të cilave ai ndërtohet, sipas tij s'janë orientime shkencore që duhet t'i ketë parasysh çdo revolucion socialist, por «kufizime të konceptit të zhvillimit të socializmit në botë». Këtu, natyrisht, ai atakon ndërtimin tonë socialist,

që, me keqdashje, e barazon me shoqërinë e sotme revizioniste sovjetike.

Grliçkovi, duke atakuar socializmin shkencor, kërkon të përligjë si të mundet dhe sa të mundet «mosangazhimin», vetadministrimin dhe «socializmin» titist, prandaj në fjalën e tij vë në dukje: «Kemi parë nëpërmjet mosangazhimit rëndësinë e universalitetit të detantës. Kemi theksuar rëndësinë e rendit të ri politik dhe ekonomik ndërkombëtar. Perspektivën e socializmit e kemi gjetur në rrugët e pavarura të zhvillimit socialist, pushtetin e klasës punëtore e kemi afirmuar me vetadministrimin».

Këto deklarata pohojnë se revizionistët jugosllavë i janë kundërvënë hapur marksizëm-leninizmit. Largimin e tyre nga ky botëkuptim revolucionar i klasës punëtore komunistët dhe proletariati kurdoherë e kanë quajtur tradhti. Sajimet titiste «mosangazhim», vetadministrim etj., etj., Partia jonë i ka demaskuar me kohë në mënyrë të qartë, të plotë dhe bindëse. Ne shpeshherë i kemi trajtuar këto probleme dhe kemi vënë në dukje rrezikshmërinë e tyre, duke ngritur zërin për nevojën e një lufte të vazhdueshme parimore kundër revizionizmit jugosllav.

Duke e ndier pozitën e vështirë të mëparshme dhe të tanishme, si dhe peshën e demaskimit të rëndë të koncepteve revizioniste të teorisë dhe të praktikës së tyre në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar, si dhe duke dashur të fitojë bekimin e Titos në pragun e vdekjes, bashkëpunëtori i tij Grliçkov shprehet: «Në botë nuk mund të them se i pranojnë zgjidhjet tona, sepse edhe ne nuk kemi përgjigje për të gjitha pyetjet, por gjithnjë e më shumë ato i kërkojnë në drejtimin që kemi përcaktuar ne, të cilin e ka përcaktuar Tito». Gjer më sot asnjë marksist-leninist i vërtetë, asnjë proletar dhe njeri i ndershëm në botë, përveç demagogjisë e mashtrimit, përveç cinizmit e poshtërsisë nuk ka gjetur gjë tjetër

në teorinë e vetadministrimit jugosllav. Ata që kërkojnë përgjigje për zgjidhjen e problemeve nga jugosllavët mund të jenë kinezët dhe të tjerë renegatë të marksizëm-leninizmit, që janë revizionistë jo më pak se titistët.

Është fakt se gjendja e rëndë shëndetësore e Titos i ka shqetësuar bashkëpunëtorët e tij, të cilët e kanë të vështirë të vazhdojnë rrugën pa krye ku ishin futur bashkë me mësuesin e tyre. Tani brenda dhe jashtë Jugosllavisë është e natyrshme të diskutohet se ç'do të ndodhë me Federatën e Jugosllavisë pas Titos. Parashikimet janë nga më të ndryshmet, por midis tyre është zor të gjesh gjykime optimiste. Kur diçka bie erë, ambienti patjetër do të reagojë për mirë ose për keq. Ndaj aromës shprehet kënaqësi, ndaj erës së keqe neveri. Megjithëkëtë Grliçkovi, duke iu referuar komenteve që bëhen, letrave e telegrameve protokollare që i dërgohen kryetarit të shtetit për sëmundjen e rëndë të tij, i interpretoi ato me pompë. Ai bile arriti deri aty sa të thotë se «gjendja shëndetësore e shokut Tito shkaktoi edhe referendumin ndërkombëtar si për prestigjin e tij në botë, ashtu edhe për drejtësinë e politikës së jashtme të Jugosllavisë»(!). Këto fjalë në aktivin e Vozhdovacit tingëllojnë si ngushëllim jo vetëm për vdekjen e Titos, por edhe për ndyrësinë e veprës që ai lë pas, pasojat e së cilës do t'i vuajnë për shumë kohë popujt e Jugosllavisë.

«Energjia që disponojmë në luftën për zhvillimin tonë me sukses, tha Grliçkovi, është e pashtershme». Këtë zhvillim me «sukses» në Jugosllavinë kapitaliste të mbytur në borxhe dhe të shitur te fuqitë e mëdha, me siguri nuk e përfytyron dot as vetë ai që pohon një konkluzion të tillë, por s'ka se ç'të bëjë, ia do puna të flasë në këtë mënyrë, sepse për këtë gjendje kaotike, ku është katandisur Jugosllavia, ka edhe ai përgjegjësinë e tij. Grliçkovi u betua në aktiv se e ashtuquajtura Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë me politikën e saj «vazhdimisht ka thënë

të vërtetën» dhe shtoi se «e vërteta është aleati ynë më i madh në luftën për zhvillimin dhe kapërcimin e të gjitha vështirësive të brendshme dhe të jashtme»(!). Sa cinike janë këto fjalë në gojën e revizionistëve! E vërteta e tyre është e hidhur, ajo tregon tragjedinë e politikës që mbështetet në gënjeshtrën dhe në hipokrizinë e pafund. Këtë gjë e ka provuar historia në mënyrë të pakundërshtueshme.

Mosaprovimin e socializmit fals dhe vetadministrimit titist, nga ana e popujve të Jugosllavisë dhe të proletariatit botëror, Aleksandër Grliçkov e interpreton si presion të brendshëm dhe të jashtëm të atyre që nuk janë dakord me ta dhe e mbyll fjalën e tij, duke thënë se «gjendja shpirtërore dhe optimizmi i të gjithë neve ndaj së ardhmes sonë, e cila nuk do të jetë pa vështirësi dhe pengesa dhe as pa sulme nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm, buron nga besimi... i ecjes së socializmit drejt demokracisë dhe i demokracisë drejt socializmit». Me kaq e mbylli revizionisti Grliçkov fjalimin e tij të zymtë në pragun e vdekjes së Titos. Kjo është një *De profundis* i papohuar, por evident dhe tingëllues.

Sido që titistë në këtë fjalim bën përpjekje të mëdha, ai nuk ka mundur t'ia arrijë qëllimit për të fshehur atë brengë dërrmuese që shqetëson sunduesit e sotëm të Jugosllavisë, faktin që Federata e tyre ka marrë të çara, është zhytur në borxhe dhe shkon drejt falimentimit të plotë. Revolucioni është e ardhmja e popujve luftarakë të Jugosllavisë, ai do t'i fshijë nga faqja e dheut titistët dhe gjithë revizionistët. Sot ose nesër revolucioni do të shpërthejë. Për këtë domosdoshmëri historike ne, komunistët, jemi të bindur.

E ENJTE
28 SHKURT 1980

MENDIME MBI INTERVISTËN E ZBIGNJEV BRZEZHINSKIT, NDIHMËS I PRESIDENTIT KARTER PËR ÇËSHTJEN E SIGURIMIT KOMBËTAR

Brzezhinski në një intervistë që i ka dhënë revistës amerikane «Junajtid Stejts Njuz end Uërlld Riport» të 7 janarit të këtij viti, pohon në mënyrë të hapët se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një forcë agresive koloniale e tipit të ri, por edhe se ato ndodhen përballë dy sfidave kryesore: «Sfida e parë është ndaj pozitës së tyre gjeostrategjike në botë, dhe e dyta ka të bëjë me marrëdhëniet e tyre me dy të tretat e botës, që gjatë dy dekadave të fundit kanë pësuar papritur një zgjim të ndërgjegjes së tyre politike». Me fjalë të tjera kjo do të thotë se pozita e imperializmit amerikan në këto vende është tronditur e po sfidohet, ose se «dy të tretat e botës» po luftojnë kundër zgjedhës së imperializmit amerikan.

Zëdhënësi i skllavëruesve amerikanë pohon në këtë intervistë se shteti i tij, që aspiron për hegjemoni botërore, kërcënohet nga një rival potencial dhe ky rival është Bashkimi Sovjetik, i cili gjithashtu aspiron për hegjemoni botërore. Përveç kësaj Brzezhinski është i detyruar të pranojë se dalja papritur e vendeve të Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine në skenën botërore ka ndikuar për të lëkundur statukuonë aq shumë të dëshiruar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo, sipas tij, do të thotë «fundi i periudhës eurocentrike në problemet botërore».

Për Brzezhinskin Irani, ku interesat e mëdha neokolonialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë rrezikuar fort, hyn në këtë sferë shqetësuese për to. Ky shqetësim, ose dezekuilibër, u shkaktua ngaqë politika amerikane në këtë vend e në arenën ndërkombëtare nuk ka qenë aktive(!). Kështu thotë ai, por në fakt e kundërta është e vërtetë. Politika dominuese, shtypëse dhe shfrytëzuese, deri edhe me luftëra të armatosura, siç ndodhi në Vietnam e gjetkë, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë rajon të botës e në arenën ndërkombëtare ka qenë vazhdimisht aktive. Pikërisht veprimet barbare dominuese, shtypëse e shfrytëzuese të imperializmit amerikan shkaktuan kundërshtimin e popujve të sulmuar ose të shfrytëzuar prej tij e që Brzezhinski i fut në dy të tretat e botës që paskan pësuar «papritur një zgjim të ndërgjegjes së tyre politike»! Tani Brzezhinski në intervistën e tij thotë se «ne (domethënë Shtetet e Bashkuara) duhet të bëjmë më shumë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e marrëdhënieve më kuptimplote me ato vende që», sipas këtij shërbëtori e mbrojtësi të tërbuar të imperializmit amerikan, «deri tani nuk kanë qenë aktive në arenën ndërkombëtare». Kjo do të thotë që imperializmi amerikan, dhe konkretisht qeveria aktuale amerikane, duhet të rishikojë taktikat, pa ndryshuar strategjinë. Brzezhinski shprehet tekstualisht kështu në intervistën e tij: «Shpresoj se angazhimi gjithnjë e më i madh ndaj një politike të përkrahjes për t'i bërë ballë në mënyrë konstruktive një bote tërësisht të re» do të bëjë që «zemërimi të pakësohet», që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe politika e tyre agresive të jenë më të pranueshme nga popujt(!).

Kjo do të thotë, siç e shpjegon vetë Brzezhinski, se strategjia amerikane do të vazhdojë me «rritjen e fuqisë amerikane» nëpërmjet shtimit të armatimeve sa më të sofistikuara, të rritjes së fuqisë së saj ekonomike, të ruajtjes

dhe vazhdimit të politikës së nënshtrimit nën një kontroll të shumëfishtë ekonomik, politik dhe ushtarak prej saj të zonave të influencës, por duke manovruar me taktikën e njohur demagogjike të ofrimit të «karotës dhe të shkopit» «për të ulur zemërimin» e popujve si në Iran e gjetiu.

Në këtë intervistë, duke iu referuar krizës iraniane e ngjarjeve të mëvonshme, Brzezhinski pohon se politika e forcës dhe e ndërhyrjes së armatosur qëndron e palëvizshme. Ja si e shpreh këtë politikë ky zëdhënës i imperializmit amerikan: «...Nuk kam asnjë dyshim se përdorimi i fuqisë amerikane dhe gatishmëria e presidentit për ta përdorur atë në rast nevoje, nuk janë konsiderata të parëndësishme qoftë për vendin tonë, qoftë për vendet e palës tjetër». Këtu cinizmi amerikan, me të cilin trajtohet politika «antidemokratike», mbrojtja e «sovranitetit të popujve», mbrojtja e «të drejtave të njeriut», aq shumë të trumbetuara nga Karteri, është krejt i dukshëm. Haptazi popujt e botës kërcënohen me goditje nga «forca amerikane», në rast se prekin interesat e Shteteve të Bashkuara dhe zonat e influencës së dollarit të vendosura gjithashtu me anë të forcës në rajone të ndryshme të botës.

Në mënyrën më të qartë, makiavelike, ndihmësi i Karterit për çështjet e sigurimit kombëtar amerikan, domethënë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në zonat e tyre të influencës në kontinente të ndryshme, thotë se në këto zona të botës «forca amerikane është burimi qendror i stabilitetit që ekziston» dhe më poshtë shton se «ato vende që përkrahin politikën e moderuar (domethënë nuk cenojnë interesat amerikane)... janë të ndërgjegjshme për fatin e sigurimit të tyre të jashtëm dhe, si rrjedhim, edhe sigurimi i tyre i brendshëm varet shumë nga forca amerikane e pranishme në rajon». Ky është konkluzioni

i tij që në të njëjtën kohë është një paralajmërim në formë ultimatumi e kërcënimi ndaj popujve që janë ngritur ose po ngrihen për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror, kundër shtypjes e shfrytëzimit të superfuqive imperialiste e neokolonialiste.

Në këtë intervistë Brzezhinski nuk thotë asgjë të re veçse konfirmon politikën e përhershme të imperializmit amerikan. Por ama në afirmimet e tij, imperializmi amerikan shpreh frikën që ka nga kryengritjet popullore që ngjiten dhe nuk e ndien veten aspak të sigurt, prandaj detyrohet të kërcasë dhëmbët e t'u thotë edhe klikave të këtyre vendeve, që kërcënohen nga popujt e tyre, se fati i qëndrimit të tyre në fuqi varet nga mbështetja te forca ushtarake amerikane. Dhe për t'u dhënë zemër vasalëve të tij Brzezhinski thotë se Shtetet e Bashkuara janë të pranishme me flotën e tyre në Gjirin Persik, se do të vëzhgojnë zhvillimin e situatave në këtë rajon dhe i siguron ata se «s'do të lejojnë ndërhyrje nga jashtë»!

Kështu, vetë imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, tregojnë që përpara se, në komplotet për sabotimin dhe shtypjen e kryengritjeve popullore, kudo është gishti i Moskës ose i Uashingtonit. Për ta në këto kryengritje nuk ekziston faktori popull, i cili lufton për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin që ia kanë grabitur imperialistët dhe socialimperialistët me kukullat e tyre. Me këtë botëkuptim ata duan të fshehin politikën e tyre të dominimit, të shfrytëzimit dhe të ndërhyrjes me armë, me intriga dhe me demagogji në dëm të popujve e të vendeve të tjera.

Imperializmi amerikan parashikon turbullira në të ardhmen dhe bën demagogji për ta fshehur këtë realitet. Kështu Brzezhinski, ndërsa kërkon që të ndërtohet një politikë që t'u përshtatet kohës dhe rrethanave, pretendon se vendet e «botës së tretë», që formojnë shumicën, «mbështetin» politikën e Shteteve të Bashkuara të Ame-

rikës dhe këtë gënjeshtër përpiqet ta vërtetojë e ta mbështetë në një votim të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke thënë se «në konfrontimin me Iranin, ne kemi një përkrahje unanime siç reflektohet në votat e Këshillit të Sigurimit 15 me 0». Mirëpo për fat të mirë revolucionet popullore nuk ndjekin rezultatet e votimeve në Këshillin e Sigurimit, por rrugën kundër atyre që votojnë për rezoluta pa asnjë vlerë për popujt e botës në këtë organ të OKB-së.

Për imperializmin amerikan kriza e madhe aktuale që ka përfshirë botën, si dhe revolucioni i popujve në ngjitje, duhet të nënshtrohen, të dominohen. Por për këtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ndihen aq të fuqishme, prandaj Brzezhinski hedh idenë se NATO-ja «mbetet aleanca kryesore në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por ajo vepron në një botë në të cilën interesat tona të sigurimit kolektiv janë zgjeruar më shumë se në të kaluarën. Sot ekzistojnë tri zona qendrore të ndërvarura sigurimi: Evropa Perëndimore, Lindja e Largme dhe Lindja e Mesme». Pra, vërtet Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbrojnë Evropën Perëndimore, por kjo nuk duhet të lajë duart, si me thënë, nga ngjarjet në Azi, në Afrikë e gjetkë. Për Brzezhinskin ngjarjet dhe interesat janë të ndërvarura dhe Evropa Perëndimore nuk duhet t'i lërë vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës në rolin e xhandarit ndërkombëtar. Duhet të gjithë së toku, si në mbrojtjen e Evropës Perëndimore, ashtu edhe në mbrojtjen e interesave amerikane jashtë Evropës, të bëhen dhe ata xhandarë. Me fjalë të tjera, Shtetet e Bashkuara u thonë Francës dhe Gjermanisë Perëndimore të mos tregohen kaq «të pavarura» në vendimet e tyre në politikën që po ndjekin në pellgun e naftës, në Afrikë dhe ndaj Bashkimit Sovjetik. Imperializmi amerikan kërkon që këto shtete borgjezo-kapitaliste të Evropës të mos dalin nga radha, por të ecin

në një çap me Karterin, siç vepron aktualisht Kina e Tenit dhe e Huasë.

Patjetër imperializmi amerikan nuk është dakord me intervistën që dha para disa ditësh presidenti i Francës Zhiskar d'Estën, në të cilën ai ngre zërin dhe thotë se Evropës duhet «t'i dëgjohet emri në botë» dhe jo t'i shuhet nga «dy të mëdhenjtë». Me fjalë të tjera, Franca predikon një bashkëpunim më të ngushtë me Gjermaninë Federale për të mbrojtur interesat e tyre ekonomike dhe politike në kontinentet e tjera e në zonat e tyre të influencës, ose në ato që do të përpiqen të krijojnë. Pra, Franca dhe Gjermania s'duan t'ua lënë të gjithë «gjahun» dy «luanëve», Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Ky oreks do t'u vijë më vonë edhe kinezëve që tash përpara amerikanëve sillen plot hipokrizi dhe përulje. Japonia militariste nga ana e saj armatoset, forcohet, pret gjahun dhe nuk mungon herë pas here «të shtjerë pushkë» në qëndrimet mbi situatat që krijohen në kontinente të ndryshme të botës.

Brzezhinski përpiqet të vërtetojë se kryengritjet popullore kundër imperialistëve të huaj dhe aleatëve të tyre të brendshëm, veçanërisht në pellgun e naftës, nuk kanë karakter shoqëror dhe çlirimtar, por kanë karakter «besimi fetar», janë kryengritje «islamike», krejt idealiste. Ai detyrohet të pohojë se «bota islamike po kalon një përtëritje politike dhe fetare», por, sipas mendimit të tij, nuk duhet që këto revolucione, që ai i quan «manifestime shpirtërore», të kthehen «në negative». Islamizmi, deklaron Brzezhinski, është «një besim në vetvete», që ushtrohet nga 800 milionë njerëz. «Të mos e kthejmë islamizmin, thotë ai, në një armik të Perëndimit dhe veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës». Kështu Brzezhinski kërkon që këta 800 milionë njerëz t'i nënshtrohen imperializmit amerikan dhe imperializmit në përgjithësi.

Pra për skllavëruesit imperialistë revolucionet kundër tyre dhe veçanërisht ato të popujve myslimanë nuk kanë karakter të çlirimit kombëtar dhe shoqëror, por karakter fetar. Feja islame konfondohet me kristianizmin dhe zgjimi i popujve për shkundjen e zgjedhës shoqërore konsiderohet vetëm si një ringjallje e besimit fetar. Sipas tyre «ksenofobia» e popujve myslimanë e ka pra burimin te feja. Demagogjia e imperialistëve dhe përpjekja e tyre për të mashtruar këta popuj arrin deri atje sa Brzezhinski të thotë: vendet islamike «kanë një besim më të madh në vetvete; ato nuk janë më nën tutelë qoftë të britanikëve, të francezëve, apo të të tjerëve».

Natyrisht, sipas kësaj deklarate të Brzezhinskit, «Shtetet e Bashkuara të Amerikës s'kanë asnjë vend ose popull nën tutelë!!».

Brzezhinski pranon se përpjekjet për ruajtjen e zonave të influencës mund të çojnë edhe në konfrontim midis dy superfuqive imperialiste në pellgun e vendeve myslimane. Por, sipas tij, bota myslimane, pavarësisht se midis saj dhe Shteteve të Bashkuara «ekzistojnë mosmarrëveshje gjithnjë më të mëdha», do t'i përmirësojë marrëdhëniet me ta, pse «ne jemi të interesuar për pavarësinë e të gjitha vendeve myslimane; ne respektojmë besimet e tyre fetare» etj.

Këto janë pjesë të «teorisë së re» të Karterit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës besojnë në fenë, Bashkimi Sovjetik nuk beson, Shtetet e Bashkuara sundojnë nëpërmjet agjenturave të tyre të instaluara në këto vende nga CIA, sundojnë nëpërmjet investimeve të kapitaleve, nëpërmjet bankave, shoqërive të përbashkëta e shumëkombëshe dhe të gjitha këto të fuqizuara me baza ushtarake, me flota të fuqishme dhe me aviacion nga më të sofistikuarit, kurse Bashkimi Sovjetik, sipas Brzezhinskit, «ushtron sundim të drejtpërdrejtë fizik mbi disa

dhjetëra milionë myslimanë». «Myslimanizmi me kristianizmin kanë shumë gjëra të përbashkëta», prandaj sipas tij, «Shtetet e Bashkuara çdo gjë i bashkon me vendet myslimane, kurse me Bashkimin Sovjetik ateist ato çdo gjë i ndan»!

Ky është gjithë deduksioni i këtij imperialisti prepotent që i merr të tjerët për budallenj dhe veten e tij si shpikës të diçkaje të re që shkakton krizat dhe ballafaqimet politiko-ushtarake dhe shoqërore. Dhe, që të mashtrojë myslimanët, Brzezhinski në mes të të tjerave thotë: «... Po të isha thjesht mysliman, do t'i bëja vetes pyetjen se si mund të lidhem unë me një vend që u mohon myslimanëve të tjerë të drejtat e tyre fetare».

Popujt e botës, dhe veçanërisht popujt e atyre rajoneve të nxehta dhe shumë të nxehta që ka sot në botë, në bazë të ndodhive, të fakteve, të qëndrimeve politike dhe të veprimeve ushtarake që janë fare të qarta, duhet ta kuptojnë se të dyja superfuqitë imperialiste dhe aleatët e tyre, të organizuar në blloqe ose të lidhur e të ndërvarur me ta, luajnë në mënyrë tragjike me fatin e tyre. Çdo veprim e çdo aksion që ata organizojnë e ndërmarrin e bëjnë për interesat e tyre dhe vetëm të tyre, në dëm të interesave jetike të popujve dhe të paqes.

Fuqitë e mëdha imperialiste luftojnë me çdo mjet të ruajnë tregjet dhe zonat e tyre të influencës që kanë sot në botë. Kur njëri e humb një treg në një zonë të dhënë, përpiqet ta sigurojë atë në një zonë tjetër, në kurriz të rivalit ose të rivalëve të tij. Këtej lindin dezbalancimet, këtej lindin dhe thellohen kontradiktat dhe mosmarrëveshjet që venë deri në konfrontime të armatosura, këtej lindin gara e armatimeve, luftërat e pjesshme lokale, që do ta çojnë njerëzimin në luftë të përgjithshme e grabitqare imperialiste.

Fuqitë imperialiste të mëdha dhe ato më pak të mëdha mendojnë, veprojnë dhe teorizojnë se janë ato që

kanë në dorë fatet e popujve dhe të njerëzimit dhe mbi këtë bazë kërkojnë t'i nënshtrojnë popujt. Këto fuqi agresive e nënvleftësojnë zhvillimin e fuqizimin dialektik të luftërave çlirimtare dhe të revolucioneve. Atyre u është errësuar pamja dhe nuk duan të kuptojnë se çdo hap i popujve përpara drejt kundërshtimit të shtypjes e të skllavërimit të dyfishtë, të jashtëm dhe të brendshëm, është një çarje që do të zgjerohet në murin e burgut kapitalist.

Zgjimi i popujve të botës është një fakt i pakontestueshëm. Ai ka ardhur në kundërshtim me dëshirat e imperialistëve dhe të kapitalistëve të ndryshëm. Zgjimin e popujve dhe luftën e tyre për fitore në fushën politike dhe shoqërore nuk e kanë sjellë as besimet fetare, as teoritë skllavëruese në shërbim të kapitalit. Pavarësisht se ç'orientim ka pasur faktori subjektiv në një kryengritje popullore, kjo kryengritje nuk mund të ketë qenë veçse një minus i rëndësishëm për regjimin e mëparshëm që sundonte dhe ky minus për reaksionin kthehet në një plus për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit popullor dhe për forcimin e faktorëve subjektivë përparimtarë që e çojnë revolucionin popullor në revolucion proletar.

Teoria jonë marksiste-leniniste na mëson se **thellimi i krizave në gjirin e botës kapitaliste është fillimi i agonisë dhe i gjendjes në komë i kësaj bote.** Prandaj bëhen përpjekje të mëdha nga kapitali botëror që të shpëtojë nga kjo darë e tmerrshme që e ka mbërthyer për fyti dhe që po e mbyt. Por shpëtimi është i pamundur, pse është vetë sistemi kapitalist që e krijon këtë krizë, që e ushqen, që e thellon deri në shkallën më të lartë. Kapitalizmi ka krijuar vetë varrmihësin e tij, proletariatin. Lufta e proletariatit dhe e popujve ia ka futur imperializmit «ethet e kalit». Kontradiktat ndërimperialiste janë rezultati i luftës së papajtueshme në mes proletariatit dhe borgjezisë. Tratativat dhe ujditë e përkohshme

koniunkturale ose me një afat relativisht të gjatë në mes të imperialistëve, janë me karakter paliativ, janë të ndërtuara mbi rërë.

Në qoftë se Brzezhinski e quan situatën në Bashkimin Sovjetik të pabalancuar, atëherë pse ta kenë frikë Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Brzezhinski i konsideron të konsoliduara Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe kjo nuk është e vërtetë.

Agresiviteti i të dyja superfuqive është i njëllojtë, ndërsa dobësimi i tyre shkon vazhdimisht duke u shtuar.

Lufta e popujve, lufta e proletariatit kundër armiqve të tyre, duhet të ecë përpara, nëpërmjet krizës së madhe që ka pllakosur imperializmin botëror.

E HËNË
10 MARS 1980

BISEDIME PËR FASADË

Kina i ndërpreu të ashtuquajturat bisedime me Vietnamin. Këto bisedime, natyrisht, zhvilloheshin sa për të kaluar kohën, ose më mirë me thënë që Kina të krijonte përshtypjen se pas «mësimit» që i dha Vietnamit duke e sulmuar, e ktheu gjendjen nga e nxehtë që ishte, në situatë «paqësore». Por, siç duket, delegatët kinezë u lodhën dhe Pekini vendosi t'u japë mundësi «të pushojnë» njëfarë kohe. Vietnamezët nga ana e tyre kanë vajtur në këto bisedime për t'i treguar Kinës dhe botës se ata kurdoherë, kur ngjasin konflikte të armatosura ose jo të armatosura, janë për bisedime, njëkohësisht janë për gjetjen e një zgjidhjeje të mundshme të çështjes kamboxhiane, kuptohet, në favor të tyre. Kështu që të dyja palët këto bisedime i përdorin për fasadë, i pari, i madhi, për të fshehur qëllimet e tij agresive ndaj Vietnamit dhe i dyti, i vogli, për të fshehur qëllimet e tij agresive ndaj Kamboxhias. Kështu as Vietnami s'heq dorë nga pushtimi i Kamboxhias, as Kina nuk heq dorë nga agresioni i saj ndaj Vietnamit.

Të dy, pra, janë hileqarë, por tani që i pari largohet nga tryeza, i dyti gjoja bën politikë dhe fajin për ndërprerjen e bisedimeve kërkon t'ia lërë në kurriz Kinës së Hua Kuo Fenit. Për këtë vietnamezët deklaruan publikisht nëpërmjet Ministrisë së tyre të Punëve të Jashtme se «janë për vazhdimin e bisedimeve me Kinën»

dhe thonë se «kjo bëri një gabim trashanik» që i ndërpreu ato; demaskojnë edhe arsyen e ndërprerjes së këtyre bisedimeve, domethënë kërkesën e kinezëve që Vietnami të tërheqë trupat pushtues nga Kamboxhia dhe «t'i lërë kamboxhianët të vendosin vetë për fatin e tyre». Kinezët pra, jo vetëm i quajnë vietnamezët agresorë, por, nga ana tjetër, lënë të kuptohet se e mbështetin të ashtuquajturën qeveri të Kieu Samfanit, ku me siguri rron dhe lufton edhe banda e vjetër kamboxhiane me Pol Potin, Jeng Sarin e të tjerë.

Për vietnamezët kjo do të thotë se Kina qëndron si shpata e Damokleut mbi kokën e Vietnamit derisa ky të heqë dorë nga pushtimi i Kamboxhias dhe t'i lërë vendin asaj, duke i krijuar mundësi të vërë dorë mbi Kamboxhian, që andej mbi Laosin dhe ta rrethojë Vietnamin. Pastaj e sulmon apo nuk e sulmon, është tjetër problem.

Lidhur me këtë ndodhi, Kieu Samfani mori valixhen dhe këto ditë po bën vizita në Kinë e në Kore. Në Kinë atë e pritën me salltanet. Hua Kuo Feni doli në aerodrom, kurse «më i vogli», por, në fakt, «më i madhi» në pozita, nuk doli. Ky shkurtabiq, që e ka emrin Ten Hsiao Pin, dhe që kohët e fundit është bërë i plotfuqishëm në Kinë, e priti Kieu Samfanin në rezidencën e tij. Pra, Hua Kuo Feni del në aerodrom, kurse Ten Hsiao Pini rri në shtëpi dhe i pret vizitorët «e shquar» në audiencë.

Natyrisht, sipas lajmeve, në fjalimet që mbajtën në aerodrom e në banket, Hua Kuo Feni foli «për miqësinë e madhe e të sinqertë që Kina ushqen për Kamboxhian demokratike» dhe Kieu Samfani «për miqësinë e madhe që lidh Kamboxhian me Kinën dhe për ndihmën e madhe që kjo i jep Kamboxhias». Kieu Samfani tha se lufta e popullit kamboxhian kundër pushtuesve vietnamezë vazhdon dhe do të kurorëzohet me fitore.

Pas dy ditësh qëndrimi në Pekin, mysafiri nga Kamboxhia shkoi te miku tjetër i tij, Kim Ir Seni. Naty-

risht, ky nuk denjoi të dilte në aerodrom, por e priti në shtëpi, ku biseduan përzemërsisht. Ndërkohë, miku i tij i vjetër, Sihanuku, të cilit Kimi i ka ndërtuar edhe një pallat në Phenian, ka shkuar në Kanada prej nga flet kundër Kieu Samfanit, Pol Potit dhe të gjithë atyre që i mbrojnë këta.

Pra, shohim se si shpejt e shpejt ndërrojnë vend pozitat e mbajtura si nga kinezët, ashtu edhe nga koreanët. Hua Kuo Feni dhe Kim Ir Seni një herë mbështetin Pol Potin, një herë tjetër Sihanukun, tani Kieu Samfanin e kështu me radhë. Kjo është politika e ndërrimit të këmishëve, politikë që, natyrisht, ka edhe pasojat e saj të hidhura.

Kina jo vetëm që armatoset, por rreth Vietnamit ka grumbulluar ushtri dhe nuk qëndron pa e provokuar këtë herë pas here, derisa të përgatitë terrenin për të bërë edhe ndonjë skandal të ri që do të kushtojë edhe disa qindra mijë të tjerë të vrarë dhe do ta përhapë zjarrin në gjithë Azinë Juglindore.

Nëpërmjet Tajlandës Kina e ndihmon fuqimisht me armë, me ushqime e me veshje ushtrinë partizane të Kieu Samfanit, e cila është e organizuar në formë çetash të vogla, që e zhvillojnë luftën me taktikën partizane në xhungla dhe e shqetësojnë ushtrinë vietnameze. Kjo është e shtrënguar të zhvillojë një luftë me forca të mëdha, por ka vështirësi, sepse lufton në një vend të huaj, populli i të cilit nuk e do, e urren dhe ia saboton përpjekjet kolonialiste. Qeveria e Heng Samrinit, natyrisht, një qeveri kukull e vietnamezëve, nuk dëgjohet, ajo është qeveri e fasadës, bën ndonjë deklaratë dhe kaq, kurse populli kamboxhian vuan të zitë e ullirit, në mjerim, uri e sëmundje dhe i hallakatur në të ashtuquajturat qytete e fshatra të djegura ose në xhungla, nëpër çadra.

Megjithëse sulmi i vietnamezëve ndaj Kamboxhias mund të ketë pasur edhe «arsye», si kundërpërgjigje e

agresionit të anës tjetër, të udhëhequr nga Pol Poti, prapëseprapë është një agresion dhe e ka vënë Vietnamin në pozita shumë të vështira, politike dhe ekonomike e me një perspektivë të errët për sa i përket vazhdimit të kësaj aventure.

Situata brenda në Vietnam është e turbullt. Atje, siç e dimë, u bënë ndryshime në udhëheqje dhe i plotfuqishëm është Le Zuani, pastaj Xhiapi dhe Fam Van Dongu, megjithëse ky, sipas të dhënave të agjencive të lajmeve, nuk e ka atë pozitë të fortë politike që kishte më parë. Kjo, thuhet, për arsye pleqërie ose sëmundjeje, por duhet të jetë për qëndrime politike të kundërta lidhur me çka po ngjet tani në Vietnam, pavarësisht se edhe Fam Van Dongu është një nga arkitektët e këtyre ngjarjeve të paqarta, të lëkundshme dhe tragjike që po zhvillohen në Vietnam.

Vietnami i Jugut, i cili qysh pas çlirimit u bashkua me Vietnamin e Veriut dhe formuan një republikë të vetme me kryeqytet Hanoin, është si të thuash në të njëjtën gjendje që ka qenë më parë. Pas luftës, në Vietnamin e Jugut vietnamezët nuk mundën të vendosnin dot po atë organizim politik dhe ekonomik, po atë ndërtim organizativ, siç ekzistonin këto, natyrisht të dobësuara nga lufta, në Vietnamin e Veriut. Kështu që tani ata po detyrohen të lejojnë zhvillimin e tregtisë private, të mbyllin sytë përpara tregut të zi, tregut privat dhe nuk po i ndërtojnë kooperativat bujqësore. Me fjalë të tjera, elementët e borgjezisë dhe të reaksionit vazhdojnë të rrojnë, të punojnë e të shfrytëzojnë masat nën maskën e regjimit pseudosocialist të Veriut.

Turbullirat që ndodhën në Vietnamin e Jugut dhe në Vietnamin e Veriut, për sa u përket masave që u morën ndaj kinezëve të pasuruar nga lufta e që banonin në Vietnam, pas arratisjes me shumicë të shumë prej këtyre, gjë që shkaktoi skandal ndërkombëtar, duke e ulur

autoritetin e Vietnamit në sytë e popujve të botës, i detyroi vietnamezët, edhe pas goditjes që u bëri Kina, të marrin masa të brendshme më të rrepta, por njëkohësisht t'i lëshojnë terren zhvillimit të ekonomive private.

Me sa kuptohet, regjimi në Vietnam është në pozita të vështira politike, ekonomike e organizative. Aktualisht Vietnami nuk mund t'ua kushtojë kujdesin kryesor zhvillimit dhe ndërtimit të vendit, ekonomisë së shkatërruar nga kjo luftë kaq e gjatë. Me agresionin mbi Kamboxhian zgjatet më tepër gjendja e mjeruar për këtë popull trim dhe heroik. Vietnamit i duhet të mbajë një ushtri të madhe në këmbë, përveç faktit që kjo ushtri ndodhet në gjendje lufte dhe në goditje të vazhdueshme nga forcat partizane të Kieu Samfanit. Megjithëse nga Kamboxhia Vietnami tërheq artikuj ushqimorë, se gjë tjetër atje nuk ka, prapëseprapë kushtet e luftës nuk i sjellin asnjë fitim shtypësit dhe agresorit të ri në Indokinë.

Aleanca me Bashkimin Sovjetik mund t'i sjellë ndonjëfarë ndihme Vietnamit, por kjo ndihmë nuk është veçse me karakter ushtarak, e cila, edhe në qoftë se ekziston, është e paktë. Ushtria vietnameze është e armatosur me ato mjete që ka pasur gjatë kohës së luftës kundër amerikanëve dhe me ato armë e municione që u kapën kur u çlirua vendi. Pra, ndihma politike e Bashkimit Sovjetik nuk ka as atë efekt, as atë peshë që udhëheqësit e Vietnamit kanë menduar të nxjerrin nga nënshkrimi i traktatit të miqësisë dhe të bashkëpunimit me të, pavarësisht se udhëheqësit e futën Vietnamin edhe në KNER.

Rreziku dhe kërcënimi i një sulmi tjetër nga ana e Kinës ndaj Vietnamit vazhdojnë dhe do të vazhdojnë. Tani së fundi Huan Huaja, ministër i Jashtëm i Kinës, filloi një turne në Filipine, në Tajlandë, në Singapor e gjetkë, sigurisht për të forcuar «miqësinë» e këtyre shteteve me Kinën, por dhe për të shtrënguar darën kundër

Vietnamit dhe synimeve hegjemoniste të Bashkimit Sovjetik në pellgun e Lindjes së Largme e të Lindjes së Mesme.

Aleati i bindur dhe i sjellshëm i amerikanëve, Kina e Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit, njëkohësisht me lojën e vet, bën edhe lojën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por si partner i dorës së dytë e të tretë, në të gjithë pellgun rreth Lindjes së Largme dhe Azisë Juglindore. Këtë Kina e bën me qëllim që të krijojë një situatë të favorshme për imperializmin amerikan, japonez dhe për imperialistët e tjerë, që të konsiderohet prej tyre si një barrikadë kundër ekspansionit sovjetik dhe të merren kështu prej tyre kreditë aq shumë të dëshiruara nga ana e saj dhe aq shumë të nevojshme për ta bërë ekonominë kineze një ekonomi të fortë ushtarake dhe socialimperialiste. Për këtë gjë ne shohim që Kina, nga njëra anë, luan rolin si një sufifrë[1] i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i kapitalizmit botëror në përgjithësi, dhe, nga ana tjetër, në mënyrë të heshtur dhe pa bujë, lidh kontrata ekonomike dhe ushtarake me këto shtete kapitaliste e imperialiste, duke ia shitur veten politikisht dhe ekonomikisht një shoqërie të re kapitalistësh që po ngrihet në Kinën e Mao Ce Dunit.

Vendimet që merren në Kinë kanë për qëllim demaskimin e plotë të figurës së Mao Ce Dunit. Këtë e bëjnë me dorashka, por konkretisht rehabilitimi i armikut kryesor të Mao Ce Dunit, ish-presidentit Liu Shao Çi, është kapaku që Teni i vuri luftës që po zhvillon kundër maocedunidesë dhe grupit që udhëhiqte më parë. Për fat të keq të Tenit ky grup është shumë i madh dhe influenca e Maos nuk është e vogël në Kinë, prandaj në rrugën për realizimin e këtyre qëllimeve të tij, si dhe në aleancat e tij të brendshme e të jashtme, ai nuk do të shkasë si në gjalpë, por do të hasë vështirësi.

1 Sous-fifre (frëngjisht) — vartës.

E DIEL
16 MARS 1980

POLITIKA E «MOSANGAZHIMIT» — NJË KËSHTJELLË E NDËRTUAR MBI RËRË

Politika e jashtme jugosllave është po aq e çoroditur dhe e lëkundshme, sa edhe ajo e brendshmja. «Kali» i luftës së titistëve është politika e «mosangazhimit», mirëpo ky «kalë» po çalon nga të dyja këmbët dhe tash, me vdekjen e kavalierit aventurier plak, Titos, edhe ai do të ngordhë.

Zaten **kjo politikë,** në qoftë se mund ta quajmë kështu, **ishte një fiksion, një kështjellë e ndërtuar mbi rërë,** jo pa qëllime të caktuara. Ajo ishte një *modus vivendi* i sajuar nga kapitalizmi botëror që ky i fundit të ruante perandorinë e tij neokolonialiste duke gënjyer popujt se gjoja politika që ndiqnin udhëheqësit e këtyre vendeve «të paangazhuara», por që në fakt ishin satelitë të imperializmit amerikan dhe të fuqive të tjera kapitaliste, ishte një politikë «e pavarur e jashtë blloqeve».

Natyrisht, dy superfuqitë imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, nuk mund t'i futnin vendet e zonave të tyre të influencës në blloqet ushtarake, siç janë NATO-ja dhe Traktati i Varshavës, sepse atëherë këto superfuqi do të rrezikoheshin orë e çast në konflikte ekonomike ose ushtarake, që nuk do të kishin më karakter lokal, sepse do të ktheheshin në zona influence edhe për anëtarët e tjerë të blloqeve dhe do të nxitnin jo vetëm luftën lokale po e po, por edhe luftën botërore.

Këto vende «të paangazhuara», ose, siç pretendojnë titistët, që ndjekin një politikë «të paangazhuar», apo vendet e «botës së tretë», ose ato të zonave të influencës së njërit ose të tjetrit vend kapitalist të industrializuar, janë si të thuash shtete notuese, shtete që kanë lëkundje të vazhdueshme politike në ekonomi, pse politika e tyre është një apendiks në mëshirën e kirurgut të madh, i cili e operon ose nuk e operon, sipas koniunkturave që krijohen.

Të gjitha këto vende dhe shtetet e tyre janë të krimbura në borxhe, pra, ekonomia e tyre është një apendiks i sëmurë i kapitalit të madh botëror, i cili bën ligjin në këto vende, dikton politikën, mban ose rrëzon klikat që i udhëheqin ato, sipas nevojave dhe politikës së shoqërive të përbashkëta të kapitalit të madh financiar.

Popujt e këtyre vendeve vuajnë nga çdo pikëpamje, fuqitë e mëdha kapitaliste kanë ndërtuar në to një strukturë dhe një infrastrukturë të atillë që të mund të sigurojnë shtypjen dhe shfrytëzimin e popujve, të cilët me anën e fokuseve të një loje gjoja demokratike, parlamentare, i gënjejnë duke u krijuar përshtypjen se janë të lirë, të pavarur e sovranë.

Në Gjirokastër populli thotë: «Dhentë e dhitë e Zeres, nami i Hasan Qeres». Kështu ngjet edhe me politikën e «të paangazhuarve». Kjo politikë, **bëhet dhe financohet nga imperializmi amerikan, aprovohet në përgjithësi nga aleatët e vet dhe trumbetohet nga Titoja.** Më parë trumbetohej edhe nga Naseri, nga Nehruja, nga Nkvame Nkruma e nga Sukarnoja, por, me vdekjen ose largimin e këtyre të fundit nga skena, mbeti vetëm një «kalë Troje», që gjoja ishte udhëheqësi i politikës së «të paangazhuarve». Ky ishte Titoja i Jugosllavisë. Në realitet, Titoja, gjatë gjithë veprimtarisë së tij, s'ka qenë tjetër veçse një agjent i imperializmit amerikan, i cili e mbante në këmbë për qëllime të caktuara dhe Jugosllavia e tij

shembull i një vendi «socialist», të pavarur nga Moska, një element «me rëndësi» në skakierën ndërkombëtare dhe një shembull për vendet e porsakrijuara pas Luftës së Dytë Botërore, që i kishin ndërruar padronët e dikurshëm dhe ishin futur nën influencën e kolonizatorëve të rinj, imperialistëve amerikanë, të dalë të fuqishëm nga lufta, për t'u treguar se ç'rrugë duhej të ndiqnin për të rrojtur me krodhat që do t'u jepte ky imperializëm.

Investimet amerikane, angleze, franceze, gjermane etj. në Jugosllavi kanë qenë shumë të mëdha dhe frytdhënëse për kapitalistët, si në fushën ekonomike e politike, ashtu edhe nga pikëpamja e forcimit të pozitave të tyre ushtarake. Për imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror Jugosllavia ishte një bastion politik kundër Bashkimit Sovjetik, kundër vendeve të ish-demokracisë popullore dhe njëkohësisht një *glacis* ushtarak midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Them se ishte një bastion politik, mbasi ky shtet kapitalist, i krijuar gjatë periudhës së pasluftës, duke pretenduar se ndërtonte një socializëm specifik, do të shërbente si një nxitës dhe element subversiv në vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, do të ishte një përçarës i «unitetit» të Bashkimit Sovjetik revizionist me satelitët e tij dhe me partitë e tjera revizioniste të Evropës Lindore dhe të Evropës Perëndimore.

Pra, Titoja, me politikën e tij «të paangazhuar», të sajuar nga imperializmi amerikan, do të arrinte tok me liderët e tjerë të kësaj politike, që i përmendëm më lart dhe që tash kanë vdekur, të krijonte një kope dhensh, pa kokë dhe pa këmbë, por me një tabelë ku të lexohej vende «të paangazhuara», me një politikë specifike, që gjoja i dallonte dhe i vinte në kundërshtim me politikën e blloqeve. Të gjitha këto vende, të ashtuquajtura të paangazhuara, por që ishin nën influencën ekonomike e politike dhe nën mbrojtjen e imperializmit e të kapitalizmit, ushqenin iluzionin se gjoja në mbledhjet e tyre të herëpashershme manifestonin vullnetin e tyre «të madh» dhe kundërshtimin e politikës së fuqive të mëdha e të blloqeve.

Mirëpo në këtë lojë të politikës ndërkombëtare Bashkimi Sovjetik nuk mbeti pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kishte edhe ai zonat e tij të influencës që përbëheshin nga shtete gjoja të pavarura nga ai nëpër kontinente, ku jo vetëm politika e Bashkimit Sovjetik, por edhe investimet ekonomike që bënte ai, luanin një rol të rëndësishëm. Këto shtete lejoheshin të bënin pjesë «në botë» dhe të zhvillonin një politikë pseudo të paangazhuar. Ç'humbitnin? As Bashkimi Sovjetik nuk humbiste gjë, as satelitët e tij, për arsye se kjo «botë e paangazhuar» nuk merrte asnjë angazhim, secili prej këtyre shteteve, në raport me vendin prej nga varej, çdo klikë që sundonte në to, bënte atë politikë e cila i siguronte më shumë fitime dhe, kur gjente çastin më të volitshëm, mund të kalonte nga njëra varësi në tjetrën, pra, nga një zonë influence në një zonë tjetër. Natyrisht kjo bëhej me fërkime, gjë që u duk edhe në votimet e Kombeve të Bashkuara, ku më parë votat ishin ndarë sipas blloqeve, kurse më pas ato filluan të lëkundeshin sa andej-këndej. Pavarësisht se këto votime s'kishin asnjë rëndësi, loja luhej në prapaskenë në mes fuqive të mëdha. Në Kombet e Bashkuara makina e votës ishte e njëllojtë me votimet që bëheshin në parlamentet e vendeve borgjezo-demokratike.

Mirëpo në këto vende «të paangazhuara» nuk ndihej vetëm influenca e blloqeve, siç pretendon titizmi, që thotë se s'mund të ketë «liri të plotë» përderisa ekzistojnë blloqet, por ndihej edhe influenca e pjesëtarëve të këtyre blloqeve veç e veç, të cilët brenda në bllok kishin kontradikta edhe politike, edhe ekonomike dhe secili kërkonte të ruante e të shtonte zonën e influencës në kurri-

zin e aleatëve të tij dhe ato të NATO-s edhe në bllokun sovjetik. Kështu që politika e «të paangazhuarve» nuk i pengonte as Francën, as Anglinë, as Republikën Federale Gjermane etj., të përhapeshin si vaji në lakra, mbasi i kishin forcuar pozitat e tyre politiko-ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore e sidomos këto dekadat e fundit. Lidhur me zonat e influencës NATO-ja nuk vepronte si bllok ushtarak, por çdo anëtar i këtij blloku vepronte në zonat e veta si një fuqi e veçantë ekonomiko-politike.

Kontradiktat në gjirin e NATO-s, natyrisht manifestohen edhe jashtë saj. NATO-ja as interesat e anëtarëve të saj nuk i shikon në prizmin e një «uniteti» monolit. Kjo duket qartë në kundërshtimet që zhvillohen midis Republikës Federale Gjermane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, midis këtyre dhe Francës, midis Francës dhe Anglisë etj., bile arrihet deri atje sa Brzezhinski kërkon që vendet anëtare të NATO-s të ndihmojnë politikën amerikane për ruajtjen e influencës ekonomiko-politiko-ushtarake të saj jo vetëm në zonën e Evropës, por në të gjitha anët e botës ku imperializmi amerikan ka investuar mjetet e tij ekonomike dhe ka përhapur forcat politike.

Politika amerikane ka pësuar disfatë në botë dhe kjo u reflektua edhe në të ashtuquajturën politikë të vendeve të paangazhuara. Kështu në Konferencën e Havanës u manifestuan kundërshtime midis vendeve pjesëmarrëse, aleate të të dyja blloqeve. Vendet prosovjetike, si Kuba, Vietnami, Somalia e të tjera mbështetnin politikën e Bashkimit Sovjetik, kurse grupi që gjoja ndjek politikën e «kalit» të Beogradit mbronte politikën amerikane nën maskën e politikës «së paangazhuar», politikës «jashtë blloqeve e në kundërshtim me blloqet».

E tërë kjo mbledhje, ashtu si edhe ato të mëparshmet, ishte një maskaradë dhe të tilla do të jenë edhe ato që do të zhvillohen në të ardhmen, për arsye se **çdo shtet kapitalist, i madh ose i vogël, që bën pjesë në botën e «të paangazhuarve», ndjek një politikë të jashtme të akorduar me diapazonin e atij që e financon, që e mbështet** dhe që ka lidhur fatet e klikës së qeverisë me veten e tij.

Aktualisht, duke parë dobësinë e politikës amerikane në botë, Franca e Zhiskar d'Estënit dhe Gjermania e Bonit kanë filluar të manifestojnë me forcë politikën e tyre të ekspansionit ekonomik, politik e ushtarak dhe që të dy këto shtete, për të mos folur për Japoninë dhe për Anglinë, kanë zonat e tyre të influencës, kanë në varësinë e tyre shtete që quhen «të paangazhuara», të cilat bëjnë atë politikë që u diktohet nga ato. Kështu me teorinë e tyre të «të paangazhuarve» titistët mund të përrallisin, duke kujtuar se gjoja kanë gjetur formulën e shumëdëshiruar për të ruajtur pushtetin e kapitalit amerikan dhe të shteteve të tjera kapitaliste të industrializuara, por kjo nuk pi më ujë as edhe si një fiksion.

«Kali» i fundit i kësaj karroce të sajuar nga imperializmi amerikan është duke vdekur dhe me të do të vdesë edhe kjo dada e tyre. Udhëheqja «kolegjiale» jugosllave nuk do të jetë më në gjendje ta mbajë ngritur këtë flamur të «mosangazhimit» dhe të gënjejë popujt, dhe në fakt asnjëherë nuk i ka gënjyer dot ata. Por edhe klikat vasale të kapitalizmit botëror, te Jugosllavia nuk shikonin veçse një *valé* të imperializmit amerikan dhe asgjë tjetër. Pas vdekjes së Titos zhduket edhe ky *valé*, zhduket dhe ky xhol që hynte në të katër anët si i dërguar i kapitalit botëror.

E HENË
24 MARS 1980

TEZAT E PK TË GJERMANISË (MARKSISTE-LENINISTE)

Para disa ditësh, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) i dërgoi Komitetit Qendror të Partisë sonë një letër si dhe një material me 43 apo me 44 teza. Objekti i këtyre tezave është: si duhet të ndërtohet një parti e vërtetë komuniste ose punëtore, marksiste-leniniste dhe ç'vijë duhet të ndjekë ajo.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) kërkon, gjithashtu, që nga 7-12 prilli të vijnë në Shqipëri për bisedime kryetari i kësaj partie, Ernst Aust dhe anëtari i Byrosë Politike Host Koh. Natyrisht, ne me kënaqësi të madhe i thamë që të vijnë dhe të shkëmbejmë mendime lidhur me sa kërkojnë ata.

Duke na dërguar këtë letër e këto teza dhe duke na kërkuar mendimin tonë mbi to, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) në radhë të parë i bën një nder Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Nga një vështrim i parë dhe i shpejtë që u bëra tezave që na ka dërguar kjo parti motër, duket se ato kanë të bëjnë me normat e njohura marksiste-leniniste që duhet të ketë dhe të plotësojë një parti komuniste e punëtore me të vërtetë marksiste-leniniste. Në përgjithësi, me ndonjë vërejtje të vogël parimore, ose me ndonjë formulim si me thënë më të mirë e më të saktë të këtyre tezave,

unë mendoj se ne mund të jemi dakord, pavarësisht se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) ka përzier normat që duhet të udhëheqin partinë me udhëzime e me orientime që mund dhe duhet të jepen për të shpjeguar këto norma.

Siç dihet, Internacionalja Komuniste (Internacionalja e Tretë, e cila u shkëput nga Internacionalja e Dytë), caktoi 21 kushtet e famshme, të ndërtuara sipas tezave të paraqitura nga Lenini, më 25 korrik të vitit 1920, në Komisionin e Kongresit të 2-të mbi «Kushtet e pranimit në Internacionalen Komuniste». Këto kushte, që u aprovuan pastaj edhe nga vetë Kongresi i 2-të i Internacionales Komuniste, përcaktonin detyrimet që duhet të plotësonin partitë komuniste për të bërë pjesë në Komintern, për të qenë, pra, pjesëtare të Kominternit. Kur Lenini themeloi Partinë Socialdemokrate Ruse dhe kur u gjend përpara luftës fraksioniste të Danit e të menshevikëve të tjerë, ai përcaktoi karakteristikat që duhet të ketë partia që i nevojitet revolucionit proletar dhe shkroi në mes të tjerash veprën e tij të famshme «Ç'të bëjmë?».

Në tezat që na kanë dërguar, shokët gjermanë jo vetëm përcaktojnë normat parimore organizative mbi të cilat duhet të bazohet partia komuniste, marksiste-leniniste, pra normat e përgjithshme strategjike të një partie të tillë, por bashkojnë me to dhe përcaktojnë afërsisht edhe taktikat që duhet të kenë partitë marksiste-leniniste në situata e në etapa të ndryshme. Vetë shokët gjermanë, në letrën që na kanë dërguar, e thonë se cili është qëllimi për të cilin i kanë formuluar këto teza. Kështu ata thonë se këto çështje duhet t'i shtrojmë e t'i diskutojmë në bisedimet dypalëshe dhe shumëpalëshe me partitë komuniste dhe punëtore, me qëllim që të përcaktohen, si me thënë, disa norma, disa piketa parimore për të gjitha partitë komuniste, marksiste-leniniste.

Mua më duket se është vështirë për ne që t'u diktojmë partive marksiste-leniniste, qoftë edhe në mbledhje të përbashkëta, dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe qysh duhet të jetë partia marksiste-leniniste. Pse është vështirë? Është i vështirë një veprim i tillë se, duam apo s'duam ne, ky përmban në vetvete «tendencën e imponimit» nga ana e një ose e shumë partive të disa orientimeve, të cilat Kominterni në kohën e vet i pat dhënë për të bërë dallimin në mes partive komuniste dhe partive socialiste e socialdemokrate të Internacionales së Dytë.

Aktualisht ekziston një situatë pak a shumë analoge. Partitë e vjetra komuniste dhe punëtore, siç janë Partia Komuniste hrushoviane e Bashkimit Sovjetik, partitë e vendeve të Evropës Lindore, e ashtuquajtura Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë, partitë eurokomuniste, Partia Komuniste e Kinës dhe gati të gjitha partitë e vjetra të vendeve kapitaliste, kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin, kanë devijuar nga teoria jonë shkencore dhe janë kthyer në parti revizioniste. Mirëpo, pavarësisht se ekziston kjo situatë, sot nuk ekziston Kominterni dhe, sipas mendimit të Partisë sonë, nuk mund të formohet një Internacionale e re, e cila të ngarkohet me detyrën e udhëheqjes dhe të drejtimit të të gjitha partive të vërteta marksiste-leniniste në luftën e tyre kundër borgjezisë kapitaliste dhe kundër revizionizmit modern.

Në qoftë se konsiderohet se ekziston një situatë e tillë (dhe në fakt ajo ekziston) partitë e reja duhet të mbështeten fort si në çështjet politike, të organizimit dhe të luftës, ashtu edhe në çështjet ideologjike, në teorinë marksiste-leniniste. Kjo teori nuk mund të imponohet nga një ose nga pesë parti. Përkundrazi duhet të bëhen përpjekje luftarake që në çdo parti të formohen pikëpamje të drejta dhe shkencore.

Përmbajtja e tezave që na ka paraqitur tani Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) në të vërtetë është formuluar me kohë, shkencërisht dhe në mënyrë precize që në «Manifestin Komunist» të Marksit dhe të Engelsit. Po kështu statutet dhe programet e Partisë Bolshevike të Leninit, përmbajnë formulime shumë ekzakte për sa i përket çështjes se si duhet të jetë partia e klasës punëtore dhe cilat janë detyrimet e saj. Stalini në veprën e tij «Mbi bazat e leninizmit», më 1924, ka parashikuar në mënyrë të hollësishme gjashtë veçoritë që duhet të ketë partia e tipit leninist.

Edhe Partia jonë që në fillim ka përcaktuar në mënyrë shkencore normat marksiste-leniniste të organizimit të vet. Në programin e saj, i cili në vija kryesore pasqyrohet në Statutin e Partisë, ajo ka përcaktuar, gjithashtu, edhe orientimet e veta politiko-ideologjiko-luftarake. Çdo parti duhet ta bëjë këtë gjë, dhe jo vetëm kaq, por këto norma e parime nuk duhet të jenë mjete dekorative, por armë dhe mësim për të vepruar në mënyrë revolucionare në udhëheqjen e masave të gjera punonjëse në luftë dhe në revolucion për të drejtat e tyre, kundër borgjezisë dhe aparatit të saj shtypës e shfrytëzues.

Teoria jonë marksiste-leniniste, që është shkencë e jo dogmë, duhet të studiohet nga të gjithë marksistët, nga të gjitha partitë marksiste-leniniste. Bile këta duhet t'ua sqarojnë atë edhe masave punonjëse, veçanërisht klasës punëtore, që është mbështetja e tyre kryesore, nga ku kanë dalë edhe për të cilën luftojnë. Natyrisht çdo parti marksiste-leniniste këto parime i përcakton në programin e në statutin e saj dhe i zbaton si duhet në kushtet e vendit të vet. Kjo shihet në praktikën e përditshme luftarake, në orientimet që jepen si për probleme kapitale, ashtu edhe për probleme korrente që interesojnë klasën punëtore dhe punonjësit e tjerë, të cilët çdo ditë e çdo orë

luftojnë për të fituar terren drejt revolucionit. Kuptohet se çdo parti vijën dhe qëndrimet e veta politike e luftarake i përhap nëpërmjet propagandës që bën dhe aksioneve konkrete. Për sa i përket çështjes përse është mbajtur ky apo ai qëndrim i caktuar ose përse është ndërmarrë ky apo ai veprim tjetër, midis partive motra marksiste-leniniste ekziston bashkëpunimi vëllazëror dhe shoqëror për të shkëmbyer eksperiencë dhe për t'i shpjeguar njëra-tjetrës çështje të vijës politike apo të veprimeve konkrete, jo pse janë të detyruara, por sepse janë parti marksiste-leniniste që i bashkon e njëjta ideologji dhe që luftojnë për një qëllim.

Kuptohet se në bisedime vëllazërore dypalëshe ose shumëpalëshe, mundet dhe duhet të ketë edhe kritikë, edhe autokritikë. Këto duhet të bëhen ashtu siç përcakton teoria jonë marksiste-leniniste dhe që të dyja të shërbejnë për përmirësimin e punës e të luftës, për kalitjen e çdo partie dhe për përgatitjen e masave për revolucionin. Prandaj partitë motra marksiste-leniniste, në kontaktet që mund të kenë dhe duhet të kenë midis tyre, nuk mund t'i kërkojnë raporte njëra-tjetrës, ose të raportojnë në një qendër ashtu siç raportonin dikur partitë komuniste në Komintern. Kominterni ishte një formë tjetër organizimi dhe partitë e asaj kohe, që ishin pjesëtare të këtij organizmi ndërkombëtar, merrnin aty direktiva për punën e tyre. Në Komintern ato kishin seksionet e veta, prandaj ishin të detyruara të jepnin raporte mbi gjendjen në partitë e në vendet e tyre, të merrnin udhëzime nga Komiteti Ekzekutiv i Internacionales Komuniste. Aktualisht dhe për arsye që dihen, një gjë e tillë nuk mund të bëhet.

Në qoftë se mendohet që partitë marksiste-leniniste duhet të pranojnë ndonjë dokument të përbashkët si një manifest të ri, mua më duket se një gjë e tillë nuk është e udhës të bëhet. Po të bëhet kjo, do të dukej sikur marksizëm-leninizmi është vjetruar dhe partive të reja marksiste-leniniste u duhet të kenë një manifest të ri...

Është e natyrshme se Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste) qëkurse i ka hartuar këto teza i ka në themel të partisë së vet. Çdo parti marksiste-leniniste këto parime duhet t'i ketë në themelin e saj dhe t'i vërë në jetë. Është gjithashtu e domosdoshme dhe e nevojshme që partitë tona, në mbledhjet që mund të kenë me ndonjë ose me disa parti motra, t'i shtrojnë këto parime, me qëllim që t'i bëjnë shtyllën kurrizore të partive të tyre marksiste-leniniste. Por kjo gjë nuk duhet bërë, si me thënë, në një platformë manifesti, por në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencës dhe të përforcimit të këtyre parimeve bazë dhe vendimtare. Kjo, aktualisht dhe në çdo kohë që të bëhet, është shumë e nevojshme. Në këtë kuptim jemi dakord me shokët e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste).

Një gjë të tillë ne e bëjmë vazhdimisht duke vënë në dukje parimet që udhëheqin Partinë tonë, domethënë ideologjinë marksiste-leniniste dhe format organizative bazë mbi të cilat është ndërtuar Partia jonë. Po ashtu, natyrisht, ne, qëkurse u formua Partia jonë dhe filloi Luftën Nacionalçlirimtare, kemi përcaktuar edhe strategjinë tonë. Aktualisht në çdo Kongres të Partisë sonë ne përcaktojmë vijën e saj konkrete për çdo etapë, forcojmë unitetin e Partisë, e kalitim atë më tej nëpërmjet edukimit ideologjik e politik dhe e vëmë në pozita të shëndosha parimore, strategjike dhe taktike marksiste-leniniste edhe për sa i përket qëndrimit ndaj ngjarjeve ndërkombëtare, pra, të politikës botërore.

Tani në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, në partitë komuniste e punëtore marksiste-leniniste, relativisht të reja, ka pikëpamje jo të qarta. Ka nga këto parti që e quajnë veten marksiste-leniniste, por në të vërtetë ato nuk bazohen plotësisht në normat

parimore që duhet të udhëheqin një parti të tillë, të tipit Lenin-Stalin. Ato çalojnë ende edhe nga ana organizative, nuk kanë një objektiv plotësisht të qartë marksist-leninist të punës dhe të luftës që duhet të bëjnë në vendet e tyre dhe në situata të ndryshme, nuk kanë, gjithashtu, një statut e një program që t'u vlejnë, pak a shumë, për të ecur përpara dhe për të kalitur anëtarët e tyre.

Shohim se këto parti marksiste-leniniste në përgjithësi janë formuar pas vitit 1960, domethënë kur Partia jonë sulmoi haptazi revizionizmin hrushovian, kur Partia Komuniste e Kinës, pak a shumë, qëndroi në pozitat antihrushoviane. Por, siç e kemi analizuar, kur Partia Komuniste e Kinës pa se ishte e pamundur që të bashkëjetonte ideologjikisht dhe politikisht me Bashkimin Sovjetik hrushovian, ajo i forcoi pozitat e saj antisovjetike, por nga një platformë nacionaliste, shoviniste dhe imperialiste derisa më në fund e më në bisht në luftën e saj pseudorevolucionare ndryshoi plotësisht strategjinë dhe taktikën.

Këtu nuk synoj të bëj një analizë për partinë revizioniste kineze, sepse vijën dhe veprimet e saj kundërrevolucionare Partia jonë i ka analizuar me kohë. Por dua të theksoj se në vitet 60-të u formuan mjaft parti marksiste-leniniste, të cilat mbajtën një qëndrim konsekuent pro Partisë sonë dhe asaj të Kinës dhe hodhën bazat e një pune organizative, luftuan për të krijuar dhe për të zgjeruar radhët e tyre. Mirëpo në disa prej tyre (dhe kjo ishte e natyrshme), përderisa nuk u vendosën themeli të shëndosha marksiste-leniniste, që përbëjnë bazën e një partie të tipit Lenin-Stalin, përderisa nuk pati norma bolshevike në jetën e tyre të brendshme, doemos do të kishte çarje, fraksione dhe kuptime të ndryshme të politikës që duhej të ndiqej si në çështjet e brendshme, ashtu edhe në ato ndërkombëtare.

Kështu u pa se kur u acaruan situatat në mes

Partisë sonë marksiste-leniniste të Punës dhe Partisë Komuniste të Kinës dhe kur në Kongresin e 7-të të Partisë sonë ne vumë qartë në dukje falsitetin e maocedunidesë, që kinezët donin ta imponoin si marksizëm-leninizmin e kohës sonë, në mjaft nga këto parti u duk një çarje. Disa prej tyre mbajtën dhe mbajnë anën e maocedunidesë. Në ato rrethana u duk qartë se këto parti nuk ishin ndërtuar në baza të shëndosha marksiste-leniniste dhe qëndrimet e tyre të mëparshme ishin qëndrime koniunkturale, ashtu si të tanishmet, të lidhura me interesat e grupeve kryesore që kishin themeluar këto parti. Ato u bënë njësh për të mbështetur haptazi partinë revizioniste të Kinës, ose rryma të tjera politike në shërbim të kapitalit, të cilat kishin interes që këto parti të mos zhvilloheshin në drejtimin marksist-leninist, por, ose të braktisnin vijën e drejtë, ose të vazhdonin të mashtronin atë opinion që kishin mundur të krijonin me qëndrimet e tyre të mëparshme. Kështu ngjau për shembull me Partinë Komuniste të Francës (marksiste-leniniste), të Belgjikës, të Holandës, me njëfarë Strobeli, i cili, deri në fund, ishte «antikinez», pastaj u bë prokinez. Në të vërtetë ky njeri nuk kishte dhe nuk ka parti, por hiqej e hiqet sikur ka një parti komuniste austriake, marksiste-leniniste. Kështu ka ndodhur edhe me partinë e Kilit, të Cejlonit dhe me disa parti të tjera të vendeve kapitaliste në kontinente të ndryshme.

Ka edhe parti të tjera si ajo e Italisë, e cila vitin e fundit devijoi nga pozitat e mëparshme, që i quante marksiste-leniniste. Ne, komunistët shqiptarë, i kemi ndihmuar udhëheqësit e kësaj partie që të forcoheshin, të organizonin punën e luftën e tyre, kemi pasur me ta bisedime të vazhdueshme dhe kemi shprehur haptazi pikëpamjet tona politike, ideologjike e organizative. Duhet thënë se ata nuk i kanë kundërshtuar pikëpamjet tona marksiste-leniniste, bile tregoheshin shumë solidarë. Mi-

rëpo del se, në fakt, ata nuk kishin qenë solidarë me ne, sepse erdhi një çast kur devijuan, duke nxjerrë një revistë të re me emrin «Otobre», e cila, nëpërmjet artikujve redaksionalë që botoi, në ata numra që dolën, mbronte idenë e një bashkekzistence me «grupet antiberlinguer» që vegjetonin në partinë revizioniste italiane. Kjo revistë mbrojti edhe pikëpamjen se Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) duhej të afrohej me Bashkimin Sovjetik, pse në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik na paska jo vetëm revizionistë, por edhe «revolucionarë»!

Po të analizohen thellë këto veprime e qëndrime, del se ato e shndërrojnë partinë e tyre në një bisht e agjenturë kapitalisto-revizioniste të borgjezisë italiane, amerikane e sovjetike. Fakt është se, në thelb, Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste) hyri në kontakte dhe në bashkëpunim me revizionistët italianë. Që në atë kohë, në mënyrë shoqërore ne u bëmë vërejtje, duke u thënë se kjo ishte një rrugë e gabuar. Në fillim ata gjoja i pranuan vërejtjet tona shoqërore, gjoja e dënuan revistën «Otobre», dhe në fakt ajo nuk doli më, por nuk morën më kontakt me ne, megjithëse Fosko Dinuçit i kërkuam të bënim një takim në Tiranë dhe të shpjegoheshim për këtë çështje. Ftesën tonë ai nuk e refuzoi, por nuk erdhi këtu dhe akoma nuk po vjen.

Kemi, për shembull, një parti tjetër, atë të Greqisë, që quhet marksiste-leniniste, por as ajo nuk është në pozita marksiste-leniniste revolucionare. (Në Greqi dhe jashtë deri tash ka nja tri parti të tjera që e quajnë veten komuniste.) Me këtë parti, të quajtur marksiste-leniniste, që për ne s'ka qenë kurrë një parti serioze, ne shumë vonë vendosëm lidhje dhe u përpoqëm duke shpjeguar qëndrimet tona për çdo çështje, ta ndihmonim sa të ishte e mundur që të mëkëmbej. Nga pamja e jashtme duket sikur kjo parti nuk ka hyrë në kundërshtim me Partinë

tonë, por në fakt ajo, për çështjen e qëndrimit ndaj maocedunidesë, është në kundërshtim me Partinë tonë. Kjo parti në mjetet e saj të propagandës thotë se me Partinë e Punës të Shqipërisë është dakord, dhe këtë e bën për të gënjyer anëtarët e vet, por thotë se vetëm në një çështje nuk është dakord dhe se për këtë do të shpjegohen, megjithëse në fakt s'kanë se për çfarë të shpjegohen. Aktualisht ata po përgatitin kongresin e tyre dhe, sipas të dhënave që kemi, në këtë kongres, kur të mblidhet, do të ngrenë lart maocedunidenë. Ç'janë këta të ashtuquajtur komunistë marksistë-leninistë? Ata s'bëjnë gjë tjetër veçse lojën e kinezëve, për t'u vetëquajtur marksistë-leninistë dhe për ta paraqitur maocedunidenë si ideologjinë që i udhëheq. Një parti e tillë nuk mund të quhet marksiste-leniniste.

Si këto parti që përmenda ka edhe të tjera. Elementë të lëkundshëm, deviatorë, që u krijojnë telashe partive marksiste-leniniste në luftën e tyre revolucionare, nuk përjashtohet mundësia që të dalin edhe në gjirin e partive që qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste. Kjo është pjesë përbërëse e luftës klasore brenda radhëve të partisë, pjesë e luftës për forcimin e frymës revolucionare e të fitores mbi borgjezinë kapitaliste. Kjo gjë ka qenë dhe është e paevitueshme, por, në qoftë se partia është ngritur mbi baza të shëndosha dhe qëndron në pozita revolucionare marksiste-leniniste, në qoftë se ajo i zbaton parimet dhe normat e një partie të tipit Lenin-Stalin, në qoftë se mbështetet në klasën punëtore dhe në ideologjinë e saj, e përvetëson këtë ideologji dhe e bën një armë të efektshme për të zhvilluar luftën në krye të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse, ajo nuk ka frikë nga elementët përçarës e deviacionistë që mund të dalin, përkundrazi i spastron ata me guxim e vendosmëri, i hedh si skoriet jashtë radhëve të veta dhe forcon bazën e saj, kalit anëtarët në luftë e në aksion.

Me fjalë të tjera parimet bazë, që në përgjithësi shokët e Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) i kanë kthyer në teza, janë të domosdoshme për një parti marksiste-leniniste. Ato ne duhet t'i propagandojmë me çdo mjet e në çdo formë, në teori e në politikë. Këtë ne duhet ta bëjmë, sepse kjo është një nga detyrat tona internacionaliste. Fitorja e një partie në një vend të vetëm ose e disa partive në disa vende të ndryshme, varet pikërisht në atë nëse ajo ose ato qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, mbrojnë teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit dhe luftojnë me rreptësi kundër deviacioneve revizioniste moderne, socialdemokrate e socialiste të vjetra.

Prandaj, në përgjithësi, ne duhet t'i mirëpresim propozimet e shokëve gjermanë, t'i diskutojmë me ta dhe t'u themi atyre se nuk kemi kundërshtim, përkundrazi në takimet tona me partitë motra ne jemi për atë që t'i theksojmë këto gjëra. Por duhet të theksojmë edhe se vënia në jetë e këtyre parimeve nuk varet nga fjala jonë. Ajo varet nga vetë komunistët e çdo partie që është marksiste-leniniste, varet nga ajo nëse i pranon me të vërtetë këto parime dhe i zbaton në jetë, pse mund të ndodhë që parimet të pranohen me fjalë, por në jetë, në praktikë, të veprohet në të kundërtën. Natyrisht, në takimet që bëjmë me atë parti motër që lëkundet nga këto pozita, që mban qëndrime taktike të gabuara ose që në ndonjë çështje strategjia e saj ndryshon, ne do të përpiqemi të diskutojmë, të shprehim mendimin tonë kritik, siç mund të thotë dhe ajo mendimin e saj kritik për pikëpamjet tona. Kjo gjë lipset të bëhet dhe në çdo rast duhen përdorur bindja, argumentimi i shëndoshë marksist-leninist dhe jo dënimi i menjëhershëm i ndonjë partie që vërtet bën ndonjë gabim, por e njeh dhe e korrigjon atë. Në qoftë se një parti nuk e njeh gabimin e saj dhe vazhdon ta thellojë, po të jetë se ajo ka rëndësi, ka krijuar një

opinion rreth vetes dhe me devijimin e saj kërkon të molepsë me këtë opinion dhe të tjerët, atëherë edhe ne haptazi duhet ta kritikojmë dhe ta dënojmë atë. E gjithë kjo duhet bërë vetëm pasi të kemi konsumuar të gjitha përpjekjet për ta shpëtuar këtë parti, ashtu siç bëjmë edhe brenda radhëve të partisë për të shëruar e për të shpëtuar shokët që gabojnë, të cilët përpiqemi t'i edukojmë dhe nuk i hedhim menjëherë jashtë partisë, përveç rastit ekstrem, kur faji i tyre është i rëndë, kur këtë faj ata nuk e pranojnë dhe nuk duan të ndreqen. Kështu duhet vepruar në marrëdhëniet në mes partive marksiste-leniniste, kur ndonjëra prej tyre edhe mund të gabojë.

E HENE
31 MARS 1980

SOT NË BOTË NUK MUND TË RUHET STATUKUOJA

Kur i hedhim një sy gjendjes ndërkombëtare, gjë që duhet ta bëjmë vazhdimisht, konstatojmë se kjo është shumë e turbullt. Imperializmi, socialimperializmi dhe kapitalizmi botëror po armatosen për t'u mbajtur në fuqi, për të mbajtur nën zap popujt e botës, për të rindarë zonat e influencës dhe për të goditur atë që do të dëmtonte statukuonë aktuale që është në favor të tyre.

Por mund të themi se aktualisht **në botë nuk mund të ruhet statukuoja. Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, socialimperializmi kinez dhe të gjithë kapitalistët e botës janë në ethe, në lëvizje, në goditje me njëri-tjetrin,** qoftë duke përdorur satelitët e tyre, ashtu edhe hapur, duke zaptuar vende të ashtuquajtura të pavarura, siç ishte Afganistani ose ndonjë vend tjetër.

Interesat e mëdha të këtyre superfuqive po përqendrohen në Lindjen e Mesme, në kontinentin afrikan dhe në Azinë Juglindore. Në këto rajone u janë krijuar vështirësi të mëdha, qoftë sovjetikëve, aq më tepër tani me pushtimin e Afganistanit, qoftë amerikanëve, të cilëve u janë tronditur thellë bazat politiko-ekonomiko-ushtarake në Iran; në vështirësi të mëdha kanë ndeshur edhe synimet agresive kineze në Azinë Juglindore dhe në të katër anët e tjera të botës, ku ky imperializëm i verdhë ka tendenca të etshme zgjerimi. Por edhe kapitalizmi francez ndodhet përpara një gjendjeje mjaft të vështirë në ish-

-kolonitë e tij të Afrikës, të cilat i ka kthyer në shtete gjoja të pavarura por që në fakt janë zonë e tij e influencës.

Zjarri i një lufte botërore akoma nuk është ndezur, por zjarre lokale kanë shpërthyer dhe këto krijojnë vatra, të cilat, sot ose nesër, kur kontradiktat të acarohen shumë, do të kthehen në një luftë botërore imperialiste.

Në këtë shkrim nuk do të zgjatem në zhvillimin aktual të situatave në përgjithësi, por do të kufizohem vetëm në disa mendime rreth situatës shqetësuese që rrjedh nga agresiviteti fashist i Kinës.

Udhëheqja aktuale kineze, që erdhi pas vdekjes së Çu En Lait dhe të Mao Ce Dunit, pa as më të voglin skrupull, është një nga udhëheqjet më agresive të botës për paqen botërore. Qëndrimet e saj politike, të jashtme dhe të brendshme, janë flagrante, ajo kërcënon me luftë. Qëllimi i saj është sulmi mbi Bashkimin Sovjetik, për ta likuiduar këtë si një fuqi të madhe dhe për të zaptuar Siberinë e pasur deri në Uralet.

Përveç kësaj, Kina e sotme imperialiste synon në mënyrë të veçantë të pushtojë gjithë Azinë Juglindore, domethënë Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën, Singaporin, Indonezinë, pse jo, edhe Filipinet. Me fjalë të tjera qëllimi i saj është që gjithë pellgu juglindor i Azisë të bëhet pjesë e perandorisë së re kineze. Por, përveç këtyre dy synimeve, **Kina e sotme ka në plan të saj hegjemonizmin botëror,** domethënë që, në një mënyrë ose në një tjetër, **të dominojë kontinentet, botën.** Ky është një plan i madh, i parealizueshëm, por, në kokën e agresorëve fashistë kinezë mund të realizohet. Ata janë nacionalistë të tërbuar, bile do të bëhen më keq se militaristët japonezë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ata kanë idenë e shtetit të madh që është një realitet në praktikë, pse në katër veta në botë një është kinez. Mirëpo kjo i nxit ata gjithashtu ideologjikisht. Prandaj udhëheqësit revi-

zionistë kinezë mendojnë se Kina mund ta pushtojë botën dhe tregjet e saj jo vetëm duke bërë luftëra grabitqare, që ata i quajnë «çlirimtare», por edhe në mënyrë paqësore kanë mundësi ta dominojnë botën, duke i krimbur shtetet e kontinentet edhe me njerëzit e vet. Dhe aktualisht udhëheqja kineze ka hyrë në veprim në këto drejtime. Ten Hsiao Pini gjatë një interviste u deklaroi gazetarëve japonezë se duhet të nënshkruhet një traktat ushtarak midis Kinës, Japonisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të «botës së tretë» kundër socialimperializmit sovjetik, për ta shkatërruar Bashkimin Sovjetik. Sa është e vërtetë kjo thënie e Ten Hsiao Pinit, nuk e dimë, por janë agjencitë japoneze dhe të tjera ato që e japin këtë intervistë të tij. Pra, udhëheqja aktuale kineze me tendenca agresive predikon një aleancë globale ku, natyrisht, të dominojnë Kina dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër socialimperializmit sovjetik. Një kjo.

Në dukje dhe aktualisht në këto situata një gjë e tillë ndoshta është e pamundur, por ideja dhe qëllimi u hodhën nga kinezët. Për t'ia arritur këtij qëllimi, natyrisht, udhëheqja aktuale kineze ka vënë të gjitha forcat për militarizimin e Kinës. Për të realizuar këtë qëllim, militarizimin e të gjithë ekonomisë, Kinës i vijnë në ndihmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Franca, Anglia dhe vende të tjera të industrializuara, siç është edhe Gjermania Federale e Bonit.

Të gjitha këto shtete imperialiste po investojnë kapitale të mëdha në Kinë, bëjnë investime në fushën e përgatitjeve ushtarake, për armatime të sofistikuara, investojnë për shfrytëzimin e pasurive të mëdha të nëntokës që ka Kina, sidomos të hekurit, të naftës dhe të mineraleve të tjera të çmueshme.

Siç kam thënë edhe në shkrimet e mëparshme, udhëheqja aktuale kineze e ka flakur tej edhe atë cipë të hollë pseudomarksiste me të cilën Mao Ce Duni, ky «La

Fajet» i revolucionit kinez, kishte mbuluar fytyrën dhe veprimet e tij prej borgjezi demokrat. Aktualisht Ten Hsiao Pini dhe banda e tij që kanë ardhur në fuqi shkojnë më tej nga një demokraci borgjeze kapitaliste, po shkojnë në rrugën e fashistizimit të vendit, në përgatitjen e luftës. Për këtë qëllim sot në Kinë kanë sjellë në udhëheqje gjithë shtresën e pasur të qytetit dhe të fshatit e cila «ishte goditur» dhe «shpronësuar» nga revolucioni demokratiko-borgjez i së ashtuquajturës Parti Komuniste të Kinës.

Tani në Kinë, me dekrete e me shkop, po zhduket çdo ndjenjë lirie e demokracie, ndryshe Kina nuk mund «të modernizohet». Me «modernizimin» që predikojnë ata, duhet kuptuar fashistizimi dhe kthimi i ekonomisë kineze në një ekonomi luftarake imperialiste.

Format politiko-ideologjike që përdor aktualisht udhëheqja kineze, për të zhdukur çdo liri demokratike, janë të hapëta. Masat që merren atje për demoralizimin në shkallë të gjerë të popullit kinez po bëhen një jetë e re në Kinë, e cila ka përfshirë masa të shumta punonjësish. Ky degjenerim që po përhapet atje, pasqyron një mënyrë jetese nga më të shthururat e kapitalizmit botëror në kalbëzim. Që nga pornografia e deri te banditizmi dhe kusaria po zhvillohen në shkallë të gjerë në Kinë.

Natyrisht, ky degjenerim, këto forma administrative të drejtimit të shtetit dhe të ekonomisë nuk realizohen pa përpjekje, pa vështirësi e pa kundërshtime. Por aktualisht konstatohet se rezistenca që u bëhet këtyre fashistëve po shtypet, gjë që e vështirëson situatën jo vetëm për Kinën, por edhe për botën.

Kina ndjek shembullin e militarizmit japonez, i cili u bë jashtëzakonisht i rrezikshëm para Luftës së Dytë Botërore dhe një nga faktorët më agresivë në këtë luftë. Pra, këtë rrugë ndjek edhe Kina tani, vetëm se duhet të kemi parasysh që, duke arritur këtë militarizim, kjo rre-

zikshmëri e Kinës bëhet 10 apo 20 herë më e fortë dhe më e madhe se ajo e militarizmit japonez, për arsye të shovinizmit kinez, të frymëzimit fashist e të numrit të madh të popullsisë që ka. Popullsia e Kinës, siç e dimë, është aq e madhe, saqë Mao Ce Duni thoshte se nuk humbasim ndonjë gjë po të na vriten në luftë 300 milionë kinezë. Udhëheqja aktuale nuk e vlerëson fare jetën e njerëzve, prandaj, pasi ta armatosë këtë mizëri njerëzish, ajo do ta hedhë pa hezitim në luftën grabitqare imperialiste në çdo moment e mbi këdo dhe një veprim të tillë ajo e bën me bindjen se do të vendosë hegjemoninë e vet. Por, para se ta ndërmarrë këtë veprim, aktualisht Kina popullsinë e saj e vë në balancën e të ashtuquajturit modernizim.

Udhëheqja e sotme kineze ka deklaruar se është e gatshme të vërë në dispozicion të imperializmit amerikan dhe të çdo kapitalizmi tjetër krahun e punës, kurse këta mjetet e punës, dhe, tok me ta, të ndërtojnë ku t'u leverdisë imperialistëve amerikanë e të tjerëve, të investojnë për të shfrytëzuar e për të skllavëruar popujt.

Pra tani, në këtë kohë paqeje relative, Kina i përdor njerëzit e saj si skllevër, ashtu siç janë përdorur afrikanët nga kolonizatorët portugezë, francezë, amerikanë e anglezë, që i kanë çuar në kolonitë e tyre për të ndërtuar dhe për të shfrytëzuar vende të ndryshme. **Tani si zezakët e dikurshëm afrikanë janë bërë të verdhët kinezë.**

Vënia e «skllevërve» kinezë në dispozicion të imperialistëve të ndryshëm nga ana e udhëheqjes aktuale të Kinës i siguron kësaj devizë, por, nga ana tjetër, gjithë kjo forcë krahu në mënyrë të heshtur, në formën e një emigracioni të madh, i shërben për të pushtuar ato vende ku gjithë këta njerëz venë për të punuar. Me fjalë të tjera, duke lëshuar jashtë kufijve të saj me dhjetëra milionë «skllevër», Kina përgatitet për luftë. Kështu kinezët do të vënë krahë pune të lirë në dispozicion të amerikanëve, të francezëve, të gjermanëve, të anglezëve dhe kjo do të konsistojë në një emigracion të madh që do t'i shtohet emigracionit të vjetër kinez, afro 40-50 milionësh, duke krijuar në kontinente të ndryshme një forcë ushtarake për ta përdorur në momentet e duhura kundër asaj superfuqie që kërkon të mbajë pozitat e fituara më parë ose që përpiqet të depërtojë në zona të tjera të influencës. Mund ta quajmë këtë një plan të madh djallëzor kinez që ka mbështetjen e imperializmit amerikan dhe të kapitalit perëndimor evropian në përgjithësi, për të kundërshtuar pushtimin sovjetik në kontinentin afrikan, në Azinë Juglindore dhe në të gjitha vendet e tjera të botës.

Është fillimi i zbatimit të këtij plani pushtues fashist kinez. Por ky plan do të ndeshë patjetër në rezistencën e popujve. Aktualisht ne shohim se depërtimi politik dhe ekonomik kinez në vende të ndryshme të botës bëhet me vështirësi të mëdha. Kjo e ka arsyen në urrejtjen që kanë popujt për kolonizatorët e vjetër dhe të rinj, në dyshimin që u ngjallin fjalët e bukura të tyre, si dhe në mungesën e mjeteve financiare e teknike të Kinës aktuale.

«Ndihma» që u jep Kina vendeve të ndryshme, është shumë e paktë në raport me investimet e mëdha që bëjnë kolonizatorët e vjetër, që nga imperializmi amerikan deri tek ai anglez, që mban bishtin e kapitalizmit botëror. Sidoqoftë udhëheqja aktuale kineze di të përfitojë nga acarimi i kontradiktave amerikano-sovjetike dhe të bëhet dora e djathtë e imperializmit amerikan, për të qenë mish për top në momentet kur Uashingtoni të gjendet në vështirësi të mëdha dhe në kontradikta të pazgjidhshme me socialimperializmin sovjetik. Pra, Kina, duke përgatitur dhe duke pritur momentin kur ajo të bëhet me të vërtetë vepruese pa ndihmën e imperializmit amerikan, po ua ofron veten, si mish për top, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kapitalizmit botëror.

Ne shohim se kontradiktat në gjirin e fuqive të mëdha po shtohen e po thellohen dhe, plani kinez si dhe plani amerikan, nuk mund të ecin ashtu siç duan këto superfuqi, për arsye se edhe superfuqia tjetër, Bashkimi Sovjetik me aleatët e tij, edhe Evropa kapitaliste nga ana e saj, përpiqen të bëjnë një politikë të balancuar për të zgjatur jetën e tyre dhe shfrytëzimin mbi ata popuj, mbi të cilët kanë hedhur kthetrat. Kështu ndihma që fuqitë kapitaliste të Evropës do t'i japin Kinës, që ajo «të modernizohet», do të jetë e atillë që të mos rrezikojë pushtetin e vendosur mbi to nga ana e imperializmit amerikan, e militarizmit japonez dhe atij të Gjermanisë Perëndimore.

Kjo, natyrisht, është një ndihmë që kërkon, gjithashtu, edhe vigjilencë nga ana e tyre, por vigjilenca ka një kufi, se nxitja e kapitalit, nxitja për fitime të mëdha dhe për të likuiduar një kundërshtar aktual, mund të sjellë atë që Kina të bëhet një shtet militarist i rrezikshëm jo vetëm për Bashkimin Sovjetik, por edhe për imperializmin amerikan, atë japonez dhe për kapitalizmin evropian.

Prandaj këto eventualitete mund të sjellin edhe ndryshime në aleancat e kapitalistëve, ndryshime pozicionesh, që do të varen nga rrethanat e krijuara, si rezultat i zhvillimit kinez, sovjetik, amerikan, japonez etj., si dhe shtrirjen e kthetrave të njërit ose të tjetrit në shumë vende dhe në shumë pozita kyçe, shtrirje kjo që do të shkaktojë ndryshime qëndrimesh në politikë dhe në aleanca.

Ja ç'po shohim ne aktualisht: të marrim marrëdhëniet kino-jugosllave dhe kino-rumune. Për një kohë u bë bujë e madhe që miqësia midis Kinës dhe këtyre dy vendeve ishte një ngjarje me rëndësi të madhe politike: një vend «socialist», siç ishte Kina, lidhi marrëdhënie të ngushta ekonomike, politike dhe partie me këto dy vende josocialiste, por të ashtuquajtura socialiste.

Jugosllavia, për t'iu kundërvënë Bashkimit Sovjetik dhe për t'u rreshtuar më fuqimisht përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleatit të saj, u afrua me Kinën dhe u duk që marrëdhëniet e tyre do të ecnin kurdoherë përpara, kurse Rumania nga ana e saj i kishte ngrohur këto marrëdhënie që më parë se Jugosllavia dhe dukej sikur ecte me një revan të madh e të papërmbajtur drejt një miqësie të përjetshme me Kinën, nga e cila mori ndihma e kredi dhe kësaj miqësie i dha ngjyrën e një kundërshtimi ndaj presionit sovjetik që i bëhej Rumanisë.

Por, siç thotë populli, u ftohën p... dhe aktualisht shohim që marrëdhëniet e Jugosllavisë me Kinën po fishken dhe po ftohen edhe marrëdhëniet me Rumaninë e jo vetëm kaq, kinezët po i bëjnë presion ekonomik Rumanisë, e cila e tregoi fytyrën e saj të vërtetë që është një satelit agjenturor i Bashkimit Sovjetik e që me Kinën nuk e lidhin shumë gjëra.

Për ftohjen e marrëdhënieve, natyrisht, u mor si një pretekst çështja e Afganistanit, por preteksti i vërtetë është se këto vende nuk shohin t'u jepet ndonjë ndihmë konkrete nga Kina si ajo që kanë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto dy vende pseudosocialiste ndjekin koniunkturat dhe aktualisht këto janë për ftohjen e marrëdhënieve me Kinën, kështu që kjo në Evropë nuk ka baza të forta, kurse në Afrikë nuk ka fare. Atje Kina përpiqet të dërgojë skllevër në shërbim të imperialistëve, të bëhet, si me thënë, «kubanezi» i imperializmit amerikan. Por të paktën kubanezët mbështetin regjimet e Angolës, të Etiopisë etj. me armë; kurse Kina aktualisht nuk ka të atilla baza që ta bëjë këtë gjë, për arsye se edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës veprojnë në këto vende me forma të tjera, ndryshe nga ato të sovjetikëve.

E DIEL
27 PRILL 1980

AKT BANDITESK I KARTERIT QË PËSOI DISFATË TË TURPSHME

Operacioni barbar amerikan me komando, i hedhur në Iran për të shpëtuar bandën e spiunëve, që gjenden në çerdhen e spiunazhit në Teheran dhe që quhet ambasada amerikane, dështoi me turp të madh. Ky akt banditesk prej gangsterësh e mbuloi me një tjetër skandal turpi imperializmin amerikan dhe presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhimi Karterin.

Ky, në një fjalim televiziv që mbajti dy ditë më parë, pohoi se operacioni kishte filluar të përgatitej që në muajin nëntor të vitit 1979 dhe se ishte vetë përgjegjës për ndalimin e këtij veprimi, për arsye se dështoi, se u përplasën ose nuk ishin në gatishmëri aeroplanët dhe helikopterët. Karteri njoftoi se 8 oficerë, anëtarë të ekuipazheve të avionëve vdiqën, disa dhjetëra të tjerë u plagosën, kurse ata që mbetën, u tërhoqën dhe ngushëlloi familjet e të vrarëve, duke thënë rrofshin «heronjtë» banditë. Këto tha Xhimi Karteri, që u mbulua me turp.

Ky veprim banditesk diskreditoi një nga fuqitë më të mëdha të botës me teknikën më të sofistikuar, fuqinë ushtarake amerikane dhe tregoi dobësinë e kalbëzimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Populli amerikan është i traumatizuar dhe Karteri, «ky Hamlet i Shtëpisë së Bardhë», siç e ka quajtur në një artikull të tij të fundit Andre Fonteni në gazetën «Lë Mond», që donte të tregohej një «luan», po izolohet deri edhe nga miqtë.

Ky akt barbar po denoncohet kudo në botë jo vetëm nga popujt, por edhe nga vetë aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët, ashtu siç lënë minjtë vaporin kur fillon të mbytet, gjejnë një mijë e një arsye të shkundin zgjedhën amerikane, duke akuzuar Karterin që nuk i lajmëroi. Kështu këta lajnë duart si Pons Pilati. Vetëm kryeministrja e Britanisë Theçer dhe Trudoja i Kanadasë mburrën «trimërinë» tragjike të Karterit. Në fakt, bota kapitaliste, e zhytur në një konfuzion të madh, në frikë dhe në dyshime për mbrojtjen amerikane dhe e shqetësuar në kulm nga kriza energjetike, veçanërisht nga prerja e naftës iraniane, po përpiqet të ngjitë «kupat e thyera». Agresorët sovjetikë nga ana e tyre fërkojnë duart. Ata mendojnë se intervencioni dhe dështimi i operacionit amerikan do të mbulojnë agresionin e tyre në Afganistan. Por, siç thotë populli ynë, me nder, m... nuk lahet me sh.... Si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik janë që të dy imperialistë, janë agresorë. Veprimet e të dyja palëve janë agresione. Ai i sovjetikëve u bë dhe po pëson disfata, ndërsa ky i amerikanëve dështoi porsa filloi, megjithëse mund të përsëritet pas një kohe. Imperialistët janë gangsterë, arrogantë, luftënxitës, ata nuk heqin dorë nga veprime të tilla barbare, prandaj ne duhet t'i luftojmë dhe t'i demaskojmë ata deri në fund.

Agresioni amerikan kundër Iranit, ashtu si ai sovjetik kundër Afganistanit, ai kinez mbi Vietnamin, ose edhe agresioni i këtij të fundit mbi Kamboxhian, do të kenë kurdoherë rrjedhime në arenën ndërkombëtare. Ato janë shenja të qarta që i paraprijnë një lufte të re botërore imperialiste.

Prandaj ne duhet të jemi shumë vigjilentë, të forcojmë ekonominë, të forcojmë mbrojtjen dhe unitetin si dhe disiplinën proletare kudo në punët tona. Brenda vendit ne duhet të jemi të fortë, por edhe në arenën ndër-

kombëtare, me qëndrimet tona të drejta të përpiqemi që të zgjerojmë rrethin e miqve dhe të popujve në favor të vendit tonë socialist. Të sulmojmë, të sulmojmë dhe kurdoherë të sulmojmë armiqtë më të egër të popujve, imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe atë kinez, revizionistët e ndryshëm dhe gjithë kapitalizmin botëror.

Ramizit i rekomandova të shkruajmë një artikull për «Zërin e popullit», në të cilin, përveç të tjerave, të argumentojmë falsitetin e argumentimeve amerikane dhe të miqve të tyre që japin lloj-lloj variantesh për disfatën katastrofike të operacionit agresiv amerikan.

E para, të shkruhet se arsyet që dha Karteri janë të alambikuara dhe false. Ajo që thuhet se forcës agresive më të madhe të botës, me armatime nga më të sofistikuarat, iu prish gjoja një helikopter, pastaj një i dytë, më tej një i tretë, një i pestë, ... asnjeri nuk e ha, çdo gjë në këtë drejtim thuhet vetëm për të shpëtuar fytyrën e autorëve të agresionit. Si është e mundur që një operacion i tillë, i përgatitur intensivisht për 100 ditë me radhë, të pësojë Vaterlonë? Jo vetëm kaq, por pjesa e banditëve që shpëtoi u largua në panik, duke lënë në rërën e nxehtë të Iranit oficerët e vrarë amerikanë si ushqim për korbat, dhe avionët e djegur në fushën e Tabasit. Karteri pohoi se gjoja për arsye defekti teknik urdhëroi ndalimin e operacionit, domethënë tërheqjen në panik të komandove. Vetëm dështimi, tërheqja në panik dhe katastrofa politike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës qëndrojnë, gjithë të tjerat bien.

E dyta, as versioni tjetër, sipas të cilit gjoja sovjetikët, me anë të satelitëve, ua ngatërruan amerikanëve ndërlidhjen, nuk qëndron. Një gjë e tillë mund të bëhet, por jo kundër amerikanëve që i njohin aq mirë si edhe sovjetikët këto mjete e mënyra, prandaj jo duhej, po me siguri amerikanët kishin marrë masa më parë kundër veprimeve eventuale të sovjetikëve. Avionët e morën të saktë urdhrin që të tërhiqeshin në panik, pse nuk ua prishën edhe këtë urdhër sovjetikët? Prandaj edhe ky version është një flluskë sapuni që bie.

E treta, qëndron supozimi sipas të cilit sovjetikët, duke vëzhguar këto veprime të amerikanëve, i lanë këta të angazhoheshin në Tabas dhe menjëherë u dhanë ultimatum që brenda një kohe rekord, sigurisht vetëm prej pak orësh, të ndalonin operacionin e të largoheshin, ndryshe do të ndërhynin me trupat e tyre gjoja për të shpëtuar Iranin, me fjalë të tjera ta pushtonin këtë ashtu siç bënë me Afganistanin. Sovjetikët morën me këtë hakën e shuplakës që hëngrën hrushovianët 18 vjet më parë. Atëherë revizionistët sovjetikë u mbuluan me turp, këtë herë u mbuluan me turp imperialistët amerikanë. Karteri, si Hrushovi dikur, u tërhoq me bisht në shalë, në panik. Bashkimi Sovjetik mundet që blofoi. Ai kishte mundësi edhe ta pushtonte Iranin, se trupat e logjistikën përkatëse i kishte si në kufi të Iranit, ashtu edhe në Afganistan.

Karteri nuk e kishte llogaritur faktorin sovjetik. Ai nuk ishte përgatitur për një ballafaqim në shkallë të gjerë, që do të çonte në një luftë botërore imperialiste. Ai kishte llogaritur që operacioni të kryhej me shpejtësi rrufeje, por s'e lanë socialimperialistët sovjetikë të vepronte kështu. Ai e mbajti të fshehtë operacionin agresiv edhe nga Senati, edhe nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, por edhe nga aleatët e NATO-s. Në qoftë se e pranojmë këtë version, Bashkimi Sovjetik ia diktoi planin dhe ia bëri gjëmën pa bërë zhurmë. Zhurmën e bëri vetë Karteri. Ai personalisht shpalli dështimin, panikun, mosbesimin që krijoi dështimi i operacionit dhe diskreditimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë sot në rend të ditës. Karteri punoi vetë në favor të sovjetikëve, të cilët po flasin me të madhe për dështimin e agresionit ameri-

kan, sepse ky mbuloi zhurmën rreth problemit afgan dhe gjithë poshtërsive të tjera të agresorëve sovjetikë.

E katërta, edhe një supozim tjetër. Amerikanët mund të kenë hedhur një grup të madh desantësh në Iran dhe ta kenë lënë këtë atje me detyrën që tani të shpërndahen dhe më vonë të grumbullohen tok me agjenturën që kanë brenda në këtë vend e në Teheran dhe së bashku të ndezin luftën civile. Me sa duket Karteri ka preferuar kështu një turp të madh të përkohshëm për të korrur më vonë në pragun e zgjedhjeve si president një fitore tjetër më të madhe. Ky veprim mund të konsiderohet si një gënjeshtër lufte, për një veprim tjetër më të madh në të ardhmen. Koha do të zbulojë versionin e vërtetë.

Iranianët duhet të jenë shumë vigjilentë. Popujt, gjithashtu, duhet të jenë shumë vigjilentë dhe të luftojnë kundër banditëve imperialistë amerikanë, sovjetikë, kinezë e të tjerë. Në këto situata të rrezikshme, kriza botërore po thellohet dhe me siguri do të ketë mosmarrëveshje në mes amerikanëve dhe aleatëve të tyre në NATO. Kinezët mund të bëjnë një kthesë prej 90 gradësh drejt sovjetikëve në të njëjtën kohë me kthesën prej 90 gradësh që kanë bërë drejt amerikanëve dhe të mbajnë kështu pozitat e titizmit. Kontradiktat në mes armiqve janë një fitore për popujt, prandaj ato ne duhet t'i thellojmë, t'i demaskojmë dhe të përfitojmë e të ndihmojmë që popujt të fitojnë lirinë, pavarësinë e vërtetë, që popujt të shkatërrojnë përgatitjet për luftë që bëhen nga sovjetikët, amerikanët dhe kapitali botëror.

MBI SITUATËN NDËRKOMBËTARE

Pas pushtimit ushtarak të Afganistanit nga ana e socialimperializmit sovjetik dhe pas ndërhyrjes së komandove ushtarake të imperializmit amerikan në Iran, gjoja për të shpëtuar pengjet që mbahen në ambasadën amerikane në Teheran, gjendja ndërkombëtare po turbullohet e po acarohet nga dita në ditë, vazhdimisht. Ne po shohim se Bashkimi Sovjetik socialimperialist po vepron haptazi e në mënyrë brutale, me forca ushtarake e me diversion në Afganistan e në rajone të tjera të Lindjes së Mesme, në Afrikë e gjetiu.

Përpara kësaj politike ekspansioniste e agresioneve të socialimperializmit sovjetik, shohim gjithashtu se imperializmi amerikan është në dilemë, i duhet të veprojë edhe ai si socialimperializmi sovjetik, domethënë të ndërmarrë të njëjtët hapa agresivë. Por, kjo çështje shtrohet kështu kur si imperializmi amerikan, ashtu edhe socialimperializmi sovjetik janë mbërthyer nga një krizë e madhe ekonomiko-politike.

Natyrisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë zgjeruar zonat e tyre të influencës, por tash atyre u duhet t'i mbajnë ato të pacenuara, bile t'i forcojnë. Mirëpo aktualisht ato nuk janë në gjendje, si më parë. Siç e dimë, pas Luftës së Dytë Botërore, imperializmi amerikan korri një fitore të madhe mbi kundërshtarët ose «aleatët» e vet dhe arriti të bëhej «lidershipi» i ka-

pitalizmit botëror. Forca ekonomike e Shteteve të Bashkuara u rrit shumë dhe u shtri duke pushtuar tregun e frangut francez, të sterlinës angleze, të juanit japonez, të markës gjermane dhe arriti që të ushtronte mbi vendet që përfaqësojnë këto tregje ligjet e veta ekonomike, politike dhe ushtarake. Kështu shoqëritë dhe monopolet e mëdha amerikane infiltruan dhe u instaluan kudo në vendet kapitaliste, në Gjermaninë Perëndimore, në Francë, në Angli dhe në ish-kolonitë e tyre, në Japoni e gjetkë dhe, nëpërmjet Traktatit të NATO-s, u bënë «mburoja» e gjithë botës kapitaliste. Si rrjedhim, kjo shtrirje i dha mundësinë industrisë ushtarake amerikane të punonte me ritme të larta për të sofistikuar armatimet dhe për t'i zhvilluar ato në një shkallë aq të madhe saqë Shtetet e Bashkuara të Amerikës arritën në gjendje t'i lidhnin mirë pas qerres së tyre të gjithë pjesëtarët e NATO-s dhe të bëheshin furnitorët kryesorë të armëve në botë. Kjo, natyrisht, nuk mund të vazhdonte tërë jetën. Kështu erdhi një kohë që pjesëtarëve të NATO-s, të cilët ndaj Shteteve të Bashkuara kishin detyrime dhe në «sofrën e përbashkët» kishin çanakun më të vogël, iu hap edhe atyre oreksi dhe organizuan e forcuan potencialin e vet ekonomik brenda dhe jashtë vendeve të tyre, u fuqizuan gjithashtu ushtarakisht dhe i hynë punës për të krijuar një organizëm të ri reaksionar, Tregun e Përbashkët Evropian.

Me kalimin e kohës, Tregu i Përbashkët Evropian, nga ana e organizimit, e ndarjes së roleve, e kontributeve ekonomike dhe e njëfarë stabiliteti ose marrëveshjeje rreth shkëmbimit reciprok të mallrave që prodhoheshin pak a shumë të planëzuara e të njëfarë stabiliteti monetar kundrejt monedhave të tjera, erdhi duke u forcuar. Tendencat e këtij grupimi synonin të balanconin, ose më mirë të themi të kundërshtonin, sa të ishte e mundur, diktatin amerikan në çështjet ekonomike në Evropë, të

frenonin ekspansionin amerikan në tregjet e vendeve anëtare të Tregut të Përbashkët Evropian, të konkurronin tregun amerikan dhe të zgjeronin tregjet e zonat e influencës së tyre, si në tërësi, ashtu edhe veç e veç për çdo shtet anëtar të këtij Tregu.

I gjithë ky organizim politik e ekonomik bëhej jashtë dëshirave e pushtetit ekonomik amerikan. Bile, dhe kjo është e qartë, një organizim i tillë plot kontradikta nuk u pëlqente Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe nga pikëpamja politike, prandaj ato u përpoqën që ta pengonin krijimin e këtij bashkimi të ri.

Në këtë drejtim e në këtë proces, ne shohim që të shtohen kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës së Bashkuar në Tregun e Përbashkët Evropian, ku secili shtet më vete, po edhe si grup, kanë qëllimet e objektivat e tyre të veçantë, si ndaj njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Këta të fundit veprojnë kundër Tregut të Përbashkët Evropian si nga jashtë, edhe nga brenda. Siç tregojnë ngjarjet, kartën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të dobësuar Tregun e Përbashkët Evropian dhe synimet e tij nga brenda e luan Anglia. Në fakt, mbledhja e kryeministrave të vendeve anëtare të Tregut të Përbashkët Evropian, që u mbajt këto ditët e fundit në Luksemburg, pësoi fiasko pikërisht për shkak të kundërshtimit të Anglisë për të kontribuar me shumën që i caktohej nga partnerët e tjerë të Tregut të Përbashkët Evropian.

Përveç kësaj, nga njëfarë ujdie, për të mos thënë bashkëpunim të ngushtë që ekzistonte në mes Francës dhe Gjermanisë Perëndimore, aktualisht në mes tyre po shohim njëfarë ftohjeje dhe në disa çështje duket qartë se Republika Federale Gjermane mban më tepër anën e amerikanëve. Dihet se Republika Federale Gjermane është

anëtarja më e fuqishme ekonomike, mundet edhe ushtarake e Evropës së Bashkuar. Ja, për shembull, është Boni ai që në krizën e madhe botërore, dhe veçanërisht në krizën e dollarit, ndihmoi disi monedhën amerikane, kurse Franca ka filluar të tregohet më e pavarur ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Franca e Zhiskarit është, si me thënë, fëmija më xanxare e Tregut të Përbashkët Evropian. Ne nuk mund të themi se ajo nuk ka influencë në këtë treg. Por mosmarrëveshjet dhe kontradiktat e Evropës së Bashkuar, të Tregut të Përbashkët Evropian, nuk konsistojnë vetëm në fushën e marrëdhënieve, si grup me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aktualisht çdonjëri prej shteteve që përbëjnë Tregun e Përbashkët Evropian ka filluar në shkallë të gjerë të rikrijojë e të forcojë zonat e veta të influencës. Bile Franca nga ana e saj po aktivizohet gjerësisht edhe me dërgim ushtarësh e komandosh në Afrikë e, veçanërisht, në vendet frankofone. Këto vende Franca i mban nën drejtimin dhe pushtetin ekonomik e ushtarak të saj jo vetëm me anë të financimit dhe të investimeve, por atje ka gjithashtu një bazë kulturore, një shtresë intelektualësh në udhëheqjet e këtyre vendeve. Kështu këto lidhen me Francën jo vetëm ekonomikisht e ushtarakisht, por edhe nga ana kulturore e shpirtërore.

Nga ana e saj Gjermania Perëndimore, që ka një potencial të madh ekonomik dhe ushtarak, livadhis poshtë e lart me grushtin plot marka nëpërmjet shitjes së fabrikave e të teknologjisë kudo ku gjen treg, dhe tregje ajo gjen boll, pse të gjitha vendet e ashtuquajtura të paangazhuara nderin duart e tyre nga të katër anët dhe marrin nga të gjithë.

Edhe Italia investon, por nuk ka fuqinë e dy vendeve që përmenda më lart, as atë të Anglisë, e cila përpiqet gjithashtu të rimëkëmbë zonën e saj të influencës në botë, megjithëse kurdoherë ka qenë dhe vazhdon të jetë një

partnere treçerek luajale ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë.

Për sa i përket anës ushtarake, vendet e Evropës së Bashkuar, që bëjnë pjesë në NATO, me përjashtim të Francës, e cila është pjesëtare e NATO-s, por ushtarakisht nuk është angazhuar në të dhe ka armët e veta bërthamore që nuk i kanë të tjerët, e ruajnë aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe, nën ombrellën e kësaj aleance, e cila ka të çara, por që i mbron nga shiu, nga breshëri dhe nga rrufeja sovjetike, punojnë si për fuqizimin në përgjithësi të saj, ashtu edhe të çdo anëtari veç e veç.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shikojnë lojën e dyfishtë të Tregut të Përbashkët Evropian dhe të pjesëtarëve të NATO-s në këto situata dhe kjo lojë e dyfishtë nuk u leverdis, prandaj kërkojnë që vendet që bëjnë pjesë në NATO t'i binden Uashingtonit, ose më mirë të themi, të njohin udhëheqjen amerikane, qoftë në NATO, domethënë në fushën ushtarake, qoftë në Tregun e Përbashkët Evropian, domethënë në fushën ekonomike. Me fjalë të tjera vendet e Evropës së Bashkuar duhet të bëjnë një politikë të tillë ekonomike, që të mos dëmtojë interesat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkundrazi ato të jenë një shtojcë e tyre dhe, në tregjet ku po futen e po zhvillohen, të kenë parasysh edhe interesat amerikane. Kjo edhe për arsye se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë potencial material dhe teknologjik më të përparuar, gjë që gjoja influencon edhe në «mbrojtjen» e Perëndimit nga forca goditëse e socialimperializmit sovjetik. Mirëpo ligji i xhunglës në botën e kapitalit vepron pa marrë parasysh dëshirat e njërës apo të tjetrës palë, kontradiktat thellohen. Kështu ne mund të mendojmë dhe të themi se Tregu i Përbashkët Evropian reaksionar kapitalist, si një forcë ekonomike, politike dhe ushtarake brenda NATO-s, ka filluar të dalë në skenë, në mënyrë

jo aq të varur dhe jo aq të bindur përballë «lidershipit» amerikan.

Aktualisht, shohim se si përpara imperializmit amerikan ashtu edhe përpara Bashkimit Sovjetik socialimperialist po ngrihet lëvizja popullore nacionalçlirimtare. Ne shohim, gjithashtu, se edhe përpara Evropës së Bashkuar po fuqizohen lëvizja dhe lufta nacionalçlirimtare e popujve për liri, për demokraci, për sovranitet.

Në këto momente, në botë përkrah njëri-tjetrit qëndrojnë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, imperializmi i ri kinez dhe Evropa e Bashkuar. Kontradiktat dhe krizat në mes këtyre blloqeve kapitalisto-imperialisto-revizioniste po thellohen. Kriza e dollarit, e frangut, e markës, e rublës dhe e të gjitha monedhave të tjera të vendeve kapitaliste, shkaktohet nga kriza e madhe politike dhe ekonomike që ka mbuluar këto vende.

Përballë imperializmit të vjetër, tani shohim që socialimperializmi sovjetik po bëhet çdo ditë e më tepër agresiv dhe po ndërhyn me armë në vende të ndryshme të botës. në tregje e në zona influence që i pretendojnë imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror. Prandaj ky invadim ndesh jo vetëm në kundërshtimin e popujve që bien viktimë e agresioneve sovjetike, por edhe në kundërshtimin e imperializmit amerikan dhe të Evropës së Bashkuar.

Ç'është e vërteta sot për sot imperializmi amerikan gjendet në pozita të vështira e të dobëta përballë akteve invaduese të socialimperializmit sovjetik. Kjo edhe për arsye se ai është në kontradikta me partnerët e tij të Evropës së Bashkuar. Kjo e fundit nuk pranon politikën aventureske dhe luftënxitëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk pranon që t'u bindet verbërisht veprimeve të planëzuara në Uashington dhe veçanërisht veprimeve kundër Iranit dhe vendeve të Lindjes së Mesme. Pikërisht për këto dy rastet e fundit, qeveria amerikane i ka qortuar aleatët e vet të Evropës së Bashkuar e të tjerë,

që nuk e mbështetin, duke u thënë hapur se ne, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do t'ju ndihmojmë ju në rast të një sulmi nga sovjetikët, edhe ju duhet të na ndihmoni ne në mbrojtjen e zonave tona të influencës — neokolonialiste në botë.

Ne konstatojmë se fuqitë perëndimore vetëm me fjalë i mbështetin veprimet agresive dhe të çmendura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në realitet, në thelb, ata janë tërhequr dhe i kanë lënë amerikanët në baltë. Konkretisht këtë e pamë në mosmbështetjen e marrëveshjeve të Kemp Dejvidit, që u arritën midis Izraelit dhe Egjiptit nën patronazhin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e shohim në mospranimin e kërkesave për masa ekonomike e politike kundër Iranit, në mospranimin e kërkesave të qeverisë amerikane për të bojkotuar lojërat olimpike që duhet të zhvillohen sivjet në Moskë etj. Në këto situata ne shohim se si pikërisht Franca jo vetëm forcon pozitat e saj në Afrikë, por, duke lënë hapur të kuptohet se nuk është dakord me politikën amerikane në Gjirin Persik e në Lindjen e Mesme, kohët e fundit dërgoi atje vetë presidentin D' Estën për vizitë zyrtare. Me fjalë të tjera Franca po tregon qëndrim të hapët kryengritës ndaj statukuosë së mëparshme kur politika prej «lidershipi» e amerikanëve bënte ligjin në këto vende dhe kudo tjetër në botë.

Në të njëjtën kohë ne shohim se Tregu i Përbashkët Evropian, domethënë të nëntët e Evropës së Bashkuar, me ndonjë dallim në qëndrimet e tyre, nuk dëshirojnë t'i acarojnë punët me Bashkimin Sovjetik. Edhe këtu shquhet Franca, e cila, në përpjekjet për uljen e tensionit me Bashkimin Sovjetik dhe për vazhdimin e dialogut me të, dallohet më tepër nga partnerët e saj të Evropës së Bashkuar. Në këtë rrugë, me një intensitet më të vogël, po ecën edhe kancelari Shmidt i Gjermanisë Perëndimore,

kurse Anglia tregohet po aq intransigjente sa edhe vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këto konsideracione tregojnë se Shtetet e Bashkuara ndodhen jo vetëm përballë fuqisë tjetër imperialiste, Bashkimit Sovjetik, por edhe përballë mosmarrëveshjeve dhe kontradiktave që shtohen me partnerët e saj të Evropës së Bashkuar, gjë që i vë në pozita të vështira dhe i pengon të konfrontohen me Bashkimin Sovjetik.

Imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror kanë investuar me miliarda dollarë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të ish-demokracisë popullore me shpresë jo vetëm të siguronin fitime të mëdha ekonomike, të cilat, në fakt i kanë siguruar, por edhe që t'u imponoin Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të Traktatit të Varshavës pikëpamjet dhe politikën e tyre të dobësimit të politikës hegjemoniste e të agresionit sovjetik dhe të forcimit të hegjemonisë amerikane.

Por edhe Bashkimi Sovjetik, në radhë të parë, ka ditur të marrë kredi, teknologji moderne perëndimore dhe amerikane për të fuqizuar industrinë e për të modernizuar teknologjinë e vet, për të përmirësuar industrinë e prodhimit të armëve, t'i shtojë këto dhe fuqinë e tyre të zjarrit, pra të fuqizojë ushtrinë e tij agresive. Si rezultat sot Bashkimi Sovjetik gjendet në pozita të forta ushtarake dhe me një ekonomi të militarizuar.

Bashkimi Sovjetik, pavarësisht se ka kontradikta me aleatët e tij të Traktatit të Varshavës, pavarësisht se i ka lejuar këta të marrin teknologjinë perëndimore nëpërmjet kredive të panumërta, i mban në zap dhe të pushtuar. Në rast të një konflagracioni botëror ose të një konfrontimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pjesëtarët e Traktatit të Varshavës, nën kamxhikun sovjetik do të ecin së toku me të, kurse NATO-ja nuk do të ecë aq kompakte nën kamxhikun amerikan. Megjithëkëtë, dhe derisa të arrihet në një konfrontim, aktualisht Evropa e Bashkuar po i hedh disa vicka imperializmit amerikan.

Në përfundim mund të dalim në këtë konkluzion: **sot Bashkimi Sovjetik socialimperialist vepron pa pyetur kërkënd dhe në veprimet e tij agresive gjen përpara kundërshtarë të dobët, ndërsa imperializmi amerikan përpiqet të vërë në zap aleatët e vet të NATO-s duke u bërë kërcënime ushtarake dhe presione ekonomike, por nuk është në gjendje të veprojë aq lirisht siç vepron Bashkimi Sovjetik me aleatët e tij të nënshtruar.** Këtu është thundra e Akilit amerikan, pse qëllimet, dëshirat dhe veprimet e veçuara të imperializmit amerikan janë në kulm agresive dhe çojnë drejt një lufte botërore imperialiste, ndryshe ai nuk mund të fitojë dhe të lejojë një situatë të tillë që i sjell vdekjen. Përpara vdekjes ai do të ndeshet, në mos sot nesër me socialimperializmin sovjetik, dashkan apo nuk dashkan aleatët e tyre të NATO-s e të Traktatit të Varshavës. **Aleatët e NATO-s ose ata të Traktatit të Varshavës po përpëliten në një politikë të balancimit në pragun e luftës botërore, por kjo nuk do t'i shpëtojë nga një rrezik eventual që mund të shkaktohet nga imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik.**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kërkojnë, pra, që t'i kenë aleatët evropianë nën një zap më të fortë, dhe, nga ana tjetër, përpiqen dhe do të përpiqen që, bashkë me klikën e Ten Hsiao Pinit, të konsolidojnë dhe të kompensojnë dobësimin që u vjen nga Evropa Perëndimore me aleancën kino-japoneze. Po ta shohim zhvillimin e ardhshëm në këtë prizëm, për strategjinë imperialiste rëndësi të madhe merr aleanca amerikano-kineze, për arsye se Kina është një partnere më e dobët se partnerët e Evropës së Bashkuar, Kina është e etshme për armatime e për teknologji për të realizuar «katër modernizimet» dhe për më tepër është në armiqësi me Bashkimin Sovjetik.

Pra për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, **për strategjinë amerikane, guri më i mirë e më i favorshëm në gjendjen aktuale të tabelës së shahut, është Kina** dhe tok me këtë edhe Japonia, sido që kjo e fundit është me potencial ekonomik dhe ushtarak shumë më të madh e më të përparuar se Kina e Ten Hsiao Pinit.

Në këto ujëra, në këtë gjendje, në këtë politikë të çoroditur vërtitet aktualisht administrata e kalbur e Xhimi Karterit.

Neve na bie detyra që këto situata t'i shfrytëzojmë. Me aq sa mundim ne, komunistët shqiptarë, në unitet të plotë me popujt që luftojnë dhe me komunistët në botë që udhëheqin lëvizjet çlirimtare, duhet të luftojmë me të gjitha forcat dhe me të gjitha mjetet që të godasim pa mëshirë dhe të demaskojmë katërcipërisht qëllimet, veprimet dhe komplotet agresive, politikën pseudodemokratike, pseudosocialiste, fashiste të të gjitha shteteve imperialiste që përpëliten në vorbullën e kapitalizmit botëror që po jep shpirt. Luftën ne duhet ta pengojmë duke luftuar kundër tyre, të jemi vigjilentë, por vigjilentë jo në apati dhe duke qëndruar duarkryq, por në veprim, në aksion e në luftë për të shfrytëzuar çdo të çarë. Marksistë-leninistët e vërtetë, forcat revolucionare, popujt liridashës duhet ta kuptojnë se, pavarësisht se situatat janë shumë të rrezikshme, ato njëkohësisht janë edhe shumë të favorshme për popujt, për revolucionin.

E PREMTE
23 MAJ 1980

TRASHËGIMIA E TITOS

Titoja nuk kishte besim në unitetin e kombësive të ndryshme që përbëjnë Jugosllavinë dhe kjo e kishte burimin në bindjet e tij antimarksiste. Ai dhe grupi i tij ishin nacionalistë-shovinistë. Parulla **«bashkim-vllazërim» mbështetej në një ideologji që ndan dhe nuk bashkon. Ajo «bashkon» vetëm për të dominuar klani më i fortë e për të shfrytëzuar më të dobëtit.**

Analiza e drejtë e gjendjes brenda në Jugosllavi nuk të lejon të mendosh se Titoja me «autoritetin» e tij e kishte realizuar «bashkim-vllazërimin» në Federatë. Është e vërtetë të thuhet se Federata u ruajt dhe u krijua shtresa borgjeze titiste e federatistëve, por jo uniteti i republikave dhe i krahinave autonome, si dhe i kombësive të ndryshme që përbëjnë Federatën.

Titoja ishte një politikan dhe etatist borgjez i zgjuar që diti të fshihej për të manovruar nën sloganet pseudomarksiste, të ruante për një kohë pushtetin e centralizuar të Federatës, por njëherësh të bënte edhe kthesën e decentralizimit brenda saj, pse dolën në dritë ndjenjat nacionale dhe shoviniste për dominim dhe për hegjemoni. **Në garë për dominim u vunë serbët, kroatët e sllovenët.** Titoja, në fakt, nuk mundi t'i dozonte dhe t'i frenonte dot këto lakmi. Ai anoi nga klani kroato-slloven, por duke vepruar në mënyrë të atillë që të kishte rolin e një arbitri «të pagabuar dhe të drejtë» dhe të jepte përshtyp-

jen e një udhëheqësi «të urtë, të zgjuar» dhe «marksist» të sprovuar. Kështu në këtë frymë ai goditi nacionalizmin serb të Rankoviçit, më pas atë të Nikeziçit dhe të Koça Popoviçit. Më vonë, më 1976-1977, ai goditi grupin e ushtarakëve serbë të Jovanoviçit, Shumonjës e të tjerëve, sikurse pat goditur edhe më 1971 grupin e nacionalistëve kroatë, me Tripallon në krye.

Përse flasin këto spastrime? **Këto flasin për rivalitetet që ekzistojnë dhe nuk mund të mos ekzistojnë në një shtet kapitalist.**

Zhvillimi jo i barabartë ekonomik në republikat dhe në krahinat autonome, brenda Federatës Jugosllave, nxiti shovinizmin, nacionalizmin dhe hegjemonizmin, pra e vuri Jugosllavinë titiste në një rrugë kryq: ose të vazhdonin grindjet dhe lufta për hegjemoni në mes klaneve serbe dhe kroato-sllovene për Malin e Zi, Maqedoninë, Bosnjën, Hercegovinën (krahina autonome e Kosovës qëndronte kurdoherë një krahinë e shtypur dhe e shfrytëzuar), ose të shtypeshin. **U ruajtën kështu republikat, krahinat autonome dhe Federata, por u vendos decentralizimi i ekonomisë, u vendos sistemi pseudosocialist i vetadministrimit.**

U mendua se me këto veprime u gjet zgjidhja e luftës së klaneve për hegjemoni dhe njëkohësisht u hap rruga e zhvillimit më të shpejtë në formë të pabarabartë të kapitalizmit në republika, po ashtu edhe pasurimi i shtresave të ndryshme të borgjezisë së re dhe të individëve në veçanti. **Titoja dhe klani i tij kroato-sllloven, babai i këtij manovrimi favorizuan jo vetëm zhvillimin e pabarabartë të republikave e të krahinave, por forcuan Kroacinë dhe Sllovenínë me investime të jashtme dhe vendosën de facto, në mos de jure, hegjemoninë e këtij klani.**

Pra rivalitetet në mes kombeve dhe kombësive, në mes republikave dhe krahinave në Federatën Jugosllave,

jo vetëm nuk u zhdukën, por u acaruan dhe do të shkojnë duke u acaruar.

Është e qartë se klani i Titos mbante fort në duart e veta ushtrinë dhe sigurimin e shtetit, që përbënin të vetmen shtyllë të mbajtjes në fuqi të klanit titist federalist në këtë formacion të sajuar. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë s'kishte asnjë funksion udhëheqës, por as edhe edukues, pse as në teori, as edhe në praktikë s'kishte se çfarë të edukonte, çfarë shoqërie të predikonte dhe me ç'ideale ta frymëzonte individin.

Vetadministrimi, në fakt, nuk ishte veçse një parodi administrimi, punëtorët s'kishin «votë në kapitull», ata ishin për formë, pse në bashkëpunim me shoqëritë shumëkombëshe dhe me kapitalin financiar të huaj që kishte ndarë zonat e influencës dhe të shfrytëzimit në Jugosllavinë federale, atje vendoste borgjezia e re. Dhe ky manipulim i madh bëhej nga klani i Titos dhe ligjërohej nga disa forume në shkallë krahine, republike dhe federate, që u përngjitnin dhomave të korporatave musoliniane.

Ky kaos kapitalist, ky regjim anarkist, kjo formë «korporative» musoliniane ta zëmë se mund të ecte sa ishte Titoja gjallë, po pas tij ç'do të bëhej? Krerët e klanit titist do të haheshin me njëri-tjetrin si qentë dhe si ujqit.

Thuhet se Titoja gjoja parashikoi edhe si duhej drejtuar pas vdekjes së tij dhe krijoi «udhëheqjen kolegjiale». **Po ç'ishte dhe ç'zgjidhte kjo udhëheqje kolegjiale?** Pas Titos nuk do të kishte më një president, po shumë presidentë në një presidencë. Kjo presidencë përbëhet nga një i zgjedhur për çdo republikë dhe krahinë autonome për 5 vjet dhe cilido nga këta me rotacion do të ishte «Çeërmën»[1] i kësaj presidence për një vit.

Çdo gjë «u rregullua», por nuk u zgjidh dhe nuk do

1 Chairman (anglisht) — kryetar.

të zgjidhet asgjë! Ç'do të ngjasë? Klani kroato-sllloven i Titos do të sundojë atje, hëpërhë jo shumë në evidencë, dhe, në fakt, ky do të jetë grupi i Bakariç-Dolancit. Të tjerët federalistë, por marioneta, derisa të bëhet kohezioni i grupit rival serbo-malazez-maqedonas, dhe ky ashtu si edhe i pari federalist në qoftë se bëhet hegjemon, ose separatist, në rast se thellohen grindjet.

Pra, pas Titos, nuk mund të ketë stabilitet veçse të përkohshëm. Situata e sotme eviton dominimin e klanit serb. Po deri kur? Aktualisht ekziston sistemi i pushtetit kolegjial i dy presidencave, ajo e republikës dhe ajo e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Të tërë, 31 veta, janë të paefektshëm në marrje vendimesh, të tërë do të kalojnë në krye me rotacione dhe ky rotacion është i tillë që në një kohë do të sjellë atje nga çdo klan njerëz me autoritet, ose pa autoritet, gjë që do të krijojë paqëndrueshmëri, rivalitet dhe do të çojë në krijimin e domosdoshëm të një personaliteti të vetëm, që do ta ndërrojë këtë «kala» (formë pushteti) të ndërtuar mbi rërë.

Klani kroato-sllloven tani dominon, por, gjatë kohërave që do të vijnë, do të diferencohet e do të afirmohet edhe klani serb (Miniç, Lubiçiç, Vidiç, Markoviç, Stamboliç e të tjerë). Tani këta punojnë të krijojnë situata të favorshme për klanin e tyre dhe do të përpiqen të godasin në fushën ekonomike, si dhe të fitojnë edhe pozita dominuese politike. Klani serb është më i gjallë, më dinamik dhe ka pozita më të gjera në kuadrin e mesëm. Udhëheqja aktuale dëshiron që të jetë federaliste, pse ia do interesi, por kjo nuk do të varet shumë dhe kurdoherë nga vullneti i saj. Zhvillimi kapitalist në forma të reja dhe influenca e kapitalit të huaj financiar do të luajnë atje një nga rolet vendimtare në të ardhmen.

Tani për tani nuk ngrihet problemi i ndërhyrjes së Bashkimit Sovjetik në Jugosllavi. Çështja qëndron në formën që do të marrë në këtë vend pushteti kapitalist.

Mendoj se tendenca e ruajtjes së Federatës do të vazhdojë, por njëkohësisht do të ketë edhe luftë për hegjemoni në mes serbëve dhe kroato-sllovenëve. Ky rivalitet do të kalojë në formën e centralizimit të pushtetit, në të cilin do të dominojë klani më i fuqishëm ekonomik që do të ketë mbështetjen e ushtrisë.

Aktualisht do të dominojë klani kapitalist që mbështetet në kapitalin perëndimor. Kjo nuk do të thotë se klani serb është prosovjetik. E kaluara pansllave nuk do të luajë atë rol që dëshirojnë t'i japin nga Moska. Reaksioni serb është properëndimor, kozmopolit, mund të them edhe antirus. Megjithatë kjo nuk do të thotë mungesë simpatie ndaj rusëve, por do të shërbejë si një koniunkturë politike e jashtme në luftën e klaneve.

Kapitali sovjetik mund të influencojë më shumë në Serbi, por mundet edhe në Kroaci, pa harruar Maqedoninë nëpërmjet bullgarëve. Në këtë vështrim nuk do të mbetet pas as kapitali amerikan, as ai perëndimor. Do të ketë luftë klanesh të brendshme, luftë në mes shtresave të ndryshme të kapitalistëve në republikat, luftë në mes monopoleve të ndryshme perëndimore, të këtyre me monopolet sovjetike dhe evropianolindore, si dhe luftë klase në mes proletariatit dhe borgjezisë së shitur jugosllave.

Diversion të armatosur nga ana e sovjeto-bullgarëve mund të ketë, por, sidomos në këto situata, në qoftë se do të ketë, këto do të jenë aventura dhe çdo orvatje nga ana e tyre do të shtypet shpejt. Të ashtuquajturit informbyroistë, si dhe rankoviçistët e ustashët janë të dobët dhe të pafuqishëm. Orvatjet jashtë klaneve proserbe apo prokroato-sllovene për separatizëm e për thirrje ndihme nga sovjetikët nuk do kenë as më të voglin sukses.

Në këto situata shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi duhet të forcojnë unitetin e tyre kombëtar dhe ta afirmojnë atë në të drejtat kushtetuese. Të drejtat e fituara

duhet të përpiqen që t'i ruajnë, t'i forcojnë dhe t'i zgjerojnë. Ata duhet të jenë vigjilentë ndaj serbëve, por edhe në aleancat me kombësitë e tjera kërkohet që të jenë të matur, as liberalë e shpresues të verbër dhe as sektarë e difidentë përpara çdo situate të favorshme koniunkturale në favor të tyre. Ata duhet të dinë të përfitojnë në çdo rast, të jenë gjakftohtë dhe të përgatitin me durim të ardhmen e tyre më të mirë e më të lirë...

THELLOHET KRIZA E MADHE EKONOMIKE BOTËRORE

Kriza e madhe ekonomike botërore që ka mbërthyer për gryke veçanërisht dy superfuqitë imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik si dhe vendet e industrializuara, Japoninë, Gjermaninë Federale, Francën, Anglinë, Kanadanë, Italinë, Kinën maoiste, Jugosllavinë titiste, vendet anëtare të KNER-it etj., po thellohet çdo ditë e më shumë. Ajo është me konsekuenca të rënda për të gjitha shtetet që varen nga kapitali ndërkombëtar.

Kjo krizë e madhe ekonomike është **krizë e superprodhimit, e bumit[1] industrial, por në të njëjtën kohë ajo ka shkaktuar një krizë të thellë në prodhim.** Në fakt kudo në vendet kapitaliste e revizioniste ajo ka çuar në rritjen e papunësisë, të inflacionit, në ngritjen e çmimeve etj. Kjo do të thotë se aktualisht prodhimi është ulur dhe ka filluar lufta për evadimin e mallrave stoqe. Mirëpo borgjezia kapitaliste, evadimin e këtyre mallrave stoqe nuk e bën duke ulur çmimet, por duke hedhur në rrugë punëtorët, pra duke ngadalësuar prodhimin. Meqenëse industria kapitaliste nuk punon më me rendimentin e mëparshëm, lind edhe kriza e lëndëve të para. Kjo krizë, gjithashtu, është shumë e rëndë. E gjithë kjo çështje sho-

1 Anglisht — lulëzim i rrëmbyeshëm dhe i përkohshëm.

duhet të përpiqen që t'i ruajnë, t'i forcojnë dhe t'i zgjerojnë. Ata duhet të jenë vigjilentë ndaj serbëve, por edhe në aleancat me kombësitë e tjera kërkohet që të jenë të matur, as liberalë e shpresues të verbër dhe as sektarë e difidentë përpara çdo situate të favorshme koniunkturale në favor të tyre. Ata duhet të dinë të përfitojnë në çdo rast, të jenë gjakftohtë dhe të përgatitin me durim të ardhmen e tyre më të mirë e më të lirë...

THELLOHET KRIZA E MADHE EKONOMIKE BOTËRORE

Kriza e madhe ekonomike botërore që ka mbërthyer për gryke veçanërisht dy superfuqitë imperialiste, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik si dhe vendet e industrializuara, Japoninë, Gjermaninë Federale, Francën, Anglinë, Kanadanë, Italinë, Kinën maoiste, Jugosllavinë titiste, vendet anëtare të KNER-it etj., po thellohet çdo ditë e më shumë. Ajo është me konsekuenca të rënda për të gjitha shtetet që varen nga kapitali ndërkombëtar.

Kjo krizë e madhe ekonomike është **krizë e superprodhimit, e bumit[1] industrial, por në të njëjtën kohë ajo ka shkaktuar një krizë të thellë në prodhim.** Në fakt kudo në vendet kapitaliste e revizioniste ajo ka çuar në rritjen e papunësisë, të inflacionit, në ngritjen e çmimeve etj. Kjo do të thotë se aktualisht prodhimi është ulur dhe ka filluar lufta për evadimin e mallrave stoqe. Mirëpo borgjezia kapitaliste, evadimin e këtyre mallrave stoqe nuk e bën duke ulur çmimet, por duke hedhur në rrugë punëtorët, pra duke ngadalësuar prodhimin. Meqenëse industria kapitaliste nuk punon më me rendimentin e mëparshëm, lind edhe kriza e lëndëve të para. Kjo krizë, gjithashtu, është shumë e rëndë. E gjithë kjo çështje sho-

1 Anglisht — lulëzim i rrëmbyeshëm dhe i përkohshëm.

qërohet me luftën ndërimperialiste kolosale për tregje. Kjo luftë herë e hapur dhe herë subversive, nga ana e saj shoqërohet me një shtim të panjohur e të pakrahasueshëm deri tash të buxheteve ushtarake dhe të armatimeve konvencionale, të sofistikuara e atomiko-bërthamore.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik, Kina e fuqi të tjera imperialiste janë bërë nxitëset më të tërbuara të një lufte të re imperialiste botërore. Politika e tyre hegjemoniste, etja për të ruajtur statukuonë imperialiste ekzistuese, nga njëra anë dhe, për rindarjen e sferave të influencës, nga ana tjetër, ka thelluar e ka ashpërsuar kontradiktat midis vetë fuqive të mëdha dhe midis tyre e partnerëve të tyre në krimet ndaj popujve të tjerë, në shfrytëzimin e tyre dhe kështu ka krijuar konflikte të reja.

Marrëdhëniet ekonomike, politike dhe ushtarake në grupimet e ndryshme imperialiste e revizioniste janë tronditur. Pjesëtarët e këtyre grupimeve po përpiqen të shkaktojnë, të gjejnë e të shfrytëzojnë të çara të ndryshme dhe kështu të formulojnë arsye për të mos iu përmbajtur angazhimeve, traktateve dhe marrëveshjeve që ekzistojnë midis tyre.

Aktualisht **lufta e popujve të shtypur e të shfrytëzuar nga kapitali botëror në krizë, ka marrë proporcione dhe forma të larmishme, të papara ndonjëherë.** Pikërisht këtu e ka burimin e vërtetë kriza e madhe ekonomike botërore që ka mbuluar botën kapitaliste e revizioniste. Në dukje konfliktet e armatosura, ato në lëmin e marrëdhënieve ekonomiko-financiare, kriza e madhe e energjetikës e të tjera, duken se janë vetëm midis shteteve kapitaliste, por në të vërtetë këto konflikte kanë një prejardhje më të thellë, që e gërryen shtetin borgjez kapitalist, i cili përpiqet të mbrohet, të mbahet gjallë, të shërojë plagët e shumta etj. **Forca që e gërryen shtetin borgjez kapitalist, është lufta në të gjitha format e në të**

gjitha shkallët që bëjnë popujt kudo në botë. Klasa punëtore dhe të gjithë të shfrytëzuarit, në një mënyrë ose në një tjetër, me më pak ose me më shumë intensitet, shohin dhe luftojnë kundër të gjitha formave të regjimit kapitalist, vendas ose ndërkombëtar që i shfrytëzon, i varfëron dhe i shtyp ekonomikisht e moralisht. Ekzistojnë, pra, pakënaqësi e madhe dhe revoltë në gjirin e popujve të botës.

Sot gati kudo në vendet kapitaliste zhvillohen greva me pjesëmarrjen e miliona vetave, ka goditje të ashpra me të ashtuquajturat forca të rendit, ka revolta të armatosura, puçe ushtarake, ka terrorizëm dhe anarkizëm të organizuar nga qeveritë borgjeze kapitaliste në fuqi, ka kontrabandë kolosale, vjedhje të organizuara në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, ka një zhvillim të pakufishëm e të llahtarshëm të korrupsionit politik, moral dhe fizik. Kështu po i përgatitet rruga fashizmit për të ardhur në fuqi.

Ne sot **jetojmë në periudhën e kalbëzimit të kapitalizmit, të dobësimit, të dezagregimit dhe të falimentimit të plotë të këtij sistemi, të kësaj shoqërie të degjeneruar.** Rrugëdalje tjetër nga ky kaos, nga ky llum, nuk ka përveç revolucionit, spastrimit të qelbit, marrjes në dorë të pushtetit shtetëror nga klasa punëtore, e cila ka për mision të vendosë diktaturën e proletariatit. Ajo që ka thënë Lenini lidhur me këtë proces, po vërtetohet dhe do të realizohet patjetër.

Imperializmi amerikan dhe kreu i tij, presidenti Karter, gjenden përpara vështirësish të mëdha në politikë, në ekonomi, në aleancat dhe në kolonitë. Imperializmi amerikan nuk e di ku e ka kokën, nuk di si t'u bëjë ballë rreziqeve që i janë turrur e që shtohen çdo ditë. Kështu ai ndodhet i mbërthyer nga një darë nga e cila përpiqet të dalë duke zbatuar një politikë të çmendur kërcënimesh, shantazhesh, presionesh ekonomike, politike,

ndërhyrjesh ushtarake të hapëta dhe subversive deri edhe në çështjet sportive etj.

Për të mos u larguar nga ngjarjet e kohës duhet thënë se lufta e dy-tre vjetëve të fundit e popullit iranian kundër shahut dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është një grusht i rëndë kundër imperializmit amerikan. **Kriza e Iranit është kriza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.** Popujt e botës i njihnin edhe më përpara politikën barbare amerikane dhe metodat e sundimit të tij të egër e grabitqar, por në Iran i panë këto akoma më qartë. Masha e imperialistëve amerikanë në Iran ishte shahu dhe klika e tij, vrasëse e popullit. Për disa dekada me radhë ligjin në Iran e bënë kusarët në aleancë me kusarët, vrasësit dhe gjakpirësit e popullit iranian, të jashtëm dhe të brendshëm, në ujdi të plotë me njëri-tjetrin, qeveria dhe administrata e shahut nën drejtimin e Uashingtonit nëpërmjet ambasadës amerikane në Teheran.

Por më në fund populli iranian u ngrit në revolucion dhe fshiu me fshesë të hekurt nga faqja e dheut shahun dhe regjimin e tij mesjetar, zuri dhe burgosi të gjithë spiunët e ambasadës amerikane, që vepronin nën petkun e diplomatëve. Që prej 9 muajsh të ashtuquajturit diplomatë të një fuqie të madhe, e cila bën ligjin në botë, ndodhen në burg *«O tempora! O mores!»*. Kjo nuk mund të ngjiste në kohët e mëparshme, por ja ngjau tash dhe, përveç amerikanëve, vazhdon t'u ngjasë edhe të tjerëve në vende të tjera.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës pësuan një disfatë të madhe politike, disfatë të cilën nuk janë në gjendje ta riparojnë, jo vetëm me rrugë diplomatike e me shantazhe ekonomike, por as edhe me ndërhyrje ushtarake siç tentuan dhe dështuan me komandon ajrore të prillit në Tabas. Në Iran Shtetet e Bashkuara të Amerikës humbën një burim nafte e energjetike nga më të rëndësishmit, humbën fitime kolosale, humbën besimin tek «aleatët» arabë

të Gjirit Persik, u lëkund kompromisi amerikano-egjiptiano-izraelit i Kemp Dejvidit, lindën *zizanies*[1], mosmarrëveshje të hapëta dhe të nënujshme me partnerët e NATO-s.

Bashkimi Sovjetik në këto situata mpreh dhëmbët dhe kafshon. Ai pushtoi Afganistanin, nxit oreksin e Vietnamit, fut pyka në NATO etj. Në të njëjtën kohë po thellohen kontradiktat midis Bashkimit Sovjetik e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Traktati i Varshavës duket «monolit», kurse në gjirin e NATO-s, Evropa e Bashkuar dhe Tregu i Përbashkët Evropian po japin shenja plasaritjeje. Plasaritja është po aq e madhe edhe në gjirin e KNER-it e të Traktatit të Varshavës, por këtu ushtria sovjetike ua ka zënë mirë frymën «aleatëve» të Bashkimit Sovjetik, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës po e humbasin ndikimin e tyre të mëparshëm mbi «aleatët» e tyre, sidomos mbi Francën dhe Gjermaninë Federale që kanë nxjerrë dhëmbët dhe po mprehin thonjtë e vet. «Mete, o Mete, gjithkush për vete», thotë populli ynë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan që në fitime të jenë të parat, të jenë lubia e madhe, kurse në fatkeqësi copat e thyera prej tyre t'i paguajnë «aleatët», domethënë të bëhen pjesëtarë të fatkeqësive dhe të disfatave që pësojnë ato.

Por edhe ligji i xhunglës vepron; varur të të shohë kapitalisti, në ndihmë nuk të vjen.

Franca e Dë Golit dhe e D'Estënit, duke qenë në NATO, nuk është në NATO. Ajo qëroi nga toka franceze bazat e NATO-s, domethënë bazat amerikane, forcoi ushtrinë e saj në mënyrë të pavarur, ndërtoi bombën atomike e me hidrogjen dhe tash së fundi edhe atë me neutron dhe nuk i nënshtrohet diktatit amerikan në këtë çështje. Politika aktuale franceze niset nga parimi «më mirë të përgatitem të mbrohem më parë vetë, sesa të pres pas aksha-

1 Frëngjisht — grindje.

mit të më mbrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Kjo përbën një të çarë midis Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Muajt e fundit Shtetet e Bashkuara dhe Karteri bënë çmos që veçanërisht Franca dhe Gjermania Federale të bashkoheshin në të gjitha veprimet e tyre kundër Iranit.

Parisi dhe Boni parimisht dënuan mbajtjen peng të diplomatëve amerikanë nga Irani, por nuk ranë dakord me masat e tjera shtrënguese ekonomike që rekomandonin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra i lanë në baltë ato. Kjo është një e çarë tjetër midis Shteteve të Bashkuara dhe Francës e Gjermanisë Federale. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dënuan pushtimin e Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik. Këtë pushtim e dënoi edhe Kina, edhe NATO-ja. E dënuam edhe ne, por jo nga pozitat dhe nga qëllimet e tyre. Ata për këtë çështje nesër do të bien në ujdi me sovjetikët, kurse ne kurrë nuk do ta bëjmë një gjë të tillë.

Presidenti amerikan, si sanksion kundër Bashkimit Sovjetik për çështjen e Afganistanit, shpalli bojkotimin e lojërave olimpike që do të zhvillohen këto ditë në Moskë, dhe kërkoi që edhe gjithë të tjerët t'i bojkotonin këto, por një shumicë shtetesh, midis tyre edhe Franca, bile edhe vasalja e bindur e tyre Italia e Kosigës, që dërgoi në Moskë një ekip atletësh gjoja jozyrtar, përsëri e lanë në baltë.

Franca shkoi më tej. Presidenti Zhiskar d'Estën, pa pyetur fare Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u takua me Brezhnjevin në Varshavë. Zhiskari bëri vizitë zyrtare edhe në disa vende të Lindjes së Mesme, ku në fjalime publike vuri në dyshim kompromisin amerikano-egjiptiano-izraelit të Kemp Dejvidit dhe paraqiti disa formulime kauçuk të tjera mbi të drejtat e popullit palestinez. Edhe kjo është një e çarë tjetër midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës.

Edhe pas këtyre disfatave Karteri propozoi që, për «mbrojtjen» e Evropës së NATO-s, të vendosen në Evropë nga ana e Shteteve të Bashkuara një lloj i ri raketash bërthamore, raketat «Pershing-2» dhe «Kruiz».

Ky propozim imponues i Karterit nuk u pranua as nga Zhiskari dhe as nga kancelari gjerman Shmidt. Përse? Me sa duket nga frika se, po t'i vendosin Shtetet e Bashkuara të Amerikës raketat e tyre të reja në Evropë, një gjë të tillë do ta bëjë edhe Bashkimi Sovjetik, duke vendosur në vendet e Traktatit të Varshavës raketat e tij të reja bërthamore SS-20. Prandaj Shmidti tash së afërmi do të shkojë në Moskë ku, siç flitet, do t'u kërkojë sovjetikëve një moratorium prej tre vjetësh lidhur me çështjen e vendosjes së raketave të reja në Evropë. Karteri u zemërua dhe i shkroi Shmidtit që të mos shkonte në Moskë e të mos bisedonte për çështjen e vendosjes së raketave të reja. Por edhe Shmidti nuk u tund dhe iu përgjigj letrës së Karterit negativisht. Bile, lidhur me këtë letër, Shmidti i ka deklaruar gazetës amerikane «Uashington post» tekstualisht kështu: «E kam pasur zakon për 20 vjet që të shpreh mendimet e mia pa pyetur njeri tjetër», domethënë edhe tani nuk kam ndër mend të pyes Karterin. E gjithë kjo çështje flet për «unitet» midis Francës dhe Gjermanisë Federale dhe për të çara midis tyre dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Evropa e Bashkuar, në vetvete nuk është më e bashkuar. Grindjet, rivalitetet, interesat e kundërta të çdo shteti, të këtij farë Komuniteti Evropian po shtohen saqë vënë në rrezik vetë ekzistencën e tij. Anglia, aleatja më besnike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk dëgjon të paguajë kuotën që i është caktuar nga Tregu i Përbashkët Evropian. Natyrisht, kjo nuk u pëlqen as Bonit, as Parisit. Franca është dakord që Greqia të rifutet në strukturat ushtarake të NATO-s

dhe në Tregun e Përbashkët Evropian, por është kundër pranimit në to të Spanjës dhe të Portugalisë. Zhiskari e di se futja e shteteve iberike në vathën e perëndimorëve do t'i sjellë vështirësi për shitjen e prodhimeve bujqësore franceze. Nga ana tjetër, Gadishulli Iberik, që është një bazë e vërtetë ushtarake amerikane, duke u pranuar në NATO, krijon një aleat të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Evropë, përkrah Anglisë. Sa për Italinë demokristiane ajo është një çizme e vërtetë amerikane në Mesdhe. Borgjezia italiane, që po e çon vendin drejt një fashizmi të ri, nuk di kujt t'ia prishë dhe kujt t'ia ndreqë më parë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e mbajnë gjallë, por ajo ndodhet edhe në Evropën e Bashkuar dhe në Tregun e Përbashkët Evropian. Italia është bërë vendi i mbledhjeve të kompromiseve dhe të kontradiktave.

Në mbledhjen e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të vendeve kryesore të industrializuara të botës, që u mbajt aty nga fundi i qershorit në Venecia, u shpalosën kontradiktat midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të industrializuara evropiane dhe, italiani Kosiga, presidenti i turnit i Komunitetit Evropian, lexoi çarçafin e komunikatës së mbledhjes së ujqve në «xhungël». Në mes të kësaj mbledhjeje ujqish, që bëhej në një manastir të një ishulli të Lagunës së Venedikut, mbërriti nga Bashkimi Sovjetik një «meteorit i vogël» diplomatik për Zhiskarin. Moska njoftonte se po tërhiqte një divizion ushtarësh dhe 100 tanke nga Afganistani, duke lënë atje, në mos më shumë, nja 10 divizione të tjera. E hodhi kështu edhe Moska një gur në kënetë, rrathët koncentrikë të të cilit nuk mbajtën shumë. Ajo ishte një manovër diplomatike, por pa jetë të gjatë. Kosiga i kërkoi Moskës që të largonte nga Afganistani edhe trupat e tjerë, por ajo

zbuloi bateritë dhe dhëmbët e saj prej egërsire, duke iu përgjigjur se jo vetëm që nuk do të tërhiqte më trupa nga Afganistani, por, po të qe nevoja, mund të dërgonte atje trupa të tjerë.

Socialimperializmi sovjetik po sulmon me arrogancë stanin kundërshtar që gjendet në vështirësi. Ariu sovjetik mendon të përdorë pykat Zhiskar dhe Shmidt, por sa dhe deri kur, kjo mbetet për të parë. Është e vërtetë se shpata sovjetike është më e gjatë, por dhe të tjerët thikat i mbajnë zhveshur. **Në këtë kazan të madh, në këtë zjarr të madh ku zien dhe digjet kapitalizmi botëror, po shtohen, po ngjiten, po shtrihen në sasi e në cilësi edhe luftërat nacionalçlirimtare, faktorët objektivë e subjektivë. Popujt e botës janë në lëvizje.** Proletariati botëror, pavarësisht se po manipulohet nga ideologjitë e ndryshme në shërbim të kapitalit, po lufton dhe po udhëheq luftën e klasave.

Duke e parë në tërësi e me syrin e marksizëm-leninizmit gjendjen, vihet re se në çdo skaj të botës po zhvillohet lufta e klasave, në format klasike e joklasike. Kudo popujt janë në ankth, në një shqetësim të jashtëzakonshëm. Pakënaqësia dhe zemërimi kundër fuqive shtypëse, kombëtare e të huaja, po shtohen, po ngjiten, po specifikohen dhe po materializohen. Luftërat e armatosura nacionalçlirimtare të popujve, pavarësisht se kush i udhëheq ato, gjaku i popujve që luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e tyre, pasqyrojnë urrejtjen dhe zemërimin kundër shtypjes kapitaliste, vendase e të huaj, bëjnë që popujt në luftë të dallojnë qëndrimet antipopullore të individëve ose të grupeve, të bëjnë aleanca me forcat më progresive dhe më revolucionare. Në çdo lëvizje, në çdo demonstratë apo grevë, në çdo manifestim publik, politik ose ekonomik, është e pamundur të mos protestohet kundër efekteve shkatërruese të krizave të rënda dhe të mos u vihet gishti

shkaktarëve të shfrytëzimit e të shtypjes së popujve, forcave që kërkojnë shkatërrimin e njerëzimit.

Në vendet kapitaliste dhe revizioniste, me një parti pseudokomuniste, me dy ose më shumë parti pseudodemokratike, pavarësisht se bëhen përpjekje për t'ia hedhur fajin njëra-tjetrës, pavarësisht se shtetet borgjeze të veçuara ose në grupe përpiqen t'ia hedhin fajin njëri-tjetrit, asgjë nuk ndryshon; shtypja e popujve vazhdon, por vazhdojnë të rriten edhe zemërimi e revolta e tyre. Ky zemërim e kjo revoltë po godasin, në forma të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm, borgjezinë kapitaliste e revizioniste.

Popujt e shohin se po i kërcënon lufta grabitqare imperialiste. Ata e kuptojnë kush e përgatit këtë luftë, kush i paguan harxhet e saj dhe kush fiton nga luftërat grabitqare. Dy fenomene vihen re në këtë situatë: ka disa popuj që i tremben akoma luftës imperialiste; ka edhe popuj të tjerë që e luftojnë atë. Por, në analizë të fundit të gjithë, me forma të ndryshme po futen në luftën e rezistencës aktive, në fazat e para të luftës nacionalçlirimtare, në sabotimin dhe në ndalimin e luftës imperialiste dhe më në fund po kapërcejnë stadin e frikës dhe po hidhen në revolucion. Lëvizjet dhe kundërshtimet që ndodhin në botë nuk duhen gjykuar vetëm nga këndi i vështrimit të qeverive borgjeze dhe të partive të tyre që i udhëheqin dhe i manipulojnë popujt, por duhet parë thelbi i problemit, i rezistencës dhe i drejtimit themelor që marrin kërkesat politike apo ekonomike të popujve, të cilat i detyrojnë udhëheqjet borgjeze kapitaliste ose të marrin masa shtypëse drakoniane kundër këtyre lëvizjeve, ose, për të ristabilizuar gjendjen e tyre të tronditur, të lëkunden sa andej-këndej dhe të mbështeten herë te njëra e herë te tjetra superfuqi.

Marksistë-leninistët duhet të përvetësojnë materia-

lizmin historik dhe ta zbatojnë atë në praktikë. Zhvillimin e botës dhe çdo ndryshim t'i shohin në prizmin e marksizëm-leninizmit. Nuk mund të quhet marksist, por antimarksist, ai që mbron pushtimin e Afganistanit nga ana e socialimperialistëve sovjetikë dhe e konsideron atë një veprim të drejtë dhe të domosdoshëm. Nuk mund të quhen marksistë, por antimarksistë, ata të vetëquajtur marksistë-leninistë që përpiqen «të argumentojnë» se nuk duhen quajtur patriotë populli afgan dhe elementët e borgjezisë së mesme, bile edhe të lartë që luftojnë kundër pushtuesve sovjetikë. Ai që mendon dhe vepron kështu, nuk ka kuptuar asgjë nga mësimet e marksizëm-leninizmit mbi aleancat, mbi frontet dhe luftërat nacionalçlirimtare. Po ashtu nuk mund të quhet mendim dhe veprim marksist-leninist, ai i disa shokëve «komunistë» jashtë, që nuk shohin anët progresive dhe antiimperialiste të popujve arabë, të popullit iranian ose të botës myslimane. Të nënvleftësosh dhe të mos shfrytëzosh këto momente revolucionare, antiimperialiste dhe të tregohesh shumë «ortodoks» për të kërkuar që këta popuj në revolucion të braktisin, me sot me nesër, besimin në fenë e tyre, në doket e në zakonet që rrjedhin prej saj, kjo tregon të paktën papjekuri ideologjike marksiste-lenineste.

As Ajatollah Khomeini me pikëpamjet e tij fetare islamike, as Ajatollahët e tjerë, as Bani Sadri e Gotbzadehu, me pikëpamjet e tyre shtetërore borgjeze ekonomike e ideologjike nuk janë aleatët tanë të natyrshëm. Por aktualisht në luftën për rrëzimin e monarkisë feudale të Pahlevëve dhe në qëndrimet e tyre kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, ata janë aleatët tanë. Ne duhet t'i mbështetim dhe t'i ndihmojmë të ecin në këtë rrugë. Rruga e tyre aktuale i lejon komunistët të futen në masat, të punojnë për edukimin e drejtë të tyre, të thellojnë botë-

kuptimet e tyre strategjike dhe taktike, të mbështeten te populli revolucionar dhe në radhë të parë te klasa punëtore dhe të dinë të shfrytëzojnë çdo situatë të favorshme për revolucionin.

Kështu duhet të kuptohet dhe të zbatohet procesi i zhvillimit të popujve. Në rast se ndjenjat e popujve, cilatdo qofshin ato, konfondohen dhe identifikohen me ato të grupeve borgjezo-kapitaliste që janë në fuqi në një vend të caktuar, ky është një gabim i rëndë. Populli i Egjiptit, për shembull, nuk është dhe nuk duhet të identifikohet me Sadatin dhe klikën e tij, që dje ishte në shërbim të sovjetikëve, sot është vënë në shërbim të amerikanëve; as populli libian nuk mund të identifikohet me Kadafin, as ai i Sirisë me Asadin, e kështu me radhë me të gjithë popujt, shtetet e kombet e tjera.

Komunistët marksistë-leninistë duhet të dinë të bëjnë analiza të drejta, të përcaktojnë strategji dhe taktika të drejta, të bëjnë aleanca të favorshme e të drejta, të ndërmarrin veprime revolucionare të drejta e jo aventura dhe të gjitha këto duhet të shikohen nën prizmin e teorisë marksiste-leniniste, pse vetëm kështu i shërbehet çlirimit të popujve nga kapitalizmi dhe bëhet revolucioni.

Luftërat nacionalçlirimtare janë luftëra të drejta. Ato shpërthejnë kur ekzistojnë dhe piqen faktorët objektivë dhe subjektivë. Këta faktorë duhet t'i krijojnë vetë marksistë-leninistët. Në luftërat e drejta marksistë-leninistët nuk duhet të rrinë asnjëherë duarkryq dhe të mos marrin pjesë qoftë si parti ose si grupe, akoma të paorganizuara si parti, qoftë si luftëtarë individualë. Kurrë ata nuk duhet të ndahen nga masat që luftojnë për çlirim shoqëror e kombëtar, por, duke luftuar në gjirin e tyre, të afirmojnë edhe bindjet komuniste, të organizohen, të vënë klasën punëtore në udhëheqje.

Edhe në qoftë se nuk janë të organizuar, ata duhet të dalin në pararojë të masave, me luftë, me sakrifica për të bërë që lufta nacionalçlirimtare të ecë drejt objektivave minimalë dhe pastaj edhe drejt atyre maksimalë.

Kushtet për shpërthimin e luftërave nacionalçlirimtare nuk përfaqësojnë vullnetin e njërit apo të tjetrit personalitet. Janë situatat objektive e subjektive ato që i krijojnë këto kushte, që bëjnë të shpërthejnë luftërat nacionalçlirimtare, që janë një formë e lartë e luftës së klasave. Ajo klasë që del në krye dhe udhëheq luftën nacionalçlirimtare, është më progresivja, faktori vendimtar. Klasa punëtore është klasa më progresive nga progresivet. Ajo duhet të marrë drejtimin e luftës çlirimtare. Edhe në rast se në fillim të luftës, ajo nuk i ka afirmuar pozitat e saj udhëheqëse, duhet të qëndrojë në ballë të luftës dhe të sakrificave, pse vetëm kështu ajo mund të marrë drejtimin politiko-ushtarak dhe të sigurojë objektivat e luftës nacionalçlirimtare, të realizojë dëshirat e klasës.

Në situatën e zhvillimit të sotëm botëror, partitë marksiste-leniniste, klasa punëtore e aleatët e mundshëm të saj, shtresat e gjera të fshatarësisë, të inteligjencies përparimtare duhet jo vetëm të shohin qartë rrezikun e një lufte të re botërore imperialiste, por edhe të organizohen e të afirmojnë me një mijë forma vullnetin e tyre për ta ndaluar këtë luftë shkatërrimtare, të demaskojnë demagogjinë dhe falsitetin e parullave demokratike të kapitalit skllavërues, t'u shpëtojnë zinxhirëve frenues të partive të ndryshme pseudodemokratike dhe pseudopopullore të krijuara nga borgjezia.

Çdo situatë që krijohet, në çdo vend e në gjirin e çdo populli, në çfarëdo kohe duhet të studiohet me kujdes e në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, të nxirren konkluzione e të dilet me veprime progresive unitare e revolucionare. Asgjë nuk duhet t'i shpëtojë

syrit revolucionar të njerëzve që luftojnë për çështjen e madhe të popullit të vet dhe të të gjithë popujve. Marksistë-leninistët këto zhvillime duhet t'i shfrytëzojnë. Kjo është një luftë e përditshme që duhet bërë, pse kështu orteku i madh i revolucionit do të shtypë armiqtë e popujve dhe do të sjellë lirinë, përparimin, shoqërinë socialiste dhe atë komuniste më vonë.

Prandaj në këtë krizë të madhe ekonomike botërore, komunistët marksistë-leninistë, kudo që janë, duhet të përcaktojnë qartë vijën dhe qëndrimet e tyre dhe këtë vijë të dinë ta vënë në jetë. Vetëm një parti komuniste e vërtetë marksiste-leniniste në këto situata mjaft të komplikuara, ku përplasen interesat e klasave të cilat nuk janë të prera me thikë, por të ndërlikuara e të ndërvarura, mund të shohë qartë ku janë avantazhet dhe ku dezavantazhet, ku dhe cilët janë miqtë dhe armiqtë, me kë duhet të bashkohet, kundër kujt duhet të luftojë e si duhet të luftojë dhe kush t'i çojë përpara etj.

E ENJTE
14 GUSHT 1980

FRANCA DHE GJERMANIA FEDERALE NUK I NËNSHTROHEN DIKTATIT TË KARTERIT

Kam shkruar edhe më parë për mosmarrëveshjet që kanë lindur midis Evropës së Bashkuar, veçanërisht Francës e Gjermanisë Federale dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto mosmarrëveshje janë manifestuar në mënyrë më të hapët këto kohët e fundit, që kur presidenti amerikan Karter kërkoi t'u imponontë shteteve të Evropës së Bashkuar diktatin e tij në lidhje me disa probleme e ngjarje politike ndërkombëtare.

Konstatojmë se aktualisht mosmarrëveshjet midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Francës e Gjermanisë Federale, sidomos pas takimit të Zhiskar d'Estënit me Brezhnjevin në Varshavë dhe takimit të Shmidtit me Brezhnjevin në Moskë, po bëhen më të theksuara e më të thella. Pas këtyre bisedimeve Zhiskari, në vazhdim të takimeve tradicionale për shkëmbim mendimesh bilaterale që kishin vendosur që në kohën e tyre Dë Goli me Adenauerin, bëri një vizitë miqësore zyrtare në Gjermaninë Federale. Bisedimet që ai zhvilloi me këtë rast me kancelarin Shmidt përfunduan në përgjithësi me një mirëkuptim politik dhe ekonomik në mes Francës e Gjermanisë, dy shtete më kryesore të Evropës së Bashkuar.

Takimet dhe bisedimet e presidentit francez Zhiskar d'Estën me kancelarin gjerman Shmidt treguan një

unitet më të thellë e më të qëndrueshëm se më parë midis këtyre dy republikave evropiane dhe një qëndrim më të fortë, pa u vënë haptazi në kundërshtim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne shohim se aktualisht kancelari gjerman Shmidt po bën deklarata, në të cilat thekson qëllimin e tij për të vazhduar më tej bisedimet gjermanoperëndimore me Bashkimin Sovjetik, domethënë për të vazhduar «Ost-politikën» që inauguroi Vili Brandi, ish-kryetar i Partisë Socialdemokrate Gjermane, e cila tash është në fuqi në Bon.

Pas takimeve me Brezhnjevin, kancelari i Bonit ka deklaruar se do të takohet së afërmi edhe me Gierekun e Polonisë dhe me Honekerin e Gjermanisë Lindore, dy shtete këto që, pas Bashkimit Sovjetik, janë nga më të fuqishmet në Traktatin e Varshavës. Bisedimet e Shmidtit me të dy këta udhëheqës revizionistë lindorë, sipas mendimit tim, do të kenë për qëllim «ndihmën» që Gjermania e Bonit, pra, kapitali gjermanoperëndimor, do t'u japë këtyre dy vendeve që gjenden në vështirësi të mëdha ekonomike dhe politike. Natyrisht kjo ndihmë e Gjermanisë Federale është në favor të fuqive perëndimore dhe në disfavor të sovjetikëve. Socialimperialistët sovjetikë janë të detyruar ta gëlltitin këtë situatë pse gjendja brenda vendit të tyre dhe ajo në gjirin e Traktatit të Varshavës nuk është e lulëzuar.

Gjermania Lindore e sidomos Polonia janë të mbërthyera në një krizë të rëndë ekonomike, gjë që i bën t'ua kenë shumë nevojën kredive të panumërta që kanë marrë e që dëshirojnë të marrin nga Gjermania e Bonit. Aktualisht në Poloni po zhvillohen greva të mëdha dhe të përditshme të punëtorëve, të cilët protestojnë për mungesën e mishit dhe të artikujve të tjerë ushqimorë dhe kërkojnë ngritjen e rrogave. Punëtorët, me grevat e tyre, e kanë vënë në vështirësi të jashtëzakonshme edhe politikisht qeverinë e Gierekut. Këto greva, natyrisht, u shkaktojnë vështirësi edhe Bashkimit Sovjetik po dhe gjithë kampit revizionist.

Bashkimi Sovjetik jo vetëm që nuk i furnizon «aleatët» e tij me lëndët e para të nevojshme, sidomos me naftë, energji elektrike, gaz e materiale të tjera, por u imponon atyre edhe armatime të reja moderne, të cilat ua shet me çmime të larta, ashtu siç bën edhe për materialet e tjera që ka kontraktuar me këto shtete. Prandaj qoftë Polonia, qoftë Gjermania Lindore, apo vendet e tjera vasale të Evropës Lindore, me kohë janë futur në borxhe kolosale jo vetëm ndaj socialimperializmit sovjetik, por edhe ndaj imperializmit amerikan e veçanërisht imperializmit gjermanoperëndimor.

Republika Federale Gjermane është bërë sot një shtet i fuqishëm ekonomik, që, së bashku me Francën, sfidojnë, deri diku, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo sfidë e tyre qëndron në mospranimin e politikës së Karterit për sa u përket sanksioneve politike e ekonomike kundër Iranit, në mospranimin e marrëveshjeve të Kemp Dejvidit për Lindjen e Mesme, në mospranimin e vendosjes në vendet e tyre të raketave «Pershing-2» dhe «Kruiz», sipas qejfit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës etj.

Këto çështje, pra, kanë krijuar fërkime midis Francës e Gjermanisë Federale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, përpiqen të mos i lënë «aleatët» e vet në NATO të shkojnë shumë larg, sidomos në bisedimet me socialimperialistët sovjetikë. Kështu, përveç presioneve të tërthorta e të drejtpërdrejta, Uashingtoni ka vënë Italinë e falimentuar që të kundërshtojë kursin e politikës së Parisit e të Bonit për bisedime me Bashkimin Sovjetik.

Në një artikull që ministri i Jashtëm italian, Emilio Kolombo, botoi para disa ditësh në gazetën «Republika», kritikonte Francën dhe Republikën Federale Gjermane,

për politikën e veçuar që bëjnë brenda Evropës së Bashkuar, në drejtim të Bashkimit Sovjetik. Ai i kritikonte Parisin dhe Bonin se gjoja flasin në emër të Evropës së Bashkuar, pa marrë më parë pëlqimin e pjesëtarëve të tjerë të këtij Komuniteti. Përveç të tjerave Kolomboja thotë se, kur flitet për Evropën e Bashkuar dhe për politikën e saj, duhet kuptuar se ajo është e lidhur ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kolomboja theksonte se «mirëkuptimi franko-gjerman» është i nevojshëm për Evropën Perëndimore dhe shtonte se për këtë «Italia nuk është xheloze». «Por, vazhdonte ai, në rast se anëtarët e tjerë të Komunitetit Evropian vihen përpara fakteve të kryera dhe bëhen përpjekje për të vendosur vetë për vijat e përgjithshme të politikës evropiane, atëherë ne nuk jemi dakord». Pastaj ai vinte në dukje se midis Francës dhe Republikës Federale Gjermane nuk ekziston unitet i plotë mendimesh dhe se ka «divergjenca në lidhje me mbrojtjen e përbashkët». Me këtë frazë të fundit ai kërkon të bëjë të njohur botërisht se ka kontradikta midis Francës dhe Italisë.

Këtu, e tërë çështja qëndron në atë që Italia mbështet plotësisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veprimet e tyre. Këtë ajo e bën pse ua ka atyre nevojën më shumë se Franca dhe Gjermania Perëndimore; Italia është një shtet i falimentuar ku mbretëron kaosi dhe ku fashizmi vepron haptas.

Megjithëkëtë ditët e fundit Shmidti e ritheksoi edhe një herë politikën e tij drejt zbutjes me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të Traktatit të Varshavës. Duket qartë, pra, se Boni dhe Parisi dëshirojnë jo vetëm të mos i presin urat me Bashkimin Sovjetik, po përkundrazi t'i zbutin gjakrat, pse ata e dinë se një acarim në mes Bashkimit Sovjetik dhe vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore do të rezultojë me një gjakderdhje katastrofike për Evropën, dhe se nga kjo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si kurdoherë, do të kenë përfitime të mëdha. Këtyre pasojave kërkojnë t'u shpëtojnë Franca dhe Gjermania Federale.

Shmidti dha shpresa gjithashtu se politika e Bonit drejt Lindjes, do të ketë efekte pozitive edhe për konferencën e ardhshme të Madridit mbi «sigurimin dhe bashkëpunimin evropian». Në këtë mbledhje Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që do të marrin pjesë, edhe pse nuk janë vend evropian, do të kërkojnë të ngrihet çështja e pushtimit të Afganistanit nga ushtria sovjetike, kurse Bashkimi Sovjetik e kundërshton një gjë të tillë. Prandaj Helmut Shmidti dhe Zhiskar d'Estëni do të përpiqen që të gjejnë një *modus vivendi* për këtë çështje, domethënë të mos e prishin me asnjërin, as me Bashkimin Sovjetik, as me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si të thuash do të përpiqen që edhe «mishi të piqet, por edhe helli të mos digjet». Kështu, ata duan të paraqiten deri diku si të paangazhuar në veprimet e shpejtuara të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë pasur edhe karakter elektoral. Siç dihet, Karteri këto veprime i ndërmori edhe sepse i ranë mbi kokë shkëmbinj të mëdhenj që e tronditën prestigjin e tij si president, dhe i duhej patjetër t'u tregonte opinionit botëror dhe atij amerikan se ishte një president «i fortë», por në të vërtetë u duk se ishte një makaronë.

Pra Franca dhe Gjermania Federale mendojnë se, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur të kenë një president të ri, ka mundësi që ai të jetë përsëri Karteri, do të ndjekin një politikë tjetër, më elastike ndaj Bashkimit Sovjetik dhe natyrisht edhe ndaj partnerëve dhe aleatëve të vet, veçanërisht ndaj Francës dhe Gjermanisë Federale.

Në këto situata Boni dhe Parisi janë në gjendje t'i bëjnë dhe po i bëjnë edhe ata shantazhe Uashing-

tonit dhe kështu forcojnë pozitat e tyre. Është e kuptueshme që këto dy vende, të cilat janë fuqizuar ekonomikisht dhe politikisht, bëjnë si me thënë ligjin në NATO derisa arrijnë të kundërshtojnë, në mënyrën e tyre, edhe planet amerikane dhe kërkojnë të ruhet statukuoja nga e cila ata kanë përfitime. Gjermania Federale dhe Franca e shtrojnë çështjen kështu: A duhet ne ta lëmë këtë rrugë, ta braktisim këtë politikë drejt Lindjes dhe të futemi në konflikte të përgjakshme me Bashkimin Sovjetik, kur gjatë gjithë kësaj kohe kemi investuar shuma të mëdha në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të Evropës Lindore, dhe nga ana tjetër kjo politikë ka sjellë mosmarrëveshje të rënda në gjirin e vendeve të Traktatit të Varshavës?

Kriza e madhe ekonomike botërore ka prekur thellë edhe Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të Traktatit të Varshavës. Nga kjo krizë e përgjithshme e kapitalizmit janë prekur edhe Gjermania Federale dhe Franca, por mund të thuhet se këto janë superiore ndaj vendeve të Evropës Lindore, të inkuadruara në Traktatin e Varshavës. Këtu e kam fjalën për anën ekonomike, pse ushtarakisht në një konflikt të mundshëm evropian Bashkimi Sovjetik dhe ato, janë më të forta nga Franca, nga Gjermania Federale dhe nga NATO-ja, në rast se nuk ndërhyjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pra me këtë politikë, Franca dhe Gjermania Federale u thonë edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe aleates së tyre, Kinës, në qoftë se ju dëshironi një konflikt me Bashkimin Sovjetik, bëjeni atë në Lindjen e Largme, në Siberi dhe jo në Evropë, jo në Lindjen e Afërt e të Mesme ku gjenden puset e naftës, të cilat furnizojnë me energji edhe Evropën. Këtu ndeshen në kundërshtim të madh politika hegjemoniste e imperialiste e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me politikën tjetër kapitaliste dhe kolonialiste të Francës, të Gjermanisë Federale dhe deri diku edhe të Anglisë, e cila nuk e ngre zërin siç po e ngrenë dy partnerët e tjerë evropianë. Anglia ka kohë që është shushatur, është bërë një aleate si me thënë e bindur, e heshtur, e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

E HËNË
1 SHTATOR 1980

ÇFARË FSHIHET PRAPA GREVAVE TË PUNËTORËVE TË PORTEVE POLAKE TË BALLTIKUT?

Sikurse kam shkruar edhe më përpara në Ditarin tim Politik, që nga fillimi i muajit korrik në Poloni, sidomos në qytetet porte të Balltikut, Gdansk, Gdinia, Shtetin etj., filloi një lëvizje greviste e dokerëve dhe e punëtorëve të sektorëve të tjerë. Këto greva morën përpjesëtime të mëdha gjatë 15-ditëshit të dytë të gushtit.

Që në fillim, zhvillimi i ngjarjeve lidhur me këto greva, tregoi se ato, edhe pse bëheshin nga punëtorë kundër vështirësive ekonomike në të cilat kanë ndeshur, frymëzoheshin e manipuloheshin nga jashtë dhe nga kisha e plotfuqishme katolike polake. Në thelb pra, ato ishin reaksionare, me karakter kundërrevolucionar dhe drejtoheshin kundër pushtetit antipopullor aktual në Poloni.

Duke i ndjekur dita-ditës këto ngjarje, që u zhvilluan dy muajt e fundit në Poloni, mund të dalim me disa konkluzione të cilat mund të jenë, por edhe mund të mos jenë plotësisht ekzakte.

Ishte e natyrshme se grevat në Gdansk, Gdinia dhe në Shtetin do të çonin në disa zhvillime e rezultate. Në radhë të parë ato i shkaktuan vështirësi të reja udhëheqjes revizioniste polake dhe, në të njëjtën kohë, bënë që të acarohej edhe situata politike në të gjithë vendin. Përveç kësaj, ashtu siç parashikohej, përpara situatave kritike që u krijuan, presioneve të brendshme e të jashtme, qeveria polake u detyrua të nënshkruante më 31 gusht, në Gdansk, një marrëveshje kapitulluese me komitetin e grevistëve dhe të bënte disa lëshime e të pranonte, midis të tjerave, që në portet e Gdanskut, Gdinias e të Shtetinit të ngriheshin «sindikatat e pavarura vetadministruese» dhe punëtorët të kishin të drejtën e grevës e të zgjedhjeve me votë të fshehtë. Ky rezultat, natyrisht, u arrit jashtë dëshirës së partisë dhe të qeverisë kundërrevolucionare polake, po ashtu edhe jashtë dëshirës së revizionistëve sovjetikë.

Ngritja e këtyre sindikatave të reja «të pavarura vetadministruese» është një sulm i ri i borgjezisë, i reaksionit ndërkombëtar dhe i revizionistëve modernë kundër teorisë leniniste për sindikatat e klasës punëtore si rripa transmisioni për të lidhur partinë me klasën e saj, si bashkim vullnetar i klasës punëtore për të mbrojtur pushtetin e saj, diktaturën e proletariatit, si shkolla të komunizmit. Ato janë krejtësisht në kundërshtim me atë që thoshte V. I. Lenini se

> *«Bashkimet profesionale duhet të jenë bashkëpunëtoret më të afërta dhe të domosdoshme të pushtetit shtetëror, i cili drejtohet në gjithë punën e tij politike dhe ekonomike nga pararoja e ndërgjegjshme e klasës punëtore — Partia Komuniste»*[1].

Tash ngritja e këtyre sindikatave të reja në Poloni do të thotë që në këtë vend, si fillim në tri qytetet e përmendura, sepse influenca e tyre mund të hapet si vaji në lakra në të gjithë vendin, por mund dhe të

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 202-203.

likuidohet në forma të ndryshme dhe nëpërmjet masave të marra kohë pas kohe, do të ekzistojnë dy lloje sindikatash: «Sindikatat e pavarura vetadministruese» dhe sindikatat e drejtuara nga Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë. Sa për formë, në marrëveshjen që u nënshkrua në Gdansk, midis të deleguarve të qeverisë dhe atyre të komitetit të grevave, thuhet se këto «sindikata të pavarura vetadministruese» njohin drejtimin e partisë. Por, sipas njoftimeve të agjencive të lajmeve, shumë grevistë nuk kanë qenë dakord me udhëheqjen e tyre për këtë çështje. Ata dëshironin që këto sindikata të ishin krejtësisht të pavarura, në mënyrë që të mund t'u imponoheshin partisë dhe shtetit polak jo vetëm në çështjen e caktimit të çmimeve të artikujve ushqimorë e industrialë, por edhe në çështje të tjera të përgjithshme. Por kjo, siç duket, deri në njëfarë shkalle, nuk u arrit dhe udhëheqësi i këtyre grevave, Les Valesa, u tha punëtorëve se për tash duhet të kënaqemi me këto që arritëm, dhe, përpara zëvendëskryeministrit polak Jegielski, që në emër të qeverisë nënshkroi marrëveshjen, theksoi se qeveria polake duhet t'i zbatojë kushtet e marrëveshjes, ndryshe grevat do të rifillojnë. Me një fjalë, të ashtuquajturit grevistë, i bëjnë kërcënime qeverisë polake.

Këto janë faktet që ne njohim deri tani. Por unë mendoj se e gjithë kjo e ashtuquajtur grevë e punëtorëve të porteve të Balltikut, nuk është shkaktuar vetëm nga mungesa e ushqimeve e sidomos e mishit ose e rritjes së çmimeve të tyre në treg, përkundrazi ajo ka karakter politik. Grevat nuk ishin spontane, por të organizuara. Ato ishin të organizuara nga jashtë, nga vendet kapitalisto-imperialiste dhe nga brenda, nga reaksioni polak, nga kisha dhe nga vetë klika e Gierekut.

Le t'i shpjegojmë dhe le t'i mbështetim në fakte këtë analizë e këto konkluzione.

Është e natyrshme që këto greva të jenë pasojë e vetë vijës revizioniste të së ashtuquajturës Parti Punëtore e Bashkuar e Polonisë dhe e nënshtrimit të gjithanshëm të këtij vendi ndaj Bashkimit Sovjetik revizionist. Polonia, si pjesëtare e Traktatit të Varshavës dhe e KNER-it, është ushtarakisht e pushtuar, ekonomikisht e shfrytëzuar dhe politikisht e varur nga Bashkimi Sovjetik. Përveç kësaj, populli polak në përgjithësi ka qenë kurdoherë antirus. Reaksioni dhe kisha katolike vazhdimisht kanë përdorur të gjitha mjetet propagandistike dhe kanë shfrytëzuar vështirësitë ekonomike e politike për të thelluar urrejtjen ndaj Bashkimit Sovjetik, për të thelluar kontradiktat me të.

Nga ana tjetër, sistemi pseudosocialist në Poloni ka qenë kurdoherë në pozita më të avancuara kapitaliste sesa ai i vendeve të tjera të ashtuquajtura vende të demokracisë popullore. Në Poloni nuk u formuan dhe as ekzistojnë kooperativat bujqësore socialiste. Ekzistojnë disa ferma shtetërore, por në përgjithësi atje lulëzon prona private. Panët e sotëm polakë, natyrisht me emra të tjerë, posedojnë parcela të gjera tokash që i punojnë me punëtorë krahu, me argatë.

Në fshatin polak, pra, mbretëron sistemi bujqësor kapitalist, që ushqehet e përforcohet me ndjenja fetare antisocialiste e antisovjetike nga propaganda kapitaliste perëndimore dhe nga Vatikani nëpërmjet kishës polake, që kanë rrugë të hapët veprimi. Një gjendje e njëjtë është edhe në qytetet polake, pra edhe në fabrikat. Kisha katolike pas çlirimit, me përjashtim të një acarimi në kohën e Boleslav Bjerutit, ka luajtur dhe luan rol shumë të rëndësishëm kundërrevolucionar. Ajo ka ruajtur, ka forcuar dhe ka zhvilluar pozitat e saj ideologjike reaksionare dhe vazhdon të ndikojë thellë politikisht mbi fshatarësinë e mbi klasën punëtore, për të mos folur mbi inteligjencien polake, e cila

ruan dhe zhvillon idealizmin dhe ideologji të tjera reaksionare. Këtë rol të rëndësishëm kishës katolike ia kanë dhënë Gomulka, Giereku dhe, me dashje e pa dashje, atë e kanë toleruar edhe revizionistët sovjetikë. Është e qartë, pra, se kisha ka gisht dhe influencon edhe në grevat që po bëhen në Poloni.

Udhëheqja revizioniste polake, si ajo e partisë ashtu edhe ajo shtetërore, në dukje paraqitet sikur është në aleancë me revizionistët sovjetikë, por, në të vërtetë është antisovjetike. Vetëm pozita gjeografike dhe qenia e Polonisë në Traktatin e Varshavës dhe në KNER, e detyrojnë atë të japë përshtypjen se është në unitet me sovjetikët. Edhe revizionistët sovjetikë e njohin këtë situatë, por ata nuk mund të lejojnë kurrë që Polonia t'u dalë nga dora. Përse? Sepse po ngjau një gjë e tillë, atëherë rrezikohen rrugët e hegjemonizmit sovjetik mbi të gjitha vendet e tjera të kampit revizionist, sepse Polonia është anëtarja kryesore dhe më luftarake, pas Bashkimit Sovjetik, në Traktatin e Varshavës dhe në rast se humbet Poloninë, Bashkimi Sovjetik nga pikëpamja ushtarake ka humbur Gjermaninë Lindore, Çekosllovakinë, Hungarinë për të mos përmendur Rumaninë dhe Bullgarinë. Me fjalë të tjera një gjë e tillë do të çonte në destabilizimin e strategjisë së vetë Traktatit të Varshavës në Evropë dhe kuptohet se në këtë rast socialimperialistët sovjetikë në asnjë mënyrë nuk mund të rrinin me duar lidhur.

Natyrisht edhe Polonia, si vetë Bashkimi Sovjetik, ka marrëdhënie ekonomike e politike shumë të zhvilluara me vendet kapitaliste perëndimore e edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto marrëdhënie kanë ardhur duke u trashur. Në lëmin ekonomik, Polonia ka marrë kredi të mëdha nga vendet kapitaliste. Sipas lajmeve të ditëve të fundit, këto kredi arrijnë në 20 miliardë dollarë. Natyrisht, kjo e ka futur Poloninë në vështirësi të mëdha ekonomike. Asaj i duhet të përballojë detyrimet ndaj borxhlinjve, domethënë jo vetëm të kthejë kështet e kredive që ka marrë, por të paguajë edhe kamatat, prandaj ka qenë e detyruar të shtojë eksportet. Por, për shlyerjen e plotë të kredive, Polonia duhet të sakrifikojë dy vjet me radhë të gjithë eksportin e vet, gjë që praktikisht është e pamundur.

Këto vitet e fundit zhvillimi ekonomik në Poloni ka rënë, dhe përveç kësaj përmbytjet e sivjetme e kanë detyruar atë që të importojë miliona tonë drithë. Polonisë, pra, i mungon drithi për popullsinë dhe foragjeret për bagëtinë. Kjo gjë ka sjellë vështirësi e mungesa në treg, sidomos për mish, megjithëse Polonia është një nga vendet kryesore për eksportimin e mishit të derrit, «*bacon*» që i thonë në Angli e gjetkë; janë shtuar tregu i zi dhe spekulimet, si rezultat është rritur pakënaqësia e masave të popullit dhe e punëtorëve. Vështirësitë janë shtuar akoma më shumë, sepse «aleatët» e Polonisë, me Bashkimin Sovjetik në krye, që e furnizojnë me shumë lëndë të parë, i kanë ngritur çmimet e mallrave dhe nuk ia livrojnë ato në kohën e duhur dhe në sasinë që kanë vendosur t'ia japin. Kjo tregon se marrëdhëniet në KNER janë vështirësuar me kohë dhe jo vetëm me Poloninë, por me të gjithë pjesëtarët e kësaj organizate ekonomike pseudosocialiste.

Për ta përmirësuar situatën në të cilën ndodhej, udhëheqja polake para 5-6 muajve ndryshoi kryeministrin, hoqi Jarosheviçin dhe vuri në vend të tij një tjetër, njëfarë Babjush, për të cilin atëherë u tha se gjoja do ta përmirësonte situatën ekonomike të Polonisë. Kjo ishte një përrallë, pse nuk ishte një person ai që e shkaktoi gjendjen aktuale të vështirë ekonomike, por ishte dhe është vetë vija revizioniste, kapitaliste e partisë dhe e shtetit polak. Babjushi dhe Giereku menduan se, duke ngritur çmimet e mishit dhe të

artikujve të tjerë të nevojës së përditshme të popullit, do të mundnin të rregullonin situatën pa ndonjë kokë-çarje të madhe. Por në fakt nuk arritën as të kalonin vështirësitë e brendshme ekonomike dhe as të likuidonin detyrimet ndaj «aleatëve» e «dashamirësve» kapitalistë perëndimorë.

Pra, në këto situata të brendshme në Poloni filluan grevat e punëtorëve të porteve të Balltikut. Por grevat në qytetet e Balltikut dhe në përgjithësi çështjen polake ne duhet t'i shohim në kuadrin e strategjisë globale imperialisto-revizioniste, në zhvillimet e politikës aktuale të të dyja superfuqive imperialiste. Kështu, para se të arrihej në grevat në Poloni, midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të Evropës Perëndimore, e në veçanti me Francën dhe me Republikën Federale Gjermane, ka pasur kontradikta të thella për disa çështje, si për Iranin, për lojërat olimpike që do të zhvilloheshin në Moskë, për vendosjen e raketave «Pershing-2» dhe «Kruiz» në territorin e shteteve anëtare të NATO-s dhe të raketave «SS-20» nga Bashkimi Sovjetik në territorin e vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, për çështjen e marrëveshjeve të Kemp Dejvidit midis Izraelit dhe Egjiptit, me fjalë të tjera për çështjen e Palestinës, të të drejtave të popullit palestinez etj.

Në këto mosmarrëveshje presidenti amerikan, Karter, mbajti një qëndrim gati arrogant dhe imponues kundrejt Francës dhe Gjermanisë Federale. Në të njëjtën kohë jo vetëm Franca, por edhe Gjermania nuk iu nënshtruan kërcënimeve dhe shantazheve amerikane. Përkundrazi, ato vazhduan politikën e tyre të «detantës» me Lindjen. Në këtë kuadër presidenti i Republikës Franceze, Zhiskar d'Estëni, shkoi në Varshavë dhe atje, duke pasur si «përkthyes» Gierekun, Sekretarin e Parë të Partisë së

Bashkuar Punëtore të Polonisë, u takua kokë më kokë me Brezhnjevin.

Nga ana e tij edhe kancelari i Gjermanisë Federale, Shmidt, shkoi në Moskë ku bisedoi me Brezhnjevin. Pas takimeve me të, Shmidti deklaroi se i kishte kërkuar Bashkimit Sovjetik një moratorium prej 3 vjetësh për të diskutuar çështjen e vendosjes ose jo të raketave të reja në Evropë, qoftë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë nga Bashkimi Sovjetik. Përveç takimit me Brezhnjevin, Shmidti kishte planifikuar gjatë muajit gusht takime e bisedime në Poloni me Gierekun dhe në Gjermaninë Lindore me Honekerin.

Gjatë muajit korrik u bë edhe takimi midis Zhiskar d'Estënit dhe Shmidtit në Gjermaninë Perëndimore. Sipas komunikatës që u botua pas bisedimeve të tyre, doli se ata kishin rënë dakord që qeveritë e të dy vendeve, në kundërshtim me dëshirat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vazhdonin politikën e «detantës» dhe të bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të Evropës Lindore, domethënë me shtetet anëtare të Traktatit të Varshavës.

Dihet se edhe vendet e Evropës Lindore, pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe vetë Bashkimi Sovjetik kanë interesa të mëdha ekonomike në bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veçanërisht me Francën dhe me Gjermaninë Federale. Këto dy shtete perëndimore kapitaliste, shumë të zhvilluara, kanë investuar miliarda dollarë, u kanë dhënë miliarda kredi këtyre vendeve. Ato janë shumë të interesuara që nga këto kredi jo vetëm të nxjerrin, dhe nxjerrin fitime të mëdha, por, nëpërmjet tyre, synojnë të minojnë akoma më shumë influencën sovjetike në vendet e Evropës Lindore.

Me fjalë të tjera, nëpërmjet kredive e investimeve të shumta dhe politikës së «detantës» ato, nga njëra

anë përpiqen të largojnë nga Evropa rrezikun e një lufte bërthamore ose me armë konvencionale dhe ta shtyjnë atë në Azi, nga ana tjetër të arrijnë të rritin influencën e vet mbi vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, të dobësojnë, pra, lidhjet e tyre të shumanshme me Moskën. Ky është objektivi i madh i këtyre dy shteteve më të fuqishme të Evropës Perëndimore.

Natyrisht, në këtë çështje e në këtë drejtim interes kanë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bile këto duan të jenë promotori i një politike ose i një shantazhi të tillë, kurse dy aleatët e tyre evropianë, Franca dhe Gjermania, për interesat e veta imediate dhe të ardhme dëshirojnë të veprojnë si të pavarur. Bashkimi Sovjetik nga ana e tij gjendet në vështirësi politike dhe ekonomike, bile edhe ushtarake pas invadimit *manu militari* të Afganistanit. Kështu që në këto situata edhe Bashkimit Sovjetik i intereson të ruhet «detanta» dhe bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në rast se këto vazhdojnë të kërcënojnë, atëherë, të paktën i intereson të çajë frontin e NATO-s duke bërë një politikë të «detantës» me Francën e me Gjermaninë Federale.

Këtë politikë të Bashkimit Sovjetik e ndjekin edhe satelitët e tij, vendet e tjera të Evropës Lindore. Bashkimi Sovjetik në asnjë mënyrë nuk dëshiron që këto vende satelite t'i dalin nga dora, por e ka të pamundur t'i ndalojë ato të futen në borxhe te Gjermania Federale, te Franca, te Shtetet e Bashkuara të Amerikës e te vende të tjera kapitaliste perëndimore.

Këto, sipas mendimit tim, janë caqet dhe objektivat politikë të synimeve dhe të dëshirave që kanë dy superfuqitë imperialiste në Evropë edhe në botë.

Pikërisht në këto situata e në këto ndërlikime politike ndërkombëtare, krahas vështirësive të brendshme të Polonisë, filluan grevat në qytetet bregdetare të

Balltikut. Këto greva, siç e kam shkruar edhe në analizat e tjera që u kam bërë, janë reaksionare, kundërrevolucionare, udhëhiqen nga kapitalistë polakë dhe drejtohen kundër kapitalistëve të tjerë polakë që quhen revizionistë e që janë në fuqi. Këto greva kanë karakter antisovjetik dhe properëndimor. Grevistët janë në shërbim të reaksionit e të kapitalit të brendshëm polak dhe të kishës katolike.

Dy supozime mund të bëhen rreth faktit që këto greva shpërthyen nën influencën e forcave reaksionare të brendshme e të jashtme, por jo në një kohë aq të përshtatshme për to për të arritur rezultatet që dëshironheshin. E para, mundet që ato shpërthyen pa llogaritur mirë momentet dhe predispozicionin e reaksionit kapitalist perëndimor. E dyta, ka mundësi që edhe ky i fundit dëshironte të arrihej në njëfarë kundërrevolucioni kundër kundërrevolucionarëve në fuqi në Poloni, por pa i kapërcyer caqet, domethënë të zhvillohej një kundërrevolucion i frenuar.

Me fjalë të tjera ka shumë mundësi që Franca dhe Gjermania Federale, nëpërmjet këtyre grevave, dëshironin të ushtronin presion ndaj Bashkimit Sovjetik, por jo ndaj Gierekut dhe klikës së tij, pra të mos shkohej aq larg, sa të viheshin në rrezik pozitat e kësaj klike polake, përndryshe e gjithë politika e tyre e «detantës» drejt Lindjes do të kompromentohej. Ata e dinin se, po të shkohej shumë larg në këtë çështje, (dhe kjo kishte mundësi të ndodhte, pse kushtet për një grusht kundërrevolucionar kundër një grupi po aq kundërrevolucionar, por që është në fuqi në Poloni, janë përgatitur prej kohësh), do të shkaktonte ndërhyrjen e armatosur të Bashkimit Sovjetik.

Pra, mund të themi pa asnjë dyshim se Perëndimi ka pasur gisht në këtë lëvizje kundërrevolucionare polake, dhe nuk mungoi t'i hidhte benzinë zjarrit, por

aq sa për t'i dhënë shtytjen e parë, shijen e parë të kundërshtimit sidomos nga klasa punëtore ndaj shtypjes sovjetike, dhe kjo në një formë të moderuar dhe jo të ashpër. Unë mendoj se për këtë orientim edhe klika e Gierekut ka pasur dijeni, e ka dashur një veprim të tillë për t'u treguar «më e pavarur» nga Moska. Giereku është properëndimor. Unë jam i bindur për këtë. Edhe shtetet kapitaliste perëndimore, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duan një udhëheqje polake me Gierekun, Babjushin ose një shokun e tyre në krye. Por në njëfarë shkalle, vendet kapitaliste evropiane sidomos, duan që edhe «mishi të piqet, edhe helli të mos digjet». Ato duan, pra, që punëtorët dhe populli polak të fitojnë gjoja të drejta demokratike, më shumë se ç'kanë aktualisht, që do të thotë se regjimi autoritar revizionist polak duhet të zbutet, të bëjë hapa të rinj drejt liberalizmit, por në të njëjtën kohë të mos kalohen caqet.

Po Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë apo s'kanë gisht në këtë mes? Mundet të kenë, mundet edhe të mos kenë. Mospasja është relative, pse Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson një situatë që ta zemërojë, ta acarojë Bashkimin Sovjetik dhe ky acarim të ndikojë në marrëdhëniet e Moskës me aleatët e saj të Evropës Perëndimore, kështu që Karteri të mund të realizojë pastaj planet e tij hegjemoniste në Evropë, të dobësojë atë farë kundërshtimi që i bëhet nga ana e Francës dhe e Gjermanisë Federale. Por mund të mendohet edhe kështu: kontradiktat e Francës dhe të Gjermanisë Federale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin një lojë diplomatike në shkallë të gjerë për të arritur në grevat në Poloni, ose për të shkuar edhe më tej.

Unë mendoj se ky version nuk mund t'u leverdiste Francës dhe Gjermanisë Federale. Kjo u duk qartë

edhe në qëndrimin që mbajti shtypi perëndimor, i cili vuri në dukje me të madhe grevat e punëtorëve të porteve polake të Balltikut, por nga ana e tyre qeveria franceze, ajo gjermane, qeveria angleze, bile edhe qeveria amerikane u treguan shumë të rezervuara. Jo vetëm kaq, por punëtorëve të Gdinias, të Gdanskut e të Shtetinit ato u këshillonin kërkesa të matura. Deri edhe papa i Vatikanit, dhe si rrjedhim edhe kisha katolike polake me Vishinskin në krye, u thoshin punëtorëve se ishin dakord me kërkesat e tyre, por haptazi u bënin thirrje që çdo gjë të zhvillohej në «qetësi», në «rregull», të merren «parasysh» kushtet e Polonisë, të shtetit polak etj., etj.

Me fjalë të tjera Perëndimi pati frikë nga një ndërhyrje ushtarake e Bashkimit Sovjetik, gjë që bëri të arrihet në Gdansk atë çka thashë në fillim të këtij shkrimi, në ndalimin e grevave me nënshkrimin e marrëveshjes midis përfaqësuesve të qeverisë dhe përfaqësuesve të komitetit të grevistëve. Sot për sot një ndërhyrje e armatosur nga ana e Bashkimit Sovjetik në Poloni nuk u leverdis as Gjermanisë Perëndimore, as Francës, as Anglisë dhe as Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sidoqoftë frymëzimi i grevave në portet e Balltikut ishte frymëzim perëndimor, por njëkohësisht i frenuar dhe prudent, që të mos ndodhte ajo që ngjau me Çekosllovakinë dhe me Dubçekun, i cili mendoi se mund të shkonte drejt caqeve që ëndërronte kapitalizmi pa u rrezikuar nga Bashkimi Sovjetik.

Për sa i përket Gierekut dhe klikës së tij, edhe ai u frikësua se mos grevistët kapërcenin kufijtë, gjë që do të shkaktonte ndërhyrjen e Bashkimit Sovjetik dhe kështu e tërë klika e plani i saj të viheshin në rrezik. Pra klika e Gierekut, e cila sipas mendimit tim ka gisht në këto greva, synonte që nëpërmjet tyre t'u thoshte popullit dhe punëtorëve polakë: jepuni të kup-

tojnë sovjetikëve kundërshtimin tuaj për varësinë nga Moska, por me kujdes dhe maturi. Në të njëjtën kohë, për t'u treguar punëtorëve se regjimi gjoja socialist në Poloni ka falimentuar, përpara kombit polak, përpara grevistëve, ai bëri autokritikë «të hapët», skandaloze, në Komitetin Qendror, duke pohuar se në Poloni, sidomos gjatë gjithë këtyre viteve të fundit, janë bërë gabime të mëdha politike dhe ekonomike, furnizimet nuk janë bërë në rregull, janë shkelur të drejtat e shtetasve e janë vërtetuar një sërë gabimesh të tjera, të cilat kanë shkaktuar pakënaqësi të mëdha te punëtorët e te populli.

Pas kësaj autokritike, klika e Gierekut premtoi se do t'i rishikonte kërkesat e grevistëve, disa prej tyre do t'i aprovonte, por nën drejtimin e Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe brenda kushtetutës e ligjeve të shtetit polak. Për gjithçka Giereku fajin ia ngarkoi kryeministrit të ri, Babjush, i cili nuk kishte veçse pak muaj që kishte ardhur në fuqi pas rrëzimit të Jarosheviçit. Tok me të u shkarkuan dhe një numër ministrash të tjerë dhe në vend të tyre u sollën disa njerëz që ishin përjashtuar nga Byroja Politike, nga KQ i Partisë dhe nga kabineti i ministrave në kohën kur ra Jarosheviçi. Kështu Babjushi dhe të tjerët u bënë «koka e turkut», ndërsa faji nuk qëndronte te Babjushi. Faje ai kishte sa të duash, por ato e kanë burimin dhe shkakun te klika e Gierekut, që është reaksionare, kapitaliste. Prandaj, në qoftë se dikush duhej të largohej nga udhëheqja e partisë dhe e shtetit në Poloni, ky, në radhë të parë, duhej të ishte vetë Giereku me gjithë klikën e tij.

Për sa i përket Bashkimit Sovjetik socialimperialist, gjatë gjithë këtyre trazirave ai heshti, por veshët i mbante ngritur, ruante si macja miun dhe pa lëvizur asnjë regjiment, sepse këto i kishte brenda në Poloni, armët

i mbante gati për rrezikun që mund t'i turrej. Revizionistët sovjetikë patjetër mbanin lidhje me Gierekun dhe me klikën e tij, e me siguri nuk ishin dakord, përkundrazi ishin në kundërshtim të hapët me çka po ndodhte në Poloni dhe me klikën e Gierekut, me autokritikën e tij dhe me vendimet që po përgatiteshin të merreshin. Kur u nënshkrua marrëveshja në Gdansk, atëherë Moska në shtypin e saj relatoi shkurtimisht ngjarjet dhe zuri në gojë diçka nga fjalimi i Gierekut. Ky është qëndrimi që mbajti Bashkimi Sovjetik gjatë zhvillimit të këtyre grevave dhe ky qëndrim i trembi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francën, Gjermaninë Federale, bile edhe vetë Gierekun dhe kishën katolike polake.

Aktualisht ne vëmë re se si Franca, ashtu edhe Republika Federale Gjermane e edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet zëdhënësve të tyre zyrtarë kryesorë po i bëjnë elozhe Gierekut për mënyrën e zgjidhjes së krizës. Kështu Brzezhinski, këshilltar i presidentit Karter për problemet e sigurimit, Ponjatovski, ish-ministër i Brendshëm i qeverisë franceze, e quajtën Gierekun «njeri të pjekur», «me eksperiencë të madhe», «patriot të flaktë» që diti të zgjidhë më së miri mosmarrëveshjet e punëtorëve në grevë me qeverinë dhe me Partinë Punëtore të Bashkuar të Polonisë. Por fakt është se fuqitë perëndimore, tash për tash, dëshirojnë të qëndrohet deri këtu, të thellohen fitoret që korrën grevistët e porteve të Ballikut dhe të përhapen ato në të gjitha qendrat punëtore të Polonisë. Ato duan që të ashtuquajturat sindikata të pavarura vetadministruese të konsolidohen dhe të kthehen në një parti politike në opozitë me të ashtuquajturën Parti Komuniste të Polonisë.

Shtypi i këtyre vendeve shkruan haptazi se «fitorja e arritur nga punëtorët polakë është një fitore historike», pse kjo ngjau në një vend gjoja komunist e socialist, ku regjimi komunist ka falimentuar dhe ku nuk

ekziston pluralizmi i partive. Pra kapitalizmi botëror, të ashtuquajturat sindikata të pavarura vetadministruese, që lindën nga kompromisi i klikës së Gierekut me grevistët kundërrevolucionarë të porteve të Balltikut, i konsideron si një parti të ardhshme politike, që ka fituar që tash pavarësinë ndaj Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë.

Marrëveshja prej 21 pikash që u nënshkrua në Gdansk midis përfaqësuesve të komitetit të grevistëve dhe përfaqësuesve të qeverisë, është një disfatë e turpshme për revizionistët polakë, për sistemin pseudosocialist të ekonomisë në Poloni, është rezultat i zhvillimit që në fillim të ekonomisë private, sidomos në fshat, si edhe i masave të çala që janë marrë në industri. Në të njëjtën kohë e për analogji, ajo është një disfatë e turpshme edhe për Bashkimin Sovjetik dhe për vendet e tjera revizioniste.

Ç'janë këto 21 pika? Ato janë kërkesat ekonomike e politike, njëfarë platforme ideologjiko-politike e programit minimal të forcave kundërrevolucionare aktuale në Poloni, që komiteti i grevistëve ia kishte paraqitur qeverisë polake si kusht për pushimin e grevës. E para nga këto kërkesa ishte krijimi i «sindikatave të pavarura vetadministruese» jashtë, dhe në opozitë me sindikatat ekzistuese në Poloni. Kështu, në bazë të kësaj kërkese, u aprovua themelimi i të ashtuquajturave bashkime profesionale të lira, si grupe krejt të pavarura dhe kjo gjoja në bazë të Konventës 87 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të cilën Polonia e ka nënshkruar, por nuk e ka zbatuar. Në këtë çështje grevistët gjoja pranojnë edhe rolin drejtues të partisë, por është e qartë, atë e pranojnë përkohësisht dhe siç thuhet në marrëveshje, «në shkëmbim të garancive se edhe nga ana e partisë

nuk do të ketë ndërhyrje në çështjet e bashkimeve profesionale». Një nga pikat e tjera thotë se punëtorëve «u garantohet e drejta për grevë» dhe grevistët e përkrahësit e tyre sigurohen që gjatë ose pas grevës «të mos keqtrajtohen». Kjo do të thotë që elementi reaksionar që frymëzon grevën dhe grevistët, kur të dëshirojnë mund të rrinë pa punë dhe të kërkojnë nga shteti çfarë t'u dojë zemra. Në qoftë se nuk u jepet, atëherë ashtu si në vendet kapitaliste ku sundon prona private, ata të vazhdojnë grevën. Kjo klauzolë e marrëveshjes vë pra në pah se edhe në Poloni në fuqi është prona private ose prona shtetërore kapitaliste.

Një nga të 21 pikat e marrëveshjes u njeh grevistëve «lirinë e fjalës dhe të shtypit», «ndalon ndjekjen e botuesve të pavarur» dhe siguron mundësinë që në shtyp «të shkruajnë të gjitha sektet fetare». Pra këto «sindikata të lira», që marrin të njëjtat forma dhe të njëjtat «të drejta të sindikatave» në shtetin kapitalist, do të kenë shtypin e tyre dhe ky shtyp do të përdoret edhe nga sektet fetare, kuptohet në radhë të parë nga kisha katolike. Marrëveshja parashikon edhe heqjen e censurës, me përjashtim të rasteve kur gjoja preken sigurimi i shtetit dhe çështjet ushtarake. Për të tjerat s'ka as kufizim, as censurë.

Një pikë tjetër e marrëveshjes e detyron qeverinë polake «të rivendosen në punë ose të rifillojnë studimet të gjithë ata që janë pushuar, që janë përjashtuar nga universiteti ose janë burgosur për arsye të pjesëmarrjes në demonstrata dhe në greva që në vitin 1970 edhe në vitin 1976, ose për pikëpamjet e tyre politike». Pra, këta grevistë reaksionarë, arritën të kërkojnë nga qeveria e tyre reaksionare lirimin e të gjithë të burgosurve politikë. Jo vetëm kaq, por udhëheqja e këtyre sindikatave që sapo u krijuan i ka dërguar që tash qeverisë një listë me

emra personash të dënuar dhe kërkon lirimin e tyre. Qeveria pranoi dhe ata do të lirohen brenda 24 orëve.

Grevistët kërkojnë nga qeveria që ajo të botojë në shtypin e saj zyrtar krijimin e komitetit të grevistëve, kërkesat e tyre, domethënë të 21 pikat, në mënyrë që ato të merren vesh nga të gjithë punëtorët e Polonisë dhe kuptohet që edhe këta të nxiten të ndjekin rrugën e tyre. Këto sindikata kërkojnë nga qeveria e tyre reaksionare që të botojnë në shtyp «informata të plota mbi gjendjen ekonomike dhe shoqërore të vendit» dhe «t'u krijojë mundësi të gjitha grupeve të marrin pjesë në diskutimin mbi një program reformash kombëtare» të reja.

Në këto kërkesa, të cilat me nënshkrimin e marrëveshjes u kthyen në vendime, flitet gjithashtu për çështjen e marrjes së masave «për shtimin e rrogave», për «pagesën e grevistëve» që përfaqësojnë «kolonën e grevës», të rrogave për «periudhën e grevës» mbi mesataren e pagës së tre muajve. Pra grevistët kërkuan rritjen e rrogave, siguruan aprovimin e qeverisë për shtimin e tyre, kërkuan dhe u vendos që «të ruhet furnizimi i plotë i tregut të brendshëm dhe të eksportohen vetëm prodhimet shtesë». Qeveria u premtoi atyre t'u japë më shumë mish, «duke e importuar atë nga jashtë». U vendos «të ndalohet shitja tregtare e mishit dhe shitja e produkteve të vendit për valutë», «të hiqen privilegjet për anëtarët e partisë, forcat e sigurimit dhe të policisë». «Qeveria, thuhet në marrëveshje, theksoi se privilegje të tilla nuk ka», (edhe pse në fakt ka). Grevistët e pranuan deklaratën e qeverisë, por «deklaruan se do të bëjnë kontrolle» për t'u siguruar. Grevistët kërkuan «uljen e moshës së pensionit në 55 vjeç për burra dhe 50 vjeç për gra, ose mbas 25-30 vjet pune përkatësisht». U arrit në marrëveshje për çështjen e parë, ndërsa vendimi për çështjen e dytë u shty. Pastaj në marrëveshje radhiten pikat që flasin për përmirësime në fushën e pensioneve, në shërbimin shëndetësor, në rritjen e numrit të çerdheve, për lejë të paguar lindjeje për 3 vjet, shkurtimi i kohës që pritet për strehim, rritja e fondeve për shërbimet zyrtare, më shumë të shtuna të lira e të tjera, e të tjera.

Të gjitha këto koncesione, dhe çështjet për të cilat ato u bënë, flasin për gjendjen e kalbëzuar të regjimit aktual revizionist polak dhe për trasformimin akoma më rrënjësor, më radikal, të Polonisë në një vend kapitalist. Siç shihet, ky transformim i një të ashtuquajturi vend socialist, që s'është socialist, u kërkua dhe u arrit nga «klasa punëtore». Pikërisht për këtë arsye, borgjezia dhe shtetet kapitaliste, krerët e tyre që nga Karteri deri te Regani, e quajnë një «fitore historike», një fazë të re të ndërtimit të një «socializmi real», që në të vërtetë do të thotë transformimi i një vendi nga revizionist e pseudosocialist, në një vend plotësisht kapitalist.

Në qoftë se klika e Gierekut, e cila nënshkroi këtë kapitullim me elementë kapitalistë që paraqiten nën maskën e klasës punëtore, mbetet në fuqi, atëherë duhet të arrijmë në konkluzionin që influenca e Bashkimit Sovjetik në Poloni dhe nënshtrimi ndaj tij, ka arritur në një shkallë mjaft interesante. Në rast se klika e Gierekut rrëzohet dhe në fuqi vjen një udhëheqje prosovjetike, dhe këto të ashtuquajtura fitore që u arritën në Gdansk, në Gdinia e në Shtetin gërryhen e më në fund zhduken, atëherë mund të arrijmë në konkluzionin tjetër se çizmja sovjetike vazhdon të sundojë fort në Poloni. Sidoqoftë, qëndron apo nuk qëndron klika e Gierekut në fuqi, këndej duhen nxjerrë dy konkluzione:

E para, regjimi pseudosocialist, sistemi revizionisto-kapitalist, qoftë ai i formës sovjetike, apo ai i formës aktuale polake, qoftë ai i vendeve të tjera që quhen vende të «demokracisë popullore», të cilat ndjekin rrugën e revizionizmit sovjetik, ose sistemi vetadministrues i titiz-

mit jugosllav, tregojnë falimentimin e revizionizmit modern.

E dyta, të gjitha format e emërtimet e ndryshme që ata kanë adoptuar i çojnë vendet e tyre respektive drejt një sistemi të plotë kapitalist.

Një konkluzion tjetër, që del nga zhvillimi i grevave të punëtorëve të porteve të Balltikut, është roli i madh udhëheqës që ka partia komuniste marksiste-leniniste në krye të klasës punëtore. Kur një parti e tillë nuk ekziston, atëherë klasa punëtore manipulohet me lehtësi nga revizionistët modernë, nga borgjezia kapitaliste e brendshme dhe e jashtme. Një manipulim i tillë e çon klasën punëtore në disfatë të vërtetë, në rrugë që janë kundër interesave të saj jetike e në favor të interesave të borgjezisë kapitaliste, duke e gënjyer me gjoja fitoren e disa të drejtave fiktive. Por këto «fitore» nuk e lëkundin dot pushtetin e kapitalit, të kapitalistëve e të revizionistëve, ashtu siç nuk mund ta lëkundin pushtetin e borgjezisë në vendet kapitaliste grevat ekonomike, «liria» e fjalës, diskutimet «demokratike» e të tjera, e të tjera.

Një klasë punëtore revolucionare, që udhëhiqet nga një parti komuniste marksiste-leniniste e vërtetë revolucionare, duhet të luftojë seriozisht për të drejtat e veta politike dhe ekonomike. Ajo nuk mund t'i fitojë të drejtat e saj të vërteta me rrugën reformiste të bisedimeve.

Cilat janë të drejtat e vërteta për të cilat duhet të luftojë klasa punëtore? Në radhë të parë e mbi të gjitha është çështja e marrjes së pushtetit në duart e veta. Vetëm kur të ketë marrë në dorë dhe të ketë çrrënjosur aparatin diktatorial të pushtetit të borgjezisë, pra, kur të ketë vendosur diktaturën e proletariatit, klasa punëtore mund të sigurojë me të vërtetë të drejtat që i takojnë për administrimin e gjithanshëm politik, ekonomik e kulturor të vendit në interes të vet e të masave punonjëse.

Çfarë do të ngjasë në Poloni në rast se revizionistët sovjetikë nuk arrijnë ta përmbysin situatën që u krijua? Do të krijohen për ta vështirësi të tjera më të mëdha dhe jo vetëm në Poloni, por edhe në vendet e tjera të Traktatit të Varshavës, në radhë të parë në Hungari, në Republikën Demokratike Gjermane, në Çekosllovaki, pastaj në Rumani e më në fund në Bullgari.

Këtij eventualiteti me siguri sovjetikët do t'i dalin përpara. Për këtë arsye Evropa Perëndimore, dhe ka mundësi që edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të solidarizohen me polakët për ta mbështetur kursin e tyre të ri, i cili është në interes të borgjezisë kapitaliste botërore dhe në disavantazh të Bashkimit Sovjetik dhe të forcave revizioniste, aleate të tij.

Prandaj ne duhet të jemi vigjilentë dhe të ndjekim me kujdesin më të madh zhvillimin e ngjarjeve.

Në përfundim, krijimin e «sindikatave të pavarura vetadministruese» në Poloni ne duhet ta gjykojmë si një trampolinë për të kaluar nga një sistem anarkosindikalist të strukturave dhe të superstrukturave të vendeve revizioniste, në një sistem të plotë kapitalist. Ajo çka ndodhi në Poloni, ka ngjasim me atë çka ka ndodhur më përpara në Jugosllavi, vepër e grupit tradhtar të Titos. Por, Jugosllavia, që kaloi nga faza e një regjimi pseudosocialist pas lufte, u shkëput definitivisht nga kampi i socializmit dhe, pas disa peripecive, kaloi në sistemin e vetadministrimit. Në Jugosllavi roli i partisë u zhduk. U zhduk edhe roli i bashkimeve profesionale. Centralizmi shtetëror dhe demokratik u zhdukën dhe ia lanë vendin decentralizimit ekonomik, duke ruajtur gjoja një centralizëm politik dhe një administrim të përbashkët federativ.

Aktualisht në Jugosllavi vetadministrimit, në forma të ndryshme, po i vihen kushtëzime. Përse? Sepse si sistem anarkist që është, ai nuk mund ta përballojë krizën e madhe ekonomike që ka mbuluar Jugosllavinë dhe ven-

det kapitaliste që e ndihmojnë atë. Kapitalistët perëndimorë dhe imperializmi amerikan me investimet, kreditë e borxhet që japin kërkojnë të sigurojnë fitime nga Jugosllavia. Për një kohë, deri në kapërcimin e stadit të shkëputjes plotësisht nga sistemi gjoja socialist, këtyre qëllimeve të tyre u shërbeu sistemi i vetadministrimit. Tash, ky s'vlen më dhe qëllimet e borgjezisë kapitaliste botërore synojnë që t'i sigurojnë Jugosllavisë një sistem tjetër, atë të centralizmit burokratik.

Kurse në Poloni, revizionizmi polak, ashtu si në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera anëtare të Traktatit të Varshavës, ruan format e vjetra të strukturës dhe të superstrukturës, domethënë atje ruhet ende centralizmi në ekonomi e në pushtet; Partia Punëtore e Bashkuar e Polonisë është në udhëheqje; bashkimet profesionale luajnë rolin e rripit transmetues të politikës së partisë revizioniste në klasën punëtore etj., etj. Borgjezisë kapitaliste perëndimore i duhet të gjejë një rrugëdalje për ta dobësuar më tej këtë sistem shtetëror që ata e dinë se është pseudosocialist, e nën influencën e plotë të Bashkimit Sovjetik. Pra, kapitalizmi perëndimor dhe imperializmi amerikan, për të dobësuar sistemet kapitalisto-revizioniste në vendet aleate të Bashkimit Sovjetik, duhet të veprojnë, por, natyrisht, me prudencë, sepse një ndërhyrje e tyre e hapët mund të shkaktojë ngjarje si në Hungari, në Çekosllovaki, në Afganistan, nga të cilat, siç duket, ata kanë nxjerrë mësime.

Pra, që të infiltrohen më mirë në këto vende, ata, domethënë perëndimorët, duhet të përpiqen jo vetëm të realizojnë aty degjenerimin e shoqërisë dhe të investojnë kapitalet e tyre, të cilat u sjellin fitime e njëkohësisht gërryejnë edhe potencialin politik, ekonomik dhe ushtarak të Bashkimit Sovjetik në këto vende, por nuk lënë në harresë dhe punojnë edhe për degjenerimin e vetë sistemit në fuqi aktual në to. Dhe mjeti më i mirë për degjenerimin e sistemit të vendeve revizioniste, është vetadministrimi, që u zbatua në Jugosllavi, po zbatohet në Kinë, e predikojnë eurokomunistët, partia revizioniste franceze, ajo italiane etj., dhe tash duhet ta zbatojnë edhe vendet e Traktatit të Varshavës.

Borgjezia kapitaliste botërore ka menduar, dhe s'ka menduar keq, se aktualisht nuk mund të tentonte për një përpjekje të tillë në Hungari, në Republikën Demokratike Gjermane ose në Rumani, prandaj gjeti Poloninë. Përse? Për arsye se në Poloni sistemi aktual revizionist në fuqi është dobësuar, kisha katolike është forcë dominuese dhe këtë forcë dhe rolin e rëndësishëm që ka asaj ia kanë dhënë Gomulka, Giereku. Me dashje ose pa dashje atë e kanë toleruar edhe revizionistët sovjetikë. Kështu, borgjezia kapitaliste botërore ka në Poloni mbështetjen e kishës katolike, që përbën një forcë të madhe brenda vetë sistemit polak, ku e ashtuquajtura parti është e krimbur dhe kërkon rrugëdalje për të likuiduar elementët që përpiqen ta mbajnë në këmbë sistemin aktual.

Borgjezia kapitaliste botërore mbështetet, gjithashtu, në antisovjetizmin e madh të polakëve, si dhe në faktin se klika e Gierekut, pavarësisht nga ana formale, nuk u bindet plotësisht revizionistëve sovjetikë. Antisovjetizmi i Gierekut dhe i klikës së tij qëndron në nxitjen e rivendikimeve të fshehta për pavarësi nga revizionistët sovjetikë.

Në këto situata, ata që qëndrojnë prapa grevave në portet e Baltikut, të cilave përpiqen t'u japin karakter «të lirë vetadministrues», synojnë të krijojnë një opozitë ndaj Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë dhe pastaj, sistemin vetadministrues ta zbatojnë dalngadalë edhe në ekonomi, ashtu siç u bë në Jugosllavi. Duhet të kemi, gjithashtu, parasysh faktin se këta «punëtorë grevistë», të frymëzuar nga borgjezia kapitaliste dhe nga kisha katolike, do të zhvillojnë aktivitet në fshatin polak

dhe «sindikatat e pavarura vetadministruese» do të përpiqen të grumbullojnë nën drejtimin e tyre, të gjitha ndërmarrjet e vogla ose punishtet që ekzistojnë atje «për t'i vetadministruar» ekonomikisht dhe politikisht. Organizatat e reja sindikale do të zgjerojnë patjetër aktivitetin e tyre politik dhe si rrjedhim edhe ekonomik. Në ndërmarrjet shtetërore ku do të infiltrohet «e drejta» e grevës dhe të gjitha «të drejtat» e tjera, që figurojnë në 21 pikat që përmenda më lart, puna do të arrijë deri në atë shkallë saqë vendimet e tyre, nëpërmjet grevash, t'u imponohen qeverisë dhe Partisë Punëtore të Bashkuar Poloneze.

Kështu mendojnë borgjezia kapitaliste perëndimore dhe ata që udhëhoqën grevat e punëtorëve të porteve të Balltikut, me të cilët indirekt është ndërlikuar edhe grupi i Gierekut, që hedh gurin dhe fsheh dorën për të fituar terren në rrugë reformiste dhe për të evituar ndërhyrjet e Bashkimit Sovjetik në punët e brendshme të Polonisë. A do t'ia arrijnë ata këtij qëllimi? Kjo është një pikëpyetje. Mendimin tim unë e shpreha më lart dhe e përsëris se do të jetë shumë «azardoze», siç thotë francezi, e guximshme që t'i çojnë gjërat më larg. Është e vështirë që revizionistët sovjetikë dhe vendet e tjera të Traktatit të Varshavës, ose klikat që sundojnë në këto vende, të lejojnë që të realizohen plotësisht qëllimet e borgjezisë perëndimore dhe të reaksionit polak. Bashkimi Sovjetik është i vendosur të ruajë pushtetin e vet në të gjitha vendet e KNER-it dhe të Traktatit të Varshavës, domethënë të ruajë të paprekur si pushtetin politik, format etatiste, strukturat e superstrukturat pseudosocialiste, ashtu edhe sistemin aktual ekonomik dhe atë ushtarak. Për këtë qëllim revizionistët sovjetikë krijuan të ashtuquajturën teori të «sovranitetit të kufizuar».

Unë mendoj se kompromisi i arritur midis grevistëve dhe qeverisë polake është vetëm një *modus vivendi*. Bashkimi Sovjetik socialimperialist nuk do të lejojë që në klanin e tij revizionist të rritet një klan tjetër ultrarevizionist. Dhe është e qartë se Bashkimi Sovjetik, pavarësisht se ndodhet në vështirësi të mëdha ekonomike, politike dhe ushtarake brenda në Bashkimin Sovjetik dhe në gjirin e Traktatit të Varshavës, prapëseprapë ka aq forca, bile këto i ka të përqendruara në vendet vasale të Evropës Lindore, sa të mos lejojë që një veprimtari e tillë kërcënuese të përhapet e të bëhet e rrezikshme për të dhe për klikat në shërbim të tij që janë në fuqi në këto vende.

Në të gjitha këto çështje rëndësi të veçantë ka që klasa punëtore ndërkombëtare të mos gabohet dhe grevën në portet polake të Balltikut ta konsiderojë veprimtari revolucionare. Në asnjë mënyrë ajo nuk duhet vlerësuar si veprimtari revolucionare. Ajo ka frymëzim kundërrevolucionar, është drejtuar kundër një udhëheqjeje po aq kundërrevolucionare. Ajo kërkon të shpëtojë Poloninë nga thonjtë e socialimperialistëve sovjetikë, por duke e shndërruar atë në një vegël të kapitalizmit botëror.

Vetë klasa punëtore polake duhet ta kuptojë këtë. Të kuptojë se rruga e vërtetë e shpëtimit kërkon që klasa punëtore polake, nën udhëheqjen e një partie me të vërtetë marksiste-leniniste e të frymëzuar nga marksizëm-leninizmi, të ngrejë popullin polak në këmbë dhe ta udhëheqë në fushën e betejës për të rrëzuar klikat e brendshme kapitalisto-revizioniste, për të hequr qafe zgjedhën e Bashkimit Sovjetik revizionist, për të shkundur zgjedhën e kapitalizmit botëror dhe për të likuiduar influencën shkatërruese të kishës katolike. Klasa punëtore dhe populli polak duhet ta kuptojnë se antisovjetizmi i tyre aktual nuk bazohet në ideologjinë marksiste-leniniste, por është një antisovjetizëm i frymëzuar nga idetë shoviniste të borgjezisë polake.

Për sa u përket njerëzve tanë, nëpërmjet shtypit dhe

mjeteve të tjera të propagandës, duhet t'i analizojnë e t'i kuptojnë drejt rrethanat në të cilat ndodhin këto ngjarje, t'i analizojnë e t'i kuptojnë ato nën dritën e marksizëm-leninizmit dhe të mos gabohen nga ajo se gjoja ata që ngritën krye ishin punëtorë dhe këta punëtorë ishin kundër klikës së Gierekut dhe kundër Bashkimit Sovjetik. Jo. Këta punëtorë, me ndërgjegje ose jo, nuk ecnin në rrugën e revolucionit, por në atë kapitaliste. Ata ishin kundër Gierekut, po jo për rrëzimin e tij, ishin kundër Bashkimit Sovjetik, por jo për shkëputjen me violencë nga çizmja socialimperialiste sovjetike, nuk janë për ecjen në rrugën revolucionare, për kthesën vendimtare në ndërtimin e vërtetë të socializmit në Poloni. Borgjezia kapitaliste perëndimore dhe reaksioni botëror mund t'i përdorin këta për të dobësuar kundërshtarët e tyre dhe për të forcuar pozitat e veta. Për të krijuar vështirësi dhe turbullira të reja, që edhe tani nuk janë të pakta, për të forcuar pozitat e veta dhe për të dobësuar ato të kundërshtarëve të saj, borgjezia kapitaliste botërore dhe veçanërisht borgjezia kapitaliste evropiane dhe ajo amerikane do të vazhdojnë me këto rrugë e me këto mënyra jo vetëm në Poloni, por edhe në Gjermaninë Lindore, edhe në vendet e tjera të ashtuquajtura të demokracisë popullore, edhe brenda në Bashkimin Sovjetik. Ja, në fakt, tash që grevat në portet polake mbaruan dhe, siç thuhet, sot rifilloi puna, borgjezia kapitaliste gjermanoperëndimore, Boni, filloi të nxjerrë përsëri në plan të parë çështjen e takimit dhe të bisedimeve të lëna mënjanë, me Honekerin, bile edhe me Gierekun. Në shtyp flitet gjithashtu se Gjermania Perëndimore i ka caktuar Polonisë një kredi të re prej 500 milionë markash «për ta ndihmuar» që të kalojë vështirësitë që ka. Po kështu edhe Franca. Po u bëhet thirrje të gjitha vendeve kapitaliste të zhvilluara që «ta ndihmojnë» Poloninë në këto situata. Pra, po vazhdon të hidhet helmi i lyer me një cipë të hollë sheqeri për të përforcuar pozitat e lëkundura të Gierekut për ta inkurajuar reaksionin polak dhe kishën katolike që të vazhdojnë punën e tyre gërryese kundër komunizmit, të shtohen mëria dhe armiqësia kundër Bashkimit Sovjetik etj. Nga ana e tij edhe Bashkimi Sovjetik, patjetër, punon për të krijuar një ekip të ri në favor të tij dhe, kur ta ketë krijuar atë, atëherë do t'ia ngrejë këmbët Gierekut dhe do ta zëvendësojë me një Gierek prosovjetik më të sigurt.

Sidoqoftë, me sa duket, tani për tani, Giereku e shpëtoi lëkurën e vet, po ashtu shpëtoi edhe nga ndërhyrja sovjetike. Megjithatë gjendja e turbullt në Poloni nuk ka marrë fund. Ajo po zhvillohet e do të zhvillohet. Mendoj se Bashkimi Sovjetik do t'ia shtrëngojë rripat Polonisë.

E ENJTE
20 NËNTOR 1980

GJYQI I TË GJALLËVE E I TË VDEKURVE, GJYQI I MAO CE DUNIT

Në Pekin ka filluar gjyqi i «bandës së të katërve», që është bërë «banda e të dhjetëve», pa përmendur të panumërtit e tjerë që quhen «pasuesit e bandës së të katërve» dhe që gjykohen në mënyrë ekstensive nëpër provinca. Ky është **gjyqi i të gjallëve dhe i të vdekurve, por mbi të gjitha është gjyqi i Mao Ce Dunit.**

Pjesëtarët e «bandës së të katërve» gjykohen kryesisht si banditë e vrasës të qindra mijëra njerëzve dhe jo si kundërshtarë politikë të grupit të Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me kompani. Gjykimi i të akuzuarve si njerëz politikë do ta çonte larg bandën e Tenit, pse do t'i hapej ose duhej t'i hapej tërë peta lakrorit, që do të thotë të dilte në dritë e vërteta mbi Kinën e ashtuquajtur socialiste, ku në realitet socializëm nuk po ndërtohet dhe të shpjegohej politika e Mao Ce Dunit, e Liu Shao Çisë, e Çu En Lait, e Tenit dhe e një numri të madh rrymash politike që përplaseshin atje.

Si e arsyetojnë këtë gjyq, që për fat të keq s'është veçse një komedi tragjike për popullin kinez, njerëzit e bandës së Tenit tani që kanë marrë plotësisht në duar frenat e shtetit? Le t'ia lëmë fjalën agjencisë kineze të lajmeve, Hsinhua. Kjo thotë se juristi Çen Jou Ju, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Shoqërore të Kinës, iu përgjigj pyetjes së mëposhtme: «Cilat janë arsyet ligjore

që gjykata e posaçme pranë gjykatës së lartë popullore ka përdorur kodin penal të Republikës Popullore të Kinës në procesin gjyqësor kundër klikave kundërrevolucionare të Lin Biaos dhe të Çian Çinit, në vend të neneve për dënimin e kundërrevolucionarëve dhe të dekreteve në fuqi, kur ata kanë kryer krime kundërrevolucionare, për të cilat akuzohen?».

Ja edhe përgjigjja tekstuale: «Lidhur me çështjen e zbatimit të ligjit, neni nëntë i kodit penal të Kinës përcakton se, në qoftë se një akt i kryer pas themelimit të Republikës Popullore të Kinës dhe para hyrjes në fuqi të ligjit të tanishëm nuk konsiderohet krim sipas ligjeve, dekreteve dhe politikave të asaj kohe, atëherë si bazë do të shërbejnë këto ligje, dekrete dhe politika. Në qoftë se akti konsiderohet krim sipas atyre ligjeve, dekreteve dhe politikave e gjithashtu edhe sipas nenit të tetë të kapitullit të katërt të dispozitave të përgjithshme të ligjit të tanishëm, për këtë krim do të zbatohen ato ligje, dekrete dhe politika, por, në qoftë se akti nuk konsiderohet krim, ose në qoftë se dënimi për krim është më i lehtë sipas ligjit të tanishëm, atëherë duhet të zbatohet ligji i tanishëm. Në përputhje me këtë nen, rrethanat e mëposhtme duhet të shqyrtohen, duke pasur parasysh zbatimin si më parë të këtij ligji. Në qoftë se një akt i kryer, pas themelimit të Republikës Popullore të Kinës dhe para hyrjes në fuqi të ligjit të tanishëm, nuk konsiderohet krim sipas ligjeve, dekreteve dhe politikave të atëhershme, por konsiderohet krim sipas kodit penal, ligjet, dekretet dhe politika e mëparshme akoma do të jenë në fuqi, ndërsa kodi penal nuk do zbatohet si më parë. Në qoftë se akti konsiderohet krim, sipas atyre ligjeve, dekreteve dhe politikave dhe gjithashtu sipas kodit penal dhe duhet të bëhet objekt ndjekjeje, ato ligje, dekrete dhe politika do të mbeten gjithashtu në fuqi për sa i përket veprimtarisë kriminale, ndërsa kodi penal nuk do të zbatohet si më parë. Në qoftë se akti konside-

rohet krim, sipas ligjeve, dekreteve dhe politikave që ishin atëherë në fuqi, ose është objekt i dënimit të rëndë, por nuk është krim ose është një krim që parashikon një dënim më të lehtë sipas kodit penal, atëherë ligji i tanishëm ka fuqi prapavepruese» etj., etj.

Jashtëzakonisht «e qartë», s'ka ku vete «më qartë dhe në mënyrë më të kuptueshme»! Me tërë kuptimin e fjalës ky është një lesh arapi, një kinezëri e vërtetë tipike për të mos kuptuar asgjëkafshë.

Udhëheqja kineze s'ka gjetur rrugë më të errët për të gjykuar një çështje kaq të madhe, të ndërlikuar dhe të pazgjidhshme në rrethanat aktuale nëpër të cilat po kalon Kina.

Duke ndjekur seancat e para të gjyqit e duke lexuar pretencën e prokurorit të përgjithshëm në gjyqin e «bandës së të katërve», del qartë se ky gjyq synon vetëm të vërtetojë në mënyrë krejt të thjeshtë **se të dhjetë personat që gjenden në bankën e të akuzuarve si dhe ata që kanë vdekur,** me përjashtim të Mao Ce Dunit, i cili nuk përmendet asgjëkundi, **«kanë komplotuar për të vrarë Mao Ce Dunin» (këtë komplot e ka organizuar banda e Lin Biaos, në të cilën implikohen oficerë që nga shefi i shtabit të përgjithshëm deri te komandanti i flotës ajrore); se «banda e të katërve», domethënë Çian Çini dhe tre të tjerët, «kanë komplotuar kundër Ten Hsiao Pinit dhe Çu En Lait me shokë», se kanë shkuar te Mao Ce Duni dhe e «kanë informuar» atë se Çu En Lai, megjithëse i sëmurë në krevat nga kanceri, po pret ditë e natë njerëz si Ten Hsiao Pinin, Jeh Çien Jinë, Li Hsien Nienin, se ata «po komplotojnë kundër pushtetit në Kinë dhe, si rezultat, është krijuar një situatë sikundërqë u krijua në Lushan».**

Në vitin 1970, në Lushan Lin Biaoja «paska bërë përpjekje që Komiteti Qendror të vendoste përsëri postin e kryetarit të shtetit, që u hoq pas shkarkimit të presidentit Liu Shao Çi, tre vjet më parë, pse donte të bëhej vetë kryetar i Republikës Popullore të Kinës, të merrte pushtetin». Në Lushan Mao Ce Duni e paskësh kundërshtuar mendimin e Lin Biaos, se gjoja ai e kishte kuptuar qëllimin e tij, por nuk kishte munguar që ta ngrinte në qiell dhe ta bënte Linin shokun e tij kryesor të armëve.

Pra, njerëzit e «bandës së të katërve», me Çian Çinin në krye, vanë komplotuan me Mao Ce Dunin, i cili gjoja i tha Van Hun Venit të dërguar nga banda, **«që të mos merreshin me këto gjëra dhe të mos u besonin shumë mendimeve të Çian Çinit». Mirëpo Van Hun Veni, natyrisht, nuk ia tha «bandës së të katërve» mendimin e Mao Ce Dunit. Këta pra «komplotuan».** Përveç kësaj, këta akuzohen për të gjitha krimet e Revolucionit të Madh Kulturor, për persekutimin e kuadrove, domethënë të shokëve të Ten Hsiao Pinit dhe të Liu Shao Çisë, si dhe për vrasjen e qindra mijëra vetave.

Ky është thelbi dhe tërësia e pretencës së prokurorit. Në këtë pretencë prej tri ose katër faqesh gazete nuk mund të gjesh asnjë fjalë për qëllimet politike, organizative, ekonomike dhe ideologjike të të akuzuarve. Nuk flitet, gjithashtu cilat ishin pikëpamjet e grupit të Liu Shao Çisë, të Ten Hsiao Pinit, të Çu En Lait, të Çu Desë etj., që u luftuan nga Revolucioni i Madh Kulturor. Mbi të gjitha nuk thuhet asgjë për pikëpamjet politike të Mao Ce Dunit mbi këto probleme të mëdha që kanë preokupuar Kinën, që nga viti 1956 dhe derisa «timonieri i madh» mbylli sytë. Asgjë. Domethënë çështjeve politike, çështjeve organizative, atyre ekonomike, apo ideologjike u është vënë kapaku në këtë gjyq dhe pjesëtarët e «bandës së të katërve» akuzohen vetëm se janë «kriminelë, vrasës e komplotistë». Gjithë aktakuza përbëhet nga thashetheme, filani porositi filanin të vejë t'i thotë filanit kështu ose ashtu dhe ai iu përgjigj kështu, tjetri shkoi i kallzoi

këtij, ky vajti i tha atij. Pra një *galimatias*[1] i tillë qesharak përbën aktakuzën e prokurorit të përgjithshëm të Kinës kundër «bandës së të katërve».

Gjyqi filloi me ushtarakët, mbasi gjykimin e të akuzuarve e kanë ndarë në dy pjesë, në gjykimin e ushtarakëve më parë, pastaj dhe në gjykimin e Çian Çinit, të Jao Ven Juanit dhe dy të tjerëve. Shumë për t'u tallur e për të qeshur është gjyqi i ushtarakëve. Të lexosh pyetjet e gjykatësit dhe përgjigjet e të akuzuarve, mund të nxjerrësh konkluzionin se udhëheqësit revizionistë të Pekinit po tallen me popullin kinez e në të njëjtën kohë bëhen edhe lodra e botës. Kryesuesi i seancës gjyqësore i bën, për shembull, pyetjen ish-komandantit të flotës ajrore të Kinës Vu Fa Hsien: «Je ti që e emërove djalin e Lin Biaos si zëvendësdrejtor të Zyrës së Përgjithshme dhe zëvendësshef të drejtorisë Operative të Komandës së Forcave Ajrore?»

Dhe i akuzuari përgjigjet: Po, unë jam.

— Po pse e emërove?

— Se mora urdhër nga Lin Biaoja. Dhe pas kësaj përgjigjeje lexohet urdhri i emërimit të djalit të Lin Biaos.

— Si ia komunikove këtë urdhër? — vazhdon gjykatësi.

— Ia komunikova duke qenë prezent filani dhe filani. Atëherë kryesuesi i seancës gjyqësore thërret personat që iu përmend emri, të cilët deponojnë se ndodheshin atje kur komandanti i aviacionit emëroi djalin e Lin Biaos dhe i porositi që urdhrat të zbatoheshin.

«U vërtetua kjo», thotë me kënaqësi kryesuesi i seancës gjyqësore. Pastaj, vazhdoi ai, djali i Lin Biaos (që u vra tok me babanë kur «u arratis» në Mongoli) bëri një mbledhje me filanin, me filanin dhe me filanin,

1 Frëngjisht — fjalim i shkruar në mënyrë të ngatërruar dhe konfuze.

ku shtroi çështjen që të formohej një komandë e përbashkët e aviacionit dhe e flotës. Je në dijeni? — e pyet përsëri kryesuesi i seancës gjyqësore ish-komandantin e flotës ajrore.

— Po.

— Po pse e bëri këtë djali i Lin Biaos?

— E bëri se mori shembullin e filan admirali japonez që kishte bërë një organizim të tillë. Kryesuesi i seancës gjyqësore me seriozitetin më të madh, thotë përsëri, «ja, u vërtetua edhe kjo».

Atëherë bëhet një tiradë, ku vihet në dukje që djali i Lin Biaos gjoja kishte bërë disa mbledhje dhe kishte kërkuar të viheshin nën kontroll radarët, pajisje e mjete të tjera ushtarake dhe të gjitha këto për arsye se do të përgatitej komploti, ose ky komplot ishte duke u përgatitur për të vrarë Mao Ce Dunin dhe tërë këta njerëz mbanin lidhje me Lin Biaon. (S'duhet harruar se Lin Biaoja ishte ministër i Mbrojtjes i Kinës në atë kohë dhe, mbi Çu En Lain, ai komandonte jo vetëm aviacionin, por tërë forcat e armatosura, pra edhe marinën, këmbësorinë etj.)

Kështu gjoja kishin vendosur, por s'ka kush e vërteton këtë gjë, vetëm se të akuzuarit e pohojnë, ata thonë «se ashtu është, do të bëhej komplot për të vrarë Mao Ce Dunin» dhe «kishin vendosur që këtë ta hidhnin në erë» kur të kalonte treni nga ajo ose nga kjo rrugë. Mirëpo Mao Ce Duni në kundërshtim me oraret e rregullta të trenit «nuk qëndroi në Shangai, nuk doli fare nga treni dhe u largua drejt e në Pekin». Kështu dështoi i famshmi komplot dhe Çu En Lai nga Pekini dha urdhër që avioni special numër kaq apo aq, që ishte në dispozicion të Lin Biaos, të kthehej në Pekin. Mirëpo Lin Biaoja pasi kishte parë dhe kuptuar se komploti u zbulua, u bashkua me gruan dhe me djalin, hipi në po këtë avion, por harroi të merrte një pilot të dytë

që i duhej, si dhe specialistin e radarëve dhe në këto kushte u nis për në Mongoli, ku u vra.

Gjithë kjo histori u zhvillua në gjyq gati kështu, me këto fjalë që thashë më lart, vetëm nuk përmenda dot emrat, se nuk i mbaj mend. Dhe tërë kjo që thashë, formon aktakuzën kundër oficerëve dhe komplotit. Me të vërtetë për të qeshur!

Nga «banda e të katërve» kanë nxjerrë përpara trupit gjykues vetëm Van Hun Venin dhe Jao Ven Juanin, të cilët i kanë pyetur nëse kanë bërë komplot.

— Po, janë përgjigjur këta, kemi bërë komplot.

— Po si e keni bërë këtë komplot?

— Ja, shkuam te Mao Ce Duni dhe i thamë se Çu En Lai me Ten Hsiao Pinin, me Li Hsien Nienin dhe me Jeh Çien Jinë po komplotojnë dhe po krijohet një situatë si në Lushan.

Ky është komplot, thotë gjykatësi, dhe çështja u sqarua, po kush ju shtyu ju t'ia thoshit Maos këto? — pyeti ai përsëri.

— Ne na shtyu Çian Çini, u përgjigjën këta.

Me fjalë të tjera këta u zbrazën, megjithatë do të shohim çfarë do të thonë tjetër dhe si do të arsyetohet gjithë kjo ngjarje e zhvilluar prej kaq vitesh, me Mao Ce Dunin në krye.

Gjyqi është një parodi e vërtetë. Si është e mundur që personalitete të tilla, që kanë luajtur një rol të madh në Revolucionin Kulturor, të mos kenë pasur qëllime politike dhe të mos jenë frymëzuar nga disa parime të caktuara në veprimet e tyre?! Vetëm në një gjyq kinez, organizuar nga një klikë pa parime mund të ndodhë një gjë e tillë. Në fakt, ky është një problem i madh, politik dhe ideologjik, për të cilin sa kam mundur të gjykoja e si kam gjykuar, kam shkruar në librin tim «Shënime për Kinën».

Shumica e mendimeve të mia vërtetohen, por, ashtu

si po zhvillohen ngjarjet në Kinë është e zorshme të arrish të vërtetosh e të krahasosh konkluzionet që kam nxjerrë, pse, sa kohë që kalon dhe nga mënyra e shtjellimit të problemeve, ato bëhen akoma më të errëta, më të pakuptueshme. Dhe është e natyrshme të bëhen më të errëta, mbasi grupi udhëheqës që ka ardhur në krye të Kinës, është pikërisht një grup puçist kapitalist, që kërkon të marrë revanshin kundër kundërshtarëve të mëparshëm të tij, të vendosë një regjim kapitalist sipas dëshirave të veta dhe ta fshehë këtë politikë, nën maskën e një pseudoregjimi socialist dhe pushtetin ushtarako-fashist ta quajë diktaturë të proletariatit.

Është për këto arsye që as në këtë gjyq, as në fjalimet e udhëheqësve revizionistë kinezë, duke filluar që nga Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni e të tjerë, nuk përcaktohet qartë vija e tyre politike dhe ideologjike. Kjo jo vetëm se është në natyrën e kinezit të jetë konfuz në mendime dhe në veprime, por edhe pse njerëzit që kanë drejtuar e vazhdojnë të drejtojnë Kinën, kanë pikëpamje idealiste konfuciane me më pak parime se idetë e Konfucit.

Ku po shkon tani Kina? Jam i bindur se këta që janë sot në fuqi, as vetë nuk dinë ku po shkojnë. Ata nuk kanë përcaktuar akoma rrugën dhe mënyrën e ecjes së tyre. Qëllimi aktual i njerëzve që sundojnë në këtë vend, është ai i mëparshmi, domethënë në radhë të parë të mbajnë në duar fuqinë që morën, domethënë një grup të dominojë mbi të tjerët. Aktualisht është grupi i Ten Hsiao Pinit ai që bën të gjitha përpjekjet të marrë në duar të gjitha kyçet e vendit. Këtu qëndron objektivi kryesor i këtij grupi dhe jo si të zhvillohet, me ç'politikë të zhvillohet, me ç'forma të zhvillohet Kina. Çdo gjë si më parë, edhe tani, atje ecën në mënyrë të çoroditur.

Është e vërtetë se njerëzit e grupit të Ten Hsiao Pinit, që janë pasardhësit e grupit të Çu En Lait, kanë

deklaruar se orientimi politiko-ekonomik i Kinës janë «katër modernizimet». Këto «katër modernizime» janë katër formula që njeriu mendon se kanë njëfarë përmbajtje, por kjo është diçka e mjegullt, që vërtet synon ndërtimin e njëfarë ekonomie dhe forcimin e pushtetit ushtarak etj., por qëllimi i tyre kryesor është që ta bëjnë Kinën një vend kapitalist.

Po çfarë vendi kapitalist, në ç'mënyrë do të ecë Kina në rrugën kapitaliste? Pikërisht këtu qëndron ajo që thashë më parë që vetë kinezët nuk e dinë. Ata nuk e kanë përcaktuar këtë rrugë, ecin në mjegull, duke huazuar sa nga njëri nga tjetri. Por në thelb qëllimi i organizimit dhe vetë organizimi shtetëror i sundimtarëve të tanishëm të Pekinit, mbetet organizimi arkaik i perandorive të vjetra të Kinës, natyrisht me forma të reja. Mbeten po ashtu objektivat e perandorive të vjetra kineze në struktura pak a shumë të reja, të cilat çojnë vetëm në vendosjen e një dinastie të re të veshur me petka gjoja moderne, por me qëllime e politikë të vjetër. Atje ekzistojnë grupe të atilla të fuqishme perandorake, si me thënë, që luftojnë njëri me tjetrin në mënyrë të paparimtë, që përpiqen kush e kush të marrë fuqinë në dorë dhe të imponojë pikëpamjet e tij që nuk janë emanacioni i dëshirave, i qëllimeve dhe i aspiratave të popullit. Përkundrazi, ato janë aspiratat e një grupi që merr fuqinë dhe që kërkon ta ruajë këtë fuqi me forma, me metoda dhe me një politikë të tij, që ka, pra, për qëllim të ruajë pushtetin që ka vendosur. Çështja qëndron pikërisht te marrja dhe te ruajtja e pushtetit. Kjo është kryesorja, pastaj këtë pushtet ta përdorë për qëllimet e «perandorit» dhe të «oborrtarëve» të tij, të cilët nuk kanë më emrin as të perandorit, as të oborrtarëve, por atë të kryetarit të partisë, të kryeministrit, të ministrave e emërtime të tjera moderne.

Kur thellohe në situatën e Kinës, në zhvillimin e

saj, në institucionet dhe në politikën që ka ndjekur ajo pas çlirimit, del në pah se në këtë vend revolucioni demokratiko-borgjez nuk ka ndjekur rrugën e revolucioneve demokratiko-borgjeze që janë zhvilluar në vendet e tjera. Kjo lëvizje ose ky revolucion ka mbetur në strukturën dhe sidomos në shpirtin e në politikën e Perandorisë së Mesit. Me fjalë të tjera, jo vetëm mbeturinat e pushtetit të vjetër perandorak, por edhe idetë e tij as janë zhdukur, as nuk janë zhvilluar në ato forma dhe me atë intensitet që kërkon një revolucion demokratiko-borgjez.

Kam shkruar për Sun Jat Senin, por, po ta analizojmë një çikë më mirë situatën e historisë së Kinës të fundit të shekullit të 19-të dhe të fillimit të shekullit të 20-të, mund të dalim në konkluzionin se ai kishte filluar rrugën drejt një revolucioni demokratiko-borgjez, i cili mbeti në mes të rrugës. E ashtuquajtura Parti Komuniste e Kinës, që u formua, që kur ishte gjallë Sun Jat Seni dhe që u forcua më vonë gjatë gjithë kohës së luftës, nuk e gjeti rrugën e vërtetë të një zhvillimi me etapa e të shkëputjes nga pikëpamjet perandorake të së kaluarës dhe formave të saj në mos tipike, të deformuara. Megjithatë ajo krijoi më vonë një pushtet që mori disa forma shumë më të avancuara, bile mund të themi disa forma të një shteti socialist, që ishin në realitet vetëm forma, sepse brendia e tyre mbeti në botëkuptimet borgjeze të pleksura me pikëpamjet e zotërinjve të tokave, të zotërinjve të luftës dhe të kompradorëve. Një gjë të tillë e quajtën në Kinë revolucion popullor, më vonë bile edhe revolucion proletar, por që, në fakt, nuk ishte i tillë.

Pas çlirimit, natyrisht, në qoftë se Partia Komuniste do ta kishte të qartë programin e saj, minimal dhe maksimal, aktualisht nuk do të ndodhej në këto situata që karakterizova. Në Kinën e luftës nacionalçlirimtare dhe

të periudhës pas çlirimit e më vonë ka ekzistuar një kaos në politikë, në ideologji e në organizim. Ky kaos nuk lejoi që Kina të kanalizohej e të futej në binarë, qoftë edhe të një revolucioni të thellë demokratiko-borgjez.

Po të marrim të studiojmë në hollësi Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Francës, do të shohim se në këtë revolucion kanë ekzistuar parti të ndryshme, që kishin qëllimet e programet e veta dhe që luftuan kundër njëra-tjetrës për të vënë cilado prej tyre në jetë pikëpamjet politike dhe format organizative që kishte përcaktuar ose që do të zhvilloheshin e do të merrnin forma të reja. Në pragun e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës shohim se ekzistonin grupe ose fraksione politike që u quajtën parti të ndryshme, siç ishin ato që donin t'i hiqnin mbretit pushtetin absolut, por që ishin në fakt për ruajtjen e privilegjeve të aristokracisë. Pikërisht ishte ky grup mjaft i fuqishëm që e filloi Revolucionin Demokratiko-Borgjez. Pra ishte vetë aristokracia ajo që e filloi këtë revolucion për të kufizuar të drejtat absolute të monarkut të vendosur që në kohën e Luigjit të 13-të nga Rishëljëja dhe Mazarini dhe atij të 14-të, por njëkohësisht për të ruajtur privilegjet e saj. Dhe, që t'ia arrinte këtij qëllimi, aristokracia franceze e mbështeti thirrjen e asamblesë së përgjithshme që të merreshin vendime të tilla. Por më 4 gusht u fshinë të gjitha privilegjet e aristokracisë dhe të priftërinjve madhorë. Kështu që në gjirin e vetë partizanëve të monarkisë u dukën ndarje të përcaktuara mirë. Krahas aristokratëve kishte grupe të cilat donin që mbreti të mbante ato pozita që kishte më parë, ekzistonin monarkistët që kërkonin një mbretëri konstitucionale, ekzistonin gjithashtu edhe disa grupe të tjera dhe revolucioni pati kështu një zhvillim të mëtejshëm. Pra vetëm në gjirin e ruajalistëve u krijua partia që mbështeste Tuilerinë, ajo që mbështeste

princët në emigracion në Goblencë, ajo që kishte në krye dukën e Bretenilit, të tjerët mbështetnin kundërrevolucionin, grupin e kontit Dantreg. Të gjitha këto grupe kishin qëllime të caktuara, për të ruajtur monarkinë. Ato kishin po ashtu edhe një politikë të jashtme të caktuar, një pjesë e tyre mbështetej në Vjenë, një pjesë tjetër te mbreti i Prusisë, disa te mbreti i Suedisë dhe më në fund një pjesë mbështetej te mbreti i Spanjës. Këto ishin grupet, si me thënë, mbretërore që kishin objektiva të caktuar, siç thashë më lart.

Nga ana tjetër ekzistonin partitë më të avancuara të borgjezisë, të aristokracisë së robës, që i thoshin, por që kishin origjinë borgjeze, dhe të borgjezisë revolucionare. Të tërë këta ishin grupuar në parti, të cilat luajtën një rol të madh në Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Francës dhe zhvilluan një luftë të ashpër klasash, një luftë të madhe intrigash e organizimi, që kishin politika të ndryshme dhe bënin aleanca të ndryshme në mes tyre për të arritur qëllimet që kishin. Në mes këtyre partive ato që kanë luajtur një rol të madh dhe që janë dalluar në këtë revolucion janë Fëjantët, partizanët e monarkisë konstitucionale, La Fajeti, Petioni, duka i Orleanit, janë Zhirondinët, njerëzit e Maresë, të Montanjës, jakobinët me Robespierin e me klubet e tyre, Dantonistët e të tjerë e të tjerë, derisa Revolucioni Demokratiko-Borgjez kaloi në faza të ndryshme dhe arriti në direktoriat dhe në perandorinë e parë të Napoleon Bonapartit e kështu me radhë.

Pra, në qoftë se mund të gjejmë disa nuanca të përafërta të revolucionit demokratiko-borgjez kinez me atë të Francës, ne nuk e shohim qartë evolucionin e këtij «revolucioni». Është e vërtetë se me çlirimin e Kinës u tha se u vendos «demokracia e re», se u vendosën të drejtat e njeriut, u zhdukën pamjet dhe pikëpamjet e Perandorisë së Mesit, u zhdukën mbretërit e luftës, u

zhdukën feudalizmi, kompradorët etj. Të gjitha këto u thanë dhe si forca vepruese nuk paraqiteshin me atë akuitet në skenë, por në brendi ato vepronin dhe krijonin një kaos të madh në politikë, në organizim, në ideologji. E ashtuquajtura Parti Komuniste e Kinës, Komiteti i saj Qendror, me Mao Ce Dunin në krye, nuk arritën, ose nuk deshën që revolucioni demokratiko-borgjez, etapa e parë tranzitore e revolucionit proletar, të zhvillohej në mënyrë konsekuente.

Format organizative të «demokracisë së re» të pasçlirimit në Kinë nuk i përgjigjeshin realitetit objektiv të ndarjes të këtij gati kontinenti me popullsi e zakone të ndryshme, me gjuhë të ndryshme, me një prapambetje të madhe kulturore, ekonomike dhe politike. Gjatë gjithë periudhës pas çlirimit në Kinë nga ana e partisë dhe e udhëheqjes së saj nuk shohim një përpjekje për të ndjekur një politikë të qartë ekonomike, ushtarake dhe administrative. Natyrisht, flitej atje për një zhvillim të ri, për një «demokraci të re», për një organizim të ri, për një përparim kulturor, për një ekonomi të re, por në të gjitha planet mbizotëronin formula dhe parulla, të cilat përvetësoheshin nga masat në ato forma dhe me ato qëllime të traditës së vjetër imperiale.

Populli kinez luftoi po me ato forma dhe gjatë luftës tek ai nuk u kristalizuan si duhet orientimet e mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike. Idetë e reja që udhëhiqnin luftën kundër okupatorëve dhe Çan Kai Shisë nuk e kishin atë qartësi që duhej dhe që kishte krijuar vetë lufta e popullit kundër armikut të jashtëm dhe atij të brendshëm.

Për një kohë të gjatë armiku i brendshëm u konfondua, u zhvilluan edhe aleanca që duhej të zhvilloheshin, po nuk u ruajt personaliteti i partisë dhe, kur flasim për këtë personalitet, nuk kam parasysh personalitetin e udhëheqjes së saj, por personalitetin e ideologjisë së partisë, të parimeve politike, ideologjike dhe organizative të saj. Këto nuk u ruajtën, se nuk ekzistonin të përcaktuara si duhet dhe qartë. Ato nuk ishin përcaktuar, se nuk përcaktoheshin nga vetë udhëheqja e atëhershme, qoftë pse kjo nuk i donte parimet e vërteta të një partie komuniste, se nuk i kishte kuptuar ato parime, ose kishte adoptuar vetëm formën e jashtme të tyre, por në fakt kishte ruajtur të gjitha pikëpamjet e vjetra që zhvilloheshin në gjirin e Perandorisë së Mesit. Në këtë gjendje po të ishin përcaktuar qartë parimet e vërteta që udhëheqin një parti komuniste, natyrisht brenda radhëve të Partisë Komuniste të Kinës do të kishte fraksione, përpjekje bile edhe luftë civile, por në fund të fundit do të triumfonte revolucioni i vërtetë i udhëhequr nga parimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Fraksione pati në Partinë Komuniste të Kinës, por ato nuk u luftuan në bazë të parimeve të shëndosha. Pa qenë parti të ndryshme, brenda në parti fraksionet u përngjitnin si me thënë atyre të kohës së Revolucionit Demokratiko-Borgjez në Francë, ishin të atilla që synonin të merrnin fuqinë dhe të vendosnin pushtetin e klanit që përfaqësonin. Kështu që, nën mbulesën e një demokracie të re, u krijuan klane të forta, që maskoheshin me emrin e komunizmit, të socializmit, të Partisë Komuniste të Kinës, por që në realitet asnjëra nuk u besonte parimeve të vërteta marksiste-leniniste.

Teoria e «lulëzimit të 100 luleve dhe e konkurrimit të 100 shkollave» ishte teoria e Mao Ce Dunit dhe e të gjitha grupeve të tjera rivale të tij që punonin dhe organizoheshin nën rrogoz për të marrë pushtetin. Ajo ishte një realitet i rivaliteteve të maskuara me gjoja liberalizimin e shtetit të ri që po ndërtohej, ose më mirë me thënë të jepte përshtypjen se demokracia e re ishte një demokraci e vërtetë që u jepte liri fjale e mendimi të gjithë njerëzve dhe grupeve e partive pa përjashtim. Të

gjithë mund të shfaqnin atje mendimet e tyre politike, mund të mbillnin farën e tyre kudo dhe kurdoherë, por realiteti nuk qëndronte ashtu. Kjo krijonte idenë e njerëzve gjoja të lirë që kanë të drejtën të shfaqin dhe të mbrojnë çdo pikëpamje, por klanet më të forta e përdornin nga ana tjetër këtë si një mashë për të forcuar pushtetin e tyre. Kur ky pushtet rrezikohej, atëherë kjo formulë binte dhe e zëvendësonin një sërë formulash të tjera, sloganesh politike, që dilnin nga një qendër, nga një kokë dhe kjo ishte koka e Mao Ce Dunit.

Mao Ce Duni ishte një ëndërrues, po njëkohësisht një perandor dhe despot në pikëpamjet e tij. Ai nuk kishte pikëpamje të qarta të një revolucionari demokrat-borgjez, të një «revolucionari» si aristokratët e Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës, pa lëre të një revolucionari proletar. Pikëpamjet e tij ishin të pajisura me idetë e theksuara perandorake, konfuciane, mistike, të shartuara këto me ide të reja të zhvillimit botëror të papërtypura e të papranueshme, të paasimiluara prej tij. Këtej del konkluzioni se nga ky person i gjithëfuqishëm nuk u bënë përpjekje për të gjetur një vijë të përshtatshme politiko-organizativo-ekonomiko-ushtarake për Kinën e re, prandaj Mao Ce Duni e çoi vendin, siç thotë francezi, *«à la derive»*, nga të frynte era, mjaft që ai të ishte në krye dhe që në fakt tërë kohën qëndroi në krye. Të gjithë duhej t'i bindeshin atij në forma gjoja të reja, moderne dhe të zbatonin idetë e tij «gjeniale», po që në realitet nuk çonin në ndërtimin e një Kine më moderne, më të përparuar, më të organizuar, më të kulturuar. Njerëzit që kishte ai rreth e rrotull vetes ishin ose kundërshtarë, ose oborrtarë.

Mao Ce Duni, duke ndjekur qëllimin e tij kryesor që të dominonte me format dhe në mendimet që kishte krijuar në kokën e vet, lejonte oborrtarët t'i thurnin himne e ditirambe të panumërta. Po ashtu ai, deri në njëfarë

kufiri, nuk i pengonte kundërshtarët e tij të vepronin, ndërsa, kur e kapërcenin këtë kufi, atëherë me veprime perandorake ai merrte masa, masa ushtarake, gjyqësore, bënte demaskimin politik dhe ideologjik të kundërshtarëve, më në fund i dënonte ata edhe me pushkatim. E tillë ishte kjo farë demokracie në Kinë, që solli më në fund këtë kaos dhe s'kishte dalje tjetër. Në Kinë luftohej anarkia me anarki dhe kaosi me kaos.

Aktualisht regjimi i Ten Hsiao Pinit nuk është gjë tjetër veçse një kopje e regjimit të Mao Ce Dunit, por më i djathtë ose më mirë të themi një regjim fashist, mbasi pushteti i Mao Ce Dunit, sido që karakterizohej nga të gjitha ato që thashë më lart, prapëseprapë kishte një element demokratik. Kurse regjimi aktual jo.

«Banda e të katërve» që po gjykohet tani është banda e oborrtarëve të Mao Ce Dunit, te të cilët ai u mbështet për një kohë të gjatë për të zhvilluar në popull pikëpamjet e tij. Është Mao Ce Duni ai që urdhëroi rrëzimin dhe shkatërrimin e grupit të Liu Shao Çisë e të Ten Hsiao Pinit me shokë dhe këtë e bëri në kohën kur e pa se rrezikohej pushteti i tij, kur pa se hrushovianët nuk e mbështetën në aspiratat e tij hegjemoniste për të dominuar në botën komuniste dhe në botë në përgjithësi; Mao Ce Duni është ai që ngriti hunveibinët në Revolucionin Kulturor dhe në krye të këtij revolucioni, është e kuptueshme, u vunë njerëz besnikë të tij, elementë të rinj, se Maoja nuk mund të mbështetej më në brezin e vjetër, që ishte i hallakatur në mendime, në politikë dhe i hutuar nga një propagandë e çoroditur. Prandaj ai u mbështet, sikundër bëri, në rininë, e cila ishte pompuar me kultin e «timonierit të madh».

Në fakt, «banda e të katërve» përbëhej nga ata oborrtarë të «perandorit» që zbatuan direktivat e tij. Oborrtar i Maos ishte edhe Lin Biaoja, ishin edhe shefat e ushtrisë kineze, të cilët është fakt se morën pjesë aktive në

Revolucionin Kulturor dhe mbështetën orientimet e Maos, sipas të cilit duhej «të shkatërroheshin shtabet», që do të thotë grupi i kryesuar nga Liu-Teni. Në këtë mes Çu En Lai, person i grupit të Tenit, kryeministri «i mirë», pikërisht si Konfuci i «perandorit», diti të manovronte dhe manovroi në dukje duke e mbështetur Revolucionin Kulturor, por duke punuar me synimin që, pasi të kalonte vala e tij, të rimerrte pozitat e vërteta të një udhëheqësi dhe të nxirrte mbi ujë klanin e tij.

Kështu gjyqi i sotëm që po zhvillohet në mënyrë kaq qesharake, sikur të mos kishte ekzistuar asnjë lidhje në mes Maos dhe «bandës së të katërve», në mes kësaj bande dhe Hua Kuo Fenit, vërteton atë që kam thënë më lart, luftën për pushtet. Në fakt, «banda e të katërve» akuzohet se ka komplotuar në mënyrë të thjeshtë. Asnjë konsideratë politike, ekonomike, ideologjike nuk figuron në akuzat që i bëhen kësaj bande, ajo akuzohet në mënyrë të thjeshtë se ata që bënin pjesë në të, kanë vajtur te Mao Ce Duni dhe i kanë kallzuar se «Çu En Lai, Ten Hsiao Pini, Jeh Çien Jia dhe Li Hsien Nieni mblidheshin çdo natë në spital për të organizuar marrjen e pushtetit». Grupi i Tenit vetëm këtë përpiqet të vërë në dukje pa asnjë konsideratë politike, duke përjashtuar nga ky «komplot» Mao Ce Dunin dhe Hua Kuo Fenin. Duhet të jesh naiv që të mos mendosh se Çu En Lai në spitalin ku dergjej nuk komplotonte (të përdor edhe unë termin e tyre — komplot) me Ten Hsiao Pinin, Jeh Çien Jinë dhe Li Hsien Nienin për të marrë pushtetin pas vdekjes sidomos të Çu En Lait, vdekje që ishte e sigurt, që edhe ai vetë e dinte se do të mbaronte nga kanceri. Pra grupi i Tenit dhe i Çusë komplotonte nga njëra anë, kurse «banda e të katërve» nga ana tjetër. Ai grup që fitoi çoi përpara gjyqit grupin tjetër.

Por nga vetë gjyqi del se «banda e të katërve» nuk ka bërë përveçse «veprime logjike». Brenda formave «banda»

e kishte për detyrë t'i drejtohej Mao Ce Dunit atje ku ndodhej për pushime dhe t'i shfaqte mendimin e vet se ç'po ngjiste në spitalin e Pekinit. Kjo është e vetmja akuzë «e rëndë» që ngrihet kundër «bandës së të katërve». Të tjerat, siç janë vrasja e qindra mijëra njerëzve, janë sfumatura, që nuk e thonë haptazi, por që me to autorët e akuzave duan të thonë se Revolucioni i Madh Kulturor, i udhëhequr nga Mao Ce Duni, shkaktoi viktima. Por, për të mos e thënë këtë, për të forcuar dozën e këtij farë komploti të të katërve, i shtojnë edhe këto krime, të cilat nuk i vënë në evidencë të madhe, po vënë në dukje vetëm atë që këta kanë komplotuar kundër Çu En Lait dhe Ten Hsiao Pinit, pra, që nuk kanë lejuar të vinte në krye një klan i ri, të ngrihej një perandori e re, por të mbetej në fuqi perandoria e Mao Ce Dunit dhe e oborrtarëve të tij. Kjo u përngjet si dy pika uji klaneve ose partive të aristokracisë, të ruajalistëve, të monarkistëve gjatë Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Francës. Në Kinë ishte lufta e klaneve të mandarinëve.

Pas vdekjes së Çu En Lait, Ten Hsiao Pini dhe grupi i tij ishte i sigurt se do t'ia zinte atij vendin, por kjo nuk ngjau. Pse nuk ngjau? Se nuk kishte dashur Mao Ce Duni që Teni të zinte vendin e Çusë, domethënë të bëhej kryeministër e kryetar partie. Kjo lë të kuptohet që komploti i Çusë dhe i Tenit, tok me Jeh Çien Jinë nuk pati sukses dhe arsyet e këtij mossuksesi duhen kërkuar te Maoja dhe te pikëpamjet e tij që kanë qenë kurdoherë konfuze, që vendoste ata që donte dhe në atë që Maoja nuk dëshironte të kishte në krah të tij një element ambicioz që e kishte provuar me kohë në qëllimet dhe në veprimet e tij, gjatë gjithë kohës kur Teni ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Liu Shao Çisë.

Sigurisht Mao Ce Duni ka marrë po ashtu mendimet e pjesës më të madhe të Byrosë Politike, në qoftë se mund të themi se ka ekzistuar tek ai një fije ideje për

konsultime dhe nëse ekzistonte në parti një Byro Politike në format dhe në idenë që i kuptojmë ne, marksistë-leninistët, që nuk e dëshironte ardhjen e Tenit në postin e kryeministrit. Është pra Mao Ce Duni ai që nuk e lejoi Tenin të zinte vendin e Çu En Lait, por emëroi, e theksoj, emëroi Hua Kuo Fenin në këtë post dhe i tha këtij se «tani që je ti në krye të partisë dhe të pushtetit, jam i qetë». Kjo ka qenë në praktikën dhe në mënyrën e drejtimit të Mao Ce Dunit që nuk pyeste kërkënd si për gjërat e vogla, ashtu edhe për gjërat e mëdha. Pra «komplotin», në qoftë se kishte komplot, e organizoi Maoja, dhe ai duhet gjykuar në radhë të parë. Po të bëhet kështu, atëherë, duhen vënë në dukje mendimet e Maos dhe të Tenit. Por këtë s'e do oportuniteti politik aktual në Kinë.

Pra faktet historike tregojnë se kryesori i komplotit, në qoftë se ekziston një komplot, nuk janë as «banda e të katërve», as banda e Lin Biaos, por është vetë Mao Ce Duni, i cili vepronte sipas mendjes, dëshirës dhe aspiratave të tij. Është ai që e hodhi matanë Ten Hsiao Pinin dhe vuri në krye Hua Kuo Fenin. Ky pati mbështetjen e Mao Ce Dunit dhe të «bandës së të katërve».

Ten Hsiao Pini, natyrisht, pati deziluzione të mëdha dhe me grupin e tij organizoi rezistencën nën hundën e Maos, të Hua Kuo Fenit e të «bandës së të katërve», i nxori njerëzit në Tien An Men dhe, siç dihet, kundër tij u morën masa.

Pas vdekjes së Maos, Ten Hsiao Pini u lidh me aleancë me Hua Kuo Fenin dhe së toku përgatitën një komplot që rezultoi në arrestimin e menjëhershëm të «bandës së të katërve» dhe të zhvillimit të situatave të mëvonshme në Kinë. Vetë gjyqi që po zhvillohet aktualisht kundër «bandës së të katërve» vërteton katërcipërisht këto mendime që Teni me Çunë kanë komplotuar për të marrë pushtetin pas vdekjes së Çusë, për ta ruajtur këtë pushtet po kështu edhe pas vdekjes së Maos. Ai vërteton gjithashtu se ata kërkonin të merrnin masa që të likuidonin kundërshtarët e tyre, domethënë pasuesit e Maos dhe vetë këtë «si ideolog, mendimtar dhe udhëheqës» dhe të ngrinin në pushtet klanin e Ten Hsiao Pinit, domethënë gjithë borgjezinë e madhe kompradore, latifondistët, industrialistët fashistë. Më vonë me siguri do të bëhet edhe gjyqi i Hua Kuo Fenit ose i Ten Hsiao Pinit. Kjo varet nga ajo se cili klan do të fitojë.

Të çudit mendimi kaq përbuzës i kësaj klike të re fashiste perandorake kur në gjyqin politik, siç është ky që po bën, nuk nxjerr në dukje pikëpamjet politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake të grupit të rrëzuar, me të cilat të vërtetojë se ky grup, që po gjykohet tani, ka pasur një politikë të tillë që bie në kundërshtim me politikën «e vërtetë» të udhëheqjes aktuale të Kinës. Pra, të ekspozohet njëkohësisht edhe politika aktuale e Kinës që populli të shohë mirë se cila ka qenë politika e Mao Ce Dunit, e «bandës së të katërve» dhe cila është politika e bandës së Ten Hsiao Pinit dhe e Hua Kuo Fenit. Kjo gjë nuk bëhet. Po pse nuk bëhet? Për arsye se dalin në shesh gjithë kalbëzimi politiko-ideologjiko-ekonomik dhe aspiratat për hegjemoni botërore të Perandorisë së re të Mesit, me perandor Mao Ce Dunin, me perandor Liu Shao Çinë, Ten Hsiao Pinin, Lin Biaon, Çu En Lain e gjithë të tjerët me radhë. Domethënë kush e ka fuqinë, kush e pati fuqinë, ose kush do ta marrë fuqinë në të ardhmen.

Kjo nuk duhet të dalë dhe nuk e nxjerrin, prandaj ky gjyq, në vend që të demaskojë «katërshen», demaskon vetë grupin e Tenit. Por ky grup është i atillë që s'ka asnjë konsideratë, as më të voglin respekt për popullin kinez dhe për opinionin publik botëror. Ai mendon vetëm të bëjë punën e tij, të vendosë pushtetin e tij, ta forcojë këtë pushtet, të likuidojë kundërshtarët

e vet politikë dhe ta çojë Kinën në rrugën e hegjemonizmit botëror, të një kapitalizmi special, të cilit, mendoj, nuk i duket akoma ai evolucion që do të marrë me kohë.

Politika e jashtme e Kinës nuk mund të bëjë përjashtime nga anarkia dhe çoroditja, nga konfuzioni në të cilin ka qenë edhe në kohën e Mao Ce Dunit, dhe në kohën e Perandorisë së Mesit. Duket sikur grupi i Tenit është proamerikan dhe në fakt ai e kërkon mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bile me pikëpamjet e një fashisti si Hitleri, ai ka pretendime të tilla që Uashingtoni ta ndihmojë Kinën deri atje sa mund të vijë koha që të bëhet e rrezikshme për vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në politikën reaksionare dhe proamerikane të Ten Hsiao Pinit vepron dinakëria kineze. Këtë dinakëri e pabesi borgjeze, ai e mbështjell në fjalën e dhënë dhe në aleanca.

Kina në politikën e saj të jashtme, nuk ka parime, nuk ka suplesën e një vendi kapitalist bile as të një vendi kapitalist të pazhvilluar, por ka aspirata të mëdha për hegjemonizëm. Te Kina aktuale kapitaliste nuk shikon drejtime, pak a shumë stabël, në gjetjen dhe në vendosjen e aleancave me shtetet imperialiste dhe kapitaliste. Ajo është kudo, pa qenë gjëkundi, kërkon të dominojë gjithë këtë botë me pesë para në xhep, kërkon ndihma nga të tjerët, por edhe të tjerët dëshirojnë ta kenë atë ashtu siç e kishin në kohën e perandorëve të Mesit, me fjalë të tjera, një koloni që ta zhveshin dhe politika e saj të drejtohet prej tyre. Prandaj këtu ka një rivalitet të madh midis shteteve imperialiste të organizuara e të fuqishme politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht me një shtet tjetër borgjez kapitalist të prapambetur, të paformuar, me një ekonomi të dobët, me një ushtri të dobët, siç është Kina, por që ka aspirata «kolosale» për hegjemonizëm botëror.

Ne shohim tani që shtetet imperialiste dhe bota kapitaliste, në përgjithësi, nuk janë aq entuziaste për regjimin aktual të drejtuar nga grupi i Ten Hsiao Pinit, se nuk shohin që të realizohen ato ëndrra ekstravagante të muajve të parë ose të vitit të parë të ardhjes së tij në fuqi. Përkundrazi, shohim një indiferentizëm relativ, një mosbesim të kujdesshëm nga ana e fuqive imperialiste ndaj Kinës, se edhe sloganet e lëshuara nga Ten Hsiao Pini ishin monstruoze. Politikës borgjezo-kapitaliste dhe imperialiste nuk i leverdiste të afishohej me një partner të tillë, të çakërdisur në politikë dhe të varfër në ekonomi e ushtri, të etshëm për të marrë dhe për të mos u dhënë gjë atyre. Kjo nuk lejohet në ligjet e kapitalizmit. Por megalomania kineze, anarkia dhe kaosi në mendjen e udhëheqësve kinezë, që është si një fill i bardhë që i përshkon, nuk i lejon ata të stabilizojnë një gjendje, si me thënë, të përshtatshme për ta dhe kjo me siguri do ta futë Kinën në aventura të reja, të jashtme dhe të brendshme.

Aventurat e brendshme nuk kanë mbaruar dhe nuk mund të mbarojnë në Kinë: Ose edhe grupi i Hua Kuo Fenit do të dalë në gjyq dhe do të akuzohet për rrëzimin e Tenit, për bashkëpunim me «bandën e të katërve», ose do të mëkëmbet dhe do t'i bëjë varrin klanit të Tenit. Pra do të kalojë një kohë mjaft e gjatë, them mjaft e gjatë, në rast se gjithë këto pësime nuk bëhen mësime, për arsye se grupet e fuqishme që ekzistojnë në Kinë dhe që mbulohen me demagogji dhe me formula, do të luftojnë njëri-tjetrin në kaos.

Hua Kuo Fenit dhe Mao Ce Dunit, siç po duket, do t'u bëhet gjyqi në njëfarë mbledhjeje të kongresit të Partisë Komuniste të Kinës, gjoja në forumin e lartë të partisë, i përbërë krejtësisht nga elementët fashisto-borgjezë të grupit të Tenit, ku do të demaskohen Mao Ce Duni njëkohësisht edhe Hua Kuo Feni. Mao Ce

Dunit do t'i mbetet vetëm emri, do t'i mbetet vetëm ndonjë formulim sa për të gënjyer masat e popullit, kurse Hua Kuo Feni do të gjejë vendin e tij. E gjithë kjo do të ngjasë, mendoj unë, në rast se gjatë kësaj kohe nuk do të ndodhë diçka tjetër që t'i vërë dru në rrota Ten Hsiao Pinit. Por, në këto situata dhe në këtë gjendje në të cilën ndodhet populli kinez, kjo, hëpërhë, do të jetë e zorshme. Kjo jo se populli kinez nuk i kupton këto manovrime të poshtra që po bëhen në kurrizin e tij, por a do të jetë në gjendje të organizojë një rezistencë të vërtetë me një ideologji të vërtetë revolucionare për të luftuar anarkinë, kaosin në politikë, në ideologji dhe në organizim? Do të jetë ai në gjendje të vërë në krye çështjet politike, çështjet ideologjike të frymëzuara nga marksizëm-leninizmi dhe kjo të mbështetet nga klasa punëtore dhe nga levat e një partie të vërtetë marksiste-leniniste në mes të të cilave edhe ushtria?

Në qoftë se populli, proletariati, komunistët e vërtetë kinezë arrijnë të bëjnë që të ndryshojë bofëkuptimi aktual i klaneve, i «zotërve të luftës», në ushtri, atëherë do të ketë sukses një revolucion i vërtetë demokratiko-borgjez e më vonë edhe proletar. Vetëm me një parti komuniste marksiste-leniniste të vërtetë në krye, mund të organizohet dhe të fitojë revolucioni proletar në Kinë.

NGJARJET NË POLONI DHE PASOJAT E TYRE TË BRENDSHME E TË JASHTME

Gjendja në Poloni po vështirësohet dita me ditë. Organizatat sindikale reaksionare janë bërë një element me rëndësi ekonomiko-politik dhe vazhdimisht ato po fitojnë terren mbi pushtetin pseudosocialist polak. Pushteti aktual në Poloni vetëm emrin ka si pushtet i një vendi socialist ose si diktaturë e proletariatit. Në të vërtetë ai është një pushtet borgjez, kapitalist në esencë, pavarësisht nga format dhe emërtimet që përdor.

Partia polake, e cila e quan veten komuniste, është një parti borgjeze, me strukturë të atillë që mbështet tekat e një klike të tërë burokratësh të rinj kapitalistë që bashkëpunojnë me kapitalistët e vjetër, veçanërisht me ata të fshatit, si edhe me kishën e fuqishme katolike të Polonisë.

Kisha katolike polake, «bija e madhe e Vatikanit», ka ruajtur dhe ka shumëfishuar aq shumë forcën e saj «bindëse» dhe pushtetin shpirtëror, saqë ka influencuar vazhdimisht, këto kohët e fundit akoma më shumë në pushtetin laik. Kisha katolike romane e Polonisë ka pasur vazhdimisht mbështetjen e autoriteteve pseudokomuniste polake. Ajo i ka pasë të hapura rregullisht jo vetëm famullitë, katedralet e kishat, por ka fituar gjithashtu, të drejtën të zhvillojë katekizmin në shkolla dhe predikimin në ushtri. Tani kisha katolike polake është frymë-

zuesja kryesore e «sindikatave të lira-Solidarnost», të cilat po veprojnë haptazi për të transformuar pushtetin kapitalisto-revizionist që ekziston në Poloni dhe për të ndërtuar një pushtet kapitalist pa asnjë maskë.

Situata që është krijuar i ka nxjerrë telashe borgjezisë së re polake për arsye se po lëkunden pozitat e saj të fituara nën maskën e një shteti socialist. Po vihen në pikëpyetje privilegjet e stabilizuara gjatë disa dekadave, të cilat do të ndahen me njerëz të tjerë më të vendosur, më të organizuar e më të lidhur me reaksionin e jashtëm kapitalist. Me fjalë të tjera një borgjezi tjetër e re kërkon një *modus vivendi* të ri, në një formë më të theksuar kapitaliste, për të ndjekur një politikë të brendshme dhe të jashtme të lirë nga çdo varësi e revizionistëve sovjetikë dhe e së ashtuquajturës bashkësi socialiste.

E keqja më e madhe, në situatën e krijuar, bie mbi popullin polak, i cili, si një popull trim, nuk mundi të gjente dot rrugën e vërtetë të ndërtimit socialist dhe të vendoste diktaturën e proletariatit. Klasa punëtore në Poloni nuk u udhëhoq nga teoria marksiste-leniniste e nuk u edukua me këtë teori. Ajo nuk zhvilloi një veprimtari revolucionare këmbëngulëse si gjatë luftës, ashtu edhe pas çlirimit për të vendosur norma të vërteta demokratike në jetën e vendit. Këtë ajo nuk mund ta bënte duke pasur në udhëheqje të ashtuquajturën Parti Komuniste të Polonisë, që nuk ishte veçse shartimi i një sëre partish borgjeze demokratike me një parti komuniste, për të cilën ishte marrë vendim të likuidohej që në kohën e Kominternit, për arsye të devijimeve të theksuara nga marksizmi. Pra, proletariati polak nuk mundi të zhdukte mbeturinat e thella idealiste, fetare e mistike në popull. Jeta politike e Polonisë, edhe pas çlirimit vazhdoi me ndjenja të theksuara të një nacionalizmi të shfrenuar.

Internacionalizmi proletar në Poloni nuk kishte vend.

Borgjezia vendase e kisha katolike ushqenin atje seriozisht dhe sistematikisht ndjenjat antisovjetike. Kështu që aktualisht, pas grevave të Dancigut dhe pas «fitoreve» të njëpasnjëshme të arritura nga «sindikatat e lira — Solidarnosti», brenda në Poloni është krijuar një situatë shumë e vështirë dhe jo vetëm për autoritetet e vendit por edhe për Bashkimin Sovjetik dhe për vendet e tjera «të bashkësisë socialiste».

Siç kam thënë edhe në një shkrim tjetër, situata e krijuar tani në Poloni është vepër e menduar mirë nga reaksioni dhe nga feja. Për t'ia arritur kësaj situate, që transformimet kapitaliste të bëheshin nën drejtimin e elementëve reaksionarë në gjirin e klasës punëtore, është punuar me kohë në rrugën antisocialiste. Veprimtaria antisocialiste në Poloni është e vjetër. Ajo është ushqyer nga brenda e nga jashtë dhe është ndihmuar nga vetë udhëheqja revizioniste e partisë polake si dhe nga transformimet regresive, kapitaliste e fashiste, të ndodhura në Bashkimin Sovjetik pas marrjes së fuqisë nga hrushovianët, po ashtu edhe nga gjithë politika hegjemoniste e Bashkimit Sovjetik mbi të ashtuquajturën bashkësi socialiste. Të tëra këto rrethana kanë ndikuar për të krijuar këtë situatë në Poloni.

Natyrisht për krijimin e kësaj situate kanë ndihmuar fuqimisht edhe borgjezia kapitaliste e Evropës dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet financimit me kredi të Polonisë, ashtu si edhe të vendeve të tjera «të bashkësisë socialiste». Tash këto vende, me Bashkimin Sovjetik në krye, janë pleksur me shoqëri shumëkombëshe dhe nëpërmjet kredive kolosale që arrijnë deri në 80 miliardë dollarë, janë varur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet e zhvilluara kapitaliste evropiane.

Bashkimi Sovjetik kudo në vendet e ashtuquajtura socialiste të Lindjes ka shkaktuar një frymë mbytëse.

Këtë e ka bërë me Traktatin e Varshavës, me repartet ushtarake që ka vendosur në të gjitha vendet e ashtuquajtura aleate të tij, me përdorimin e KNER-it në format që ka dashur vetë, për të lehtësuar shfrytëzimin ekonomik të «aleatëve», të cilëve u ka caktuar drejtimet e zhvillimit të njëanshëm të ekonomisë së tyre, nëpërmjet «ndarjes së punës» në industri, në bujqësi etj., si dhe me pikëpamjet politike të veçanta të diktuara nga Moska për qëndrime të caktuara në favorin e hegjemonizmit sovjetik.

Pavarësisht nga pamja e jashtme dhe nga qëndrimet e udhëheqësve të këtyre vendeve, asnjë popull, asnjë parti bile asnjë udhëheqje, në këto vende nuk e do Bashkimin Sovjetik revizionist, shtypës dhe skllavërues. Të gjithë manovrojnë, veprojnë dhe kërkojnë të gjejnë vrima nga të cilat të mund të shpëtojnë. Sa mund të shpëtojnë nga kjo zgjedhë, është çështje tjetër. Polonia e gjeti një rrugë, të ndryshme nga ato që ndoqën Dubçeku, Nagi ose Kadari. Në kundërrevolucionin hungarez, reaksioni i jashtëm e hoqi maskën. Dubçeku mendoi se e gënjeu Moskën dhe filloi të bënte «reforma» gjoja në favor të socializmit, por, kur u mbush kupa, Moska futi tanket në Çekosllovaki. Rruga e ndjekur nga Polonia, pra, ndryshon si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja. Këtu është klasa punëtore e manipuluar që ka dalë në skenë «për të kërkuar liri e pavarësi» nga Partia Komuniste e Polonisë.

Ç'mund të ngjasë në këtë situatë? Natyrisht kjo situatë që po zhvillohet në Poloni, Bashkimit Sovjetik nuk i pëlqen, ndërsa të tjerëve, «aleatëve» të tij, në dukje as atyre nuk u pëlqen, por në thelb mund t'u leverdisë për të lehtësuar barrën e sovjetikëve mbi ta. Veçse Bashkimi Sovjetik, në fakt, humbet perandorinë, kurse udhëheqjet revizioniste në vendet e «bashkësisë socialiste», humbasin privilegjet e fituara, ashtu siç i humbi Gierekun. Në rast se infeksioni nga ngjarjet në Poloni do të jetë më i madh, ka mundësi të shkaktojë turbullira të gjera dhe të pallogaritshme për klikat revizioniste në fuqi, në radhë të parë për sundimin e Bashkimit Sovjetik. Prandaj ky do të përpiqet të kufizojë ngjarjet në Poloni dhe, duke u përpjekur ta realizojë këtë gjë, do të luftojë për ta hedhur në erë situatën negative që është krijuar atje për të, duke përdorur agjenturën e vet. Sa do të arrijë agjentura sovjetike t'i vërë shkopinj në rrota kësaj karroce, që po ecën revan drejt kapitalizmit, kjo varet nga shtrirja e lëvizjes së të ashtuquajturave sindikata të lira, nga forca e tyre organizative dhe nga ndjenjat që do të ngjallë veprimtaria e tyre te populli polak.

Por mund të thuhet se udhëheqja revizioniste polake, sado prosovjetike që të hiqet, në vetvete është antisovjetike, antiruse dhe masat që mund të marrë imediatisht, ose për një kohë relativisht më të gjatë, nuk do të kenë efektin që shpreson Moska. Kjo e fundit, nga ana e saj, në të njëjtën kohë, në kuadrin e Traktatit të Varshavës e të KNER-it do të përpiqet të bëjë presion mbi Poloninë nëpërmjet satelitëve të vet. Në fakt këtë punë ajo e ka filluar nëpërmjet Gjermanisë Lindore e Çekosllovakisë, kurse Hungaria flet pak, Bullgaria gjithashtu flet ca më pak, ndërsa Rumania nuk flet fare.

Pra, për të shuar atë që po ngjet në Poloni, në pararojë janë aktualisht Gjermania Lindore dhe Çekosllovakia. Në këtë çështje Moska vazhdon taktikën e vjetër duke ngarkuar udhëheqësit e këtyre dy vendeve të shkruajnë sidomos artikuj kërcënues kundër elementëve reaksionarë në Poloni dhe i riboton këta në faqen e parë të «Pravdës». Por Kremlini, natyrisht, nuk mbetet vetëm me ribotimin e artikujve të të tjerëve. Ai po merr edhe masa, akoma të padukshme, nën rrogoz, por të egra kundër kësaj situate që po bëhet e rrezikshme për të.

Megjithëkëtë tani për tani në Poloni nuk shohim të

bëhet ndonjë ndryshim në favor të Moskës. Përkundrazi, udhëheqja polake u ka dhënë të drejtë sindikatave «Solidarnosti», të veprojnë, bile të hedhin hapa përpara në rivendikime politike, të kërkojnë të spastrojnë partinë nga elementët «antisocialistë», «spekulatorë» etj. Udhëheqja aktuale e partisë dhe e shtetit polak u mban avazin këtyre rivendikimeve të «Solidarnostit». Nën presionin e këtyre rivendikimeve për së shpejti ajo do të bëjë edhe një mbledhje të Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, ku do të merren vendime gjoja për të forcuar situatën e krijuar. Këto vendime nuk duket të jenë në disfavorin e situatës së krijuar. Pra, gjendja në Poloni nuk po ecën në favorin e Bashkimit Sovjetik.

Në rast se Bashkimi Sovjetik i shkreh të gjithë këta fishekë dhe prapë nuk ia arrin qëllimit që ka caktuar, atëherë i mbetet një rrugë tjetër, ajo e ndërhyrjes ushtarake, siç bëri në Hungari, në Çekosllovaki dhe vitin e kaluar në Afganistan.

Ndërhyrja me armë në Poloni nga Bashkimi Sovjetik, e bashkërenduar kjo me Çekosllovakinë dhe me Gjermaninë Lindore, do të shkaktojë për të gjithë kampin revizionist, me Bashkimin Sovjetik në krye, një turbullirë të jashtëzakonshme, një situatë shumë të ngarkuar me ngjarje të rënda për të. Po ngjau kjo, Bashkimi Sovjetik revizionist dhe vendet e tjera aleate të tij do të pësojnë humbje të mëdha politike, ekonomike dhe ushtarake, për arsye se populli dhe ushtria polake, mendojmë ne, nuk do të pranojnë një ndërhyrje të huaj, qoftë edhe me emrin e Traktatit të Varshavës, pa iu përgjigjur asaj me armë.

Karakteri i vetë proletariatit, i popullit dhe i ushtrisë polake, nuk është si ai i atyre të Çekosllovakisë, ku tanket sovjetike ndërhynë pa hasur në rezistencë. Në këtë rast, në mes Polonisë nga njëra anë dhe Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera të Traktatit të Varshavës nga ana tjetër, do të ketë luftë, e cila nuk mund të ndalet lehtë, shpejt dhe pa pasoja të rënda, jo vetëm për Poloninë, jo vetëm për vendet e tjera ish-socialiste, por dhe për vetë Bashkimin Sovjetik revizionist. Brenda në Bashkimin Sovjetik do të lindin probleme e situata që mendoj se do të jenë revolucionare. Popullit sovjetik do t'i hapen disi sytë. Ai do të shohë më mirë se udhëheqja aktuale e vendit është një udhëheqje kapitaliste, revizioniste, imperialiste dhe «aleancat» që predikon ajo me shtete dhe popuj të tjerë miq, nuk janë veçse hallka shtypjeje, skllavëruese dhe mjete dominimi nga ana e saj.

Nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik do të ketë një humbje të re të jashtëzakonshme politike në arenën ndërkombëtare. Kjo jo vetëm se aktualisht ai është demaskuar si një shtet agresiv imperialist, ashtu siç është, por duke ndërhyrë në Poloni, pra edhe në kurriz të «aleatëve» të tij, provon se mund të ngjasë ca më keq kundër popujve të tjerë.

Mendoj se hëpërhë ndërhyrja me armë e Bashkimit Sovjetik në Poloni nuk do të bëhet shkak për një luftë të re botërore, por kjo ndërhyrje do t'i acarojë situatat në një shkallë të tillë që do të sjellë me të vërtetë gjendjen në prag të një lufte të re botërore.

NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta konsiderojnë patjetër ndërhyrjen e Bashkimit Sovjetik, ashtu siç është, një ndërhyrje agresive, që paralajmëron një sulm edhe kundër vendeve të tjera kapitaliste, duke kaluar mbi trupin e të gjithë disidentëve të hapët ose të fshehtë në vendet e të ashtuquajturave demokraci popullore, që aktualisht ndodhen nën thundrën sovjetike dhe konsiderohen si një *glacis* në luftën e ardhshme në mes dy blloqeve, të NATO-s dhe Traktatit të Varshavës.

Por, edhe nëse ndërhyrja e armatosur sovjetike në Poloni mund të mos shërbejë si një shkëndijë për luftën

e madhe botërore, vendet e Evropës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të mbajnë anën e Polonisë. Kështu Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të ish-demokracisë popullore nuk do të kenë më atë ndihmë ekonomike, ato kredi të shumta prej miliarda dollarësh si ato që kanë marrë deri tani nga Perëndimi. Kjo do të bëjë që këto vende të hasin në vështirësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e ekonomisë së vet, të tregtisë së jashtme. Do të krijohet në to një konfuzion ekonomik dhe një amulli e tmerrshme që do të frenojë zhvillimin e tyre, gjë që do të dobësojë gjendjen ekonomike të popujve të këtyre shteteve, do të shtojë zemërimin e tyre dhe do të kërcënojë udhëheqjet aktuale.

Kjo është diçka konkrete, që nuk do të kufizohet vetëm në fushën propagandistike, por do të shfaqet konkretisht në jetën e këtyre shteteve të Evropës dhe në botë.

Pra çështja e Polonisë në këto situata nuk do të mbetet një episod si në rastin e Çekosllovakisë, pavarësisht se edhe ai ishte i rrezikshëm dhe për të u bë shumë zhurmë. Por me kohë plaga çekosllovake u cikatrizua. Pas pushtimit të Çekosllovakisë, kanë kaluar shumë vjet, megjithëkëtë Perëndimi përsëri i vazhdoi ndihmat dhe infiltrimin e tij ekonomiko-politik për degjenerimin e vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës dhe një nga fitoret e këtij infiltrimi është pikërisht Polonia. Prandaj ndërhyrja në Poloni do të shkaktojë një reaksion të madh nga ana e perëndimorëve dhe një dëm të madh për Bashkimin Sovjetik revizionist e për vendet e tjera revizioniste të Evropës Lindore.

Pra, marrja e një vendimi të tillë nga Bashkimi Sovjetik, kur ai ta shikojë se kupa u mbush dhe do të jetë përpara rrezikut që të humbasë dominimin e vet jo vetëm në Poloni, por rrjedhimisht edhe në vendet e tjera ish-socialiste ku ngjarjet në Poloni do të kenë reperkusione, do të jetë katastrofike për të. Prandaj mendoj

se revizionistët sovjetikë dhe aleatët e tyre do të maten shumë për ta marrë këtë vendim, se nuk është i lehtë. Ai është me konsekuenca të rënda për ta. Fundi i fundit kjo për perëndimorët është e leverdishme se Bashkimi Sovjetik, duke qenë në luftë me popullin afgan, duke u futur në luftë edhe me Poloninë, duke kërcënuar tërthorazi popujt e tjerë aleatë të tij, do të dobësohet, jo vetëm politikisht dhe ekonomikisht, ca më shumë nga sa është sot, por edhe ushtarakisht. Pavarësisht se ushtria sovjetike është e armatosur, duke u futur në luftë edhe me ish-aleatët e tij, me ata aleatë që janë propaganduar në popull si besnikë të Bashkimit Sovjetik, morali i saj do të bjerë shumë. Kjo do të bëjë që edhe mentaliteti i ushtarit sovjetik të ndryshojë, gjë që do të jetë një humbje për kampin revizionist dhe fitore për imperializmin amerikan dhe kapitalizmin e Evropës Perëndimore.

Nga ana tjetër mund të themi se veprime të tilla agresive të sovjetikëve do të kenë po ashtu anën pozitive revolucionare në gjirin e popujve, ku po ndodhin këto ngjarje të tmerrshme invadimi dhe skllavërimi. Ndjenja revolucionare, aktualisht e topitur, do të ngrihet edhe në vetë Bashkimin Sovjetik, ku mund të ndodhin transformime jorrënjësore siç na i do zemra, por sidoqoftë mund të arrihet në disa ndryshime progresive që do të shkaktojë lufta imperialiste, e cila ua ngre lart ndërgjegjen revolucionarëve për ta kundërshtuar këtë luftë të padrejtë. Kjo do të jetë e keqja më e madhe për Bashkimin Sovjetik revizionist.

Në të njëjtën kohë duhet pasur parasysh se ndërhyrja me armë në Poloni nga ana e Moskës nuk mund të realizohet vetëm me Gjermaninë Lindore ose edhe me Çekosllovakinë. Në qoftë se do të ngjasë, kjo do të bëhet nën emrin dhe nën petkun e Traktatit të Varshavës, gjoja

për të «mbrojtur socializmin» në Poloni, i cili rrezikohet nga elementët reaksionarë, të brendshëm dhe të jashtëm.

Mund të mendohet edhe një version tjetër. Revizionistët sovjetikë, po t'i shikojnë punët pisk, mund të bëjnë lëshime, po në ç'drejtim dhe sa? Lëshimet mund të bëhen për shkak të zhvillimit të situatave në disfavorin e tyre, duke u dhënë ngjarjeve në Poloni ngjyrën e një transformimi gjoja të vetëdijshëm të klasës punëtore dhe të Partisë Komuniste Polake. Me fjalë të tjera, të lihet Polonia të zhvillohet politikisht dhe organizativisht në «një formë të re», gjoja socialiste vetadministruese dhe të qëndrojë në Traktatin e Varshavës; regjimi polak i zhvilluar në rrugën e «sindikatave të lira» të marrë formën e një «regjimi socialist» si ai i Jugosllavisë ose që t'i përngjasë atij, brenda kuadrit të Traktatit të Varshavës dhe të KNER-it.

Në rast se një Poloni e tillë do t'i shtyjë marrëdhëniet e saj shtetërore, politike dhe ushtarake, jashtë kuadrit të Traktatit të Varshavës, atëherë Bashkimi Sovjetik do të ndërhyjë me armë. Por, në qoftë se Bashkimi Sovjetik do të pranojë të bëjë lëshime të tilla, atëherë kjo do të sjellë shpërthimin zinxhir të zhvillimeve të reja në të gjithë kampin revizionist të ashtuquajtur bashkësi socialiste. Kjo do të thotë se shembullin polak do ta ndjekin edhe klasa punëtore e Gjermanisë Lindore, ajo e Çekosllovakisë, e Hungarisë po e po, e Rumanisë, më në fund edhe e Bullgarisë. Atëherë do të krijohet një situatë krejt e ndryshme në marrëdhëniet në mes Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij. Në qoftë se ky transformim do të bëhet nga zori, në qoftë se do të bëhen lëshime të tilla për të zgjedhur rrugën më pak të keqe nga rruga më e rrezikshme, siç është ajo e ndërhyrjes së armatosur, ky transformim mund t'i afrohet strukturës organizative, politike dhe ushtarake të NATO-s dhe të Tregut të Përbashkët Evropian.

Pra, vendet e Traktatit të Varshavës, ashtu si vendet e NATO-s, do të ruajnë potencialin e tyre ushtarak brenda lidhjeve të Traktatit të Varshavës për të mbrojtur kufijtë e tyre dhe kufijtë e përbashkët kundër një invadimi nga forcat e NATO-s. Në një situatë të tillë, në qoftë se do të krijohet, atëherë mund të ketë transformime edhe në pozicionet luftarake të ushtrive që aktualisht janë vendosur te njëri-tjetri, dhe sidomos të ushtrisë sovjetike jashtë kufijve të saj kombëtarë. Në rast se gjendja merr një evolucion të tillë, në strategjinë ushtarake të Traktatit të Varshavës dhe në NATO duhet të bëhen ndryshime të tilla dhe të merren vesh në mes tyre që të tërhiqen nga të dy këto blloqe si forcat ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ashtu edhe ato të Bashkimit Sovjetik. Me fjalë të tjera Bashkimi Sovjetik të tërheqë trupat që ka vendosur në vendet e aleatëve të tij, dhe ushtritë amerikane të largohen nga Belgjika, nga Gjermania Perëndimore, nga Italia dhe nga vendet e tjera anëtare të NATO-s.

Kjo, natyrisht, nuk bëhet as në një ditë, as në një vit, se është një çështje mjaft e ndërlikuar politike, në radhë të parë, po edhe nga ana strategjike, nga ana ushtarake, se, me largimin e ushtrive nga çdo vend, flasim të ushtrive të huaja që janë vendosur në vende të ndryshme, duhet të largohen ose të transferohen edhe bazat ushtarake që janë krijuar në këto vende, ose të mbeten në pronësi e nën komandën e shtetit pjesëtar të cilitdo kamp.

Në këtë situatë shtetet do t'i ruajnë aleancat ushtarake nga të dyja anët, do të ruajnë gjithashtu marrëdhëniet ekonomiko-tregtare që kanë vendosur njëri në KNER, tjetri në Tregun e Përbashkët Evropian.

Natyrisht, në qoftë se Bashkimi Sovjetik, në pamundësi të bëjë ndryshe, do të bëjë ndryshime të tilla, atëherë marrëdhëniet aktuale ekonomike duhet medoe-

mos të ndryshojnë në disfavorin e tij dhe të marrin një formë të tillë organizative, ekonomike dhe politike ku do të shikohet më shumë interesi nacional sesa interesi i komunitetit. Kështu ngjet edhe në NATO, ku ka edhe koordinime, po ka edhe kontradikta të mëdha midis shteteve pjesëmarrëse. Një gjë e tillë vetvetiu do të ngjasë edhe në KNER.

Por a do ta lejojë Bashkimi Sovjetik një situatë të tillë? Domethënë ka mundësi të realizohet një shthurje e tillë në dëm të revizionizmit sovjetik? Mua më duket se kjo nuk mund të ngjasë, se Bashkimi Sovjetik nuk do të lejojë që punët të shkojnë në këtë rrugë. Agresiviteti i tij, fryma e tij dominuese dhe imperialiste, nuk mund ta lejojnë të zhvillohet një situatë e tillë. Ai do të preferojë ndërhyrjen ushtarake nën maskën e Traktatit të Varshavës.

Si konkluzion: aktualisht Bashkimi Sovjetik do të luftojë me dorën e polakëve, për të ndaluar shkëputjen dhe do të përdorë çdo presion të mundshëm dhe të imagjinueshëm. Fisheku i fundit do të jetë ndërhyrja me ushtri.

TREGUES TEMATIK I LËNDËS

A

Afganistani
— pushtimi ushtarak nga socialimperialistët sovjetikë. Lufta e popullit afgan kundër tij dhe kundër klikave sunduese të vendit
344-347, 351-353, 389-391
— qëndrimi i popujve dhe i shteteve të ndryshme të botës ndaj agresionit ushtarak sovjetik dhe ndaj luftës çlirimtare të popullit afgan
346-347, 390-391, 480

Afrika
— gjendja e brendshme, lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve afrikanë
14, 156, 170-171, 210, 218--220, 222-224, 310, 373-374
— politika e shteteve imperialiste dhe revizioniste për të siguruar zona influence dhe për të mbajtur të nënshtruar popujt afrikanë
13-14, 21, 123, 153-155, 170, 218-222, 225

Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto - amerikane
9, 456-457, 466-467, 504, 506-507

Aleanca kino-japono-amerikane
121, 152, 267, 448, 467-468

Algjeria, gjendja e brendshme dhe e jashtme e saj
222-223, 225-226

Amerika Latine
— ndërhyrjet e imperializmit amerikan në Amerikën Latine; lufta e popujve të saj kundër diktaturave fashiste
239-240, 312-314
— partitë marksiste-leniniste të Amerikës Latine
141-149

Analiza e thellë dhe e gjithanëshme marksiste-leniniste e situatave ndërkombëtare
80-81, 142-148, 297-300, 484-486, 487-488

Azia — përpjekjet e superfuqive për të vendosur hegje-

mos të ndryshojnë në disfavorin e tij dhe të marrin një formë të tillë organizative, ekonomike dhe politike ku do të shikohet më shumë interesi nacional sesa interesi i komunitetit. Kështu ngjet edhe në NATO, ku ka edhe koordinime, po ka edhe kontradikta të mëdha midis shteteve pjesëmarrëse. Një gjë e tillë vetvetiu do të ngjasë edhe në KNER.

Por a do ta lejojë Bashkimi Sovjetik një situatë të tillë? Domethënë ka mundësi të realizohet një shthurje e tillë në dëm të revizionizmit sovjetik? Mua më duket se kjo nuk mund të ngjasë, se Bashkimi Sovjetik nuk do të lejojë që punët të shkojnë në këtë rrugë. Agresiviteti i tij, fryma e tij dominuese dhe imperialiste, nuk mund ta lejojnë të zhvillohet një situatë e tillë. Ai do të preferojë ndërhyrjen ushtarake nën maskën e Traktatit të Varshavës.

Si konkluzion: aktualisht Bashkimi Sovjetik do të luftojë me dorën e polakëve, për të ndaluar shkëputjen dhe do të përdorë çdo presion të mundshëm dhe të imagjinueshëm. Fisheku i fundit do të jetë ndërhyrja me ushtri.

TREGUES TEMATIK I LËNDËS

A

Afganistani
— pushtimi ushtarak nga socialimperialistët sovjetikë. Lufta e popullit afgan kundër tij dhe kundër klikave sunduese të vendit
344-347, 351-353, 389-391
— qëndrimi i popujve dhe i shteteve të ndryshme të botës ndaj agresionit ushtarak sovjetik dhe ndaj luftës çlirimtare të popullit afgan
346-347, 390-391, 480

Afrika
— gjendja e brendshme, lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve afrikanë
14, 156, 170-171, 210, 218-220, 222-224, 310, 373-374
— politika e shteteve imperialiste dhe revizioniste për të siguruar zona influence dhe për të mbajtur të nënshtruar popujt afrikanë
13-14, 21, 123, 153-155, 170, 218-222, 225

Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto - amerikane
9, 456-457, 466-467, 504, 506-507

Aleanca kino-japono-amerikane
121, 152, 267, 448, 467-468

Algjeria, gjendja e brendshme dhe e jashtme e saj
222-223, 225-226

Amerika Latine
— ndërhyrjet e imperializmit amerikan në Amerikën Latine; lufta e popujve të saj kundër diktaturave fashiste
239-240, 312-314
— partitë marksiste-leniniste të Amerikës Latine
141-149

Analiza e thellë dhe e gjithanëshme marksiste-leniniste e situatave ndërkombëtare
80-81, 142-148, 297-300, 484-486, 487-488

Azia — përpjekjet e superfuqive për të vendosur hegje-

moninë e tyre në këtë kontinent
287-288

B

Ballkani — gjendja e brendshme, marrëdhëniet ndërmjet shteteve ballkanike dhe politika e superfuqive në këtë zonë
193-194, 292-293

Bashkimi Sovjetik, socialimperializmi sovjetik
— gjendja e brendshme; kriza e rëndë ekonomike dhe politike
39-40, 152, 185, 288-289, 312
— depërtimi i kapitaleve të huaja. «Ndihmat», kreditë dhe huatë të shteteve imperialiste për BS
185, 466
— politika agresive dhe hegjemoniste e socialimperializmit sovjetik
125-126, 131, 150, 153, 183-184, 221, 246-247, 255, 288, 289-290, 382-384, 387-388, 464, 466-467, 504, 508-509, 518-519, 547-556

Brezhnjev, Leonid
183, 212, 249, 250, 269, 288, 312, 480 489

Britania e Madhe — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme e saj
216, 295-296, 461, 462-463, 495

E

Egjipti
— politika e jashtme e tij
169-170, 177, 179, 226-227, 283, 391-392
— marrëdhëniet egjiptiano-izraelite, pjesë e komplotit imperialisto-sionist
11, 12, 17-20, 163-165, 226-227

Engels, Frederik
35, 263, 301

Eurokomunizmi, eurokomunistët — tradhtarë të marksizëm-leninizmit
307-308

Evropa, problemi i «sigurimit evropian»
7-9, 78, 371-372, 377

«Evropa e Bashkuar». Kontradiktat në gjirin e saj dhe me SHBA e BS. Parlamenti evropian
238-239, 264-268, 284, 302-305, 308, 460-461, 463-466, 481-483

F

Fashizmi — riaktivizimi dhe përpjekjet e tij për të ardhur në pushtet
41-47, 477

Feja — roli i saj në vendet myslimane
223, 353-354, 361, 363, 374-377

Franca, imperializmi francez
— gjendja e brendshme dhe marrëdhëniet e saj me vendet e tjera. Politika sunduese ndaj ish-kolonive dhe lufta e tyre kundër neokolonialistëve francezë
46, 170, 220-221, 222, 224-225, 318-319, 392, 417, 462, 465, 479-480, 489-490, 492-493, 503-504, 505-506

— revizionistët francezë
295

G

Greqia
— marrëdhëniet e Greqisë me vendet e tjera
117-118, 293
— qëndrimi i saj ndaj RPSSH
394

GJ

Gjendja e sotme ndërkombëtare dhe karakteristikat e saj
217-240, 278-296, 388-396, 446-447, 459-468

Gjermania Perëndimore (RF Gjermane)
— gjendja e brendshme dhe kthimi i saj në një shtet të fuqishëm kapitalist. Marrëdhëniet e saj me vendet revizioniste e kapitaliste; kreditë dhe «ndihmat» për këto vende
44-46, 417, 461-462, 481, 489-490, 492-493, 503-504, 505-506
— detyrimi i saj për t'i paguar dëmshpërblimet e luftës RPSSH
326-331
— Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste)
434-436, 437, 439, 443-444

H

Hua Kuo Fen
9, 10, 21, 38, 116, 118, 119, 122-123, 128, 129, 141, 142, 147, 306, 317, 423, 424, 529, 538; 540, 543-544

I

Imperializmi
— fazë e fundit e kapitalizmit. Kontradiktat, kriza në gjirin e tij
236, 301-302
— strategjia globale, politika e luftës dhe e agresionit
155-156, 455-476

Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni)
435, 436, 438

Irani
— gjendja e brendshme; revolucioni demokratiko - -borgjez në Iran, problemi i thellimit të tij
122, 125-126, 166-169, 229- -231, 364-371, 389, 478- -479
— politika agresive dhe kolonialiste e SHBA ndaj Iranit; agresioni i tyre në Iran dhe dështimi i tij
174-175, 230, 337-338, 389- -390, 391, 454-458
— përpjekjet e superfuqive dhe të imperialistëve të tjerë për ndarjen e zonave të influencës në Iran; lufta e popullit iranian për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë
126, 168-169, 230, 337-343
— domosdoshmëria e një partie të vetme marksiste-leniniste si udhëheqëse e klasës punëtore, e popullit dhe e revolucionit iranian
364-365, 369-371

Italia, imperializmi italian
— gjendja e brendshme; kriza ekonomike dhe politike; riaktivizimi i fashizmit dhe rreziku i arritjes së tij në fuqi
28-30, 43-44, 291, 395
— politika e jashtme, varësia e Italisë nga imperializmi amerikan
462, 491-492
— Partia Komuniste Italiane, degjenerimi i saj në parti revizioniste
29
— Partia Marksiste - Leniniste e Italisë; kritikë ndaj gabimeve dhe të metave të saj
441-442
— qëndrimi i saj ndaj RPSSH
395

Izraeli
— politika agresive ndaj vendeve arabe dhe përkrahja e tij nga imperializmi amerikan
11, 135-136, 172-173, 227
— marrëdhëniet e tij me vendet e tjera
18

J

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav
— gjendja e brendshme, kriza ekonomike dhe politike; grindjet nacionale dhe lufta e klaneve për pushtet në Jugosllavi
70-71, 85, 86, 97-98, 99- -100, 103-104, 107-112, 187-188, 190-191, 192-193, 250-252, 290-291, 381-386, 469-474
— «vetadministrimi» jugosllav
35-38, 101-109, 380-382, 409-410, 471, 515-516
— degjenerimi i LKJ. Kongresi i 11-të i saj
60-61, 62-64, 71-72, 96-97, 105-106, 471
— agjenturë e imperializmit amerikan, përçarës dhe minues i lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Përpjekjet e tij për të vendosur hegjemoninë mbi vendet e demokracisë popullore
31-32, 34-35, 63, 76, 77, 89, 190-191, 293-294, 380, 429-431
— «ndihmat», kreditë dhe investimet e shteteve imperialiste për Jugosllavinë
66, 191, 248-249, 293-294, 380-381, 430, 516
— marrëdhëniet, bashkëpunimi dhe kontradiktat me vendet e tjera
81-82, 83-85, 119, 251, 384, 387, 453, 472-473
— qëndrimi armiqësor i revizionistëve jugosllavë ndaj PPSH dhe RPSSH
53, 54-59, 84, 190-191

K

Karter, Xhimi
15, 17, 18, 20, 21, 31, 36, 37, 38, 49, 137, 138, 139, 161-164, 172, 212, 216, 266, 269, 270, 274-277, 279, 280, 310, 311, 313-314, 359-360, 389-390, 454-455, 457, 477, 480, 481, 489, 491, 493

Kapitalizmi
— kriza e kapitalizmit; pashmangësia e zhdukjes së tij
271-273, 398-399, 420-421, 477
— lufta e klasës punëtore dhe e masave punonjëse kundër rendit kapitalist
476-477, 483-484

Kina
— strategjia globale, politika e luftës dhe përpjekjet e saj për t'u shndërruar në një superfuqi dhe për të vendosur hegjemoninë në botë
114, 121, 122, 128-129, 131- -132, 147-148, 236-238, 270, 305-307, 447-451, 452, 541- -542
— gjendja e brendshme e rëndë dhe kaotike në Kinë. Lufta për pushtet midis grupeve dhe klaneve. «Katër modernizimet» dhe dështimi i tyre. Emigrimi i punëtorëve kinezë
47, 123-124, 130, 147, 237, 285, 316-317, 427, 449-451, 524-528, 529-530, 535-541, 543-544
— «banda e të katërtëve» dhe gjyqi kundër saj
522-529, 537-541
— PK e Kinës, parti revizioniste

143-144, 145-146, 440-441, 529, 531, 534-535
— ndërhyrja e kapitaleve të huaja në Kinë dhe përpjekjet e saj për të depërtuar në vendet e tjera
119-120, 121, 285-287, 448, 451, 452, 542
— revolucioni demokratiko-borgjez dhe karakteristika të veçanta të tij
531-536
— politika e jashtme, lidhjet dhe bashkëpunimi me imperializmin amerikan
21-22, 116-117, 119, 120, 121-122, 129, 139, 144-145, 278-279, 305-306, 359-360, 427, 542
— kontradiktat e Kinës me BS dhe qëndrimet e lëkundura ndaj tij
115, 116, 286-287, 317-318, 319, 447
— përpjekjet për të vendosur hegjemoninë në vendet e Azisë Juglindore. Përkrahja e klikave reaksionare të botës nga Kina
122, 124-125, 287-288, 318-319, 422-424, 426-427, 447
— politika e saj ndaj Ballkanit dhe marrëdhëniet me Jugosllavinë e me Rumaninë
60, 117-118, 119, 124, 127, 128-129, 452-453
— lidhja e Kinës me partitë revizioniste dhe ndihma e saj për to
132
— qëndrimi i shteteve imperialiste ndaj Kinës
543
— qëndrimi armiqësor i Kinës ndaj RPSSH
25-27, 113, 117, 124, 131

KNER-i
501, 555-556

Kontradiktat në gjirin e vendeve kapitaliste e revizioniste dhe ndërmjet tyre
179-181, 205, 207-211, 215-216, 224, 232, 258-259, 261, 265-268, 289-290, 324, 390, 446-447, 452, 458, 464-466, 479-483, 489-490, 491, 493-495

Kosova, krahinat e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi dhe qëndrimi antimarksist i revizionistëve jugosllavë ndaj tyre
85-86, 386-387, 473-474

Kriza e madhe ekonomike e botës kapitaliste dhe revizioniste. Kriza e naftës
214-215, 231, 240, 276-277, 278, 279, 280-281, 283-284, 287, 388-389

L

Lenin, V. I.
28, 35, 39, 119, 149-150, 262, 301-302, 305, 407, 477, 497

Lëvizja marksiste - leniniste ndërkombëtare. Partitë m-l
— gjendja në partitë m-l, sigurimi i rolit udhëheqës, forcimi dhe lufta për spastrimin e radhëve të tyre
296, 300, 439-443
— parimet dhe normat m-l mbi të cilat ndërtohet një parti e tipit të ri të klasës punëtore
434-437, 443-444
— takimet, bisedimet, shkëmbimi i mendimeve ndërmjet partive m-l
434-436, 438-439, 444-445

Lindja e Mesme — synimet dhe kontradiktat midis superfuqive në Lindjen e Mesme për të vendosur hegjemoninë e tyre në këtë zonë
14, 16-17, 134-135, 161-166, 228-232, 314, 340, 388-391

Lufta — shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të një lufte të re botërore dhe përpjekjet e popujve për ndalimin e shpërthimit të saj
446-447, 484

Luftërat nacionalçlirimtare të popujve të botës për liri e pavarësi
— detyrat e klasës punëtore dhe të partive m-l për të marrë pjesë në këto luftëra dhe për t'i udhëhequr ato
156, 233-234, 486-487
— faktorët objektivë dhe subjektivë të shpërthimit dhe të fitores së tyre
222, 234, 240-241, 486-487

M

Mao Ce Dun, pikëpamjet dhe veprimtaria antimarksiste e tij
10, 129, 143-147, 305-307, 427, 448-449, 522, 524, 525, 534, 535-537, 539-540, 543-544

Marrëveshjet dhe kontradiktat ndërmjet Francës e RF Gjermane dhe SHBA
215-216, 266, 392-393, 479-481, 489-490, 491, 493-495, 502-503, 506

Maqedonia, problemi maqedonas
200, 293

Marksizëm-leninizmi — armë e busull për udhëheqje e veprim. Domosdoshmëria e studimit të tij nga komunistët dhe nga masat punonjëse
233, 297-298, 369-371, 398

Marks, Karl
35, 119, 149, 262, 301-302, 406-407

Mercenarët, mercenarizmi
48-52, 240

N

NATO, kontradiktat në gjirin e saj; përpjekjet e imperializmit amerikan për të ruajtur sundimin mbi vendet anëtare të saj
293, 387, 431-432, 460, 463-464, 466, 467, 551, 555

Neokolonializmi, neokolonialistët
202-205, 219-220

P

Palestina — agresioni izraelit kundër Palestinës dhe lufta çlirimtare e popullit palestinez
11-12, 136-137, 231-232

PPSH — parti revolucionare marksiste-leniniste. Mbështetja e saj në parimet e në normat m-l
132-133, 437, 439

Politika e jashtme e RPSSH, pozita ndërkombëtare e saj
— lufta për demaskimin e imperializmit, socialimperializmit dhe reaksionit
11, 140, 296-297, 300, 337-339, 340-341, 373
— qëndrimet parimore m-l të RPSSH në marrëdhëniet me vendet fqinjë
292, 387, 388, 394, 395
— qëndrimi parimor m-l ndaj PK të Kinës
148-149, 440-441
— përkrahja e RPSSH për popullin palestinez, për popujt arabë dhe për popujt e tjerë të botës
12, 13, 232
— rritja e prestigjit dhe e autoritetit të RPSSH në botë. Miqtë dhe dashamirësit për vendin tonë
232-233, 297-299, 393-394

Polonia
— gjendja e rëndë ekonomike dhe politike e saj. Restaurimi i kapitalizmit në Poloni
254, 490-491, 499-502, 507-508, 513-514, 517-518, 545-547
— grevat e punëtorëve polakë, shkaqet, karakteri dhe pasojat e tyre. Sindikatat e reja «të pavarura vetadministruese» dhe «solidarnost»
496-521, 550-551
— pozitat sunduese dhe roli reaksionar i kishës katolike në Poloni. Vizita e Papa Pavlit të 2-të në Poloni dhe qëllimet e saj
253-262, 499-500, 517, 545-546
— kontradiktat e revizionistëve polakë me revizionistët sovjetikë. Afrimi i Polonisë me SHBA dhe ndihmat e imperializmit amerikan për të
255-256, 258-259, 500-501
— qëndrimi i shteteve revizioniste dhe imperialiste ndaj ngjarjeve kundërrevolucionare në Poloni
498-499, 502-507, 508-510, 513, 515-516, 517-518, 520-521, 547-556
— partia revizioniste polake, parti borgjeze
255-256, 514, 545, 550

Propaganda, shtypi, radiotelevizioni i shteteve borgjeze dhe revizioniste
119, 193-194, 267, 313, 315, 316, 317, 332-334, 335-336, 397-411, 412-421

R

Revizionizmi modern — afrimi dhe bashkëpunimi i partive revizioniste me partitë socialdemokrate dhe socialiste
295, 436, 441-443

Revolucioni
— rruga e vetme për përmbysjen e kapitalizmit
87, 234, 321, 420-421, 477
— sigurimi i aleatëve të proletariatit në revolucion. Përgatitja e revolucionit dhe detyrat e partisë m-l në këtë drejtim
234, 235-236, 487-488
— lufta e revizionistëve modernë kundër teorisë leniniste mbi revolucionin.
149-150, 372-373

Rumania — lidhjet, bashkëpunimi dhe kontradiktat e saj me SHBA, me BS dhe me Kinën
118-119, 289, 290

RR

Rrethimi imperialisto-revizionist i Shqipërisë
278, 291-292, 299-300

S

SALT-2, falsiteti i tij mbi çarmatimin dhe mjet në duart e superfuqive për mashtrimin e popujve
212-216, 236, 269-271

Socialdemokratët, socialistët dhe partitë e tyre
294-296, 307-309

Stalini, J. V.
— vlerësimi i tij nga PPSH dhe nga forcat m-l
143, 332, 335
— qëndrimi antimarksist i revizionistëve sovjetikë ndaj Stalinit dhe veprës së tij
332-334
— qëndrimi i popujve sovjetikë ndaj Stalinit dhe veprës së tij
333, 336

Superfuqitë
— strategjia globale, politika hegjemoniste dhe ekspansioniste për ndarjen e rindarjen e zonave të influencës

13-14, 155-156, 235, 340--342, 346-347, 412-421, 446--447, 504
— marrëveshjet dhe kontradiktat midis superfuqive 115-116, 155, 234-236, 312, 314, 351-352, 358-360

SH

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi amerikan
— kriza e madhe ekonomike dhe politike në SHBA dhe pasojat e saj brenda dhe jashtë vendit 15, 47, 274-277, 278-280, 310-312, 412-413, 415, 477--479
— kreu i imperializmit botëror, politika e luftës, e agresionit dhe e ekspansionit 150-151, 206, 270, 281, 382--383, 387-388, 459-460, 466--467, 504, 506
— «ndihma» dhe investimet amerikane për vendet kapitaliste dhe revizioniste 114-115, 155, 185-186, 466
— teoria reaksionare e imperializmit amerikan mbi «sigurimin kombëtar» dhe kritika ndaj saj 412-421

T

Teoritë e revizionistëve jugosllavë dhe kritika ndaj tyre
— kritika e pikëpamjeve mbi «detantën», «mosangazhimin», «paqen dhe bashkekzistencën paqësore» 33-34, 77-78, 89-90, 93-96, 127-128, 323-324, 399-409, 411
— kritika e pikëpamjeve të tij mbi «socializmin specifik» 72
— kritika e pikëpamjeve të tij mbi mohimin e diktaturës së proletariatit dhe të rolit udhëheqës të partisë 98-100
— kritika e pikëpamjeve të tij mbi «çarmatimin» 33, 67, 86-87

Teoria e «tri botëve» — karakteri reaksionar dhe armiqësor i saj ndaj popujve 12-13, 61-62, 202, 206, 261

Tito, titizmi 31-33, 64-92, 100, 104-105, 117, 118, 127, 128, 129--130, 188-190, 191, 192, 195, 242-252, 291, 293, 322, 323-324, 380, 381, 398-399, 406-408, 410, 429-430, 433, 469-471

Traktati i Varshavës — karakteri agresiv i tij, veçël në duart e socialimperialistëve sovjetikë 186-187, 466, 467, 500, 553--554, 555

Traktati izraelito - egjiptian i Kemp Dejvidit, karakteri imperialist antiarab dhe qëndrimi i popujve arabë ndaj tij 134, 137-139, 172-181, 227--228, 281-282

Tregu i Përbashkët Evropian — vendet anëtare të tij, synimet, kontradiktat midis tyre dhe me SHBA 265-266, 460-462, 465-466

Turqia, gjendja e brendshme dhe politika e jashtme e saj. Qëndrimi ndaj RPSSH 118, 292-293, 394-395

V

Vatikani — qendër e reaksionit botëror. Lufta e tij kundër socializmit dhe marksizëm-leninizmit 255, 256-258, 259-263, 342

Vendet arabe
— politika hegjemoniste dhe përçarëse, interesat e imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik në vendet arabe; kontradiktat midis tyre 173-174, 178, 179-181, 225--232
— problemi i forcimit të unitetit të popujve arabë dhe lufta e tyre kundër sionizmit izraelit dhe superfuqive 173-174, 177-178, 179-180, 208-209, 223-224, 226, 227--228, 281-283

«Vendet e paangazhuara»
— karakteri reaksionar dhe falsiteti i kësaj teorie. Qëndrimi i revizionistëve modernë dhe i shteteve imperialiste ndaj saj 12, 127-128, 202-211, 242--243, 244-252, 315, 322--325, 428-433
— kontradiktat, mosmarrëveshjet në gjirin e «vendeve të paangazhuara» 205, 207-211, 245-246, 324

Vendet dhe popujt me besim mysliman — lëvizjet përparimtare antiimperialiste, antifeudale dhe shoqërore të popujve me besim mysliman dhe vlerësimi i tyre nën prizmin e materializmit dialektik dhe historik 345, 351-379, 390-391, 417--419

Vendet revizioniste
— rivendosja e kapitalizmit, kriza e rendit politik dhe ekonomik në këto vende 182-183, 186, 187, 516
— depërtimi i kapitaleve të huaja 186, 187, 393, 503-504, 516--517, 547
— politika e jashtme. Qëndrimi i tyre ndaj RPSSH 290, 296-297
— kundërshtimi i tyre ndaj diktatit dhe hegjemoniz-

mit të socialimperialistëve sovjetikë
183-185, 195-200, 289-290, 515, 547-549, 552, 554, 555--556

Vietnami
— gjendja e brendshme politike dhe ekonomike e tij 425-426
— politika e jashtme, marrëdhëniet e tij me vendet e tjera
209-210, 318-320, 422, 424--425

Vigjilenca revolucionare e popujve ndaj imperialistëve dhe revizionistëve modernë
458, 468

Vigjilenca revolucionare e popullit shqiptar ndaj imperialistëve dhe revizionistëve modernë
386, 388, 396, 455-456, 468

TREGUESI I EMRAVE

A

Adenauer, Konrad
489
Al Bakri
282, 357
Alia, Ramiz
11, 53, 57, 127, 337, 456
Amin, Hafizullah
339, 344, 352
Arafat, Jaser
176, 231, 232
Aref, al Salam
357
Asad, Hafez
139
Aust, Ernst
434

B

Babjush, Eduard
501-502, 506, 508
Baftiar, Shapur
368
Bakariç, Vladimir
291
Bartu, Lui
196
Bazargan, Mahdi
368
Begin, Mënaem
17, 18, 137, 138, 162, 163, 175, 176, 179, 283
Bjerut, Boleslav
253, 499
Bokasa, Zhan Bedel
219
Bonaparti, Napoleon
7-8
Brand, Vili
490
Braun, Harold
178, 212
Brzezhinski, Zbignjev
178, 212, 258, 342, 412--421, 509

Ç

Çan Kai Shi
534
Çaushesku, Nikola
8, 68, 124, 290

Çen Jou Ju
522
Çian Çin
317, 524, 525, 526
Çu De
525
Çu En Lai
10, 144, 243, 305, 306, 309, 524, 525, 527, 528, 529, 538, 540-541

D

Dajan, Moshe
272
Daut, Mohamed
352
De Çomoro, Violeta
313
Demirel, Sulejman
293, 395
D'Estën, Zhiskar Valeri
18, 20, 49, 170, 215, 417, 465, 480, 481, 482, 489, 493, 502-503
Dë Gol, Sharl
215, 489
Dinuçi, Fosko
442
Dimitrov, Gjergj
190
Dobrinin, Anatol
212
Dolanc, Stane
111
Dubçek, Aleksandër
507, 548

E

Elisabet, Aleksandra
243-244
Emam, Xhafar Sharif
125

F

Faisal, Khaled
357
Fam Van Dong
425
Firjubin, Nikolai
286
Fonten, Andre
454-455
Franko, Françisko
74
Frashëri, Abdyl
56
Frashëri, Naim
56
Frashëri, Sami
56

G

Gandi, Indira
360
Gomulka, Vladislav
255, 500, 517
Gierek, Eduard
255, 490, 500, 502, 505, 506, 507-508, 509, 510, 517, 520, 521, 548
Gotbzadeh, Sadek
485
Grliçkov, Aleksandër
397-411
Gromiko, Andrei
179

H

Habash, Xhroxh
232
Hasan II (mbret i Marokut)
224-225
Henderson, David
125, 342
Honeker, Enrik
490, 503, 520
Hrushov, Nikita
183, 191, 334, 380, 457
Huan Hua
426-427

J

Jao Ven Juan
317, 526, 528
Jarosheviç, Piotr
501, 508
Jegielski, Niecislav
498
Jeh Çien Jin
538, 539
Jen Çien Ji
524
Jovanoviç, Gj.
470

K

Kadaf, Mohamer
17, 170, 226, 248, 357, 392, 486
Kadar, Janosh
548
Kallagan, Xhejms
295
Kapo, Hysni
113
Karagjorgjeviç, Aleksandër I
196
Kardel, Eduard
106, 107, 111, 191, 380, 381
Karmel, Babrak
344
Karsten, Karl
179
Kasem, Abdyl Kerim
357
Kastro, Fidel
314, 322
Kenedi, Xhon
50
Khomein, Ajatollah
166, 167, 168, 174-175, 180, 229, 230, 339, 340, 341, 342, 358, 364, 368, 379, 485
Kim Ir Sen
121, 423-424
Kisinger, Henri
161
Koh, Host
434
Kolombo, Emilio
491-492
Kosiga, Françisko
482

L

La Fajet, Mari Zhozef
533
Le Zuan
425
Li Hsien Nien
285-286, 524, 528, 538
Lin Biao
145, 146, 524-525, 526, 527, 537, 540, 541
Liu Shao Çi
10, 427, 524, 525, 538, 541

Lubiçiç, Nikolla
86, 111, 472
Luigji i 14-të
532
Luigji i 18-të
7
Luigji i 13-të
532

M

Maknamara, Robert
293
Marshe, Zhorzh
295
Mazarin, Zhyl
532
Miniç, Millosh
76, 77, 248, 472
Miteran, Fransua
295
Minxenti, Jozef
257
Mobutu, Sese Seko
49, 68, 219
Mok, Alois
308, 309
Moro, Aldo
43
Mosadeg, Mohamed
125, 367
Musolini, Benito
43, 44

N

Nagib, Muhamad
356
Nagi, Imre
548
Naser, Gamal Abdel
165, 202, 206, 226-227, 243, 282, 356, 362
Nehru Xhavaharlal
96, 202, 206, 243
Nej, Mishel
7
Neto, Agostino
50
Nierere, Julius
210
Nikeziç, Marko
470
Nikson, Riçard
144, 145
Nkruma, Kvame
243

P

Pahlevi, Reza
124, 125, 229, 230, 281, 338, 364, 367, 389
Pastora, Eden
313
Pavli i 2-të, Xhovani, Papa
253, 256, 257, 258, 259, 342, 507
Petion, Zherom
533
Pilati, Pons
455
Pinoçet, Augusto
74
Pollo, Stefanaq
56
Ponse, Zhan Fransua
215, 266
Ponjatovski, Jozef
509
Popoviç, Koça
470

Pot, Pol
423, 424, 425

R

Rankoviç, Aleksandër
98, 381, 470
Rishelië, Armand Zhan
532
Robespier, Maksimilian
533
Roldos, Joaime
313
Romel, Ervin
356

S

Sadat, Anvar-el
11, 16, 17, 18, 20, 137, 138, 139, 162, 169, 175, 176, 177, 356
Sadr, Bani
485
Said, Nuri
357
Salazar, Antonio
219
Samfan, Kieu
423-424
Sari, Jeng
423
Selasie, Haile
21, 222
Sihanuk, Norodom
287-288, 318, 424
Somoza, Anastasio
312
Stamboliç, Petar
472
Strobel, Franc
441
Sukarno, Ahmet
94, 202, 243
Sun Jat Sen
531
Suslov, Mihail
384

SH

Shariat, Ali
368
Shehu, Mehmet
56
Shmid, Helmut
215, 266, 465, 481, 489, 490, 492, 493, 503

T

Taraki, Nur Muhamed
339, 344, 352
Ten Hsiao Pin
10, 141, 142, 147, 285, 306, 317, 423, 427, 448, 149, 524, 528, 529-530, 538, 539, 540-541, 542, 543-544
Tripallo, Miha
470
Trudo, Pierr Eliot
455

TH

Theçer, Margaret
216, 295-296, 455

U

Ul Hak, Zia
360

V

Valdhajm, Kurt
9
Valesa, Les
498
Van Hun Ven
525, 528
Van Nguen Xhiap
425
Vens, Sajrus
139, 313
Vidiç, Dobrivoje
85, 472
Vishinski, Andrea Januareviç
254, 507
Vu Fa Hsien
526

X

Xoxe, Koçi
190

Z

Zaher Shah, Mohamed
352

ZH

Zhivkov, Teodor
195, 249, 384

TREGUESI GJEOGRAFIK

A

Abadan (Iran)
369
Aden (Jemen)
154, 165, 231, 362
Afrika e Veriut
222-224, 225-226
Afrika Franceze
219, 222
Afrika Jugore
219, 221, 222
Afrika Lindore
219
Afrika Qendrore
219, 222, 226
Angolë
14, 50, 52, 154, 210, 219, 221, 222, 322
Arabia Saudite
17, 19, 20, 163, 165, 166, 169, 173, 174, 177, 178, 180, 208, 214, 227, 228-229, 281, 390
Azerbajxhan
169
Azia Juglindore
121, 267, 318, 320

B

Bab-el-Mandeb (ngushtica ~)
19
Bagdad
177, 223, 357
Belgjikë
555
Beograd
245
Bon
179, 480, 492, 493
Bosnjë (Jugosllavi)
470
Brioni (Jugosllavi)
245
Briri i Afrikës
76
Bullgari
117, 118, 186, 249, 250, 261, 292, 293, 500, 515, 549

C

Cisjordani
19, 176, 231

Ç

Çad
226
Çekosllovaki
261, 262, 500, 507, 515, 549, 550, 552, 553

D

Damask
223
Dancing (Poloni)
547
Deti i Kinës Jugore
287
Deti i Kuq
19, 165

E

Elbë (ishulli ~)
7
Emiratet e Gjirit Persik
169, 173, 174, 177, 178, 180, 208, 227, 231, 390
Eritre
50, 154, 165, 221, 222, 390
Etiopi
21, 32, 50, 52, 154, 210, 221, 222, 322, 390
Evropa Perëndimore
238, 280, 287

F

Filipine
121, 238, 426, 457
Fontenëblo (Francë)
7
Fusha e Tabasit (Iran)
456, 457

G

Gadishulli Iberik
482
Gafsa (Tunizi)
392
Gaza (rripi ~)
19, 172, 176, 231
Gdansk (Poloni)
496-497, 499, 502, 507, 509, 510, 513, 517, 519
Gdinia (Poloni)
496-497, 499, 502, 507, 513, 517, 519
Golan
19, 172, 176, 177, 227
Grudë (Jugosllavi)
55
Guci (Jugosllavi)
55

GJ

Gjermania Lindore
327, 490, 491, 500, 515, 517, 520, 549, 550, 553
Gjiri i Adenit
19
Gjiri i Akabas
176
Gjiri i Derrave
50
Gjiri Persik
17, 121, 228, 339, 340, 389 415, 465

H

Havanë
210, 247-248, 251, 315, 322, 323
Hercegovinë (Jugosllavi)
470
Hot (Jugosllavi)
55
Hungari
261, 262, 500, 515, 517, 549, 550

I

Indi
121, 267
Indonezi
238, 457
Islamabad (Pakistan)
390

J

Japoni
205, 237, 238, 267, 279, 306, 311, 317, 340, 388, 475
Jemeni i Jugut
165, 180, 208, 362-363, 390
Jemeni i Veriut
165, 166, 180, 208, 362, 390
Jerusalem (Izrael)
139, 161, 163, 172, 176
Jordan (lumi ~)
19, 137, 172
Jordani
174

K

Kaçanik (Jugosllavi)
55
Kajro
18, 161, 162, 227
Kamboxhia
209, 238, 283, 318, 320, 422, 423, 424, 457
Kanada
475
Kanali i Suezit
19, 165, 176, 177
Katanga
49
Kepi i Gjelbërt (ishujt ~)
219
Kipur
178
Kore
121, 318
Kroaci
37, 103, 291, 385, 470, 473
Kubë
50, 209, 240, 247, 322, 324
Kuito
313
Kuvajt
173, 174, 180

L

Laos
238, 320, 322, 423, 457
Liban
20, 170, 173, 174, 220, 226, 231
Libi
20, 139, 161, 169, 170, 177, 208, 210, 220, 222-223, 226, 356-357, 392

Lindja e Largme
238, 267
Lushan (Kinë)
524, 525

M

Mali i Zi
85, 103, 385, 470
Marok
17, 19, 139, 170, 220, 221, 222-223, 224-225, 226, 227, 355
Mauritani
17, 221, 225
Mitrovicë (Jugosllavi)
55
Mongoli
527
Moskë
318, 482, 489
Mozambik
219

N

Namibi
76, 80
Nikaragua
312-313

O

Ogaden
50
Oman
165, 169, 178, 180, 390
Oqeani Atlantik
225
Oqeani Indian
19, 389
Oqeani Pacifik
237

P

Pakistan
121, 153, 210, 359-360, 391
Paris
480, 492, 493
Pekin
316, 318
Phenian
318
Plavë (Jugosllavi)
55
Portugali
318, 482

R

Rodezi
50

S

Saharaja Perëndimore
17, 225
Serbi
37, 85, 103, 193, 385, 473
Siberi
289
Sinai (Egjipt)
19, 172, 175, 178
Singapor
426, 457
Siri
16, 17, 20, 139, 154, 164, 169, 177, 179, 180, 208, 220, 227, 228, 231, 272-273, 282, 356, 391
Slloveni
37, 103, 470
Somali
13, 21, 32, 50, 52, 154, 210, 222, 390
Spanjë
482
Sudan
50, 169, 177, 220, 226

SH

Shabë (Zaire)
49
Shën Elenë (ishulli)
8
Shtetin (Poloni)
496, 502, 507, 513, 517, 519

T

Tabriz (Iran)
368, 369
Tajlandë
424, 426, 457
Tanzani
220, 222, 247
Teheran
223, 368, 458
Tirani (ngushtica e)
176
Tivar (Jugosllavi)
55
Tunizi
177, 208, 220, 222-223, 226, 355, 392

U

Uashington
18, 161, 162, 172, 179, 212, 478, 491
Ugandë
210, 222, 247

V

Varshavë
480, 489
Venecie
482
Venezuelë
392
Vjenë
7
Vojvodinë (Jugosllavi)
385

Z

Zaire
14, 49, 52, 222
Zambia
50
Zimbabv
76, 80

LËNDA

1977

Faqe

1. — **8 gusht 1977.** Konferenca e mossigurimit evropian në Beograd shënoi disfatën e «botës së tretë» dhe «të paangazhuar» 7
2. — **19 shtator 1977.** Të demaskohen fort armiqtë e popujve arabë. (Teza për artikull) 11
3. — **17 dhjetor 1977.** Çështja e Lindjes së Mesme në dritën e ngjarjeve të fundit 16

1978

1. — **12 janar 1978.** Shprehje e ndjenjave armiqësore të udhëheqjes revizioniste kineze ndaj vendit tonë 25
2. — **28 shkurt 1978.** Struktura e shoqërisë italiane është e kalbëzuar 28
3. — **9 mars 1978.** Titoja pohon botërisht unitetin e tij me imperializmin amerikan 31
4. — **1 prill 1978.** Revizionistët sovjetikë përpiqen të fshehin tradhtinë e tyre 39
5. — **18 prill 1978.** Fashizmi po ngre krye kudo 41

Faqe

6. — **20 maj 1978.** Mercenarizmi në rendin e ditës 48
7. — **1 qershor 1978.** Të demaskojmë renegatët e kombit shqiptar 53
8. — **10 qershor 1978.** Lidhja Shqiptare e Prizrenit, moment krucial në historinë heroike të popullit tonë 54
9. — **22 qershor 1978.** Disa mendime për Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë 60
10. — **30 korrik 1978.** Kinezëve iu dha përgjigja që meritonin 113
11. — **29 gusht 1978.** Trekëndëshi i superfuqive 114
12. — **31 gusht 1978.** Ide të tjera për artikullin mbi udhëtimin e Hua Kuo Fenit në Ballkan 127
13. — **22 shtator 1978.** Tre banditë politikë dhe problemet e Lindjes së Mesme 134
14. — **29 shtator 1978.** Përse disa parti (M-L) të Amerikës Latine nuk i kuptojnë gabimet dhe fajet e Mao Ce Dunit 141
15. — **31 dhjetor 1978.** Mbi gjendjen ndërkombëtare gjatë vitit 1978 151

1979

1. — **15 mars 1979.** Arsyet e ecejakeve të Karterit në Lindjen e Mesme 161
2. — **31 mars 1979.** Një traktat imperialist antiarab 172
3. — **15 prill 1979.** Rreth gjendjes në vendet revizioniste 182
4. — **26 prill 1979.** Teoria e «botës së paangazhuar» po falimenton 202

Faqe

5. — **13 maj 1979.** SALT-2 212
6. — **26 maj 1979.** Panoramë politike 217
7. — **28 maj 1979.** Titoja dhe vendet «e paangazhuara» 242
8. — **7 qershor 1979.** Papa pritet në Poloni si perëndi e si shpëtimtar 253
9. — **13 qershor 1979.** Një parlament formal 264
10. — **19 qershor 1979.** Panoramë politike 269
11. — **17 korrik 1979.** Fokuset e presidentit Karter 274
12. — **19 korrik 1979.** Kronika e ngjarjeve të këtyre ditëve dhe çfarë konkluzionesh mund të nxjerrim prej tyre 278
13. — **23 korrik 1979.** Uniteti ndërkombëtar i Evropës mund të arrihet vetëm në bazë të mësimeve të marksizëm-leninizmit 301
14. — **13 gusht 1979.** Lëkundje e madhe në politikën e imperializmit dhe të revizionizmit 310
15. — **19 gusht 1979.** Mbledhja e vendeve «të paangazhuara» në Havanë, një teatër kukullash 322
16. — **4 dhjetor 1979.** Gjermanoperëndimorët janë të detyruar të na paguajnë dëmshpërblimet. (Teza) 326
17. — **21 dhjetor 1979.** Emri dhe vepra e J. V. Stalinit nuk do të vdesin në shekuj 332
18. — **27 dhjetor 1979.** Larg duart nga Irani! (Teza për artikull) 337
19. — **31 dhjetor 1979.** Viti 1979 mbyllet me situata revolucionare 344

1980

1. — **Janar 1980.** Ngjarjet që po zhvillohen në vendet myslimane duhet të shikohen në dritën e materializmit dialektik e historik 351
2. — **13 shkurt 1980.** Panoramë e gjendjes ndërkombëtare 380
3. — **21 shkurt 1980.** «Frymëzimi» i fundit i titizmit në pragun e vdekjes së «babait» të tij 397
4. — **28 shkurt 1980.** Mendime mbi intervistën e Zbigniev Brzezhinskit, ndihmës i Presidentit Karter për çështjet e sigurimit kombëtar 412
5. — **10 mars 1980.** Bisedime për fasadë 422
6. — **16 mars 1980.** Politika e «mosangazhimit» — një kështjellë e ndërtuar mbi rërë 428
7. — **24 mars 1980.** Tezat e PK të Gjermanisë (marksiste-leniniste) 434
8. — **31 mars 1980.** Sot në botë nuk mund të ruhet statukuoja 446
9. — **27 prill 1980.** Akt banditesk i Karterit që pësoi disfatë të turpshme 454
10. — **30 prill 1980.** Mbi situatën ndërkombëtare 459
11. — **23 maj 1980.** Trashëgimia e Titos 469
12. — **1 korrik 1980.** Thellohet kriza e madhe ekonomike botërore 475
13. — **14 gusht 1980.** Franca dhe Gjermania Federale nuk i nënshtrohen diktatit të Karterit 489
14. — **1 shtator 1980.** Çfarë fshihet prapa grevave të punëtorëve të porteve polake të Balltikut? 496
15. — **20 nëntor 1980.** Gjyqi i të gjallëve e i të vdekurve, gjyqi i Mao Ce Dunit 522

Faqe

16. — **Nëntor 1980.** Ngjarjet në Poloni dhe pasojat e tyre të brendshme e të jashtme 545
Treguesi tematik i lëndës 557
Treguesi i emrave 569
Treguesi gjeografik 575